



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 9, 14, 15 DHE 27 SHKURT 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 9, 14, 15. I 27. FEBRUARA 2017. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë,
5. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
7. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë,
8. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues, në lidhje me përgjegjësinë mbi Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës,
9. Debat parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, sipas kërkesës së deputetit Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë nënshkrues,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-135 për ndërmjetësim,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-214,
16. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ARE),
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
18. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera,
19. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit për Ankesa të Medie,
20. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë
21. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-137 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,
22. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-149 për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë,
23. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje Predloga-rezolucije, u vezi organizovanja predškolskog i pred univerzitetskog obrazovanja na Kosovu,
5. Glasanje Predloga- rezolucije, u vezi hapšenja aktivista Pokreta “Vetëvendosje”,
6. Osnivanje Ad-hoc Komisije za izbor jednog (1) člana Borda Radio Televizije Kosova,
7. Interpelacija Premijera Kosova Isa Mustafa, na zahtev poslanika Rexhep Selimi, podržan od 14 poslanika potpisnika, u vezi sa stvorenom situacijom u Mitrovici,
8. Interpelacija Premijera Kosova Isa Mustafa, na zahtev poslanika Visar Ymeri, podržan od 9 poslanika potpisnika, u vezi odgovornosti o Zakonu o zdravstvenim osiguranjima u Republici Kosova,
9. Parlamentarna rasprava u vezi Bezbednosnih snaga Kosova, na zahtev poslanika Daut Haradinaj, podržan od 10 ostalih poslanika potpisnika,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-129 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-149 o izvršenju krivičnih sankcija,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-127 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-033 o Posebnoj komori Vrhovnog suda Kosova po pitanjima u vezi sa Kosovskom agencijom za privatizaciju,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-150 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosova,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-135 o posredovanju,
14. Prvo razmatranje N/zakona br.05/L-133 o izmenama i dopunama zakona br.04/L-036 o službenim statistikama Republike Kosova,
15. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-143 o izmenama dopunama Zakona br. 04/L-072 o kontroli i nadgledanju državne granice, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-214,
16. Razmatranje Agende o Evropskim Reformama (AER),
17. Razmatranje Izveštaja Komisije za prava i interese zajednica i povratak u vezi nadgledanja sprovođenja člana 11. Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosovo,
18. Izbor jednog (1) člana Sudskog saveta Kosova iz redova drugih zajednica,
19. Izbor 1 (jednog) člana Borda za žalbe medija,
20. Glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o slobodi vera na Kosovu,
21. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-137 o ratifikaciji Sporazuma u vezi osnivanja Fonda Zapadnog Balkana,
22. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-149 o ratifikaciji Sporazuma za osnivanje Regionalne kancelarije za omladinsku saradnju između Kosova, Albanije, Bosne i Hercegovine, Crne Gore, Makedonije i Srbije,
23. Izbor jednog (1) člana Sudskog saveta Kosova iz redova srpske zajednice.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 6 shkurt 2017.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

A ka kolegë deputetë që e donë fjalën. Janë të lajmëruar tre: Abdyl Ymeri, Shaip Muja, Selville Halimi. Zonja Halimi, fjala për ju. Jemi në seancë të rregullt plenare.

SELVILLE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje, kolegë,

Çështja që dua të ngre unë sot, faktikisht janë dy çështje, po e ngre në emrin tim personal si deputete.

E para ka të bëjë me sektorin privat, me të punësuarit në sektorin privat.

Qeveria duhet të marrë masa dhe të mos e shohë sektorin privat vetëm si taksapagues dhe të kujdeset për tatimet që ata i paguajnë, por t'i japë prioritet mbrojtjes së të drejtave dhe sigurimit shëndetësor të punëtorëve në sektorin privat. Çka do të thotë? Kam propozime konkrete.

Meqenëse sektori privat më tepër është i orientuar kah konsumimi, mendoj që duhet të jenë oraret e punës sipas Ligjit të punës dhe Ligji për festat zyrtare të vlejë edhe për sektorin privat. Këtë e dëshmoj me faktin se sa herë takohem me punëtorët e sektorit privat, kërkojnë që edhe ata në sektorin privat duhet të trajtohen ligjshmërisht dhe, në njëfarë forme, e shprehin edhe një admirim për ne që jemi në institucione publike, sepse i kemi vikendet dhe festat zyrtare ditë pushimi, kurse për ata kjo nuk vlen. Kështu që Qeveria duhet të marrë masa dhe të rregullojë këtë çështje.

Dhe, çështjen tjetër që është mjaft e ndjeshme. Unë mendoj se para dy ditësh në mediat publike u dha një lajm, ku nga viti 2009 deri në vitin 2016 mbi 37 mijë qytetarë të Kosovës me dëshirë e kanë lëshuar shtetësinë e Kosovës.

Qeveria duhet ta marrë shumë seriozisht këtë çështje.

E para, duhet të marrë iniciativë që të ashpërsojë kriteret, do të thotë, ta ndryshojë Ligjin për shtetësinë dhe t'i ashpërsojë kriteret e lëshimit të shtetësisë dhe të kujdeset që Kosova të sigurojë mirëqenie për të gjithë qytetarët, edhe për ata që janë në diasporë dhe të mos u krijohet mundësia që për të fituar disa të drejta në diasporë, ata me vullnet ta lëshojnë shtetësinë e Kosovës.

Kur e them këtë e kam parasysh edhe faktin se nataliteti në Kosovë është në rënie e sipër. Prandaj për lëshimin e shtetësisë me vullnet, duhet t'i bëjmë pyetje secili vetes se për çka duhet të angazhohemi ne? Përveç që na interesojnë territori i Kosovës, shtetësia, sovraniteti, duhet të na interesojë edhe jeta e qytetarit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Abdyl Ymeri e ka kërkuar fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 nga Serbia, e cila e filloi okupimin klasik në të gjitha sferat, në vitin 1991 nisi largimi masiv i punëtorëve shqiptarë nëpër institucionet e asaj kohe, do të thotë u vendosën masat e dhunshme.

Gjithçka filloi më 3 shtator, me grevën e madhe të organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës që kërkonte heqjen e masave të dhunshme në organizata dhe në institucione të ndryshme nga regjimi serb.

Edhe punëtorët e administratës dhe policët e asaj kohe në masën më të madhe u larguan nga vendi i tyre i punës.

Sot, pas gjithë atyre viteve, dy sindikatat, Sindikata e Pavarur e Administratës Publike të Kosovës dhe Sindikata e Policëve të viteve '90 që përfaqësojnë dhe avokojnë për të drejtat dhe interesat e nëpunësve të shtetit të Kosovës, ka kohë që nëpërmjet shkresave të shumta dhe, së fundi, edhe me anë të një propozimi të përcjellë në disa institucione përgjegjëse të vendit kanë kërkuar plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Ata e konsiderojnë ligjin e tashëm diskriminues, me që ua pamundëson njohjen e stazhit të viteve 1989-1999, në kohën kur, sipas tyre, dhunshëm janë larguar nga puna.

Të dy sindikatat në këtë propozim thonë se ajo periudhë me këtë ligj është njohur nga institucionet e Kosovës si periudhë normale, edhe pse, sipas tyre, në atë kohë ishte suprimuar gjithçka.

Këto dy sindikata e konsiderojnë të nevojshme këtë propozim dhe nismën legislative për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për skemat pensionale të financuar nga shteti, me që, për bindjen e tyre, është ligji më diskriminues dhe më dëmtues dhe dënues për nëpunësit e shtetit të viteve '90, i cili shkel në pafundësi të drejtat njerëzore të kësaj kategorie të asaj kohe.

Këto dy sindikata e argumentojnë me faktin se në nenin 8, paragrafi 1, me të cilin përcaktohen kushtet për njohjen e pensionit kontributdhënës të moshës, kërkohet mosha 65 vjeçe dhe stazhi pensional kontributdhënës para datës 1. 1. 1999, i bazuar në Ligjin e KSAK-së të vitit 1983, "Gazeta Zyrtare e KSAK"-së, numër 26/83, që në fakt ky ligj, 'de fakto' dhe 'de jure', e legjitimon si periudhë normale periudhën kohore 1989-1998.

Duke ua pranuar stazhin kontributdhënës të gjithë atyre që punuan në këtë periudhë edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem, ua lejoni fjalën, edhe kolegë deputetë, 30 minuta, në 10:15 kemi filluar dhe pastaj gjysmë ore do të jemi tamam në kohë.

ABDYL YMERI: Edhe pse në Kosovë ishte suprimuar çdo gjë. Ndërsa të gjithë ata punëtorë që ishin larguar nga puna me karakter politik dhe nacional, si dhe për shkak të aktiviteteve të tyre në të mirë të vendit, nuk u pranohet ky stazh.

Duke mos ua njohur këtë stazh të larguarve nga puna në këtë periudhë, ata me rastin e pensionimit nuk i plotësojnë kushtet për pension kontributdhënës dhe nuk marrin pensionin e plotë.

Unë konsideroj se është mirë që të merren parasysh kërkesat e tyre, e dy sindikatave, dhe të analizohen mirë dhe të shikohet, së pari, a është vërtet ky ligj diskriminues, siç thonë ata, dhe nëse është, të shqyrtohet mundësia për zgjidhjen adekuate të kësaj çështjeje, sepse është absurde që ata që janë larguar gjatë kësaj periudhe nga puna dhunshëm të mos e gëzojnë pensionin e plotë kontributdhënës, ku ka raste të tilla që edhe për një ditë nuk arrijnë ta plotësojnë kushtin për pension të plotë.

Gjithashtu unë konsideroj se te Ligji për skemat pensionale duhet të ndryshohet edhe neni 16, në mënyrë që familjarët e dëshmorëve dhe martirëve të kenë të drejtën në pension që u takon në bazë të këtij ligji dhe pensioni që u takon për djalin apo vajzën të rënë për lirinë e Kosovës, si një

e drejtë që u takon në bazë të Ligjit për veteranët dhe invalidët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri, të bëhet gati Murat Hoxha.

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, Deputetë në këtë Kuvend të Republikës, Nesër, pra më 10 shkurt, bëhen 10 vjet nga demonstrata që e kishim organizuar kundër planit të Ahtisarit.

Atëherë demonstrohej vullneti politik kolektiv për një Kosovë sovranë, pra vetëvendosjen, dhe kundër planit të Ahtisarit, i cili për së brendshmi e mohonte edhe vullnetin dhe e minonte një sovranitet të Republikës.

Mu këta politikanë që edhe sot vijnë vërdallë, para 10 vjetëve ia dhanë Serbisë 10 komuna, 45 zona eksteritoriale, në parlament atyre deputetëve që ua rezervuan ulëset, e bënë shuarjen e TMK-së, betonimin e sundimin ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen e Kosovës në borxhin e jashtëm të Serbisë.

Gjithnjë me idenë se kur Serbia e merr pakon e Ahtisarit, ajo do ta njohë pavarësinë tonë.

Serbia i mori të gjitha elementet përbërëse të pakos, ndërsa pakon si ambalazh dhe pavarësinë nuk na i pranoi.

Këta pushtetarë e pranuan Serbinë brenda Kosovës, kurse Serbia nuk e pranoi Kosovën jashtë Serbisë.

Pas shpalljes së pavarësisë, ky Kuvend, në të cilin ne të Lëvizjes ende nuk ishim, i miratoi turboligjet e Ahtisarit, ani se ishte e qartë se Serbia nuk do të na njihte, dhe pazaret po vazhdojnë edhe sot.

Tash Serbia komunat e Ahtisarit po i do të bashkuara në ‘Zajednicë’ dhe prapë kemi një qeveri, e cila po ia pranon këtë kërkesë Serbisë, për ta konsoliduar kështu edhe më shumë kontrollin faktik në mbi 25% të territorit të Republikës së Kosovës dhe për ta centralizuar decentralizimin etnik që kishte ndodhur në atë botë.

Edhe sot e kësaj dite, 10 vjet pas Ahtisarit e 9 vjet pas shpalljes së pavarësisë, ne diskutojmë se si do të duhej ta ndërtojmë ushtrinë tonë për ta mbrojtur territorin e garantuar, sovranitetin.

Mitrovica, që u nda në dy komuna me Ahtisarin, sot po muros ndarjen nëpërmjet mureve dhe konstrukteve të tjera të betonit.

Këto ditë vazhdon edhe aktualiteti i rënies më Mon Balajt e Arben Xheladinit. Këta të dytë u vranë nga policia më 10 shkurt. Atë botë, përfaqësimin institucional i Kosovës u vë në mbrojtje të Policisë së UNMIK-ut, pra kundër qytetarëve që ishin vrarë dhe plagosur më 10 shkurt. Natyrisht që këtu kishte përjashtime, për shembull, e kemi këtu deputetin Fatmir Rexhepi, i cili atë botë dha dorëheqje, edhe pse nuk kishte përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ndërhyrjen e policisë më 10 shkurt.

Edhe sot e kësaj dite ka të tillë, sikur Hashim Thaçi, për shembull, që i fajëson demonstruesit për dhunën e ushtruar nga policia. Edhe sot të tillë si ky e mbrojnë UNMIK-un, policinë e tij dhe vrasjet që ata i kryejnë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Hoxha, fjala për ju, le të bëhet gati zonja Teuta Haxhiu.

MURAT HOXHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës më 06.6.2013 ka nxjerrë një rezolutë për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, duke qenë i sensibilizuar edhe nga kërkesat apo problemet e një numri relativisht të madh të qytetarëve të Luginës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në iniciativë edhe të Lëvizjes “Vatra” me seli në Gjilan, në shtator të vitit 2016 kam vizituar Komunën e Bujanocit, ndërsa në dhjetor të vitit 2016 vizitova Komunën e Preshevës.

Në të dy komunat takova strukturën udhëheqëse komunale, deputetin në Kuvendin e Republikës së Serbisë, Fatmir Halimi, si dhe kryetarin e Partisë për Veprim Demokratik, zotim Rizah Halimi.

Me këtë rast mora informacione për aktivitetet dhe përpjekjet zhvillimore të mirëqenies dhe mbijetesës së shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Në këtë kontekst, u organizuan edhe disa takime me qytetarë të dëbuar nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja dhe një debat të organizuar nga klubi i gazetarëve “Beqir Musliu” në Gjilan.

Pas këtij aktiviteti e ndiej obligim që në Kuvendin e Republikës së Kosovës të paraqes disa nga shqetësimet, të cilat në vlerësimin tim janë të arsyeshme dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të mundshme për eliminimin e tyre.

Këto përpjekje u manifestuan besoj edhe në takimin e delegacionit, apo të delegacioneve të Luginës, te kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjithsesi edhe në vizitën e delegacionit të Luginës te Kryeministri i Republikës së Kosovës. Në fakt, rezoluta për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, e iniciuar atëherë nga deputeti, zoti Lutfi Haziri, e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 6. 6. 2013, në përmbajtjen e saj ka gjëra, të cilat janë zbatuar, por janë edhe disa çështje të rëndësishme që duhet të zgjidhen.

Njëra prej çështjeve më të rëndësishme është zgjidhja e çështjes së dokumenteve civile të mbi 6 mijë qytetarëve që tani janë rezidentë në Republikën e Kosovës, kanë prona dhe shtëpi banimi, por janë pa letra. Ata e kanë hallin e dokumenteve personale edhe në vendin e origjinës, por edhe në Kosovë, edhe pse me vite të tëra jetojnë këtu. Sigurisht që këto çështje duhet ta kenë të hartuar një strategji të studiuar mirë për zgjidhje, megjithatë më duket që është e pajustificueshme duke mos u zgjidhur me vite të tëra.

Sigurisht që kjo çështje dhe të tjera duhet të jenë edhe pjesë e dialogut dhe komunikimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Në fakt, që në fakt është e shprehur edhe nga përfaqësuesit e institucioneve të Luginës, me ç'rast do të diskutoheshin edhe çështje tjera, siç është themelimi i një fondi zhvillimor për Luginën, hapja e një universiteti publik në gjuhën shqipe dhënia e dokumenteve të regjistrimit civil, përfshirë edhe pasaportat e vendit të origjinës, të drejtat e pronës, informimit, çështjeve të sigurisë, edukimit, njohjes së diplomave dhe shumë probleme të tjera zhvillimore këtë rajon. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu, fjala për ju! Bëhet gati Zafir Berisha.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju kolege,

Ngecjet pa fund në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike nga limiti dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, dështimet e njëpasnjëshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës në menaxhimin e këtyre resurseve, përkatësisht abuzimet e vazhdueshme edhe të zyrtarëve të KEDS-it me këto resurse, çmimet ndër më të lartat në rajon e më gjerë kanë bërë që gjendja e furnizimit me energji në tërësi edhe sot, 18 vjet nga paslufta, të jetë katastrofale.

E them këtë me përgjegjësi të lartë, me fakte të pakontestueshme, sepse vetëm para 3-4 ditëve në Komunën e Gjakovës regjione të tëra kanë ngelur pa energji elektrike për më shumë se 24 orë. Konsumatori, përkatësisht qytetari, është dashur të mjaftohet me një gjysmë kërkimfalje nga zyrtarët e KEDS-it, të cilët me një arsyetim absurd thonë se e pranojnë gjendjen e rëndë me furnizim, madje kërkojnë mirëkuptimin e konsumatorëve për këtë situatë, e cila, sipas tyre, është krijuar kinse nga devijimi i prodhimit të planifikuar.

A do të duhej në këtë rast që edhe konsumatori shumëfish i dëmtuar, t'ua kthejë me të njëjtën masë: “Na falni, nuk mund t'ua bëjmë pagesën!”. Jo të nderuar kolegë deputetë, kështu nuk funksionon shteti, madje në asnjë mënyrë një ndër sektorët jetik për zhvillimin normal të jetës së prodhimit në vend. Ku është Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila hesht pothuajse në të gjitha situatat e tilla, duke e dëshmuar qartë paaftësinë e saj menaxheriale. Me fjalë të kota e boshe nuk ndërtohet shteti.

Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike gjithandej nëpër Kosovë është pothuajse në gjendje të mjerueshme, sidomos gjatë periudhës së dimrit dhe motit të lig, dhe natyrisht humbjet janë të mëdha. Për këtë dështim përsëri ai që e pëson më së shumti është vetë konsumatori.

Mosvendosja e njehsorëve të rinj nëpër gjithë territorin është një tjetër dështim në sektorin energjetik, sepse në këtë mënyrë për vite me radhë nëpërmjet orëve të vjetruara gjithandej ka pasur mundësi manipulimi, ku edhe janë përfshirë edhe vetë zyrtarët e KEDS-it. Qytetarët vazhdimisht kanë protestuar për faturat e fryra me çmime enorme, ndërsa që përgjigjja institucionale është injoruese, ku thuhet se qytetarët paguajnë aq sa shpenzojnë. Ne jemi të vetëdijshëm se edhe mund të ketë ndonjë përjashtim, për shembull gabim në lexim të një apo dy konsumatorë, por në asnjë mënyrë gabim kolektiv.

Unë me vete i kam vetëm dy fatura, të cilat për një muaj, vetëm për muajin janar në një familje që ka 120 metra katror në një banim ka 598,91 euro për një muaj, dhe familja e dytë që ka 950 euro vetëm për një muaj, pra në amvisëri. Nuk është ndonjë biznes, prandaj për këtë fakt qytetarët vazhdimisht kanë protestuar dhe nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje. Kjo nuk ndodh gjëkund, as në shtetet më të zhvilluara në Evropë, por për fat të keq ndodh te ne, ndërsa Qeveria e Kosovës si zakonisht i mbyll sytë para situatave të tilla. Ndërsa bëhet shumë e zëshme në koncesionet e papranueshme shtetërore, madje edhe me çmimin e faljes së territorit, duke krijuar situata të rënda për vendin.

Të gjithë e dimë se termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” e kanë një kapacitet të përbashkët, mirëpo për shkak të vjetërisë së tyre aktualisht kapaciteti i tyre sillet rreth 915 megavat. Të gjithë e dimë, pra se këto kapacitete prodhuese janë të vjetruara, kanë nevojë për riparime, por ku është Qeveria e Republikës së Kosovës? Pse nuk e bën asnjë hap më të voglin në zgjidhjen e këtij problemi jetik? Me një fjalë, gjendja e rëndë e furnizimit si pasojë e kapaciteteve prodhuese të pamjaftueshme dhe të vjetruara në sistemin elektroenergjetik dëshmon vazhdimësinë e dobësisë së kësaj Qeverie, e cila asnjëherë nuk e ngjalli një shpresë më të vogël për qytetarët dhe për të mirën e vendit.

Gjithashtu është i domosdoshëm përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe rritja e sigurisë së furnizimit me energji për të gjithë qytetarët. Edhe për faktin se obligimet e kësaj Qeverie, ose Kosova është zotuar që në përmbushjen e caktuar të kursimit prej 9% nga konsumimi i

gjithmbarshëm i energjisë, cak i vendosur sipas direktivës 2006-32EC të BE-së. Në të kundërtën, ajo do të duhej të shkojë, meqë tashmë ia ka trasuar vetes rrugën, pra përfundimisht të largohet nga qeverisja. Ky do të ishte shpëtimi për qytetarët e Kosovës, e besa edhe shpëtimi i tyre nga skandalet e tjera, të cilat do ta rëndojnë edhe më shumë barrën shumë të rëndë, që edhe ashtu e kanë mbi vete qytetarët, sepse qytetarët e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha, fjala është për ju, përgatitet Shaip Muja, pa grup parlamentar.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar Kryesi e punës,

Kabinet qeveritar,

Unë kësaj radhe do të përqendrohem në atë që është shumë jetike dhe thelbësore lidhur me zhvillimet e fundit që po ndodhin në Kosovë dhe në rajon dhe përqendrimi im do të jetë rreth agresionit të politikës serbe në Kosovë nëpërmjet Listës sërspska.

Veprimtaria e këtij subjekti politik dhe qëndrimet janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, prandaj institucionet e Kosovës, duke përfshirë dhe Parlamentin, duhet ta kenë një platformë politike të përcaktuar drejt për t'iu kundërvënë veprimit politik të Serbisë që po dëmton në funksionalitetin e shtetit. Deputetët e Listës sërspska e kanë dhënë betimin sikur të gjithë ne në përputhje me Kushtetutën e vendit, mirëpo ata e kanë shkelur këtë betim dhe bëjnë veprime antikushtetuese dhe për këtë unë mendoj se institucionet e Kosovës duhet të mendojnë që ta ndalojnë veprimtarinë politike të kësaj organizate, sa kriminale, aq edhe dorë e zgjatur e regjimit fashist të Vuçiqit.

Duke e ndaluar veprimtarinë politike, duke e çregjistruar, por në mungesë të ligjeve dhe të një vakumi ekzistues duhet të mendojmë që në të ardhmen e afërt të këtij subjekti politik t'i ndalojmë pjesëmarrjen në zgjedhje. Arsyet janë të shumta, unë do t'i përmend disa dhe besoj që janë të mjaftueshme që ne dalëngadalë të fillojmë të sillemi si shtet në raport me ata që nuk na njohin dhe e rrezikojnë shtetin e Kosovës dhe kjo nuk është ndonjë risi, është praktikë që ndodh edhe në vendet më të zhvilluara dhe më demokratike të botës dhe të Perëndimit, veçanërisht.

Fjalori nacionalist i tyre ka filluar qysh me ardhjen në pushtet dhe qysh në momentin kur janë bërë pjesë e koalicionit aktual, fjalor i cili ka nxitur reagime të arsyeshme të qytetarëve dhe ky fjalor nuk është ndaluar. Ata kanë vazhduar të ngrenë përmendore të carëve të tyre, të cilët historia jonë i njeh si okupatorë dhe njihen në histori edhe për gjenocidin që kanë bërë ndaj popullatës autoktone, konkretisht shqiptare. Gjatë ngritjes së përmendoreve ata i kanë lëshuar edhe klithmat që i keni dëgjuar të gjithë, se Kosova është Serbi. Ata kanë vazhduar edhe më tej

sipas platformës së Vuçiqit për defunksionalizimin e shtetit të Kosovës dhe kanë qenë pjesë e gurthemelit për koloninë që është duke ndodhur në pjesën veriore të Kosovës, “Lugina e Diellit”.

Ata vazhdojnë që të mos e njohin Qeverinë e Kosovës dhe shpeshherë i kemi dëgjuar të thonë se ne e kemi Vuçiqin kryeministër, por jo Isa Mustafën. Ata, përpos që i sabotojnë institucionet e Kosovës, marrin pjesë në takimet ku përgatiten shantazhe ogurzeza ndaj Kosovës, siç ishte rasti i fundit, kur me kryekriminelin e Serbisë, Vuçiq, takohen në kazerma ushtarake, që për simbolikë dihet mesazhi i këtij takimi në objekte ushtarake. E fundit është se ata, duke e mbajtur peng perspektivën e vendit tonë, ndërtojnë edhe mure ilegale dhe shpeshherë institucionet e Kosovës i vënë para aktit të kryer, edhe pse të gjithë bashkë me ne në Parlament kemi konstatuar dhe vërtetuar se veprimi është joligjor, siç ishte rasti i murit. Shpesh edhe në këtë rast, qeveritarët detyrohen që për veprimet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të lutem, regjia mos ia ndal fjalën!

ZAFIR BERISHA: ...joligjore dhe antikushtetuese të serbëve dhe Listës serpska, qeveritarët tanë pakurrizorë, e them lirisht, detyrohen të bëjnë marrëveshje politike, derisa në anën tjetër tërë kohën thërrasin dhe klithin se veprimet janë kundërligjore.

Unë mendoj se është moment i fundit të mendojmë për një platformë shtetërore për t’iu kundërvënë agresionit politik të Serbisë dhe Vuçiqit nëpërmjet Listës serpska dhe t’i rikthejmë në pozicionet përfaqësuesit legalë të serbëve, të cilët për vite të tëra e kanë njohur realitetin në Kosovë, por që për fatin e keq për interesa mesquine tyre ata qytetarë serbë u nxorën nga loja dhe përfaqësuesve të Vuçiqit iu dha hapësirë në institucione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! 3 minuta kemi tejkalim të kohës. Kohën do ta mbajmë 30 minuta, aq sa e kemi, kanë kërkuar edhe kolegët e opozitës. Fjalën s’do t’ia ndal askujt, por atë çka deputetët e tejkalojnë do të jetë koha, e cila do të bartet në zgjerim.

Kemi filluar në 10:15, do ta kemi aktualisht deri në 10:50. Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Për qartësim tuajin, ose nëse e keni bërë për humor, unë nuk jam pa grup parlamentar që nga 16 janar 2017, por kjo vërteton se në Republikën e Kosovës, përveç që nuk funksionojnë organizimet e subordinuara të institucioneve brenda Kuvendit dhe relacioni Kuvend - Qeveri, e kemi një situatë të tillë e cila sjell më shumë humor se sa vendimmarrje.

Prandaj, në letrën e 16 janarit, unë për shkak të situatave që i kam vlerësuar vetë, kam thënë se do të kthehem, edhe pse vazhdoj të mbaj fort qëndrimet e mia dhe pakënaqësitë e mia, të evidentuara më 18. 12. 2014.

Prandaj, shpresoj që Administrata do të ju funksionojë më mirë që ta keni një informacion, sepse sot jemi më 9 shkurt, do të thotë ka bajagi kohë.

Desha të bisedoj mu për këto çështjet joserioze që trajtohen në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe një terrorizim publik që bëhet rreth demarkacionit me ekipet joserioze që janë formuar për matjen të ashtuquajtur “matjen e territorit”, me grupin e pabesueshëm intelektual, që kryesohet nga akademiku i ashtuquajtur Hivzi Islami, i cili me botimet e veta, me botimet e veta, të cilat ai i ka të dokumentuara në kërkimet gjeografike në vitin 2008 ku jep orientime eksperte të bisedimeve me Ahtisarin, zotit Lutfi Haziri, në ato kërkime gjeografike nr.14, në monografinë e Akademisë ku jep publikime të qarta se ku janë vijat kufitare. Nga ne deputetët, kjo Qeveri po mundohet të na fusë në lajthitje dhe të na bëjë fajtorë para publikut të Kosovës.

Dhe, Qeveria e Kosovës, zoti kryetar, është fajtorë, por edhe ne nuk jemi pa faj, sepse ne nuk i kemi përfunduar të gjitha ato mundësi të cilat ne mund t'i shterojmë brenda Kuvendit dhe të dalim unikë me propozime konkrete.

Ka dy vjet e gjysmë që publiku terrorizohet me personalitete joserioze të kësaj Qeverie, e cila duhet të shkojë sa më shpejt në shtëpi.

Çështja tjetër, e cila, unë po them, që prapë nuk funksionojnë këto çështje, ne e kemi miratuar Ligjin e “Trepçës” në këtë Parlament dhe para disa ditësh Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik e kthyen një propozim, i cili parashihet në Ligjin e “Trepçës”, që të mblidhen taniema nga Ligji për miniera dhe minerale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem mos ia ndal. Të lutem zoti Muja, një minutë!

SHAIPI MUJA: ...dhe ligji i parasheh qartë në atë miratim që taniema të ndahet 20% për Obiliqin dhe unë kam kërkuar që të bëhet ndryshim ligji në mënyrë urgjente për t'u funksionalizuar ai ligj në nivel të krejt Republikës, krejt zonat fitojnë, dhe të paguajnë 20% për zhvillimin e komunitetit, për interes të komunitetit.

Prandaj, në këto forma që i bëhet qasjes, edhe të vendimeve tona, edhe të interpretimeve tona, kjo Qeveri tregon që prapë nuk është duke funksionuar.

Dhe, unë shpresoj që ne do të ngrihemi në nivel mbipartiak, apo mbipartizanë, që t'i trajtojmë çështjet shumë serioze, siç janë demarkacioni dhe funksionimi i kësaj Qeverie, për ta çuar sa më shpejt në shtëpi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të ngre një çështje sa u përket vajzave dhe grave në Kosovë, që po ushtrohet dhunë çdo ditë ndaj tyre.

Vitin që e lamë pas në ditët e aktivizimit, sërisht u nxor në pah se dhuna në baza gjinore vazhdon të jetë shqetësim edhe në nivel vendi, por edhe në atë global. Ne i kemi rastet e fundit, që nuk dua t'i përmend emrat e viktimave, që po ushtrohet dhunë dhe dua të kërkoj edhe përgjigje nga institucionet përkatëse se deri kur mund të presim viktimë dhe pastaj të dalim e të protestojmë dhe të kemi këtë shqetësim.

Raportet e fundit të vitit të kaluar e prezantojnë një dhunë deri në 69% që ushtrohet dhunë ndaj vajzave dhe grave dhe kjo në asnjë mënyrë nuk mund të arsyetohet nga ne, kolegë deputetë, dhe gjithë shoqëria në përgjithësi. Mendoj se në këto raporte që po prezantohen me shifra të dhunës që po ushtrohet, del se edhe burrat, por edhe gratë, po e arsyetojnë, edhe shoqëria, sikur në rastin që e kishim të vajzës ndaj të cilës u ushtrua dhunë në shkollë dhe ishte tmerr, sa më përket mua, se si e arsyetonin këtë dhunë që ushtrohet, jo vetëm në shkollë, por edhe para nxënësve, por edhe para prindërve që e shikonin dhe nuk ndërmerinin asgjë.

Unë konsideroj që tani është momenti i fundit, e jo ta presim 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, por të vazhdojmë që të marrim masa sa u përket personave apo ndëshkuesit, kryerësit e këtyre veprave që i bëjnë dhe që kjo shoqëri jona, kjo popullsi e re e vajzave nuk e meriton këtë nga kryerësit që bëjnë dhunë ndaj tyre.

Viktima kemi pasur dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje të vetme për këto viktima dhe këtë para katër ditëve, siç jeni të informuar edhe në medie, është ushtruar dhunë ndaj një zonje dhe unë nuk dua t'ia përmend emrin, por po konsideroj dhe mendoj që ne si kolegë, si Kuvend i Kosovës, jo vetëm si gra e vajza, por si përfaqësues që kemi obligim ndaj tyre, ta ngremë edhe në nivel nacional dhe të mblidhet një këshill sa u përket këtyre shqetësimeve, këtyre viktimave, që të ndërmarrim masa, të shohim se ku kanë arritur institucionet. Ka raste që dihet kush janë kryerësit e këtyre veprave dhe nuk është ndërmarrë asgjë, atëherë shtrohet pyetja, pse?

Edhe unë po e bëj këtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, që koha ka përfunduar... Avash, Glauk! Unë do të ju pyes tash juve, unë e krewa timen, ju e vendosni a doni të vazhdoni apo jo?

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, LDK-së dhe... jo, se pastaj unë po kritikohem se po e shkel Rregulloren. Më falni, në qoftë se po, e vazhdoj. Vetëm shpejt, po - jo? A doni ta vazhdojmë, janë edhe tre diskutues. Jo, se mbledhjen e fundit kam marrë kritikë për këtë çështje. Po ose jo, ju e vendosni vetë. Zenun Pajaziti, urdhëro!

ZENUN PAJAZITI: Po, nëse ka mundësi edhe nga një diskutues prej grupit.

KRYETARI: Ismet Beqiri, urdhëro!

ISMET BEQIRI: Unë mendoj që do të duhej të respektohet Rregullorja. Dhe, ju zoti kryetar, e dini që në Kryesi jemi pajtuar edhe me anëtarët e Kryesisë, anëtarët e nderuar të opozitës, për ta respektuar Rregulloren...

(Debat nga salla)

KRYETARI: Zonja nënkryetare, vetëm le ta përfundojë ai dhe pastaj ti e merr fjalën. Po, ti do marrësh fjalën gjithsesi.

Vetëm pak, se është propozim i mirë i zonjës deputete. Vetëm pak, kolegu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, se jemi duke shkuar drejt respektimit të Rregullores. Urdhëro, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Unë thashë, jo vetëm në këtë seancë, po në çdo seancë është mirë ta respektojmë minutazhën dhe Rregulloren. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqiri, për ta konfirmuar, kritika ka ardhur prej “Vetëvendosjes”, në mbledhjen e kaluar.

Urdhëroni, zonja Aida Dërguti, fjala për ju!

AIDA DËRGUTI: Kryetar!

Ju e dini që në mbledhje të Kryesisë çështjen e ka ngritur Valdetja nga “Nisma”. Nëse keni harruar, po jua përkujtoj. E dyta, sa i përket respektimit, të gjithë jemi për respektimin e Rregullores, përfshirë edhe minutazhën. Ju ua zgjatët minutazhën disave dhe ia pamundësuat tash shefit të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” të flasë në emër të grupit. Kështu që, nëse bëtë shkelje në fillim duke ua zgjatur kohën, përfundoni edhe këto tri fjalimet e fundit.

KRYETARI: Ju lutem për vëmendjen e kolegëve deputetë, të Qeverisë dhe të medieve.

Në mbledhjen e kaluar të Kryesisë opozita ka kërkuar që unë të jem më strikt në respektimin e Rregullores. Unë do ta bëj tani publikisht. Në qoftë se kolegët e mi, pozitë a opozitë, më autorizojnë për ta respektuar Rregulloren, po jua jap fjalën që na dita e sotme asnjë sekondë nuk do të flasin më shumë se sa ua përcakton Rregullorja. E kemi të qartë, unë e kam shtuar 5 minuta, në 10:15 kemi filluar, në 10:45 ka përfunduar, e kam shtuar edhe 5 minuta për shkak të zgjatjes së fjalimit. A dëshironi që unë ta mbaj në mënyrë strikte Rregulloren? Jo, jo, fjala është juaja publikisht. Partia Demokratike e Kosovës, Zenun Pajaziti urdhëro!

ZENUN PAJAZITI: Më falni, vëmendje ju lutem!

Zoti kryetar,

Ajo që ka ndodhur në seancat e kaluara me dhënien e mundësisë shtesë për deputetë që të shprehen, sidomos në pikën e parë, ka qenë diçka që nuk është se ka ndodhur edhe më herët. Si të thuash në opinion, më shumë ka pasur kritika pozitive rreth asaj që deputetët po mund të shprehen pavarësisht cilit grup i takojnë, sesa shkelja e Rregullores. Por, meqenëse është kjo kërkesë kohëve të fundit edhe nga opozita, që të respektohet Rregullorja, atëherë ne plotësisht e mbështetim dhe kërkojmë që derisa të ndryshohet Rregullorja, të respektohet në çdo aspekt të saj. Unë kam menduar që do të kërkohej ndryshimi i Rregullores dhe t'i përshtatet kësaj fryme të dhënies së mundësisë për t'u shprehur më shumë deputetë, por meqenëse kjo kërkesë është për t'u respektuar, atëherë edhe ne si grup parlamentar e mbështetim.

KRYETARI: Zoti Beqiri, edhe pse e ke pasur qëndrimin e qartë në Kryesi, po edhe një herë më mirë publikisht, le ta dëgjojnë edhe mediet.

ISMET BEQIRI: Edhe në Kryesi, edhe këtu, po e përsëris, të respektohet Rregullorja ashtu siç e thatë dhe ajo ju autorizon juve plotësisht, vetëm duhet ta respektojmë të gjithë ne.

KRYETARI: Zoti Glauk Konjufca, fjala për ju! Pal Lekaj bëhet gati dhe Enver Hoti.

GLAUK KONJUFCA: Ndonjëherë edhe në emër të respektimit të vlerave universale dhe respektimit të Rregulloreve fshihen prapa disa truke, që këtu po ndodhin, për shembull.

Unë këtë që po ndodh e konsideroj kështu: LDK-ja dhe PDK-ja folën edhe në emër të grupit parlamentar, edhe në emrin e tyre personal, që i bie se secila ka folur nga 8 minuta. “Vetëvendosja” ka folur 3 minuta sot, kjo është esenca. Kështu po doni. Ky është thelbi i kësaj që po doni të bëni ju. “Vetëvendosja” të flasë veç 3 minuta sot, e LDK-ja me PDK-në të flasin 8 minuta. A është kjo fer? A është kjo e ndershme? Unë mendoj që është e gabueshme, kështu që kërkoj që edhe unë të flas në emër të grupit parlamentar. Visari nuk ka folur në emër të grupit

parlamentar. Shikoni, kthejini pamjet edhe një herë dhe do ta vërtetoni që Visar Ymeri sot ka folur 2 minuta e 49 sekonda.

Pra, “Vetëvendosja” sot ka folur vetëm 3 minuta dhe ju po doni t’ia ndërprisni “Vetëvendosjes” në 3 minuta. Nëse ky është qëllimi, tregojeni hapur, zoti kryetar, mos flisni me respektim të Rregullores dhe me vlera universale.

KRYETARI: Mos e ndërprisni, zoti Konjufca. Unë po flas për sot, po e marr përgjegjësinë, se ju kam diskriminuar. Po, po! Por, unë po flas për çdoherë, a e respektoj Rregulloren, a ka mundësi publikisht që të mos ketë më tejkalim të normave. Ta keni parasysh, unë kam dhënë fjalë në këtë mandat timin deri në 40 minuta, më duket kanë folur, Profesori po e pohon, deputetët, s’po dua ta them se cili. Urdhëro zoti Beqiri, pastaj zoti Konjufca. Nuk po flas vetëm për sot, por për çdoherë.

ISMET BEQIRI: Zoti Konjufca, unë kërkoj nga Administrata le të na tregojë, edhe nëse keni qenë në seancë vërtet të pranishëm, askush s’ka folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, çdo deputet ka folur në emër të vet, prandaj nuk qëndron kjo që e thoni. Kurrkush nuk ka folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së sot në deklaratimet jashtë rendit të ditës. Ne jemi këtu, po të kishte folur... po, kemi folur dy, se ne jemi 33 deputetë, kur t’i bësh 33 ju flitni edhe 3, s’ka problem. Nuk ka folur kurrkush në emër të grupit, prandaj mos krijoni insinuata, se s’qëndron.

KRYETARI: Zoti Konjufca, mos ta ngarkojmë për sot, po për herët tjera. A ka mundësi të marr edhe aprovimin, se do të kaloj tek AAK-ja, Nisma dhe “6+”-i. Cili është qëndrimi juaj politik, pas ditës së sotme?

GLAUK KONJUFCA: Për t’u respektuar Rregullorja, ne jemi plotësisht për atë.

KRYETARI: Faleminderit! Ky është qëndrimi, faleminderit! Zoti Lekaj?

PAL LEKAJ: Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Sa i përket Rregullores, ne jemi thirrur që rregulloret t’i respektojmë, e sidomos saktësisht të respektohet minutazha. Përndryshe nuk ka kuptim, atëherë pse të miratohen rregulloret dhe ligjet. Nëse do të jeni të barabartë për të gjithë, atëherë s’ka kush çfarë të flasë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hoti dhe pastaj zoti Bajrami.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Me të vërtetë duhet ta konstatojmë, meqë u futëm në këtë debat për miratimin apo përfilljen e Rregullores, se bukur moti kjo tolerancë kështu ka kaluar në një cirk popullist, që nga kryetari, e sidomos dy shefat e grupeve parlamentare shumicë.

Besoj që tani e tutje do të vazhdojmë me zbatimin e rregulloreve. Gjithsesi jemi për t'i ikur këtij cirku populist që ka ndodhur në Kuvend që 3 vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju “Nisma” keni përvojë, sepse 7 vjet e keni pasur kryetarin. Enver, s’e thashë me sherr! Zoti Bajrami e ka fjalën!

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uzimajući u obzir da su sve parlamentarne grupe za respektivanje Pravilnika, i mi smo za istu stvar, i uzimajući u obzir da i Pravilnik vas obavezuje i da ne treba puno diskusije oko toga. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Unë, për hir të korrektësisë, sot e kam tejkaluar kohën, do të shkojmë tutje. Zonja Gaxherri, në emër të kujt do të flasësh? Zoti Zemaj, në emër të kujt do të flasësh?

Atëherë, të respektojmë Rregulloren e Kuvendit dhe shkojmë me pikën:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Ora tash është fiks 11:00.

Për këtë seancë janë parashtruar 38 pyetje parlamentare.

Deputeti Zafir Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Problemi është ku ta gjejmë kryeministrin. E pyetjen unë e kam bërë në kohën kur s’ka pasur ministër të Ambientit, e tash, me gjasë, ka, por s’e di a është në rrjedhë për të dhënë përgjigjen.

Sido që të jetë, po e bëj pyetjen, për shkak se e kam përshtypjen që ministri është në rrjedhë të kësaj.

Fjala është për një vendim të Kuvendit Komunal të Prizrenit, që është miratuar në prill të vitit 2016, e që ka të bëjë me një plan rregullativ urban në Qendrën e re, i cili ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe Ministria e Administratës Publike, por edhe Ministria e Ambientit kanë qenë në

dijeni dhe faktikisht i kanë rekomanduar Kuvendit të Prizrenit që të anulojë atë vendim, pasi që s'ka qenë në përputhje me ligjin.

Mirëpo, në të njëjtën kohë Kuvendi ka vazhduar dhe nuk i ka përfillur rekomandimet e këtyre dy ministrive dhe pyetja ka të bëjë se çfarë veprimesh ligjore ka ndërmarrë Qeveria, konkretisht Ministria e Planifikimit Hapësinor lidhur me këtë vendim arbitrar të Kuvendit të Prizrenit?

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër i Mjedisit, Ferat Shala, për përgjigjen!

MINISTRI FERAT SHALA: I nderuar kryetar,

I nderuar deputet,

Ne kemi marrë pyetjet tuaja dhe pa dashur t'i përsërisim ato, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nëpërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal ka marrë një kërkesë për ligjshmëri nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 28. 4. 2016 për rishqyrtim dhe shikim të ligjshmërisë së projektit, gjegjësisht Planit rregullues urban të hollësishëm Qendra e re, për Qytetin e Prizrenit.

Konform legjislacionit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kthyer përgjigje dhe ka konstatuar se ky plan duhet të plotësohet, të rishikohet dhe harmonizohet me legjislacionin, sepse ka pasur parregullsi në hartim, në procedura, kështu që i është refuzuar ose është kthyer për rishikim.

Saktësisht, si e thatë ju, këto procedura janë kryer konform legjislacionit dhe përsëri Kuvendi Komunal i Prizrenit e ka bërë edhe një kërkesë shtesë për ta rishikuar ligjshmërinë.

Konform legjislacionit në fuqi, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor nuk ka kompetencë ta rishikojë vendimin e vet praktikisht, dhe i është drejtuar Kuvendit Komunal që ta zbatojë vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rishikim të planeve të hollësishme urbane dhe konform rregullave e ligjeve, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në muajin dhjetor ka lëshuar vendim të qartë që pushteti lokal i Komunës së Prizrenit, gjegjësisht Drejtoria për Urbanizëm dhe organet e tjera përgjegjëse duhet ta rishikojnë, pra ta kthejnë edhe një herë në rishikim tërë këtë plan, konform legjislacionit në fuqi.

Vendimi i Inspektorati është në fuqi dhe jam thellësisht i bindur se po zbatohet ligjshmëria në tërë territorin e vendit.

Këto fenomene e praktika të gabimeve dhe mospërshtatshmërisë së legjislacionit janë edhe në disa komuna të tjera, tanimë kemi nxjerrë një udhëzim të qartë për hartimin e planeve rregulluese, i kanë të gjitha pushtetet lokale dhe gradualisht po zbatohen këto praktika. Faleminderit!

KRYETARI: I keni parasysh edhe ministrat, 3 minuta e kanë kohën për përgjigje, derisa pyetja është 2 minuta.

Zoti Berisha e do fjalën edhe një herë. Tash e ka 1 minutë.

ZAFIR BERISHA: Problemi është se Kuvendi Komunal nuk e ka respektuar rekomandimin dhe sugjerimet e Ministrisë dhe për atë pyetja ishte: çfarë masash të tjera mund të merrni ndaj njerëzve të cilët nuk i respektojnë institucionet dhe ligjet? Sepse, në Qendrën e re, me planin rregullativ tashmë e kemi një gjendje krejt të re, si rezultat i mosrespektimit të sugjerimeve tuaja me kohë dhe tash faktikisht, aty mund të dëmtohen edhe investitorët, edhe qytetarët. E pasojat kush mund t'i bartë në këto relacione, për shkak se arsyeimi i Kuvendit Komunal, siç e dini edhe ju, ka të bëjë se ministria brenda 30 ditësh nuk ka kthyer përgjigje dhe ata kanë pasur të drejtë ta shkelin ligjin, sepse sipas logjikës së tyre, ligji është prej llastiku. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër! 2 minuta i ke për përgjigjen, ta keni parasysh.

MINISTRI FERAT SHALA: Saktësisht, më 20.12.2016 vendimi është lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ligji e thotë qartë se pushteti lokal ka të drejtë që brenda 30 ditësh ta rishikojë projektin ose të ndjekë dy rrugë: njërën për ta ndërprerë dhe të kthehet në rishqyrtim plani dhe dy, të apelojë në gjykatën e duhur.

Prandaj jemi në pritje të zbatueshmërisë së ligjit dhe konsideroj se do të zbatohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri nuk është këtu. Zoti Beqa, do ta bësh pyetjen? Urdhëroni! E ka fjalën Hajdar Beqa!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përsëndetje për kryetarin, Kabinetin qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë e kam një pyetje për zotin Skender Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme. Është pyetje me rëndësi të veçantë, sepse bëhet fjalë për statusin e qytetarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit dhe këtë pyetje po e lë për ta bërë kur të jetë ministri prezent, sepse është me interes të veçantë dhe duhet të kemi përgjigjen nga ministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Haxhi Shala, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

HAXHI SHALA: E cilës datë është pyetja, sepse i kam 2-3 pyetje.

KRYETARI: Pyetja është bërë më 5 dhjetor 2016.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë këtë pyetje e kam parashtruar, e kam pritur një përgjigje nga ministri që së paku të ma sjellë me shkrim.

Ka të bëjë lidhur me invalidët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të cilët Komisioni i Verifikimit e ka kryer punën e vet, por certifikatat qysh tash i kanë marrë disa invalidë, por Komisioni i cili duhet të merret me përcaktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve ende nuk është funksional, prandaj kur do të jetë ky komision funksional për caktimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

KRYETARI: Ministri Arban Abrashi e ka fjalën për përgjigjen.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, zoti deputet Shala!

I nderuar kryetar,

Deputetë, ministra,

Komisioni mjekësor për vlerësimin e shkallës së invaliditetit të kategorive të invalidëve të luftës do të themelohet pasi të pranojmë listat përfundimtare për njohjen e statusit për dëshmorët, invalidët e veteranëve nga Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit së dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së.

Këto lista ende nuk janë pranuar dhe realisht ne jemi në baza ditore, në kontakt si me shoqatat e dala nga lufta, ashtu edhe me Komisionin që këto lista të përfundojnë.

Realisht ne kemi pritur edhe në javën e kaluar që këto të përfundojnë, në mënyrë që ne t'i marrim dhe fillojmë procesin e hapjes së aplikimit për këtë kategori, proces i cili është ndaluar në vitin 2011.

Në ndërkohë, ne si Ministri kemi vazhduar me disa përpjekje të tjera që ta plotësojmë infrastrukturën ligjore, në mënyrë që sapo t'i pranojmë këto lista Komisioni dhe infrastruktura ligjore të jenë të gatshme që të funksionojë sa më lehtë, dhe jemi në proces të plotësimit të 3 udhëzimeve administrative:

- Procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve dhe beneficinet e përcaktuara me legjislacionin për kategoritë e dala nga lufta;

- Udhëzimin administrativ për kompensimin e shpenzimeve të varrimit për veteranët, luftëtarët dhe invalidët e luftës së UÇK-së, dhe

- Udhëzimin administrativ për procedurat e lajmërimit, mbikëqyrjes, raportimit të përfituesve të pensioneve të skemës pensionale të përcaktuar me legjislacionin për kategori të dala nga lufta.

Realisht, ne presim përfundimin e këtyre listave, në mënyrë që menjëherë të nisë puna e komisionit mjekësor.

Kemi pranuar edhe nga shoqatat e dala nga lufta një listë të mjekëve potencialë që mund të jenë në këtë komision, andaj edhe të gjitha përgatitjet po bëhen në mënyrë që sapo të jenë listat gati, ne të fillojmë me punën e komisionit.

Sa për informim, komisionin e ka ndaluar ose Ministria ka marrë vendim që në vitin 2010 të ndërpritet kjo dhe besojmë se tani do të jetë ky komision pas 6 vjetësh.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Shala, a keni pyetje shtesë? Urdhëro! Fjalën e ka zoti Shala!

HAXHI SHALA: Zotëri ministër, pasi që qe një vit ata nuk kanë marrë të ardhura për shkak të mospërcaktimit të shkallës së invaliditetit, në momentin kur i caktohet shkalla e invaliditetit, a do t'i marrin retroaktivisht pagat, apo do të fillohet prej atij momenti kur i caktohet apo bëhet pjesë e kësaj kategorie?

KRYETARI: Zoti ministër, urdhëroni!

Zoti ministër, edhe një gjysmëpyetje brenda kësaj të Haxhiut, nëse ka mundësi: Familjarët e dëshmorëve që i kanë nga 2 djem të vrarë, ose 2 fëmijë, u është ndaluar njëri pension, për njoftim edhe të opinionit, pse ka ndodhur kjo? Lidhur me këtë kemi reagime nga familjarët, është për ata që kanë 2 fëmijë. E përfshini pra, nëse ka mundësi, edhe këtë pjesë.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, deputet Shala!

Thënë të drejtën, nuk kam përgjigje në atë pyetje dhe besoj pasi të fillojë komisioni do të bëjmë edhe shqyrtimet ligjore në kuadër edhe të ministrisë sonë, edhe të Ministrisë së Financave dhe dalim me përgjigje. Pra, nuk kisha dhënë deklaratë tani për atë pyetje.

Kurse sa i përket pyetjes së kryetarit të Kuvendit dhe shqetësimit, besoj se është edhe një pyetje tjetër nga edhe disa deputetë të tjerë lidhur me ndaljen e pensioneve të dyfishta. Kjo ka ardhur fillimisht si kërkesë e Auditorit të Përgjithshëm, i cili është bazuar në dy ligje të Kosovës, e ka nxjerrë një listë të pensioneve të dyfishta, të cilat menaxhohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ka kërkuar ndalesën e njërit nga pensionet. Me këtë rast, është bërë ndalesa sipas praktikave ndërkombëtare, ndalesa e pensionit më të ulët dhe, sa për sqarim, janë dy klauzola në dy ligje, të cilat e përcaktojnë. Njëri është te Ligji mbi vlerat e luftës, i cili e përcakton. E kemi nenin 5, pika 1.4:

“Përfituesit e pensioneve sipas paragrafit, familja e ngushtë e dëshmorit; familja e ngushtë e të zhdukurit; familja e ngushtë e viktimës civile; familja e ngushtë e të zhdukurit civil; pensioni familjar; familja e ngushtë e realizon për të rënë dhe të zhdukurit 1997-1999”.

Neni 1 pikë 4, thotë: “Përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 të këtij neni nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj”.

Do të thotë, auditori ka marrë kërkesë dhe vendim që kjo duhet ndërprerë, bazuar në këtë nen, sikurse edhe në nenin tjetër të Ligjit mbi menaxhimin e skemave pensionale të financuara nga shteti, i cili thotë:

“Personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, në asnjë rrethanë nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta, të cilat menaxhohen ose administrohen nga Ministria”.

Do të thotë, auditori ka marrë një vendim dhe ka kërkuar nga ne që të ndërpresim këto lloje të pensioneve, do të thotë se janë ndërprerë më të ulëtat. Në mënyrë që të ndryshojmë këtë gjendje, ne kemi dërguar Ligjin për menaxhimin e skemave pensionale nga shteti, një plotësim-ndryshim që të jetë e definuar se çfarë është pensioni familjar e çfarë është pensioni individual dhe të bëjmë lirimin e të dy pensioneve, por gjithashtu duhet të ndryshojmë edhe Ligjin për vlerat e dala nga lufta dhe të heqim këtë nen. Domethënë, jemi në proces të plotësim-ndryshimit të dy ligjeve, në mënyrë që të kthehen pagesat ashtu siç kanë qenë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Daut, po mundet, por ne do të marrim iniciativë për 40 nënshkrime që sa më shpejt të sillen në Kuvend dhe të ndërrohet veçanërisht për familjet e dëshmorëve. Urdhëro, Daut Haradinaj, ndërlidhet me këtë pyetje, që na e kanë bërë shumë prindër të dëshmorëve.

DAUT HARADINAJ: Veç të shpjegohem saktë, se m'u duk që u keqkuptuam, ministër, edhe pyetja kur ta bëri edhe kryetari, edhe deputeti. Edhe më herët e kam bërë edhe unë një pyetje. Nuk është fjala te mosha, për shembull, kush e merr pensionin e dyfishtë. Pyetja është një familje që ka më shumë se një, pra 2 dëshmorë, 3, 4, 5, domethënë këtu qëndron pyetja: Pse ata nuk i përfitojnë të hyrat për të gjithë dëshmorët? Por ata e marrin vetëm një, kjo është pyetja. Nëse nuk gaboj, këtu nuk u përgjigje dhe kjo nuk e përcakton me ligj, domethënë nuk e ke pjesë të ligjit të shpjeguar. Thuaj është marrë vendim i padrejtë dhe u janë ndalur të hyrat atyre familjeve, por ka pasur edhe përjashtime. Pse, për shembull, një familje i merr, një tjetër jo, e kemi shumë raste në Kosovë, i kemi rreth 112 raste në Kosovë që i kanë më shumë se dy djem dëshmorë.

KRYETARI: Zoti Haradinaj, faleminderit!

Ne në seancën e radhës e qartësojmë aspektin ligjor dhe marrim iniciativë si deputetë në qoftë se duhet të ndryshohen ligjet. 40 deputetë, 60 deputetë e ndryshojmë në mënyrë urgjente. Po flas vetëm për familje të dëshmorëve edhe të martirëve, edhe të pagjeturve, nëse mund të jenë mbi 2, ka mundësi.

Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Kërkoj falje. Ministrat kanë marrë obligim të përgjigjen, tash varet nga pyetje. Kam paralajmërim se ministrat do të përgjigjen në emër të kryeministrit Isa Mustafa. Ka të drejtë në bazë të Rregullores që ministri të përgjigjet. Urdhëro, zoti Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ka të bëjë me FSK-në dhe transformimin e FSK-së. Meqenëse kemi një debat më vonë, unë mendoj që kjo pyetje tashmë e ka humbur peshën e vet, dhe vazhdojmë debatin më vonë kur është e njëjta temë, kështu që atë pyetje e konsideroj të tërhequr. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri, pyetje për ministren Edita Tahiri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në marrëveshjen e Brukselit për telekomunikacionit Kosova ka fituar kodin telefonik + 383, e cila ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2016. Ky lajm bëri jehonë në mediat e shkruara dhe elektronike. Nga ministrja për Dialog u tha në një konferencë për shtypë se është një arritje e madhe dhe ditë e veçantë, edhe historike, për shtetin e Kosovës.

Po ashtu në mediet në Serbi, duke iu referuar autoriteteve serbe, shtrirjen e kodit serb në Kosovë e kanë konsideruar si historike.

Në anën tjetër, e lexova deklaratën e shefit për komunikim me media në ITU në Gjenevë, i cili për agjencinë e lajmeve “Presheva Jonë” thotë se mund të konfirmojë në emër të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit se ky kod nuk është nga ITU-ja.

Sipas zyrtarit të ITU-s në Gjenevë, nëse ky kod qenka dhënë nga ITU-ja, pse atëherë Prishtina zyrtare nuk bëri marrëveshje e ITU-në në Gjenevë, por me Beogradin. Këtë e bazoj në deklaratën Edita Tahirit, e cila thotë se kodi është dhënë nga ITU-ja.

Pyetja ime është kështu: Cila është e vërteta e kësaj marrëveshjeje? Sepse edhe për Kosovën, edhe për Serbinë është cilësuar si historike kjo marrëveshje dhe nëse kjo për dy shtete është historike, atëherë cili është fituesi?

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Tahiri e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Deputetë të nderuar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Abdyl Ymeri,

Më 15 dhjetor 2016 Kosova është bërë me kodin telefonik shtetëror, të cilën ia ka ndarë ITU-ja me vendim zyrtar të shpallur publikisht. Pra, Kosova ka bërë marrëveshje të drejtpërdrejtë me ITU-n për ta marrë këtë kod, por me ndihmën e dialogut të Brukselit.

ITU e ka bërë publik vendimin e kodit telefonik ndërkombëtar dhe e ka renditur Kosovën në listën e shteteve, të cilave kjo organizatë u ka ndarë kode telefonike shtetërore dhe unë ju kam sjellë këtu vendimin e ITU-s, në të cilën, pra, Kosovës si shtet i jepet kodi telefonik ndërkombëtar.

Dëshiroj të them se kodi telefonik ndërkombëtar për Kosovën është një e arritur historike, sepse për herë të parë Kosova ka kodin telefonik në historinë e vet.

Me kodin telefonik Kosova ka fituar njohjen e plotë ndërkombëtare në fushën e telekomit, duke e konsoliduar më tej shtetësinë e vet.

Ky është një sukses i madh i dialogut të Brukselit dhe një lajm shumë i mirë për shtetin dhe qytetarët tanë që vjen si rezultat i marrëveshjes për kodin telefonik të vitit 2013.

Shteti ynë, Kosova, është pronare e kodit telefonik ndërkombëtar, të cilën e mori direkt nga ITU, sikur edhe të gjitha shtetet e tjera.

Kosova ka sovranitet të plotë për kodin telefonik shtetëror, qeveris me kodin dhe lidhjet ndërkombëtare mes Kosovës dhe shteteve të tjera në botë tash e tutje janë direkt dhe jo si përpara që janë bërë nëpërmjet Monakos, Sllovenisë apo Serbisë.

Po ashtu në lidhje me pyetjen direkte, dëshiroj t'ju them që nuk është mirë të referoheni në lajmet e Serbisë apo lajmet e portaleve që nuk kanë fakte, por kontaktoni direkt ose ITU-n, ose WEB faqen ose unë jo jua dorëzoj vendimin tash, para jush.

Me keqardhje dëshiroj t'ju bëj me dije se ka pasur deputetë nga Kuvendi i Kosovës, të cilët madje edhe me logon zyrtare të Kuvendit të Kosovës i janë drejtuar ITU-s, duke i thënë që Kosovës të mos i jepet kodi, nëse nuk e keni ditur, e solla dokumentin. Pra, në emër të Kuvendit të Kosovës, një deputet nga radhët e “Vetëvendosjes” i ka shkruar letër ITU-s, duke i kërkuar që të mos i jepet Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, pyetje shtesë, zoti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: A do të thotë se shtrirja e kodit serb në Kosovë është ndërhyrje e shtetit në shtet?

KRYESUESI: A pate pyetje shtesë, a koment? Edhe një herë fjala zotit Ymeri, se nuk e ka dëgjuar mirë.

ABDYL YMERI: A do të thotë se shtrirja e kodit serb në Kosovë është ndërhyrje e shtetit në shtet?

KRYESUESI: Zonja Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Zoti deputet, Kosova ka marrë kodin telefonik ndërkombëtar +383 direkt nga ITU-ja dhe për Kosovën ka aplikuar Austria, siç e dini, sepse Kosova nuk është anëtare e OKB-së, prandaj e ka bërë Austria dhe kodi telefonik i Serbisë shuhet në Kosovë dhe ai ka qenë 381 dhe gjithë pas luftës ne kemi vazhduar ta përdorim kodin e ish-okupatorit. Ndërkohë kemi përdorur edhe kodin e Monakos edhe të Sllovenisë, të gjitha këto shuhen, shuhen edhe operatorët ilegalë, sepse kemi vendosur kufirin frekuencor mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Ministri nuk qenka këtu, po më duke. Zoti Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Kohët e fundit në media, por edhe në Komisionin Parlamentar për Bujqësi janë ankuar fermerët, të cilët po kultivojnë mjedrën se materiali fidanor i importuar ka qenë i infektuar me kancer të bimëve.

Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinës ka dështuar në kontrollin e këtyre bimëve, duke lejuar hyrjen e 450 mijë fidanëve të importuara nga një kompani kosovare, e që u janë shitur kultivuesve të mjedrës, duke u shkaktuar këtyre dëme të konsiderueshme materiale.

Pyetja është: Zoti ministër,

Me që dëmet materiale të fermerëve janë të mëdha, çka keni ndërmarrë apo çka do të ndërmerrni që këta fermerë të mos dorëzohen, por të vazhdojnë ta kultivojnë mjedrën më tutje si dhe a do të ndihmoni fermerët që pësuan dëme nga bora dhe era e fortë, sidomos në komunën e Vitisë, konkretisht në fshatin Gërmov të Vitisë, ku u shkaktua një serë prej 20 ari tërësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dikush nga ministrat nuk e ka marrë përgjegjësinë të përgjigjet. Deputeti Salih Salihu, prapë e ka një pyetje për ministrin Krasniqi, dy pyetje i ke me radhë.

SALIH SALIHU: Kryesues, edhe këtë pyetje po e lexoj, edhe pse e kemi shqyrtuar në Komision Parlamentar me ministrin, por për hir të opinionit po e lexoj pyetjen.

Ky vit ka qenë njëri ndër vitet më të vështira për fermerët kosovarë. Çmimet e ulëta të drithërave, grurit dhe misrit, por edhe të produkteve të tjera bujqësore me origjinë bimore dhe shtazore po e shkatërrojnë prodhimin vendor, duke rrezikuar që sipërfaqet bujqësore të mbesin djerrina, në pamundësi për t'i përballuar importit.

Pra, duke pasur parasysh koston e lartë të prodhimit bujqësor në Kosovë dhe importin e pakontrolluar të produkteve bujqësore, bujqësi si degë e ekonomisë rrezikon të shkatërrohet tërësisht, duke dëmtuar kështu ekonominë e vendit tonë.

Pyetja është: Zoti ministër,

A je në dijeni për këtë gjendje të rëndë në sektorin e drithërave dhe, nëse po, a jeni duke ndërmarrë diçka që kjo gjendje të përmirësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Aida nuk qenka. Atëherë, as Rexha nuk është. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Pyetja në fakt është bërë më 16 janar 2017 dhe ne po shohim se çfarë llogaridhënie dhe transparence ka Qeveria kur kryeministri asnjëherë nuk merr pjesë në seanca kur i drejtohen pyetjet parlamentare.

Pyetja ka qenë: çka do të ndodhë me bisedimet Kosovë-Serbi pas ngjarjeve të fundit? Këto kanë qenë ndërtimi i murit ilegal, arrestimi i zotit Haradinaj dhe më pas provokimet e hapura të shtetit serb për shkak të nënshkrimeve nacionaliste.

Po ne e kemi marrë përgjigjen, sepse pa asnjë hezitim dhe pa asnjë kusht kryeministri, bashkë me presidentin, kanë shkuar në Bruksel pa asnjë format të ri të bisedimeve dhe krejt çka është arritur në këto bisedime është se serbëve në veri për heqjen e murit, që ka qenë një mur ilegal, e që ai murr është dashur të hiqet para se të shkohet në bisedime në Bruksel, kanë marrë premtime për formimin e Asociacionit të komunave serbe. Është dashur që kryeministri të vijë e të shpjegojë para deputetëve se çfarë marrëveshje dhe çka kanë biseduar kohët e fundit në Bruksel, sepse nga praktikat e kaluara këta tjetër po vendosin në Bruksel dhe tjetër po deklarohen këtu para opinionit të gjerë, dhe a po tentohet që me asociacion të bosnjëzohet Kosova?

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryeministri e ka autorizuar zonjën Edita Tahiri për t'u përgjigj në pyetjen në fjalë. Zonja Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRA EDITA TAHIRI: E nderuar deputete Kadrijaj,

Qeveria e Republikës së Kosovës në periudhën e fundit ka vlerësuar se ka pasur kërcënime serioze për sovranitetin dhe integritetin territorial nga ana e Serbisë, duke përfshirë këtu provokime destabilizuese, siç ishin një tren nacionalist barbar, pastaj fletarrestimi për ish-kryeministrin dhe njërin prej liderëve më të shquar të UÇK-së, zotin Ramush Haradinaj, pastaj ishte muri ilegal në Mitrovicë si dhe ishin bombat e njëpasnjëshme në ndërtesën e Qeverisë që u vendos në veri.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim të plotë me institucionet e shtetit tonë, ka mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial në pajtim me interesat nacional dhe sigurinë nacionale, andaj treni është ndaluar, nuk ka mundur të cenojë sovranitetin e Kosovës, por është ndaluar dhe është kthyer prapë.

Muri është rrënuar këtë të diel, sepse ka qenë ilegal dhe është e rëndësishme që është bërë me një dialog brenda institucioneve të shtetit tonë dhe kemi pasur edhe ndihmën e faktorit ndërkombëtar. Si dhe angazhimet për lirim sa më të shpejtë të zotit Haradinaj janë bërë nga Qeveria e Kosovës nga të gjitha ministrat që janë të angazhuara, siç është Ministria e Punëve të Jashtme, e Dialogut, e Drejtësisë dhe kontaktet kanë qenë edhe bilaterale me autoritetet franceze, por edhe kemi lobuar në gjithë botën. Ministria e Jashtme madje ka dërguar letër njoftuese dhe ka kërkuar që këto procese të ndërpriten, sepse Serbia po shkel juridiksionin e vet, duke bërë fletarrestime për shtetasit e shteteve të tjera.

E dyta, ne kemi kërkuar nga faktori ndërkombëtar që sa më shpejt Kosova të bëhet anëtare e Interpolit dhe Evropolit, sepse aty do të mund të japim edhe kontributin për keqpërdorimet e Serbisë dhe t'i ndalim këto tendenca provokative.

Për sa i takon nivelit të lartë të dialogut që u mbajt dy herë në Bruksel, mund t'ju njoftoj se në sajë të dy takimeve të nivelit të lartë me ndërmjetësimin e Përfaqësues së Lartë, zonjës Mogerini, janë ulur tensionet, u zgjidhën problemet e krijuara gjatë këtyre dy muajve, por kjo nuk do të thotë që Serbia nuk vazhdon tutje me provokimet e saj. Por në anën tjetër edhe ne si shtet dhe institucione të Kosovës me çdo mjet, me obligim kushtetues mbrojmë sovranitetin ...

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Të gjithë e dimë se tensionet nuk i ka shkaktuar Kosova, po tensionet i ka shkaktuar Serbia, si përherë, dhe prej fillimit të bisedimeve në fakt s'po ka rezultate konkrete. Mua po më intereson ta di: cilat janë rezultatet konkrete të bisedimeve të fundit dhe çka ka fituar Kosova prej këtij rundi të bisedimeve? Sepse, në fakt, ne nuk po shohim që ka një rezultat konkret.

Nëse Serbia ka përdorur gjuhë nacionaliste, Serbia është dashur të dënohet për të gjitha ato veprime, por ajo ka fituar premtime për formimin e Asociacionit. Ndërsa Kosova, në fakt, nuk ka fituar asgjë.

KRYESUESI: Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Ja përfitimet konkrete nga këto dy runde.

Serbia dështoi, sepse nisi një tren dhe e ktheu mbrapshtë, sepse Kosova vendosi dhe faktori ndërkombëtar e ndihmoi.

Muri ilegal u rrënuar duke ruajtur stabilitetin e vendit, ashtu siç kemi premtuar. Edhe kjo u bë me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe Bashkimit Evropian, sepse Serbia e ndërtoi këtë muri ilegal dhe ne e rrëzuam, në qetësinë më të madhe.

E treta, Asociacioni është një prej marrëveshjeve të dialogut të Brukselit, nuk ka lindur sot. Po ashtu Asociacioni, si një e drejtë në Kosovë për të pasur më shumë asociacione, lind nga bisedimet e Vjenës. Në ato bisedime, ju e dini, që partia juaj ka qenë në pushtet, e ka udhëhequr.

E tani është plani i Ahtisarit që ka lejuar në Kosovë të kihet më shumë se një asociacion të komunave. Ky plan ka qenë i dobishëm, se na e ka sjellë edhe pavarësinë e Kosovës, pra me pavarësinë kanë ardhur edhe këto gjëra, pra nuk është asgjë e re. Ne jemi të përkushtuar jo veç për Asociacionin, por edhe për marrëveshjen e drejtësisë dhe energjisë, por Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. Do ta bëjmë në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe para se të bëhet Asociacioni shuhet të gjitha strukturat e Serbisë që kanë mbetur ende në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Dërguti, a i bëre dy pyetje ti?

AIDA DËRGUTI: Para se të filloj me pyetjen, kam një përgjigje për zonjën ministre, e cila ma përmendi emrin. Ne jemi mësuar, ministre, ta dezinformoni shumë herë opinionin për çështje të ndryshme, por ajo çka tentoni të më citoni mua lidhur me letrën drejtuar ITU-s nuk qëndron. Tani do t'ju sjell, sepse unë për hir të transparencës e kam përkthyer edhe në shqip dhe e kam lexuar në seancë të Kuvendit. Tani do t'ju sjell edhe një herë, sepse nuk është e vërtetë, nuk qëndron ajo çka thatë ju lidhur me marrëveshjen, pra me ITU-n.

Pyetja ime ka të bëjë me ministrin e Shëndetësisë. Në konkursin e fundit të specializimeve që është shpallur nga Ministria e Shëndetësisë për profile të ndryshme, nuk është ndarë asnjë specializim për spitalin e Vushtrisë, duke ditur se ky spital ka mungesë të mjekëve specialistë të lëmenjve të ndryshme.

Zoti ministër, a mund të na tregoni, pse nuk është ndarë asnjë specializim për Spitalin e Vushtrisë?

KRYESUESI: Zoti ministër, një sekondë. Patjetër, meqenëse Aida e shkeli Rregulloren, më duhet ta shkel edhe unë Rregulloren me zonjën ministre. Pastaj zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Në fakt, unë nuk përmenda asnjë emër, por ju vetë u zbuluat, sepse vetë e keni dërguar letrën. Jo, jo, unë vërtet nuk thashë emër. Unë thashë një deputet, ju vetë u zbuluat.

Zonja Dërguti, në internet e gjeni, unë e kam, gjithkush mund ta gjejë në internet. Tani, tani, veç pak, veç unë nuk lexoj si ju që lexoni letrat e Bahtirit, veç ngadalë.

Aida, shiko, edhe e ke keqpërdorur Kuvendin, se e ke nënshkruar si nënkryetare e Kuvendit. S'ke guxuar, sepse kjo është dashur të bëhet me miratimin e Kryesisë, e ke shkelur Rregulloren, zonja Dërguti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete,

Pyetja rreth specializimeve në spitalin e Vushtrisë ka këtë përgjigje.

Ne jemi munduar që të shpallim specializimin mbi bazën e një planifikimi të nevojave dhe nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës na ka ardhur përgjigjja se njëherë përnjëherë duhet parë që ata që janë në specializim t'i sistemojmë aty dhe ata që janë të papunë, të sistemohen.

Kjo nënkupton që deri në vitin 2019 për Spitalin e Vushtrrisë do të specializohen 20 mjekë, të shumë lëmenjve: anestologjia, gastroenterologjia, kardiologjia, kirurgji maksilofaciale, kirurgji orale, neurologji, oftalmologji, ortodonci, pediatri, protetikë stomatologjike, psikiatri, reumatologji, radiologji, sëmundje të dhëmbit dhe urologji, të gjitha këto janë në emër të spitalit të Vushtrrisë.

Dhe, e dyta është që ne shumë shpejt do të procedojmë me konkursin për specialistë të papunë që i kemi sistemuar me kontrata të përkohshme dhe sigurisht që Spitali i Vushtrrisë do të jetë një nga spitalet që do të ketë prioritet në shpalljen e vendeve të lira për specialistë, që janë tash me kontrata brenda QKUK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Dërguti?

AIDA DËRGUTI: Faleminderit!

Me që u mora pak më shumë me këtë konkursin, u çudita kur e pashë në Departamentin Shëndetësor të Burgjeve është ndarë specializimi për pediatri. A mund të na sqaroni, zoti ministër, çka nënkupton specializimi në pediatri në Departamentin e Burgjeve, a kemi fëmijë të burgosur nën moshën 12-vjeçare?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Thashë që konkursi i specializimeve është shpallur mbi bazën e kërkesave të institucioneve dhe departamenteve, bile edhe të shërbimeve të burgjeve mjekësore ka ardhur edhe kërkesa për ato specializime dhe ato i kemi shpërndarë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dërguti, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit!

Meqenëse kjo është hera e dytë që e parashtroj pyetjen, bartet në dy seanca dhe prapë ministri nuk është prezent, po e lexoj pyetjen.

Nga mbledhja e parë e përbashkët mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë më 11 janar 2014 dhe marrëveshjeve të dakorduara Qeveria në Tiranë mori vendim më 7 maj 2014 për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësishë etnike shqiptare.

Në mars të vitit 2015, pra një vit më vonë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale njoftonte se u firmosën tri marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë.

Nënshkrimi u bë në atë kohë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj dhe homologu i tij, Arban Abrashi.

Më konkretisht, u arrit marrëveshja për heqjen e lejeve të punës dhe liberalizimin e tregut të punës ndërmjet dy vendeve nga Gjirokastra deri në Mitrovicë, Shqipëria i ka hequr lejet e punës për shtetasit nga Kosova, ndërsa Kosova u zotua ta bëjë këtë shumë shpejt për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Në pyetjen e shtruar ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në njërën nga seancat e kaluara ai u përgjigj se për këtë duhet ta pyesim ministrin e Punëve të Brendshme dhe se Ministria që drejton ka lobuar për këtë ndryshim, si dhe e ka kryer punën, por Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk e ka realizuar pjesën e saj.

Tash jemi dy vjet e pesë muaj nga mbledhja e dy qeverive dhe një vit e gjysmë nga nënshkrimi i marrëveshjeve për lejet e punës. Pra, ministri nuk e zbatoi këtë marrëveshje dhe pyetja ime për të në këtë rast është: A ka nevojë për ndihmë për t'i shkruar ato amendamente, që janë të nevojshme? Nëse ka nevojë, le të na drejtohet ne si Kuvend do ta ndihmojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Ku ta gjejmë kryeministrin?! Nëse dikush në emër të kryeministrit nga Qeveria mund të përgjigjet, atëherë do t'ia kisha lexuar pyetjen. Duket se zëvendëskryeministri i ri mund të bëjë përgjigje.

KRYESUESI: Po, është paraqitur zonja Tahiri.

REXHEP SELIMI: Dakord! Atëherë, pyetja ka të bëjë me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, konkretisht neni 3.6 ku thuhet se në cilësinë e vëzhguesit mund të marrin pjesë kryetari i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Pra, bëhet fjalë për takimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Pyetja ime parlamentare drejtuar kryeministrit është kjo: Thirrja e mbledhjes së Këshillit është e precizuar me nenin 5.3 të këtij ligji, citoj “takimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës thirren formalisht nga kryeministri”. Pyetja ime për kryeministrin është se pse nuk është ftuar asnjëherë, theksoj asnjëherë, në mbledhje të këtij këshilli kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi e paska fjalën, edhe pse po ju them publikisht që kjo është shkelje e Rregullores, ministrat s’duhet të autorizohen, ministrat s’duhet të përgjigjen, përveçse në rastet e jashtëzakonshme në emër të kurrkujt hiç. Secili përgjigjet për vete, në këtë rast edhe kryeministri. Zoti Kelmendi, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Selimi,

Këshilli i Sigurisë së Kosovës është themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 127 paragrafi 2 të Kushtetutës, Këshilli i Sigurisë së Republikës së Kosovës kryesohet nga kryeministri dhe me mbledhje nga Qeveria.

Sa i përket përbërjes së Këshillit, procesi i emërimit dhe i shkarkimit të anëtarëve të Këshillit përcaktohet me Ligjin nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Bazuar në nenin 3 të këtij ligji, Këshilli i Sigurisë së Kosovës përbëhet nga anëtarët e përhershëm me autoritet ekzekutiv, si në vijim: kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose zëvendësi i tij, ministri i Punëve të Jashtme ose zëvendësi i tij, ministri i Punëve të Brendshme ose zëvendësi i tij në mungesë, ministri i Drejtësisë ose zëvendësi i tij në mungesë, ministri i Ekonomisë dhe Financave ose në mungesë zëvendësi i tij, ministri për Kthim dhe Komunitete ose në mungesë zëvendësministri.

Këshilli i Sigurisë së Republikës së Kosovës, përveç anëtarëve të përhershëm me autoritet ekzekutiv, bazuar në nenin 3, paragrafi 3-4 të Ligjit nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës po ashtu përfshin edhe anëtarët e përhershëm në rolin këshillëdhënës, si vijon: një përfaqësues i Presidentit të Republikës së Kosovës, drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, këshilltarin e lartë të kryeministrit, këshilltarin e kryeministrit për Siguri, drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, drejtorin e Doganave të Republikës së Kosovës.

Përveç anëtarëve të lartpërmendur, bazuar në nenin 3, paragrafi 3.5 të Ligjit, kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës sipas nevojës mund të emërojë anëtarë shtesë në cilësinë e këshilltarëve me status të përkohshëm. Gjithashtu, bazuar në po të njëjtin nen sipas paragrafit 3.6, në cilësinë e vëzhguesit mund të marrin pjesë kryetari i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe kryetari i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Andaj, duke pasur parasysh dispozitat ligjore të lartcekura, konsiderojmë se anëtarët e përhershëm me autoritet ekzekutiv dhe anëtarët e përhershëm në rolin këshillëdhënës të Këshillit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, të cilët janë të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin nr. 03/L-050 për

Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Këshillit, të cilat thirren dhe kryesohen nga kryeministri i Republikës së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ramiz, u mor vesh kjo punë. Pyetje shtesë, zoti Selimi?

REXHEP SELIMI: Meqë siç the ti në nenin 3.6, në cilësinë e vëzhguesit mund të marrë pjesë kryetari i Komisionit Parlamentar për Siguri dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ju nuk u përgjigjët në pyetjen time: Pse nuk është ftuar kryetari, ose pse nuk është informuar kryetari i Komisionit Parlamentar, i cili ka të drejtë, pavarësisht që atje përmendet në cilësinë e vëzhguesit? Pra, ka të drejtë të jetë i ftuar dhe ka të drejtë të marrë pjesë në Komisionet e Sigurisë.

Meqë deri më tash është praktikuar, pra në legjislacionet e kaluara është praktikuar, kryetari i Komisionit për Siguri gjithmonë ka marrë pjesë, a do të thotë kjo që nuk është ftuar kryetari i Komisionit për Siguri për shkak se këtë komision e udhëheq një deputet i caktuar, në këtë rast Daut Haradinaj. Pra, a është përjashtuar Daut Haradinaj, apo është përjashtuar kryetari i Komisionit për Siguri? Do të doja të përgjigjeshit, meqë po përgjigjeni në emër të kryeministrit, të përgjigjeni drejt dhe të përgjigjeni po ashtu me saktësi.

KRYESUESI: Zoti Kelmendi e keni fjalën, nëse keni përgjigje.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMIZ KELMENDI: Kryetari i Këshillit për Siguri Kombëtare sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, që e përcakton që mund të marrë pjesë, por nuk është e thënë që duhet domosdoshmërisht të marrë pjesë, prandaj është e drejtë e kryeministrit t'i bëjë ftesat sipas ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Uroj që të mos luhet me institucionet, as me Këshillin e Sigurisë, as me Parlamentin, as me Qeverinë, nga askush. Zëvendësuesit janë për çështje tjera, për pyetjeve duhet t'u përgjigjet ai që i shtrohen pyetjet.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Desha t'i përgjigjem zëvendëskryeministres për t'i thënë që ju keni pasur autorizim për bisedimet teknike dhe jo politike, dhe prej se kanë filluar bisedimet po bisedohet kryekëput për çështje të brendshme të Kosovës.

Ka një kohë të gjatë që Ministria e Integrimeve Evropiane ka ngelur pa ministër, në kohën kur ne e kemi zgjedhur rrugën e integrimeve evropiane dhe kur tash në këtë seancë do të miratohet agjenda për reforma evropiane, e ku janë ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, e ka qenë vërejtje edhe e Bashkimit Evropian dhe kush do ta përmbushë gjithë këtë agjendë, sepse edhe në Bruksel kur kemi qenë kanë thënë se nuk po ka njerëz të duhur, të cilët llojnë për proceset e integrimit evropian dhe për anëtarësim në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Pse po zvarritet kjo punë dhe kur do të zgjidhet ministri i Integrimeve Evropiane?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abrashi e ka fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Ministri ose ministrja e re e Integrimeve Evropiane do të caktohet do të caktohet në atë moment kur kryeministri e pranon edhe nominimin nga partneri i koalicionit, çka është me rëndësi të theksohet është që zëvendësministrja Statovci dhe zëvendësministrja Beqaj tani po e kryejnë detyrën në mënyrë të shkëlqyer dhe Ministria e Integrimeve po i kryen të gjitha detyrimet dhe obligimet që i ka, si karshi institucioneve tona publike, si karshi Brukselit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zoti Abdyl Ymeri, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Ne jemi dëshmitarë të problemit të demarkacionit tash e dy vjet, i krijuar nga të gjithë pavarësisht, pozitë e opozitë, por që është problem faktik që po përdoret edhe për arsye të tjera të njohura dhe në këtë frymë iniciativat e nisura nga ju së fundmi si iniciativë e radhës, ajo me krijimin e një komisioni, ju nuk keni ftuar ekspertë nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, Katedra e Gjeodezisë dhe Kadastrës, e cila është kompetentja kryesore për problemet kadastrale dhe gjeodezike.

Pyetja ime është: Pse nuk është ftuar ndonjë ekspert nga Katedra e Gjeodezisë dhe Kadastrës në Komisionin për matjen e territorit të Kosovës?

KRYESUESI: Zoti Rexhep Selimi, pyetje për ministrin Abrashi. Zoti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Zoti kryeministër, shumica e qytetarëve të Kosovës e mbajnë mend premtimin elektoral për shtet zhvillimor dhe për sigurimin e rreth 120 mijë vendeve të reja të punës. Tashmë kanë kaluar më shumë se dy vjet të qeverisjes suaj dhe asnjë shenjë nga zhvillimi ekonomik dhe nga krijimi i vendeve të reja të punës, po i përjashtoj ato që jua keni dhënë djemve tu si tenderë, e që janë bërë pak punësime, por në përgjithësi nuk ka ndonjë ndryshim.

Sa për lustrim, vetëm në Komunën e Mitrovicës 30% e qytetarëve jetojnë në varfëri, ndërsa 2 089 familje marrin ndihma sociale, kurse një pjesë tjetër nuk marrin fare për shkak se e keni rritur numrin e kriterëve. Vetëm në Mitrovicë, Vushtrri, Drenas dhe Istog jetojnë 6 406 familje me ndihma sociale. Në gjithë Kosovën, numri i atyre që jetojnë nga ndihmat sociale, e që ato nuk mjaftojnë as për bukë, është afërsisht 120 mijë pra, aq sa keni premtuar se do t'i punësoni. Po ta realizonit premtimin tuaj për këta qytetarë të varfër, do të kishte vend të punës.

Pyetja ime për ju: Besoj që e keni bërë bilancin e dy vjetëve të kaluara, a mund të na thoni sa parashihni t'i punësoni deri në fund të mandatit tuaj? A e keni bërë ndonjë analizë për t'i treguar opinionit, duke qenë akademik dhe doktor i ekonomisë, pra ndër njerëzit më të ditur në Kosovë për ekonomi, së paku për nga diplomat, për çfarë nuk u realizua programi juaj? Për çfarë arsye ngeci? Pse kemi kaq shumë, zoti kryeministër, varfëri në Kosovë? Cilat janë shkaqet? Dhe, a ndieni përgjegjësi personale si kryeministër për moskryerjen e detyrave që ju takojnë, për premtimet e rrejshme që keni bërë dhe për varfërinë e madhe, e cila po qëndron në vendin tonë?

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro, zoti Abrashi!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Unë, sa e kam lexuar në Rregullore, sa jam në dijeni për Rregullore të Kuvendit, kryeministri i Kosovës mund t'i delegojë pyetjet tek ministrat, të cilat përputhen me lëmin, ose ashtu siç vendos kryeministri. Sa është Rregull unë e di, edhe me Sekretariatit mund ta konfirmojmë.

KRYESUESI: Po mund t'i delegojë ligjet, e për nevoja tjera, por pyetja është e drejtpërdrejtë për të. A është për të? Hajde, se e shkelëm sot.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Sa e di unë, në Rregullore ekziston kjo mundësi, prandaj kjo rregull ka të drejtë që ta delegojë,... A bën të përgjigjem në pyetjen tuaj, dhe nuk është shkelje e Rregullores, por është e drejtë ligjore për t'u përgjigjur. Ok, faleminderit!

I nderuar kryesues,
Kabinet qeveritar,
Deputetë,

Ndërlidhur me pyetjen e deputetit Topalli, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka filluar ndryshimet fiskale dhe stabilitetin financiar për ta përcjellë me një sërë reformash në shumë fusha. Nuk mund të anashkalohet as efekti i pakos së parë fiskale, të cilën bizneset e kanë cilësuar si bazë të dëshirueshme për ta zhvilluar edhe më tej ekonominë familjare, si masë për ta lehtësuar edhe konsumin bazik.

E kemi themeluar dhe funksionalizuar Fondin për Garanci Kreditore, që pritet të ketë efekt direkt në lehtësimin e hapjes së vendeve dhe bizneseve të reja. Kemi investuar në energjetikë dhe jemi pranë investimeve më të mëdha ndonjëherë që i njeh historia e re e Kosovës. Kemi nënshkruar dhjetëra marrëveshje ndërkombëtare financiare, po ashtu edhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, programin me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu, kemi ndarë shuma rekorde për ta subvencionuar bujqësinë, kemi falur borxhet publike, e kemi aprovuar Projektligjin për investime strategjike, e kemi aprovuar Ligjin për “Trepçën” dhe të gjitha këto kanë ndikuar që të kemi një rritje ekonomike prej së paku 4% në vitin 2015 dhe presim po aq rritje të ngjashme edhe për vitin 2016. Viti 2017 duket edhe më pozitiv.

Në anën tjetër, Agjencia e Statistikave të Kosovës tregon se norma e papunësisë ka rënë nga 35 në 26%. Megjithatë, burimet tjera të të dhënave, si për shembull Administrata Tatimore e Kosovës apo Fondi i Kursimeve Pensionale tregojnë se gjatë vitit 2015 kemi pasur mbi 18 mijë persona të rinj, të cilët kanë kontribuar aktivisht ose nëpërmjet taksave, ose në kursimet e tyre personale. Pra, po flasim për numër të punësimit në vitin 2015 prej së paku 18 mijë persona. Kjo tregon se mbi 18 mijë persona kanë hyrë për herë të parë në punë gjatë vitit 2015, për vitin 2016 vlerësohet se kjo shifër ka arritur mbi 22 mijë persona, që nënkupton se trendi i punësimit po vjen duke u rritur dhe duke pasur parasysh se efekti i politikave të ndërmarra më herët ka arritur të jetë fuqishëm, besoj që ky vit do të jetë edhe më i fuqishëm.

Presim që ky trend të përshpejtohet edhe më tutje, duke krijuar edhe më shumë vende të reja të punës në vitet 2017 dhe 2018 për të arritur përafërsisht atë që e kemi premtuar gjatë fushatës elektorale, diku rreth 20 mijë të punësuar gjatë një mandati qeverisës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Unë kam pyetje për kryeministrin, nëse ministrat dalin sa herë kanë dëshirë të flasin për pyetjet që nuk u shtrohen, mendoj që nuk është në rregull. Zoti Abrashi është më mirë të përgjigjet, po këtë pyetje ia bëj në veçanti pastaj, e drejta e tij se si i ka kursyer 10 milionë euro, e proklamon atë si një fitore të madhe, ndërsa ka lënë jashtëzakonisht shumë njerëz pa bukë, duke ua ndalë pensionet që i kanë marrë për vite e vite me radhë.

KRYESUESI: Zoti Abrashi, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Megjithëse nuk është pyetje në rend të ditës, duhet ta sqaroj deputetin Topalli që nuk i ka kuptuar deklaratat e mia, ose nuk e ka lexua Ligjin për skemat pensionale, ose nuk e ka lexuar udhëzimin administrativ për çka flitet.

Ne nuk ia kemi ndalë pensionin askujt që ka marrë vite e vite, ajo çka kemi parë gjatë vitit 2015 e kemi ndryshuar një udhëzim administrativ. Në vitin 2016 ka qenë që Kosova ka qenë destinacion i pensionit të turizmit, le të themi kështu. Njerëzit, ditën e marrjes së pensioneve kanë ardhur nga shtetet fqinje dhe kanë përfutur pensione vetëm pse e kanë pasur një letërnjoftim të Kosovës, por nuk janë banorë të përhershëm të Kosovës. Ligji e përcakton shumë qartë që ata që marrin pensionin e Kosovës duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës. Ne e kemi marrë një udhëzim administrativ dhe kemi kërkuar nëse ata që marrin pensione kanë prona ose jetojnë në Kosovë nëpërmjet një qiraje, mbi 17 mijë nuk kanë mundur ta dëshmojnë. Nuk ka të bëjë me atë se e kemi larguar dikë, ne thjesht e kemi zbatuar ligjin. Lexojeni ligjet të cilat po i kaloni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Faton Topalli, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Kuçi nuk është këtu.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Zoti ministër, kanalizimi i qytetit të Ferizajt derdhet në lumë, pra komplet kanalizimi i qytetit derdhet në lumë në fshatin Nidadin, afër Pishinës “Matoshi”. Uji i kanalizimit kalon pastaj nëpër fshatrat Varosh dhe Gurëz. Njëri problem është se ndotet ambienti dhe problemi tjetër është se gjatë muajve të verës, posaçërisht kur është shumë ngrohtë, është e pamundur të jetohej në këto fshatrat për shkak kundërmimit të erës së fekaleve.

Pyetja ime është: A jeni të informuar për këtë gjendje, respektivisht për ndotjen e ambientit? Cilat janë masat që keni ndërmarrë deri tani? Ndërsa, pyetja tjetër ka të bëjë me fshatin Greme, i cili është krejtësisht pa ujë dhe ku uji i pijes nga pusët që janë bërë aty përzihet me ujin e kanalizimit, pra rrezikohet shëndeti i 10 mijë banorëve. Kjo pyetje s’ka qenë për zotin Hajredin Kuçi, por meqë tash ministrat po flasin kur të duan e si të duan atëherë kësaj pyetje mund t’i përgjigjet ministri për Mbrojtjen e Ambientit, i cili ndodhet këtu në sallë.

KRYESUESI: Po zoti Shala e keni fjalën nëse doni, nëse jo mund ta lini.

MINISTRI FERAT SHALA: Faleminderit, i nderuar deputet!

Edhe në planin legjislativ, por edhe në të arriturat buxhetore të miratuara tashmë, Komuna e Ferizajt i ka kodet e veta dhe janë paraparë të gjitha këto sanime apo plotësime të këtyre projekteve.

Ne jo më larg se dje kemi pasur takim me kryetarin e Kuvendit Komunal të Ferizajt, jemi dakorduar që brenda pak ditësh të fillojë implementimi i gjitha këtyre projekteve, mbështetur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pra, shumë shpejt do të fillojë implementimi dhe zgjidhja e këtyre problemeve mjedisore dhe infrastrukturore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Faton, pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Atëherë, nëse ju kuptova drejt, ju u premtoni qytetarëve të fshatrave që përmenda, pra të fshatit Varosh e Gurëz, që kjo çështje do të rregullohet brenda javësh dhe gjithashtu u premtoni banorëve të fshatit Greme që do ta rregulloni problemin e ujit të pijshëm dhe që uji i pijshëm nuk do të përziehet më tutje me ujin e kanalizimit.

KRYESUESI: Po, zoti Shala e keni fjalën, ministri i Ambientit.

MINISTRI FERAT SHALA: I nderuar deputet,

Nuk u premtoj brenda javësh, as nuk e thashë, thashë jemi në koordinim të plotë me pushtetin lokal, me kryetarin e Komunës dhe javët e ardhshme do të jemi në harmonizim të investimeve dhe planeve, e jo për të filluar javën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Pyes nëse ka ndonjë vërejtje sa i përket çështjes së procesverbalit, ka ndonjë mendim shtesë? Nuk ka!

Atëherë, konsideroj që Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 19 janar 2017.

Zoti Pajaziti e ka kërkuar fjalën sa i përket rendit të ditës.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë kam dy çështje: një propozim për rendin e ditës. I pari rreth Komisionit të Pavarur për Medie, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Medie, më 8 shkurt 2017, ky komision e ka proceduar në Kuvend listën e kandidatëve që kanë aplikuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie dhe sipas ligjit brenda 20 ditës pas përfundimit të afatit për paraqitjen e

kandidatëve Komisioni ad hoc i themeluar prej Kuvendit i interviston kandidatët dhe i rekomandon për votim në seancë plenare.

Prandaj, duke e respektuar ligjin dhe afatin ligjor në bazë të nenit 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, propozoj që të plotësohet rendi i ditës në seancë plenare, më 9 shkurt 2017, formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtarë të Komisionit Pavarur për Medie dhe propozoj që të radhitet në pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Dhe, çështja e dytë, e njoftoj seancën plenare për zëvendësimin, meqenëse në një seancë për shkak të mungesës së kryetares së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është dashur të bëhet një ndryshim për nevojat e punës së komisionit, zonja Flora Brovina rikthehet ose propozohet si kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në emër të grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Veç silleni me shkrim...

A po e bëjmë një votim formal lidhur me këtë çështje, sepse unë mendoj se është interes i të gjithëve, sa i përket kësaj. Kush është për? Kundër, a ka? Nuk ka! Miratohet që të renditet si pikë e gjashtë formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për medie, si dhe ndërrimi i deputetes, është në rregull.

Pika e katërt e rendit të ditës, tani po hyjmë në votime, ju kisha lutur që t'i zini vendet dhe të fillojmë ta kapërcejmë këtë çështjen e votimeve dhe pastaj hyjmë në seancë që ka të bëjë me interpelancën e kryeministrit.

4. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë

Ju njoftoj se në seancën e kaluar ka përfunduar diskutimi për këtë pikë, si dhe është harmonizuar teksti i propozim-rezolutës në grupet parlamentare. Andaj, në seancën e sotme procedoj me votimin e propozim-rezolutës lidhur me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë.

E ftoj deputetin Ismajl Kurteshi që ta paraqesë propozim-rezolutën. E ka paraqitur a? Në rregull! Le ta paraqesë dhe votojmë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Është e vërtetë që rezolutën e kemi lexuar më 19, por atëherë kanë qenë 60 deputetë. Për deputetët që s'janë këtu merr një minutë kohë. Mendoj që është mirë me e lexua, nëse pajtoheni.

Pra, bazuar në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 19 janar 2017, pas interpelancës së zhvilluar me ministrin e Arsimit, zotin Arsim Bajrami, në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë, me propozim të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe me harmonizim nga grupet parlamentare PDK, LDK, AAK, Nisma dhe një pjesë e grupit “6+”, është arritur të nxirret kjo:

R E Z O L U T Ë

1. Arsimi të shpallet interes nacional, ndërsa në funksion të kësaj të rritet buxheti për këtë sektor.
2. Të rritet llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i performansës së të gjithë mësimdhënësve në nivel vendi dhe të bëhet kategorizimi i tyre sipas rezultateve të vlerësimit dhe sidomos sipas rezultateve të testimit të jashtëm të nxënësve të tyre.
3. Qeveria e Kosovës ta krijojë një fond të veçantë për ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve dhe një fond tjetër për arsimin parashkollor, me qëllim të sigurimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme.
4. Të bëhet rishikimi i Kurrikulës, i planprogrameve dhe teksteve shkollore në përputhje me kushtet dhe rrethanat në Kosovë.
5. Të ndalohet përdorimi i teksteve shkollore me përmbajtje antikushtetuese.
6. MASHT-i ta iniciojë themelimin e një forumi gjithëpërfshirës nga deputetët, nga ekspertët e fushës së arsimit dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për analizën e situatës në arsim dhe të propozojë rekomandime.
7. Të rikonceptohen tekstet shkollore dhe të bëhet unifikimi i lëndëve shkencore.
8. MASHT-i të krijojë kushte të volitshme për organizimin e mësimi fakultativ.
9. Të zbatohet në plotëni Kontrata Kolektive.
10. Të rishikohet dhe të amendamentohet infrastrukture ligjore në fushën e arsimit.
11. Në rast të mospërmbushjes së kriterëve për licencim, institucionet shkollore jashtë sistemit publik të mbyllen.

12. Ministri i Arsimit të raportojë para Kuvendit të Kosovës në çdo tre muaj për gjendjen në arsim.

Siç thashë në fillim, kjo rezolutë është e harmonizuar me grupet parlamentare të lartpërmendura, prandaj i lus deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus deputetët dhe regjinë, që të përgatitemi për votim. Votojmë tani!

Në sallë janë 64 deputetë. A dikush pa kartelë në sallë? Tre janë pa kartelë. E përsëris edhe një herë votimin. Kanë votuar 50 deputetë nga 64 që janë në sallë, ose 64.

Lus regjinë që edhe një herë ta përsërisë votimin, se po vijnë edhe dy deputetë dhe shpresoj që të dy votojnë. Regjia, votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar me kartelë 62, plus 3, a jeni për? Besoj që po. 65, në fakt 64 u bënë me kartelë, i bie plus 3, d.m.th. 67 deputetë kanë votuar, 60 janë për, 3 janë kundër, një abstenon. Konstatoj që Kuvendi miratoi rezolutën lidhur me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë.

5. Votimi i propozim-rezolutës lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Ju njoftoj se në seancën e kaluar ka përfunduar diskutimi për këtë pikë, andaj në seancën e sotme procedojmë me votimin e propozim-rezolutës lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, që ta paraqesë propozim-rezolutën.

GLAUK KONJUFCA: Pika e parë, ministri i Punëve të Brendshme t’i dorëzojë raport me shkrim Kuvendit mbi hetimin dhe masat e marra rreth shkeljeve të faktuara, të shkaktuara nga zyrtarët e Policisë së Kosovës.

Pika e dytë, ministri i Punëve të Brendshme t’i dorëzojë Kuvendit përgjigjen zyrtare të dhënë për Amnesty International, lidhur me letrën apo raportin e dërguar më 29 shkurt të vitit 2016.

Pika e tretë, Komisioni parlamentar për siguri dhe mbikëqyrjen e FSK-së të monitorojë dhe raportojë në Kuvend mbi zbatimin e Ligjit për Policinë, referuar arrestimit të 6 qytetarëve të Kosovës, aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, më 30 gusht të vitit 2016.

Kjo rezolutë hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kërkoj që të votohet kjo rezolutë!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Sa deputetë janë në sallë, ju lutem? Janë 61 deputetë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Unë e kuptoj mosinteresimin për të votuar, por në qoftë se nuk e votoni nuk hiqet prej rendit të ditës, sërish duhet ta sjellim në seancën e ardhshme. Kështu që, më mirë votojeni, në qoftë se doni kundër, sepse nuk prish punë edhe të votoni kundër. Unë s'di çka me i bë kësaj! Kanë votuar veç 23 deputetë. Nëse doni ta përsërisim, e përsëris edhe një herë. E përsëris edhe një herë votimin.

Votojmë tash! Në rregull. I mbetet Kryesisë pastaj të merret me këtë punë.

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më 16 janar dhe 6 shkurt 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri në këtë seancë t'i propozojë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Ftoj kryetarët, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dua të ju informoj që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka propozuar dy kandidatë: Sadri Ferati dhe Agim Kikaj. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që t'i propozojë kandidatët.

ZENUN PAJAZITI: Propozoj Blerta Deliu dhe Xhevahire Izmaqu, kryetare dhe anëtare.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" do ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të parë të komisionit. Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Ne refuzojmë të marrim pjesë në këtë komision.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që ta propozojë një deputet për anëtar të Komisionit.

PAL LEKAJ: Ne propozojmë deputetin Lahi Brahimaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Lahi Brahimaj. Grupi Parlamentar i Listës Serbe, që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit. Nuk është askush për ta propozuar. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “6+” që ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të dytë të komisionit.

MUFERA SHINIK: “6+”-i propozon deputetin Kujtim Paçaku.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “Nisma” që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

ENVER HOTI: “Nisma” e propozon Zafir Berishën, jua kam sjellë edhe me shkrim.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, o hedh në votim propozimet për ta themeluar komisionin. Në qoftë se, Grupi Parlamentar i Listës Serbe kthehet në parlament, ka të drejtë që ta propozojë një anëtar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, nuk kanë votuar deputetët kanë votuar vetëm 50, 49 janë për, një abstenim. E shtyjmë për... kalendra, kur të plotësohen kushtet. S’ka deputetë, nëse vijnë deputetët e pozitës bëjmë. Sipas propozimit të zotit Pajaziti është formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie. Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Ftoj kryetarët dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t’i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një në Komisionin e Pavarur për Medie.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që ta propozojë një deputet për kryetar të komisionit dhe një deputet për anëtar të komisionit. Zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Propozoj të njëjtën përbërje, meqenëse do të punojmë.

KRYESUESI: Duhet me i ndërrua, se s’bën. Dy herë kryetar në të njëjtin komision nuk... ndërrohet.

ZENUN PAJAZITI: Propozoj në vend të zonjës Xhevahire Izmaku, nëse nuk prish punë me e lënë të njëjtën atëherë e propozoj Selvije Halimin.

KRYESUESI: Në rregull, Selvija kryetare. Pse s’po i bën të dyja siç kanë qenë kryetare, le të jetë në të parin Xhevahirja, në të dytin le të jetë Blerta edhe qe... Në rregull, Selvija s’po pranon. Tani a doni me e lënë? Edhe një herë fjalën zotit Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Propozoj Hajdar Beqën, si...

KRYESUESI: Në rregull atëherë Hajdar Beqa dhe Xhevahire Izmaku. Zoti Beqiri, në emër të Lidhjes Demokratike, kë e propozoni?

ISMET BEQIRI: Po ne, meqenëse s'po na vjen rasti me e pas kryetarin, unë s'shoh arsye me i ndërrua. Le të jenë të njëjtit që ishin edhe në komisionin paraprak. Duhet me ua thënë emrat a? U bë, zoti Xhelë. Agim Kikaj, Sadri Ferati.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi i “Vetëvendosjes” që ta propozojë një deputet, zëvendëskryetar të parë të komisionit, zoti Konjufca, çfarë qëndrimi keni për rastin e dytë?

GLAUK KONJUFCA: Propozojmë që të jetë Shqipe Pantina.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

PAL LEKAJ: E propozojmë të njëjtin deputet, Lahi Brahimaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “Nisma” që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

ENVER HOTI: Zafir Berisha, i njëjti.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “6+”, që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

MUFERA SHINIK: Danush Ademi.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Listën serbe vlen e njëjta formulë, si për çështjen e parë.

Atëherë, e hedh në votim propozimet për komisionin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

A ka pa kartelë? 2, në rregull. Atëherë, 59 me kartelë, 3 u bënë pa kartelë, domethënë kanë votuar 63 deputetë dhe për janë 58, kundër s'është asnjë, ka abstenuar 1.

Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc që të veprojë në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Medie.

Atëherë, me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar, meqenëse kështu duhet të jetë si rregull, sipas propozimit të shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozohet zëvendësimi i kryetarit të Komisionit për Shëndetësi, në vend të dr. Nehat Baftiut, propozohet deputetja Flora Brovina. Edhe, besoj që s'ka kurrkush kundër, miratohet.

7. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit, zotit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë

Deputeti Rexhep Selimi i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë.

Ju njoftoj, se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Nga kryetarët e grupeve parlamentare është kërkuar që mbi bazën e kohës së ndarë për çdo grup parlamentar, para fillimit të seancës plenare kryesuesit të seancës plenare t'ia paraqesin listën e deputetëve për diskutim gjatë debatit për interpelancë.

Pa grup parlamentar janë 4 deputetë dhe i kanë 6 minuta për diskutim.

Tani ato... kohën e dini ju të gjithë sa keni. Në qoftë se, i keni caktuar deputetët është më mirë, në qoftë se jo, atëherë kohën në dispozicion varësisht nga diskutimet që i bëni, të keni kujdes edhe për kolegët e juaj që duan të diskutojnë. Ne do ta llogarisim fiks sipas rregullores minutazhin e grupeve parlamentare, meqenëse kurrkush nuk i ka dorëzuar listat. Sipas Rregullores secilit deputet i takon vetëm një minutë e gjysmë për të diskutuar. Tani, ne kemi praktikuar një variant që nuk është i përshtatshëm për të gjithë deputetët, sepse në seancën e kaluar e kam parë që disa janë mërzhitur, veçanërisht nga Grupi Parlamentar i PDK-së, sepse u është marrë minutazhi nga diskutuesit paraprakë.

Në qoftë se e keni bërë listën e diskutuesve, unë e marr parasysh. E ftoj zotin Rexhep Selimi, deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në cilësinë e propozuesit të interpelancës ta marrë fjalën. Hapësirë kohore keni 10 minuta.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja dhe zotërinj,

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Situata e sigurisë e krijuar në Kosovë, në veçanti në komunat veriore të Republikës së Kosovës, e ka bërë të nevojshme një interpelancë me kryeministrin e vendit dhe vlerësimin real të situatës së përgjithshme, duke debatuar dhe marrë vendimet e nevojshme me shumë seriozitet, ashtu siç edhe situata është serioze.

Ka pasur kërkesa për interpelancë të kryeministrave edhe herëve tjera, madje edhe për të njëjtën temë, për gjendjen e rënduar në veri të vendit. Jo pse më herët ka qenë situata më e mirë, por gjendja e rënduar, sidomos në fushën e sigurisë, në komunat veriore të Kosovës, sidomos në pjesën veriore të Mitrovicës, e ka bërë të nevojshme thirrjen për interpelancë. Në fakt, kjo interpelancë është thirrur para dy muajsh, pikërisht atëherë kur edhe ka nisur një situatë e re e rënduar fushën e sigurisë, kur ende nuk ishte tharë betoni i një muri ndarës në mes të qytetit të Mitrovicës.

Kronologjia e ngjarjeve në Mitrovicën veriore dhe në komunat në veri të vendit, tregon se atje kishte një dinamikë të vazhdueshme të përkeqësimit të gjendjes së sigurisë. Pas djegies së pikave kufitare 1 dhe 31 dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Qeveria e atëhershme nuk ndërmori asnjë masë të vetme për jetësimin e shtetit edhe në ato komuna, pra në komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Pushteti i atëhershëm i koalicionit të tashëm PDK-LDK heshtazi e pati pranuar ndarjen e Kosovës në pjesën jugore dhe veriore të Kosovës, duke mos bërë asgjë për ta shtrirë sovranitetin e vendit edhe atje.

Në vend të veprimeve shtetërore, ata pranuan negociata që fillimisht i kamufluan si teknike, pastaj rezultuan ato politike.

Më 26 korrik të vitit 2011, me një veprim të paplanifikuar ose me një veprim të planifikuar që të dështojë, Qeveria e atëhershme ndërmori një veprim policor që rezultoi me vdekjen e policit Enver Zymberi dhe me ngritjen e barrikadave që e bllokuan veriun e vendit për qarkullim në shumë rrugë e sheshe atje.

Ndonëse nuk ishte një plan operacional për Policinë e Kosovës, rezultoi se kishte një plan politik për krijimin e një situatë çfarë u krijua më vonë.

Prej atëherë e deri më sot, atje në vend që të shuheshin strukturat e sigurisë së Serbisë, me anë të negociatave dhe marrëveshje u liberalizuan ato dhe e ndanë policinë në baza etnike.

Prej atëherë e deri sot, atje nuk ka shtet as institucione të Republikës së Kosovës, dhe edhe ato pak institucione, siç është Policia e Kosovës në Mitrovicën e veriut, pra kontrollohen më shumë nga Serbia se sa nga zinxhiri komandues i Policisë së Kosovës.

Prej atëherë e deri sot, në vend që të respektohej sovraniteti i Kosovës, Qeveria e Kosovës ka vazhduar ta mohojë sovranitetin e vet në ato komuna, duke pranuar ta negociojë këtë me Serbinë në Bruksel.

Pas të gjitha bisedimeve e marrëveshje në dëm të sovranitetit të Republikës, marrëveshje pas marrëveshjeje, Qeveria e Kosovës arriti deri te një marrëveshje edhe për ndarjen fizike të qytetit të Mitrovicës, respektivisht të Kosovës, siç është marrëveshja për ndërtimin e një pengese prej betoni në anën veriore të urës së lumit Ibër në mes të qytetit të Mitrovicës.

Kjo ndarje u ekzekutua me ngritjen e një muri prej betoni brenda një nate, para 2 muajsh.

Si rrjedhojë, tensionimi i situatës lidhur me murin ngriti reagimin e qytetarëve, por edhe të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ku menjëherë kërkuam interpelancë të kryeministrit lidhur me situatën e krijuar në Mitrovicë më 9 dhjetor 2016, pra tash e 2 muaj.

Në ndërkohë, brenda afatit kohor kur do të duhej të rrënohej muri sipas vendimit të Kuvendit, më 14 janar Serbia e nisi edhe një linjë të re të qarkullimit të trenit Beograd - Mitrovicë.

Siç dihet ai tren u ndal në Rashkën e marrëveshjes së koalicionit, shumë larg para se të arrinte në territorin e Republikës sonë.

U proklamua shumë një retorikë e pakuptimtë se kush e ndali linjën e trenit Beograd-Mitrovicë në Rashkë. Por kurrë Qeveria e Kosovës nuk dha shpjegime përse dhe me çfarë të drejte qarkullon treni i hekurudhave të Serbisë në një linjë tjetër, në atë Kralevë - Mitrovicë.

Përse për Qeverinë e Kosovës vetëm treni që vjen nga Beogradi qenka ilegal, por jo edhe ai që vjen nga Kraleva?

Kryeministri, së paku sot, do të duhej të na e shpjegonte një gjë të tillë, apo edhe muri, edhe treni ishin krejt një skenar i parapërgatitur për të krijuar një situatë të caktuar.

Pas krejt kësaj situatë të krijuar, as treni s’u ndal, as muri s’u rrënua. Në të vërtetë, u ndal treni i linjës Beograd, por jo ai i Kralevës, që i bie se treni ende qarkullon Serbi - Kosovë, pa licencën e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, u rrënua një mur, por filloi një tjetër pranë tij. E, siç po shihet, edhe muri që u rrënua, edhe ai që po ndërtohet, kanë të njëjtin qëllim: të jenë barrikadë dhe pengesë fizike për qarkullim kundrejt anës jugore të lumit Ibër.

Në ndërkohë, ka pasur edhe një rezolutë në këtë Kuvend më 29 dhjetor 2016, për rrënimin e murit brenda muajit janar të vitit 2017.

Në fillim të këtij muaji pamë se Komuna e ashtuquajtur veriore e Mitrovicës nisi rrënimin e murit pas një marrëveshjeje me Qeverinë në Prishtinë. Se cili është çmimi, le ta shohim tash e tutje në insistimin e kryeministrit, e sidomos të presidentit, për jetësimin e “Zajednicës”.

Edhe pse nuk ndodhi në janar, rrënimi i murit do të duhej të ishte garanci e lëvizjes së lirë. Në vend të kësaj ndodhi vetëm një ridizajnim i qëllimit të atij muri, i cili po ashtu mbeti i njëjtë.

Me ridizajnimin e barrikadës moderne, të quajtur ashtu, në fakt po duket që aty po i mbyllet rruga qarkullimit të lirë, por po i hapet rruga “Zajednicës”.

Barrikada u ridizajnuar, por pa e ndryshuar qëllimin dhe funksionin e saj. Prandaj, sot, pas kësaj interpelance Qeveria do të duhej të marrë përgjegjësi dhe të reflektojë duke u kthyer në mbrojtje të integritetit territorial të vendit, në mbrojtje të sovranitetit të Republikës dhe në mbrojtje të interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke garantuar siguri të lëvizjes së lirë dhe siguri për të gjithë qytetarët e vendit, si në jug, ashtu edhe në veri, si në lindje, ashtu edhe në perëndim.

Edhe me vonesë, pra të përgjigjes së kryeministrit për interpelancë, edhe me tendencën ndoshta për ta eskivuar një gjë të tillë, pas rreth 2 muajsh kohe fatkeqësisht kjo temë ende nuk e ka humbur aktualitetin e saj, përkundrazi po rezulton të jetë përditë e më aktuale.

Të qenit aktuale kjo temë edhe pas 2 muajsh e bën edhe më të domosdoshëm trajtimin me shumë seriozitet të kësaj çështjeje.

Muri prej betonit në Mitrovicë, treni i linjës Beograd-Mitrovicë, krijimi i një klime të pasigurisë në vend me kërcënime dhe frikësime ndaj qytetarëve për luftë herë nga presidenti i Serbisë, e herë nga ai i Kosovës, duket qartë se janë skenarë të harmonizuar mirë në bashkëpunim në mes të qeverive të Serbisë dhe Kosovës.

Krijimi i një situatë të tillë dhe i skenarëve të luftës së ftohtë, e dëmton rënd shtetin e Kosovës. Dëmton rënd rolin e shqiptarëve në rajon. Dëmton rënd partneritetin me miqtë tanë perëndimorë, u krijon hapësirë të favorshme forcave antiperëndimore në Kosovë dhe, mbi të gjitha, rrënon të ardhme e sigurt të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, një rezolutë e re dhe implementimi i saj do të ishte fillim i një ndryshimi shumë të nevojshëm në kursin e ecjes së Kosovës.

Për këto arsye që i përmenda, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i ka propozuar Kuvendit të Kosovës miratimin e një mocioni përmbajtjesor. Në bazë të Rregullores ne e kemi dorëzuar këtë mocion përmbajtjesor, në momentin e kërkesës për interpelancë, meqë situata edhe mund të ketë ndryshuar, unë po e lë që këtë mocion përmbajtjesor për këtë projekt-rezolutë ta lexoj në fund, pas debatit, për shkak që t’i hapim hapësirë edhe ndonjë ndryshimi, në bashkëpunim me grupet e tjera parlamentare.

Njëkohësisht kërkoj që grupet parlamentare të japin kontributin e tyre në këtë interpelancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e ngritur për interpelancë. Hapësirë kohore, zoti kryeministër, keni 15 minuta, sipas Rregullores.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Qytetarë të nderuar,

Prolongimi i kësaj interpelance, mund të them se nuk është çështje e kërkesës sime. Ajo çfarë është kërkuar në Kryesi është vetëm të prolongohet për një seancë të Kuvendit, sepse nuk kam qenë këtu dhe unë në asnjë rast s’kam bërë vërejtje që të mos mbahet interpelanca dhe të mos përgjigjem në këtë interpelancë.

Dëshiroj vetëm të përsëris se veriu i vendit të Kosovës është pjesë e Republikës së Kosovës, se qytetarët e katër komunave në veri, ashtu sikurse edhe qytetarët e të gjitha komunave të tjera janë qytetarë të Republikës së Kosovës, prandaj gjendjen në veri të vendit mund ta kuptojmë e ta trajtojmë më lehtë dhe pa ngarkesa, kur vetes ia sigurojmë dhe ia sqarojmë se po flasim për territorin tonë dhe po flasim për qytetarët tanë, pa marrë parasysh problemet e trashëguara dhe pa marrë parasysh problemet që sot po lindin.

Problemet në veri të vendit, sikurse edhe në çdo pjesë të Republikës së Kosovës duhet t’i zgjidhim mbi bazë ligjore, me mirëkuptim dhe komunikim me qytetarët.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetin territorial të shtetit tonë. Ky është obligim kushtetues për të gjithë ne, ashtu sikur që është siguri i të drejtave dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre.

Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet e vendit arritën ta mbrojnë sovranitetin e shtetit, ta ruajnë stabilitetin e brendshëm përballë provokimeve destabilizuese që erdhën nga sjelljet e Serbisë.

Me sjellje dhe përgjegjësi shtetërore u ndal treni me parulla provokuese i nisur nga Beogradi, në marrëveshje me kryetarin e Komunës së Mitrovicës së veriut dhe me përfaqësuesit serbë nga radhët e deputetëve dhe ministrave në institucioneve të Kosovës, si dhe me përkrahjen ndërkombëtare arritëm marrëveshje për rrënimin e murit ndarës dhe për ndërtimin e një sheshi, sipas ligjeve dhe standardeve të përcaktuara.

Po ashtu i kemi bërë të gjitha përpjekjet për të dëshmuar se fletarrestimi i lëshuar kundër kryetarit të AAK-së dhe ish-kryeministrit të vendit, zotit Haradinaj, është politik, është joligjor dhe është i pavlefshëm jo vetëm për Kosovën, por duhet të jetë i pavlefshëm për gjithë komunitetin ndërkombëtar.

Në të gjitha rastet, përgjigjja jonë ishte institucionale dhe e vendosur në koordinim të plotë me të gjitha institucionet shtetërore, me presidentin e vendit dhe me kryetarin e Kuvendit.

Në përballimin e sfidave gjatë kësaj periudhe, ne patëm përkrahjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. U dëshmuar se ata kanë besim në institucionet e Republikës së Kosovës.

Këtë të diel, më 5 shkurt, hoqëm murin ilegal në Mitrovicë, në dobi të lëvizjes së lirë të qytetarëve, me një angazhim institucional, me një proces të brendshëm të bisedimeve mes Qeverisë dhe autoriteteve komunale të pjesës veriore të Mitrovicës.

Tashmë ka filluar realizimi i planit për shëtitoren në rrugën kryesore të qytetit, sipas ligjeve të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë, për herë të parë, ndërmjet Komunës së pjesës veriore të Mitrovicës, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Të nderuar deputetë,

Janë dy probleme, të cilat e ngarkojnë jo vetëm situatën në veri të vendit, por edhe në tërë vendin. Është shtrirja akoma e gjerë e strukturave paralele serbe në shumë komuna, jo vetëm me shumicë serbe, por formalisht edhe me ato me shumicë shqiptare, në institucione shëndetësore dhe kompani publike dhe është ndikim i drejtpërdrejtë i Qeverisë së Serbisë në deputetët e Kuvendit dhe anëtarët e Qeverisë nga radhët e Listës serbe, prandaj mendoj se kjo çështje duhet të shtrohet në mënyrë integrale dhe jo vetëm si çështje e 4 komunave të veriut, asaj të Leposaviqit, Zubin-Potokut, Zveçanit dhe pjesës veriore të Mitrovicës, por si problem i tendencave që Serbia të ushtrojë edhe më tutje ndikim në vendin tonë.

Përfundimisht, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë ndërlidhet me shuarjen e plotë të strukturave paralele dhe me ndërprerjen e ushtrimit të ndikimit të Serbisë te përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës dhe me pranimin e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

Sa i përket veriut, Qeveria e Kosovës do të vazhdojë angazhimet për të konsoliduar më tej sovranitetin shtetëror në pjesën veriore të vendit. Gjendja në veri ka ndryshuar pozitivisht dhe këto ndryshime janë rezultat i drejtpërdrejtë i dialogut në Bruksel.

Zhvillimet negative kohët e fundit nuk kanë mundur t'i zbehin këto rezultate dhe ne nuk kemi lejuar që ajo të ndodhë.

Me marrëveshjen për kufirin është arritur që autoritetet shtetërore të Kosovës të vendosen në dy pika kufitare në veri, të cilat ishin sulmuar dhe djegur kur Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Këto pika gjenden aty ku është kufiri shtetëror i Kosovës me Serbinë.

Kosova ka arritur të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit në këto fusha: në fusha të sigurisë, ku Policia e Kosovës vepron nga viti 2014, në fushën e Doganave nga viti 2012, në fushën e Administratës Tatimore.

Kosova ka vendosur të gjitha ministritë dhe agjencitë shtetërore që kanë veprimtari lokale në këtë pjesë të vendit. Kemi shuar strukturën ilegale me premisa paramilitare, e ashtuquajtura “Mbrotje civile”, ndërsa ish-pjesëtarët e saj janë bërë shërbyes civilë të punësuar në sistemin e Kosovës.

Është implementuar marrëveshja për kodin telefonik dhe shteti i Kosovës e ka marrë kodin e vet telefonik 838, i cili ka filluar edhe të implementohet.

Është arritur marrëveshja për drejtësinë dhe kjo marrëveshje do të përmbyllet së shpejti.

Kemi hapur zyra të regjistrimit civil në komunat veriore për t'i pajisur ata qytetarë me dokumente shtetërore të Kosovës.

Kemi shuar strukturat paralele të Serbisë në fushat ku janë arritur marrëveshjet.

Integrimi i komunitetit serb të asaj pjese në sistemin shtetëror të Kosovës është gjithnjë në rritje.

Interesimi i tyre për jetë normale dhe prosperuese është fakt se shprehet nga vetë ata.

Dialogu i Brukselit ka mundur heqjen e të gjitha barrikadave në veri, të cilat ishin vendosur si reaksion ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe po ashtu është hequr edhe barrikada nga ura e Mitrovicës, e cila do të lëshohet së shpejti dhe do të hapet qarkullimi automobilistik dhe qarkullimi tjetër ndërmjet pjesës jugore e veriore të Mitrovicës.

Këto zhvillime pozitive në veri të vendit krijojnë mundësi për përmirësimin e jetës së qytetarëve, të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të qytetarëve dhe komuniteteve.

Qeveria e Kosovës vlerëson kontributin e dhënë nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për tejkalimin e tensioneve të krijuara dhe ndaljen e provokimeve destabilizuese nga ana e Serbisë dhe mund t'ju them se dy takimet e fundit në Bruksel sa kanë qenë të rënda, aq edhe kanë dhënë rezultate në këtë fushë.

Delegacioni ynë e ka bërë të qartë se mbetemi të përkushtuar për paqe dhe fqinjësi të mirë, por gjithnjë në kushte të respektimit të pavarësisë, sovranitetit shtetëror dhe të mosndërhyrjes në punë të brendshme.

Kosova tani ka hyrë në rrugën zyrtare të integritetit evropian nëpërmjet Marrëveshjes për asociim-stabilizim me Bashkimin Evropian.

Të nderuar deputetë,

Kosova do të vazhdojë forcimin e shtetit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, mirëqenien e qytetarëve dhe komunitetit, integritetit, të sigurisë dhe prosperitetit.

Ashtu sikur që e dëshmuam në këtë periudhë, Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet shtetërore kanë zotësinë për t'iu përgjigjur çfarëdo sfide me të cilën ne do të ballafaqohemi.

Kosova mbetet e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjeve që janë në pritje të zbatimit, siç është marrëveshja për drejtësinë dhe marrëveshjet e tjera.

Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj veçmas Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, Gjermaninë, Britaninë e Madhe dhe vendet e tjera për vendosmërinë e tyre që të përkrahin proceset euro-integruese të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Gati të gjitha interpelancat, por edhe debatet që u iniciuan në Kuvend tani kanë një emërues të përbashkët. Ky emërues është: ndërprerja e dialogut, kushtëzimi i dialogut, ngrirja e dialogut.

Dialogu me Serbinë, në mbështetje të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zhvillohet në interes të Republikës së Kosovës, sepse Kosova po ballafaqohet me probleme si pasojë që nga përfundimi i luftës, të cilat nuk kanë alternativë tjetër të zgjidhjes, përveç dialogut.

Me dialog ne nuk po i zgjidhim problemet e Serbisë, sepse ne nuk po cenojmë sovranitetin e Serbisë. Por, është e kundërta.

Si kryeministër i vendit, konsideroj se dialogu nuk ka alternativë. Konsideroj se politika e dialogut me fqinjët, edhe me Serbinë, është orientim strategjik i Republikës së Kosovës, ashtu siç është orientimi ynë strategjik rruga euro-integruese dhe partneriteti i përhershëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

E kam thënë publikisht se asnjë nga ju nga opozita që sot po kundërshtoni dialogun nuk do ta kundërshtoni këtë po të ishit në pozitë dhe po t'i kishit përgjegjësitë që ne i kemi.

Ne njihemi dhe nuk harrojmë se si jemi betuar të gjithë, meqë jemi këtu, pa marrë parasysh në cilën anë sot jemi, se si do të vazhdojmë dialogun dhe kemi konkurruar e kemi bërë gara se kush është ai që do të marrë ta udhëheqë dialogun.

Edhe rezoluta si e tillë nuk meriton përkrahje. Ndryshe, ajo nuk shpreh as interes të Kosovës, përpos të një mllëfi opozitar ose të një mllëfi, i cili nganjëherë lind edhe si pasojë e veprimtarive të papërgjegjshme dhe sjelljeve të papërgjegjshme të Serbisë.

Prandaj, do të ishte mirë që energjitë tona, që po i shpenzojmë për të bllokuar dialogun ose për të kundërshtuar bllokimin e dialogut t'i orientojmë pozitivisht në orientimin tonë për zhvillim ekonomik, zhvillim social, integrimin e serbëve në të gjitha institucionet e vendit tonë, krijimin e mirëbesimit dhe mirëkuptimit reciprok dhe për rrugën euro-atlantike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Fjalën e ka Zenun Pajaziti, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot ky debat mbase e gjen Kuvendin më të relaksuar, sepse, siç e dini, ditë më parë ne prezantuam shqetësimin tonë serioz për atë që po ndodhte në veri, për atë që po inskenonin përfaqësuesit ose drejtuesit e Beogradit me provokimet e tyre, si me rastin e arrestimit të zotit Haradinaj, si me trenin, e po ashtu edhe me murin.

Pra, jemi të relaksuar sepse ndodhën disa zhvillime që mund t'i quajmë, pavarësisht se ishin krijuar artificialisht, pozitive dhe tanimë nuk e kemi murin në veri dhe po ashtu kemi një rrugë të mirë, në mbështetje edhe të institucioneve ndërkombëtare që të mundësohet lëvizje e lirë e qytetarëve pa dallim atje.

Pra, është po ashtu një anë pozitive që muri u rrëzua nga vetë ata që e ndërtuan dhe nuk kishe nevojë të bëheshin hapa të tjerë të njëanshëm nga institucionet e Republikës së Kosovës, siç ndodhi me trenin, me ndalimin e trenit.

Zoti kryeministër e tha qëndrimin e tij rreth dialogu dhe mendoj që ne pa hezitim, të gjithë që jemi përfaqësues të qytetarëve, duhet kuptuar se dialogu nuk ka alternativë tjetër. Pra, të gjithë duhet dhënë shansin merituar dialogut dhe duhet shpresuar se vetëm në këtë mënyrë mund të zgjidhet gjithçka që mund të jetë pengesë, sidomos në rrugën tonë të normalizimit të marrëdhënieve, si pengesë që na del në rrugën tonë drejt integritetit në BE.

Dhe, tanimë, të gjithë jemi të vetëdijshëm edhe për pacenueshmërinë e territorit të Republikës së Kosovës dhe kushtetutshmërinë dhe po ashtu jemi të inkurajuar me mënyrën e mirë të zgjidhjes së këtyre problemeve dhe me vendosmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve për të mos lejuar cenimin e sovranitetit dhe integritetit të territorit të Republikës së Kosovës.

Në kushte normale, sikur edhe sot, nuk do të ishte mirë që në raste të tilla, pra kur tejkalohen këto probleme të mos bëheshin agjendë politike ditore këto çështje dhe të kalonim në çështje apo pika të tjera, që ka mjaft vendi ynë si sfida, e që kanë të bëjnë edhe me zhvillimin ekonomik dhe çështje të tjera integruese, e me kritere tjera që ne duhet përmbushur qoftë për liberalizmin e vizave, qoftë për integrimin tonë drejt BE-së.

Duke u bazuar në suksesin e institucioneve të Republikës së Kosovës karshi zhvillimeve të fundit dhe në konsistencën e përgjegjësitë kushtetuese ligjore të gjitha institucioneve, të presidentit, kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë në zgjidhjen e këtyre problemeve që, po e përsëris, ishin artificiale, ne konsiderojmë se në një mënyrë është konsumuar edhe sot kjo çështje që të ketë një debat të tillë. Por, meqë kjo ka ndodhur, ne duhet të jemi këtu sa më unikë, në mënyrë që t'i hapim rrugë agjendës së mbetur të Kuvendit edhe për çështje të tjera.

Ne, duke u bazuar në kontestin historik të zhvillimeve shqiptaro-serbe, me zhvillimet e fundit, atëherë në këtë seancë duhet të tregojmë pjekurinë maksimale shtetformuese si Republikë e Kosovës dhe duhet të reflektojmë po ashtu që të dalim të bashkuar rreth qëndrimeve tona edhe rreth veriut dhe rreth çështjeve që kanë të bëjnë me dialogun dhe çështje të tjera.

Nëse kthehemi në retrospektivë, ne shohim se më 21 prill të vitit 2013, që ka qenë një ditë vikendi, ka qenë një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit, kur i është dhënë mbështetje e fuqishme dialogut me 89 vota për.

Mendoj se është për të falënderuar gjithë spektrin politik që ka qenë në këtë agjendë mbështetëse dhe është për t'u inkurajuar që kjo vendosmëri e atëhershme e Kuvendit që të jemi sa më unikë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me interesin e vendit, të vazhdohet edhe sot, edhe më tutje.

Pra, unë besoj që edhe sot subjektet politike, të gjitha, jo vetëm këto që e kanë mbështetur, të jemi në një frymë për të mbështetur vazhdimin e dialogut dhe për të mbështetur tejkalimin e sfidave që i kemi në raport me Beogradin. Meqenëse kjo marrëveshje e atëhershme del edhe si obligim, meqenëse po ashtu kemi zhvillime politike të tjera të ngjashme, tash që ka rezultuar se dialogu mund të jetë i suksesshëm dhe sidomos pas një mbështetjeje shumë intensive të bashkësisë ndërkombëtare, BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ne mbetemi të inkurajuar dhe me shpresë që edhe situata e sotme, kur ne po debatojmë për veriun, të na gjejë, si të thuash, unikë, edhe më unikë se sa atëherë dhe unë i ftoj të gjitha partitë opozitare që sot të jemi në këtë drejtim unikë.

Po ashtu është për t'u theksuar që zotimi politik i të gjithë përfaqësuesve të institucioneve gjeti një mbështetje të gjerë të qytetarëve, e sidomos të partnerëve ndërkombëtarë, është për t'u falënderua mbështetja e jashtëzakonshme në këtë drejtim.

Dhe, po ashtu, unë nga këtu në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dëshiroj t'i ftoj edhe kolegët serbë që janë përfaqësues në parlament, në institucione të tjera të Republikës së Kosovës dhe në qeveri, t'i kthehen punës së tyre të përditshme e t'i përfaqësojnë qytetarët atje.

Ajo që ka ndodhur në veri ditët e fundit ishte më shumë kërcënim për vetë qytetarët, për izolimin e qytetarëve serbë atje. Sa më shpejt që të kthehen kolegët tanë në institucione, do të ndikojë pozitivisht në relaksim të këtyre raporteve dhe në tejkalimin sa më të shpejtë të situatave të tilla në terren.

Po ashtu dëshiroj t'i ftoj gjithë qytetarët që kanë qenë dhe janë të kërcënuar për të jetuar dhe lëvizur normalisht në veri që të kthehen dhe të punojnë normalisht dhe të kontribuojnë në krijimin e gjendjes sa më normale të jetës së tyre në veri.

Po ashtu i ftoj institucionet përkatëse, me përgjegjësitë e tyre t'i mbështesin të gjithë qytetarët, pa dallim, që ata të kthehen, të punojnë dhe të lëvizin lirshëm në veri.

Dhe, po ashtu inkurajojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës në dialogun dhe në tejkalimin me rrugë politike të të gjitha problemeve dhe çështjeve që ngrihen atje dhe po ashtu shpresojmë që të mos ketë provokime të tilla, të cilat do të nxisin intervenimet e institucioneve të Kosovës atje, siç ka ndodhur më 2011, e siç ka ndodhur edhe më vonë, intervenime të cilat edhe mund të krijojnë situata të tjera. Faleminderit!

Sa i përket mocionit, unë mendoj që tashmë rrethanat nuk janë të tilla siç kanë qenë kur është parashtruar ai dhe, po ashtu mendoj që gjithçka që është rreth dialogut ne do ta mbështesim.

Unë dëshiroj që ta kemi një qëndrim të përbashkët në mbështetje të dialogut dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës që t'i zgjidhim çështjet dhe t'i kryejnë obligimet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë,

Sigurisht që kjo interpelancë është në vazhden e shqetësimeve pothuajse që janë të çdoditshme për gjendjen në veri të vendit.

Dhe ju e dini, kolegë të nderuar, se një interpelancë, gjegjësisht një debat ose interpelancë të ngjashme e kemi pasur edhe më herët pikërisht më temën për veriun e vendit, sepse edhe pas 18 vjetësh të çlirimit të Kosovës dhe 9 vjetëve të pavarësisë sonë veriu i vendit po bëhet dhe është temë, si dhe është në fokusin e interesimit të qytetarëve tanë, por edhe të angazhimeve të institucioneve tona shtetërore.

Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdimisht e ka shprehur brengosjen dhe përkushtimin e saj për përmirësimin e gjendjes në veri të vendit, së bashku sigurisht me institucionet përkatëse shtetërore dhe veçmas Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kemi kërkuar vazhdimisht që në veri të funksionojnë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe të ushtrohet sovraniteti shtetëror. A jemi tërësisht të gjithë ne qytetarët të kënaqur me të, jo, por ka përparime, ka avancime të mëdha, të cilat nuk duhet dhe nuk mund t'i mohojmë.

Sigurisht që këndvështrimi është i ndryshëm edhe nga subjektet, veçmas opozitare, i asaj se çfarë është bërë dhe çfarë po bëhet ose si është edhe situata në tërësi në veriun e vendit.

Pa dyshim që ne si Grup Parlamentar i LDK-së shohim ndryshime pozitive, të cilat janë rezultat i dialogut të Brukselit, i cili ka mundur dhe po mundëson në një masë, nëse jo tërësisht, po në rrugëtim e sipër do të bëhet edhe kjo, të shuarjes së strukturave paralele të Serbisë, ndikimit të

Serbisë në këto struktura, jo vetëm në veriun e vendit, por edhe në disa komuna të tjera në jug, ku shumicë janë ose një pjesë e madhe të qytetarëve e përbëjnë komuniteti joshqiptar ose komuniteti serb.

Dialogu i Brukselit i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sigurisht jo në përmasa edhe dëshirueshme dhe të nevojshme, megjithatë ky dialog ka dhënë kontribut dhe ka dhënë rezultate të caktuara në integrimin, në një masë të madhe, të komunitetit serb dhe konsolidimin dhe forcimin e shtetit nëpërmjet normalizimit të gjendjes në veri të vendit.

Kryeministri i vendit i tha dhe i kemi thënë edhe më herët disa nga ato të arritura që janë në veriun e vendit. Ju i dini që të gjithë, shumë shkurt vetëm po e them, prej menaxhimit të integruar të kufirit, prej funksionalizimit, siç u tha, të pikave kufitare, grumbullimit të taksave në kufij, prezencën dhe funksionimin normal dhe pa leje të askujt tjetër përpos të institucioneve të vendit të Policisë së Kosovë në veriun e vendit dhe ju dëgjuat deklarata shumë serioze nga ata që janë të rëndësishëm për ne se edhe Policia e Kosovës, Policia Speciale s'ka nevojë të marrë fare leje prej dikujt tjetër, sepse vepron dhe do të veprojë në territorin e Republikës së Kosovës, e kam parasysh veriun e vendit.

Sigurisht u përmend edhe çështja e integritetit dhe fillimi i funksionimit të organeve gjyqësore në veri të vendit, të mos e zgjas, kodi, e të ngjashme. Kodi telefonik që nuk lidhet vetëm me veriun, por është një rezultat i dialogut dhe është në interesin e gjithë Republikës së Kosovës.

Sigurisht që ne si subjekt politik, deputetë dhe institucione edhe më tej e kemi këtë brengosje që përkundër nënshkrimit të marrëveshjeve nga Brukseli, ka tentime nga Beogradi, në forma dhe mënyra të ndryshme, t'u ikë zbatimit të këtyre marrëveshjeve, aq më tepër të provokojë situata çfarë kishim muajt e fundit, e veçmas dy muajt e fundit.

Ne si deputetë, të nderuar kolegë, mendoj që jo vetëm si deputetë, por edhe qytetarë edhe institucione çdo veprim, çdo punë të mirë institucionale duhet ta mbështesim, ta përkrahim pa dallim pozitë apo opozitë.

Dhe, dy veprime veçmas të fundit, çështja e trenit, një provokim i rëndë dhe çështja e murit, provokimi tjetër i radhës, kanë treguar se megjithatë institucionet tona kanë treguar pjekuri, maturi në menaxhimin e situatës, mençuri, veprim institucional dhe jo veprim emocional.

Sigurisht secili prej nesh, jemi njerëz, kemi edhe emocione kur ballafaqohemi me situata të tilla, por veprimi institucional është ai i cili i obligon institucionet tona dhe një përgjigje të tillë e kanë marrë këto veprime provokuese nga ana e shtetit serb dhe sigurisht që duhet përgëzuar të gjithë

ata që e kanë dhënë kontributin në këtë që të mos kemi një tren të tillë dhe një muri të tillë ndarës.

Edhe një herë Qeveria e Republikës së Kosovës mendoj se ka vepruar ashtu siç do të duhej të vepronte, të punojë dhe jo shumë të bëhet zhurmë dhe pak çon peshë kur e kemi marrë vesh, në mëngjes apo pak më vonë. Mendoj se nuk është edhe shumë mençuri e madhe të tregohen edhe punët se si do të kryhen nga ata që duhet t'i kryejnë, flas për Policinë e Kosovës.

Ndërkaq kur vjen çështja e murit, unë nuk di pse duhet të na pengojë fakti që e kanë rrënuar ata që e kanë ndërtuar. Bile-bile, kjo është edhe shumë më mirë, sepse i ke detyruar ta kryejnë një obligim që ata e kanë për të anuluar një veprim që e kanë bërë më herët, joligjor dhe ilegal, në Mitrovicën e veriut.

Dhe, pa dashur ta zgjas, them edhe këtë: teoritë e konspiracionit të asaj se u bë kjo dhe rezultat do të jetë kjo, mendoj që qytetarët tanë mund t'i deshifrojnë lehtë.

Unë nuk di pse duhet të lidhet muri apo treni me Asociacionin. Askush prej nesh si deputetë nuk është që e ka pritur me ekzaltim formimin e një asociacioni, por kolegë të nderuar, marrja e obligimeve, votimi këtu në këtë Kuvend i marrëveshjeve, zbatimi i tyre është edhe kulturë, është edhe përgjegjësi dhe është obligim, pavarësisht momenteve që tash dëshirojmë t'i shfrytëzojmë thjesht për interesa politike.

Të mos harrojmë fare në fund që Gjykata Kushtetuese e vendit, si institucion i pavarur, nuk e ndalon themelimin e Asociacionit në këtë rast, por kërkon që të respektohet sovraniteti i vendit, që ky asociacion të formohet duke eliminuar ato që janë gjetur si vërejtje, si gjëra ose elemente të papranueshme që do të jepnin sipas asaj që është menduar, kompetenca ekzekutive.

Pra, pa këto kompetenca të pretenduara ekzekutive, asociacioni është obligim yni, edhe një herë po e them jo për ta lidhur tash me momente, por është një obligim që na bën të përgjegjshëm dhe nuk është bërë asnjë veprim pa koordinim, bashkëpunim, me ata, nuk është e tepërt asnjëherë të themi, ta përsërisim, me ata që na kanë ndihmuar, na ndihmojnë, na kanë ndihmuar dhe na ndihmojnë në shtetndërtimin tonë dhe në rrugëtimin tonë drejt integriteteve euro-atlantike.

Prandaj, duke i falënderuar shumë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si një partner strategjik afatgjatë shumëvjeçar, dhe Bashkimin Evropian në rrugëtimin e Kosovës, ne u jemi mirënjohës dhe sigurisht që veprimet, sugjerimet e tyre ne i konsiderojmë që janë në interesin e vendit.

Dhe, fare në fund, unë mendoj që situatat që i kemi pasur janë menaxhuar mirë dhe kryeministri i vendit, me ekipin dhe institucionet, organet përgjegjëse, kanë qenë në nivelin e detyrës dhe i

kanë kryer obligimet ashtu siç ua përcakton Kushtetuta, ligji dhe ashtu siç e ndiejnë dhe do të duhej ta ndiejnë përgjegjësinë e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Muri më i ri në veri të Mitrovicës ishte si një perde teatri. Perdja u ngrit para skenës, teksa shikuesit po zinin ulëset në teatër. Perdja u hoq për të parë dramën që kishte mbaruar tashmë, drama kishte mbaruar, sepse drama ishte vetë perdja. Dhe, çka do që sheh, pastaj është më e durueshme se sa perdja. Perdja para shikuesit të teatrit është e padurueshme, ajo u hoq dhe tash kemi ndërtimin e skenës së teatrit.

Qytetarët e Kosovës tani janë shikuesit e ndërtimit të skenës dhe jo të dramës, drama të tjera vijnë më vonë në atë skenë.

Qyteti i Mitrovicës është i ndarë në urë të Ibrit dhe jo me mure që vihen si perde. Ajo çka po etablohet me çështjen e murit është se gjërat as nuk munden, e as nuk duhet të bëhen pa Serbinë dhe pa strukturat e saj.

Serbia e bën gjendjen në veri edhe ca më keq se sa që është, në mënyrë që nëse kjo ‘ca më keq’ bëhet pak më mirë, atëherë të duket gjithçka mirë dhe e keqja e madhe të normalizohet.

Pyetja ime për kryeministrin Mustafa është: pse pranoi që rruga “Mbreti Pjetër” të shndërrohet në rrugë për këmbësorë? A beson kryeministri Mustafa që kjo është një çështje e mirë, një çështje e drejtë, një çështje e duhur dhe e dobishme, apo është dashur ta pranojë që ajo rrugë të bëhet rrugë për këmbësorë? E nëse është dashur ta pranojë që rruga “Mbreti Pjetër” të bëhet rrugë për këmbësorë, pse është dashur ta pranojë një gjë të tillë? Pra, a beson që është një gjë e mirë, apo ka qenë i kushtëzuar, e nëse ka qenë i kushtëzuar, si ka qenë i kushtëzuar?

Më datën 22 shtator të vitit 2015 për herë të parë është gjuajtur kryeministri Mustafa me vezë këtu nga deputetë opozitarë. Dhe, nëse shikoni videot e asaj kohe e vëreni që kjo ndodh porsa ai thotë që kjo pako, e ka fjalën për marrëveshjet e nënshkruara më 25 gusht të vitit 2015 në Bruksel, është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet ekzistuese.

Më 23 dhjetor të vitit 2015, pra vetëm tre muaj më vonë, Gjykata Kushtetuese e diskrediton qëndrimin e kryeministrit.

Pra, ai nuk ka dhënë asnjëherë përgjegjësi për këtë diskreditim, i cili i ka ndodhur.

Këtu e dëgjuam në ekspozenë e tij teksa tha se edhe më herët disa kanë qenë të interesuar për dialog, e kanë folur se kush do ta udhëheqë dialogun, e kështu me radhë. Po, është e vërtetë, në kohën e VLAN-it kemi pasur një marrëveshje të 10 shtatorit, në të cilën në pikën 5 thuhet që Lëvizja “Vetëvendosje” udhëheq dialogun. Ju e keni nënshkruar atë marrëveshje, mirëpo vëreni me kujdes, në pikën 5 fjala Serbi nuk është askund. Thuhet dialogu, thuhet marrëveshje me Kuvend. Ndërkaq në pikën 4 thuhet ‘dialog me serbët e Kosovës’, ju e keni nënshkruar vetë, lexojeni edhe një herë tekstin.

Ne jemi për dialog me kushte për Serbinë, me parime, jemi kundër dialogut pa parime. Këto janë dallime substanciale. Ne vazhdimisht dialogojmë, teksa njeriu bisedon, ai edhe dialogun. Nuk mund të ketë njerëz normalë kundër dialogut. Çështja është çfarë dialogu, me cilin qëllim, nën cilat kushte, me cilat tema dhe agjendë? Pse, ta zëmë, ju nuk jeni në gjendje që asnjëherë atje ta bëni prioritet çështjen e pensioneve të plaçkitura ose dëmeve të luftës, ose grave të dhunuara, ose Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit, ose kriminelëve serbë që janë brenda Kosovës e brenda Serbisë? Çdo temë atje është temë që e ka caktuar Serbia, realisht kur ju shkon në Bruksel e përfaqësoni Kosovën më shumë si temë të dialogut, se sa si palë në dialog. Prandaj, ne jemi kundër këtij dialogu, i cili në fakt është nënshtrim.

Lëvizja “Vetëvendosje” në planin e saj beson që është i mundshëm të bëhet bashkimi i Mitrovicës, edhe në aspektin socio-ekonomik me rivitalizim të Trepçës, me bursa për studentë e nxënës, shqiptarë dhe serbë, në universitet e në shkolla të mesme, me investime në spitalin e Mitrovicës, me transport falas veri-jug edhe anasjelltas tri herë në ditë, investimet në Trepçë sipas Nazmi Mikullovcit dhe ekspertëve të tjerë që janë “Vetëvendosje”, me më pak se 200 milionë euro do të mund të eksportoni metale të përpunuara dhe gjysmë të përpunuara deri në 450 milionë euro në vitin e parë dhe gjithashtu shqiptarëve duhet t’u mundësohet kthimi nëpër tokat e tyre dhe shtëpitë e tyre. Ju nuk e hapni këtë temë asnjëherë.

Qeveria e Kosovës nuk do të duhej të lejonte asnjë shqiptar ta shesë pronën e vet në veri. Nëse një shqiptar, për shkak të kushteve të vështira, detyrohet ta bëjë një gjë të tillë, atëherë Qeveria e Kosovës le ta blejë pronën, por të mos lejojë që Qeveria e Serbisë ta bëjë një gjë të tillë.

Duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë dhe të aplikohet për paqe të qëndrueshme, reciprociteti dhe simetria në të drejtat mes shqiptarëve në përgjithësi në Serbi, se nuk janë veç në Luginë të Preshevë, edhe serbëve në Kosovë. Sepse, mos harroni, më shumë ka shqiptarë në Serbi se sa serbë në Kosovë.

Por, barazia është ajo e cila integron, jo privilegjet, privilegjet diskriminojnë. Sami Frashëri thotë: “Privilegjet janë shokë të tiranisë, pa barazi nuk ka as liri”. Pra, nëse dëshirojmë edhe lirinë e serbëve në Kosovë, edhe të shqiptarëve, duhet të ketë barazi, paraprakisht. Me barazi e pa privilegje, ndodh integrimi.

Dhe, krejt në fund, dihet që në vitin 1999 dhe në vitin 2000 Mitrovica i ka pësuar dy goditje të mëdha.

Së pari, kur janë vënë telat me gjemba në urë dhe, së dyti kur janë dëbuar shqiptarët prej andej.

Mirëpo në verën e vitit 1999, kur kanë provuar shqiptarët të kthehen në spitalin e Mitrovicës atje, është një videoincizim shumë interesant, mbi 9 minuta, ku shihen edhe Thaçi dhe Veseli teksa i kthejnë mbrapsht popullsinë shqiptare që dëshirojnë të shkojnë në veri. Ajo që më bëri përshtypje kur e shikova sot në mëngjes është që Thaçi teksa flet para turmës, para masës së njerëzve, është shumë i shqetësuar dhe në fund të fjalimit, kur hyn në xhipin e KFOR-it francez qesh aty brenda. Pra, nuk qesh te populli shqiptar, e të jetë i brengosur në xhip të KFOR-it francez, po është e kundërta, por edhe ai, edhe Veseli e kanë një të përbashkët.

Në verën e nxehtë të vitit '99 të dytë janë të veshur në kravata, ende pa u kryer lufta mirë, ende pa ia filluar TMK-ja, këta nguten me kollare e me sako që të bëhen gati për pushtet. Një farë mënyre, kjo tregon ku ka qenë preokupimi dhe prioriteti i tyre.

Unë e di që Serbia ka dashur ta ndajë Mitrovicën, ne nuk kemi faj, ama kemi përgjegjësi për atë që ka ndodhur, sepse nuk kemi qenë të pafuqishëm, njeriu gjithmonë ka përgjegjësi.

Edhe unë po kërkoj sot prej Veselit që të na lejojë ta shfaqim atë video 9- minutëshe, sepse është shumë interesante që ta vërejmë aty edhe fjalimin që mbahet, edhe zmbropsjen që u bëhet shqiptarëve në momentin kur ata dëshirojnë të shkojnë në veri.

Pra, unë do të mund t'ia dërgoja regjisë tash 'linkun', ku do të mund të shfaqej kjo video.

KRYETARI: Faleminderit!

Në qoftë se deputetët kishin pranuar t'i merren edhe 10 minuta njërit prej kolegëve të "Vetëvendosjes", e kishim vendosur atë 'linkun', e 'donlladojnë' kolegët e administratës, edhe 10 minuta do t'ia marrim një kolegu të "Vetëvendosjes". Unë e kisha bërë këtë.

Vazhdojmë tutje. Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Më shumë e kanë zorin te ne, se te Serbia.

PAL LEKA: I nderuar kryetar i Parlamentit!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju medie të nderuara,

Gjithë ju të pranishëm,

Sot kemi dalë të flasim për një temë, për një vend të Kosovës që quhet veriu i Mitrovicës.

Kemi debatuar shumë në këtë vend, por a kemi zgjidhur ndonjë çështje? Ju them që jo. Duke u bazuar në dialogun që shumë e vlerëson Qeveria, por qytetarët e veriut të Mitrovicës ende mbesin jashtë sistemit juridik të Kosovës. Nuk janë të integruar dhe nuk janë të zhvilluar.

Sa herë është folur që janë shuar strukturat paralele, prapë po e them që nga presidenti, kryeministri e shumë ministra e thonë të vërtetën që ato struktura nuk janë shuar. Prapë veprojnë, si në shëndetësi, arsim dhe në institucione të tjera.

Çka na solli dialogu? A solli ndonjë zhvillim ekonomit të atyre qytetarëve që janë qytetarë të Republikës së Kosovës? S solli integrim të serbëve në Kosovë dhe pse Lista serbe sot nuk gjenden në Kuvend, pse ministrat serbë nuk gjenden në Qeveri? A thua, ky është dialogu që i ka ofruar serbët, prandaj nëse nisemi nga kjo, mendoj që dialogu nuk ka sjellë rezultate për Kosovën, sepse kemi shkuar për të dialoguar në Bruksel me Beogradin pa ndonjë platformë, pa ndonjë saktësi kohore dhe pa ndonjë marrëveshje paraprake, se pak këtij dialogu a do të ndodhë njohja reciproke. Dhe jemi shumë larg.

Kosova nga ky dialog nuk e ka njohjen e pesëshes së shteteve evropiane, Kosova nga ky dialog nuk ka liberalizim të vizave, Kosova nga ky dialog nuk është e pranuar në UNESK-o, Kosova nga ky dialog nuk është e pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Kosova nga ky dialog nuk ka njohje të reja.

Prandaj, si mund ta vlerësoni këtë dialog, Qeveri e nderuar, si pozitiv, derisa vetëm është folur për situatën e brendshme të asaj që Qeveria duhet ta rregullojë.

E themi murin, është sjellë një rezolutë dhe ka qenë obliguar Qeveria ta rrënojë murin, e pse të dialogohet? Me këtë të dialogohet për ndërtime ilegale? Pse s'kanë dialoguar edhe në Prevallë, kur e kanë marrë vendimin, po ministrat kanë thënë se do të hipim në 'bagera' dhe nuk i rrënojmë. Pse nuk e bënë për murin në veri që prej kreut të shtetit, e deri te zyrtari i fundit, kam thënë që është ndërtim ilegal. Pse ndodh kjo? Pse e bëni të rëndësishme atë që është kompetencë e Qeverisë. Po thonë që është projekt i Kuvendit Komunal sa i përket parkut. Po, por aty ka qenë një rrugë regjionale që është kompetencë dhe përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës, dhe nuk është kompetencë e kryetarëve të komunave, e në këtë rast zotit Rakiq.

Atëherë, çka keni ndërmarrë? Po thoni që e keni ndalë trenin, ku e ndalët trenin? Po tamam puna të mos ndalet treni në Serbi atje pa hyrë këtu, sepse atëherë ishte dashur ta vëmë flamurin e bardhë. Dhe, duke u nisur nga kjo, çdoherë po e keqpërdorni kërkesën e opozitës për ndërprerjen e këtij dialogu, që as nuk ka platformë, as nuk ka saktësi kohore se deri kur mund të vazhdojë ky

dialog dhe formati që është dialoguar mendoj që është joserioz dhe ne duhet të shkojmë me platformë të qartë, me dialog, sepse e thanë edhe parafolësit - pa dialog nuk mund t'i zgjidhim gjërat. Por, dialog në forcimin e shtetit të Kosovës, dialog për një zhvillim për të gjithë qytetarët e Kosovës, dialog për integrim të qytetarëve serbë në institucionet e Kosovës, dialog për një normalizim të gjendjes.

Si mund të thoni që kemi normalizim të gjendjes kur Serbia me veprimet e veta ka treguar se sa është për ta fuqizuar Kosovën. Dihet treni, dihen edhe njësitë paramilitare që janë në veri të Mitrovicës aty dhe kanë qenë dhe asnjë shpjegim nuk është bërë. A pritni që një ditë kur të aneksohet dhe pastaj të veprojmë?

Prandaj, ju themi që ne si opozitë jemi për dialog konstruktiv, për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për njohje reciproke dhe për një zhvillim ekonomik që shkon në favor të qytetarëve pa dallim, qofshin ata serbë, shqiptarë, turq, romë, ashkalinj dhe të gjithë të tjerët. Prandaj, për këtë themi që dialogu në këtë format dhe në këtë mënyrë nuk i ka sjellë asgjë nuk të mirë Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lekaj! Nga Grupi Parlamentar “Nisma”, Enveri apo Zafiri? Zafir Berisha e ka fjalën, ndërkohë edhe Grupi “6+”, pastaj pas kësaj do të shkojmë në pauzë deri në orën 15:00 për ta vazhduar interpelancën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Është temë që për disa vjet na mban peng si institucione dhe si Parlament, por temë të cilës nuk mund t'i ikim për shkak se po e dirigjon komplet jetën institucionale në Kosovë dhe shumë probleme jetike të qytetarëve po mbeten nën hije.

Mosreagimi i Qeverisë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet lidhur me realitetin e krijuar në veri të vendit nga viti '99, realitet i cili është si rezultat i skenarëve djallëzorë për copëtimin e Kosovës po e rrezikon shtetin funksional. Skenarët për pastrim etnik në veri, ku nga pronat e tyre u dëbuan me forcë rreth 12 mijë qytetarë dhe dhjetëra të tjerë u vranë dhe u masakruan barbarisht nga strukturat paralele që kjo Qeveri i ka integruar në institucionet dhe natyrisht ne në këtë rast mund të themi se “ujku qimen e ndërron, por zanatin s'e harron”.

Heshtja dhe mosveprimi i duhur i Qeverisë lidhur me agresionin e planifikuar serb në Kosovë na nxjerr para një situatë që të veprojmë sa nuk është vonë. Kryeministri e tha disa herë që i kemi shuar strukturat paralele në atë pjesë të vendit, gjë që nuk qëndron. Dje në disa takime me ministrat e kabinetit të tij u theksua se strukturat paralele ekzistojnë dhe veprojnë shumë fuqishëm dhe të koordinuara me Vuçiqin, dhe ato struktura, që një pjesë janë kamufluar në uniformat e institucioneve të Kosovës, e kanë vendin në Burgun e Dyzit, e jo në institucione, sepse vazhdojnë ta mbajnë peng Kosovën dhe në rast se është e vërtetë kjo që thotë zoti Mustafa

se nuk ekzistojnë strukturat paralele, iu referua atyre kriminale, paraushtarake, atëherë shtrohet pyetja cili është ai “Boshko Buha” që po terrorizon institucionet dhe qytetarët pa dallim nacional gjatë gjithë kohës duke hedhur bomba dhe duke mos i kursyer as institucionet, objektet e institucioneve, as pasurinë private të qytetarëve, por as edhe jetën e qytetarëve serbë, të cilët e njohin realitetin në Kosovë.

Dialogu me Serbinë është evident në situatën në të cilën gjendemi. Më vjen shumë keq që kryeministri për të satën herë e keqpërdor qëndrimin e opozitës lidhur me dialogun. Unë nuk besoj se opozita, por edhe askush tjetër është kundër dialogut, por ne jemi për një dialog me Serbinë, dialog ndërshtetëror, por jo një dialog siç është duke ndodhur me një shtet armiqësor dhe si provincë e atij shteti.

Strukturat kriminale të Serbisë sipas platformës të Vuçiqit që veprojnë vazhdimisht e provokojnë situatën në Kosovë. Provokimet e fundit natyrisht ishin vazhdë e realitetit jo të këndshëm që po krijohet dhe me vetëdije apo pa vetëdije institucionet aktuale po e miratojnë, e si rezultat kemi e pasur një mur ilegal për të cilën jemi pajtuar të gjithë që ka qenë ilegal, por ajo që nuk pajtohemi është se strukturat paralele që bëjnë veprime ilegale të ulen në tavolinë dhe të rehabilitohen me institucionet e Kosovës, siç ndodhi me rastin e këtij muri.

Lista sërpska vazhdon të jetë zëdhënës i Qeverisë së Vuçiqit dhe edhe më herët kam fol për këtë çështje që është momenti i duhur që ne, bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e vendit të veprojmë ligjshmërisht në mbrojtjen e sovranitetit edhe politik të vendit që kërcënohet nga kjo listë, e cila i ka bllokuar shumë ligje të Kosovës, njëri nga ata edhe sot është në seancë - Ligji për liritë fetare, i cili është tërhequr për shkak të tyre dhe që jam shumë i bindur që do të tërhiqet edhe nga kjo seancë, siç është edhe ligji, i cili tash e sa kohë rrinë në sirtarë - Ligji për festat shtetërore, e të mosë flasim për bllokadën që i bëhet Ligjit për FSK-në.

Unë mendoj se Asociacioni është kulmi i realitetit të hidhur që kjo Qeveri tenton ta krijojë, i cili do t'i grumbullojë komplet grupet mafioze, kriminale të Serbisë, ta cilët me qëllim veprojnë dhe do të krijojnë një bosnjëzim të Kosovës për të mos e ripërsëritur se tash, meqë edhe Hashimi po e thotë, unë tash dua t'i ik atij termi se kam qenë i pari që kam thënë Krimenë reale të Ukrainës në Kosovë. Unë dëgjova edhe nga kolegët e mazhorancës për obligime ndërkombëtare lidhur me Asociacionin. Ne jemi për një Asociacion, por pse duhet të bisedojmë me Serbinë për një Asociacion që është OJQ dhe që duhet të formohen përputhje me ligjet e Kosovës dhe që, në fakt, veç kemi Asociacion të Komunave në Kosovë dhe askush nuk i ndalon. Pse Serbinë duhet ta pyesim se si ne duhet që ta rregullojmë organizimin e brendshëm në Kosovë?!

Përfundimisht, për të mos e zgjatur, besoj që edhe kolegët tjerë do të na thonë diçka, unë mendoj që rezolutës së propozuar nga zoti Rexhep Selimi t'i shtohet edhe pika 6, me të cilën t'i ndalohet veprimtaria politike subjektit politik Sërpska si zëdhënës e politikës shoviniste të Beogradit.

Mendoj se me këtë pikë do të kompletohet rezoluta dhe sigurisht deputetët do ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami, fjala për ju, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Poštovani ministre,

Poštovani Premijeru,

Uzimajući u obzir da smo više puta ovdje u Skupštini Republike Kosova govorili o dijalogu između Republike Kosova i vlasti Republike Srbije, te uzimajući u obzir da smo takođe više puta razgovarali o problemima sa kojima se suočavaju građani na sjeveru ili opštinama na sjeveru Republike Kosova, ovoga puta ja ću se samo kratko osvrnuti i kazati da mi iz parlamentarne grupe “6+” smo redovno podržavali dijalog koji vodi Vlada Republike Kosova iz prostog razloga što smatramo da samo preko dijaloga i uz pomoć Evropske Unije, odnosno međunarodne zajednice, možemo rešiti neka pitanja koja nismo do sada rešili u odnosima između Republike Kosova i Republike Srbije.

Nažalost svi znamo se taj dijalog iako teško odvija, da se dogovoreno teško sprovodi u život, i da imamo uglavnom kočenje od strane Vlasti Republike Srbije da se ispune one obaveze koje su prihvatili u Briselu prema Republici Kosova.

I te poteškoće se svakako biti i u perspektivi u tom dijalogu i ono što je ovde bitno i što trebamo uvijek naglašavati jeste da se nadamo da će posrednici iz Evropske Unije vršiti redovno adekvatni pritisak na vlasti Republike Srbije da ispune sve ono što su prihvatili u odnosima sa Republikom Kosova. Vezano za jedan veliki problem koji ja redovno ovde potenciram u opštinama na sjeveru Kosova, a to je položaj ne većinskih zajednica, među njima i Bošnjačke zajednice, nažalost ja moram i ovom prilikom da istaknem da na osnovu podataka koje ja dobijam od strane delegata iz Skupštine opštine u sjevernoj Mitrovici, gospodina Neđada Ugljanina, i od takođe delegata i predstavnika ne većinske zajednice u Skupštini opštine Leposaviću, gospodina Mithata Savkovića, položaj Bošnjačke zajednice je jako težak, odnosno i dalje su izloženi bezbednosnim rizicima, te takođe se pripadnici Bošnjačke zajednice na sjeveru u zapošljavanju koje sprovodi i Vlada Kosova preko svojih ministarstava na sjeveru, i lokalna administracija, koje takođe sprovodi i u Mitrovici i u Leposaviću i drugim opštinama, uglavnom zapošljava samo pripadnike Srpske zajednice, i tek ponekog pripadnike Albanske zajednice, do god strane pripadnika Bošnjake zajednice nije zapošljeno gotovo niti jedan jedini dakle član naše zajednice, niti u administracije, niti u drugim službama.

To se redovno ponavlja, imali smo zadnji slučaj kada otvorena kancelarija Vlade Kosova u sjevernoj Mitrovici, gde među 80. zaposlenih nema nijednog Bošnjaka, takođe smo skoro imali zapošljavanje u administraciji Skupštine opštine Leposavić, gde je među takođe 80. zaposleni primljenog kao što sam rekao tek nekoliko Albanaca, a nema niti jednog jedinog primljenog Bošnjaka.

Nažalost nije primljena ni udovica, odnosno samohrana majka Šefka Savkovića, koji je ubijen 2010. godine tokom centralnih izbora kao komisioner centralne izborne Komisije Vlade Kosova.

Ni za nju nije moglo se naći jedno mjesto, a kao što znamo u međuvremeno je predsjednica Atifete Jahjaga proglasila rahmetlih Šefka Savkovića za narodnog heroja. Dakle udovica jednog narodnog heroja Kosova nije mogla da bude primljena u administraciji opštine Leposavić na jedno, inače jako prosto mjesto. O čemu dalje da govorimo? Prema tome, g. Premijeru, kao što sam juče rekao uvaženoj ministrici Editi Tahiri, ponavljam ovde i vama.

Mi ćemo i dalje podržavati dijalog, jer smatramo da je to jedini put da rešimo sva sporna pitanja koja imamo sa Republikom Srbijom i da integrišemo i Srpsku zajednicu u sistem Republike Kosova, međutim mi ne možemo da dio Bošnjaka koje ostao i pored svih izazova kojima su bili izloženi na sjeveru Kosova, inače autohtoni narod koji tamo živi vjekovima, zanemarimo, za ničiji hatar i za nikakvi dogovor.

Juče sam čuo jedno prosto obrazloženje da Međunarodna zajednica je insistirala samo na integraciju pripadnika Srpske zajednice u sistem Republike Kosova. Ako je to tačno, ja i ovde poručujem Međunarodnoj zajednici da pogleda statistiku Kosova taj Bošnjački narod je tamo živo i pre rata, živi i sada, i on nije popisanih inače u 2011. godini.

Prema tome, Bošnjaci žive na sjeveru i neka i Međunarodna zajednica malo obrati pažnju na mir, i neka izvrši, ako je potrebno, pozitivan pritisak i na Vladu Kosova da zapošljava i pripadnike Bošnjake zajednice, a zasebno na administraciju lokalnih samouprava na sjeveru Mitrovice i Leposavić.

Još jednom, od nas imate punu podršku vezano za sve poteze koje preduzimate, s tim što i one kritike koje se ovde čuju treba uzeti veoma ozbiljno, i popravljati naše pozicije koliko god možemo u dijalogu, koji je jako težak sa vlastima Republike Srbije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Për korrektësi, dëshiroj të theksoj se tri orë zgjat e tërë interpelanca, aktualisht e kemi kaluar 59 minuta. Kisha kërkuar nga Administrata ta mbyllë orën, i kemi edhe 2 orë e 1 minutë. Nga këto, po i lexoj grupet parlamentare sa kanë kohë: Partia Demokratike e Kosovës, 40 minuta, pavarësisht sa deputetë i ka duhet ta kombinojë kohën e vet, ta adaptojë në

këtë pjesë që e ka. Administratë, faleminderit! Sesha të ju lavdëroj, po ma larguat kohën prej ekrani, isha duke e lexuar.

A ka mundësi edhe një herë të ma ktheni? Më duhet për hir të grupeve parlamentare. Mirë është: Lidhja Demokratike e Kosovës i ka 34 minuta e 52 sekonda; Lëvizja “Vetëvendosje” i ka 16 minuta, Lista serbe i ka 14 minuta e 34 sekonda; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 5 minuta e 19 sekonda, se i keni afruar dy diskutues nga 2 minuta e gjysmë; “Nisma” ka mbetur vetëm me 2 minuta e 25 sekonda; “6+”, 1 minutë e 33 sekonda; dhe deputetët pa grup parlamentar i kanë 7 minuta e 30 sekonda. Ta keni parasysh, nga 1 minutë e gjysmë i kanë.

Kështu që planifikojeni kohën në bazë të kësaj që e keni për arsye se do të jem i detyruar pastaj t’jua ndali e të mos ia jap fjalën tjetërkujt mbi tri orë. Faleminderit! Në orën 15:00 e vazhdojmë interpelancën. Pushimi i drekës.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, e vazhdojmë interpelancën. Atëherë, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Ka vite që qeveritë e Kosovës njëra pas tjetër dhe kush më shumë e kush më pak diskutojnë, negociojnë për gjendjen në veri dhe për ndryshimin e saj. Unë dua t’i shtroj dy çështje kryesore: për çfarë po negocion Qeveria me Serbinë? Për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, apo për të drejtat dhe pozitën e qytetarëve serbë?

Nëse bisedimet zhvillohen për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, kjo çështje duhet të deklarohet kështu dhe duhet të shtrohen temat të cilat i japin, respektivisht i kapin këto raporte.

Temë kryesore e marrëdhënieve në mes dy vendeve janë njohja reciproke dhe vendosja e reciprocitetit në marrëdhëniet në mes vendeve, një parim i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht. Pra, nëse qeveria serbe e njeh Republikën e Kosovës, atëherë Republika e Kosovës e njeh Republikën e Serbisë, por nëse Republika e Serbisë nuk e njeh Republikën e Kosovës, atëherë shtrohet pyetja pse duhet ta njohim ne Republikën e Serbisë dhe a u shtrua kjo si temë në diskutimet që janë bërë me Qeverinë e Serbisë.

Temë tjetër e këtyre bisedimeve do të ishte çështja e dëmeve të luftës dhe pasojat e tij në Kosovë. Kemi 140 shtëpi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem... çfarë ka ndodhur?

FATON TOPALLI: Temë tjetër e bisedimeve...

KRYETARI: Vetëm pak, në qoftë se është shtim i orës, më nuk e shtoj asnjë sekondë, në qoftë se është... të drejtën e orës vazhdo edhe mos ia merr këto sekonda kur jam duke folur unë.

FATON TOPALLI: Temë tjetër e këtyre bisedimeve do të ishte çështja e dëmeve të luftës dhe pasojat e tij në Kosovë. Kemi 140 mijë shtëpi të rrënuara, xhami, kisha, objekte historike kulturore. A u shtrua kjo temë ndonjëherë në dialogun me Serbinë? Asnjëherë!

Kemi rreth 13 mijë viktima të luftës, 20 mijë gra të dhunuara dhe në funksion të përgjegjësisë dhe, së paku, vlerave morale, a është kërkuar nga Serbia që të marrë përgjegjësi dhe të kërkojë falje, madje të kërkojë falje për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar Kosovës në 87 vjet të okupimit të saj. Kemi pensionet e vjedhura. A janë bërë temë e diskutimeve? Dhjetëra e mijëra qytetarë të Kosovës kanë mbetur pa pensione për shkak se shteti serb i ka vjedhur ato dhe ngurron t'i paguajë.

Po pasuria e ish-Jugosllavisë, ku Kosova ishte krahinë autonome a u shtruan këto bisedime me Serbinë? Pra, tema kryesore që kapin marrëdhëniet në mes dy vendeve, nuk janë shtruar si tema të diskutimeve.

E dëgjova kryeministrin e Kosovës që deklaroi se sikur të ishte “Vetëvendosja” në pushtet do të zhvillonim bisedime me Serbinë. Natyrisht, që do të zhvillonim, asnjëherë nuk kemi deklaruar se nuk jemi të gatshëm të bisedojmë, por këto bisedime duhet të zhvillohen me një agjendë me të cilën shtrohen problemet kryesore dhe zgjidhen njëri pas tjetrit, diçka që Qeveria e Kosovës nuk e bëri.

Nuk ka bisedime pa zbatimin e parimit të barazisë, parimit të reciprocitetit dhe parimit të zgjedhjes së problemeve kryesore në dialogun me Serbinë dhe kjo është çështja e dytë, që dua të shtoj. Në fakt, u diskutua për minoritetin serb, respektivisht pozitën e tij në Kosovë, pra u diskutua për punët e brendshme të Kosovës. Unë do pyesja kryeministrin e Kosovës, për çfarë arsye nuk e njihni të drejtën e serbëve të Kosovës për të diskutuar për problemet që i preokupojnë ata por i jepni këtë të drejtë republikës së Serbisë. Në këtë mënyrë ju i përjashtoni

serbët e Kosovës, qytetarët e vendit tonë, që të flasin për problemet e tyre që në thelb dallojnë pak nga problemet e shumicës së qytetarëve tjerë të Republikës.

Përjashtimi faktik i qytetarëve serbë nga bisedimet për ta është shkelje demokratike dhe në të njëjtën kohë, është shkelje e Kushtetutës së vendit tonë, për shkak se kryeministri dhe Qeveria heqin dorë nga sovraniteti i vendit dhe i lejojnë një qeverie të huaj t'i përfaqësojë interesat e qytetarëve të Kosovës.

Unë nuk e kam problem të deklaroj publikisht se në Kosovë janë privuar të drejtat elementare demokratike të serbëve, e drejta për të folur për vetveten, për problemet që i preokupojnë ata.

Qeveria e Kosovës duke e bërë Serbinë përfaqësues të tyre është shkelësja e këtyre të drejtave, së bashku me Bashkimin Evropian. Qeveria e Serbisë i përdor për interesat e shtetit serb dhe nomenklaturave në pushtet, por nuk ka fare hallin e problemeve reale me të cilat ballafaqohen ata.

Po flisni vazhdimisht për integrimin e serbëve. Unë mbase mund të jem më pak i ditur se akademik dhe doktor i ekonomisë, zoti Mustafa, por integrimin nuk e kuptoj përmes ndarjes. Për çfarë integrimi është fjala, kur ndani komunat në serbe dhe komuna shqiptare? Çfarë integrimi është ai, kur për shqiptarët duhet të përdoren spitale të tjera dhe për serbë të tjera? Çfarë integrimi është ai, i cili i detyron nxënësit e të së njëjtës shkollë në komunë të shkojnë në shkolla të ndryshme?

Dialogu me Serbinë nuk solli asgjë, solli vetëm ndarje, ndarje në komuna, ndarje në shkolla, ndarje në ekonomi, ndarje në politikë, ndarje në arsim. Ju e hoqët një mur dhe vazhdoni të ndërtoni mure të tjera, të pakapërcyeshme, si “Zajednicën”. Mua më vjen keq për këtë pjesë të qytetarëve të Kosovës, që po manipulohen nga të dy qeveritë, si nga Serbia ashtu edhe nga Qeveria e Kosovës. Republika e Serbisë i përdor si “mish për top”, ndërsa Qeveria e Kosovës nuk i njeh këtij komuniteti të drejtën për tu përfaqësuar.

Asnjëherë nuk keni dërguar sinjale të mirëfillta për serbët e Kosovës, asnjëherë nuk jeni interesuar t'i integroni vërtet brenda Republikës. Shikoni deklaratimet e juaja dhe gjuhën e urrejtjes, që ju rrëshqet prej kohe në kohë. Ju nuk keni program për integrim, ju keni program të të qenët shërbyes të politikave të huaja, por më së paku të politikave për qytetarë të Kosovës.

Republika e Kosovës ka stabilitet ekonomik dhe politik, nëse vendi është integruar, nëse qytetarët e saj ndihen të barabartë, nëse popullsia shumicë përmes përfaqësuesve të saj angazhohet që të krijojë kushte të nevojshme që minoriteti serb, por edhe minoritetet tjera të ndjehen të integruara dhe të barabarta.

KRYETARI: Faleminderit! Raif Qela e ka fjalën. Të bëhet gati Sadri Ferati.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër,

Në frymën e asaj se jemi në interpelancë dhe jo që të japim deklarime politike, unë do t'i drejtohem zotit kryeministër me pyetje.

Çka do të bëjë zoti kryeministër dhe Qeveria, në mënyrë që në veriun e Mitrovicës të kthehen pronarët e ligjshëm të pronave, të cilët janë të dëbuar me dhunë, veçanërisht në vitin 2000? Si e mendon ai se do të realizohet kjo? Çfarë do të jenë ata hapa, që do të bëjë Qeveria në mënyrë që pronarët të kthehen në pronat e veta të ligjshme?

Janë rreth 500 prona të uzurpuara akoma, disa qindra të tjera janë shitur nga pronarë shqiptarë për shkak të neglizhencës edhe të institucioneve të Kosovës. Është koha e fundit, që të ndërmerren zhapa në këtë drejtim.

Tjetra, çfarë do të ndërmarrë Qeveria e Kosovës, në mënyrë që 7 fshatrat shqiptare të veriut të Kosovës, të cilat janë pothuajse të izoluara, tu hapet rruga në mënyrë që ato të ndihen pjesë e Kosovës? Janë shtatë fshatra në tri komuna që administrohen nga serbët, në Leposaviq, në Zubin-Potok e në Zveçan.

Dhe, shtrohet çështja nëse duhet apo nuk duhet të vazhdohet me bisedimet lidhur me problemet e mbetura ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, respektivisht ndërmjet problemeve të mbetura nga lufta e Kosovës. A do të ndërmarrë Qeveria e Kosovës hapa, në mënyrë që çështjet të fillojnë të shtrohen si çështje politike e jo si tani, të nisen si çështje teknike e të përfundojnë në probleme të rënda politike?

Natyrisht, se rrugë e vetme janë bisedimet, sepse vetëm përmes bisedimeve mund të realizohen qëllimet tona, mirëpo pa platformë të qartë ne do të vazhdojmë të bëjmë hapa të gabuar, siç kemi bërë deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati e ka fjalën. Zonja Vjosa, fjala për ju, në qoftë se s'është Sadriu.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Do të doja që diskutimi i sotëm vërtet, të mos fokusohet në dialogun Kosovë - Serbi në tërësi, mirëpo është e padiskutueshme që një pjesë e madhe e marrëveshjeve dhe e dialogut në Bruksel ka prekur jo vetëm zhvillimet në veri të Mitrovicës, por ka pasur efekt edhe më të gjerë.

Mirëpo, njëjtë sikur kolegu që foli paraprakisht, mendoj se interpelancat duhet të fokusohen në pyetje dhe kërkesa për sqarime në raport me Qeverinë e jo vetëm deklarime, siç bëhet rëndom në debate parlamentare.

Prandaj, do të filloj me disa kërkesa për sqarime, të cilat shpresoj që Qeveria do t'i marrë parasysh.

Siç e dini, qëllimi i dialogut qysh nga miratimi i rezolutës së asamblesë së përgjithshme në vitin 2010, ka qenë që marrëveshjet në mes të Kosovës dhe Serbisë të rezultojnë me përmirësime praktike në jetën e qytetarëve.

Pyetja ime është: Sa e shihni ju apo në qoftë se bëni analiza të tilla, që marrëveshjet e deritanishme, qoftë ato që konsiderohen si teknike, qoftë edhe marrëveshjet në nivel të kryeministrave, kanë ndihmuar në integrimin praktik të qytetarëve në Mitrovicë, qoftë për jetën e qytetarëve shqiptarë që jetojnë në veri, qoftë për jetën e qytetarëve serbë?

E para, në qoftë se deri tani, pra nga viti 2011 kur ka filluar dialogu deri sot, Mitrovica është konsideruar për projekte zhvillimore të cilat përfundimisht do tu ndihmonin qytetarëve që të integroheshin. Sepse, pavarësisht problemeve politike, qytetarët qofshin serbë, qofshin boshnjakë, turq, rom, ashkalinj, egjiptian apo të tjerë kanë, mbi të gjitha, probleme ekonomike. Dhe, edhe serbët që jetojnë në veri përtej këtyre problemeve ekonomike edhe ata kanë vështirësi në jetën e tyre nga bandat ilegale, të cilat ua rrezikojnë edhe jetën.

Pra, sa ka pasur projekte zhvillimore që do t'i bënin bashkë këto komunitete, sepse më shumë do të ketë efekt një serb, një shqiptar, një boshnjak, që punojnë në një vend të përbashkët pune, se sa shtrëngimi i duarve nga ana e politikanëve.

E dyta, çfarë veprimesh konkrete janë ndërmarrë për mbrojtjen e jetës, pra për sigurinë fizike, edhe fizike pra, të qytetarëve shqiptarë që jetojnë në veri? Numri i tyre, fatkeqësisht, është duke u bërë çdo ditë e më i vogël. Pra, praktika po tregon që nga viti 2011, në vend se efekti përfundimtar të ishte rritja e numrit të shqiptarëve që jetojnë në veri, sepse ndjehen më të sigurt, ka ndodhur e kundërta. Kemi pasur incidente të shumta, që nuk janë lejuar të ndërtojnë shtëpi, që shumë prej tyre i kanë shitur, u tha edhe më herët, për shkak se Serbia ka fonde të caktuara, me të cilat i blen. Dhe, në shumë raste kanë probleme të shkojnë në shkollë e madje, edhe të blejnë ushqimin e përditshëm.

Sa i përket çështjes së dytë, u fol këtu shumë për marrëveshjen për Asociacionin, për bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka krijuar një normë, e cila tanimë kishte ekzistuar në Kushtetutën tonë, mirëpo është konfirmuar edhe në këtë vendim, që

nuk mund të ketë marrëveshje të nënshkruara në Bruksel, të cilat diskriminojnë komunitetet tjera dhe kërkojnë që vende të caktuara të punës tu ndahen vetëm serbëve apo edhe vetëm shqiptarëve.

Ne kemi dëgjuar disa herë në deklarime këtu që, edhe pse po nënshkruhen këto letra kështu, në praktikë në fakt do të hapen vende të punës apo do të ketë përfshirje edhe të komuniteteve tjera.

Pyetja ime është: Në zbatimin e marrëveshjeve, siç është marrëveshja për drejtësi apo edhe marrëveshje të tjera, që u referohen vetëm serbëve, ose vetëm një komuniteti të caktuar, sa keni arritur që të integroni apo të përfshini edhe komunitetet tjera, sepse vendimi i Gjykatës Kushtetuese, siç e thash, krijon këtë detyrim pastaj, jo vetëm për marrëveshjen për Asociacionin, por për çdo marrëveshje që është nënshkruar në Bruksel.

E treta, deri tani është diskutuar shumë, jo vetëm për rikthimin e sovranitetit në veri, por edhe për sundim të ligjit në atë pjesë, sepse në esencë kjo është edhe çështje e sundimit të ligjit. Sundim të ligjit në veri nuk do të ketë pa rikthim të Gjykatës në veri, pra po flas edhe për Gjykatën Themelore, e cila tani funksionon siç e dini jashtë Mitrovicës. Kjo gjykatë, kam punuar edhe vetë në të disa vite në veri të Kosovës, e ka pasur rolin esencial për të dëshmuar, se institucionet e Kosovës po funksionojnë edhe në veri të vendit.

Do të doja që Qeveria të na tregojë, sepse sipas raportit vjetor të Ministrisë për Dialog të vitit 2016, botuar më 12 dhjetor 2016, thuhet se në janar do të zbatohet ajo pjesë. Janari shkoi. Do të kisha dashur të dëgjoj më në detaje, se deri ku ka arritur zbatimi i këtyre premtimeve?

Dhe përfundimisht, do të doja të dëgjoj, se sa e ka marrë me seriozitet Qeveria e Kosovës një sondazh të fundit të bërë me qytetarët e Kosovës, lidhur me atë se çfarë saktësisht presin ata nga dialogu me Serbinë? Cilat tema kërkojnë qytetarët e Kosovës që të jenë në qendër të dialogut?

Unë e kuptoj shumë mirë, që kjo nuk varet vetëm nga Kosova, është dialog në mes dy palësh, ndërmjetësuar edhe nga Bashkimi Evropian dhe rol të rëndësishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, së paku në propozimet me të cilat shkon Qeveria e Kosovës në Bruksel dhe platformën që do të duhej ta kishte, zëri i qytetarëve duhet të ketë rëndësi. Kërkesat e qytetarëve duhet të dëgjohen. Sa do të arrihen përfundimisht ato të bëhen letër e nënshkruar si marrëveshje është tjetër çështje, por së paku do të duhej të trajtoheshin si kërkesa të Republikës së Kosovës. Përndryshe, ne do të vazhdojmë për vite të tëra me një pranueshmëri tepër të ulët në publik të këtij procesi kaq të rëndësishëm për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rustem Berisha e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kur jemi te vlerësimi i mjedisit të brendshëm të sigurisë, e në veçanti në veri të Kosovës, mund të konstatojmë se kjo pjesë e Kosovës po ballafaqohet me provokime të vazhdueshme, me kërcënime e rreziqe të ndryshme, ku do t'i theksoj disa prej tyre.

E para, krimi i organizuar dhe korrupsioni e që janë si pasojë e mosfunksionimit të ligjit dhe minojnë besimin e qytetarëve në shtetin e Kosovës; mos shuarja e strukturave paralele të Serbisë; skenarë të ndryshëm dhe deklarata të ndryshme, që po vijnë nga ana e shtetit të Serbisë dhe mund të theksoj lirisht, se të gjitha këto janë të përkrahura dhe të motivuara nga shteti i Serbisë.

Çështja tjetër, që duhet ta parashtroj, ose ta theksoj sot këtu, janë se çfarë po bëjmë ne si shtet, si Qeveri, si institucione të sigurisë, që t'i parandalojmë këto dukuri, ose fenomene negative? E para, mendoj se shteti ynë patjetër duhet që ta shtrijë sovranitetin e plotë në këtë pjesë të territorit, duhet të fuqizojmë institucionet e sigurisë që për këtë çështje sigurisht se do të flasim më vonë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Por, ajo që unë dua ta theksoj dhe të parashtroj pyetje për kryeministrin është:

I nderuar kryeministër, pse disa prej bizneseve në veri të Kosovës nuk janë të licencuara dhe nuk punojnë me leje të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe, kur shteti ynë do të marrë masa që këto të pajisen me licenca valide?

Pasi që kemi kohë shumë, unë kam edhe shumë tjera për t'i cekur, por nuk do ta zgjas. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë, diskutimet e sotme janë lidhur me situatën e fundit në veri, unë do të fokusohem kryesisht në zhvillimet e ditëve të fundit, meqë ishte edhe diskutimi im i paraparë në deklarime jashtë rendit të ditës, e të cilin nuk arrita që ta them.

Mendoj që në radhë të parë, sot ne deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kemi mundësinë që të flasim qetë dhe me një ndjenjë jashtëzakonisht të mirë, që pas gjithë asaj që ka ndodhur në atë pjesë, asgjë e keqe s'ka ndodhur nga raportet e krijuara, në kontekstin e problemeve të javëve të kaluara, të cilat ishin në atë pjesë. Përkundrazi, unë konsideroj se shteti

ynë ka kaluar një fazë tjetër, ku ati perceptohet si nga qytetarë të republikës së Kosovës, po ashtu edhe nga partnerët, si një shtet i cili ka aftësinë dhe potencialin e duhur që problemet t'i zgjidhë në mënyrë aktive dhe në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme.

Në dy tri javët që lamë pas, mendoj që kosovarët, veçanërisht ata të asaj pjese, jetuan me dy probleme të cilat nuk ishin iniciuar apo provokuar nga qytetarët e Kosovës dhe presioni i madh i krijuar, që në momente të caktuara ishte edhe artificial, u kontrollua dhe u menaxhua me një përgjegjësi të madhe shtetërore dhe institucionale nga të gjithë ata që kishin mandat për tu marrë me problemin e krijuar. Në shumicën e rasteve gati se të gjithë faktorët e rrezikut, ose u eliminuan tërësisht apo edhe u minimizuan deri në atë masë, sa të mos jenë fare relevante.

Pas kësaj faze të vështirë, e cila në fund rezultoi me fillimin e zgjidhjes së problemeve, ne vërtetua se Kosova ka përgjegjësi ndaj qytetarëve të republikës, pa dallim përkatësie nacionale. Ne nuk krijuam tensione shtesë dhe nuk kërkuam fajtorë, por shteti ynë kërkoi dhe gjeti zgjidhje për problemet gjithnjë duke lëvizur në konturat e ligjit dhe të kushtetutshmërisë dhe mendoj se kjo tregon se tek ne po krijohet raporti, ku dallimet e përkatësisë etnike në mes njerëzve nuk janë më primare. Por, raporti shtet dhe qytetar po zhvillohet në bazë të ligjeve e rregullave kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot tensionet e shkaktuara lidhur me trenin si dhe problemin e murit, kanë zbritur në shkallën më të ulët të mundshme. Këto tensione nuk u balancuan nga vetvetja apo nga ndonjë fuqi anësore e paparë. Bisedimet aktive, madje edhe gatishmëria për të gjetur modelin, ku nuk do të kishte humbës, por vetëm fitues, si dhe marrja e obligimeve që duhet të realizohen në mënyrë të saktë dhe të sinqertë, konsideroj se e bëjnë shtetin tonë edhe më serioz edhe më të pranueshëm edhe nga skeptikët më të mëdhenj, të cilët fatkeqësisht nuk janë të paktë e sidomos, ata të cilët vazhdimisht po bëjnë politika ditore.

Aty ku nuk arrihen marrëveshjet në bazë të dëshirës dhe vullnetit, bashkëjetesa si dhe diversiteti është pasuri e nuk është dallim. Ata që sot nxisin kob e armiqësi, mendoj se janë frikacakët më të mëdhenj, ata nuk janë luftëtarë, por janë nxitës të luftërave, ku nuk do të ndodhin në mes vete. Jo vetëm ne, por qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjithë ata që kanë luftuar për jetë e paqe, për lirinë e fituar, mundemi dhe duam ta ndajmë me secilin që dëshiron të jetojë këtu, në shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës.

Ne duam dhe duhet të ngremë ura që lidhin, sepse funksioni i tyre është që të bashkojnë e jo të ndajnë njerëzit.

Veriu i Kosovës nuk do të jetë territor ku sfidohet shtetësia e Kosovës, veriu i Kosovës nuk do të jetë territor ku profiterët politikë e përdorin si arenë të nacionalizmave folklorikë. Veriu i

Kosovës duhet t'i kthehet normalitetit dhe nuk guxon që qytetarët e kësaj pjese, qofshin ata shqiptarë apo serbë, të jenë vegël e politikës nacionaliste të Beogradit e as të politikës ditore të atyre, që kërkojnë që problemet t'i zgjidhim vetëm përmes dhunës, si mjet i vetëm i parë dhe i fundit.

Republika e Kosovës nuk ka dhe nuk do të ketë mure. Ajo ka kufijtë e saj dhe është sovranë e territorit të saj. Qytetarët e saj do të jetojnë të lirë dhe do të jetojnë të sigurt. Aty, sikurse në çdo pjesë të Kosovës, njerëzit do të duhet të jetojnë të lirë dhe gara duhet të zhvillohet në prosperitet ekonomik, për një mirëqenie më të mirë dhe për zhvillim ekonomik, si dhe për perspektivën për të rinjtë dhe për fëmijët tanë, të cilën e kemi obligim si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Tjetër garë në pjesën e veriut të Kosovës, mendoj se nuk do të ketë asnjëherë.

Dhe një gjë për fund, institucionet e Republikës së Kosovës mund t'i heqin muret dhe barrikadat fizike, por mentalitetin e murit, si në Beograd ashtu edhe në Prishtinë, duhet ta heq vetëm e vetëm qytetari i Republikës së Kosovës dhe këtë përmes proceseve demokratike, duke përdorur të drejtën e tij për të zgjedhur në mes të mentalitetit të urave bashkuese, si dhe mentalitetit të mureve, që fatkeqësisht, po tentojnë që të ndajnë qytetarin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pra, edhe sot derisa po flasim, edhe një herë mund të konstatojmë që veriu vazhdon të mbetet sfida edhe e shtetësisë së Kosovës dhe e kualitetit të jetës në atë pjesë të Kosovës.

Dhe, po të kthehemi në bazën e ndërtimit të shtetit, jam i bindur që po të mos kishte qenë veriu, ne do të kishim pasur një kushtetutë ndryshe nga kjo që e kemi ne sot. Edhe atëherë delegacioni ynë në Vjenë ka qenë i vetëdijshëm, se nga i vijnë rreziqet Kosovës dhe cilat do të jenë sfidat kryesore të ardhshme të shtetit të Kosovës, prandaj e kemi këtë dizajnim të tillë, edhe të pakos së Ahtisarit, edhe të Kushtetutës, edhe të ligjeve që ne i kemi aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa herë që është biseduar për veriun, a e kemi quajtur një... do të thotë, dokumente veprimi, i kemi quajtur strategji apo i kemi quajtur "integrimin e veriut", gjithmonë e kemi pasur parasysh, që atje ndikimi i Beogradit ka qenë i madh dhe detyra e parë kryesore ka qenë zvogëlimi i ndikimit të Beogradit në atë pjesë. Prej instalimit të institucioneve që i ka pasur, pra zhbërjen e

atyre institucioneve, deri te një ndikim joparimor, që ka pasur tek serbët, tek institucionet, që sot e kemi aktualisht, është Lista sërpaska.

Po ashtu, deficit i sundimit të ligjit ka qenë një pengesë e madhe dhe aktualisht akoma sfidohemi me sundimin e ligjit në atë pjesë.

Prandaj, si të marrim shembullin e një shisheje gjysmë të mbushur, po të flasim për progresin që e ka shënuar Kosova, sidomos këto dy-tre vjetët e fundit. Mund të numërojmë mjaft progres në instalimin e ligjeve, zgjedhjeve të lira me ligjet e Republikës së Kosovës, vetë dialogu dhe rezultatet e dialogut që do të kishim dëshiruar që ato në tërësi të implementohen dhe që dialogu të intensifikohet që sa më shpejt t'i nxjerrë të gjitha produktet e nevojshme, sidomos në temat që lidhen me Beogradin që përfundimisht të fillojë t'i respektojë institucionet e Republikës së Kosovës, duke mos mohuar një angazhim pozitiv që ai mund ta ketë në gjithë ndihmën që mund t'ua japë qytetarëve të Republikës së Kosovës, qoftë të komunitetit serb, apo edhe të gjitha komuniteteve të tjera.

Prandaj, mendoj se, përveç forcimit të sovranitetit në atë pjesë, por forcimi i sovranitetit në mënyrë automatike nënkupton integrimin e asaj pjese dhe zëvendësimin e të gjitha atyre strukturave me strukturat e institucioneve të Republikës së Kosovës. Shtrirja e autoritetit të institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe politikat sektoriale.

Unë kohët e fundit kam pasur rastin të bisedoj pikërisht për këtë ide me shumicën e ministrave të Republikës së Kosovës dhe të gjithë kanë shprehur një pajtueshmëri dhe gatishmëri që të jenë të përkushtuar dhe nga fusha ku ata mbulojnë të jenë shumë më prezentë atje, duke stimuluar zhvillimin ekonomik, duke ndikuar në gjenerim të punësimit dhe listat që unë i kam, është numri i vogël i shqiptarëve që ka arritur të punësohet në strukturat komunale të asaj pjese, sidomos në Mitrovicë, por numri nuk është i kënaqshëm as nëpër komunat Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Po ashtu, është shumë me rëndësi që tani, edhe në planifikimet e buxheteve, qoftë nga pika 1.31, por edhe nga fondet e tjera të ketë një bashkëpunim që, përveç koordinimit me institucionet aktuale, përfitues të mëdhenj të jenë po ashtu edhe qytetarët e komunitetit shqiptar në atë pjesë, që edhe deri tash nuk janë mbuluar mjaftueshëm nga Prishtina, por kanë qenë të lënë anash nga institucionet lokale të asaj pjese.

Unë kam pasur rast të vizitoj të gjitha ato pjesë, e së fundi edhe Kodrën e Minatorëve, ku pothuaj në gishta mund të numërohen qytetarët e punësuar.

Prandaj, është minimum që çdo familje shqiptare në atë pjesë, që e ka të pamundur të zhvillohet aty afër shtëpisë së vet, të ketë mbështetjen e institucioneve, qoftë afër shtëpisë aty, në veri, apo

në institucionet jugore, në mënyrë që ata të shohin se është dora e shtrirë dhe mbështetja dhe duke e siguruar pastaj qëndrimin e tyre atje komod, ne mund dhe kemi të drejtë që pastaj të thirremi edhe në kthimin e shumë familjeve që janë të gatshme të kthehen në atë pjesë.

Prandaj, mendoj që në këtë pikë nuk ishte dashur të kishim dallime pozitive - opozitive, apo ata të cilët deri dje kanë pasur një pozicion apo një tjetër. Integrimi i veriut, vazhdimi i dialogut, sundimi i ligjit, gjenerimi i zhvillimit janë pa alternativë.

Prandaj, shpresoj se nëse dëshirojmë të komunikojmë, edhe në konkluzionet bazike në këtë dokument që do t'i kishim votuar të gjithë, mendoj se në rend të parë duhet ta kenë interesin e qytetarëve.

Nuk e di sa e kemi seriozisht kur merremi me çështje që realisht nuk e determinojnë veriun. Ne tani mund të flasim deri në mëngjes se një shëtitore a duhet të jetë objekt. Tërë ditën bisedoi Parlamenti i Republikës së Kosovës, ndërsa vetëm duhet të kthehemi e t'i lexojmë ligjet e Republikës së Kosovës.

Shëtitorja është kompetencë komunale. Ne kemi të drejtë të themi se atje nuk duhet të ndërtohen barriera, nuk duhet të ndërtohen kala afër urës që fatmirësisht u arrit pajtueshmëria dhe pa tensione e ndarje u rrënuar muri. Por, ne tash diskutojmë shumë dhe është mesazh i keq që ne të diskutojmë tash dhe ta kontestojmë të drejtën e komunës ta bëjë një shëtitore, e cila nuk e rrezikon qytetarin atje, por nga ana tjetër, janë institucione tona dhe janë qytetarët tanë.

Prandaj, unë edhe një herë thërras për një unifikim të këtyre qëllimeve primare, ndërsa e dimë se kemi edhe zgjedhje lokale këtë vit. Do të kemi kohë të bëjmë diskutime elektorale e fushata, por kur është veriu në pyetje, ju lus që vërtet ta kemi prioritet integritetin, sovranitetin dhe interesin e qytetarëve në atë pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë, kështu, pa elaboruar shumë, i kam dy pyetje konkrete për kryeministrin.

Zoti kryeministër, ju disa herë publikisht jeni deklaruar kundër ndërtimit të kolonisë serbe nga Qeveria e Serbisë që quhet "Lugina e Diellit". Po më intereson çka keni ndërmarrë, përveç deklaratave publike, çfarë masa konkrete keni marrë që kjo koloni të mos ndërtohet dhe të mos ndërtohen edhe koloni të tjera me qëllim të ndërrimit të strukturës së popullsisë, qoftë në pjesën veriore ose pjesët e tjera.

Dhe pyetja e dytë është:

Zoti kryeministër, disa herë publikisht keni deklaruar se për çështjen e murit, përtej urës së Ibrit, nuk do të bisedoni me Serbinë. Pas kthimit nga Brukseli keni thënë se për murin keni biseduar vetëm me zonjën Mogerini, por zonja Mogerini ju ka demantuar, që do të thotë se ajo ka thënë që ju keni biseduar edhe me Serbinë për çështjen e murit.

Pyetja ime është: Zoti kryeministër, cila është e vërteta: deklarata juaj se nuk keni biseduar me Serbinë për murin, apo demanti i zonjës Mogerini në lidhje me këtë çështje? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ali Berisha.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kosova është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm. Të paktën kështu thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Në fakt, situatën nuk e kemi ashtu. Matanë Ibrit vazhdojnë të funksionojnë strukturat paralele me bazë antikushtetuese dhe kriminele, të nxitura nga Serbia.

Ato jo vetëm që s'e njohin shtetin e Kosovës, por edhe veprojnë për të minuar funksionalitetin e shtetit, jo vetëm në këtë pjesë, por edhe në pjesë të tjera të territorit tonë.

Veriu i Kosovës paraqet modelin më të keq se si punohet për dezintegrim në emër të integritetit, se si cenohet sovraniteti dhe nuk sundon as minimalisht rendi kushtetues dhe ligjet e shtetit të Kosovës.

Ura mbi lumin Ibër paraqet simbolin e ndarjes së Mitrovicës dhe kufizimet e mëdha në qarkullimin e lirë të njerëzve, të mallrave, ideve, e të tjera.

Në veriun e Kosovës, si asnjë vend normal demokratik të Evropës, ju mund të shihni realisht situata që janë të paimagjinueshme. Aty shihni atmosferën e frikës, tension në rritje, kriminalitetin e të gjitha llojeve.

Një zonë ku nuk ka shenja të shtetit të Kosovës dhe plot simbole të një shteti fqinj. Në veriun e vendit shtetësia e Kosovës sfidohet hapur si nga pikëpamja juridiko-kushtetuese, e po ashtu edhe nga ana politike.

Serbia vazhdon të hedhë hapa legalë dhe ilegalë për të çimentuar realitetin e ndarjes, ndërkah Kosova s'ka arritur të bëjë hapa të duhur që të parandalojë investime të shumta për ndarje që i bën Serbia.

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa të vegjël e të paktë dhe s'ka arritur të krijojë siguri, normalitet dhe t'i kryejë funksionet e veta si shtet.

Nga sa kemi parë, hapat e Qeverisë së Kosovës, përveç se janë të pamjaftueshëm, nuk kanë treguar ndonjë rezultat të prekshëm që vërehet në terren.

Qeveria e Kosovës, qoftë me mosveprim apo me mungesë të vizionit për integrim, qoftë me mungesë të energjisë vepruese, ka lejuar të kurdisen projekte, siç është ura mbi Ibrin dhe beteja e gjatë për rikonstruktiv të saj, bllokimin e urës me justifikimin se po ndodh ndërtimi i ashtuquajtur “Park i paqes”, pastaj muri i ndarjes, tashmë i rrënuar, treni serb me mesazhe të qarta nacionaliste.

Kur po dialogohet në Bruksel, Kosova ka pranuar një agjendë të imponuar nga kurset e Serbisë që të merret dhe të trajtojë forma të brendshme të shtetit të Kosovës.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kërkoj falje, tash po punojmë me Rregullore. Gazetarët më kritikojnë, se për juve e kisha lejuar. Shkojmë te “Nisma”, Enver Hoti, pak kohë kenë, Enver. Urdhëroni!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se gjendja në veri është e vështirë dhe aspak nuk është ashtu sikur që e paraqiti kryeministri dhe disa deputetë këtu të pushtetit dhe atë për faktin se duke pasur parasysh agresivitetin e Serbisë, e cila është duke e shfaqur vazhdimisht, dhe nëpërmjet dy elementeve: nëpërmjet strukturave paralele në terren dhe nëpërmjet Listës serbe këtu në Kuvend dhe brenda Qeverisë.

Po ashtu, fakt tjetër është se Qeveria nuk është e aftë dhe nuk ka treguar aftësi e gatishmëri për t'u përballur me këtë gjendje aktuale, e cila po shfaqet në terren. Sidomos në bisedime ka shkuar e papërgatitur dhe mund të konstatojmë se ka hyrë komplet në agjendën e Republikës së Serbisë.

Ne sot ishte dashur të dëgjojmë këtu mbi çështje konkrete, siç është: cila është gjendja dhe numri i të kthyerve të shqiptarëve në pjesën e veriut? Cila është gjendja e pronave të tyre? Çka po ndodh me ata njerëz? Cila është gjendja sociale e tyre, e punësimit? Çka ka bërë Qeveria qendrore dhe lokale për jetën dhe mirëqenien e atyre njerëzve atje?

Ju lutem, shkoni pyetni ata njerëz atje dhe do të shihni se si do të vlerësojnë qëndrimin tuaj këtu në Qeveri.

Prandaj, ne nuk i morëm këto pyetje dhe, për më keq, ne dëgjuam këtu triumfalizëm për një tren, i cili është ndalur atje apo për një çështje e cila, në bashkëpunim me qeverinë lokale, mund të ndërtohet diçka e tillë, që s'ka të bëjë fare me seriozitetin dhe me situatën e cila është duke u shfaqur atje.

Unë kam një pyetje konkrete dhe direkte për ju, zoti Veseli, nëse ashtu mund të them, sepse po ngrihet këtu çështja vazhdimisht se sikur opozita të mos ishte në pushtet se si do të veprohej, sikur të ishte në pushtet opozita si do të veprohet me këtë. Këto i pata si pyetje për ju, dhe ma lejoni pyetjen ta shtroj:

Sikur të mos ishte Hashim Thaçi dorëzon i këtyre bisedimeve, si do të vepronit ju konkretisht, edhe si funksionar, edhe si qytetar i asaj pjese? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Interpelanca s'ka pyetje, por pyetjet mund të bëhen. Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERY: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Nga këndvështrimi historik siguria në përgjithësi është siguri njerëzore, në përgjithësi dhe siguria njerëzore në veçanti janë elemente themelore për funksionimin e një shteti. Siguria është vlerë fundamentale e marrëdhënieve njerëzore, ndërkaq gjendja e saj është rregulluar apo institucionalizuar nëpërmjet shfaqjes së shtetit sovran dhe sistemit të shteteve në nivel global.

Gjendja e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës që nga paslufta e këndeje ka qenë e paqëndrueshme dhe është sfiduar në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat paralele të sigurisë nga Serbia dhe grupet e krimit të organizuar, të cilët për t'i arritur objektivat e tyre kanë përdorur një luftë speciale në formë dhe metoda nga më të ndryshme, të kombinuara e të menduara mirë, të planifikuara në mënyrë sekrete, me të cilat është tentuar në mënyrë të vazhdueshme që ta destabilizojnë situatën, në mënyrë që të ndryshohet raporti i forcave pothuajse në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Ajo pjesë për një kohë të gjatë, por edhe tani, në një masë ndoshta më të vogël, ka shërbyer si një oazë për lulëzimin e kontrabandës dhe krimit të organizuar. Ndërsa qytetarët e ndershëm dhe të zakonshëm të asaj pjese kanë jetuar mes frikës nga grupet e krimit të organizuar dhe dëshirës për rend dhe ligj në atë pjesë.

Ushtrimi i ndikimit dhe të kontrollit efektiv të Qeverisë së Republikës së Kosovës në atë pjesë ishte kufizuar dhe përgjegjësit e sigurisë, si UNMIK-u, KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës, në shumë raste u gjend edhe në pozita jo të lehta, duke aplikuar sigurinë gjithëpërfshirëse me qëllim të mbajtjes së paqes dhe stabilitetit e brishtë. Sepse mënyra e kryerjes së veprave dhe organizimit të grupeve të ndryshme kriminale, duke përdorur edhe banorët lokalë serbë, në atë pjesë tregon shkallën e lartë të përgatitjes dhe realizimit të aksioneve të caktuara të dirigjuara kryesisht nga punonjësit e Qeverisë serbe.

Në atë pjesë kemi pasur djegien e pikave doganore, vendosjen e barrikadave në rrugë të ndryshme si dhe sulme kundër pjesëtarëve të UNMIK-ut, e më pas të EULEX-it. Ndaj popullatës shqiptare që nga periudha e pasluftës është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike, me dëbime me përmasa kolektive nga pronat e tyre dhe është cenuar në shkallën më të lartë liria e lëvizjes së atyre që kanë qëndruar në pronat e tyre.

Shkalla e sigurisë është e cenuar rëndë, shtrirja e sovranitetit në atë pjesë ishte kufizuar, rreziqet ishin të shumta dhe reale, të cilat u shkaktuan me veprime të individëve dhe grupeve kriminale, të cilët sipas vëllimit, intensitetit, kohës dhe mënyrës së shfaqjes kanë sjellë pasoja të dëmshme për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Përkundër bisedimeve dhe marrëveshjeve në Bruksel, edhe për shuarjen e strukturave paralele serbe, këto struktura, për fat të keq, ende vazhdojnë të operojnë në veri të Kosovës, duke cenuar sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit, që duhet të paraqesë një shqetësim si për sigurinë kombëtare, ashtu edhe për mekanizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë.

Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë në mënyrë konsistente nga Brukseli që kjo marrëveshje të implementohet në tërësi, në mënyrë që të bëhet shuarja e tërësishme e këtyre strukturave.

Cila është gjendja e sigurisë sot, pas të gjitha këtyre viteve? Jo e dëshiruar, siç do të dëshironte çdo qytetar i Kosovës, dhe të gjithë ne duhet të jemi realë e të shohim realitetin si është.

Këtu duhet ta them një thënie: “Nëse imagjinata është vepër e mendjes njerëzore, atëherë realiteti është vepra e vullnetit hyjnor”, prandaj realiteti është përherë më i fuqishëm se imagjinata dhe është burim nga i cili ushqehet imagjinata njerëzore.

Skenarët e politikës serbe po shihen se janë armiqësore. Dhe, ku e dimë ne se çka bluajnë ata në kokat e tyre të mykura, me të vetmin qëllim të provokimit dhe destabilizimit të vendit.

Provokimet e fundit me trenin dhe ndërtimin e murit ilegal janë veprime kundër stabilitetit të Kosovës, në mënyrë që të krijojnë situatë jostabile dhe konfuze.

Institucionet e Kosovës dhe udhëheqësit e saj, nga presidenti, kryetari i Kuvendit, kryeministri, ministrat e linjës dhe të gjithë mekanizmat e sigurisë, në koordinim me mekanizmat ndërkombëtarë, nuk lejuan që ky tren të hyjë në territorin e Kosovës, sepse nuk ishte i zakonshëm, por me ikonografi dhe shkrime provokuese.

Prandaj, besoj se çdo qytetar i Kosovës i është gëzuar një vendimi të tillë të drejtë të institucioneve të vendit, të cilat treguan vendosmërinë e tyre duke e zbatuar ligjin dhe Kushtetutën e vendit.

Pas trenit, brenda natës tek ura e njohur e Ibrit na doli një mur i gjatë dhe i lartë, mur i cili mendohej se do të sillte ndarjen në mes të dy pjesëve të qytetit të Mitrovicës, por nga institucionet e vendit u cilësua si mur i ndërtuar në mënyrë ilegale, mur i shëmtuar, mur provokues dhe politik.

Prandaj, institucionet e vendit dhe udhëheqësit e saj vendosën se duhet të largohet sa më shpejt ky mur i ndërtuar pa leje.

Natyrisht se këtu institucionet e vendit janë treguar të përmbajtura dhe të kujdesshme e të matura që nëpërmjet bisedimeve të autoriteteve qendrore dhe atyre lokale të Mitrovicës së veriut si dhe faktorit ndërkombëtar ta zgjidhin këtë problem, dhe pas bisedimeve është arritur një marrëveshje për rrënimin e këtij muri nga ata të cilët e ndërtuan.

Muri u rrënua dhe në atë pjesë nuk do të ketë mure të tilla. Këtë e thanë qartë edhe presidenti, edhe kryetari, edhe kryeministri dhe pa dyshim se një kontribut të veçantë dhe të çmuar në zgjidhjen e këtij problemi ka dhënë ministri i Mjedisit, Ferat Shala, i cili me ekipin e tij profesional bëri që me dizajnimin dhe zgjidhjen teknike se si do të duket ai shesh në atë pjesë, i cili në mënyrë transparente, nëpërmes televizioneve, materialeve të shkruara ka bërë publike gjithçka dhe në detaje projektin e këtij sheshi.

Prandaj ka edhe gjëra pozitive në atë pjesë. Nuk është gjithçka e zezë. Në pikat doganore punojnë dhe veprojnë doganierët dhe policë të Kosovës. Në këto komuna funksionojnë organet komunale, të cilat kanë dalë nga zgjedhjet lokale. Kemi ndërtimin e shtëpive të Kroi i Vitakut dhe kthimin e banorëve në atë pjesë, heqjen e barrikadave, lëvizjen e qytetarëve.

Do ta përfundoj fjalimin tim me një thënie: “Ata që mohojnë çdo gjë, nuk mohojnë asgjë dhe nuk thonë asgjë”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Anton Quni, të bëhet gati Ilir Deda.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Aty ku mungon rendi dhe ligji, prezenca e institucioneve shtetërore dhe vullneti i qytetarëve për shtetndërtim krijohet mundësia që në forma dhe metoda të ndryshme të refuzohet, të sabotohet dhe të minohet çdo përpjekje për forcimin e shtetit.

Një ndër format më të rrezikshme për të kundërshtuar shtrirjen e sovranitetit mbi një territor janë aktivitetet e formacioneve paramilitare, prandaj edhe do të fokusohem me këtë çështje pas publikimit televiziv të veprimtarisë së një formacioni, të cilët veten e quajnë ‘klub sportiv’, por që në fakt janë formacion paramilitar.

Në bazë të pamjeve bëhet fjalë për një grup sportiv, të quajtur “Vukovi”, apo “Ujqit”, të cilët për sport dhe argëtim i kanë lojërat luftarake.

Pajisjet, uniformat, stërvitjet, lëvizjet taktike, vendosja e kampit, ikonografia, që të gjitha janë ushtarake dhe të karakterit ushtarak.

Gjithnjë sipas filmimit, ata vërehen se kryejnë veprime taktike sipas programeve të njësive speciale dhe komando, marshimet në formacion luftarak, infiltrimi, organizimi i pritave, minimi, kapja e robërve, ndërhyrja në objekte, e tjera, të gjitha janë pjesë e programit stërvitor ushtarak.

Në mesin e tyre vërehen disa individë të njohur në ish-Jugosllavi, si udhëheqës të njësive paramilitare, kontrabandues të armëve dhe eksplozivëve, si dhe nxitës të urrejtjeve nacionale.

Po ashtu, është shqetësues fakti se në mesin e tyre, nuk e di në cilën cilësi, vërehen edhe disa zyrtarë të Policisë së Kosovës.

Të nderuar, ky klub edhe mund të jetë sportiv, edhe të ketë siguruar leje për veprimtari nga autoritetet e Kosovës, edhe të ketë përdorur imitacion të armëve, por e vërteta është se qëllimi i tyre nuk është i mirë. Veprimet e tyre janë provokuese dhe kërcënuese.

Shumë prej këtyre aktiviteteve që i numërova, Forca e Sigurisë së Kosovës i ka të ndaluara.

Besoj se institucionet e sigurisë dhe të inteligjencës të kenë më shumë informata dhe të dinë e të mund të menaxhojnë situata të tilla. Por, nëse këto institucione janë një hap mbrapa hulumtuesve të mediave, atëherë ky fakt është shqetësues dhe shenjë alarmi për Qeverinë e Kosovës dhe për të gjithë ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Në vend të fjalimit, unë i kam disa pyetje për kryeministrin. E para ka të bëjë me ndryshimin e heshtur të strukturës etnike të popullsisë në veri. Kjo është një politikë e Serbisë, e cila edhe financohet me para të Qeverisë së Serbisë, ku pronat e shqiptarëve, të cilët jetojnë në veri të Mitrovicës, blihen nga qeveria e një shteti tjetër.

Pyetja është: A ka menduar Qeveria juaj si t'i kundërpërgjigjet pastrimit të heshtur etnik në veriun e Mitrovicës?

Pyetja e dytë: Çka po ndodh me funksionalizimin e bordit qeverisës ndërmjet dy komunave, Komunës së Mitrovicës së jugut dhe Komunës së Mitrovicës së veriut?

Duhet të dini se që 9 vjet nuk po respektohet ajo që është obligim për funksionimin e qytetit, i cili i ka dy komuna, dhe a e keni ndërmend që gjatë këtij mandati qeverisë të funksionalizoni bordin?

E treta, pasi që veriu i Kosovës lidhet domosdoshmërisht me dialogun me Serbinë, a jeni të gatshëm ta filloni procesin për krijimin e konsensusit minimal politik për këtë dialog, ku të gjithë duhet të jenë të përfshirë? Dhe, kjo gjithëpërfshirje është në përputhje me kërkesat e 53% të qytetarëve të Kosovës që e duan gjithëpërfshirjen në dialogun me Serbinë.

Dhe, së fundmi, pika e katërt: Keni deklaruar se është koha që të fillojnë punët në funksionalizimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe. A do të shkoni njëanshëm në draftimin e statutit, apo njëjtë do të ketë gjithëpërfshirje edhe në këtë proces?

Dhe, t'ju përkujtoj, vendi ynë ka qenë në krizë bash për shkak të mungesës së gjithëpërfshirjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Unë do të vazhdoj pikërisht aty ku e la deputeti Anton Quni. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme që ai e ngriti. Gjendjen në veriun e Kosovës e tregojnë më së miri gatishmëria e Serbisë për të futur atje grupe militare dhe paramilitare, por gjithnjë të armatosur deri në dhëmbë, qysh ia vejnë ata emrin vetvetes, a 'klub sportiv', a 'i gjuetisë' a OJQ, është plotësisht e parëndësishme. E rëndësishme është pamja e tyre, armatimi i tyre deri në dhëmbë dhe kjo shpjegon, qysh tha edhe deputeti Anton Çuni, qëllimin e tyre. Kjo është fotografia e atyre

njerëzve, janë me uniforma të ushtrisë, fare nuk ka lidhje me sport dhe janë të armatosur deri në dhëmbë.

Po ajo çka e bën problemin edhe më serioz është ky dokumenti këtu, që e kam në dorë. Ky dokument e mban vulën e Policisë së Kosovës, për këta paramilitarë që hyjnë në Kosovë. Policia e veriut të Kosovës lëshon këso dokumentesh në Kosovë. Kjo është polici jona, është polici e ligjshme, dhe ky është integrimi i strukturave paralele të Edita Tahirit. Pra, ky është integrimi i strukturave paralele. Këta po na thonë janë integruar dhe punojnë për Kosovën, këta lëshojnë dokumente që i fusin grupet paramilitare të Serbisë për të organizuar operacione ushtarake brenda territorit të Kosovës. Tash shtrohet pyetja çfarë integrimi i strukturave paralele të Serbisë qenka ky? A për këtë integrim na paskan folur Edita Tahiri, Isa Mustafa e Hashim Thaçi? Ky nuk është integrim, ky është legalizim i strukturave të Serbisë, të cilat vazhdojnë ta kryejnë punën e tyre qysh e kanë kryer vazhdimisht.

Pse Qeveria e Kosovës i fsheh këto dokumente? Për shembull, pse për Edita Tahirin nuk është ky dokument problem fare? Kjo nuk e ka hallin e Kosovës. Ky dokument është dashur të dalë në publik, e ka vulën e Policisë së Kosovës, janë futur ato grupe paramilitare në Kosovë. Ky duhet të jetë shqetësimi i vërtetë i shtetit dhe i Qeverisë, jo të shiten pallavra këtu, Qeveria është integruar dhe gjithçka është mirë atje.

Serbia ka ushtruar agresion të vazhdueshëm shtetëror në pjesën veriore të Kosovës prej qershorit të vitit 1999. Vetëm tetë muaj pas çlirimit të Kosovës, pra në shkurt të vitit 2000, Serbia e ka spastruar etnikisht me dhunë dhe me vrasje veriun e Kosovës, më saktësisht pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.

Po çka është problemi? Problemi është që asnjëherë deri tash qeveritë tona, e kjo është Qeveria e pestë që e kemi në Kosovën e pasluftës, asnjë qeveri nuk e ka shtruar problemin e veriut të Kosovës në dy dimensione esenciale, në të cilat është dashur të shtrohet çështja e veriut të Kosovës.

Së pari, që veriu i Kosovës është një agresion dhe, së dyti që është spastrim etnik.

Para çfarëdo fillimi të dialogut me Serbinë, para çfarëdo procesi negociator, ky do të duhej të ishte qëndrimi i shtetit dhe i Qeverisë së Kosovës. E para, atje ka agresion shtetëror, e dyta atje ka spastrim etnik. Qysh po do ti të flasësh me një qeveri për territorin tënd, kur ai ka bërë agresion dhe e ka shtetin atje? Me institucione të sigurisë, me MUP-in, me BIA, me krejt institucionet e sigurisë që funksionojnë atje, qysh do të flasësh?

Vetë fakti që ti po pranon të ulesh në tavolinën e bisedimeve me Serbinë, kur ekziston kjo situatë atje, i bie që je i gatshëm faktikisht të pranosh gjendjen aspak të favorshme ekzistuese në këtë pjesë të Kosovës.

Pra, qeveritë tona janë përcaktuar për një politikë tjetër, e kjo është politika e pajtimit me faktin e kryer në terren.

Kjo politikë pastaj e përcakton edhe qasjen e qeverisë tonë ndaj kësaj pjese të territorit të Kosovës. E qasja e Qeverisë ka qenë që duhet të bëjmë kompromise me këtë gjendje ekzistuese. Atje është Serbia, nuk kemi çka të bëjmë, duhet kompromis, duhet dialog. Po ky nuk është qëndrim politik i mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të interesave të kombit. Pikënisja duhet të jetë: ne nuk e pranojmë atë situatë. Ne nuk e njohim autoritetin e Serbisë atje. Serbia ka krijuar fakte me spastrim etnik, me agresion shtetëror, duhet edhe një marrëveshje për tërheqjen e të gjitha trupave të Serbisë atje në veri, pastaj flasim si dy shtete normale, për normalizim të marrëdhënieve, për demokraci e për çka do.

Po kur Serbia i ka brenda forcat e veta të armatosura, të ulesh e të diskutosh, jo, po kjo, si të thuash, rezultati dihet, është shumë kallaj. Është i disfavorshëm për shtetin e Kosovës. Kemi pasur të bëjmë me një qasje krejtësisht të gabueshme të qeverive tona.

Pastaj pranimi i gjendjes ekzistuese në pjesën veriore të Kosovës e ka prodhuar konceptin e dialogut edhe të negociatave.

Serbia është pranuar si faktor vendimmarrës për punë të brendshme të Kosovës, kjo ka çuar në krijimin e Listës serbe, e cila është bërë pjesë e Qeverisë sonë, të mos harrojmë, dhe të cilët e mbrojnë interesin e Serbisë dhe jo interesin e serbëve të Kosovës. Këtë e kemi parë prej veprimeve të tyre. Për shembull, zëvendëskryeministri, njeriu i dytë në Qeverinë e Kosovës, shkon e inauguron Luginën e Diellit. Pse zoti Mustafa nuk e shkarkoi Branimir Stojanoviçin, shtrohet pyetja. Nëse kryeministri është kundër Luginës së Diellit, edhe njeriu i dytë i tij është pro Luginës së Diellit, atëherë ju më tregoni mua, cili është shefi i Qeverisë dhe kush kujt i kërkon llogari dhe kush kë e shkarkon në këtë shtet?

Kryeministri Mustafa rri dhe e shikon zëvendëskryeministrin e vet duke inauguruar projekte kolonizatore të Serbisë brenda Republikës së Kosovës, kjo është skandaloze.

Kjo i bie që në mënyrë indirekte edhe vetë Qeveria jonë i miraton në heshtje këto projekte. A Jablanoviçin ky e shkarkoi vetëm pasi dhjetëra-mijëra qytetarë dolën nëpër sheshet e Prishtinës. Këtë tjetrin, Branimir Stojanoviçin, e mban aty, është zëvendëskryeministër, shkon e pret shirita atje për kolonizimin e Kosovës.

Para se të fillonte dialogu, kanë qenë tetë premtime, zonja dhe zotërinj, tetë premtime madhore të Qeverisë së Kosovës para se të shkohet në dialog me Serbinë atje. Ka qenë marsi i vitit 2011, ne i mbajmë mend ato premtime, nuk i kemi harruar.

E para, do të vijë njohja për Kosovën.

E dyta, do t'i përfundojmë integrimet evropiane, paralelisht me këtë dialog.

E treta, plotësisht do të integrohen serbët. A integrimin e pamë çfarë dokumentesh lëshojnë këta për ata 'ujqit', për atë formacionin paramilitar.

E katërta, Lugina e Preshevës do të ketë status reciprok, do ta ngremë edhe atë, do ta zgjidhim. Kështu fliste Hashim Thaçi në këtë foltore, me këto premtime.

Pastaj ato katër premtime të tjera shtesë që gjithmonë i ka përmendur çdo zyrtar qeveritar. Të pagjeturit. Gjashtë vjet po bëhen kur një fjalë për të pagjeturit nuk e kanë thënë atje në Bruksel dhe kanë fytyrë t'u dalin përpara familjeve të tyre.

Pastaj, pensionet e vjedhura nga ana e Serbisë, një premtim tjetër i parealizuar.

Pastaj premtimi i shtatë, përmendeshin reparacionet e luftës.

Edhe premtimi i tetë i presidentit Thaçi, premtimi i famshëm. Unë nuk di ku u tret ajo padi për gjenocid? Padia për gjenocid, a po ju kujtohet këtu, në këtë foltore. Ku mbeti ajo padi për gjenocid? Nuk është askund, e kanë harruar, po merren me krijimin e "Zajednicës", jo me gjykimin dhe me padinë çka na ka bërë Serbia këtu, me gjenocidin e saj.

Dhe, në vend të këtyre tetë premtimeve të parealizuara na erdhën tetë rezultate. E tash t'i shpjegojmë rezultatet që na ka sjellë dialogu me Serbinë.

E para, "Zajednica".

E dyta, "Telekomi" i Serbisë brenda Kosovës.

E treta, "Elektrokosmeti",

E katërta, "Gazpromi" rus ia ka nisur të funksionojë në veri të Kosovës, nuk e di a e dini? Me ato pikat e shitjes ilegale.

Fusnota, pastaj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Po mundohem të jem sa më racional në diskutim. Mendoj se kjo interpelancë është e dobishme nëse nxjerrim përvojë se si të merremi me këtë çështje të ndjeshme të komunave tona të veriut dhe se si të menaxhojmë situatat, të cilat i kishim dhe të cilat mund t'i kemi edhe në të ardhmen.

Mendoj se parakusht esencial për të qenë më efektiv në integrimin e plotë të këtyre komunave është që kjo çështje të trajtohet me një unitet më të madh të brendshëm si një çështje me rëndësi të interesit kombëtar të vendit dhe integritetit të tij që kërkon një qasje unike të forcave politike të pozitës dhe të opozitës.

Frikohem se futja e premisave të luftës primitive politike për pushtet, edhe në këtë çështje edhe në çështje të tjera të ngjashme nacionale, i dëmton rëndë angazhimet në kohën tonë kur ballafaqohemi me këto probleme. I dëmton rëndë përpjekjet tona për t'u ballafaquar në mënyrë më efektive lidhur me këtë çështje, pa mohuar nevojën që edhe në këto çështje të kërkojmë përgjegjësi dhe llogaridhënie ndaj institucioneve të Qeverisë dhe të tjerëve.

Jam i bindur se në adresimin e këtij problemi dhe problemeve të ngjashme duhet të jemi unikë dhe duhet t'i tejkalojmë këto probleme të ndasive dhe të sigurojmë një përkrahje të Qeverisë në momentet kur duhet të ballafaqohet me këto situata të rënda, jo të lehta.

Nuk besoj se pozita jonë forcohet kur pas secilit provokim të Serbisë në këto situata, dikush rri në një këmbë dhe sikur gëzohet që ta shfrytëzojë këtë për të kërkuar përgjigje nga Qeveria, në kohën kur Qeveria jonë duhet të veprojë kundër këtyre situatave.

Kjo nuk mund të konsiderohet e dinjitetshme dhe produktive dhe nuk na bënë seriozë në kundërshtimin e situatave të Serbisë.

Mendoj se situata që kishim ishte e rëndë, po më lejoni të konstatoj se angazhimi i institucioneve qeveritare, i liderëve institucionalë të vendit tonë lidhur me provokimet e fundit ishte serioz, i përgjegjshëm, brenda kushtetutës dhe ligjeve dhe tërë kjo u përcoll me efekte pozitive në përballimin e kësaj situatë.

Kur bisedojmë për veriun, ne patjetër kemi të bëjmë edhe me planin e Ahtisarit dhe duhet ta dimë se këtë çështje mund ta trajtojmë me planin e Ahtisarit, sepse ai është një akord mes nesh dhe bashkësisë ndërkombëtare. Serbia nuk e ka pranuar këtë. Ne kemi obligime t'i përmbahemi këtij, por natyrisht që në atë pjesën kur ballafaqohemi me Serbinë nuk do të mund të ballafaqohemi me Serbinë në këtë çështje pa pasur përkrahjen e aleatëve tanë veriatlantikë edhe NATO-s.

Prandaj, aksionet ose veprimet e njëanshme, unilaterale, e dëmtojnë pozitën tonë dhe ne duhet të jemi praaktivë me NATO-n, me partnerë, të pajtohemi me gjithçka, por veprimet unilaterale dhe futja edhe e kësaj çështjeje në luftën për pushtet e dëmton pozitën tonë.

Dialogu, mendoj se u tha këtu që ka rezultate, natyrisht u tha se ka edhe sfida, të dyja janë të vërteta.

Mendoj se më tutje dialogu me Serbinë duhet të ngrihet në nivel të dy shteteve dhe të reciprocitetit në trajtimin edhe të çështjeve që kanë të bëjnë me problemet e llogarive ekonomike, dëmeve dhe çështjeve të tjera. Por, paralelisht me këtë ne duhet të iniciojmë diskutimin dhe dialogun me minoritetin serb në Kosovë. Rasti me urën, problemin e Mitrovicës për murin edhe çështjen e parkut ishte një punë e mirë dhe mendoj se duhet të punojmë në parime reciprociteti: shteti me shtet, dialogu me minoritetin serb paralelisht me këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Emilija Rexhepi e ka fjalën, të bëhet gati Adem Salihaj.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem!

Poštovani predsedniče, uvaženi premijeru, ministri, poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Bošnjačka zajednica podržava dijalog i normalizaciju odnosa između Kosova i Srbije ali pre svega zahtevamo od naše Vlade, od naše premijera i predsednika države ali celokupnog pregovaračkog tima da se tokom procesa ili razgovora u Briselu obavezno spominju drugi narodi koji žive na Kosovu, koji žive u opštini Mitrovica i u severnom i u južnom delu, u opštini Leposavić ali s tim okolnim selima koji su totalno izolovani iz celokupnog ovog procesa, konkretno mislim na Bošnjački narod.

Mi smo gospodo ustavno otvorena kategorija i imamo podjednako pravo na sve ono što imaju u Albanci, i Srbi, i po pitanju uključivanja u sistem, i po pitanju zapošljavanja u javnim institucijama, i po pitanju ulaganja vladinih sredstava a pre svega po pitanju kršenja naših osnovnih ljudskih i manjinskih prava.

Poštovani premijeru,

Kolege poslanici,

Svi mi jako dobro znamo da su Bošnjaci, odnosno Bošnjačka mahala u posle ratnom periodu preživljavali razne strahote sa svih strana, ali opet bili i ostali most povezivanja između dve zavađene strane.

Zbog svega gore navedenog apelujem na našu Vladu, ali pre svega na međunarodni faktor koji je uključen u procesu dijaloga da poštuje sve nas na ravnopravnoj pravnoj osnovi, da poštuje

kosovsku multietničnost kao što to rade, da uvažava podjednako sve narode koje žive na prostorima Republike Kosova, a ne da multietničnost bude potrebna i dobra samo kada nekome odgovara radi zadovoljavanja nečega što nije u nečijem interesu.

Sama činjenica da su isključeni Bošnjaci, Turci, Goranci, Romi, Aškalije, Egipćani i ostalih narodi govori nam da ovaj dialog ne ide u najboljim smeru, i njegova realizacija na terenu će ići u pogrešnom pravcu.

Svima nama je jasno da je to proces koji je jako zahtevan, potrebno je vreme, ali uključivanje svih zajednica može samo ublažiti njegovu implementaciju na terenu a i naše demokratsko pravo da to tražimo zato što nam Ustav Republike Kosovo to dozvoljava, i mi nećemo odustati od toga i ovom prilikom pozivam sve poslanike u ovom parlamentu koji predstavljaju i štite druge zajednice da podignu svoj glas i štite svoj narod. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Adem Salihaj, të bëhet gati Ganimete Musliu.

ADEM SALIHAI: Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Unë s'i kam numërua, nuk e di e sata herë është që zhvillojmë debat ose interpelancë për veriun e Kosovës, por sigurisht që kemi diskutuar shumë herë dhe nuk besoj që ndonjëherë kemi arritur një rezultat ose një përfundim të caktuar në mënyrë që situata të kthehet në favor të Kosovës.

Cilat mund të jenë arsyet që ne vetëm debatojmë këtu, sa për të bërë debat, dhe nuk arrijmë asnjë rezultat.

Unë mendoj se problemi kryesor është brenda nesh, sepse ne këtu bëjmë një luftë sikur ne jemi palët e këtij problemi. Pra opozita me pozitë dhe pozita me opozitë e konsiderojmë palë njëra-tjetrën dhe, natyrisht që nuk arrijmë asnjë rezultat sepse nuk kemi një unitet të veprimit në mënyrë që të nxjerrim vendime dhe palë ta kemi Serbinë, jo njëri-tjetrin. Pra, ky është problemi esencial dhe ne nuk do të arrijmë askund asnjëherë përderisa i shohim problemet në këtë formë.

Shpeshherë kemi zhvilluar debate dhe në fund s'kemi arrit ta nxjerrim asnjë rezolutë, pa e thanë faktin që rezolutat edhe ashtu nuk zbatohen. Por ne nuk kemi arrit asnjë rezolutë ta nxjerrim si duhet, jo më të bëjmë diçka tjetër, sepse në fakt ne nuk e kemi një program ose një platformë politike të veprimit si institucion ose si komb, për dallim nga Serbia, e cila me shekuj ka një platformë politike të shtypjes, të pushtimit dhe të shkatërrimit të shqiptarëve, nga e cila nuk ka hequr dorë as sot.

Pra, edhe sot orientimi i politikës serbe në raport me shqiptarët është ajo që ka qenë me shekuj dhe s'ka asnjë ndryshim.

Çdo gjë që arrihet me Serbinë, duke i bërë koncesione, duke i krijuar favore brenda territorit të Kosovës, do të përdoret kundër Kosovës. Pra këtë s'duhet ta harrojmë asnjëherë, sepse kjo po ndodh në praktikë edhe çfarëdo koncesioni, çfarëdo forme që u japim atyre në dorë, ata do ta përdorin kundër nesh. Pra, nuk vlen parimi që ne nëse lëshojmë pe, situata do të zbutet dhe do ta kemi një situatë më të mirë në Kosovë.

Nuk vlen fakti që nëse ne u japim atyre disa të drejta shtesë, sepse të drejtat normale i kanë si të gjithë të tjerët, ata do të integrohen në shoqërinë e Kosovës. Ata po i përdorin këto privilegje për ta penguar pikërisht integrimin në Kosovë dhe për ta mbajtur peng konsolidimin e shtetit të Kosovës.

Pra, këto janë çështje që ne duhet t'i diskutojmë dhe në fund të nxjerrim përfundime. A mund ta bëjmë këtë, me siguri jo, sepse qasja jonë është shumë e gabuar në këtë aspekt. Ne këtu bëjmë luftë, një palë e sulmon Qeverinë, tjetra e mbron Qeverinë. Serbia është vetëm pretekst që ne të diskutojmë këtë dhe të sulmohemi ndërmjet vete.

Ne duhet ta dimë që pas çdo marrëveshjeje Serbia ka festuar, sepse e ka arritur një sukses. Ne i kemi bërë koncesione, e kemi bërë Serbinë partner brenda Kosovës, për rregullimin e brendshëm të Kosovës, që mendoj që është parim i gabuar dhe s'duhet ta bëjmë. Nëse e kemi bërë deri tash, së paku prej tash e tutje s'duhet ta bëjmë. Ne duhet të diskutojmë me komunitatet serbe, me përfaqësuesit e tyre që t'i zgjidhim problemet me ta, e jo të bëjmë marrëveshje ndërkombëtare, sepse marrëveshjet ndërkombëtare do të jenë një gur në qafën e Kosovës për një kohë të gjatë dhe besoj që nuk do të mund t'i anulojmë asnjëherë.

Unë dëshiroj ta përmend një fakt interesant pas një marrëveshjeje që Serbia e konsideroi sukses të saj. Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë deklaroi me kënaqësi të madhe se prej sot këmba e shqiptarit më nuk do të shkelë në veriun e Kosovës. Pra, këtu shihet qartë qëllimi i bisedimeve që bën Serbia me Kosovën, mos ta përdor atë shprehjen "serbe" që thotë "šiptarska čizma nikad neće da kroči na sever". Pra, një shprehje tepër fyese për ne shqiptarët.

Unë mendoj se ne duhet ta bëjmë një politikë tjetër, në binarë tjerë, në parime tjera, në mënyrë që ta shpëtojmë atë që mund të shpëtohet tash, sepse të mos harrojmë që edhe çështja e Asociacionit, pavarësisht faktit që Gjykata Kushtetuese e ka vënë deri diku binarë kushtetues dhe kjo që ka thënë Gjykata Kushtetuese është një e keqe ndoshta 10% krahasuar me atë marrëveshjen që është nënshkruar, megjithatë unë mendoj që do të kemi probleme vazhdimisht me këtë çështje, sepse serbët kurrë nuk do të pajtohen me një gjë të tillë dhe do të krijojnë situata dhe tensione të reja.

Zhvillimet e fundit, pra takimet e fundit në Bruksel, treni e muri kanë treguar se nëse ne kemi qëndrim të vendosur mund të arrihet diçka, e jo sikur deri më tash që çdo marrëveshje që është vënë në tavolinë është nënshkruar me një lehtësi të palejueshme. Pra, vetë fakti që ishin disa takime, që u cilësuan të rënda, pra që përfaqësuesit tanë nuk lëshuan pe, me vetë faktin që u ndal një tren që ishte për qëllime politike dhe shoviniste, me vetë faktin që u rrënuar një mur që ishte provokim i hapur ndaj shqiptarëve, tregon se ne nëse kemi qëndrime këmbëngulëse mund të bëjmë diçka, mund t'i mbrojmë interesat e Kosovës. Nëse lëshojmë pe sikur kemi lëshuar deri më tash, vetëm sa do të keqësohet situata dhe fakti që ne ndoshta mund të shkojmë ose s'mund të shkojmë në veri shumë lehtë nuk tregon që ajo pjesë e Kosovës është integruar. Nuk tregon se edhe po t'u japim autonomi të plotë ne mund të shkojmë në veri dhe kjo s'tregon vetvetiu asgjë.

Pra, unë mendoj që ne duhet ta kemi një platformë politike të përbashkët që nuk e kemi dhe deri atëherë sigurisht që do të na shkojë situata kështu siç na ka shkuar, do të grindemi ndërmjet vete, s'do të arrijmë në fund asnjë rezultat dhe natyrisht që Kosova do të jetë vazhdimisht humbëse në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Edita Tahiri, në emër të Qeverisë. 15 minuta i ka Qeveria e Kosovës, ta keni parasysh. LDK-ja aktualisht i ka edhe 8 minuta e 19 sekonda, vetëm ndajeni kohën. Dhe Shpejtim Bulliqi është i lajmëruar, bisedojmë në ndërkohë.

Zonja ministre, 15 sekonda t'i morën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë nga Kabineti qeveritar,

E para mendoj se të gjithë pajtohem se po flasim qetë, mirë, pa tensione, sepse edhe tensionet që i patëm në Kosovë, të shkaktuara nga Serbia, i hoqëm me vendosmërinë e institucioneve të shtetit të Kosovës, të qeverisjes së të gjitha institucioneve, prandaj edhe zëri sot po shkon më lart e më mirë.

E dyta, gjendja në dialog dhe rezultatet e dialogut janë faktike, nuk janë fjalë. Ne kemi qenë me Serbinë në dialog tri herë deri tash, kemi fol në Rambuje edhe kur Serbia bënte gjenocid këtu, edhe kishte disa shkurtpamës që thoshin "nuk duhet të bisedohet". Por, çka ndodhi? U bë marrëveshja, Serbia nuk e nënshkroi, u bombardua, ne u çliruam. Natyrisht u bëmë bashkë me aleatët SHBA-në, NATO-në e partnerët evropianë. Biseduam në Vjenë. Për statusin kemi biseduar dy vjet bashkë me një ekip uniteti. Çka ndodhi? E fituam pavarësinë, vazhdoi mbështetja e aleatëve, por i patëm edhe sfidat e realizimit të disa të drejtave më tepër për serbët.

Tani jemi duke folur në dialogun e Brukselit. Edhe një herë ju kam thënë, është mirë të flitet me fakte se për dezinformata dikush u mërzit këtu sot kur tregova se madje është dezinformuar edhe ITU-ja kur i kanë thënë se ka pasur petition në Kosovë kundër kodit telefonik.

Kështu që për dezinformata nuk e kemi aq problem, por problemi është kush po e bën dhe problemi është pse kaq dezinformata për një proces, i cili po e ndryshon gjendjen pozitivisht në veri. Po në veri nuk ka kurrfarë elementesh, siç u përmend këtu militare e paramilitare. Ju lutem! Policia e Kosovës vepron që nga viti 2014 dhe më lejoni që të ju tregoj prej 2014, prej pesë vrasjeve që ka pasur, 0 vrasje ka pasur në veri në vitin 2016. Kanë rënë dukshëm krimi e kriminaliteti. Pastaj ju e dini vetë që para dialogut qytetarët e Serbisë kanë hyrë në Kosovë pa probleme, as s'janë legjitimuar se s'ka pas pika kufitare, se janë djegur në Jarinjë e Bërnjak pas pavarësisë.

Çka ka ndodhur? Janë vënë autoritetet shtetërore, sot kontrollohet kush hyn e kush del prej Kosovës. A nuk është ky ndryshim i madh? Qytetarët e Kosovës nuk janë pranuar të kalojnë dhe të hyjnë në Serbi se s'i ka njohur Serbia dokumentet e shtetit të Kosovës, e që nga viti 2011 me dokumente të shtetit shkojnë në Serbi nëpër Serbi. Veç të ju tregoj, për vitin 2011 ka pasur 1 milion udhëtarë, sot në 2016 3 milionë e gjysmë udhëtarë prej Kosovës shkojnë nëpër Serbi për Evropë. Tre milionë e gjysmë! Mandej, pse kaq shumë? Se është rruga më e lirë, më e shkurtër.

Pastaj, shikoni në pikëkalimet kufitare Jarinjë e Bërnjak nuk kemi pasur taksa të grumbulluara, veç ka pas forca të krimit e kontrabandës. 30 milionë i kanë ardhur buxhetit të Kosovës kur i kemi vendosur autoritetet shtetërore me IBM-in.

Është shuar struktura paramilitare e Mbrojtjes Civile, s'ka më polici paralele, s'ka gjykata paralele. Kur do të jetë gjykata apo sistemi unitar? Është paraparë më 10 janar, po tensionet që i krijoi Serbia kanë krijuar zvarritje dhe tani do të rifillojë zbatimi, jo vetëm për drejtësinë, por edhe për marrëveshjet tjera.

Vazhdojmë tutje. Dikush po frikohet ende për aneksimet. Po çfarë aneksimesh, ne 100 vjet nuk u dorëzuam, lëre më tash që e kemi bërë shtetin. Me vullnetin e popullit, me luftën e UÇK-së e të LDK-së e të gjitha brezave, edhe me garancitë ndërkombëtare të SHBA-ve e të NATO-s. Po pse ende e kemi këtë frikë? Shikoni, është një filozof francez, quhet Fanoni, e ka shpjeguar mirë që populli i shtypur nuk lirohet menjëherë. Duhet të kalojë një kohë që t'i hiqet frika. Shikoni, edhe Serbia e ka një problem të disonancës mendore. Është agresori i njohur për gjenocid në Kosovë, Bosnjë, Kroaci e tjera, dhe sot sillet si viktimë. Ndoshta e keni parë. Ky është fenomeni i njohur, quhet "disonancë kognjitive". Ne mos ta bëjmë.

Të vazhdojmë, a doni edhe pak, apo ta ndërpres? Vazhdojmë! Shikoni, sot fola me Vjosën gjatë pauzës. Deputetja Vjosa më tha "i lexova të gjitha raportet në ueb-faqen e Qeverisë". Më erdhi

mirë shumë, ndërsa Palit po i them që kurrë s'ka lexuar kurrgjë në atë ueb-faqe. Krejt platformat janë aty. Krejt platformat që i kemi mbrojtur në Bruksel, ndërsa Adem Salihajt, shokut tim të vjetër, po i them diçka: Adem, marrëveshjet që janë arritur janë krejt në pajtim me ligjet e Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës, se këto kanë qenë në vija të kuqe. Tani po ju them, në ueb-faqen e Qeverisë e keni çdo informacion. Krejt është transparente dhe po ju them i kemi mbrojtur vijat e kuqe. Mos harroni, dialogu ka qenë i nivelit të lartë politik, e para kryeministri Thaçi, tani kryeministri Mustafa, dhe unë kam qenë kryenegociatore, por delegacionet janë përbërë nga ministrinë që janë përfaqësuar vetëm me ekspertët më të mirë që i kanë përbërë ekipet negociatore.

Tutje edhe diçka desha t'ju them, të mos ju vonoj shumë. Fusnota, shikoni Kosova ka pasur fusnotë edhe para fusnotës së Brukselit. Po, kush s'e ka ditur po jua them: Para fusnotës së Brukselit që ia ka shtuar vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare që e ka njohur pavarësinë, përpara ka qenë vetëm Kosovë nën Rezolutën 1244, ose Kosovë linjë me Rezolutën 1244. Edhe një dallim ka pasur atëherë. Ne atëherë nuk ishim pjesë e organizatave ndërkombëtare, UNMIK-u fliste për neve. Tani me këtë dialog ne flasim në emër të shtetit, nënshkruajmë në emër të shtetit, kemi fusnotë të avancuar me njohjen e pavarësisë në përmbajtje të fusnotës.

Kur do të shkrihet fusnota? Së pari, fusnota po e shtrin rrugën e Kosovës për integritet euroatlantike se na mundësoi që të shkojmë në Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, që është faza e parë e integritetit në BE, dhe pastaj do të shkrihet kur pesë vende mosnjohëse të BE-së do ta njohin Kosovën. Kam edhe shumë, por besoj mjafton me kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Musliu, fjala për ju. Përgatitet Sabri Hamiti.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Jepja fjalën kryetar, se po ia jap fjalën Palit.

KRYETARI: Ndalini minutat, dalim te Pali është replikë. Ka të drejtë për replikë. Urdhëro, Pal Lekaj!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Në kulturën time nuk e kam që të dialogoj keq me femra, e sidomos me këtë zonjën ministre, mirëpo po ia përkujtoj që në portalin shtetëror i ke vetëm dy raporte, edhe atë nga 5 faqe. Dhe, ajo që mund ta them, e ke dhunuar këtë Kuvend me fjalorin që thua që se Kosova është bërë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur qytetari e di dhe qytetari i Kosovës ka për t'ju treguar vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë një minutë, zonja deputete, dhe vazhdojmë me zonjën Musliu.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Lekaj, po shihet që s'keni lexuar unë thashë s'po lexoni. Po e kërkojmë tash menjëherë nga Kuvendi të lidheni me linkun e Zyrës së Kryeministrit, do t'i shihni jo pesë, po ti ndoshta veç pesë i lexon, me qindra faqe dokumentacion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Musliu, fjala për ju.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Ju përgëzoj për fjalimet paraprake, ministre të falënderoj për gjithë atë rezyme që na dhatë dhe atë sukses që e prezantuat dhe gjithashtu do t'i referohem fjalës suaj kur thatë që të flasim me fakte, e jo me dezinformata. Dhe, këtu edhe e mora kurajën që ta kërkoj fjalën sot.

Para dy javësh isha në Mitrovicë dhe kur them në Mitrovicë isha pikërisht në Kodrën e Minatorëve. Nuk isha në Lagjen e Boshnjakëve, as nuk isha në jug të Mitrovicës, por isha në veri të Mitrovicës dhe sinqerisht dua që sot nëpërmjet fjalës time t'i përsëjndes të gjithë ata shqiptarë dhe ato familje, të cilat jetojnë edhe sot atje në kushte shumë të vështira dhe me halle shumë të mëdha. Pa dashur që të lëshohem shumë në detajet e vizitës sime atje, unë dua t'i bëj disa pyetje: pyetja e parë është për ministrin, zotin Arsim Bajrami.

Zoti ministër, unë e kam vizituar shkollën "Hivzi Sulejmani", paralelen e ndarë në veri të Mitrovicës, konkretisht në Kodrën e Minatorëve. Ata pak nxënës që janë atje vërtet ta kujtojnë kohën e Migjenit. Është një kontejner, i cili ka vetëm dy klasa, dhe ato dy klasa më së paku mundesh t'i quash "klasa". Konsideroj që një kontejner i tillë nuk duhet shumë që të shkohet as në Bruksel, e as të thirret debat në Kuvend për t'u investuar, sepse me pak investim i bëhet një izolim dhe thjesht ata fëmijë dhe ata prindër, të cilët për mua janë heronj, nuk duhet të lejojnë që të dekurajohen që fëmijët e tyre t'i nxjerrin nga ajo shkollë.

Prandaj, pyetja ime konkrete është: Cilat janë mundësitë që ai kontejner të rinovohet me urgjencë dhe ata fëmijë të shkojnë dinjitetshëm në atë shkollë dhe t'i ndjekin mësimet pa u mërdhirë, sepse ishin të mërdhirë kur i vizitova.

Pyetja ime tjetër është kjo: Zoti kryeministër Mustafa, a mund të ju garantojmë qytetarëve të Kosovës, konkretisht të veriut të Mitrovicës kthimin nëpër shtëpitë e tyre që i kanë në veri? Kur do ta bëjmë këtë si institucione, sepse ne po garantojmë kthimin e serbëve në gjithë territorin e Kosovës ku ata i kanë pronat dhe shtëpitë e veta. Mendoj që tash 18 vjet pas luftës duhet të ju

ofrojmë garanci edhe qytetarëve tonë, të cilët e kanë vullnetin dhe sot e kësaj dite ende nuk i kanë shitur pronat e tyre të kthehen në Mitrovicë, ose në veri të Mitrovicës dhe të jetojnë të qetë në shtëpitë dhe në pronat e tyre.

E shoh që sot këtu nuk është ministri i Punëve të Brendshme, zoti Skënder Hyseni, por meqë është një pjesë e madhe e Qeverisë dhe jeni ju zoti kryeministër, pyetja ime tjetër është: Kur Qeveria e Republikës së Kosovës e ka një plan që të investojë në stacionin policor në veri të Mitrovicës, sepse punëtorët, serbë e shqiptarë, të cilët punojnë në atë stacion janë në kushte të mjerueshme. Atij gjithçka mund t'i thuhet, vetëm stacion policor dhe vend pune jo, dhe ajo që është paradoksi më i madh është në të njëjtën ndërtesë ne i kemi edhe organet e EULEX-it dhe të OSBE-së dhe vetëm nëse ngjithsh në zyrat e tyre e sheh se ata jetojnë shumë larg me standarde, sikur komplet ndryshon situata, në të njëjtin objekt ndryshojnë zyrat që duan vetëm pak investim dhe angazhim me zyrat e shqiptarëve dhe të serbëve që punojnë në stacionin policor, e që janë zyrtarë të shtetit të Republikës së Kosovës.

Dhe, thjesht si Qeveri, a keni menduar që të ketë investime ose një plan strategjik për investime në veri të Mitrovicës, sepse sinjerisht po them, dua ta citoj një qytetar, pa ia përmendur emrin, çka më tha në Mitrovicë. Tha “më shumë ka pasur ndikim një super-market që është hapur në veri të Mitrovicës në integrimin e shqiptarëve dhe serbëve, ose në bashkëjetesën, se sa ato qindra e qindra seanca dialoguese në Bruksel”. Prandaj, unë mendoj që kthimi i vëmendjes dhe investimi në veri të Mitrovicës është ajo çka duhet tani të bëhet, sepse kemi pritur mjaft dhe besoj që është momenti i fundit. Nuk dua të ndalem në retorikat ose thjesht t'i përsëris edhe kolegët e mi, as për murin dhe as për trenin, sepse tashmë dihen vendimet që janë marrë, por unë konsideroj që ne duhet të fillojmë të merremi me kushtet bazë të jetës së atyre qytetarëve atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti e ka fjalën

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Tash sot pak a shumë u artikulua çfarë jemi, që shkojmë në ekstreme, se dëgjuam edhe këngë vajtimi, edhe këngë lavdërimi. Secili i dëgjon me veshë, me timbrin e vet, ato që i pëlqejnë më shumë, por çështja është që është unë e dëgjova që kryeministri në mënyrë lapidare dhe kurrë më i saktë se sot s'ka qenë, shkurt tha që bisedat për Qeverinë janë alternativë. U përpoqa të dëgjoj dhe kundërshtarët dhe më në fund, nuk dëgjova që dikush tregoi se ka alternativë tjetër, veçse alternativa e tyre është modifikimi i formatit dhe i termeve. Formatit është i modifikuar, sepse në bisedat e fundit kemi një përfaqësim superior politik, kryeministër - kryetar i shtetit, në të dyja anët. Kemi dhe një risi, sepse është kërkuar që të mos flitet publikisht për marrëveshjet, që është risi paradoksale, sepse bisedimet këtu janë nisur si bisedime që duhet të tregohen para ose prapa në konsultime me Kuvendin. Edhe tash, një marrëveshje e fundit që ka ndodhë rreth detyrimeve

qeveritare që të rrëzohet muri, sepse ju e dini që është votuar rezoluta e Kuvendit që të rrëzohet muri i paligjshëm politik në veri të Mitrovicës. Edhe aty kemi një marrëveshje.

Unë menjëherë po them, sipas detyrimeve të Qeverisë rreth kësaj teme dhe raportit me Kuvendin, është dashur që ajo marrëveshje të vijë në Kuvend si dokument dëshmues, nuk po flas për mjete tjera, qysh ka dalë e s'ka dalë, dhe ai të vijë shqip, sepse gjuha zyrtare e Kuvendit dhe e komunikimit me Qeverinë është shqip. Dhe, zoti kryeministër, nëse dokumenti është ju lutem shumë, që t'u jepet nëpër kuti të gjithë deputetëve, atëherë janë ata vetë që e shohin a është zbatim i rezolutës së Kuvendit, nëse është në rregull, nëse s'është atëherë mund të diskutojmë tutje, pse? Sepse, kemi dëgjuar interpretime të ndryshme në këtë përshpejtim të tensioneve, çka është mur e çka s'është mur, i kam pa fjalorët dygjuhësor shqip e serbisht, që ekzistojnë në Kosovë, te tëra i thonë me një fjalë "mur" shqip, "zid" serbisht. Pastaj, disa fjalorë tutje nuk e shpjegojnë, ka fjalorë të tjerë që thonë vetëm "mur" dhe e shpjegojnë shqip që është një objekt i ndërtuar me material të fortë, që i bie gurë, e të tjera... në këtë rast beton, por nuk përcaktohet lartësia, s'e përcakton murin hiç. Funksionalisht përcaktohet në këta fjalorë, muri quhet "mur ndarës", "mur mbajtës", "mur pengues", e tjera...

Çfarë dua të them? Këtu pushojnë interpretimet e mija, por meqë tendenca e përdorimit e jep kuptimin nëpër këta fjalorë, atëherë edhe tendenca e atij objekti "strukture" që po i thonë "betonuese", është a po e pengon zhvillimin normal të komunikimit në mes dy mitrovicave, unë them po dhe nuk është veç puna e murit "të luleve" po e quaj unë, si po i thonë, por është funksionalisht, ajo ndodh sepse bëhet një rrethrotullim në dalje të urës dhe bigëzohet rruga për të kaluar më tutje.

Po, ky është vizion, po thonë "komunal", unë mendoj që është vizion i gabueshëm edhe atyre që e kanë projektuar, por nuk jam këtu që të gjuaj gabime të huaja. Po flasim për punët tona. Atëherë, unë do të shtoja edhe dy-tri çështje, shpejt. Transparenca e bisedimeve duhet të vazhdojë pa marrë parasysh që atje nuk munden kolektivisht shqiptarët e Kosovës të shkojnë të bisedojnë me serbët e Serbisë. Ata që shkojnë atje kanë detyrim të komunikimit para këtij Kuvendi çka bëhet. Thuhet se do ta mbrojmë në bisedime Kushtetutën, e kanë detyrim, veçse nëse nënshkruajnë dokumente që nuk janë kushtetuese dhe i bien në Kuvend dhe Kuvendi i voton me votë kushtetuese, bisedimet me Serbinë e ndërrojnë kushtetuesen dhe keni në vëmendje këtë, e kam thënë para tri vjetësh, po më duhet ta përsëris edhe sot, e bëjmë kushtetuese në çdo marrëveshje, në rast se e votojmë me votë kushtetuese, nëse jo nuk bëhet.

Pra, Kuvendi e ka përgjegjësinë finale për të gjitha këto. Biseduesit e kanë përgjegjësinë nëse nënshkruajnë dokumente initiale, pa i pasur parasysh këto.

Unë e kam edhe një vërejtje, puna e bashkëpunimit me, në u themi aleatë, dashamirët, përkrasitë e Kosovës, që janë shumë dhe pa dyshim janë përcaktues në historinë e re të

Kosovës, megjithatë duhet të jemi pak më të kujdesshëm dhe diskursin për ta mos ta çojmë vetëm në variantet e lutjeve, ankesave, ngushëllimeve ose falënderimeve, se këto janë komunikime elementare në ngushtica, se nuk janë ato qoshqe që i mbledhin këto tipa diskurseve. Nëse është partneritet domethënë bashkëpunim, domethënë me punua bashkë dhe me i marrë përgjegjësitë. Kurrkush kurrkënd nuk e amnistion brenda as jashtë për përgjegjësitë që i ka, në këtë rast edhe Kuvendi edhe vetë Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, po vazhdojmë. I kemi dy deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj dhe Shpejtim Bulliqi i kanë 1,35 sekonda, një minutë e tridhjetepesë sekonda. Ju kolegë jeni, si të doni në mes vete, lërinini sa të doni sekonda e vazhdon tjetri.

Shpejtim Bulliqi e ka fjalën, nëse e lë ndonjë sekondë, pastaj Armendi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetar!

Po, vërtet pas krejt kësaj që e tha akademik Hamiti, besoj që nuk mbeti shumë për t'u thënë.

Unë pajtohem plotësisht me ato që i tha, në njëfarë forme, sepse mendoj që ishte gjithëpërfshirës. Por, desha të them vetëm një dy fjalë, që faktikisht problemi thelbësor për ne si institucione të Kosovës qëndron që gjithmonë, faktikisht jemi të vonuar në veprimet tona. Pse jemi të vonuar?

Jemi të vonuar për arsye se gjithmonë çdo gjë që po ndodhë në veriun e Mitrovicës, neve gjithmonë po na gjen të papërgatitur, në fakt, dhe ne më pastaj po duhet të shpenzojmë kohë, energji e ndoshta edhe mjete për të mundur ta përcjellim situatën, ose situatat të cilat faktikisht po na qesin para aktit të kryer.

Faktikisht, ne e kemi pasur një periudhë të gjatë kohore bllokimin e urës së Ibrit, më pastaj e patëm problematikën e krijimit të murit, e patëm problematikën e trenit, filluan lufta mediatike e institucioneve tona se kush e ndali trenin, që në fakt ne e dimë të gjithë kush e ka ndaluar trenin dhe falë faktorit ndërkombëtar ndodhi edhe kjo, sepse faktikisht u pa që për institucionet tona treni do të shkonte deri në Kaçanik, nuk do të kishte ardhur hiç në Mitrovicë që të ndalet.

Të gjitha këto, faktikisht ndodhën dhe jemi dëshmitarë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më vjen keq! Bekim Haxhiu dhe përgatitem edhe unë në fund, një dy tri fjalë dhe pastaj vazhdojmë seancën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Është e sata herë që po diskutojmë për Mitrovicën, për situatën atje. Sigurisht që edhe kërkesa për këtë interpelancë është dorëzuar, ashtu si tha parashtuesi i kërkesës, në një periudhë kohore kur situata në Mitrovicë ka qenë më e tensionuar se sa që është tani. Sigurisht, se është menduar se kur kemi qenë unikë për murin si Kuvend i Kosovës dhe kemi vendosur edhe afate ligjore, sa i përket murit. Kemi kërkuar edhe atëherë, kemi deklaruar që nëse këto nuk përmbushen do të kërkonim edhe llogaridhënie nga institucionet qeveritare.

Dhe, kur si deputetë kërkojmë llogaridhënie nga institucionet qeveritare, sigurisht se atëherë është në nderin dhe përgjegjësinë tonë, që kur këto detyra përmbushen nga institucionet tona, nga ministritë përkatëse dhe Qeveria, atëherë të japim edhe vlerësimin pozitiv për këto. Por, ajo që duket edhe gjatë diskutimeve është që sigurisht se disa nga kolegët deputetë, edhe parashtues të kësaj interpelance, kërkesës për interpelancë, do të donin që ai mur të ekzistonte aty, që ai mur të mos rrënohej dhe në emër të murit të goditeshin muret e Qeverisë dhe muret e institucioneve të Kosovës.

Por, është një fakt që muri nuk është dhe institucionet tona kanë bërë punën e tyre, e kanë bërë me përgjegjësi prandaj edhe duhet të vlerësohet puna që është bërë dhe mendoj që këtë unitet që e kemi pasur në debatin për murin në Mitrovicë ta ruajmë, ta ruajmë për situatën atje, që të ndihmojmë qytetarët tanë në pjesën veriore, të punojmë bashkë në integrimin e veriut, të krijojmë kushte më të mira për qytetarët atje, jo vetëm në një lagje, por në tërë veriun, deri në pikat kufitare 1 dhe 31.

Pati këtu kërkesa edhe për lëshimin e video-incizimeve të periudhës së vitit 1999 dhe disa nga ne edhe na rifreskoi për të parë ato në medime tonat të prezantuara, për të parë se ku ishin Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rrahman Rama, Bekim Haxhiu dhe të tjerë, në vitin 1999. Më detyroi edhe e pashë edhe një herë atë incizim. Më vjen mirë, që presidenti tash i Kosovës dhe kryetari i Parlamentit të Kosovës në vitin 1999 ka qenë me qytetarët e Mitrovicës, me qytetarët e Kosovës, kanë vendosur fillimisht personalin mjekësor në spitalin e Mitrovicës. Më kujtohet fare mirë, se nuk ka qenë e lehtë, kam qenë me ta atje. Por, ai që parashtroi këtë kërkesë për '99-tën, po e pyes, ku e kishte liderin e vet në '99-tën, kur këta ishin në Mitrovicë, ku ishte parashtuesi i kërkesës, ish-ministri i Punëve të Brendshme ishte me ta? Sepse, duhej të dialogohej me KFOR-in, aty ishte Rrahman Rama, komandanti i Zonës së Shalës në atë periudhë kohore, ishte edhe tani presidenti dhe tani ish-kryetari i Parlamentit. Po, po, e dimë fare ku ka qenë edhe ai dhe ku kam qenë unë.

Dhe, të gjitha këto prandaj nuk ka qenë në nivelin e detyrës, as atëherë, as sot, as atëherë, as sot... dhe sigurisht, zoti Glauk, se je i interesuar. Unë nuk mendoj, Glauk, që agresioni i Serbisë ka

qenë në vitin 1999, a? Agresioni kur ka qenë? Në '99-tën? Unë mendoj, që agresioni i Serbisë ndaj Kosovës ka qenë një vit krejt, ndoshta '99-ta ka qenë liria! Liria e Kosovës ka ndodhur në '99-tën, jo agresioni i Serbisë në '99-tën, po sigurisht për qëllime politike atëherë në pamundësi të atij preteksti, për të cilin është thirrur kjo interpelancë edhe dëshiron të devijohet.

Por, unë mendoj se nëse ka gatishmëri të Kuvendit do të ishte interesante të shihej ai video-incizim, të cilin iu apostrofua njërit nga, u thirr në emër të tij njëri nga parafolësit. Mendoj që sot situata në veri do një përkushtim dhe unitet të të gjithëve, në veçanti ai proces të cilin e ka filluar Partia Demokratike në vitin 2008 për kthimin e shqiptarëve atje, të vazhdojë.

Janë ndërtuar një numër i madh i shtëpive dhe janë kthyer një numër i madh atje. Duhet të punohet edhe më shumë, ndërsa për ata qytetarë që nuk kanë pasur mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre, por që janë qiraxhinj në qytetin e tyre, ata qytetarë të veriut që jetojnë në pjesën jugore, tu paguhen qiratë, atë që ka bërë pushteti i kaluar komunal i Partisë Demokratike atje, që u ka siguruar pagesat e qirave atyre qytetarëve e që sot nuk u paguhen.

Prandaj, kemi edhe një takim të atyre qytetarëve edhe me pushtetin lokal sot atje, që ishte i datës 3 të këtij muaji dhe ku pas përfundimit të takimit ato kërkesa që merren nga qytetarët edhe në fund të takimit shqyhen nga nënkryetari i komunës së Mitrovicës dhe kjo tregon nivelin e përgjegjësisë së atyre, që sot udhëheqin me komunën e Mitrovicës dhe që bëjnë këto paradokse.

Mendoj që vërtet duhet të punojmë bashkë, që situata në Mitrovicë të përmirësohet dhe të shkohet kah kthimi i qytetarëve shqiptarë dhe të gjithë atyre që janë të interesuar për të jetuar në qytetin e tyre. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Ju përshëndes të gjithëve.

Jemi të gjithë sot shumë më të lehtësuar, se ajo që ka qenë një lloj cenimi i sovranitetit dhe i tërësisë me murin, është tejkaluar. Po shihet edhe nga vetë fakti i kësaj seance, se sa në mënyrë më të relaksuar ka shkuar. I falënderoj të gjithë kolegët e pozitës dhe të opozitës.

Ajo që është më me rëndësi, në Mitrovicë ka fituar ligji, kanë fituar institucionet, ka fituar Republika e Kosovës, nuk kemi shkuar me të mundshëm, kanë fituar edhe qytetarët serbë të pjesës veriore. Më besoni, do të ishte shumë e dëmshme, më së shumti do të ishte e dëmshme edhe për ta.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë qenë të vendosura që të shkojnë deri në fund me realizimin e ligjshmërisë, po asnjëherë manipulimeve të cilat u mundua Beogradi zyrtar t'i trumbetojë, nëpërmjet medieve të tyre, duke tentuar t'i frikësojë qytetarët tanë nën presionin psikologjik, po flas për qytetarët e veriut, se Republika e Kosovës do ta cenojë jetën e qytetarëve. Kurrë! Asnjëherë! Ky është edhe mesazh, i cili është nga institucionet e Republikës së Kosovës, nuk do ta cenojmë asnjë qytetar të Republikës sonë.

Përveç, ruajtjes dhe mbrojtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, ky ka qenë qëllimi dhe ky do të jetë edhe në të ardhmen. Ky edhe duhet të jetë mesazhi për qytetarët tanë në pjesën veriore, një mesazh i miqësisë, i respektit, i barazisë, po në të njëjtën kohë edhe respektimit të shtetësisë dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Unë nuk do dëshiroja, shumë mirë është si sot, nuk jemi heronj, por as nuk jemi viktimë, nuk jemi as përfitues politikë për t'u shtyrë, kanë fituar institucionet e Republikës së Kosovës dhe ligji.

Në të njëjtën kohë mirë është të orientohejmë nga pjesa e së ardhmes, është me u orientua se sa është relaksuese kjo situatë edhe për vetë qytetarët tanë në pjesën veriore, të cilët që 18 vjet manipulohen dhe tentohet të nxiten nga pushtetarët e Beogradit, se në qoftë se ka lëvizje të lirë, shqiptarët do të shkojnë dhe t'i dëbojnë nga shtëpitë e tyre bashkëqytetarët e tyre serbë në pjesën veriore. Kjo është një manipulim, të cilin nuk është mirë të zhvillohet më tej.

Qytetarët tanë serbë kudo që janë, duhet të jetojnë të qetë, të barabartë me bashkëqytetarët e tyre shqiptarë e boshnjakë, turq e malazezë, të gjithë, romë e ashkalinj, egjiptianë... i kanë të drejtat e barabarta, do të jenë qytetarë të respektuar, por ajo që është të gjithëve neve na preokupon është Republika e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran me zhvillim ekonomik, me perspektivë euroatlantike dhe me një mirëqenie sociale për të gjitha familjet tona.

Unë dëshiroj të përçoj një mesazh, veçanërisht të bashkëqytetarët e mi, edhe tuajt natyrisht, në Mitrovicë, shqiptarë, serbë, boshnjakë, malazezë, romë, turq, ashkalinj, egjiptianë... Republika e Kosovës do të investojë atje për të gjithë. Të gjithë ata duhet të ndjehen të sigurt, ta ndjejnë veten të sigurt si qytetarë të barabartë të Republikës së Kosovës. Ne asnjëherë nuk do të lejojmë cenimin e tyre dhe as të të drejtave të tyre, ata duhet të besojnë në shtetin tonë të përbashkët, Republikën e Kosovës.

Duhet të distancohemi të gjithë nga strukturat paralele, të cilat në shumicën e rasteve janë pjesëtarë të krimit të organizuar, të cilët në emër të patriotizmit përfitojnë për interesat e tyre, në rend të parë, dhe pak u bën për interesat proklamuese të patriotizmit, të cilat tentojnë t'i proklamojnë.

Le të jetojmë të gjithë të qetë në pronat tona, kudo që jemi, si qytetarët në veri si në jug, nuk ka veri e jug, ka vetëm një Republikë e Kosovës dhe le të jenë të sigurt të gjithë uzurpatorët, që kanë zaptuar pronat e tjetërkujt, se shteti nuk do t'i tolerojë edhe nuk kanë perspektivë në Republikën e Kosovës. Ligji do të jetë më i fortë sesa ata. Ata duhet t'i lirojnë pronat sa më shpejt dhe të njëjtën kohë, duhet t'i krijojmë mundësi të gjithë bashkëqytetarëve tanë, që të kthehen në pronat e tyre, të vazhdojnë jetën e tyre të komunikojnë së bashku me ta, për arsye se i kemi preokupime që janë të botës sociale, një jetë më e mirë, një perspektivë më e mirë për fëmijët tanë.

Për bashkëqytetarët tanë në pjesën e Mitrovicës, ne do të vazhdojmë si prioritet pjesën veriore. Shumë shpejt, tani është në fazën finale, në Kuvend prapë është kthyer, ka qenë në Qeverinë e Republikës së Kosovës iniciativa nga 25 deputetë, me sa di unë, për integrimin në mënyrë prioritare të qytetarëve tanë të pjesës veriore, ai do të vijë edhe si projektligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës në seancën parlamentare dhe jam shumë i sigurt, se do të jetë projektligji që do të marrë shumicën absolute të votave, në mënyrë që t'u krijohet perspektiva atyre qytetarëve, qofshin ata shqiptarë apo serbë, që të punësohen në biznese nëpërmjet vlerësimeve, të cilat do të jenë nga institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ata të integrohen në tregun e punës.

Nuk do të ketë shtëpi që ka qenë para 1999-tës që nuk do ta rindërtojnë institucionet e Republikës së Kosovës. Mos i lëshoni shtëpitë tuaja, mos i shitni ato, as shqiptarë e as serbë, rrini aty! Rrini ku jeni! Shteti i Kosovës është shteti juaj.

Është ligësi kush e shet shtëpinë e vet. Mos i lëshoni shtëpitë tuaja, jetoni aty. Do të keni mbrojtjen dhe përkrahjen e institucioneve të Republikës së Kosovës, në çdo aspekt.

Do të vazhdojmë investimet në shtëpitë tuaja, do të vazhdojmë investime dhe veçanërisht projektin ekonomik, i cili është edhe prioritet i institucioneve të Republikës së Kosovës, që qytetarët tanë të jetojnë në vendin e tyre, të mos e lëshojnë vendin e tyre, siç e patëm një lajm shumë të rëndë në media sot, se afro 3 mijë qytetarë vetëm nga komuna e Pejës e kanë lënë shtetësinë. E keni parasysh, me një natalitet i cili është në rënie e sipër për 10 vjet, dikujt mund t'i duket çudi sot në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës, por ne mund të ballafaqohemi me shtëpi e fshatra të braktisura nga qytetarët tanë dhe më jo që s'do të kemi të papunë, por për mirëmbajtjen e ekonomive tona familjare do të mund të kërkojmë njerëz edhe jashtë Republikës së Kosovës.

Ne të gjithë kemi dhënë shumë për këtë shtet. Mirë është që të gjithë të jemi unikë. Edhe ky debat kaloi mirë, me interpelancë, të afrohem i rreth shtetit tonë, për arsye se nuk ka në mesin tonë ndasi. Nuk e besoj, dikush mund të përfitojë politikisht nga një moment, për arsye se e shoh

shpeshherë që sa ballafaqohemi me mungesë të argumenteve, të cilat janë qenësore, të cilat kanë të bëjnë me të tashmen, njerëzit mundohen të godasin nga pjesa e së kaluarës.

E kaluara e popullit tonë, besoj, bile e çdo individ në Republikën e Kosovës, është shumë e dinjitetshme dhe krenare. Nuk ka popull sa qytetarët tanë që kanë qenë të pushtuar për kohë të gjatë, që kanë gabuar dhe e kanë dëmtuar vendin e vet, për arsye se në mesin tonë, sikur të mos kishim qenë bashkë, nuk do të ishim sot të lirë.

Ky ka qenë edhe përkushtimi ynë bashkërisht që kemi arritur lirinë, dhe është mirë bashkërisht të ecim përpara, të mos gjejmë të zezën në mesin tonë, për hir të interesave të cilat kanë të bëjnë me përfitim politik, por të gjenden pika më tepër të përbashkëta.

Kjo është pjesa e fundit. Nuk është thumbuese, as goditëse, por po dëshirojmë ta bëjmë me gjysmëshaka. Në vitin 1999, është e vërtetë, po edhe pas 1999-tës, çdo ditë, edhe sot besoni, nuk kam dëshirë të shkojmë në mënyrë demonstruese dhe të vijmë në pjesën veriore, sepse nuk i besoj që pas 12 qershorit të 1999-ës që mund të çlirohen bashkëqytetarët tanë nëpërmjet dhunës dhe forcës së armëve.

Po, po e jep fjalën publikisht, po të shkojë dikush nga ky Kuvend e të dalë andej, kurrë s'do t'i dal përpara e t'i them: "Ndal". Do t'i them: "Shko, shko"... Le të shkojë, s'e ndal! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryeministrit të Republikës së Kosovës, nëse dëshiron ta marrë fjalën sa i përket interpelancës.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Tani unë nuk dëshiroj të përsëris atë çfarë e thashë në fillim dhe as shumë vlerësime, të cilat u dhanë këtu në Kuvend nga ana e deputetëve.

Unë i vlerësoj të gjitha pikëpamjet që u shtruan këtu. Natyrisht se disa prej tyre kalojnë pak në fushën emocionale, e ndoshta edhe në çështje të vlerësimeve private dhe personale. Mirëpo, atë që unë mund të them si kryeministër i vendit është se ne do të punojmë me përkushtim të plotë që në veri të vendit të zbatojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të zbatojmë ligjet e Republikës së Kosovës, të trajtojmë atë pjesë, ato 4 komuna dhe komunat e tjera në mënyrë të njëjtë siç i trajtojmë të gjitha komunat në Republikën e Kosovës, që të bëjmë përpjekje në zhvillimin ekonomik, zhvillimin social, zhvillimin kulturor të asaj pjese, ashtu sikur që do të angazhohemi edhe në komuna të tjera që do të ndihmohet pastaj në integrimin e qytetarëve serbë dhe qytetarëve shqiptarë.

Unë e vlerësoj shumë angazhimin e shumë deputetëve këtu që ne të punojmë më tepër në zhvillimin ekonomik të asaj pjese, por po ashtu dua të nënvizoj, sepse u shtruan edhe disa pyetje

a çështje që ne domosdoshmërisht do të angazhohemi që Ligji mbi qeverisjen lokale në ato komuna të zbatohet ashtu si zbatohet në komunat tjera. Dhe, të drejtën që e kanë komunat atje mbi bazën e këtij ligji dhe mbi bazën e ligjeve të tjera që përcaktojnë fushëveprimtarinë e tyre dhe të respektohen, edhe në pikëpamje të shndërrimit të një rruge atje një shëtitore, sepse është çështje që e zbatojmë te komunat e tjera në vend dhe zbatohet edhe atje.

Dëshiroj po ashtu të nënvizoj se do të ishte lajm i mirë për Serbinë që treni provokues i Serbisë do të mbërrinte deri në Kaçanik, po që se nuk do të ndërhyjnë ndërkombëtarët. Por unë mund t'ju them se është lajm i vërtetë për Serbinë se ai tren nuk do të hynte me asnjë kusht në territorin e Republikës së Kosovës përderisa njësitë e Policisë sonë kanë qenë atje.

Prandaj ne nuk duhet të zhvlerësojmë përkushtimin e djemve dhe vajzave tona të Policisë deri në atë formë, sepse ata nuk kanë dalë atje të tallen, e as të tallet kurrkush me të, por kanë dalë të mbrojnë sovranitetin e vendit tonë, kanë dalë të mbrojnë lirinë dhe të drejtat e qytetarëve atje, pa marrë parasysh a janë serbë a shqiptarë dhe kanë dalë të mbrojnë rendin e qetësinë publike në atë pjesë të vendit.

Dhe, kështu do të jetë gjithmonë, pa marrë parasysh individualisht se a frikohet dikush shumë apo më pak prej Serbisë. Institucionet e Republikës së Kosovës do ta bëjnë punën e tyre.

Unë ju falënderoj shumë për këtë debat dhe interpelancë të pjesës dërmuese tuaj, dhe ju siguroj se ne do të bëjmë maksimumin që ligjet dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës të zbatohet në veri të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën e ka propozuesi i interpelancës, Rexhep Selimi. 5 minuta të parapara.

REXHEP SELIMI: Shpresoj të jem brenda Rregullores.

Në fakt, e gjithë kjo interpelancë që u mbajt sot nuk duhet të harrojmë se u mbajt edhe nën peshën e një vendimi krejt të padrejtë sërish për zotin Haradinaj dhe e pakta edhe 3 javë s'e kemi zotin Haradinaj në Kosovë dhe nuk mund të trajtohet shkëputshëm as nga tema që po e bisedojmë, për shkak se ne e dimë atje ai po mbahet si rezultat i një fletarrestimi të Serbisë, me të cilin Qeveria e Kosovës po bisedon dhe po thirret se ka bërë bisedime shumë të suksesshme.

Por, gjithë atë që folëm e çfarë u diskutua sot, nuk e di, kryeministri nuk dha përgjigje, nuk u dha përgjigje shumë çështjeve që u ngritën këtu nga të gjithë deputetëve dhe të gjitha grupeve parlamentare, qoftë nga ne si opozitë, qoftë nga pyetjet e tjera që u ngritën edhe nga deputetët e mazhorancës.

Në anën tjetër, nganjëherë është edhe situatë e pakuptueshme sepse kryeministri tha se strukturat paralele atje janë shuar, kurse në anën tjetër, kemi fakte që i sjell zoti Konjufca këtu, me njësi krejt të tjera. Tash nuk e dimë kë i ka quajtur Qeveria dhe vazhdon t'i quajë si institucione paralele të Serbisë, apo ndoshta ato institucione të sigurisë së Republikës së Serbisë nuk janë më paralele, se kanë mbetur nganjëherë të vetme, sidomos në pikat kufitare, për të cilat thirremi se nganjëherë i mbrojmë.

Nuk dua të bëj komentime veç e veç, por shumë të përbashkëta të diskutuesve qoftë nga Qeveria këtu, qoftë nga mazhoranca, kanë qenë se dialogu nuk ka alternativë.

Profesor Hamiti e ngriti këtë temë, që duket nganjëherë sikur është qëndrim i të gjithëve që dialogu ka alternativë. Por, jo, opozita mendon se dialogu ka alternativë, sidomos ka alternativë kur bëhet fjalë për respektimin e Kushtetutës dhe kur ky dialog ka qëllim cenimin e kësaj Kushtetute. Pra, mes dialogut, të bisedimeve dhe Kushtetutës, respektimit të Kushtetutës, ne është dashur që, së paku, alternativë e parë të jetë Kushtetuta, pra respektimi i saj.

Tash gjithë në këtë kohë, për besë është shumë vështirë të përballosh, ta dëgjosh zonjën Tahiri dhe ironinë e saj karshi çështjeve shumë serioze që ne po i trajtojmë.

Besoni, është goxha vështirë të dëgjohet e, si për qershi mbi tortë del komandant Kamishi dhe na jep leksione se ku ka qenë ky, ku ka qenë ai. Tash, nëse duam ta degradojmë deri këtu, ta degradojmë, por nuk është serioze kjo që të silllet debati deri aty.

E nëse bëhet fjalë për mur atje, është rrënuar një mur, por po ngrihet tjetri. Dhe, po harrojmë se duke rrënuar një mur e duke u ngritur tjetri, është krijuar një mur tjetër, një mur shumë më ndarës se sa ai prej betoni. Një mur tjetër, i cili nuk i lejonte shqiptarët të kalojnë as në vendet e punës së tyre në veri dikur, e as nëpër shtëpitë e tyre dhe sot quhet ligësi nëse ata nuk qëndrojnë atje.

A nuk është e padrejtë ndaj të gjithë atyre njerëzve të quhet ligësi që i lëshojnë shtëpitë? A nuk është ligësi për ne institucionet e Kosovës, për Qeverinë e Kosovës që të mos i mbrojmë ata, para se ne t'i quajmë se është ligësi që ata të mos qëndrojnë në shtëpitë e veta.

Dhe, të mos harrojmë, mes natës 3 dhe 4 shkurt të vitit 2002 aty u vranë 10 njerëz, aty u vranë njerëz të cilët në fund nuk mund t'i quajmë të ligj.

Për shkak të kohës që jam i kufizuar, mua më lejoni edhe një herë, nëse më lejon koha të lexoj pra, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” projektrezolutën, për të cilën edhe është mbajtur kjo si mocion përmbajtjesor.

Shpresoj të më lejojë koha që t'i lexoj 5 pikat e saj dhe t'i krijoj mundësi cilitdo grup parlamentar apo deputet që të shtojë dhe të kontribuojë në ndryshimin e kësaj rezolute.

Nën një, po futem menjëherë në tema:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të zbatojë pa vonesë dhe pa hezitim ligjet në fuqi për ndërtimet e paligjshme dhe për nxitjen e urrejtjes ndëretnike;
2. Kryeministri dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, si përgjegjësit kryesorë për administrimin e territorit, nëpërmjet organeve ligjzbatuese të heqin murin dhe çdo lloj pengese për lëvizje të lirë në Mitrovicë, jo më larg se 30 ditë nga miratimi i kësaj rezolute.
3. Ngarkohet Qeveria e Kosovës të hartojë planin dhe kalendarin e kthimit të qytetarëve shqiptarë dhe rindërtimin e shtëpive të tyre në veri të qytetit.
4. Kuvendi i kërkon Qeverisë së Kosovës të tërhiqet nga marrëveshjet e 25 gushtit 2015, të nënshkruar në Bruksel mes Mustafës dhe Vuçiqit, në respektim të vullnetit të qytetarëve dhe të interesit të vendit.

Dhe e fundit,

5. Në vend të negociatave me Serbinë në Bruksel, Kuvendi i Republikës angazhohet për të filluar dialogun me qytetarët e Kosovës të nacionalitetit serb, për integrimin e tyre në jetën institucionale, politike, ekonomike e sociale.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë! Deputeti Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 44, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, ka propozuar për miratim rezolutën prej 5 pikave.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin e rezolutës së propozuar, por së pari të shohim gjendjen e deputetëve. Siç shihet, në bazë të Rregullores, nuk mund të hapim diskutim për këtë çështje, por vetëm votim. Ky qenka qëndrimi, prandaj të shkojmë në votim, e pastaj sa po shoh Pal Lekaj do të marrë fjalën për një çështje tjetër.

70 deputetë jemi prezentë. Do të shkojmë në mënyrë elektronike, në rend të parë. Por të shkojmë në votim një herë. Pal Lekaj e do fjalën, me të cilën ka të bëjë jashtë kësaj pike të rendit të ditës. Urdhëro, Pal Lekaj!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,
Më lejoni që sa i përket rezolutës, ndoshta me pëlqimin e propozuesit, mendoj se duhet të harmonizohet dhe të dalim me një rezolutë të përbashkët. Pra, të mos hyhet në votim, nëse e pranoi.

Por, ajo që mua më shtyri të dal para jush është jo fort lajm i gëzueshëm, as për Kosovën e as për zotin Haradinaj, as për bashkëluftëtarët e tij, e sidomos për familjen, se zotit Haradinaj i është shtyrë vendimi deri më 2 mars.

Prandaj, në bisedë me deputetët, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kërkoj një protestë, pra në shenjë proteste dhe solidarizimi që kjo seancë të ndërpritet dhe të vazhdohet të martën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për të njëjtin propozim kanë folur shumica e deputetëve dhe grupet parlamentare, po donë ta ndërpresim.

Atëherë, para se të vijë kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, erdhën edhe kryetarët e grupeve parlamentare të PDK-së e LDK-së dhe është qëndrim parimor të ndërpritet seanca në përkrahje të zotit Haradinaj, me propozimin e zotit Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar.

Atëherë, s'po e fusim në votim këtë pjesë dhe të martën në orën 10:00 e kemi vazhdimin e seancës. Faleminderit!

* * *

E martë, 14 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 9 shkurt

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotërinj,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 9 shkurt 2017.

Kemi ngelur te pika e pestë e rendit të ditës, në pamundësi për të pasur kuorum për votim. E njëjta gjendje është edhe tani, kështu që do ta filloj me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues, në lidhje me përgjegjësinë për Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës

Nuk është Visari këtu a? Atëherë erdhi Visari.

Deputeti Visar Ymeri, bashkëngjitur edhe nga 8 deputetë nënshkrues në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me përgjegjësinë për Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë.

Nga kryetarët e grupeve parlamentare është kërkuar që mbi bazën e kohës së ndarë për çdo grup parlamentar, para fillimit të seancës plenare, kryesuesit e seancës plenare t'ia paraqesin listën e deputetëve për diskutim gjatë debatit për interpelancë.

Pa grup parlamentar janë katër deputetë dhe i kanë 6 minuta për diskutim.

Tani ftoj zotin Visar Ymeri, deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në cilësinë e propozuesit të interpelancës, ta marrë fjalën. Hapësira kohore është 10 minuta, në qoftë se nuk merr nga grupi parlamentar.

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Deputetë të këtij Kuvendi të Republikës,

Siç e dimë të gjithë, Qeveria e Republikës së Kosovës njoftoi më herët se më 10 gusht të vitit 2016 ka marrë vendimin që të fillohet me mbledhjen e premiumeve për sigurime shëndetësore dhe si datë për këtë fillim ishte caktuar 1 janari i vitit 2017, pra i këtij viti.

Në fillim të këtij viti sërish Qeveria e Republikës e shtyri këtë datë për në verën e vitit 2017, më saktësisht, në korrik.

Po ashtu, Qeveria ka aprovuar edhe koncept-dokumentin për sigurime shëndetësore, ku nga njëra anë bëhet përpjekje për të arsyetuar vendimin për mbledhjen e premiumeve dhe, nga ana tjetër, vihen në pah vështirësitë që paraqet implementimi i këtij vendimi për shkak të mosplotësimit të kushteve paraprake për zbatimin e sigurimeve shëndetësore.

Vendimin për mbledhjen e premiumeve Qeveria e Republikës së Kosovës e ka mbështetur në Ligjin për sigurime shëndetësore, respektivisht në nenin 12, paragrafi 1, ku saktësohet që ato mund të fillojnë të mbledhen vetëm pas që të jenë plotësuar parakushtet për zbatimin e sigurimit shëndetësor, të specifikuara në nenin 38 të dispozitave kalimtare.

Në këtë kuptim, ligji qartazi e detyron Qeverinë për plotësimin e parakushteve përpara se të fillojë mbledhja e premiumeve, e këto parakushte janë:

1. Grumbullimi i premiumeve do të fillojë vetëm pasi që lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor, së bashku me deklaratën përkatëse financiare për atë vit fiskal, të jenë miratuar sipas nenit 14 të këtij ligji. Pra, si ka mundësi të mbledhen premiumet për sigurime shëndetësore pa u treguar të siguruarve se për cilat shërbime janë duke paguar këtë premium.
2. Është lista e shërbimeve pa pagesë, nga neni 7 i këtij ligji, të cilat do të jenë të definuara. Çmimi i çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor për atë vit fiskal të jetë i dakorduar.
3. Bashkëpagesa dhe nivelet e tjera të bashkëfinancimit të jenë të dakorduara.
4. Së paku 75% e të punësuarve në sektorin publik dhe në ndërmarrjet e regjistruara private dhe publiko-private me TVSH të deklaruar dhe me qarkullim më të madh se 50 mijë euro të kenë marrë kartelë të sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër të verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor, dhe
5. Së paku 75% të individëve që u përkasin kategorive të liruara t'u jepen kartelat e sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër i verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor.

Krijimi i këtyre parakushteve është i lidhur ngushtë me funksionalizimin e sistemit të informimit shëndetësor, i cili përfshin të gjitha modalitetet, duke filluar nga: lista e shërbimeve, lista e

çmimeve për çdo shërbim, licencimi i rregullt për çdo punonjës shëndetësor në gjithë Republikën e Kosovës, funksionalizimi i odave të punonjësve shëndetësorë, që duhet të bëjnë këtë licencim, regjistrimi i personelit shëndetësor, regjistrimi i pacientëve, sistemi i referimit, udhërrëfyesit klinikë, regjistri i barnave dhe siguria e të dhënave.

Sipas planit të veprimit për implementimin e SISH-it, pra sistemit të informimit shëndetësor, të publikuar në strategjinë për sistemin e informimit shëndetësor 2010-2020 nga Ministria e Shëndetësisë, aktualisht SISH do të duhej të ishte në fazën finale të implementimit të tij, gjë që nuk përkon aspak me situatën aktuale, ku i tërë plan-veprimi i paraqitur në këtë strategji ka mbetur në letër dhe kurrë nuk u bë realitet.

Për këtë arsye, në mungesë të funksionalizimit të SISH-it dhe në mungesë të parakushteve të përcaktuara në nenin e sipërpërmendur, vendimin që ka marrë Qeveria në lidhje me fillimin e mbledhjes së premiumeve ka qenë në kundërshtim me vetë Ligjin për sigurime shëndetësore dhe çdo veprim i metutjeshëm do të bëjë shkelje ligjore të rëndë dhe me dëm ekonomik e financiar të madh për vendin.

Në vend që të mblidhte premiumet pa plotësuar standardet e domosdoshme të sistemit të sigurimeve, çdo Qeveri serioze do të ishte marrë seriozisht dhe pa vonesa me faktorët që ndikuan në mosrealizimin e SISH-it, duke adresuar shqetësimet e kërkesat e vazhdueshme për kontroll e hetim në drejtim të aktorëve përgjegjës, respektivisht zbatuesit të projektit të financuar nga buxheti i Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe të ndihmuar nga donacionet e “Lux Development”.

Për dijeninë e qytetarëve, projekti për sistemin informativ shëndetësor ka nisur prej vitit 2009. Aktualisht jemi në vitin 2017, tetë vjet pas dhe ende ministria është duke u marrë me grupe punuese lidhur me SISH-in.

Ende Qeveria e Kosovës ndan buxhet për këtë projekt dhe ende projekti as nuk është afër përfundimit.

Ndërkohë që janë shpenzuar miliona euro nga buxheti dhe nga donacionet, pa e nxjerr në dritë asnjë rezultat serioz të vetëm për këtë sistem.

Është thënë disa herë në publik se grumbullimi i fondeve duhet të fillojë disa muaj para ofrimit të shërbimeve, me argumentimin se fondi paska nevojë për akumulim të mjeteve financiare para se të fillojë mirëfilli me afrimin e shërbimeve.

Argumenti është i palogjikshëm me që, krahas të punësuarve, fondi pritet të ofrojë shërbimet edhe për familjet pa ndonjë anëtar të punësuar, për të cilët kostoja do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

Rrjedhimisht fondi mund të fillojë operimin që në datën e fillimit të grumbullimit të premiumeve, me që atij i alokohen mjetet nga buxheti shtetëror për mbulimin e shpenzimeve për persona që nuk e mbulojnë vetë premiumin.

Në kushtet kur Kosova është vendi më i varfër në Evropë, me jetëgjatësinë mesatare më të ulët në Evropë, me investimin më të ulët në sektorin shëndetësor në raport me produktin e brendshëm bruto, si dhe i vetmi vend në rajon pa sigurime shëndetësore, qasja joserioze jo vetëm që nuk siguron të drejtën elementare për të marrë shërbime shëndetësore, që bën pjesë në të drejta themelore të njeriut, por thellon varfërinë, duke pasur impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Duhet theksuar se mungesa e një sistemi të mirëfilltë informativ në sektorin e shëndetësisë shpeshherë ka qenë një nga indikatorët e mosfunksionimit të drejtë të sistemit shëndetësor dhe pasojat zakonisht kanë qenë fatale.

Në këtë mënyrë, komunikimi i institucioneve të niveleve të ndryshme, përpunimi i të dhënave lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe arkivimi i të dhënave në një sistem unik para së gjithash do t'i kontribuonte efikasitetit kontraktual në mes të institucioneve shëndetësore dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Dhe, konkretisht, mijëra jetë të qytetarëve tanë me të ardhura jo sa të qeveritarëve do të shpëtonin.

Për këtë sistem nevojitet një ligj i veçantë. Me këtë ligj përpos që do të rregullohet mënyra e bartjes së informatave të përpunimit dhe të arkivimit të tyre, do të rregullohet edhe çështja e mbrojtjes konfidenciale të të dhënave individuale që i përkasin shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.

Gjithashtu, në kuadër të këtij ligji do të parashihej edhe përgjegjësia si dhe krijimi i një qendre të veçantë për sistemin informativ shëndetësor, Qendra e Sistemit Informativ Shëndetësor.

Kështu do të krijonin një status të ri me rëndësinë që meriton ky sistem dhe po ashtu do të vendosnim mundësitë që nga një projekt i një grupi të ministrisë, të kthehen në një çështje të ligjvënës, duke u monitoruar nga të gjitha palët.

Po le të kthehemi edhe një herë te çështja e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe planin e Qeverisë për ta ndryshuar sërish këtë ligj.

Në Kosovë u trajtuan pak a shumë dy metoda të sigurimit të financimit të mjaftueshëm për shpenzimet e sektorit të shëndetësisë.

Alternativa e parë sugjeronte financim si përqindje e tatimeve apo akcizave të caktuara nga buxheti i vendit, si për shembull, aplikimi i një përqindjeje të të hyrave nga TVSH-ja, akciza për duhan apo alkool e të ngjashme, në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Kjo ra poshtë për shkak të mosstabilitetit në të ardhura të përfituara nga kjo skenë.

Alternativa tjetër konsistonte në ngritjen e kontributeve për sigurime shëndetësore, të cilat do të grumbulloheshin nga të punësuarit, të vetëpunësuarit, punëdhënësit dhe sipas mundësisë, edhe fermerët.

Ndërsa për kategoritë e papërfshira mbulimi i shpenzimeve do të arrihej nëpërmjet transferimit të parave drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

Atë kohë pati edhe një propozim që vinte nga Banka Botërore, i cili sugjeronte një financim të përzier mes të hyrave nga tatimet të caktuara dhe nga premiumi fiks që do të paguhej nga të punësuarit, të vetëpunësuarit, punëdhënësit dhe fermerët.

Një zgjidhje e tillë nuk do të ishte serioze. Në veçanti bëhet fjalë për principin e uljes së rrezikut nga shpenzimet katastrofike, principit të solidaritetit dhe efikasitetit të grumbullimeve të të hyrave.

Ligji që kaloi në vitin 2014 për sigurime shëndetësore nuk i plotësonte disa parime bazë, atë të universalitetit, të solidaritetit dhe, mbi të gjitha, të barazisë që sigurohet nga progresiviteti si dhe lë hapësirë shumë të madhe për keqmenaxhim sa i takon favorizimit klientelist të interesave private në shërbimet e sektorit me kapital jopublik.

Po i risjell në diskutim këto çështje të viteve 2011-2013, meqenëse grupi punues për çështjen e sigurimeve shëndetësore, i ngritur nga Qeveria e Kosovës, është duke menduar edhe ndryshimin e Ligjit ende të paimplementuar për sigurime shëndetësore.

Teksa publikisht deklarohet data e mbledhjes së premieeve nga pagat e qytetarëve tanë, vetë Qeveria është duke planifikuar ndryshime në këtë ligj, të cilat prekin thellësisht vetë strukturën e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Ata vetë kanë konstatuar mungesat në Ligjin për sigurime shëndetësore, në përcaktimin e kategorisë së të vetëpunësuarve, kolizionin me Ligjin për tatimin në vlerë të shtuar, sanksioneve administrative dhe plot çështje të tjera. Por, këto nuk po i deklarojnë publikisht.

Pra, as sistemi informativ, as burime njerëzore të gatshme, as ligj të strukturuar drejt e saktë, vetëm nxitim për të mbledhur paratë nga pagat e shumicës së popullatës, e cila sigurisht nuk është ajo e shtresës së lartë, por atyre që kanë vetëm nga një të punësuar në familje, prej pesë ose gjashtë anëtarësh.

Pa analizën e mirëfilltë të punës së deritashme në implementimin e SISH-it, nuk mund të kemi fillim të punës serioze të sigurimeve shëndetësore.

Para se të fillojë mbledhja e parave të qytetarëve për sigurime, ata publikisht duhet të njoftohen për përfitime që do të kenë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria duhet të garantojnë, në bazë të një dinamike kohore, se cilat do të jenë benefitet për paratë që i paguajnë qytetarët.

Ka shumë gjëra të paqarta rreth Agjencisë për Sigurime Shëndetësore dhe mundësitë që të shkaktohen dallime dhe ndarje voluntariste të buxhetit për institucionet dhe spitalet që do të lidhin kontrata për shërbime në buxhetin e paraparë për vitin 2017, nuk planifikohet fare buxhet për sigurime shëndetësore, edhe pse kjo është në kundërshtim me ligjin. Javën e kaluar ministri juaj, zoti Mustafa, e ka shkarkuar drejtorin e Agjencisë për Sigurime Shëndetësore, Arsim Çavdërbasha, që ka po ashtu përgjegjësi për këtë çështje dhe e ka emëruar Xhevat Ukajn, i cili ka qenë i shkarkuar për shkak të dështimit në projektin e SISH-it dhe i përfolur për keqmenaxhim.

Çfarë mund të pritet nga papërgjegjësi të tilla? Rruga që mund ta rikthejë këtë proces në drejtimin e duhur është ndalja e procesit për mbledhjen e parave, fillimi i punës për rishikimin në themel të Ligjit për sigurime shëndetësore, hartimi i Ligjit për sistemin informativ shëndetësor, e mbi të gjitha nisja për procedime penale i të gjithë përgjegjësve të gllabërimit të miliona eurove të destinuara për të gjithë këto vite për SISH dhe projekte mbështetëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa, që t'i paraqesë qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e ngritjes për interpelancë. Zoti Mustafa i keni 15 minuta në dispozicion, e keni fjalën. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Zhvillimi i shëndetësisë është prioritet i përcaktuar me programin tonë qeverisës. Lipsen investime kapitale, sidomos në pajisje dhe aparaturë të teknologjisë sa më të re, furnizimi i rregullt me barna dhe material tjetër, si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit mjekësor dhe personelit ndihmës.

Investimet në shëndetësi dhe në arsim janë investime produktive, prandaj në periudhën e ardhshme me prioritet do të kalohen investimet nga infrastruktura rrugore në këto fusha, të cilat drejtpërdrejt e determinojnë zhvillimin ekonomik dhe social. Përpos Fondit për Sigurime Shëndetësore do t'i shfrytëzojmë edhe mjetet e tjera, të cilat mund të shfrytëzohen për këto destinime zhvillimore.

Themelimi i fondit dhe aktivizimi i tij në Kosovë nga Qeveria shihet si një çështje tepër e rëndësishme dhe në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës qysh nga marrja e mandatit para dy vjetëve, edhe pse e vetëdijshme se është një proces mjaft i vështirë dhe sfidues, ka filluar t'i përmbushë të gjitha detyrat për ta aktivizuar sistemin e sigurimeve shëndetësore si komponentë tepër e rëndësishme e shëndetësisë në Kosovë.

Kemi bërë përpjekje që të fillojmë me sigurime shëndetësore në fillim të këtij viti, qoftë edhe me një skemë fillestare të thjeshtë, e kemi përfunduar pjesën kryesore të përgatitjeve, por kemi vlerësuar se lipset edhe pak kohë në mënyrë që përgatitjet të jenë sa më të kompletuara. Ligji për sigurimet shëndetësore parasheh që Ministria e Shëndetësisë me akt nënligjor e përcakton datën e fillimit të mbledhjes së premiumëve për fond. Ministria i ka propozuar Qeverisë marrjen e vendimit për fillimin e mbledhjes së premiumëve dhe Qeveria, më 10 gusht vitit të kaluar, ka marrë vendim për fillimin e mbledhjes së premiumëve për sigurimet shëndetësore të obligueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës nga 1 janari i këtij viti.

Ju informoj se në mbledhjen e Qeverisë, datë 23 dhjetor 2016, kemi bërë një vlerësim të gjithanshëm të përgatitjeve për fillimin e mbledhjes së premiumëve. Kemi konstatuar se pjesa më e madhe e punëve janë kryer dhe janë përmbushur shumica e kushteve të parapara me ligj, por duke pasur parasysh edhe konsultimet me partnerët e jashtëm të kyçur në këtë fushë kemi vlerësuar se është e dobishme që të zgjatet afati edhe për gjashtë muaj për mbledhjen e premiumëve. Prandaj, është marrë vendimi dhe është caktuar data 1 korrik 2017 për fillimin e mbledhjes së tyre.

Sugjerimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë kanë qenë dhe janë se sektori i shëndetësisë në Kosovë ka nevojë për ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm të financimit dhe të menaxhimit. Orientimi dhe angazhimi ynë sa i përket sektorit të shëndetësisë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë vetëm rritja e buxhetit për shëndetësi, por edhe që buxheti të menaxhohet me një kosto-efektivitet dhe efikasitet më të mirë, duke i përfillur parimet e transparencës, të kontrollit dhe të llogaridhënies.

Ne i kemi bashkërenditur aktivitetet dhe vlerësimet tona me partnerët tanë, siç janë: Banka Botërore, Ambasada zvicerane, Luksemburgu, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe, po ashtu, i kemi ndërlidhur të gjitha këto edhe me Ministrinë e Financave dhe me asociacionet e biznesit.

Banka Botërore ka bërë vlerësimin e gjendjes dhe ka dhënë rekomandime të caktuara, ndaj të cilave ne jemi sjellë me respekt të plotë.

Ju informoj se muajt e fundit të vitit 2016, unë si kryeministër, me qëllim të koordinimit, të bashkëpunimit ndërministror për mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë, kam organizuar dhe zhvilluar disa takime me ministrat që involvohen në çështjet e funksionalizimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore edhe me praninë e partnerëve ndërkombëtarë, me ministrin e Financave, ministrin e Punëve të Brendshme, ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministrin e Administratës Publike, drejtorin e Administratës Tatimore, pastaj me Bankën Botërore, me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, me përfaqësuesit e Luksemburgut dhe me ambasadorin zviceran.

E kemi vlerësuar së bashku gjithë nivelin e përgatitjeve teknike dhe legale për funksionalizimin e fondit dhe mundësitë e mbledhjes së premiumeve. Kemi marrë rekomandime nga partnerët ndërkombëtarë se është mirë që përgatitjet të bëhen në drejtim të asaj që të sigurohen kushtet që koha prej fillimit të mbledhjes së premiumeve deri te shfrytëzimi i tyre në destinim të jetë sa më e shkurtër, përkatësisht të mos jetë më e gjatë se tre muaj.

Ministria e Shëndetësisë ka punuar me dikasterët e tjerë të Qeverisë me një plan konkret të veprimit. Me planin e veprimit të Ministrisë së Shëndetësisë është punuar në këto fusha: në ngritjen e kapaciteteve të financimit shëndetësor, në fushën e legjislacionit, në sistemin e informimit të fondit, në definimin e skemave të përfitimeve të barnave jashtëspitalore, në definimin e pagesave për kapitacion sipas performansës dhe në komunikimin publik dhe në transparencë.

Sa i përket lartësisë së pagesave me ligj është paraparë që pagesat për fondin të ndahen në mënyrë proporcionale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, përkatësisht kjo lartësi prej 7%, që llogaritet në të ardhurat bruto, prej të cilave 3,5% i paguajnë punëmarrësit dhe 3,5% punëdhënësit.

Qeveria më vonë do të vendosë për lartësitë, varësisht prej nivelit të shërbimeve shëndetësore, të cilat do të përballohen nga fondi, ashtu siç është përcaktuar me ligj. Përgatitjet tjera janë të natyrës teknike, që përfshihen në kompletimin e sistemit informativ shëndetësor, kompletimin e kuadrit për fondin shëndetësor dhe sigurimin e ambienteve për punë të fondit. Sa i përket sistemit informativ të shëndetësisë, ministri Rrahmani do të japë më shumë informacione më vonë kur ta marrë fjalën, por më lejoni të theksoj se me strategjinë e sistemit informativ shëndetësor për periudhën 2010-20120, e cila ka pasuar pas studimit të fizibilitetit nga BE-ja, kompletimi i këtij sistemi është buxhetuar me 17 milionë euro. Deri më tani janë investuar rreth 6 milionë euro, prej të cilave afro 3 milionë euro nga Luksemburgu dhe 3 milionë euro nga ministria, përkatësisht nga Buxheti i Kosovës.

Deri më tani sistemi informativ shëndetësor është kompletuar në Prishtinë, në Prizren, duke përfshirë edhe Spitalin e Prizrenit, në regjionin e Prizrenit përfshirë Suharekën, Rahovecin, Malishevën, Dragashin dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Tani ministria po punon shtrirjen e rrjetit edhe në komunat tjerë dhe në kompletimin e të rrjeteve edhe në komunat tjera.

Gjithashtu, procesi i informimit të popullatës në lidhje me fillimin e mbledhjes së premieeve dhe të përfitimeve, si dhe sqarimeve tjera shoqëruese, të cilin proces informues e kemi vlerësuar me rëndësi më të madhe, ka filluar në fund të vitit të kaluar dhe do ta vazhdojmë deri tek aktivizimi i fondit.

Si përfundim, analizimi i rrethanave si dhe të gjitha rekomandimeve nga partnerët dhe ekspertët e brendshëm dhe ndërkombëtarë, të cilët i ceka më lart, si dhe të asociacioneve të bizneseve dhe odave ekonomike vendore dhe tjera, kanë qenë arsyt, të cilat kanë rezultuar me faktin se procesi për mbledhjen e premieeve është caktuar të fillojë nga data 1 korrik 2017.

Unë jam i bindur se ministria deri atëherë duhet t'i përmbushë të gjitha punët. Shpreh po ashtu qëndrimin e Qeverisë se ministria i ka pasur të përmbushura obligimet themelore dhe në fund të vitit të kaluar dhe kemi mundur të fillojmë edhe më 1 janar të këtij viti, por kemi vlerësuar se përgatitjet më të mëdha do të ndikonin që efikasiteti i fondit të jetë më i madh. Unë vlerësoj se agjenda që kjo të fillojë nga 1 korriku është agjendë reale dhe është normale për të filluar një proces shumë i rëndësishëm i shëndetësisë së Kosovës.

Sa i përket ndryshimeve në krye të fondit, për të cilat foli zoti Ymeri këtu dhe i adresoi tek unë, unë mund të them se si kryeministër nuk kam vendosur për to, sepse nuk kanë qenë në kompetencën time, janë çështje të ministrisë. Si Qeveri, ne do të vendosim në momentin kur të na vijnë propozimet sipas procedurës ligjore për caktimin e drejtuesve të fondit dhe do t'i respektojmë të gjitha kriteret që në krye të fondit të vijnë njerëzit, të cilët kanë përgatitje dhe të cilët në mënyrë efikase do ta drejtojnë fondin në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Tani vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje zoti kryeministër, ministra,

Kolege dhe kolegë,

Shëndetësia është një lëmi me interes të veçantë për qytetarët e Kosovës. Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi i kushteve për t'u mjekuar është e drejta themelore e njeriut, ajo është edhe ndër të drejtat dhe përparësitë që i jep edhe Qeveria në këtë mandat, duke e konsideruar një prej pesë përparësive të qeverisjes.

Ky sektor është ndër sektorët që kërkon buxhet, kërkon investime dhe vëmendje. Për kokë të banorëve, Kosova e ndan një buxhet mjaftë të varfër dhe numërohet ndër vendet që ka buxhet më të varfër ndër të gjitha vendet e regjionit. Kërkon edhe përgatitje profesionale të duhur të punëtorëve shëndetësorë krahas përcjelljes së zhvillimit kësaj fushe të të arriturave në botë dhe në kohë të duhur sigurisht që këto të arritura të përcillen edhe në shërbimet tona, në mënyrë që mjekimi të jetë i duhur për qytetarët dhe të ofrohet shërbim në nivel të lartë dhe fondet e Kosovës të mos shpërndahen në fondet e vendeve të tjera, por me ato të mund të ofrohet një shërbim i mirë këtu dhe një shërbim i saktë.

A ka ndodhur kështu gjatë kësaj kohe? Jo, pikërisht shëndetësia e rrënuar nga një sistem pushtues dhe shëndetësia e masakruar gjatë luftës nuk u mëkëmb asnjëherë gjatë kësaj periudhe të pasluftës. Kjo fushë mbeti e çalë dhe shumë defekte, pa një vëmendje të merituar nga qeverisjet në rend, pa buxhet të mjaftueshëm dhe nuk mundësoi përmirësimin e rrethanave dhe të kushteve për punë, por në rend të parë për vetë mjekimin e qytetarëve, ofrimin e shërbimeve.

Pati edhe një varg eksperimentimesh në këtë lëmi, e që sollën defekte të ndryshme në vetëmenaxhimin e shëndetësisë. Më në fund, para sa kohe u nxor Ligji i shëndetësisë dhe nisën reformat në këtë fushë, nga ku dolën dhe obligimet për sigurimin shëndetësor të qytetarëve tanë si një e drejtë themelore për të pasur sigurime shëndetësore, duke e themeluar dhe Fondin për Sigurimin Shëndetësor, ku do të participonte shteti, në rend të parë, për kategoritë e shumta të caktuara dhe qytetarët e punëdhënësit me 7%, përkatësisht 3,5 + 3,5.

Pas një pune të gjatë dhe angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë për përgatitjen mbledhjes dhe premimit se ajo do të realizojë këtë duke filluar nga janari i vitit 2017, pra do të formojë Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe ndarjes së buxhetit nga Qeveria, Qeveria vendosi në fund të vitit që ta shtyjë këtë datë për gjashtë muaj, pasi që nuk janë plotësuar kushtet paraprake për zbatimin e sigurimit shëndetësor, sipas neni 38 të dispozitave kalimtare, ku kërkohen parakushte para se të fillojë mbledhja e premimeve.

Edhe si Komision për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, por në rend të parë si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kemi debatuar shumë herë për mundësitë, rrethanat dhe përgatitjen institucionale dhe me kohë, kur duhet të fillojë mbledhja e premimeve, por edhe për mundësitë që i ofron biznesi dhe çka mund t'u ofrojmë qytetarëve, shërbimet që mund të ofrojë vetë shëndetësia, punëtorët shëndetësorë.

Gjithë nxjerrjen e statutit për fondin shëndetësor, nxjerrjen e Rregullores për menaxhimin e fondit, për kushtet e punës së këtij fondi, pastaj nënshkrimin e memorandumit për pagesat e sigurimit shëndetësor, fletëpagesat për shpërndarjen e tyre, për informimin e qytetarëve për sigurimin shëndetësor nga ana e ministrisë, si dhe nxjerrjen e draft-çmimoreve finale për shërbimet, e cila tani ndodhet në diskutim në institucionet shëndetësore, përmbledhjen dhe

vërejtjet finale para aprovimit të kësaj marrëveshjeje. Atëherë, pati shumë dilema se a mund të sigurohen shërbime krahas premiumeve, që do të mbledhen sipas nevojave të qytetarëve, pastaj edhe krahas kapaciteteve dhe dilema kryesore ishte se a do të dëmtohen bizneset, a do të kenë fuqi fondet familjare ta paguajnë këtë premium, e tjera, e tjera...

Pati vërejtje se vërejtjet kryesore erdhën nga bizneset, nga Oda e Bizneseve, ekonomia në përgjithësi, e cila kërkoi që të shtyhet data e mbledhjes së premiumeve. Pas një komunikimi dhe informimit bizneset kërkuan dhe Qeveria, normalisht, u pajtua që të kemi një informim të përmuajshëm të përcjelljes së progresit e zhvillimit ekonomik në ven, të përcillet pra për këtë kohë, këtë periudhë që u mor parasysh, të përcillen se sa mund ta përcjellin ato dhe sa të investojnë në fonde.

Sigurisht, se Qeveria do të angazhohet dhe ta përcjellë edhe buxhetin familjar, sepse jo vetëm bizneset që e mbajnë këtë barrë, por edhe buxheti familjar.

Krahas kësaj, secili qytetar duhet ta dijë dhe të informohet saktësisht, se çka do të përfitojë nga sigurimet shëndetësore dhe kjo nuk mjaftoi deri tani, sepse qytetarët pamjaftueshëm janë njoftuar, pas fillimit të mbledhjes së premiumeve, se çka do të fitojnë ata.

Për të qenë funksional, fondi së pari duhet t'i plotësojë kërkesat e qytetarëve, fondit i duhet kohë në rend të parë t'ia nisë punës, mbledhjen e premiumeve. Ne kemi trashëguar një sistem të sigurimit shëndetësor, nuk trashëguam një sistem të sigurimeve shëndetësore dhe kjo lindja e fondit po ndodhë me vështirësi. Këso vështirësish kanë edhe vendet që nuk patën luftë, ose kanë punësim të lartë dhe ekonomi të zhvilluar. Ka vende që pas themelimit të fondit shëndetësor mendojnë edhe për mbylljen e tyre, për ta mbrojtur ekonominë e në rend të parë, për ta mbrojtur vetë qytetarin dhe vetë shtetet, pra qeveritë marrin përgjegjësinë e fondeve të sigurimeve shëndetësore.

Andaj, pa nisur nuk ka fond, por as kushte për përmirësimin e punës së punëtorëve shëndetësor në shëndetësi e në rend të parë, pra nuk ka shërbime dhe mjekim adekuat.

Ne përkrahim Qeverinë duke shpresuar, se në ndërkohë do të plotësohen këto kushte e në rend të parë sistemi i IT-së, çmimorja, do të njihemi pra me çmimoren, e cila ende s'është përgatitur saktësisht, do të bëhet punësimi i ekspertëve në këtë lëmë, do të bëhet informimi më i mirë i vetë qytetarëve, po edhe i bizneseve.

Gjatë këtyre muajve si grup parlamentar dhe Komision për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, do ta përcjellim hap pas hapi dhe do të kontribuojmë me vërejtjet tona, do të angazhohemi për mbledhjen e premiumeve, që të fillojë sa më parë krahas përmirësimit të kushteve të tjera, që duhet të ofrohen për këtë shërbim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i gatshëm për harmonizimin e rekomandimeve, qoftë edhe rezolutës, nuk e di çfarë keni menduar, ose çfarë do të vendosim si përfundim të mbledhjes dhe të japim kontributin tonë me vërejtjet që do t'i japim së bashku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Hatim Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar i Parlamentit!

I nderuar zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht, dua të falënderoj zotin kryeministër për një ekspozitë të thuktë, por përmbajtjesor, të hollësishëm dhe të argumentuar, për punën që po bën Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë në drejtim të funksionalizimit të fondeve të sigurimeve shëndetësore.

Grupi Parlamentar i LDK-së gjendjen aktuale, në të cilën ndodhet shëndetësia e Kosovës, e sheh të palakmueshme dhe njëherësh si problem shumë të rëndësishëm për gjithë shoqërinë kosovare. Prandaj, në këtë drejtim LDK-ja e vlerëson angazhimin e Qeverisë dhe punën që bën në këtë drejtim drejt funksionalizimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Duke u nisur nga kjo premisë, LDK-ja nuk ka asgjë kundër debateve dhe interpelancave në Kuvendin e Kosovës për këto çështje, po që se ato janë konstruktive dhe me të vetmin qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Kosovës. Por, LDK-ja është kundër politizimeve dhe përdorimit të kësaj çështjeje për nevoja propagandistike dhe elektorale, të cilat kanë për qëllim vetëm të bëjnë zhurmë në Parlament, duke shkaktuar huti te qytetarët dhe nuk i ndihmojnë aspak çështjes, për të cilën është thirrur kjo interpelancë.

Ne duam të besojmë, se kjo interpelancë është thirrur për të adresuar një çështje shumë të rëndësishme për shëndetësinë kosovare dhe qytetarët e Kosovës, siç janë sigurimet shëndetësore, prandaj i ftoj të gjithë deputetët që diskutimet e veta t'i përqendrojnë në këtë problem dhe t'i vënë në pah se cilat janë problemet, cilat janë përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë, po edhe të Qeverisë, nëse ato ekzistojnë, lidhur me vonimin e implementimit të Ligjit për sigurime shëndetësore dhe funksionimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Dhe, për problemet tjera shëndetësore ne mund të organizojmë debate kur të duam dhe sa herë të duam.

Nëse do t'i përmbahemi këtij parimi, mendoj se kjo seancë do të prodhojë edhe rezultatet e veta. Në të kundërtën, nëse fillojmë të diskutojmë pa argumente edhe me argumente, për problemet e shumta të shëndetësisë, të cilat e pranojmë se ekzistojnë, dhe të cilat pajtohem se janë të shumta

dhe kërkojnë zgjidhje, por të cilat nuk lidhen fare me temën për të cilën është thirrur kjo interpelancë, efektet e interpelancës do të jenë kurrfarë.

LDK-ja themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore e sheh si një domosdoshmëri për përmirësimin e shërbimit shëndetësor për qytetarët e Kosovës dhe beson se themelimi i tij do të sigurojë një financim më të sigurt për këto shërbime, do të sigurojë një barazi të qytetarëve për qasje në shërbimet shëndetësore, do të sigurojë shërbime shëndetësore më cilësore dhe do t'i zvogëlojë harxhimet financiare të qytetarëve, nga xhepat e tyre, për shërbimet shëndetësore dhe do të zvogëlojë varfërimin e tyre të mëtejshëm.

Sigurisht se këto efekte nuk mund të priten prej ditës së parë të themelimit të fondit dhe kjo kërkon kohë dhe kjo është një qëllim, të cilin Fondi i Sigurimeve Shëndetësore do ta arrijë për një periudhë më të gjatë kohore.

Duke u bazuar në atë që u tha më lart, LDK-ja është e pakënaqur për vonesat në implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe themelimin e fondit të sigurimeve, por njëkohësisht është e vetëdijshme edhe për problemet dhe vështirësitë e mëdha, që janë në këtë proces.

Ne duhet të kemi parasysh se sa u përket sigurimeve shëndetësore, Republika e Kosovës nuk ka trashëguar asgjë nga kapacitetet infrastrukturore të objekteve, infrastrukturës teknike dhe teknologjike, nuk ka trashëguar asnjë kapacitet financiar të fondit, nuk ka pasur asnjë bazë ligjore. Nuk e them këtë dhe nuk dua të amnistoj Ministrinë e Shëndetësisë, as Qeverinë, për vonesat, por nëse duhet të jemi korrektë me vetveten dhe me qytetarët e Kosovës, këto fakte padyshim duhet t'i përmendim dhe t'i kemi parasysh.

Themelimi dhe funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore është një proces, i cili nuk lidhet vetëm me Ministrinë e Shëndetësisë, edhe pse barra kryesore bie mbi të. Në këtë proces kërkohet një bashkëpunim dhe bashkëveprim i shumë dikastereve dhe ministrive, agjencive të tjera, siç janë: Ministria e Financave; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Administratës Publike; Administrata Tatimore Kosovës; Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia për Sigurimin e të Dhënave Civile.

Për këtë arsye është dashur një punë e madhe për bashkëveprim, bashkëpunim, me të gjitha këto dikastere, punë e cila shumë herë paraqet pengesa edhe ligjore, ndonjëherë edhe burokratike, por të cilat vonojnë këtë proces.

Në bazë të planit të veprimit, që ka bërë Ministria e Shëndetësisë, mund ta shohim se disa nga këto punë janë kryer dhe disa janë në proces. Zotimi i Ministrisë së Shëndetësisë është, se shumica prej tyre do të kryhen deri në qershor të vitit 2017. Po ashtu, ministria ka bërë shumë

punë në krijimin e infrastrukturës, qoftë asaj hapësinore, qoftë ligjore dhe të plotësimit të kapaciteteve humane dhe profesionale të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Këto të dhëna nuk kanë qenë të fshehta, kanë qenë publike dhe ka mundur t'i ketë secili deputet përmes pyetjeve parlamentare për ministrin e Shëndetësisë, përmes ueb-faqes dhe nga informatat, që do t'i kërkonin nga përfaqësuesit e tyre në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ku në vazhdimësi janë mbajtur takime dhe seanca dëgjimore me ministrin e Shëndetësisë dhe takime të komisionit me ministrin e Shëndetësisë. Prandaj, puna jonë si deputetë dhe si Parlament është që të bëhen trysni të vazhdueshme, të kërkojmë transparencë dhe llogaridhënie, që këto punë të kryhen sipas afateve të parapara me planin e veprimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Mendoj se këtë mund dhe duhet ta bëjmë, shumë më shumë, ne si deputetë. Dua t'ua kujtoj deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës, se ministria ka bërë shumë punë edhe në përgatitjen e kriterëve të nevojshme, të cilat parashihen sipas nenit 12, paragrafit 1 dhe nenit 30 të dispozitave kalimtare, për të cilat sigurisht që ministri për Shëndetësi do të flasë më shumë, por të cilat mund t'i gjejë çdokush në planin e veprimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Këto kriterë, siç janë: formimi i listave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, së bashku me deklaratën financiare; çmimoren për shërbimet shëndetësore; listën e pakos bazike të shërbimeve shëndetësore; listën e barnave të rimbursuara nga lista esenciale e barnave, të cilat janë në shqyrtim dhe në diskutim publik në SHSUK dhe në Shëndetin primar të shëndetësisë.

Po ashtu, një prej kriterëve që duhet të plotësohet për fillimin e sigurimeve, për fillimin e mbledhjes së premiumëve, është edhe kriteri i pajisjes me kartelë të sigurimit, ose me një mjet tjetër verifikimi të më shumë se përafërsisht 70% të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, si dhe publiko-privat.

Kjo çështje, më mirë do ta shpjegojë edhe ministri, është zgjidhur me numrin e identitetit, numrin personal dhe në këtë mënyrë është shkurtuar edhe mënyra e sigurimit, kriteri teknik, dhe janë zvogëluar harxhimet e qytetarëve për ta siguruar një kartelë të tillë.

Të nderuar deputetë,

Problemi i mosfunksionalizimit të SISH-it është një problem që na shqetëson të gjithë neve, por duhet të kemi parasysh se ky është një proces i gjatë, proces i cili kërkon disa module dhe i cili me strategjinë sektoriale është paraparë të përfundojë diku në vitin 2020, e dihet shuma e cila është kërkuar dhe është ndarë deri më tani.

Mirëpo, sipas deklaratave të ministrit, mosfunksionimi i sistemit informativ shëndetësor nuk pengon fillimin e mbledhjes së premiumëve, sepse Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i

Sigurimeve Shëndetësore ka sistemin e informimit të fondit, i cili është në testim dhe i cili do të jetë i gatshëm në momentin e duhur.

Të nderuar deputetë,

LDK-ja është e vendosur të bëjë tryshinë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë e Kosovës për t'i përshpejtuar punët për përgatitjen sa më të mirë dhe të kryhen të gjitha punët e mbetura. Për këtë do të jemi konsekuentë dhe gjithnjë do të kërkojmë edhe informata shtesë nga përfaqësuesit tanë në Komisionin për Shëndetësi.

LDK-ja përkrah dhe përshëndet vendimin e Qeverisë dhe të kryeministrit për shtyrjen e afatit të mbledhjeve të premiumeve, me të vetmin qëllim që ky fond të jetë sa më i përgatitur për fillimin e mbledhjes së premiumeve, të jetë sa më i mirë.

Ne jemi të vetëdijshëm se fondi nuk mund t'i plotësojë të gjitha pritjet e qytetarëve dhe të institucioneve shëndetësore dhe duke pasur parasysh kapacitetet buxhetore, humane, profesionale dhe të infrastrukturës tjetër, por puna, jemi të bindur, duhet të fillojë.

Ne e dimë se edhe shumë shtete të zhvilluara, të cilat kanë fonde të fuqishme të sigurimeve shëndetësore, kanë probleme të shumta dhe çdo ditë azhurnojnë listën e shërbimeve, të cilat u ofrojnë qytetarëve dhe listën e barnave.

Për fund, ftoj të gjithë deputetët që të japin kontributin e tyre konstruktiv, në mënyrë që edhe Kosova më në fund të ketë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Pas vitit 1999 për arsye të shumta sistemi shëndetësor në Kosovë pa ndërprerë është gjuajtur nga një model organizimi në tjetrin, pa u lënë bartësve të procesit kohë të mjaftueshme për përshtatje në modelin e ri.

Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për mbrojtje shëndetësore, kjo e drejtë akoma u mohohet qytetarëve të Republikës së Kosovës për shkak të keqmenaxhimit të qëllimshëm në sektorin publik shëndetësor.

Si pasojë, shumica e qytetarëve nuk po mund të marrin shumicën e shërbimeve në këtë sektor, e në anën tjetër, e kanë të pamundshme marrjen e këtyre shërbimeve në sektorin privat, pasi që vetëm më pak se 5% e qytetarëve kanë sigurime private, apo këtë nuk ua lejon xhepi për një gjë të tillë.

Gjatë 18 vjetëve as edhe një herë nuk është bërë një përpjekje serioze e matur, e bazuar në situatën në terren dhe analizave shkencore për t'u funksionalizuar Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Qysh në vitin 2004, kur Ligji i atëhershëm për shëndetësi obligonte Qeverinë për të filluar me aplikimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore, nga 2005 e deri më sot Fondi i Sigurimit Shëndetësor është shfrytëzuar vetëm si pjesë e premtimeve megalomane dhe boshe të qeverive të pasluftës. E gjithë kjo në kurriz të qytetarëve, të cilët edhe pas 18 vjetëve vazhdojnë të përballen me të njëjtat probleme me këtë sektor vital.

Për të qenë akoma më tragjike kjo situatë, të gjitha iniciativat që janë ndërmarrë deri më tani, koha ka treguar se kanë qenë vetëm iniciativa korruptive për interesa të ngushta klanore dhe partiake. Të gjitha këto e kanë shkallmuar sistemin informativ shëndetësor, kur tani më është e qartë se edhe pas investimeve milionëshe nga buxheti i Kosovës dhe buxheti i donatorëve, ky sistem akoma është në fazën embrionale. Kurse të gjithë e dimë se pa një sistem informativ-shëndetësor të funksionalizuar dhe të shtrirë në tërë territorin e Kosovës, në të gjitha nivelet e shëndetësisë, fillimi i mbledhjes së premiumeve apo tendenca për të funksionalizuar Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, pavarësisht se çfarë thotë ministri, është vetëm aventurë e radhës, e cila prapë do t'i kushtojë shtrenjtë buxhetit të Kosovës, e rrjedhimisht edhe xhepit të qytetarëve.

Të nderuar deputetë,

Në fillim të mandatit të tij ministri Rrahmani e tha një të vërtetë se nuk mund të ketë sigurime shëndetësore në vitin 2015, siç pati premtuar së koti paraardhësi i tij, zoti Agani. Por, fatkeqësisht, në vend se të vazhdojë me të vërtetë të tjera, si duket edhe ministri aktual ka rënë në kurthin e interesave klanore të lartpërmendura.

Pse po e them këtë? Ministri Rrahmani në një moment nuk tregoi vendosmëri, guxim dhe vullnet politik të kërkojë sqarim për ngecjen e sistemit informativ shëndetësor, si dhe të kërkojë hetim për milionat e shkuara kot në këtë drejtim.

Ministri Rrahmani, në vend që të fillojë me një analizë e punë serioze për funksionalizimin e sistemit informativ shëndetësor, do të na hedhë hi syve se sistemi informativ shëndetësor dhe Fondi i Sigurimeve jodomosdoshmërisht janë të lidhura ngushtë, kur të gjithë e dimë se kjo nuk është e vërtetë.

Ministri Rrahmani, ashtu si ministri Agani, i cili brengën kryesore e kishte të mbahej mend me Ligjin për sigurime shëndetësore, pa llogaritur pasojat e një ligji të pamenduar mirë. Edhe ky do të mbahet në mend me fillimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore pa përfillur situatën në terren, duke rrezikuar t'i shkaktojë dëme të pariparueshme konceptit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Qeveritë PDK-LDK deklarativisht mund të kenë radhitur si prioritet shëndetësinë, por edhe pas 18 vjetëve është e qartë se qeveritë e ndryshme që e kanë qeverisur vendin kanë treguar një mungesë të vullnetit politik për funksionimin dhe reformim të sistemit shëndetësor, gjë që ka bërë që sot të gjendemi përballë këtij realiteti të hidhur në këtë sektor.

Sektori publik sot gjendet para kolapsit për shkak të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit, fenomeneve që kanë përmbysur administratën publike në tërësi, e natyrisht, se e kanë rënduar edhe shëndetësinë.

Gjithë këto vite ka pasur një përkeqësim të vazhdueshëm të statusit dhe dinjitetit të personelit shëndetësor, si mungesa e kushteve elementare për punë, mungesa e mjeteve dhe e barnave, prodhimi enorm i skandaleve, afëra korruptive, emërimet e shkarkime politike të njëpasnjëshme, gjë që ka bërë që ky profesion të shndërrohet nga një profesion i dëshiruar, në një profesion të përbuzur.

Gjithë këto vite ka munguar një strategji e mirëfilltë afatmesme apo afatgjate për zhvillimin e shëndetësisë dhe kur ka pasur dokumente të tilla, ato janë ndryshuar vazhdimisht pa kurrfarë vijimësie.

Edhe sot kur po flasim, nuk ka një mekanizëm institucional që të kontrollojë përgjegjësinë dhe dhënien e shërbimit shëndetësor.

Së fundi, mungon një politikë e mirëfilltë për sigurimin e investimeve nga jashtë dhe donacioneve, të cilat, edhe pse nuk kanë munguar, janë shfrytëzuar keq dhe në mënyrë aspak racionale.

Nuk mjafton vetëm miratimi i ligjeve apo vendimi për mbledhjen e premiumeve për të bërë një reformë të sistemit shëndetësor. Sidomos kjo e fundit nuk është as ligjore. Për ata që mendojnë se në këtë sektor ka vetëm defekte të pjesshme dhe të cilat mund të korrigjohen me ndryshime ligjore, vendime apo deklarata, për ne kjo konsiderohet si mungesë e seriozitetit dhe si tolerim të fenomeneve abuzive që kanë për rezultat përfundimtar rrezikimin e jetës së qytetarëve.

Kryeministri në paraqitjen e tij tha se mbledhja e premiumeve do të fillojë në mes të muajit gusht, mirëpo unë e kam një pyetje për kryeministrin: Si do të fillojë mbledhja e premiumeve apo implementimi i Ligjit për sigurime shëndetësor, kur në nenin 15 të Ligjit për sigurime

shëndetësore decidivisht thuhet se “shërbimet e kujdesit themelor shëndetësor ofrohen nga institucionet e licencuara shëndetësore, publike, publiko-private dhe private, me të cilët fondi ka lidhur kontratë”.

Si mund të lidhë fondi kontratë kur e dimë se asnjë institucion shëndetësor publik në vendin tonë nuk është i licencuar.

Prandaj, kam pyetje: A do ta shkelni ligjin dhe do të filloni së implementuari Ligjin për sigurime shëndetësore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së fjalën e merr zoti Ali Berisha.

ALI BERISHA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Sigurimet shëndetësore e përbëjnë një bazë të rëndësishme të sistemit shëndetësor dhe zgjidhje të shumë problemeve që e rëndojnë shëndetësinë.

Ato jo vetëm se e rritin vlerën e përgjithshme të mjeteve financiare, por edhe vendosin rregulla në sistem dhe rrisin kualitetin e shërbimeve shëndetësore.

Bazuar në këtë aspekt, populli i Kosovës është në pritje që shumë vjet për fillimin e zbatimit të një sistemi të sigurimeve shëndetësore që do të rriste kualitetin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Gjithmonë partitë e ndryshme politike kanë proklamuar në fushata të ndryshme që sigurimet shëndetësore do të jenë prioritet i tyre në qeverisje. Qeveria aktuale ka propaganduar se do të fillojë me sigurime shëndetësore qysh në vitin e parë të qeverisjes së saj dhe po kalon pothuajse viti i tretë dhe do të hyjmë në vitin e katërt të kësaj qeverisjeje dhe sigurimet shëndetësore as që kanë filluar.

Qeveria dhe ministria duhet të pranojnë se në këtë aspekt kanë dështuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe ministri, edhe pse ka pasur indikacione nga shumë asociacione e shoqata që nuk janë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e zbatimit të sigurimeve shëndetësore, vazhdimisht kanë insistuar se do të fillohet më 1 janar, e kjo doli se nuk filloi. Gjithashtu, tani vazhdimisht deklarohet se do të fillojë më 1 korrik, mirëpo mendoj se nuk janë bërë përgatitjet e duhura që një proces i tillë të fillojë suksesshëm.

Fillimit të zbatimit të sigurimeve shëndetësore duhet t'i paraprijë një përkushtim shumë më i madh, edhe i Qeverisë, edhe i Ministrisë, në mënyrë që ky proces të jetë i suksesshëm.

Janë të domosdoshme disa parakushte që sistemi i sigurimeve shëndetësore të fillojë mirë dhe mbarë. Në radhë të parë, mjetet buxhetore të ndara nga Qeveria për fillimin e zbatimit të sigurimeve shëndetësore duhet të jenë shumë më të mëdha. Shuma e mjeteve që do t'i shtohen financimit të shëndetësisë në këtë fond aktualisht nuk është e madhe. Kosova ndan rreth 150 milionë euro për shëndetësi dhe 30 apo 50 milionë që do t'i sjellë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, mund të sjellin maksimalisht 200 milionë euro për shëndetësi. Kjo bën rreth 100 euro për kokë të banorit, ndarje kjo që Kosovën vazhdon ta mbajë dukshëm prapa vendeve të rajonit. Shqipëria ndan 200 euro për kokë të banorit, Maqedonia ndan 300, Mali i Zi 400, Bosnjë e Hercegovina 500 euro dhe Kroacia 1 000 euro për kokë banori. Për vendet e Bashkimit Evropian të mos flasim, që ndajnë 3 000 deri në 6 000 euro për kokë banori për shëndetësi, kurse Kosova 100 euro. Çka do të thotë kjo, që asnjëherë për Qeverinë e Kosovës prioritet nuk ka qenë shëndetësia.

Mbledhja e premieeve duhet të bëhet krahas ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të kontributdhënësve në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Ligji për sigurime shëndetësore parasheh lidhjen e kontratave me institucione shëndetësore vetëm me ato që janë të licencuara, e botërisht dihet që deri tash institucionet publike shëndetësore nuk janë të licencuara. Dhe, që të kryhet një proces i tillë nevojiten kapacitetet njerëzore, mekanizma dhe kohë.

Lista e shërbimeve themelore shëndetësore ende nuk është e përfunduar. Nuk ka çmimore të shërbimeve shëndetësore dhe nuk është krijuar agjencia i financimit të shëndetësisë. Nuk janë krijuar kapacitetet njerëzore për fillimin e zbatimit të sigurimeve shëndetësore.

Nga Qeveria dhe ministria ky do të duhej të ishte një proces i filluar shumë më herët, pasi që nevojitet kohë për rekrutimin dhe trajnimin e personelit të tillë, në mënyrë që të jenë të gatshëm të hyjnë në funksion në kohën e duhur për zbatimin e një procesi të sigurimeve shëndetësore.

Me gjithë përmirësimet në sistemin e SISH-it, nevojitet ende investim dhe avancim në këtë proces, pasi që pa një SISH të avancuar nuk ka sigurime të mirëfillta shëndetësore.

Të nderuar deputetë,

Bazuar në të gjitha këto mangësi që janë parakusht për fillimin e zbatimit të ligjit për sigurime shëndetësore dhe mangësitë e përkushtimit dhe kohën që nevojitet për këtë, po parakushtet të realizohen, është plotësisht e qartë se qytetarët e Kosovës edhe për një kohë të konsiderueshme

do të jenë të privuar nga një e drejtë e rëndësishme, që është e drejta për sigurime shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha. Fjalën e ka zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Kuvend ka miratuar më 2014 Ligjin për sigurime shëndetësore, ligj që nuk ka filluar të aprovohet dhe pritet që në fillim plotësim-ndryshimet të jenë në proceset e deputetëve.

Po e përmend këtë, pasi qysh në fushatën e vitit 2014, sikur PDK-ja, ashtu edhe LDK-ja kishin premtuar se problemin e sigurimeve shëndetësore do ta kenë prioritet dhe do ta zgjidhin që në fillim të marrjes së mandatit.

Kjo, të nderuar kolegë, jo që ndodhi, por edhe sot vazhdojnë mashtrimet e qytetarëve tanë se sigurimet së shpejti do t’i kenë të gjithë në shërbimet e tyre.

Ne e dimë se duhet kohë fillimisht për t’i siguruar fondet, e që ministri juaj, zoti kryeministër Mustafa, që nga fillimi është lodhur duke dhënë data se kur do të fillojë grumbullimi i premieeve, e që as këtë nuk e ka menaxhuar ashtu siç duhet. Sigurisht nuk e ka pasur dhe nuk e ka idenë se si menaxhohet me këtë sektor që nga momenti i marrjes së postit të ministrit.

Ju zoti Mustafa, por edhe varësit tuaj, për asnjë moment nuk e keni parë të arsyeshme që të merreshit me hallet dhe problematikat e qytetarëve, të krijuara pikërisht nga politikëbërja e keqe juaja, duke përfshirë edhe sistemin e shëndetësisë, po ashtu edhe këtë që sot e kemi temë, sigurimet shëndetësore.

Sistemi shëndetësor në vend është në kolaps, e ju as që e vëreni këtë. Ju as që jeni në dijeni se sa pacientë ngelin nga një derë në tjetër për moskujdes të duhur.

Ju nuk jeni në dijeni se sa pacientë vdesin nga pritja për t’iu mundësuar mjekimi jashtë vendit, kjo për faktin e politikës tuaj burokrate. Por kjo, duhet të theksohet se nuk vlen për ata të cilët nuk janë me LDK-në, nuk janë të afërmit tuaj, nuk kanë interes nga ju. Pra, kjo qasje juaja u kushton me jetë qytetarëve të vendit tonë, duke i lënë ata të presin shumë gjatë për t’iu mundësuar shërimin jashtë vendit, pasi që e dimë që në vendin tonë atë nuk e kanë të mundur.

Ju që nga fillimi keni marrë shembull qeverisjen e PDK-së, ku për asnjë moment nuk punuat për shtetin e për qytetarët, po punuat dhe po vazhdoni të punoni vetëm për interesat e ngushta klanore e partiake.

Pra, kjo është politika e kapjes së çdo segmenti të shtetit të udhëhequr nga ju dhe nga vartësit e dështuar, nga i pari deri tek i fundit dhe kësaj nuk i ka shpëtuar as sektori i shëndetësisë.

Zoti Mustafa, por edhe ministri juaj, çdo herë po ua mohoni këtë të drejtë qytetarëve tanë dhe kjo për faktin se as nuk e kishit idenë se si duhet të funksionojë i tërë procesi, por nuk e keni as vullnetin, sepse për fajin tuaj, por edhe të atyre që e kishin premtuar më herët, sot i tërë sistemi shëndetësor, e që nuk është i vetmi, është në kolaps.

Kusht tjetër duhet ta paguajë për gabimet, dështimet, korrupsionin, keqmenaxhimet tuaja dhe të vartësve tuaj. Normalisht qytetarët, ata pra janë të vetmit që janë të dëmtuar, që janë të lënë anash e të diskriminuar nga një e drejtë elementare që do të duhej ta gëzonte qysh moti çdo qytetar.

Zoti Mustafa, a jeni në dijeni se a ka pasur ndonjëherë ndonjë kampanjë informuese, kampanjë vetëdijesimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për mbledhjen e premieeve. Sepse, po të dalësh sot në shesh dhe t'i pyesësh qytetarët, ata nuk e kanë idenë se çka janë premiumet se si do të mblidhen ato, sepse po e ritheksoj, nuk i keni informuar qytetarët për këtë proces.

Ne kërkojmë nga ju, por edhe nga ministri që sot të na e jepni një datë kur qytetarët tanë mund të kenë në shërbim sigurimin shëndetësor.

Prandaj, po ashtu unë sot e kam edhe një pyetje, zoti Mustafa, por edhe për vartësin tuaj, se kur do të vijë koha që qytetarët e vendit tonë të kenë një shërbim të sigurimit shëndetësor?

Ju lutem, kësaj here, në rast se e keni ndonjë datë apo muaj, të siguron bile që ta realizoni, sepse me këtë qasje tuaj karshi çështjeve të sigurimeve shëndetësore do të ngelim vetëm me fjalë e kurrë nuk do të realizohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka grupe të tjera të paraqitura, “6+” nuk është paraqitur. Atëherë vazhdojmë me diskutimet e deputetëve, fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që kjo seancë do të duhej të ishte jo një interpelancë vetëm për sigurimet shëndetësore, por një debat i gjerë mes deputetëve dhe Qeverisë për gjendjen në tërësi në sektorin e shëndetësisë, në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e saj, nga ai primar, sekondar e deri te niveli terciar.

Në një debat televiziv, i nderuar kryeministër, ministri juaj, Imet Rrahmani, pati deklaruar se situata e rëndë në shëndetësi është perceptcion dhe për këtë perceptcion jashtë vendit shkojnë afro 100 milionë euro për trajtime të pacientëve jashtë vendit.

Tani dua të pyes ministrin e nderuar Rrahmani se vërtet a është perceptcion gjendja e rëndë në shëndetësi, a është realitet? Sepse ata që kanë nevojë të marrin shërbime shëndetësore gjenden e rëndë në shëndetësi e përjetojnë si një realitet të hidhur.

Për përkeqësimin e gjendjes në shëndetësi, e në veçanti për projektin që dështoi në vitin 2015 dhe ndryshimin e atij projekti të financuar nga 'Banka Austriake', e që tani del se vërtet kam pasur arsye në ngritjen e atyre shqetësimeve rreth rritjes së shumës së kredisë dhe formës se si e ka nënshkruar Ministria e Shëndetësisë atë marrëveshje dhe tani rrezikojmë që për shkak të asaj marrëveshjeje ne të paguajmë përveç kredisë, edhe dënime të tjera, sepse Ministria nuk ka arritur të zotojë dhe të aranzhojë gjithë atë që ka qenë e paraparë me kontratë, e në veçanti pas deklaratës së ministrit që përgjegjësia për implementime dhe përgatitjen e hapësirës për implementimin e projektit të kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë invazive ka qenë arsyeja pse është rritur ajo shuma e kredisë për 500 mijë euro dhe tani ne, përveç që e kemi rritur atë për 500 mijë euro, të paguajmë edhe dënime.

Nëse jo për të gjithë ato shkelje, një numër shkeljesh që kanë ndodhur në Ministrinë e Shëndetësisë, atëherë vetëm për mosimplementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore Imet Rrahmani është dashur të shkojë në shtëpi, të shkarkohet.

Në muajin dhjetor ka deklaruar publikisht se implementimin e SISH-it e ka gjetur në 70% të institucioneve publike, apo në 70% të territorit të Kosovës.

Dhe, tani, për tre vjet atë hapësirën që të implementohet në tërësi nuk ka arritur ta implementojë. Kemi pasur një tentativë, një pilotim të implementimit të SISH-it në qershor të vitit 2016 dhe ka dështuar.

Edhe përkundër se për këtë projekt prej vitit 2002 e deri më tani janë shpenzuar mbi 22 milionë euro dhe prapë ky sistem nuk po funksion. Nuk ka sigurime shëndetësore pa implementim të SISH-it, e kam thënë me dhjetëra herë.

Hapi i parë dhe i domosdoshëm që sigurimet shëndetësore të implementohen ka qenë implementimi i SISH-it, pastaj funksionalizimi i AFSH-së, të cilin ministri përgjegjës e ka gjetur me 12 punëtorë dhe nuk ka arritur ta funksionalizojë për tre vjet.

Dhe, në këtë rast, bartja e përgjegjësisë së ministrit Rrahmani do të duhej të jepte dorëheqje dhe ju, i nderuar kryeministër, besoj që keni pasur njerëz profesionistë brenda partisë tuaj për të

udhëhequr këtë sektor, sepse ju e keni përcaktuar prioritet dhe besoj shumë edhe është prioritet i qeverisjes. Por sigurisht që nuk mund të realizohet me njerëz që nuk e kanë zotësinë për të menaxhuar këtë sektor.

Si mund të themi ndryshe kur një vit e gjysmë më herët, kur vetëm kishte afro dy vjet po thuaj se SHSUK punon pa bord, si mund të themi që është prioritet shëndetësia, kur një vit e gjysmë më herët ministri Imet Rrahmani ka deklaruar publikisht që brenda muajit do të kompletohet bordi i SHSUK-së dhe shkuan po thuaj se dy vjet e gjysmë edhe SHSUK është pa bord. Nuk ka arritur një bord prej gjashtë anëtarëve ta kompletojë, edhe të mendohet që do ta implementojë Ligjin për sigurime shëndetësore, as që mund të presim një gjë të tillë.

Gjithashtu, implementimi i Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë është një ngecje tjetër në këtë sektor. Prandaj, e thashë në fillim të diskutimit. se mendoj që shumë më e arsyeshme dhe më e drejtë do të ishte që ne ta kemi një debat më të gjerë për gjendjen në shëndetësi. Sepse mosfunksionimi i sistemit shëndetësor në tërësi krijon këto probleme në zinxhirë, të cilat pastaj i përballë pacienti dhe qytetari ynë për çdo ditë.

Ne ende vazhdojmë, i nderuar kryeministër, të mos e kemi spitalin regional të Prishtinës. E keni deklaruar edhe publikisht në fushatë që është një nga prioritetet tuaja dhe tani në projektbuxhetin e vitit 2017 unë dua t'i përgëzoj dhe t'i uroj qytetarët e Podujevës se do ta kenë spitalin e tyre. Por qytetarët e Prishtinës, të kryeqytetit, të Obiliqit, të Fushë-Kosovës dhe të Lipjanit u pamundësohet mundësia që të kenë shërbime shëndetësore në sektorin sekondar apo ta kenë spitalin rajonal të tyre që do të ndihmonte në shkarkimin e fluksit të pacientëve të cilët vërshojnë për çdo ditë në Qendrën Klinike Universitare.

Prandaj, mendoj që edhe kjo seancë e sotme që do të paraqesë dështimet e Imet Rrahmanit, do të reflektonte jo që ato dështimet të mos reflektojnë te ju, sepse në programin tuaj qeverisës e keni përcaktuar prioritet dhe ai i cili nuk ka mund të ndjekë hapin tuaj për implementimin e këtij prioriteti, atëherë sigurisht se duhet të japë përgjegjësi, nëse jo atë morale, me dorëheqje, atëherë sigurisht përgjegjësia ju takon juve që ta shkarkoni.

Uroj që ministri i ardhshëm i Shëndetësisë t'i ketë kapacitetet edhe vullnetin që të udhëheqë dinjitetshëm me këtë sektor dhe vërtet që ne t'i implementojmë ligjet, të cilat i kemi miratuar. Për jo asgjë tjetër, legjislatura e kaluar, të paktën, ka arritur të krijojë infrastrukturën ligjore që sistemi shëndetësor të rimëkëmbët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!
I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për sigurimet shëndetësore, i miratuar në prill të vitit 2014, i cili ka për qëllim sigurimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative shëndetësore, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësorë dhe sigurimit të mbrojtjes financiare dhe varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha, përkujdesjes shëndetësore nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Ky ligj paraqet një mundësi reale për përmirësimin përmbajtjesor të gjendjes në sektorin shëndetësor në vend, i cili për vite të tëra është lënë pas dore. Pra, nuk ka qenë prioritet i qeverive të mëhershme, e aq më pak i partisë së deputetit Bekim Haxhiu, i cili na vajtoi me lot krokodili.

Me këtë rast, duke falënderuar kryeministri Mustafa, i cili me marrjen e mandatit të tij, në programin e tij qeverisës shëndetësinë e ka paraparë si prioritet të pestë.

Po ashtu vlen të theksohet edhe puna dhe angazhimi i ministrit të Shëndetësisë, zoti Imet Rrahmani, për hapat konkretë që ka ndërmarrë deri më tani për implementimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore, si dhe veprimet konkrete që janë bërë deri më tani si dhe përgatitjet e fundit që po bëhen në fillimin e mbledhjes së premiumeve si dhe funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Të nderuar qytetarë,

Të hyrat e fondit të grumbulluar nga mbledhje e premiumeve si dhe buxheti për shëndetësinë që do të mundësojnë përmirësim të ndjeshëm të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve shëndetësore në vend, duke optimizuar qasjen e kategorive të varfra të qytetarëve në shërbime sa më cilësore shëndetësore dhe, mbi të gjitha, duke siguruar mbrojtje financiare të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës nga shpenzimet e mëdha të trajtimit në rast të sëmundjeve dhe lëndimeve të tyre.

Ne i mirëpresim dhe përkrahim fuqishëm çdo aktivitet që dërgon në drejtim të përmirësimit të gjendjes në sektorin e shëndetësisë kosovare dhe, në kuadër të reformave shëndetësore që po ndodhin, ne konsiderojmë rëndësi vitale që Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të jetë funksional dhe i qëndrueshëm dhe sa më parë që është e mundur, si në aspektin financiar, po ashtu edhe me numër të stafit.

Kërkojmë nga Qeveria që të ndërmarrë hapat e nevojshëm si në plotësimin e infrastrukturës ligjore. Pra, plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për sigurimet shëndetësore si dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm që sa më parë të përmbushet plani i veprimit për themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Dhe, në këtë rast, të arrihet të fillohet në korrik të vitit 2017 me mbledhjen e premieeve dhe, menjëherë, pas tre muajve, të fillohet edhe me shfrytëzimin e tyre, siç e ceku edhe kryeministri.

Dhe, në fund, kërkoj nga Qeveria të përmbushen të gjitha objektivat e mbetura të këtij plani dhe sa më parë të funksionalizohet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe të fillojë mbledhja e premieeve si dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore për qytetarë.

Po ashtu, të shqyrtohet mundësia që në një periudhë sa më të shkurtër qytetarët të kenë mundësi të marrin shërbime nga ky fond dhe t'iu rimbursohen barnat. Pra, të preken të mirat e sigurimit shëndetësor për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit! Veç dua ta falënderoj deputeten Kalludra për dëshirën e saj për replikë. Por, unë besoj, i nderuar kryeministër, edhe ju vetë keni edhe brenda grupit parlamentar profesionistë shëndetësorë dhe nuk do të duhej t'ia lejoni që vërtet për shëndetësinë të diskutojnë ata që nuk marrin vesh në këtë çështje. E më së pakti nuk i kujtohet që i kanë pasur prej partisë së vet dy ministra të Shëndetësisë, zotin Alush Gashi dhe Bujar Bukoshin, Partia Demokratike asnjëherë nuk ka udhëhequr, e respektuar deputete, me këtë sektor, dhe nuk dua ta shikoj shëndetësinë në vija politike dhe partiake, sepse për mua shëndetësia është prioritet nacional dhe si i tillë do të duhej të trajtohej pa ngjyrimë politike, sepse po kalojmë në nivele të tilla politike, atëherë mund të gjejmë vërejtje në gjithsecilën komunë në të gjitha subjektet politike në menaxhimin shëndetësor, sepse është mizori, nuk është në nivelin e duhur dhe këtë e përjetojnë qytetarët për çdo ditë. Ata qajnë për çdo ditë me fatin që e kanë në trajtimin shëndetësor.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kalludra, kundër-replikë!

MIRJETA KALLUDRA: Duke mos dashur ta zgjas diskutimin me deputetin Bekim Haxhiu, mirëpo ne e dimë cili është Bekimi dhe sa janë interesat e tij personale në sektorin e shëndetësisë.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Çaushi.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të pranishëm,

Pa dyshim që shëndetësia dhe sigurimet shëndetësore paraqesin një ndër reformat, në këtë rast, më thelbësore jo vetëm në sistemin tonë shëndetësor, por edhe në gjithë sferën e ofrimit publik të mallrave apo shërbimeve.

Si çdo reformë tjetër, edhe futja e sigurimit shëndetësor me siguri që do të ketë fituesit dhe humbësit e tij. Në anën e humbësve do të jenë gjithmonë ata aktorë, qoftë mjekë, administrues apo tenderues që janë pozicionuar mirë në sistemin ekzistues.

Është e logjikshme që humbësit u rezistojnë reformave dhe, mbase edhe do të rreshtohen të organizuar në kundërshtimin e tyre.

Nisja e mbledhjes së premieeve pa u kujdesur për përgatitjen dhe forcimin e hallkave të tjera të sistemit, pa dyshim se do të përdorëshin me shumë zell nga kundërshtuesit e kalimit në sistemin e ri. Rrjedhimisht do të dëmtohej pa kthyesëm e gjithë reforma, duke shtyrë për shumë vjet riimplementimin dhe rifutjen e sigurimeve shëndetësore.

Kur flasim për hallkat e tjera të sistemit, mendohet kryesisht për strukturën e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, përgatitjen e stafit të fondit, caktimi i pakos bazike, caktimi i çmimeve për njësitë e shërbimeve të përfshira në pako, caktimi i listës së barnave esenciale, negociimet me ofertuesit privatë të shërbimeve mjekësore, mekanizmat për informim të mjaftueshëm të publikut, avancimi dhe centralizimi i sistemit të grumbullimit të informatave shëndetësore.

A disponojnë institucionet shëndetësore kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me sistemin e ri, në mënyrë që pas hyrjes në fuqi të skemës së sigurimeve shëndetësore, të operohet pa vështirësi.

Që nga viti 1999 me sistemin tonë shëndetësor është eksperimentuar në vazhdimësi, por pa pasur mundësi që modeli i ri i adaptuar të testohet plotësisht.

Me që futja e sigurimeve prek secilin prej nesh, mendoj se shumë e rëndësishme që nëpërmjet informimit të vazhdueshëm dhe kualitativ të sigurohet rritja e pranueshmërisë së qytetarëve të sistemit të ri të financimit.

Por shanset për një rritje të pranueshmërisë varen pastaj nga aftësia e Qeverisë që të bindë qytetarët se do t'u afrohen të gjitha shërbimet e përfshira në pako. Të binden kontribuuesit se pas futjes në skemë nuk do të detyrohen të ofrojnë pagesa informale gjatë shfrytëzimit të shërbimeve mjekësore, t'u sqarohet qytetarëve se me gjithë kontributet e paguara, ata prapë do të mbulojnë një pjesë të kostos së shërbimeve në formë të bashkëpagesave.

Të binden ofruesit e shërbimeve që bashkëpunojnë me sistemin e ri dhe të mos minojnë atë në rast se frikësohen mbi efektet që sistemi i ri mund të ketë në të ardhurat e tyre.

Të binden të dyja palët gjithashtu, se fondi do të ketë resurse të mjaftueshme humane për të garantuar një menaxhim të suksesshëm të resurseve. Se Qeveria nuk do të lejojë keqmenaxhimin dhe korrupsionin në radhët e menaxhmentit të fondit dhe ofertuesve të shërbimeve.

Shihet, pra, se në fazën fillestare nevojitet një përkushtim serioz dhe një rol udhëheqës jo vetëm i Ministrisë së Shëndetësisë, por i gjithë spektrit politik të vendit.

Me këtë Qeveri që ka Kosova aktualisht, secili prej këtyre proceseve është tashmë i rrezikuar.

Rritja e pranueshmërisë nga ana e qytetarëve është me rëndësi edhe për faktin se në fillim të implementimit të mënyrës së re të organizimit mund të hasim në rezistencë nga ofruesit e shërbimeve mjekësore.

Mjekët që kanë praktikuar marrjen e pagesave informale mund të rezistojnë trajtimin e të siguruarve, të cilët tani nuk preferojnë ofrimin e ryshfetit.

Këto zhvillime mund të rrisin armiqësinë e qytetarëve kundër sistemit dhe rezistencën e tyre në bashkimin kësaj skeme.

Të fillosh mbledhjen e premiumeve pa e kaluar këtë fazë të informimit dhe rritjes së mbështetjes së qytetarëve, është gabim shumë i madh dhe garanci për dështim të reformës.

Nisur nga rëndësia që ka pranimi i këtyre ndryshimeve nga ana e qytetarëve, do të ishte shumë me rëndësi që të krijohet një perceptim që vetë ligji është përpiluar dhe mbështetet nga të gjithë, fakt ky që nuk është për Ligjin për sigurime shëndetësore që është miratuar më 2014 nga ky Kuvend në legjislaturën e kaluar.

Si në çdo fushë tjetër, parashikimet qeveritare i japin kohë formimit të burimeve njerëzore për një punë të re të specializuar vetëm pak javë. Kjo është për shkak se që në fillim nismat në dukje reformatore nuk e kanë përnjëmend atë qëllim.

Ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore del të jetë një komponent shumë me rëndësi në gjithë procesin e kalimit në sistemin e ri të administrimit. Pra, ofrimit dhe negocimit të shërbimeve shëndetësore.

Kuadrot nuk përgatiten me trajnime dyjavore apo mujore, por kërkon kohë, resurse financiare dhe mbështetje teknike.

Paralelisht me këtë, menaxhmenti e ka të mundshëm ushtrimin e rolit të vet, në fakt e ka vështirë të mundshëm në mungesë të statistikave cilësore shëndetësore, të cilat do të dilnin me saktësi nga sistemi i shumëpërfolur informativ shëndetësor, meqë të njëjtat shërbejnë edhe si pikënisje për çfarëdo dizajnimi të pakos bazike dhe kalkulim të çmimeve për shërbimet e ofruara.

Duke pasur parasysh karakterin e sistemit shëndetësor, gabimet sado të vogla në margjinë, në përcaktimin e këtyre çmimeve mund të rezultojnë vendimtare për suksesin, apo dështimin e gjithë reformës. Jo vetëm i gjithë procesi i dizajnit të pakos dhe caktimit të çmimeve për njësi duhet të jetë i kompletuar para nisjes së grumbullimit të premiumeve, por i gjithë procesi nevojitet të jetë transparent.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është thënë shumë herë se ministria i ka gati çmimoret, por diçka e tillë është ruajtur sikur të paraqiste ndonjë sekret shtetëror, që dëshmon mbi mendësinë e vjetër të menaxhimit me fondet e qytetarëve. Në një vend normal, me një qeveri të përgjegjshme, fushatat informuese, diskutimet publike, debate, shkrimet e seancat parlamentare për këtë çështje do të duhej të ishin me dhjetëra e qindra. Kur u soll në Kuvend Ligji për sigurimin shëndetësor në këtë formë që është sot, Lëvizja “Vetëvendosje” e sqaroi paraprakisht se ai e përmbante një seri gabimesh dhe një seri padrejtësish që çonin në dështimin paraprak të tij.

Kjo sot është tepër e qartë dhe e dukshme për secilin prej nesh besoj. Problemi është se sa kohë duhet të ju presim që ju me këto gabime të qëllimshme që i nëpërkëmbni me njëri-tjetrin, që ta kemi një shtet normal, të drejtë dhe solidar. Unë them që ky është qëndrimi ynë, që kjo kohë është tashmë e kaluar dhe gjithashtu në këtë kuadër përfshihet edhe ky eksperiment i radhës që bëhet me qytetarët e Republikës së Kosovës nëpërmjet një sistemi të dështuar që nga fillimi për sigurimet shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pas vitit ‘99, shëndetësia në Kosovë, sikur edhe sistemet e tjera, ka pësuar kolaps, si në aspektin organizativ, por edhe në atë financiar. Edhe pse reformat e financimit në shëndetësinë në dekadën e fundit kanë qenë dhe vazhdon të jenë prioritet i agjendës së partive në pushtet, sidomos në fushata parazgjedhore, ende deri më sot nuk ka pasur ndryshime në mekanizimin e financimit në shëndetësi. Duke e ditur se shëndetësia është një sektor i rëndësishëm, është dashur të jetë prioritet dhe jo prioritet deklarativ. Kur është pritur që ta sjellin në Kuvend pakoja e ligjeve, si pako e reformës në shëndetësi, në popullatë e të gjithë ne, është mirëpritur me shpresën se diçka e mirë do të ndryshojë për të mirë.

Dhe, tash pas sa viteve e shohim se ajo pako e shpresës ka qenë një kamuflim qeveritar siç po bëhet me të gjitha veprimet, në mënyrë që populli të mbahet me shpresa të rreme se diçka e mirë po ndodh. Ende këto ligje s’po zbatohen në tërësi si ligje për shëndetësi, ndërsa pak a shumë po implementohet Ligji i odave të mjekëve, ndërsa sa për Ligjin për sigurime shëndetësore pa fijen

e turpit nga kryeministri dhe ministri po caktohen datat e fillimit të implementimit, 2015, 2016, 2017. Dhe, ende nuk ka ndonjë sinjal pozitiv që do të fillojë të zbatohet ky ligj.

Vitin në të cilin hymë do të jetë një vit i vështirë për shëndetësinë kosovare dhe për pacientët kosovarë, të cilët po kërkojnë trajtim në institucionet shëndetësore publike, sepse me këto institucione, përpos vullnetit të çeliktë të punëtorëve shëndetësorë për të qenë në shërbim të popullatës nuk ka diçka tjetër të mirë, sepse ju s'po investoni as në infrastrukturë, as në funksionalizim të klinikave, si ajo Kardiokirurgjike, e miliona para janë shpenzuar në klinika private e spitale në vende rajonale. Ju po e merrni guximin dhe po thoni se shëndetësia në Kosovë është falas, por nëse e bëjmë një llogaritje dhe e krahasojmë me vendet e rajonit e më gjerë del se tek ne shëndetësia është më e shtrenjtë, sepse nuk ka barna nga lista esenciale obligative për furnizim të institucioneve dhe normalisht që vetë pacientët detyrohen t'i blejnë nga xhepi i tyre. Mungesë e insulinës, mungesë e vaksinës, mungesë e citostatikëve që ka kosto tmerruese për qytetarët e varfër, e kjo ndodh se ju kur të tenderoni barërat në vend të përzgjedhjes së kompanisë më të lirë, ju e përzgjidhni kompaninë me çmimet më të larta dhe kështu zvarriteni nëpër gjykata, dhe kështu ka mungesa të barnave dhe qytetarët nuk mund ta marrin terapinë me kohë.

Bile shumë qytetarë në pamundësi që t'i blejnë barnat detyrohen ta ndërpresin terapinë, e kjo u kushton me jetë, dhe kush jep përgjegjësi për këtë? Duket që 2017-ta prapë do të jetë një vit i vështirë për shëndetësinë kosovare, do të jetë një vit i vështirë për pacientët kosovarë, të cilët do të kërkojnë trajtim nëpër institucionet publike, sepse prapë kjo Qeveri, përpos premtimeve në letër se do ta ketë prioritet shëndetësinë, në fakt po shihet se shëndetësia nuk është prioritet.

Menaxhmenti i lartë, Ministria e Shëndetësisë, ministri dhe strukturat menaxheriale që punojnë nëpër spitalet rajonale dhe në Qendrën Klinike Universitare po merren vetëm me punësimin e njerëzve, të cilët kanë influencë në partitë e tyre politike dhe në fakt shëndetësia keqmenaxhohet dhe keqkeqveriset nga kjo politikë.

Dhe, kisha disa pyetje: Pse nuk po inicohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për prokurimin publik në Ministrinë e Shëndetësisë për furnizim me barna kur dihet se barërat po blihen me çmime 20 herë më të shtrenjta? A mos ka ndërlidhje me fillimin e implementimit të Ligjit për sigurime shëndetësore, me Ligjin për prokurim, duke marrë parasysh se ju keni planifikuar që me mjetet të grumbulluara nga Fondi për Sigurime Shëndetësore do të blihen fillimisht barëra.

Cili është qëndrimi juaj në raport me luftimin e informalitetit, kur dihet se me fillimin e mbledhjes së premiumeve barrën më të madhe të pagesës do ta kenë bizneset e vogla e të mesme në raport me ekonominë dhe zhvillimin e këtyre bizneseve, që kryesisht janë familjare. A e keni përgatitur çmimoren e shërbimeve shëndetësore që do të ofrohen me pako bazike të mbuluara me

sigurim të obligueshëm, si dhe çmimoren e shërbimeve shëndetësore të mbuluara me sigurim shëndetësor plotësues?

Cili është numri i personave të vetëpunësuar dhe a i keni identifikuar të gjithë qytetarët e liruar nga pagesa dhe të papunësuarit? Çka do të ndodhë me qytetarët, të cilët kanë kontraktuar me kompanitë private të sigurimeve, të cilat operojnë në Kosovë me kontrata afatgjate?

Dhe, në fund, kisha thënë me plot të drejtë, ju e keni kolapsuar shtetin, e të mos flasim për shëndetësinë, e cila është në kolaps total. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka shumë përkufizime të shumta të ndryshme rreth shëndetit, por dua ta theksoj përkufizimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë si një ndër përkufizimet më gjithëpërfshirëse se shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore, dhe jo thjesht mungesë e sëmundjeve apo e pafuqisë fizike të organizmit.

Kurse shëndeti publik është një koncept social dhe politik që synon në përmirësimin e shëndetit, zgjatjen e jetës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës midis gjithë popullatës nëpërmjet promocionit të parandalimit të sëmundjeve dhe formave të tjera të ndërhyrjeve shëndetësore. I citova këto dy përkufizime për të shikuar nga këndvështrimi ynë dhe përditshmëria jonë sot se vërtet në cilën masë është përmbushur objektivi i përgjegjësve të sektorit të shëndetësisë për një popullatë të shëndetshme dhe një sistem shëndetësor, i cili funksionon në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për bindjen time, por edhe të shumë ekspertëve të kësaj fushe, si dhe ankesat e shumta të pacientëve dhe atyre që frekuentojnë nëpër institucione shëndetësore, shihet se gjendja në shëndetësi nuk është në nivelin e dëshirueshëm, do të thotë nuk është shumë e mirë, edhe pse ka disa përmirësime, sidomos në infrastrukturë që kanë krijuar hapësira për zhvillim normal të punës së profesionistëve të shëndetësisë. Në këtë drejtim, në miratimin e fundit të strategjisë për zhvillimin e shëndetësisë në Kosovë, besoj se ministri me ekipin e tij do të angazhohet maksimalisht që të ketë përmirësime të dukshme në këtë fushë.

Është e rëndësishme që ta kemi një lidhje të ngushtë ndërmjet sistemit shëndetësor dhe sistemit të sigurimeve shëndetësore si tërësi e një sistemi, i cili duhet të ofrojë përkujdesje publike shoqërore. Sigurimi shëndetësor është një pjesë jashtëzakonisht e dobishme e jetës së secilit dhe ka si qëllim që ta mbrojë pasurinë tuaj financiar, duke e promovuar shëndetin tuaj. E drejta në

sigurim shëndetësor paraqet një nga të drejtat themelore të njeriut dhe rrjedhimisht është parakusht që njeriu të mund t'i gëzojë shumë të drejta të tjera.

Mungesa e deritanishme e një sistemi të sigurimeve shëndetësore ka shpërfaqur probleme dhe vështirësi për qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore në raport me të drejtat e njeriut në përgjithësi, e veçanërisht efektet ndaj shtresave të caktuara të shoqërisë sonë, si familjet apo personat që jetojnë në asistencë sociale, pensionistët, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës, të cilët janë më të goditurit ngase me trendët aktualë të çmimeve ata nuk arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet e shërbimeve shëndetësore.

Konsideroj se Qeveria e Kosovës duhet ta ketë në prioritet më të lartë sektorin e shëndetësisë me qëllim të investimeve dhe krijimit të kushteve për punë normale dhe paga dinjitoze për punëtorët shëndetësorë, në mënyrë që ta kemi një shëndetësi të avancuar me standarde evropiane, ku pacienti t'i ketë shërbimet shëndetësore më cilësore, që të mos ketë ankesa për listë esenciale të barërave, të definohet qartë dhe të ketë një ndarje ndërmjet shëndetësisë publike dhe asaj private, të ketë transparencë dhe një menaxhim më të mirë dhe në nivelin më të lartë nga përgjegjësit e kësaj fushe, e gjithashtu të ketë llogaridhënie për çdo dështim kudo në institucionet shëndetësore.

I nderuar kryeministër,

Është menduar që 1 janari 2017 është periudha ku do të fillojë s zbatuari Ligji për sigurimet shëndetësore, mirëpo kjo siç po shihet nuk do të ketë mundësi të zbatohet për faktin se dhe për shkak të kërkesave edhe të kompanive private dhe bizneseve edhe për një periudhë, dhe është mirë ta dimë ne dhe qytetarët se kur do të fillojë së zbatuari ky ligj. Kur do të fillojë mbledhja e perimumeve, kur do të jetë funksional Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, kur do të përfundojë së kompletuari Shërbimi Informativ Shëndetësor, në mënyrë që të jetë funksional në sistemin e shëndetësisë në tërësinë e tij? Kryeministri meqë e përmendi datën 1 korrik si datë të mundshme, unë mendoj që kur të ofrohet kjo datë mos do të ndodhë që ta shtyjme afatin edhe për një kohë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Se implementimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore nuk është i rëndësishëm shihet edhe nga mospranim e kryeministrit këtu, që domethënë se ai nuk ka durim as t'i dëgjojë qytetarët, e lëre më që ta fusë në zbatim këtë ligj.

Ligji për sigurimet shëndetësore, edhe pse i votuar në vitin 2014, asnjëherë s'ka filluar së zbatuari, plus tani është në plotësim-ndryshim, një ligj që nuk ka filluar asnjëherë të

implementohet. Por, mosimplementimi i këtij ligji nuk është i rastësishëm, sepse edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, edhe Banka Botërore kanë hezituar dhe nuk kanë besuar në këtë Qeveri që t'u japin fonde për krijimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësore. Kjo për shkakun se domethënë ne kemi keqpërdorim të mjeteve edhe të Agjencisë së Privatizimit, edhe të tenderomania, edhe klanet e ndryshme që veprojnë në Republikën e Kosovës.

Ju ende nuk e keni krijuar platformën me të cilën duhet të krijohet databaza e shënimeve personale qytetare, ku do të mund të identifikohen qytetarët në bazë të emrit, mbiemrit, gjinisë, vendlindjes e tjera. Domethënë, SISH-i në Republikën e Kosovës nuk është funksional edhe pse janë dhënë miliona euro, edhe nga Qeveria e Kosovës, edhe nga fondet e ndryshme që ky të funksionojë, e ne jemi dëshmitarë që SISH-i është ende jofunksional në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu odat e mjekëve janë jofunksionale, e edhe ato e kanë rolin e vetë në implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Ne jemi dëshmitarë të asaj se Bordi i SHSKUK-së është i pakompletuar, domethënë nuk e kemi një bord ose një organizëm që do të merret me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Kjo i bie që kur ka zot shtëpie shumë, përgjegjësia mbetet e askujt. Tani proklamimi i ministrit që do të fillojë implementimi i sigurimit shëndetësor më 1 korrik, që ne nuk besojmë që kjo Qeveri është e gatshme të fillojë, por edhe nëse do të fillojë, qytetarët dëshirojnë të kenë sigurime kualitative dhe të kryhen të gjitha shërbimet, në të kundërtën ne do të ballafaqohemi me probleme të ndryshme.

Derisa me ligj është paraparë sanksionimi për mospërbushjen e obligimit ose mospagesën e premieeve, cilat janë sanksionet për ofruesit e shërbimeve mjekësore nëse nuk ofrojnë shërbime të premtuara me ligj? Ligji për sigurimet shëndetësore është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Republikës së Kosovës, por ne nuk presim që kjo Qeveri do ta implementojë këtë ligj, duke i ditur problemet që ballafaqohemi ne edhe në Qendrën Klinike Universitare, por edhe në spitalet regjionale. Nuk e di se ku do të kryhen ato shërbime, kur të gjitha aparaturat e QKUK-së janë jashtëfunksionale, sidomos te Radiologjia, gjithashtu edhe laboratorët në QKUK, aty nuk kryhen shumica e shërbimeve të analizave laboratorike.

Me ligj është e obliguar që kontrata të lidhet ndërmjet institucioneve të licencuara, e ne jemi dëshmitarë të asaj se shumica e institucioneve publike shëndetësore në Kosovë nuk janë të licencuara, prandaj nuk e di që kjo Qeveri a do ta shkelë ligjin në lidhjen e kontratave, apo si do të veprojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ne sot po diskutojmë për një temë, e cila sigurisht nuk do të ketë ndonjë fund pozitiv për dobinë e qytetarëve, sepse kjo temë duhet të diskutohet në një formacion tjetër dhe në një formë tjetër.

Parashtruesi që e ka paraqitur këtë temë e ka radhitur bukur mirë, të jemi të sinqertë, por shtrirja në temë nuk mund të arrijë në rezultat, i cili neve do të na sjellë ndonjë dobi edhe për interes të qytetarëve. Ju kujtohet buxhet, para ca ditësh që e miratuam këtu, kur e pyeta ministrin, thashë “pse po ulet buxheti i shëndetësisë”, ai tha “sepse ne do ta rritim duke mbledhur premiumet”. Dhe, unë i propozova kryeministrit thashë “pa të keqe bonja një task-forcë se ky s’ka faj, ky nuk di ta organizojë shëndetësinë”. Nuk kemi personale asgjë në këtë problem, por jemi duke e bartur në shpinën tonë çdo ditë nga qytetarët dhe të gjithë jemi fajtorë në këtë temë.

Në vitin 2007, kur ne si Parti Demokratike e kemi bërë ofertën për ta rregulluar shëndetësinë kanë qenë pesë pika, të cilat në pesë pika po sillen nga 2007-ta deri sot, po askush s’po i radhit, por asnjëherë nuk po them që nuk ka përgjegjësi Partia Demokratike, edhe pse asnjëherë nuk e ka udhëhequr Ministrinë e Shëndetësisë që së paku të jetë në tapetën e përgjegjësisë sot. Pika e parë ka qenë që të bëhet stabilizimi i sistemit të informimit shëndetësor. Unë e dëgjova kryeministrin dhe ata që e kanë dëgjuar që janë profesionalisht ia ka huq në shumë pika, por është detyruar të dalë të flasë diçka, sepse ia ka përgatitur dikush fjalimin dhe është huqje totale nga interpretimi çka ka bërë. Për keqardhje është që edhe deputetëve të tjerë ua kanë përgatitë fjalimet sa për ta marrë kohën dhe për të thënë diçka tjetër.

Në pikën e parë do të thotë, në 2007-ën, kur ka filluar një iniciativë ndoshta shpresëdhënëse e një ekipi profesional, nuk po them unë ose dikush tjetër, por një ekip ka qenë i tërë, nuk është implementuar ajo pjesë dhe sot jemi duke u sjellë si në mjegull. Ka qenë stabilizimi i sistemit shëndetësor, ka qenë pika e dytë depolitizimi dhe decentralizimi i shëndetësisë. Ju jeni koshientë që në buxhetin e vitit 2014-2015, kur ky i njëjti ministër ju futi të gjithëve që të votoni për t’ia marrë buxhetin Qendrës Klinike Universitare, do të thotë për ta centralizuar, kur shërbimet i ka centralizuar brenda shërbimit shëndetësor, e që i ka orientimet politike nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe nga ekspertët e shëndetësisë.

Të gjithë këta, të cilët janë të paaftë, duan ta fusin në kontroll, në dorën e vet, çdo gjë, sepse vetëm dorës së vet i besojnë, por nëse çelet dora e tyre është e paaftë për ta sjellë në dobi shërbimin shëndetësor dhe pika e tretë, e cila ka qenë aftësimi i sektorëve, të cilët mungojnë në Republikën e Kosovës. Vetëm sot, zoti ministër, i kam këtu, mund t’i jap edhe e-mail-at, dy kërkesa, të cilat janë aq primitive, e janë aq të përgjegjshme për paaftësinë e juaj menaxheriale. E çdo ditë kam të tilla, ata që na i përgjojnë telefonat duhet të qajnë në e-mail-et tona, ose në mesazhet tona. Për shembull, sot thotë një papa-test ma bënë dhe biopsinë thanë po thonë për 2 mars duhet bërë, nëse në 2 mars nuk ka...

KRYESUESI: Shaip, të lutem rreth sigurimeve e kemi, jo për biopsi.

SHAIP MUJA: Po, kjo flet për sigurimet, zoti nënkryetar, për atë po them nuk është formacioni për të biseduar, sepse unë me ty nuk jam i barabartë edhe të bisedoj për këtë çështje, prandaj më lë të dal edhe në sistemin e informimit shëndetësor, të lutem!

KRYESUESI: Por, po flet në emër të Grupit Parlamentar...

SHAIP MUJA: ...nëse do të ishte stabilizuar Sistemi i Informimit Shëndetësor në Klinikën e Gjinekologjisë do të kishim pasur të dhëna se sa gjilpëra dhe sa material të reagjensave në atë sistem ka në gjendje dhe pacientit nuk i thuhet hipotetikisht për 2 mars.

Do të thotë, automatikisht e kishte parë në sistem dhe ky është ai komponenti, ose moduli i sistemit të sigurimit shëndetësor. Ose rezonanca tha “nuk po punon, por disave po ua bëjnë”, një rast tjetër. Nëse një rezonancë do ta kishte pasur një sistem të informimit shëndetësor dhe do ta kishte të përshkruar mënyrën e servिसimit periodik të rregullt, me alert do t’i kishte dhënë, nuk do të kishte ardhur sot krejt Kosova, se shërbimi publik nuk e ka asnjë rezonancë. Kjo është përgjegjësi! Do të thotë nuk jep kurrkush përgjegjësi.

Zoti kryeministër ka marrë pjesë nga fondet e USAID-it në vitin 2004 në një projekt prej 5 milionë dollarëve për ta printuar një libër “blue print”, që njëri ndër komponentët ka qenë edhe sistemi i informimit shëndetësor dhe në atë libër, nëse do ta kishte lexuar, sot do t’i kishte dalë fjalimi më i mirë sesa që ia kanë përgatitur. Nga viti 2000 deri më tani thuhet se janë investuar mbi 40 milionë euro në Sistemin e Informimit Shëndetësor dhe Kosova me këtë territor të vogël, me këto shërbime, të cilat, nga fjalimi që e dëgjova kryeministrin, ai ia huq thotë “pjesën teknike është gati duke u bërë”, e de facto pjesa teknike është në vitin 2004 e kryer, që quhet “virtual private network”, ose “rrjeti konfidencial ose privat virtual i spitaleve, që përfshin intranetin brenda spitaleve dhe ekstranetin.

Dhe, këta komponentë janë shumë teknikisht të thjeshtë. Sot ka teknikë dhe ka fatmirësisht ekspertë në Republikën e Kosovës që mund ta bëjnë perfekt. Por, ne kemi lënë fondet e Luksemburgut me njerëz të paaftë brenda shëndetësisë, të cilët menaxhojnë dhe fitojnë mëditje, e kemi lejuar një fond prej Bankës Botërore prej 20 milionë eurove për ngritjen e kapaciteteve të ndryshme, të cilat janë quajtur në anglisht “teaching the preaching”.

Prandaj, ne nuk mund ta lejojmë një formë të tillë, kur një ministër thotë “premiumet do të mblidhen në janar” dhe kur i thashë “bëja task-forcën se e ka futur në kaos shëndetësinë” u tërhoqën, i kanë në Postën e Kosovës të printuara për të gjithë qytetarët t’ua dërgojnë e t’jua marrin juve këto. Por, në pyetjen që ia shtrova ministrit, i thashë, dikush e përmendi nga kolegët këtu, “hipotetikisht po themi sistemin e informimit, shtyllën teknike e paskemi të stabilizuar”. Shtylla humane se si ekziston është me shumë pikëpyetje. Por, pyetja kryesore - çmimorja është përcaktuar, kryeministri i cili pretendon se është ekonomist i famshëm, nuk e kupton ose s’do që

ta kuptojë se pse janë dy çështje në çmimoren e shërbimeve shëndetësore shumë të rëndësishme, për situata mikrofinanciare në Republikën e Kosovës, që janë ekspertë të shërbimeve shëndetësore, ekonomistë të shërbimeve shëndetësore, e që Republika e Kosovës s’e ka asnjë dhe nuk mund ta bëjë me komisione të cilat i kanë paraqitur këta dhe të formohet hipotetikisht një çmim sa kushton një apendiks.

Më e keqja është, se këta flasin për sistemin shëndetësor, vetëm për sistemin publik. Sistemi shëndetësor është edhe ai privat. Tërë sistemi i bashkuar mund të paraqesë edhe hapësirat, të cilat nuk mund ta mbulojnë njëri tjetrin dhe e kombinojnë.

Prandaj, çmimorja e shërbimeve shëndetësore, me këtë formë, me këtë standard, siç është duke u përgatitur, nuk kanë shans, sepse shtetet më serioze se sa ne kanë pasur serioze, duke sjellë faktorët mikrofinanciarë dhe mikrofinanciar të rritjes së GDP-së së shtetit. Ajo duhet të shkojë me tabela, me diagram, i cili shkon bashkërisht për ta nxjerrë një çmim.

Në problemet e kësaj, që thonë “premiumet do të mblidhen”. Çdo ministër nga viti 2008 e deri sot kanë thënë çdo qershor kanë me fillua sigurimet shëndetësore, edhe ky po thotë në korrik, e ka shty për një muaj, por unë po ju them, në projektin që e ka Qeveria e Luksemburgut me Qeverinë tonë, që bashëfinancon, e ka në fund të vitit 2018 ta përfundojë projektin. Hipotetikisht, do të themi që nga 6 muaj ia kanë huqur, do të thotë deri në fund të 2025-ës nuk ka sigurime shëndetësore. Kanë pas thënë, kur ka qenë ministri Agani këtu, që deri në fund të 2018-tës nëse e bën ti, unë do të dal dhe të ndaj dekorata maksimaliste.

Por, ky nuk do të mund të arrihet as deri më 2025-tën, nuk është faji te ky, është te ne. Ne duhet të ngrihemi në nivel të detyrës dhe të bëjmë task-forcën dhe të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Deri tash jashtë teme ke, tash hyn në temë. Grupi po t’i jep. Në rregull, ama mos bërtisni kur të ju humbin minutat. S’ka më.

SHAIP MUJA: Zoti Xhavit, po ma merr temën, është një material, kam me ta dhënë, CISKO e ka të botuar dhe thotë “nëse do të arrish qëllime të mëdha për implementimin e strategjive në shëndetësi, filloni edukimin, së pari nga politikanët.”

Kam me ta sjellë ty, kryeministrit e disa tjerëve, mandej do të vij e të flas këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për leksionin! Fjalën e ka Enver Hoti, nëse i ka mbetur ndonjë minutë. S’është këtu. Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj se debati që po zhvillohet do të jetë në kuadër të shumë debateve për tema jetike për qytetarët, që janë mbajtur në këtë Kuvend dhe jeta në fushën e shëndetësisë do të vazhdojë ashtu siç është, dramatike për qytetarët.

Një gjë është shumë interesante që nga paslufta në Kosovë, pjesa dërmuese e atyre që janë marrë me politikë, që kanë qenë në institucione, duke përfshi edhe Kuvendin kanë qenë punëtorë të shëndetësisë, kanë qenë mjekë dhe, e kemi sektorin më të lënë mbrapa në Kosovë, shëndetësinë. Shtrohet pyetja tash, a kemi të bëjmë me mjekë profesionalisht të përgatitur për fushën e tyre apo mjekë që përgatiten për tu marrë me politikë dhe për ta dështuar shëndetësinë.

Kështu që, unë po pres që Qeveria ta ketë prioritet fushën e shëndetësisë, sepse jemi dëshmitarë që miliona e miliona euro dalin jashtë Kosove shkak i kolapsit, në të cilin gjendet shëndetësia në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Nëse themi se kemi një shëndetësi që po vdes, nuk kemi thënë ndonjë gjë të re, për shkak se kjo është e njohur për shumicën e qytetarëve të Kosovës, por në fakt problemi është se po vdesin edhe qytetarët si pasojë e politikës që po zhvillon Qeveria.

Sipas statistikave të vitit 2014 vdekshmëria e foshnjave është më e larta në rajon. Derisa, për shembull, në Maqedoni në 100 mijë foshnja 5 vdesin, në Kosovë kjo shifër rritet në 12. Pra, në Kosovë vdesin 7 fëmijë më shumë se, për shembull, në Maqedoni.

Arsyeja e vdekjes së tyre nuk është për shkaqe gjenetike. Vdekja e tyre është pasojë e keqmenaxhimit dhe korrupsionit në institucionet shëndetësore. Shembulli i vdekshmërisë së foshnjave është vetëm një nga mijëra shembuj të tillë. Këto shtatë foshnja që vdesin në Kosovë para moshës njëvjeçare, po të kishin jetuar në Maqedoni do të shkonin në shkollë, do të martoreshin, do të krijonin familje.

E dhembshmja është që vdekja e tyre vjen si rezultat i vjedhjeve, i keqpërdorimit, pavarësisht që Republika e Kosovës ndanë çdo vit një buxhet të caktuar. Në një farë mënyre, kjo që po ndodhë është vrasje me paramendim. Dhe kjo nuk vjen rastësisht, vjen dhe për faktin që sistemi i menaxhimit të informatave ka dështuar tërësisht, ashtu siç e thanë edhe parafolësit. Për këtë sistem janë ndarë tash pesë vjet me radhë milionë euro, janë ndarë mjete edhe nga donatorë të huaj dhe në fund, subjekti që ka marrë tenderin pa e përfunduar punën i ka marrë paratë.

Pra, nuk është problem vetëm vjedhja e buxhetit, por problemi është që në mungesë të sistemit të informimit shëndetësor, gjë që po mundëson keqmenaxhimit dhe korrupsionin në shëndetësi, eh kjo po i vret fëmijët.

Sot ankthi më i madh i çdo qytetari të Kosovës është sëmundja. Kjo, jo vetëm për faktin që nuk gjen shërim në spitalet tona, por në rastet e tilla duhet ta shesësh shtëpinë, tokën, traktorin, veturën,... vetëm për t'u trajtuar jashtë vendit.

Qytetarët e Kosovës në mungesë të funksionimit të sigurimeve shëndetësore paguajnë jashtëzakonisht shumë për shëndetësi dhe rrezikojnë për ta humbur gjithë pasurinë, për ta rivendosur shëndetin. Në Kosovë ka shumë mjekë të mirë, profesionistë, punëtorë të vyeshëm dhe me etikë të lartë. mjerisht ata janë viktima e parë e kushteve të mjerueshme, keqmenaxhimit dhe korrupsionit.

Po, a jemi në gjendje të punojmë më mirë edhe me këtë buxhet që kemi? Mendoj që një shembull i mirë është komuna e Prishtinës.

Sot në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prishtinë mund ta bëni kontrollin e fëmijës, analizat e gjakut dhe trajtimin profesional vetëm brenda 30 minutash. Fal kontrollit të rregullt në shkollat e Prishtinës, sado që disa ministrave u duket qesharake, në më shumë se 20 raste janë identifikuar problemet e zemrës tek ta. Në vitin 2016 shërbimet mjekësore në Prishtinë janë shtuar për 17%, edhe pse buxheti është ulur për 34%. Pra, kemi më shumë shërbime me më pak buxhet, madje gati 1/3-ën e buxhetit. Pastaj, e habitshme por e vërtetë, është edhe fakti që QKUK edhe pse ka një buxhet shumë të madh për shëndetësi, pacientët i dërgon në qendrat mjekësore familjare në Prishtinë, nga se aty punojnë aparatet e rëntgenit.

Kjo Qeveri ka vite që ka funksionalizuar sigurimin për automjete, sepse kjo u siguron disa milionë, më duket më shumë se 200 milionë brenda viteve të fundit, por nuk ka arritur të funksionalizojë sigurimin shëndetësor. Pra, kemi sigurim për makina, po që se prishen makinat, janë të siguruara, por nëse prishet shëndeti i njeriut, nuk është i siguruar. Kur u bë Ligji për shëndetësi u tha që “kështu po japim një kontribut për zbutjen e varfërisë”. Mendoj që Qeveria e kishte menduar dhe perceptuar drejtë, që shëndeti, respektivisht ruajtja e shëndetit po i varfëron qytetarët e Kosovës.

Tani, tre vjet pas miratimit të Ligjit për shëndetësi, qytetarët po thonë “na keni ndihmua valla, na keni... ndihmu”.

KRYESUESI: Ministri e ka kërkuar fjalën, zoti Rrahmani.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Pa dashur të hyj në ato diskutimet që atakojnë personalitetin dhe japin cilësime, për të cilat të tjerët besoj që janë duke e thënë fjalën, unë do t'i listoja radhazi të gjitha punët që Ministria e Shëndetësisë i ka bërë që nga marrja e mandatit, në drejtim të funksionalizimit të fondit të sigurimeve shëndetësore dhe të thellimit, ose të zbatimit të reformës.

Ne e kemi mandatin që të zbatojmë ligjet ekzistuese dhe mbi bazën e këtij mandati ne kemi zbatuar vetëm ligjet dhe brenda kornizave ligjore edhe i kemi kryer punët.

Që në fillim, me marrjen e mandatit ne kemi vlerësuar që sigurimet shëndetësore nuk janë as për afër nga ajo që u trumbetua nga koha e mëhershme, ose kabineti i mëhershëm qeveritar dhe ministri i shëndetësisë dhe kemi deklaruar, që nuk jemi as afër me sigurimet shëndetësore, sepse AFSH-në, paraardhësen e fondit të sigurimeve shëndetësore e kemi gjetur edhe pa rregulloren e organizimit të brendshëm, do të thotë, dokumentin bazë mbi të cilin është dashur të funksionojë Agjencia e Financimit Shëndetësor.

Kjo rregullore, natyrisht që është nxjerrë dhe është miratuar nga Qeveria. Më vonë është formuar edhe Këshilli për funksionalizimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, që me ligjin aktual të Ligjit për sigurime shëndetësore do të duhej të formohej 3 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, do të thotë as kjo nuk ka qenë dhe ky këshill për funksionalizimin e fondit të sigurimeve shëndetësore ka mbajtur dhe mbanë takime të rregullta dhe gjithmonë ka qenë miratues i dokumentacionit dhe punëve, që kemi kryer ne në Ministri.

E kemi hartuar dhe nxjerrë Udhëzimin administrativ, mbledhja e premieeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm. Gjithashtu, në këtë periudhë të përgatitjes për fillimin e mbledhjes së premieeve janë hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe aprovuar nga Qeveria edhe Statuti i fondit të sigurimeve shëndetësore, Rregullorja për menaxhimin financiar të fondit të sigurimeve shëndetësore, për të vazhduar me përgatitjen e rregullores së re të organizimit të Agjencisë për Financim Shëndetësor, respektivisht fondit, sepse me Ligjin e ri të buxhetit janë lejuar edhe 26 pozita të reja, të cilat kompletojnë deri diku mangësinë e kuadrove, të themi në AFSH, respektivisht në fond.

Është bërë ndërkohë përshkrimi i vendeve të punës për 26 pozita, sepse duhet të merren ekspertë që do të bartin përgjegjësinë për implementimin e këtij ligji. Në këtë periudhë jemi angazhuar dhe ia kemi arritur që të kemi: planin e trajnimit për skemën e barnave jashtë-spitalore, do të thotë njerëzit duhet të përgatiten se si duhet të funksionojë kjo; pagesën për kujdesin parësor shëndetësor, respektivisht të ashtuquajturën pagesa për kapitacion, duke u bazuar në

performansë, dokumente këto të cilat janë finalizuar edhe me përkrahjen e projektit të shëndetësisë kosovare, të financuara nga huamarrja me Bankën Botërore.

Krahas këtyre dy planeve specifike të trajnimit parashihen edhe trajnime të vazhdueshme të stafit ekzistues dhe atyre që do të rekrutohen në ndërkohë. Në kujdesin parësor shëndetësor tanimë ka filluar ky lloj trajnimi. Gjithashtu, jemi në koordinim me Ministrinë e Administratës Publike, ashtu siç e tha edhe kryeministri në fjalën e tij, që të sigurohet hapësirë për stafin shtesë të fondit të sigurimit shëndetësor.

Ku jemi me legjislacionin, se u përmend shumë herë? Me këto, dje bile, dje, kush ka pasur mundësi të marrë pjesë, e promovuam publikisht Strategjinë Sektoriale 2017-2021, që është një dokument i pari i llojit të tillë, i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe unë, sigurisht që do ta shpërndaj së paku te Komisioni Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe do ta shihni se sa është punuar në atë dokument dhe sa është, sa indikatorë janë lehtë të matshëm dhe të vendosur aty, që të sigurojnë implementimin e strategjisë për pesë vjetët e ardhshme.

Po ashtu, është miratuar në Qeveri koncept-dokumenti për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. U diskutua këtu, pse? Gjatë zbërthimit të Ligjit për sigurime shëndetësore në detaje me agjencitë e ndryshme qeveritare, por edhe me ministritë tjera dhe të gjithë partnerët, të cilët kontribuojnë në implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, është vërejtur se ka mangësi në ligj dhe pamundësohen implementimet e proceseve biznesore, që janë procese teknike që duhet të mundësojnë prej dhënies së premiumit deri te marrja e shërbimit. Do të thotë, jemi marrë vesh, jemi koordinuar me Komisionin Parlamentar që kjo të bëhet me prioritet. Në dokumentin final e kemi, e qesim në diskutim dhe shumë shpejt do ta sjellim në miratim në Parlament.

Udhëzimi administrativ për përcaktimin e kriterëve për lirim nga pagesa e premieeve, bashkëpagesa dhe pagesat tjera për sigurim shëndetësor për qytetarët e Kosovës, sipas testit zyrtar të varfërisë. Është një udhëzim administrativ, që është duke u hartuar. Është formuar grupi dhe pritet që brenda pak muajve të bëhet, sepse ky test është shumë i rëndësishëm, që në të ardhmen, edhe pas fillimit të zhvillimit të fondit, sepse me fillimin e mbledhjes së premieeve nuk instalohet në tërësi fondi funksional, do të duhet të identifikojë vërtet të varfrit në raport me ata që lirohen me ligje dhe skema të ndryshme sociale, mos të ngarkohen vërtet të varfrit për premie, po ata të jenë nëpër skema të ndryshme të benifiteve.

Është hartuar lista e të gjitha shërbimeve shëndetësore, që ofrohen në institucionet publike shëndetësore dhe ka përfunduar diskutimi publik me të gjitha institucionet spitalore, sidomos në Shërbimin Spitalor Klinik-Universitar, por edhe me të tjerët të cilët kanë qenë të interesuar që të kyçen dhe të kontribuojnë.

Kjo është e ashtuquajtura “pako bazike” e shërbimeve shëndetësore, të cilat në të ardhmen fondi duhet t’i mbulojë, por duhet ta themi që pakoja bazike bashkë me çmimoren janë dinamike, nuk janë diçka që vendosen tash dhe do të qëndrojnë me vite, por çdo vit, varësisht prej kapacitetit të fondit dhe prej nevojave që paraqiten në sistem dhe mundësive të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ajo duhet të sillet në Qeveri dhe të nxirret vendimi për çdo vit.

Çmimorja e shërbimeve shëndetësore, ne kemi vendosur që ta bëjmë këtë përmes sistemit të DRG-së. Jemi përcaktuar për formën e DRG-së në formën australiane, është përzgjedhur konsulenti i cili ka me dhënë vlerësimin se kushteve, respektivisht sistemit tonë shëndetësor cila formë, ose cili version i DRG-së është më i përshtatshëm dhe shumë shpejt ne do ta kemi në tavolinë cilën formë dhe atë formë do ta blejmë, sepse duhet blerë nga ai që e ka punuar fillimisht dhe e ka patentën.

Është edhe draft-çmimorja, e cila është në diskutim. Natyrisht, se nuk është më e mira, por sigurisht se me një draft çmimore ne duhet vazhduar dhe është bërë nga ekspertë me metodologjinë çfarë është përdorur edhe për vendosjen e çmimoreve edhe në regjion, në Shqipëri e gjetiu. Unë them se e kam bërë vetëm një krahasim, kam pyetur sa është një seancë e dializës, sipas kësaj draft-çmimoreje, del sa është çmimi i një seance të dializës në Shqipëri. Do të thotë, do të ketë këtu mundësi të përmirësimit, por ajo do të jetë në proces sepse çmimoret, thash se janë diçka dinamike dhe varësisht prej mundësive të buxhetit dhe varësisht prej nevojave të sistemit dhe mundësive të ofrimit të shërbimeve edhe nxirren çmimoret. Këto dy aktivitete nuk janë të domosdoshme, as çmimorja, as lista e shërbimeve të kujdesit themelor shëndetësor, që të jenë ditën kur të fillojë mbledhja e premieeve. Ne kemi propozuar në Qeveri, kemi kërkuar nga Qeveria, që të nxirret vendimi që të fillohet më 1 janar, sepse kemi pasur plan veprimi se si do të vijmë deri te të gjitha dokumentacionet dhe përgatitjet, që kur të jemi të gatshëm të ofrojmë shërbime shëndetësore duhet të kalojë një periudhë. Por, ka qenë konsultimi dhe mirëkuptimi edhe i Qeverisë për vërejtjet që janë bërë, që me i marrë edhe 6 muaj shtesë, deri sa të përgatitemi. Po, këto dy çmimore dhe lista e shërbimeve themelore nuk janë të domosdoshme në fillim.

E kemi zbërthyer Ligjin e sigurimeve shëndetësore deri në atë masë, sa që kemi ardhur në pikën kur kemi vlerësuar se si dhe sa do tu kushtojë qytetarëve, që nuk janë as në skema sociale, po as nuk janë të punësuar, ose të vetëpunësuar. Ata që do të paguajnë nga 2 euro sipas ligjit për anëtarë të familjes në baza mujore. Dhe, kjo ka qenë pikënisja që ne kemi marrë iniciativën të hulumtojmë mundësi të tjera, që qytetari për 2 euro të mos paguajë 2,5 euro shtesë në bankat komerciale, po e kemi arritur një marrëveshje me Postën e Kosovës, e cila marrëveshje nënkupton edhe disa shërbime të tjera, që futen në atë kuadër të shërbimeve për informimin e qytetarëve.

Deri tash, brenda kësaj marrëveshjeje janë shpërndarë rreth 300 mijë fletëpalosje, ose janë të gatshme të vazhdohet me shpërndarjen e tyre, për informimin e qytetarëve rreth obligimeve dhe të drejtave pas fillimit të mbledhjes së premieeve.

U përmend shumë sistemi i informimit shëndetësor. Unë them që sistemi i informimit të fondit është një modul, një pjesë e tërë asaj tërësie siç është sistemi i informimit shëndetësor dhe, thjeshtësimi i këtij projekti, sistemi i informimit shëndetësor, vetëm në proceset e sigurimeve shëndetësore është gabim, sepse sistemi i informimit shëndetësor është një projekt i cili, e kam thënë edhe më herët këtu, megjithëse shumë herë po më citojnë gabimisht, është më i rëndësishëm se sa siguri shëndetësor për reformimin e sistemit.

Unë do t'jua jap edhe disa shpjegime shtesë. Softueri është i bërë për sistemin e informimit shëndetësor të fondit dhe është funksional. Janë në përfundim licencat, instalimi i licencave në data-qendër në MAP dhe konfigurimi. Është zhvilluar pakoja standarde për të dhënat minimale për person. Janë definuar proceset e punës me Administratën Tatimore të Kosovës, janë definuar proceset e punës me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Është bërë interkonjeksioni ndërmjet ATK-së, ASHI-së dhe SIF-it, Sistemit të Informimit të Fondit, interkonjeksioni në mes ARC-së, ASHI-së dhe Sistemit të Informimit të Fondit dhe është marrë, është kërkuar aprovimi nga organi kompetent për shfrytëzimin e të dhënave nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që është obligim.

Kemi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të ofruara shënimet 100% në formë elektronike për të gjithë individët, që përfitojnë nga skemat sociale. Do të thotë, kjo është përmbushur dhe janë integruar. Me Bankën Qendrore kemi përfunduar punët. Janë hapur tri llogari: llogaria e të hyrave; llogaria operative dhe llogaria e fondit rezervë.

Cilat janë përfitimet që pas mbledhjes së premieeve do t'i kenë qytetarët?

Është skema e barnave jashtë-spitalore. Me përkrahjen e projektit të shëndetësisë Kosovare Agjencia e Financimit Shëndetësor, respektivisht Fondi, ka përgatitur planin e implementimit të skemës së barnave jashtë-spitalore 2017-2020. Kjo agjenci është duke punuar në aktet legale, që do të mundësojnë implementimin e skemës së barnave jashtë-spitalore. Po ashtu, është duke u konsultuar me komunitetin profesional farmaceutik, se si kjo duhet të shkojë dhe cilat do të jenë çmimet dhe si do të realizohet e tëra.

Dy udhëzimet administrative veç i kemi të draftuara, që e rregullojnë këtë fushë. Njëri është për çmimet e barnave dhe kategoritë e qytetarëve me të drejtë rimbursimi të barnave dhe tjetri është definimi i kushteve për kontraktim të barnatoreve private për listën e rimbursueshme.

Deri në fund të marsit 2017 ne mendojmë se do ta kemi krejt të qartë se cili është pako bazike e përfitimit të barnave jashtë-spitalore. Duhet ta dimë, që fillimisht fondi nuk do të ketë mundësi që të mbulojë të gjitha nevojat, ose të mbulojë të gjithë nevojën për barna, ta rimbursojë gjithë nevojën për barna, sepse fondet që do të akumulohen do të jenë shumë më të vogla, se sa ato që janë në sistem.

Përfitimi i dytë është pagesa për kapitacion sipas performansës për kujdesin parësor shëndetësor, që dikush e përmendi “na e kanë cunguar fondet, e tjerë...”. 1/2-ta e kredisë që është marrë me Bankën Botërore shkon për forcimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe është komponenti i dytë, komponenti i dytë i kësaj marrëveshjeje dhe pas definimit të manualit operacional për skemën e pagesës për kapitacion duke u bazuar në performansë në kujdesin parësor shëndetësor, ne kemi përzgjedhur 6 komuna pilotë, kanë qenë 4 në projektin e Bankës Botërore, i kemi shtuar edhe dy, janë bërë 6, për shkak se Qeveria ka mirëkuptuar dhe ka ndarë buxhet më shumë për këtë skemë.

Dhe, para disa ditësh, më dy të këtij muaji kemi nënshkruar marrëveshjen për shkuarjen përpara me këtë komponent dhe thënë të drejtën, edhe komuna e Prishtinës, po pak me vonesë, ka ardhur dhe e ka nënshkruar, është pjesë e këtij projekti. Indikator ka qenë Sistemi i Informimit Shëndetësor.

Çka do të fitojnë komunat nga kjo? I vetmi kriter është evidentimi i qytetarëve për qendër të mjekësisë familjare. Për çdo qytetar të evidentuar për qendër të mjekësisë familjare që është njëlloj parahyrjeje në procesin e zonimit dhe përzgjedhjes së mjekut nga çdo qytetar përfitojnë nga 2,4 euro në këtë vit. Thashë se kemi nënshkruar me komunat.

U përmend shumë, që kemi nevojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani se është duke folur në minutazhin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Shpesh është thënë se duhet të kemi një komunikim me intensiv me publikun, partnerët dhe kontribuuesit, rrjedhimisht edhe përfituesit nga fondi.

Sot mund të themi se është hartuar strategjia e komunikimit, gjithashtu me mbështetje të projektit Shëndetësia kosovare nëpërmjet huamarrjes në Bankën Botërore, për katër vjetët e ardhshme. Tash janë duke u zhvilluar procedurat e përzgjedhjes së kompanisë, e cila nga prilli i vitit 2017 do të fillojë implementimin e kësaj strategjie rresht katër vjet. Ndërkohë, ne kemi shfrytëzuar edhe forma të tjera të informimit të publikut, nëpërmjet kapaciteteve përbrenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë së Financimit Shëndetësor, nëpërmjet komunikatave, intervistave,

konferencave, debateve, ueb-faqeve që janë funksionale dhe marrëveshjes që e përmendëm më herët me postën.

Unë do të mundohem të jap disa informacione rreth sistemit të informimit shëndetësor në shpejtësi.

Në vitin 2008 është bërë një hulumtim i studimit të fizibilitetit të sektorit të shëndetësisë, mbështetur nga Komisionit Evropian. Mbi bazën e atij studimi kanë dalë edhe disa rekomandime dhe një nga ato rekomandime është zhvillimi i sistemit të integruar të informimit shëndetësor. Dhe, nga ky dokument është nxjerrë strategjia e informimit shëndetësor, SHIS, 2010 - 2020, është bërë plani i veprimit dhe kostimi. Ai kostim ka dalë që për të implementuar në tërësi këtë strategji të informimit shëndetësor duhen 17 milionë.

Unë nuk e di sa milionë janë investuar prej vitit 2002, por i kam shënimet sa janë investuar pas nxjerrjes së kësaj strategjie. Janë investuar përafërsisht në pjesë të barabarta 6 milionë euro dhe parashihet që në vitin në vijim të investohen edhe rreth 6 milionë euro të tjera që të mund ta shtrijmë rrjetin në të gjitha institucionet shëndetësore.

Ky sistem i integruar është unik dhe është sistem shumë i mirë, sepse nuk kemi pasur nevojë në të integrojmë shumë sisteme. Është e përzgjedhur një platformë dhe në momentin e realizimit do të jetë shumë funksional.

Çfarë ka ndodhur? Për harduerin në fazën pilot ka filluar më 2013. Do të thotë është përzgjedhur Prishtina, QKUK dhe zona e regjionit të Prizrenit.

Janë investuar deri më tash nga Ministria e Shëndetësisë 489 067 euro, e Luksemburgu 1 milion. Kjo ka qenë faza e parë.

Nuk janë 70% të institucioneve që është deklaruar, por 30% të institucioneve janë përfshirë në zonën pilot. Dhe, sot flasim për 62 institucione të cilat është instaluar hardueri dhe është duke u testuar dhe duke funksionuar SISH-i. E keni shembullin e komunës së Prishtinës që e përmendët dhe e dimë se, duke funksionuar me përjashtime të vogla, aty ku ka pasur ndryshime infstrukturore e organizative, por mjaft mirë është duke shkuar edhe në regjionin e Prizrenit.

Ka pasur problem në fillim të implementimit të strategjisë së SISH-it, sepse është dashur Ministria e Shëndetësisë të investojë në Qendrën e Informatave në MAP, të krijojë kapacitetet e veta. Dhe, aty janë investuar 970.000 euro aparaturë për krijimin e kapaciteteve, që në ‘data qendër’ do të duhej dhe ka nevojë edhe më tutje të investohet që ne të kemi SISH-in funksional.

Tash, jemi duke përgatitur fazën finale të shpalljes së tenderit për përzgjedhjen e kompanisë, e cila do të shtrijë rrjetin dhe aparaturën harduerike në gjithë pjesën tjetër të Kosovës, në institucionet e mbetura, plus 30% e zonës pilot.

Të kuptohemi se, për shkak të ndryshimeve ka pasur nevojë të shtohen edhe 30% këtu. Dhe, kjo llogaritet që do të kushtojë diku rreth 6 milionë euro deri në fund.

Fillimi i implementimit të kontratës për softuer të SISH-it është bërë në dhjetor të vitit 2014. Softueri prokurë është përshtatur dhe vazhdon të përshtatet sipas nevojave të procesit biznesor dhe specifikat e sistemit shëndetësor.

Sot janë regjistruar në sistem të informimit shëndetësor këta regjistra: regjistri civil; regjistri i institucioneve shëndetësore; regjistri i stafit shëndetësor; regjistri i barnave dhe ISD 10.

Struktura softuerike funksionale. Këtu ne e kemi njëfarë skeme, unë mund t'ju shpjegoj. Procesi i zhvillimit të softuerit po vazhdon me temp të shpejtuar, por gjithmonë duke u bazuar në dinamikën dhe gatishmërinë e institucioneve shtetërore si dhe organizimit strukturor përbrenda institucioneve, duke përfshirë edhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe momentalisht është duke u bërë përshtatja e softuerit për këto procese në vazhdim: softueri për proceset biznesore spitalore, laborator, rëntgen, vaksinim, raportim dhe statistika.

Folëm për sistemin e informimit të fondit, s'dua t'ju lodh, por dua t'ju them se deri tash janë trajnuar 3 500 punëtorë shëndetësorë për përdorimin e softuerit në zonën pilot. Prej tyre janë 729 mjek, 1 724 infermierë dhe të avancuar 207. Nëse doni sipas komunave janë: në Dragash 68; në Malishevë 116; Prishtinë 1 302; Prizren 925; Rahovec 101; Suharekë 137; Mamushë 11. Janë të evidentuar 2 660, plus stafi tjetër përcjellës. Këta janë punëtorë shëndetësorë, mantelbardhë.

U përmend një lloj qendre nacionale për operim, e të tjera. Unë them se për shkak të mungesës së resurseve njerëzore, jo vetëm në Ministri të Shëndetësisë, por edhe në institucione shëndetësore Ministria e Shëndetësisë ka përdorur formën e realizimit të shërbimeve, me qëllim të mbulimit të shërbimeve dhe të vazhdimit të projektit tutje.

Ministria e Shëndetësisë së bashku me partnerin mbështetës "Lux Development" ka siguruar mbështetjen teknike profesionale dhe mirëmbajtjen e sistemit deri në muajin shtator 2017.

Mbetet në vazhdimësinë e proceseve se si do të shkojmë tutje për mirëmbajtje dhe ecje tutje.

Dhe, është themeluar Qendra operative e sistemit, qendër kjo që operon, mbikëqyr dhe definon politika standarde dhe avancimin e mëtutjeshëm të sistemit të informimit shëndetësor.

Tash Ministria e Shëndetësisë, duke dashur të ketë një proces digjital të avancuar dhe të pranueshëm për platformat që monitoron, ka zhvilluar dhe avancuar shumë sisteme të brendshme, duke përfshirë edhe softuerin për: licencimin dhe rilicencimin e profesionistëve shëndetësorë; stokun farmaceutik; Inspektoratin shëndetësor, licencimin e institucioneve private shëndetësore; sistemin e evidentimit të statistikave shëndetësore; resurset humane të integruara për tërë territorin e Kosovës, e të tjera.

Unë këtu i kam edhe shifrat e investimeve që janë bërë pas aprovimit të strategjisë që flet se Ministria e Shëndetësisë në total ka ndarë 3.057.023.62 euro, ndërsa “Lux Development” ka ndarë 2 948 266,5 euro.

U përmendën edhe disa çështje që janë jashtë temës, e unë për atë nuk dua t’ju marr kohë, por besoj që edhe në pyetjet parlamentare, po edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi do të arrijmë t’i adresojmë, por gjithmonë unë jam i gatshëm që nëse doni për të gjitha rrjedhat në shëndetësi ne mund të bisedojmë hapur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

U bënë 3 vjet që Ligji për sigurimet shëndetësore ka hyrë në fuqi dhe ende nuk kemi implementim.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se është një çështje shumë komplekse, por njëkohësisht e dimë se ky ligj është i një rëndësie shumë të veçantë. Ta sigurosh shëndetin nuk është luks, por është domosdoshmëri e kohës.

U tha se janë kryer përgatitjet e duhura dhe në janar, nën thonjëza, po e them, “po fillohet me mbledhjet e premiumeve”. Doli e kundërta se nuk paskan përfunduar këto përgatitje.

Zoti ministër, sa jeni të sigurt që e potencuat se deri në korrik do të kryhen të gjitha përgatitjet për të filluar implementimi i këtij ligji. Dhe, ajo që është më e rëndësishmja, qytetarit nuk po i bën më përshtypje fakti se kur do të fillojë të paguajë, por qytetarit po i intereson se kur do të fillojë të përfitojë nga kjo pagesë.

Duke nisur nga ky fakt, që me përmbledhjen e premieeve po kemi vonesa për shkak të mospërgatitjeve të nevojshme, ekziston risku që ngjashëm të kemi vonesa edhe me fillimin e blerjes së shërbimeve.

Andaj, pyetja ime është kjo: Në momentin që fondi fillon të mbledhë pagesa, pas sa muajsh do të fillojë t'i japë shërbimet?

A do të përfitojnë qytetarët në gjithë territorin e Kosovës apo do të jenë të ndarë në qytete të ndryshme?

Dhe, çfarë nëse pas kësaj periudhe qytetarët nuk fillojnë të marrin benefitet? A nënkupton kjo se, nëse pas 3 muajsh, për shembull, qytetari nuk fillon të marrë përfitimet, a duhet të ndërpresë pagesat deri në fillim të marrjes së përfitimeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma” i ka edhe 30 sekonda, s’është askush këtu. Nehat Baftiu e ka fjalën. S’është as Nehati. Selvije Halimi? S’është! Visar, a e do fjalën në fund, apo? I ke edhe 2 minuta... Atëherë, zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit! Së pari, duhet të kemi parasysh situatën në cilën gjendemi sot në sektorin e shëndetësisë në përgjithësi, për të cilën as ministri e as kryeministri ose nuk janë të vetëdijshëm, ose nuk donë ta përmendin.

Pra, kemi një dështim të jashtëzakonshëm në sektorin publik. Kemi një mosfunksionim të Inspektoratit shëndetësor, paqartësi rreth procedurave të licencimit dhe akreditimit të spitaleve private, për shembull Spitalin amerikan që është licencuar jashtëligjshëm të veprojë brenda oborrit të Qendrës Klinike Universitare.

Vendimi për mbledhjen e premieeve pa përgatitjet e duhura është goditja e fundit që i bëhet gjithë sektorit publik, duke përfshirë edhe stafin e tij në funksion të bizneseve të lidhura me partitë politike në pushtet, pra me spitalet private.

E dyta. Dëgjova edhe ministrin që e përmendi se në vend të implementimit të plotë të SISH-it mund ta përdorim edhe sistemin informativ të fondit, si një nga komponentët e SISH-it, i cili do të mjaftonte për fillim.

Mendoj se kjo as që është e vërtetë dhe është rrugë jashtëzakonisht e rrezikshme po të hyhet në këtë drejtim, sepse SISH-i do të duhej t'i kishte të gjithë komponentët në mënyrë që të jetë funksional dhe të jetë i përdorshëm për funksionimin e plotë të fondit të sigurimeve shëndetësore dhe një funksionim transparent të tij.

Në të do të duhej të ishin edhe regjistri i pacientëve, regjistri i personelit, çmimorja komplete dhe të gjithë komponentët e tjerë për ta bërë sistemin e informimit shëndetësor të përdorshëm dhe funksional.

Përndryshe, do të kishim vetëm krijimin e një data baze jofunksionale dhe jo të mjaftueshme për funksionalizimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore në përgjithësi.

Po ashtu, nëpërmjet sistemit të integruar dhe të centralizuar të informimit shëndetësor do ta kishim më të lehtë edhe të kuptojmë se ku do të duhej të alokoheshin investimet në sektorin publik për ta përmirësuar shëndetësinë, se çfarë barash do të duhej t'u ofronim qytetarëve të Kosovës, cilat sëmundje do të ishin më të... ose statistikisht më të shpërndara te qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që pastaj të investojmë edhe në shëndetin publik. Por, veçanërisht në preventivë që do të duhej të ishte njëri prej mekanizmave më të përdorur për sa i përket sistemit të shëndetit publik.

Dhe, asnjëra prej këtyre pa funksionalizimin e plotë të SISH-it nuk mund të bëhen dhe ky dështim në funksionalizimin e SISH-it, natyrisht se është përgjegjësi edhe e kësaj Qeverie, dhe jo vetëm të kësaj Qeverie, për shkak se, siç e përmendët edhe ju, ka filluar shumë më herët dhe asnjëherë nuk janë adresuar brengat dhe shqetësimet që janë ngritur për funksionalizimin e tij, dhe veçanërisht për nivelin e lartë të korrupsionit në këto para të derdhura në këtë fond dhe të mos jenë të implementuara asnjëherë as në harduer dhe softuer për sa i përket funksionalizimit të tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme, për sigurimet shëndetësore. Kemi dëgjuar prononcime të ministrit të Shëndetësisë nëpërmjet mediave, kemi bërë pyetje parlamentare dhe mendoj që kjo interpelancë është me rëndësi, sepse ky është vendi ku duhet të kritikojmë, por edhe të japim idetë e sugjerimet tona për përmirësimin e gjendjes së shëndetësisë dhe për fillimin e implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Është e vërtetë se ka kaluar kohë nga miratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore dhe nga shumë diskutues u tha se ende nuk jemi gati, sepse nuk janë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e mbledhjes së premiumeve, siç është sistemi informativ shëndetësor, lista e kujdesit themelor shëndetësor, çmimorja e shërbimeve shëndetësore dhe shumë përgatitje të tjera.

Pajtohem se do të duhej të bëheshin përgatitjet e nevojshme dhe pastaj të fillohet me mbledhje të premieeve dhe fillimin e zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore. Mirëpo, unë mendoj se nuk kemi më kohë për të humbur dhe qytetarët tanë të jenë ende pa sigurime shëndetësore.

Edhe përkundër faktit se Ministria e Shëndetësisë ka ende punë për të bërë, mendoj se me një përkushtim më të madh deri më 1 korrik do të mund të kryhen obligimet e mbetura dhe të fillohet me mbledhje të premieeve.

Unë jam ithtare e asaj se më mirë të fillohet me mbledhje të premieeve dhe gjatë rrugës të tejkalohen vështirësitë që do të na dalin për zbatim të Ligjit për sigurime shëndetësore, sepse jemi dëshmitarë se edhe ligjet që po i miratojmë në Kuvend nuk po kalon shumë kohë dhe shpesh kemi nevojë për plotësim-ndryshime. Andaj mendoj se duhet të fillohet dhe të tejkalohen vështirësitë që do të na dalin gjatë rrugës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Labinotë Demi-Murtezi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

T'i kontribuosh vendit nëpërmjet implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore do të thotë të luftosh korrupsionin dhe krimin e organizuar në fushën më humane – shëndetësinë.

As kjo Qeveri dhe as të tjerat para saj nuk kanë kursyer fjalë se shëndetësia është prioritet qeverisës, sikurse në praktikë asnjëherë nuk është bërë sa duhet.

Vendi ynë i udhëhequr nga dy partitë më të mëdha në vend nuk ka edhe asnjë arsye të vetme që pas dy vjet e më shumë mandat të kësaj qeverisjeje të mos ketë bërë diçka konkrete në këtë drejtim.

Ju rikujtoj se gjatë vitit 2015 personalisht kam përkujtuar Qeverinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për tejkalimin e afatit kohor të paraparë për miratimin e rregullores për formimin e bordit, i cili do të bënte mbledhjen dhe mbikëqyrjen e premieeve, që ishte prilli i vitit 2015.

Po ashtu kam tërhequr vërejtjen, duke përkujtuar se fondet e ndara nga Banka Botërore dhe Qeveria e Luksemburgut në mirëbesim për reforma shëndetësore, të filluara në mandatin e kaluar nga ish-ministri Agani, duhet të jenë një arsye më shumë për konsideratë pikërisht edhe për shkak të kësaj mbështetjeje disamilionëshe.

Ministri Rrahmani ka pasur shumë herë pyetje parlamentare për këtë çështje nga deputetët dhe gjithmonë kemi marrë fjalë e data, në të cilat kemi shpresuar dhe që sot nga ky debat dhe deklaratimet e shumta me ndërrime datash dhe veprimesh, po shohim se jemi larg të dëshiruarës.

Konsideroj se Qeveria nga fjala prioritet, tani e tutje, bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të kalojnë në veprim urgjent, nëse vërtet dëshirojnë të bëjnë diçka në këtë drejtim.

Përndryshe, duke dhënë një vlerësim të përgjithshëm nga debati, i cili ishte përmbajtësor, por edhe elektoral, në fushata të ardhshme elektorale dhe debate në Kuvend nuk e di se kush kujt më shumë do t'ia drejtojë gishtin për interesat dhe përfitimet nga situata e krijuar në shëndetësi, përkatësisht nga dështimet e pafundme, të cilat po i vuajnë vetë qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Baftiu e ka fjalën.

NEHAT BAFTIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuar ministër i Shëndetësisë,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Fillimisht falënderoj kompanitë e sigurimeve vendëse, të cilat, pas deklaratës time në Komisionin për Shëndetësi, deklarata kjo që u bë hit në media, duke mos kapur thelbin e deklaratës, kanë shprehur gatishmërinë e tyre që të më sigurojnë shëndetin e familjes falas.

Me informatat që unë posedoj, Ligji për sigurimet shëndetësore ka paraparë një sërë të drejtash dhe detyrimesh për institucionet shëndetësore publike, publiko-private, private dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, ligji si dokument është përpiluar në bazë të standardeve dhe në përputhje me gjendjen e përgjithshme në vend, por si i tillë është shumë vështirë të implementohet. Andaj edhe pa filluar zbatimin është ngritur nevoja për plotësim-ndryshimin e tij dhe kjo tregon një joseriozitet në relacion me sponsorizuesit e ligjit dhe aktorët relevantë të tij.

Në rastin konkret, kur jemi duke diskutuar për plotësim-ndryshimin e këtij ligji, duke u bazuar në konceptin e dokumentit kemi vërejtje që në fillim me përbërjen e Grupit punues të formuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Mungojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe përfaqësues nga sektori privat, respektivisht përfaqësuesit e odave ekonomike vendore dhe ndërkombëtare.

Ligji në tërësi ka vërejtje, por bazë për plotësim-ndryshimin e tij janë çështje të cilat kanë të bëjnë me Administratën Tatimore të Kosovës, gjegjësisht çështjet administrative, të cilat duhet të përmbushen për mbledhjen e premieeve shëndetësore.

Në rastin konkret, çështjet e natyrës administrativo-teknike do të mund të rregulloheshin me akte nënligjore, çështje të cilat duhet t'i trajtojë ky ligj në kontekst të ATK-së. Do të thotë, duhet të jetë forma dhe përcaktimi i burimeve primare dhe sekondare të pagesës së premieeve.

Tani kur kemi parasysh argumentet, të cilat kanë çuar në shtyrjen e implementimit të këtij ligji, do të duhej t'u kushtojmë vëmendje të veçanta pikave të dobëta, të cilat nëse nuk përmbushen, do të na shpijnë në mungesë të qëndrueshmërisë së fondit dhe kjo do të rezultojë me kolaps të sistemit shëndetësor.

Mospërcaktimi i kategorive të vetëpunësuarve, kategorive të liruar nga pagesat, është njëra nga pengesat kryesore të zbatimit të këtij ligji.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe sistemi informativ shëndetësor, i cili nuk është funksional që nga paslufta, ndonëse janë shpenzuar mjete enorme për ta vënë në funksion këtë sistem.

Mbledhja e premieeve shëndetësore në bazë të ligjit aktual konsiston në mbushjen e disa detyrimeve, si listat e shërbimit të kujdesit shëndetësor themelor, së bashku me deklaratën përkatëse financiare për atë vit fiskal të jetë miratuar sipas nenit 14 të këtij ligji.

Lista e shërbimeve pa pagesë, nga neni 7 i këtij ligji, të jetë e definuar: çmimi i çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor për atë vit fiskal të jetë i dakorduar.

Me ligj është përcaktuar që të gjithë të punësuarit duhet të paguajnë premiumin shëndetësor prej 7% në proporcion të barabartë në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kjo vlen për të dy sektorët, publik dhe privat.

Nëse nuk përmbushen obligimet e përcaktuara me ligj, nëse nuk do të ketë rritje të buxhetit për shëndetësi, nëse nuk do të plotësohet infrastruktura e burimeve njerëzore, nëse nuk funksionalizohet SISH-i, nëse i marrim të gjitha ato që i thashë më herët dhe të njëjtat nuk plotësohen para plotësim-ndryshimit të ligjit, procesi si i tillë duhet të kthehet nga fillimi.

Prandaj, rrjedhimisht rrjedhin pyetjet: Pse nuk janë ftuar në grup punues përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, sektori privat dhe i odave? Cilat veprime i ka marrë Ministria e Shëndetësisë në raport me identifikimin e numrit të vetëpunësuarve, numrin e personave të liruar nga pagesat dhe e qytetarëve të tjerë? A keni bashkëpunuar me Ministrinë e

Punës dhe Mirëqenies Sociale për këtë kategori? Cilat janë veprimet konkrete që ministria i ka ndërmarrë në lidhje me SISH-in?

Meqenëse zbatimi i ligjit është shtyrë për muajin korrik, a keni filluar me përmbushjen e këtyre obligimeve dhe në rast se po, cilat janë hapat konkretë të cilët i keni ndërmarrë?

Si e keni rregulluar pagesën nëse në institucionet e njëjta punojnë dy a më shumë anëtarë të familjes? Në rast konkret, a duhet të paguajë njëri për të gjithë, apo të gjithë, në mënyrë të veçantë? Dhe, nëse është kështu, cili e ka për detyrë të paguajë, ai që e ka pagën më të madhe apo më të vogël?

Ka edhe shumë gjëra të tjera, për të cilat s'do të vazhdoj. Dhe, unë e di që te sigurimet private, do të thotë i kemi tri kategori: kategoria standard që është 20 euro për familje dhe që ofron deri 20 000 euro shërbime jashtë vendit, ndërsa dy kategori të tjera, që janë 'silver', do të thotë deri 50 000 euro jashtë vendit. Çka do të ofrojë Ministria e Shëndetësisë, deri në sa euro do t'i ofrojë për shërbime shëndetësore për trajtime jashtë vendit apo brenda vendit? Pra, cilat janë ato shërbime, të cilat do t'i ofrojë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Nëse do kryeministri Isa Mustafa të marrë fjalën për fund, le të urdhërojë, pastaj e ka fjalën propozuesi i interpelancës, 5 minuta. Zoti kryeministër Mustafa e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vlerësoj diskutimin e deputetëve dhe shqetësimin e tyre lidhur me shëndetësinë dhe shëndetin. Vlerësoj po ashtu se çështja e shëndetësisë nuk është çështje e një subjekti politik dhe e as një grupi parlamentar, as e një individ. Është çështje jona, e të gjithëve dhe politikat të cilat ne duhet t'i zhvillojmë në shëndetësi janë politika të cilat domosdoshmërisht duhet t'i harmonizojmë mes vete.

Prandaj unë shoh edhe arsye që bashkërisht të punojmë dhe të vlerësojmë se politikat të cilat deri më tani i kemi ngritur në këtë fushë dhe ligjet të cilat i kemi aprovuar apo zbatojmë apo jo dhe, natyrisht në qoftë se ka moszbatim të tyre, atë ta themi qartas, në qoftë se ka moszbatim të politikave, ta themi qartas.

Unë nuk pashë sot disponim që ne të flasim në mënyrë të argumentuar në këtë fushë dhe unë vlerësoj që në këtë formë do të flasim, në mënyrë që të shohim se a duhet të bëjmë ndryshime rrënjësore në këtë fushë, në mënyrë që të arrijmë t'i plotësojmë pritjet e qytetarëve dhe të kemi një shëndetësi më të mirë për qytetarët.

Është e vërtetë se ne këtë e kemi përcaktuar si prioritet, si Qeveri e koalicionit, është e vërtetë se është punuar me përkushtim në këtë fushë, por po ashtu është e vërtetë që kemi mjaft shumë për të bërë dhe kemi nevojë që të bëjmë edhe ndryshime sistemore, në mënyrë që këtë fushë ta vëmë në rrafshin e duhur.

Dhe, unë ju ftoj të gjithë juve që në këtë formë ta diskutojmë këtë çështje, çka duhet të bëjmë bashkërisht që ta zgjidhim problemin e shëndetësisë në Kosovë?

Unë jam shumë i bindur që shëndetësinë ne nuk mund të zgjidhim as vetëm me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, nuk mund ta zgjidhim as vetëm me ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, mirëpo duhet ta zgjidhim nëpërmjet ndryshimit të sjelljes sonë në shëndetësi. Para së gjithash duhet ta ndryshojmë sjelljen ndaj pacientëve, të gjitha institucionet shëndetësore edhe publike, edhe private, duhet ta ndryshojmë sjelljen ndaj investimeve në shëndetësi, në mënyrë që ato të jenë racionale dhe të jenë në interes të shëndetësisë, dhe duhet ta ndryshojmë sjelljen tonë ndaj implementimit të rregullave në shëndetësi.

Tash sa i përket vetë fondit unë jam shumë i bindur që ministri i Shëndetësisë e tha në mënyrë të qartë se çfarë kemi punuar dhe jam i bindur që është punuar shumë dhe ne do të arrijmë që të aktivizojmë Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, pa lënë asgjë anash sa i përket ligjit. Ne do të përpiqemi dhe ju siguroj që do të arrijmë që në datën që ne e kemi paraparë, më 1 korrik të këtij viti, të aktivizojmë këtë fond.

Por po ashtu është e domosdoshme që të punohet edhe në të gjitha fushat e tjera në mënyrë që të mos presim që vetëm nëpërmes fondit ne e zgjidhim problemin e shëndetësisë, sepse kemi mjaft shumë për të bërë në këtë fushë. Është një fushë shumë e ndjeshme, e cila meriton prioritet, a do ta ndryshojmë ne fjalën prioritet, a do ta zëvendësojmë ose do ta supstituojmë me ndonjë fjalë tjetër është çështje e formës, por me rëndësi themelore është që të gjithë të përkushtohemi ta zgjidhim dhe ta përparojmë problemin e shëndetësisë.

Nuk kemi asnjë arsye që të vazhdojmë që t'i dërgojmë jashtë për shërim qytetarët tanë, por duhet të bëjmë maksimumin që qytetarëve tanë t'u sigurojmë shërim shëndetësor në vend.

Nuk kemi asnjë arsye që ne të bëjmë konkurrencë, vërtet të na konkurrojë Maqedonia që t'i tërheqë pacientët tanë atje, kur personelin shëndetësor s'e kemi fare më të paaftë se sa e kanë maqedonasit, dhe mund ta bëjmë ne këtu.

Prandaj, unë angazhohem duke respektuar tërësisht diskutimet tuaja që ne të punojmë bashkërisht në këtë fushë, të gjejmë zgjidhjet më të mira, sepse është në interes të qytetarëve që politikën në këtë fushë dhe rivalitetet politike momentalisht t'i lëmë anash, sepse është një fushë

e cila meriton etikë, meriton humanizëm dhe meriton një përkushtim tonin të singertë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka propozuesi, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Së pari, këtu me sa dëgjova nga shumica e deputetëve të them ashtu pati edhe argumente të mangësive që i kemi aktualisht në sistemin në përgjithësi, e që janë edhe në kundërshtim me Ligjin për sigurime shëndetësore që pamundësojnë implementimin e Fondit për Sigurime Shëndetësore, pra fillimin e mbledhjes së premiumeve, madje edhe më 1 korrik. Sepse edhe ato që i tha ministri e kështu me radhë absolutisht janë të pamjaftueshme për ta krijuar një situatë ku vërtet do të kishim mundur ta kemi një fond, i cili fillon të mbledhë premiumeve dhe të ofrojë shërbime shëndetësore për qytetarët e Republikës, e që do të ishte transparent dhe i cili do të na mundësonte vërtet që njëkohësisht ta përdorim atë edhe për rritjen e cilësisë në sektorin publik, përveçse për t'i kanalizuar paratë në sektorin privat. Mendoj që kjo është njëra prej mangësive që nuk po flitet ose për të cilën nuk po flitet, po që, në fakt, duhet të jetë qëllim ose e paqëllimshme nga Qeverisa, por sidoqoftë, do të jetë efekti përfundimtar i implementimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, në këtë mënyrë siç po do ta bëjë Qeveria.

Sepse, natyrisht që mbledhja e premiumeve për sigurime shëndetësore duhet të bëhet vetëm atëherë kur, së pari, siç u përmend disa herë këtu, ta kemi një sistem të informimit, pra të centralizuar dhe të integruar të informimit shëndetësor.

Dhe, nuk mund të mbledhim premiume pa i plotësuar ato parakushtet që janë përmendur në nenin 38 të Ligjit për sigurime shëndetësore, të dispozitave kalimtare. Pra, çfarëdo fillimi i mbledhjes së premiumeve pa i plotësuar këto, do të ishte i jashtëligjshëm, sepse nuk i përfill kërkesat ose obligimet që dalin drejtpërsëdrejti nga ligji.

Pastaj, si mund të mblidhen premiumet nëse nuk u tregohet paraprakisht të siguruarve se cilat shërbime ose për cilat shërbime janë duke i paguar premiumet. Kjo është e domosdoshme, që t'u tregohet atyre që paguajnë sigurime shëndetësore që secili prej tyre ta dijë se me këtë pagesë në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore do t'i ketë këto, këto, këto shërbime mjekësore. Dhe, pastaj, natyrisht edhe me cilat çmime, kjo është e domosdoshme.

Pra, kjo është e domosdoshme edhe po të kishte qenë një kompani që ofron sigurime edhe shëndetësore e kapitalit privat, e veçanërisht një kompani ose një fond, i cili do të jetë publik, edhe i obliguar që qytetarët të kontribuojnë në të.

Dhe, normalisht që caktimi i çmimit për secilin shërbim varet nga kompozimi i pakos bazë dhe incidentes së secilës sëmundje, që prapë na rikthente nevoja e kompletimit të sistemit informativ shëndetësor.

Pra, si mund ta dimë ne se cilat sëmundje janë më të shpeshtat në Republikën e Kosovës, se çfarë shërbimesh duhet të ofrojë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore pa pasur edhe matje statistikore të gjendjes në terren. Pra, të shëndetit publik në përgjithësi dhe pastaj nëpërmjet saj ta kuptojmë cilat mangësi i kemi në sektorin publik, ku do të duhej të investonim në sektorin publik, në mënyrë që ai të jetë i aftë që t'i ketë të gjitha kapacitetet për të ofruar shëndetin ose përkujdesjen shëndetësore të nevojshme për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pa këtë natyrisht, unë e di çka do të ndodhë.

Mbledhja e premiumeve nga qytetarët e Republikës së Kosovës do të kanalizohet te spitalet private, hapja dhe licencimi i të cilave është bërë me intervenim e ndërhyrje të politikës. Pra, të njerëzve që kanë udhëhequr me sektorin dhe me institucionet e tjera politike dhe kështu do të përfundojmë në një skenë të kanalizimit të parasë publike në xhepat privatë, siç kemi skema të shumta të tjera në Republikën e Kosovës, e veçanërisht në shëndetësi.

Mospërcaktimi preciz i dizajnit, pra të shumës absolute apo përqindjes së çmimit për bashkëpagesat, me siguri do të krijonte një kaos, e rrjedhimisht do të ndikonte negativisht në pranueshmërinë e skemës së sigurimeve shëndetësore nga ana e kontribuuesve. Njëkohësisht duhet të definohet qartë edhe mënyra e shfrytëzimit të të njëjtave bashkëpagesa.

Dhe, deri sot, të paktën, nuk është raportuar që kontributdhënësit, ose ata qytetarë që do të jenë të mbuluar nga skema të ketë një kartelë që e verifikon statusin e regjistrimit në sigurimin shëndetësor. Por, deri sot të paktën ne nuk jemi të informuar që ka pasur një lëvizje në këtë drejtim dhe si mund të arrihet pastaj 75% të punësuarve të pajisen me këtë kartelë, që është po ashtu obligim ligjor që del nga këto dispozita kalimtare, për të cilat fola më herët.

Në këtë gjendje të cilën jemi natyrisht që implementimi i mbledhjes së premiumeve ose fillimi i mbledhjes së premiumeve, siç po pretendohet nga Qeveria, të nisë më 1 korrik, më shumë do të shkaktojë probleme se sa që do të zgjidhë ndonjë problem për shëndetësinë në përgjithësi dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës që do ta financojnë, në fund të fundit, këtë fond.

Prandaj, ne mendojmë që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdoje!

VISAR YMERI: Pra, për ta lexuar rezolutën, se mbaroi koha, e keni përpara, janë gjashtë pika që ne propozojmë të votohen. Natyrisht që jemi të hapur që t'i diskutojmë këto edhe t'i akordojmë edhe me grupe të tjera parlamentare.

1. Duhet një hetim institucional dhe auditim për fondet e shpenzuar deri më tani për sistemin informativ shëndetësor.

2. Funksionalizimi dhe shtrirja e plotë e sistemit informativ shëndetësor me plan e kalendar publik.

3. Raportimi në Kuvend për rezultatet e shtrirjes së sistemit informativ shëndetësor në të gjitha nivelet e shëndetësisë.

4. Anulimi i vendimit të paligjshëm të Qeverisë për mbledhjen e premieeve nga 1 korriku i vitit 2017. Pra në rezolutë ju e keni janarin, mirëpo kjo interpelancë, siç e dini, është thirrur në dhjetor, kur vendimi për të filluar në janar ka qenë ende në fuqi, tash e kemi një vendim tjetër dhe kjo duhet të ndërrohet.

5. Plotësimi i parakushteve të sanksionuara në Ligjin për sigurime shëndetësore para fillimit të mbledhjes së premieeve dhe

6. Publikimi i dokumenteve paraprake me qëllim informimin e publikut për çmimoren, kategori që përfshihen pagesa dhe ata që përjashtohen.

Ju ftoj, pra, të gjithë deputetët që ta votojmë këtë dhe natyrisht ju ftoj të gjitha grupet parlamentare që të kontribuoni në një rezolutë të përbashkët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa deputetë janë në sallë? Atëherë kemi qëndrimet e grupeve parlamentare rreth çështjes së rezolutës. Ideja është që të harmonizohet teksti, si të doni. Zoti Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Ministra,

Nga dy debat mendoj që shqetësimet janë reale dhe ajo që është e përbashkët, të gjithë jemi për ta përmirësuar dhe për ta ndihmuar që të kemi shërbime shëndetësore më të mira.

Unë mendoj që nga ky debat është mirë të dalim të koordinuar, nga këto pika ka diçka që mund të nxjerrim të përbashkët.

Unë propozoj që nga një përfaqësues i grupeve parlamentare së bashku le të ulen e ta harmonizojnë një draft, i cili do të mund të votohej, dhe mendoj që do të ishte mirë edhe për ministrinë, edhe për Qeverinë të kenë një orientim të përbashkët për këtë sektor. Faleminderit! Nëse bëhet kjo, unë e kam propozimin që zonja Flora Brovina të jetë pjesë e këtij grupi.

KRYESUESI: Në rregull. Zoti Beqiri, urdhëro!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe ne mbështesim përpjekjet që në fund, si grup parlamentar, të bëhet harmonizimi, nëse kjo është e mundur, i këtyre rekomandimeve dhe ne për këtë propozojmë që në këtë grup të jetë deputeti zoti Hatim Baxhaku.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, urdhëro!

VISAR YMERI: Jam dakord që t'i japim një shans harmonizimit të një rezolute të përbashkët po qe se mund ta arrijmë.

Nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” do të jetë në këtë grup deputetja Besa Baftija.

KRYESUESI: Zonja Kadrijaj, në emër të grupit parlamentar.

TIME KADRIJAJ: Pas këtij debati po shihet se vërtet shëndetësia nuk është në pozitë të mirë dhe është interes i të gjithëve që të harmonizohet një rezolutë e përbashkët me pajtim të gjitha grupeve parlamentare, me kusht që kjo rezolutë të jetë obliguese për Qeverinë e Kosovës për implementim, për shkak se është interes i të gjithëve që të bëjmë diçka për shëndetësinë.

Në këtë grup do të jetë doktor Ali Berisha.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të “Nismës”.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu “Nisma për Kosovën” e përkrah këtë rezolutë, mirëpo edhe ne kemi diçka që të shtojmë si pikë tonën.

Prandaj, në grup punues do të jetë deputetja Shukrije Bytyqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Paqaku, në emër të Grupit “6+”.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar propozojmë zotin Fikrim Damka. Përndryshe, jemi në pajtim me harmonizimin e rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po shihet që duhet një konsultë shtesë, unë ju kisha lutur që të uleni dhe t'i votojmë, t'i kalojmë me votim këto tri pika paraprake që nuk kemi mundur t'i votojmë, nëse kalojnë, nëse jo, është çështje juaja.

Kemi pikën e pestë të rendit të ditës që nuk është votuar.

5. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Ju njoftoj se në seancën e kaluar për këtë pikë nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj në seancën e sotme procedojmë përsëri me votimin e propozim-rezolutës për arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Në sallë janë 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Regjia, ju lutem. Përsërite edhe një herë, votojmë tash:

Kanë votuar vetëm 22 deputetë, nuk kalon.

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Në seancën plenare të filluar më 9 shkurt 2017 grupet parlamentare kanë propozuar deputetë për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Vetëm Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk ka propozuar kandidat. Andaj ftoj që ta propozojnë, nuk është askush.

Atëherë kalojmë në votim për ta miratuar Komisionin ad hoc. Votojmë tash!

Në sallë vazhdojnë të jenë 68 deputetë. Nuk po votoni, unë nuk mund t'u detyroj. Janë 68 deputetë, kanë votuar 48.

7. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në seancën e kaluar diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar, andaj në seancën e sotme procedojmë me votimin e propozim-rezolutës lidhur me situatën e krijuar në Mitrovicë.

Ju lus që të votoni. Votojmë tash!

Është e njëjta situatë, nuk po votojnë deputetët.

Konsideroj që si çështje ndoshta duhet të mbyllet, sepse s'ka vullnet për ta votuar.

Atëherë besoj që komisioni ose përfaqësuesit e partive politike sa i përket rezolutës mund të takohen gjatë pauzës për të biseduar. Deputetët janë të lirë të shkojnë në pauzë deri në orën 15:00, shpresoj që tekstin do ta sjellin.

Në orë 15:00 fillojmë me debatin tjetër. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, po e vazhdojmë seancën.

9. Debat parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, sipas kërkesës së deputetit Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë nënshkrues

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, zoti Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë ka propozuar debat parlamentar lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Në emër të propozuesit të çështjes, zoti Haradinaj, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, e ka fjalën që ta bëjë ekspozitën e vet.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër i FSK-së,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Duke dashur të besoj që secili nga ne, e secili nga ju e ndajmë bindjen e njëjtë për nevojën e themelimit të ushtrisë sonë, e kemi iniciuar këtë debat së bashku me deputetë nënshkrues dhe po ashtu me të gjithë anëtarët e komisionit që të diskutohet për një temë tepër të rëndësishme për vendin tonë.

Edhe në të kaluarën e mëhershme, por edhe në luftën e fundit është kërkuar që të merreshin vendime të zorshme, edhe ato u morën. Edhe pas luftës, edhe deri më sot jemi sfiduar edhe po sfidohemi nga të gjitha anët, sidomos në shtetndërtimin tonë.

Populli ynë është i përkushtuar në rrugën e tij euro-atlantike, NATO-ja është në Kosovë dhe besoj që shumë shpejt edhe Kosova do të jetë pjesë e NATO-s.

Qëndrimi i qartë i shefit të NATO-s dhe, po ashtu edhe më i qartë i sekretarit amerikan të Mbrojtjes dëshmojnë qartë se është obligim yni që të veprojmë në këtë drejtim.

Rajoni i trazuar me veprime të shpejta dhe të qarta kërkon pikërisht nga ky Kuvend që ta përmbushim kapitullin e fundit, krijimin e ushtrisë së saj.

Të nderuar deputetë,

Unë sot nuk jam duke folur si i AAK-së, as në emër të AAK-së, por më lejoni t'ju garantoj se me gjithë dallimet e mëdha që i kemi me këtë koalicion, me këtë Qeveri, sa i përket transformimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës në forca të armatosura jemi të gatshëm në çdo kohë ta japim kontributin tonë.

Ne e konsiderojmë të domosdoshëm këtë transformim. Kjo duhet të bëhet në koordinim të plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me NATO-n.

Duke qenë tërësisht i bindur se gjeneralët tanë, ushtarët, oficerët dhe nënoficerët e kanë kryer detyrën e tyre me sukses tash e sa vite, jam plotësisht i bindur se ata janë të gatshëm t'i marrin detyrat e reja.

Forcat e armatosura të Kosovës në asnjë rrethanë nuk duhet të konsiderohen rrezik për askënd, por përkundrazi, ato do të jenë partner të paqes dhe stabilitetit në rajon. Trupat tona do të jenë të popullit të Kosovës.

Prandaj, po ju lus që ta shfrytëzojmë këtë debat në frymën e mirëkuptimit, vullnetit të mirë për ta kryer një detyrë të shenjtë që na takon si deputetë dhe pikërisht atë që populli e pret prej neve.

FSK është po thuaj se tash e sa vite duke i pritur ndryshimet kushtetuese dhe këto ndryshime duhet të bëhen pikërisht në Kuvendin e Kosovës.

Por, ju e dini sa është e mundur një gjë e tillë. Ju e dini se për të ndodhur këto ndryshime kërkohet votim i dyfishtë i shumicës, në këtë rast i komunitetit serb.

Na janë paraqitur si pengesë, duhet ta themi hapur, deputetët e Listës serbe, por a mund të shkojmë në përjetësi duke pritur Listën serbe që të ndodhë një transformim i tillë.

Ky transformim është paraparë edhe me dokumente ndërkombëtare, në bazë të cilave është shpallur edhe pavarësia e Kosovës, ku edhe vetë deputetët serbë kanë marrë përgjegjësit e tyre.

Sot, pra, ju ftoj edhe një herë që të diskutojmë hapur këtu, në këtë foltore, në këtë Kuvend, në të mirën e përbashkët që edhe Kosova ta përmbyllë një kapitull të fundit që e ka - krijimin e ushtrisë së saj. E nëse në rast se ne nuk mund ta ndryshojmë Kushtetutën, atëherë duhet të gjejmë forma tjera. E cila është ajo formë, ju e dini mirë. Është mundësi e thjeshtë që nëpërmjet ligjit thjesht ta kemi transformimin pikërisht në këtë Kuvend dhe edhe një herë, të mos i përsëriti fjalët e njëjta, edhe Kosova krahas shumë shteteve të rajonit ta ketë ushtrinë e saj.

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, unë kam paraparë tri pika të Rezolutës, të cilat në fund të diskutimeve do t'i harmonizojmë me të gjitha grupet parlamentare, por në rast se e shihni të arsyeshme unë do t'i kisha lexuar tash, ose edhe në fund. Sido që ta vlerësoni ju, unë jam i gatshëm, por më mirë t'i lexoj dhe pastaj tani jemi këtu.

1. Qeveria e Kosovës autorizohet që deri më 1 mars në koordinim të plotë t'i koordinojë dhe ta procedojë në Kuvend për miratim përmbajtjen e Projektligjit për avancimin e mandatit dhe misionit të FSK-së.

2. FSK-së t'i ndryshohet mandati dhe misioni sikur edhe të avancohet në aspekte profesionale njerëzore të pajisjeve materialo-teknike dhe ato buxhetore, në mënyrë që të fillojë menjëherë përmbushjen e kapaciteteve fillestare, operacionale dhe atyre të plota mbrojtëse në kuadër të misionit ushtarak, tashmë FSK, në koordinim të plotë me partnerët strategjikë dhe ata të NATO-s, dhe

3. Duke shprehur solemnisht përkushtimin e paalternativë për integrimin në organizatat e paktit Veriatlantik NATO, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat tjerë institucionalë t'i bashkërendojnë angazhimet dhe t'i harmonizojnë përpjekjet e përbashkëta me NATO-n dhe SHBA-në për zhvillimin e kapaciteteve të plota operacionale konform misionit të ri, tashmë të FSK-së.

Por, këto gjithmonë do të dakordohen në fund të debatit, por ajo që është thelbësore sot të mos i japim karakter se kush është bajraktar e kush jo, por të diskutojmë me bindjen e plotë se në fund

të këtij diskutimi, Qeveria e Kosovës ta marrë një obligim dhe ta sjellë para Kuvendit që edhe ne t'i ndryshojmë obligimet ligjore që i dalin kësaj trupe. Është shumë e thjeshtë, ministrin e kemi të pranishëm, FSK-ja ka punuar tash e sa vite dhe është shumë e gatshme, e ka bazën e gatshme ligjore dhe jam i bindur që deri në një mundësi tjetër të re, kur do ta bindim edhe faktorin serbë që të jetë pjesë e kësaj strukture, pjesë e këtij ndryshimi, ne të shkojmë me një ligj të thjeshtë.

E para që kisha pas qejf edhe ju ta kuptoni që data nuk është fiktive, kjo ka qenë vetëm si ide, por ne pas diskutimit do të jemi edhe më konkretë se në çfarë periudhe kohore mund të shkojmë. Ju ftoj për një diskutim dhe në fund besoj që secili përfaqësues i grupeve parlamentare, qofshin anëtarë të komisionit, t'i harmonizojmë këto rreth rezolutës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e ministrit, në qoftë se e dëshiron fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Fillimisht më lejoni ta përshëndes këtë debat parlamentar lidhur me Forcat e Sigurisë së Kosovës, me dëshirën që debati të zhvillohet në frymën parlamentare dhe demokratike dhe si i tillë të jetë një shtytës, respektivisht përshpejtues në proceset zhvillimore që kanë të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Si ministër i FSK-së, me dëshirë që ta jap kontributin tim në këtë debat, si dhe me qëllim që t'i ndihmoj pjesëmarrësit e debatit për ta pasur një pamje më të qartë lidhur me zhvillimet në Ministrinë e FSK-së, respektivisht në FSK, unë gjatë fjalës sime do të fokusohem në pasqyrimin e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete, të cilat Ministria e FSK-së i ka ndërmarrë lidhur me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Më konkretisht, unë do të fokusohem:

1. Në veprimet që kanë të bëjnë me krijimin e bazës ligjore për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura.
2. Në planifikimin dhe përgatitjen për procesin e transformimit dhe
3. Në transparencën e Ministrisë së FSK-së dhe informimin e subjekteve relevante, politike, nacionale dhe ndërkombëtare për aktivitetet planifikuese të Ministrisë së FSK-së.

Sa u përket aktiviteteve të Ministrisë së FSK-së për krijimin e bazës ligjore për fillimin e procesit të transformimit, më duhet të them se pas përfundimit të procesit të rishikimit të strategjisë së sektorit të sigurisë gjatë viteve 2012-2014 dhe pas miratimit të analizës së rishikimit me vendim të Qeverisë, Ministria e FSK-së, mbi bazën e rekomandimeve të rishikimit të strategjisë, i ka

përgatitur amendamentet kushtetuese, të cilat nëpërmjet Qeverisë, respektivisht Kuvendit të Republikës së Kosovës ia ka proceduar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për të vlerësuar nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë apo liri të garantuar në Kapitullin 2 Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykimin e saj, datë 31 mars 2014, i ka aprovuar propozim-amendamentet, duke vlerësuar se të njëjtat nuk e pakësojnë të drejtat apo liritë e përcaktuara në Kapitullin e dytë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Vlen të theksohet se në një nga amendamentet më përmbajtjesore, amendamenti 12, nr. 35, me të cilin propozohet ndryshimi i nenit 126 të Kushtetutës së Kosovës, përveç ndryshimit të emërimit të FSK-së në Forca të Armatosur të Kosovës, propozohet edhe ndryshimi i misionit të forcës, e që sipas ndryshimeve të propozuara do të bëhej, citoj: “Forcat e Armatosura të Kosovës mbrojnë sovranitetin, integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, duke kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global”.

Duke pasur parasysh Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2015, Qeveria e Kosovës këto amandamente ia ka dorëzuar për miratim Kryesisë së Kuvendit të Kosovës në qershorin e vitit 2015. Mirëpo, të njëjtat nuk janë vënë në rend të ditës të Kuvendit të Kosovës për shkak të mosgatishmërisë të deputetëve të komunitetit serbë për të votuar dhe për t'i aprovuar këto amendamente. Mirëpo, Ministria e FSK-së, përveç amendamenteve të larttheksuara, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës e ka hartuar edhe draft-ligjin për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, të cilin ia ka proceduar deri më tani dy herë Qeverisë së Kosovës, dhe atë në marsin e vitit 2015 dhe në tetorin e vitit 2016.

Mirëpo, i njëjti nuk është proceduar fare në Kuvendin e Kosovës për shkak të mosaprovimit të amendamenteve kushtetuese të larttheksuara. Sa i përket planifikimit dhe përgatitjes për procesin e transformimit më duhet të them se bazuar në rekomandimet e rishqyrtimit të strategjisë së sektorit të sigurisë, e në veçanti në rekomandimin për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, që nënkupton edhe transformimin e Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes, Ministria e FSK-së menjëherë e ka themeluar Komisionin për implementimin e rekomandimeve që i takojnë fushëveprimit të saj. Që nga viti 2014 e deri më tani, lidërshi i Ministrisë së FSK-së, në bashkëpunim me organizatën amerikane DIRI, ka punuar në planifikimin e zhvillimit të procesit të transformimit, duke identifikuar 5 shtyllat kryesore të këtij procesi dhe atë kohëzgjatjen e procesit të transformimit, buxhetin e nevojshëm për këtë proces, shtimin e personelit gjatë tërë procesit, trajnimin dhe pajisjet individuale dhe kolektive të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, si dhe infrastrukturën e nevojshme për vendosjen e forcave shtesë.

Falë punës dhe përkushtimit të komisionit, respektivisht Departamentit për Transformim dhe Standardizim, i themeluar enkas për këtë proces dhe përkrahjes së vazhdueshme të DIRI-t,

tanimë janë draftuar dhe aprovuar dokumentet, vendimet dhe strategjitë e shumta që kanë të bëjnë me strukturën organizative të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes, me misionin e Forcave të Armatosura dhe njësisë të saj, me detyrat dhe përgjegjësitë e reja të Forcave të Armatosura dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, aktet normative, dokumentet strategjike, procedurale dhe administrative, të nevojshme për fatin e planifikimit.

Prandaj, me plotë të drejtë mund të thuhet se Ministria e FSK-së i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të filluar me procesin e transformimit dhe është në pritje të vendimit të Kuvendit të Kosovës, e kjo do të thotë se FSK-ja është plotësisht e gatshme për misionin e ri. Pra, për misionin për t'u shndërruar në Forcë të Armatosur të Kosovës, e cila do të jetë një forcë bashkëkohore, jo voluminoze, diku me 5 mijë pjesëtarë aktivë dhe 3 mijë rezervë, një forcë multietnike, që e respekton barazinë gjinore, e cila do të ketë vetëm kapacitete mbrojtëse, që nuk do të paraqesë kurrfarë kërcënimi dhe e cila do të ndihmojë në promovimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë në vend, në regjion dhe më gjerë, gjithnjë në përputhje me standardet më të avancuara të NATO-s.

Lidhur me transparencën e Ministrisë së FSK-së dhe informimin e subjekteve relevante, politike, nacionale dhe ndërkombëtare për aktivitetet planifikuese të ministrisë sonë duhet theksuar se ne si ministri kemi qenë tejet të vëmendshëm dhe të kujdesshëm që të bëjmë transparencë të zhvillimeve dhe rezultateve të arritura gjatë përgatitjes dhe planifikimit të procesit të transformimit. Kështu, në vazhdimësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për këto rezultate i kemi informuar: faktorët ndërkombëtarë, si ekipet këshilluese të NATO-s, ... respektivisht... Pastaj i kemi informuar partnerët tanë strategjikë. Kurse në rrafshin nacional i kemi njoftuar: Presidentin e vendit, Kryeministrin, Komisionin për Mbikëqyrjen e FSK-së, deputetët e komuniteteve pakicë joserbe, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës nga Lista serbe, të cilëve me qëllim të informimit më të plotë u kemi dorëzuar edhe numër të konsiderueshëm të dokumenteve që ndërlidhen me transformimin.

Kuptohet, përveç informimit si ministër, në të shumtën e rasteve i shoqëruar edhe me komandantin e FSK-së, kam mbajtur takime me deputetët e Kuvendit për të biseduar, ndër të tjera, edhe për votimin e amendamenteve kushtetuese.

Me këtë rast do t'i falënderoja deputetët e të gjitha grupeve parlamentare shqiptare që janë anëtarë të Komisionit për Mbikëqyrje të FSK-së, të cilët në takimet e tilla kanë deklaruar se grupet e tyre parlamentare në çdo moment janë të gatshme t'i votojnë amendamentet kushtetuese të FSK-së, pavarësisht zhvillimeve të tjera politike në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, dëshiroj t'i falënderoj deputetët e komuniteteve joserbe, të cilët në takimet tona të përbashkëta kanë deklaruar se deputetët e komuniteteve të tyre do të votojnë pro këtyre amendamenteve pa asnjë kusht të vetëm.

Për dallim prej tyre, ne kemi pasur katër takime me ministrat nga radhët e Listës serbe, të cilëve, përveç që i kemi informuar për zhvillimet në procesin e transformimit, ua kemi dorëzuar edhe dokumentet e ndryshme lidhur me procesin, si dhe kemi biseduar për mundësinë e votimit të deputetëve të tyre pro këtyre ndryshimeve. Fillimisht, ata votën e deputetëve të Listës serbe e kanë kushtëzuar me kërkesa të caktuara, kurse më vonë, do të thotë nga gjysma e dytë e vitit të kaluar, u janë shmangur takimeve me ne, respektivisht nuk u janë përgjigjur kërkesave tona për takim. Duke theksuar arsyeime të ndryshme për mosmbajtje të takimeve, përveç ministrave, kërkesa e ftesa për takime për të biseduar lidhur me çështjen e transformimit të FSK-së u kemi dërguar edhe të gjithë deputetëve të Listës serbe, qoftë në grup, qoftë individualisht, qoftë shefit të grupit të tyre dhe në forma të tjera.

Mirëpo, përkundër insistimeve dhe kërkesës sonë nuk është realizuar asnjë takim me të, kështu për ta dëshmuar insistimin dhe këmbëngulësinë tonë për takime të tilla do të theksoj se në periudhën nga 1 prilli 2016 deri më 18 korrik 2016 nga kabineti im janë dërguar 18 ftesa të tilla, sikurse në e-mail-a, ashtu edhe nëpërmjet telefonit në adresa të ministrave dhe deputetëve të Listës serbe, e që asnjëri nuk ka rezultuar me ndonjë takim të përbashkët. Pra, thjesht, ministrat dhe deputetët e Listës serbe nuk kanë qenë të interesuar të bisedojnë me përfaqësuesit e ministrisë sonë për këtë çështje.

Krejtësisht në fund më duhet ritheksuar edhe një herë se ne si ministri jemi të gatshëm, respektivisht Forca e Sigurisë së Kosovës është e gatshme për ta filluar procesin e transformimit në Forcë të Armatosur, kurse vetë fillimi i procesit varet nga vendimi që do të marrë ky Kuvend. Mirëpo, konsiderojmë se çfarëdo vendimi që merr ky Kuvend, ai nuk duhet të jetë i njëanshëm, por përkundrazi duhet të jetë i koordinuar dhe në konsultim me NATO-n dhe me partnerët tanë strategjikë, dhe atë me: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Italinë, Francën dhe të tjerët.

Them i koordinuar me NATO-n, sepse njëri prej objektivave strategjik të FSK-së është anëtarësimi në iniciativa regjionale të sigurisë, në partneritetin për paqe dhe në vetë NATO-n. Pastaj, arsye tjetër është se që nga viti 2008, NATO-ja ka dërguar në Ministrinë e FSK-së ekipet e saj këshilluese të saj, , e të cilat në gushtin e vitit 2016 janë fuzionuar në një ekip të vetëm, që në vazhdimësi me këshilla, sugjerime dhe forma të tjera ndihmojnë në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në drejtim të përmbushjes së standardeve dhe kriterëve të NATO-s. Kuptohet, këto ekipe në vazhdimësi i kanë raportuar selisë së NATO-s në Bruksel për zhvillimet në FSK.

Nga përgjigjja e sekretarit të NATO-s në shkresën e kryeministrit Mustafa shihet se janë shtuar mundësitë për intensifikimin e bashkëpunimit të FSK-së me NATO-n, gjë që e theksoi edhe sekretari i NATO-s gjatë vizitës së javës së kaluar në Kosovë dhe atë në programet e kërkim-shpëtimit, programet e ndërtimit të integritetit dhe kapaciteteve të tjera, programin e shkencës

për paqe, në luftimin e krimeve kibernetike e tjera. Vendimi duhet të jetë i koordinuar edhe me partnerët tanë strategjikë për arsye se përkrahja dhe ndihma e tyre për FSK-në është e rëndësishë së jashtëzakonshme. Thjesht, pa një përkrahje të tillë FSK-ja nuk do t'i kishte kapacitetet aktuale profesionale, sikur të nivelit strategjik, ashtu edhe të atij operativ.

Kjo përkrahje është e gjithanshme dhe konsiston në formë të ndihmës financiare që herë-herë arrin shuma milionëshe, pastaj në formë të donacioneve të pajisjeve të ndryshme, në formë të shkollimit të kuadrove të FSK-së, sikur të kadetëve, ashtu edhe të oficerëve, pastaj trajnimeve dhe ngritjes profesionale të pjesëtarëve të FSK-së, ushtrimeve të përbashkëta ushtarake, si dhe shumë e shumë sfera të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Në debatin e sotëm po e trajtojmë një çështje, e cila është sa e rëndësishme po aq edhe e ndjeshme, jo vetëm për ne deputetët që jemi këtu në sallë, por për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Çështja që po e diskutojmë sot nuk është çështje as personale, as grupore, as partiake, por është çështja më e rëndësishme me karakter nacional dhe si e tillë duhet të kuptohet dhe të trajtohet me seriozitetin më të madh. Nuk është hera e parë që synohet ky qëllim, por shpresojmë të jetë e fundit, duke rezultuar me epilogun e dëshiruar nga të gjithë ne. Tani për Kosovën është një moment jetik dhe ne mendojmë se janë pjekur të gjitha kushtet dhe janë kryer të gjitha obligimet që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. Jemi të vetëdijshëm që kjo mund të arrihet vetëm në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me NATO-n dhe gjithë faktorin tjetër ndërkombëtar, por mbi të gjitha me një konsensus të gjerë politik vendor.

Ne nuk duhet të kemi dilema rreth formimit të ushtrisë. Dilemë mund të kenë vetëm injorantët. Këto dilema tashmë na janë hequr edhe nga miqtë tanë, raportimi i sekretarit amerikan të Mbrojtjes para Senatit, deklaratat e tij të qarta për formimin e Ushtrisë së Kosovës e tregojnë fatin e FSK-së, i cili është i pashmangshëm drejt transformimit në Ushtri të Kosovës. Ne duhet të jemi të kujdesshëm për hapat që do t'i ndjekim dhe besoj shumë se hapat tanë do të jenë në përputhje të plotë me sugjerimet e partnerëve tanë, e sidomos atyre amerikanë dhe NATO-s.

Prandaj, sot në këtë debat u bëjmë thirrje të gjithëve që çdo çështje të mos kalojë në një debat partiak, politik e ditor, por të ketë gjithmonë parasysh qëllimin që duhet ta kemi si parim.

Problemet me të cilat është përballur dhe po përballlet ky proces janë të qarta, por jo edhe të patejkalueshme. Sado që mund të kemi mospajtime apo mendime të ndryshme, mendimet dhe qëndrimet tona në këtë pikë asnjëherë nuk duhet të jenë të kundërta. Të jemi unikë, qoftë edhe vetëm një herë, dhe njëzëri t'i kontribuojmë këtij procesi të rëndësishëm për vendin tonë, nëse jo për vete, këtë ia kemi borxh themeleve të shtetit tonë, themele këto për të cilat u bënë kurbane bijat dhe bijtë më të mirë të këtij vendi.

Falë ndihmës së NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Forcat e Sigurisë së Kosovës janë forca profesionale dhe të përgatitura me standardet më të larta ushtarake, të cilat janë të gatshme profesionalisht e moralisht të transformohen në Forca të Armatosura të Kosovës dhe t'i dalin në mbrojtje çdo qytetari të vendit pa asnjë dallim.

Republika e Kosovës i ka përmbushur të gjitha kushtet për ta ndërmarrë hapin final të këtij transformimi dhe tani mendojmë që ky proces do të varet shumë nga konsensusi ynë politik. Nëse ne arrijmë ta tejkalojmë politikën dhe retorikën tonë ditore, atëherë jemi të bindur se ky proces nga sot do ta marrë kahun e duhur. T'i lëmë qoftë edhe vetëm sot deklaratat boshe dhe përçarëse, të mos shkaktojmë huti të panevojshme në opinion. Ne sot e kemi mundësinë që me një qasje shumë të thjeshtë ta përcjellim mesazhin e unitetit, përgjegjësisë dhe gatishmërisë për tejkalimin me sukses të kësaj sfide. Kur ne dimë t'i thërrasim arsyes, çdoherë sfidat tejkalohen me sukses dhe në të mirën tonë të përgjithshme. Çdo eskalim i këtij debati në debat maratonik, partiak dhe personal do të ishte barra më e rëndë e fajit që do të mund t'ia ngarkonim vetes para popullit, por edhe para historisë.

Problemi kryesor, por jo i pazgjidhur në këtë proces është Lista serbe, e cila edhe në këtë pikë padrejtësisht ka kompetencë të 2/3 të deputetëve serbë për të drejtën e bllokimit. Janë këta 2/3 e këtij grupi të vogël deputetësh, të cilët kanë ulëset në Kuvend dhe përfitojnë benefite të majme dhe në vend të punës dhe rezultateve na sfidojnë me pengesa nga më të ndryshmet. Këto pengesa burojnë nga politika armiqësore serbe dhe e kanë një qëllim të vetëm, destabilizimin e Kosovës dhe me këtë edhe të gjithë rajonit, sepse edhe në Serbi e kanë të qartë se një Kosovë e destabilizuar është një bumerang edhe për vetë ata.

Të nderuar kolegë,

Pas provokimeve të fundit që iu bënë shtetit tonë, sot më shumë se kurrë e kemi të gjithë të qartë që me apo pa Listën serbe, Forca e Sigurisë së Kosovës duhet të bëhet ushtri, një ushtri e cila në rast nevojë do t'i mbrojë edhe vetë ata deputetë serbë dhe familjet e tyre, edhe pse uroj të mos gjendemi asnjëherë para një nevojë të tillë. Lista serbe duhet ta kuptojë përfundimisht se Republika e Kosovës është shteti i të gjithë qytetarëve pa dallim. Qasja e tyre bllokuese dhe refuzuese në pikëpamje afatgjate është duke i dëmtuar vetë ata dhe komunitetin, të cilin ata e përfaqësojnë, gjithmonë duke u bazuar se ata në këtë Kuvend vërtet përfaqësojnë serbët e Kosovës, e jo Qeverinë e Beogradit.

Ne mendojmë se ka kaluar koha e kompromiseve, sepse kemi bërë mjaft dhe Ushtria e Kosovës është ajo pikë për të cilën ne nuk jemi të gatshëm të bëjmë kompromise më tutje. Sot e kemi shansin më të mirë të tregojmë se në disa çështje nuk jemi thjesht përfaqësues të një subjekti politik, por përfaqësues të popullit, përfaqësues të një populli paqedashës, i cili nga ne pret seriozitet dhe veprime të drejta.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, duke i falënderuar deputetët përfaqësuesit e komuniteteve joserbe në Kuvend për bashkëpunimin dhe seriozitetin e treguar në këtë proces, i ftoj edhe deputetët e Listës serbe që të reflektojnë dhe nëpërmjet këtij procesi t'i kontribuojnë paqes dhe bashkëjetesës në Kosovë. Gjithsesi jemi shumë falënderues për të gjithë trupat e KFOR-it dhe NATO-s, të cilët për 17 vjet me radhë janë gardian i ruajtjes së paqes në vendin tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Nëse ne sot arrijmë në përfundim të dalim me një rezolutë të përbashkët, besoj se do ta ketë një simbolikë shumë të mirë. Do ta ketë simbolikën e mirë, se po i hapim rrugë krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës pikërisht në ditën e Shën Valentinit dhe ky është një mesazh i mirë për të gjithë ata që kanë frikë nga Ushtria e Kosovës.

Arti i luftës, vepër e filozofit dhe gjeneralit kinez Shon Shu, besoj se është e njohur dhe e dëgjuar nga shumica e deputetëve. Por, shumica e ushtarakëve kanë të studiuar mirë, por edhe të sprovuar në jetë. Kjo vepër është e shkruar para më shumë se 2 500 vjetëve dhe e veçanta e saj është, që sot ende mbetet aktuale dhe në fuqi, përkundër zhvillimeve në teknologji, koncepteve, trendëve globalë, e tjera...

Aty, ndër të tjera, thuhet: shkathtësia më e lartë është, në qoftë se e mposht armikun pa luftë dhe ai që e di kur duhet të luftohet e kur jo, është fitues.

Të nderuar,

Krijimi i Ushtrisë së Kosovës nuk do të thotë se ne po hyjmë në luftë, as që pasi që ta kemi ushtrinë jemi absolutisht të sigurt. Krijimi i Ushtrisë së Kosovës është akt i natyrshëm dhe i domosdoshëm, këtu besoj që askush nuk ka dilemë. E vetmja dilemë është rreth rrugëve kushtetuese dhe ligjore për krijimin e ushtrisë me mungesë të vullnetit të deputetëve serbë.

I nderuar Kabinet qeveritar,

Përveç rolit të Parlamentit të Kosovës, roli juaj në transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës është kyç. Ju e zbatoni strategjinë e sigurisë nacionale, ligjet dhe detyrimet në fushën e sigurisë, ju e keni ekspertizën në fushën e sigurisë, ju i mbani marrëdhëniet diplomatike me shtete, organizata politike ushtarake, ju i keni fondet dhe të gjitha kapacitetet për të transformuar Forcat e Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ju duhet të siguronit që formimi i Ushtrisë së Kosovës të mos kontestohet nga askush e as nga deputetët serbë. Ju duhet të siguronit, që ky proces të ketë mbështetjen e fuqishme të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në qoftë se, përkundër vullnetit të Parlamentit, Qeverisë në bashkëveprim me SHBA, NATO, Bashkimin Evropian, prapë siguria e Kosovës varet nga katër deputetë serbë, atëherë ky është një paradoks i llojit të vet.

Të nderuar,

Edhe nëse kontestohet apo shkakton pasojë krijimi i Forcave të Armatosura ne kemi obligim të gjejmë alternativa tjera për ngritjen e mekanizmave mbrojtës. Gjithnjë brenda Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, brenda Policisë së Kosovës, Forcave të Sigurisë së Kosovës, Agjencisë Kosovare për Inteligjencë dhe organizatave tjera, ne mund t'i zhvillojmë dhe ngremë kapacitetet për përgjigje adekuate në situata të ndryshme. Mund të hartojmë protokolle të gatshme për tu vënë në funksion në rast të agresionit total apo të kufizuar në kohë dhe hapësirë.

Arsimimi bazik i rinisë në fushën e mbrojtjes, nëse vlerësohet, duhet të merret në konsideratë. Kategorizimi dhe seleksionimi i objekteve vitale, identifikimi i burimeve dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre në rast lufte do të duhej të ishte punë e kryer.

Krijimi i rezervave shtetërore në derivate, medikamente, artikuj higjienikë, ushqimorë, e tjera... janë të domosdoshme për shtetet nën kërcënim.

Informimi i drejtë dhe në kohë është garanci e luftimit të propagandave, që shkaktojnë konfuzion dhe frikë. Miqësia me partnerët e perëndimit duhet të ruhet dhe thellohet edhe në fushën e mbrojtjes.

Më e rëndësishmja dhe arma më e fuqishme për tu mbrojtur kombi dhe shteti, në çdo pjesë të saj, është që qytetarët ta duan vendin e vet.

Po i plotësuam këto obligime nuk do të ketë luftë, paqen e sigurojmë pa shkrepur asnjë plumb. Atëherë, vërtetohet shprehja më lartë, shkathtësia më e lartë është kur e mposht armikun pa luftë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,
Forca e Sigurisë së Kosovës ka histori pararendëse, nga e cila është shkëputur.

Prej 10 qershorit të vitit 1999 UÇK-ja i është nënshtruar në vazhdimësi një dobësimi dashakeq. Në fillim ndodhi çmilitarizimi, goditja më e rëndë që mund t'i bëhet një ushtrie, qëllimi fundamental i së cilës ka qenë çlirimi i atdheut.

Një ushtri e cila përfundimisht e materializon çlirimin, ajo shndërrohet në ushtrinë e vërtetë të atdheut të çliruar. Goditjet e njëpasnjëshme e pasuan çmilitarizimin, burgosjet e komandantëve dhe ushtarëve të shquar të UÇK-së, dënimet drakonike, shpesh edhe mbajtjet e ish-ushtarëve burgjeve pa asnjë dëshmi për ngarkimin e veprave gjoja të kryera, bastisje dhe poshtërime nga më të padurueshmet, deri në skandalin e patolerueshëm të bastisjes së memorialit të Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jasharit, krejt kjo për ta përdhosur e kriminalizuar luftën tonë çlirimtare për liri.

Po të tentonte bashkësia ndërkombëtare pas luftës që ta shuante UÇK-në përnjëherë do të lindte një UÇK tjetër e re, prandaj ata krijuan TMK-në (Trupat e Mbrojtjes së Kosovës), fiksuan numrin e pjesëtarëve, ua morën armët, i pajisën me simbole dhe vetëm atëherë filluan spastrimet e elementëve radikalë.

Në kuadër të standardeve para statusit TMK-ja kishte përmbushur me sukses standardin e 8-të, si asnjë institucion tjetër. Shpërblimi për këtë i erdhi asaj i formuluar në Planin e Ahtisarit, shpërbërje e TMK-së. Nisën zërat kundërshtues, përfshirë këtu edhe kryeministrin e ardhur nga TMK-ja, aso kohe zoti Agim Çekun, dhe kjo gjë u ndryshua nga shpërbërja e TMK-së në shuarje të TMK-së.

Në një intervistë për Radio BBC-në në gjuhën shqipe, menjëherë pas Pavarësisë, në verën e vitit 2008, në pyetjen nëse do të ndihmojë KFOR-i në krijimin e forcës së re të sigurisë së Kosovës dhe për atë se si do të dukej ajo, gjenerali Ksavier De Marnak përgjigjet: “NATO-ja ka marrë vendim që të ndihmojë këtë proces, që përfshinë shuarjen e TMK-së. Forca do të jetë, kryesisht, një njësi për mbrojtje civile, që do t'i japë Kosovës kapacitete dhe përgjegjësi për tu përballur me katastrofat e rënda, siç janë tërmetet, vërshimet, ose zjarret. Kjo është vija e fundit dhe ajo që do të ndodhë.”

Dhe, më pas, në pyetjen vijuese, “Pra, kjo do të jetë një forcë emergjente?”, De Marnak përgjigjet: “Mund ta quani një forcë emergjente, ose një komponentë për mbrojtje civile.”

Aso kohe neve na thuhej, që FSK-ja është ushtria. Pra, keni parasysh, sot po flasim që na nevojitet Ushtria e Kosovës, a prej vitit 2008 deri para një apo dy viteve na është thënë që kjo

është ushtria. FSK-ja më parë se nën kontroll të ministrit për FSK-në, realisht ishte nën kontroll të KFOR-it, komandanti i së cilës në intervistën e përmendur kur flet për procesin e themelimit të FSK-së, e vë theksin te shuarja e TMK-së, ngjashëm sikurse që formimi i TMK-së para nëntë vjetëve kishte të bënte... më falni, tash i bie para 17 vjetëve, kishte të bënte para së gjithash me shuarjen e UÇK-së.

Në vend të TMK-së nuk fituam ushtri, por FSK-në. TMK-ja, së paku, i kishte ngjyrat kuq e zi dhe fjalën “mbrojtje” në emërtim, gjë që nuk është rasti me FSK-në. Pakoja e Ahtisarit në mënyrë eksplicite ia ndalonte FSK-së të ketë artileri, tanke dhe aviacion ushtarak. Disa vende të Botës kanë hequr dore fare nga ushtria. Ka vende të tilla, që madje janë edhe të anëtarësuar në NATO. Islanda është njëra prej shteteve, që nuk ka ushtri edhe është anëtare e NATO-s, por ky vend ka hequr dorë me vetëdëshirë nga ushtria, për arsye financiare apo të tjera, nuk ka rëndësi. E rëndësishme është, që secili vend në Botë, që nuk ka ushtri, ka të drejtë ta ketë atë, mirëpo Kosovës nuk i është lejuar që të ketë ushtri.

Këtu u tha, që ushtrinë neve na e bën NATO-ja, në fakt është e kundërta, nuk na e bën neve ushtrinë NATO-ja, po ne e përbëjmë NATO-n, se NATO-ja nuk ka armatim të vetin. NATO-ja ka vetëm armatimin e shteteve anëtare. Ti e bën ushtrinë tënde, bëhesh anëtar i NATO-s dhe e përbën NATO-n. Je ti ai që e bën NATO-n, nuk të bën NATO-ja ty. NATO-ja ta ka bërë TMK-në, NATO-ja ta ka bërë FSK-në, por jo edhe Ushtrinë.

Misioni i Forcave të Armatosura të Kosovës duhet të jetë gatishmëria dhe aftësia për ta mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial dhe t’i mbrojtë qytetarët, pronat e tyre dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe global. Mirëpo, pyetja që shtrohet është: Çfarë vendi do të zë UÇK-ja, misioni e simbolet e saj, fryma e trashëgimia e saj, në Forcat e Armatosura të Kosovës?

Të gjithë e dimë, që UÇK-ja u demilitarizua dhe u formua TMK-ja për t’u shuar edhe kjo pastaj drejt formimit të FSK-së. A kemi tash, me formimin e Ushtrisë së Kosovës, ecje nëpër të njëjtën kahe apo ndryshim të orientimit? A do të jetë UÇK-ja dhe dëshmorët e saj pjesë e kujtesës institucionale të Forcave të Armatosura të Kosovës? Çfarë historie dhe çfarë patriotizmi do t’u mësohet qytetarëve të Republikës së Kosovës, që inkuadrohen në Forcat e Armatosura të Kosovës, kjo është thelbësore, jo vetëm armatimi.

Nuk do mend, që kollaj mund ta paramendojmë Forcat e Armatosura të Kosovës në operacione të ndryshme në vatra të krizës nëpër Botë, krahas ushtarëve të NATO-s, mirëpo cili do të jetë qëndrimi dhe veprimi, apo mosveprimi i Forcave të Armatosura të Kosovës ndaj Serbisë, ndaj ushtrisë, policisë, xhandarmërisë dhe strukturave të saj në Kosovë? A është Serbia shtet e ushtri armike për Forcat e Armatosura të Kosovës, ushtrinë e ardhshme të Kosovës apo ajo është

partner bashkëpunimi, sipas marrëveshjeve Thaçi - Daçiç e Mustafa - Vuçiq? Kjo është pyetje thelbësore.

Në prill të vitit 2015, kryeministri Mustafa ka deklaruar me sa vijon: “Forcat e Armatosura të Kosovës pa marrëveshje me serbët nuk do të shkojnë në veri të Kosovës.”, por kjo më është thënë edhe nga zyrtarë të NATO-s. Në prill të vitit 2015, kryeministri Mustafa ka deklaruar kështu. Një kryeministër i këtillë nuk ta bën ushtrinë. Me këso qasje nuk ka Forca të Armatosura të Kosovës, mund të bëjmë debat gjithë ditën e natën.

Në faqet e mesit të Gazetës “Epoka e Re” të datës 9 dhjetor 2015 ishte botuar revista 8-faqesh “Forca Jonë” nga Ministria për FSK-në, revistë kjo mujore. Gjithandej, e lexova 8 faqe, gjithandej takime ndërkombëtare, po ashtu konferenca ndërkombëtare, vizita, sërish ndërkombëtare, intervista me ndërkombëtarë, letra, urime e përshëndetje nga ndërkombëtarët, trajnime nga ndërkombëtarët, nderime ushtarëve ndërkombëtarë të rënë, por edhe ndihma humanitare e certifikata për në thonjëza, citat: “zhvillimin e specifikimeve teknike dhe hulumtim të tregut, si dhe gara sportive të ndryshme...” në tetë faqe. Krejt në fund të faqes së fundit, në më pak se çerek faqeje, kemi titullin “Batalion i 3-të i Brigadës për reagim të shpejtë testoi aftësitë fizike në Marshin e Nëntorit”. Në çerek faqeje, në fund të faqes së fundit prej tetë faqesh. Po, kjo është tepër pak edhe shumë vonë.

Sipas raportit javor të Agjencisë së Lajmeve “Beta”, Serbia i shpenzon gjysmë miliardi euro në buxhetin për ushtri, pra sa dhjetëfish ne dhe, së paku 300 milionë tjera sivjet për armatim. Kjo është 20 deri në 30 herë më shumë se çdo vit paraprak, për armatim dhe mirëmbajtje të tij. Për kë e ka këtë armatim Serbia? Për Hungarinë, për Rumaninë? Natyrisht, se jo! Bosnja dhe Kosova janë të parat që të bien në mend në mënyrë të arsyeshme.

Pra, Kosova është e rrezikuar, sidomos prej Serbisë dhe është e domosdoshme, që ta ketë ushtrinë e saj. Harta e Ballkanit që është sot, shumë më tepër është e përcaktuar nga pasojat e Luftës II Ballkanike, se sa nga dy luftërat botërore, marrë së bashku. Pra, disa muaj të Luftës II Ballkanike, kur Serbia e ka zgjeruar territorin për 81% e kanë përcaktuar hartën e sotme të Ballkanit shumë më tepër, se sa dy luftërat botërore, që janë gati një dekadë, marrë së bashku, në këtë Ballkanin tonë Perëndimor.

E di që do të akuzohet Kosova prej armiqve të saj dhe prej jo miqve të saj, mirëpo Kosovës i nevojitet ushtria pikërisht që të mos ketë luftë. Dobësia jonë na bën magnet për apetitet e kundërshtarëve. Pra, ushtria është ajo e cila ta siguron paqen, aq më tepër karshi armiqve, të cilët asnjëherë nuk janë dëshmuar paqësorë ndaj nesh. Faleminderit!

KRYETARI: Rrustem Berisha, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë viteve të fundit mjediset e sigurisë, ai global dhe rajonal, po bëhen gjithnjë më të paparashikueshëm dhe sfidues. Rreziqet dhe kërcënimet janë në rritje e sipër dhe nuk ka shenja që do të jetë ndryshe edhe në vitet që vijnë. Këto sfida dhe rreziqe ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në mjedisin e brendshëm të sigurisë.

Kosova nuk mund të jetë dhe nuk është immune ndaj këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve. Shteti i Kosovës dëshiron t'i ndërtojë raportet e mira fqinjësore dhe nuk ka pretendime territoriale ndaj askujt prej fqinjëve dhe është logjike, që të njëjtën e pret edhe nga fqinjët e vet. Por, a është ashtu? Përgjigjja është se sigurisht jo. U pa dhe u dëshmuar edhe me zhvillimet e fundit.

Kosova është e pavarur dhe si e tillë ka përgjegjësi për sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e territorit të saj. Vonesat në transformimin e FSK-së në Ushtrinë e Kosovës janë të papranueshme për qytetarët e Kosovës dhe për ne deputetët. Sipas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë është paraparë një plan dhjetëvjeçar i transformimit të FSK-së në Ushtri të Kosovës. Janë paraparë edhe dinamikat e zhvillimit të kësaj force. Unë ua kujtoj, se faza e parë e transformimit të FSK-së është dashur të zhvillohet në vitin 2014-2016 dhe, tani jemi në vitin 2017. Arsytet e mos transformimit janë politike dhe të njohura për ne. Shteti i Kosovës duhet të zhvillojë dhe fuqizojë institucionet e sigurisë, e në veçanti ta bëjë ndryshimin e misionit të FSK-së dhe kjo forcë duhet sa më parë që t'i marrë detyrat e reja.

Është e domosdoshme të ndryshojmë përmbajtjen e Ligjit për FSK-në dhe në kuadër të këtij ndryshimi ta ndryshojmë misionin, organizimin dhe t'i japim detyra të reja kësaj force.

Ka shumë ushtri moderne që nuk e kanë emërtimin ushtri, por janë shumë të njohura, siç janë Forcat Mbrojtëse të Izraelit dhe ato të Japonisë. FSK-ja ka nevojë të zhvillojë kapacitetet e saj dhe të marrë përsipër detyrat shtesë të sigurisë në përputhje me sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Këto kapacitete do t'i zhvillojë në mënyrë graduale dhe FSK-ja do të marrë gradualisht përgjegjësinë për mbrojtjen e vendit.

Kjo forcë duhet të aftësohet dhe të pajiset për të përmbushur misionin e ri të mbrojtjes. Kjo forcë duhet të krijojë kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e misionit. Zgjerimi i misionit duhet të bëhet në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një gjë tjetër, që e kam potencuar edhe më herët dhe që prapë do ta potencoj, ka të bëjë me futjen e lëndës “Mbrojtja dhe Siguria” në programin e Universitetit të Prishtinës, me qëllim që studentëve apo të rinjve tanë tu ofrojmë njohuri dhe arsimim të duhur për mbrojtjen dhe sigurinë.

Kur jemi te ndryshimi i misionit të FSK-së të gjithë ne duhet të jemi të bashkuar, duhet ti lëmë anash bindjet politike, mospajtimet, dallimet mes nesh, dhe nuk duhet që ato dallime të kenë asnjë ndikim tek ne, pra duhet të jemi unikë, sepse këtë e presin edhe qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Berisha! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne në seancën e paradites folëm për prioritetet që ka shoqëria, që ishte fokusi te shëndetësia. Mirëpo, siguria e vendit është prioritet i të gjitha prioriteteve, pa të cilën çdo segment i jetës nuk mund të jetë stabil dhe të funksionojë normalisht.

Besoj, se rrethanat e krijuara kohëve të fundit e dëshmojnë fuqishëm nevojën për të bërë hapa përpara, si institucione dhe si shtet dhe mungesa e guximit dhe vizionit për siguri dhe strategji, sigurisht në vend, duhet të kthehet në një përafrim të forcave politike dhe të gjithë mekanizmave të tjerë, që të reflektojmë fuqishëm në kohë dhe hapësirë.

Nevoja urgjente për krijimin e infrastrukturës ligjore për avancimin e misionit të FSK-së, mendoj se tash nuk ka alternativë. Mbajtja peng e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura është i papranueshëm dhe mendoj, se si Kuvend i Kosovës ndaj atyre që e mbajnë peng duhet të kemi përgjigje. Lista sërpska si politika zyrtare e Beogradit në institucionet e Kosovës duhet ta ketë të qartë, se Kosovën nuk mund ta mbajë peng në sferën e formimit të ushtrisë, siç është duke e mbajtur peng në disa sfera të tjera.

Mendoj se marrëveshja në fushën e sigurisë me Shqipërinë që ka ndodhur dje, është për tu përgëzuar, por besoj se edhe ministri e di se nuk është e mjaftueshme. Kjo duhet të avancohet edhe më tej dhe natyrisht, meqë kemi të bëjmë me Shqipërinë, duhet t’i paralajmërojmë të gjithë se ne jemi një.

Mundësia që transformimi të ndodhë në këtë kohë konform rrethanave të krijuara është evident dhe unë mendoj, se paralelisht me ndryshimet ligjore që duhet të ndodhin dhe që, sa jam në dijeni veç edhe janë përgatitjet e duhura, të shoqërohet edhe me krijimin e një fondi të posaçëm, që nga praktikat e kaluara besoj se kemi përvojë, por pse jo edhe me një taksë të veçantë, e cila do ta përshpejtojë procesin e transformimit të Forcave të Sigurisë në Forca të Armatosura.

Transformimi i FSK-së i shërben paqes në Rajon dhe për këtë unë besoj, edhe ky Kuvend, edhe institucionet tjera, fuqishëm janë duke theksuar dhe mendoj se edhe partnerët në fushën e sigurisë në Kosovë dhe në Rajon, e kanë më se të qartë se duke pasur një ushtri Kosova do t'i ndihmojë shumë edhe ata për të krijuar një stabilitet, i cili kohëve të fundit po lëkundet nga interesat e fuqive të caktuara, të cilat po mendojnë të rikthejnë luftën e ftohtë në Ballkan dhe duke e kthyer në Ballkan ta fusin edhe Evropën në një krizë që nuk do t'i pëlqente askujt.

Harmonizimi i rezolutës, unë mendoj se është shumë jetike për forcat politike, sepse deri më tash është treguar se asnjë forcë politike nuk ka dilema në hapin që duhet bërë dhe besoj se duke qenë korrekt dhe duke pasur parasysh rrethanat, në të cilat gjendemi, ne do të bëjmë këtë hap, sa të nevojshëm aq edhe urgjent.

Forcat e Armatosura të Kosovës besoj se do të jenë vazhdimësi edhe për nga tradita edhe për nga motivimi i përpjekjeve për të mbrojtur Republikën e Kosovës dhe në këtë drejtim ministri bashkë me Qeverinë duhet t'i përgjigjet kërkesave të këtij Kuvendi dhe këtij debati dhe mos të vonohemi në nevojën urgjente që kemi, sepse një fjalë popullore thotë: "Më mirë vonë, se hiç.". Ne e dimë, se jemi pak vonë, mirëpo kapacitete dhe mundësi të jashtëzakonshme kemi, që hapat e humbur në këtë drejtim t'i zëmë me të shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami nga "6+" e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedavajuću!

Poštovani Predsedniće Parlamenta,

Poštovani ministri,

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Kako je debata krenula ispred svih parlamentarnih grupa, mislim da će ova debata biti jedna od uspešnih i da će završiti dogovorom cijelog Parlamenta oko jednog pitanja koja je obaveza svih nas ovde u ovom Parlamentu, odnosno obaveza prema građanima Kosova i prema državi Kosova.

Da ponovim svoje mišljenje koje sam često iznosio na Komisiji za unutrašnje poslove i nadzor FSK da mi zapravo malo kasnimo sa ovim procesom, i da je krajnje vrijeme da njega sada, s obzirom da smo malo zakasnili, ubrzamo.

Naime, imali smo malo neslaganja unutar Komisije vezano oko inicijative, ali to smo raščistili, i što se tiče svih članova Komisije za unutrašnje poslove i nadzor FSK, mi imamo jedinstven stav oko ovog pitanja, i tu nema nikakvog odstupanja, a taj stav jeste da se, ako već ne može da se izmeni Ustav Republike Kosova zbog suprostavljanja, ne gospodine Čuni četiri, već pet poslanika ispred najvećinskih zajednica, onda idemo na promjenu Zakona o FSK odnosno o

sigurnosnim snagama Kosova i pretvaramo dakle sigurnosne snage u vojsku u pravom smislu te riječi.

Mi Bošnjaci Kosova, a ovde je prisutna i gospođa Emilija Redžepi kao druga opcija, mimo opcije Vakata, a ona će svakako izneti svoje mišljenje, ali svakako da smo uvek tražili svoje mjesto u FSK-u, odnosno poboljšanja našega broja i naših pozicija, i to ćemo uvek tražiti i ako promjeni Ustav ili ako promenimo zakon. Međutim, to naše traženje i ti naši zahtevi nemaju dakle veze sa našom podrškom za transformacijom FSK.

U svakom slučaju, u perspektivi će nam trebati da mi kao Komisija za unutrašnje poslove podržimo svake napore Ministarstva i za povećanja budžeta možda već na rebalansu ove godine i za povećanje budžeta u 2018 godini, jer nas čeka i povećanje broja, i povećanje svih kapaciteta unutar naše buduće vojske ili armije Kosova.

Ovde ja bih podržao sve naše napore da ne idemo u nekim stvarima mimo naših prijatelja iz međunarodne zajednice, odnosno naših prijatelja od NATO pakta, kao što su Sjedinjene Američke Države i sve one zemlje koje su ovde spomenute, a ja bih takođe i spomenuo i jaku članicu NATO pakta, a to je Republika Turska.

U svakom slučaju, da ponovim ono što su moje kolege rekli. Mi ne stvaramo armiju da bi nikoga napadali. Mi ćemo stvoriti armiju koja će braniti Kosovo u slučaju agresije. I naši građani ovde na Kosovu često postavljaju pitanja, a među njima i mnoga pitanja među Bošnjacima: ko će nas braniti?

Prema tome, braniće nas dakle naša buduća armija i svi građani Kosova u njoj, računajući tu i Bošnjake Kosova. U svakom slučaju, naš narod je stalno bio u svim bitkama istorijskim sa Albancima zajedno, pa neće prepustiti priliku, kao što sam jednom rekao na Komisiji a ako je potrebno i da preduzme i odgovornost, a što da ne i da budući načelnik general štaba bude školovan bošnjak sa Kosova.

U svakom slučaju apelujem još jednom na sve nas da se ova diskusija završi u interesu svih građana Kosova i u interesu države Kosova, bez novog politiziranja, da usvojimo tu rezoluciju koja će obavezati Vladu na što pre predlog promjene zakona o FSK-u. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Bajrami! Do të keni gjeneral, sepse ju jeni të shkolluar. Zoti Agim Çeku e ka fjalën dhe pastaj, kolegë deputetë, vazhdojmë një nga një. Po e shoh se Besa, nga LDK-ja, po e kërkon fjalën dhe vazhdojmë tutje.

AGIM ÇEKU: I nderuar kryetar,
Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

E përshëndes edhe unë mbajtjen e këtij debati dhe e shoh si shumë të nevojshëm e shumë të dobishëm, që i ka dy synime. I pari është se të gjithë ne, në emër të atyre që na kanë zgjedhur, në emër të qytetarëve të Kosovës që të kërkojmë nga Qeveria të marrë masa që Kosovën ta bëjë me ushtri.

Dhe, synimi i dytë, është që të gjithë ne gjatë këtij debati të japim mendime, të japim ide se si ta bëjmë këtë ushtri.

Dua të përshëndes dhe ta përgëzoj edhe një herë FSK-në, ministrin e FSK-së për gjithë punën e madhe që e kanë bërë, dhe sa i përket këtyre, kjo punë është e përfunduar dhe FSK-ja si e tillë është e gatshme t'i marrë detyrat që ne një ditë, besoj shpejt, do t'ia ngarkojmë.

Janë dy çështje që gjatë tërë debatit duhet t'i kemi parasysh. Projekti i krijimit të forcave të armatosura të Kosovës, apo ushtrisë së Kosovës, që nga fillimi është projekt i përbashkët me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Dhe, e dyta, Forcat e Sigurisë së Kosovës janë institucion shumë serioz, forcat e armatosura të Kosovës do të ishin shumë serioze, institucion në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha komuniteteve dhe duhet bërë përpjekje që pjesë e këtyre, edhe e krijimit, edhe e vendimmarrjes, edhe e anëtarëve të jenë të gjitha komunitetet apo pjesëtarë të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Andaj, brenda këtyre dy parimeve bazë, ne duhet të gjejmë mënyrën si ta krijojmë.

U bënë 3 vjet, saktësisht po bëhen më 17 shkurt 2014 kur ish-kryeministri, e tani presidenti Hashim Thaçi, në fjalimin e tij në festimin e Ditës së Pavarësisë e shpalli që FSK-ja do të shndërrohet në forca të armatosura të Kosovës, në shumës po flas. Sepse, ato ditë përfundoi një proces i gjatë, një proces shumë studimor, thellësisht studimor, i cili quhet "Rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë" dhe doli me shumë rekomandime. Po them, me shumë rekomandime dhe vetëm një pjesë e tyre kishin të bëjnë me FSK-në apo transformimin e tyre në forca të armatosura të Kosovës dhe Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes.

Të gjitha këto rekomandime ishin dhe i gjithë ky proces ishte udhëhequr nga Qeveria e Kosovës, konkretisht nga Ministria e FSK-së, si drejtues i Komitetit drejtues dhe ishte gjithëpërfshirës. Ishte i ndihmuar gjatë tërë kohës nga një organizatë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konkretisht nga Departamenti i Mbrojtjes në Pentagon, DIRI. Gjithashtu ishte i ndihmuar nga ekipi këshillues i NATO-s dhe ishte, në çdo hap, apo fillimisht çdo analizë dhe çdo hap ishte i koordinuar dhe i miratuar nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Pra, që nga fillimi ky proces ka shkuar kështu dhe bëj apel edhe te Qeveria dhe të gjithë ne të kuptojmë se deri në fund duhet të shkojë kështu.

Janë humbur 3 vjet. Janë humbur dhe paramendoni ku do të kishin qenë sot forcat e armatosura të Kosovës po të ishin formuar më 2014-tën. Duhet të them, kam qenë edhe pjesë e Qeverisë dhe i di përpjekjet edhe të kryeministrit të atëhershëm, edhe përpjekjet e mia modeste si ministër që ta bëjmë, por thjesht kishte gatishmëri të deputetët e komunitetit serb. Por, i kishin disa kërkesa që ne, disa parti politike, nuk ishim të gatshëm t'i aprovojmë. Thjesht, kishte të bëjë me vende të rezervuara edhe për këtë mandat që ne sot po e gëzojmë.

Dhe, ndodhi çka ndodhi, e humbëm shansin historik. Tani jemi këtu ku jemi! Po shoh edhe në media, edhe sot këtu, ka propozime të ndryshme se si duhet ta bëjmë ushtrinë e Kosovës.

Unë do t'u bashkohem ideve dhe mendimeve të mia, po edhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Ne po themi dhe mendojmë, mund të jetë edhe e vërtetë se deputetët serbë nuk do ta përkrahin ndryshimin e Kushtetutës. Por, a kemi provuar, a kemi marrë masa serioze? Jo. Unë mendoj se ne, sikur që thashë, duhet bërë çmos që të mbetemi në koordinim, në bashkëpunim, në projekt të përbashkët me bashkësinë ndërkombëtare dhe të bëjmë çmos që edhe komunitetin serb ta bëjmë pjesë edhe vendimmarrës, edhe pjesë të forcave të armatosura të Kosovës.

Çka mund të bëjmë? Projekti dhe propozimi i ndryshimeve kushtetuese është në Parlament, bile ka kaluar edhe Komisionin Legjislativ. Kam qenë unë dhe disa deputetë që s'jemi anëtarë të komisionit aty kur është aprovuar. Pra, është i gatshëm të vijë.

Unë mendoj se do të ishte dashur që Kryesia e Parlamentit ta caktojë një ditë, në një të ardhme të afërt, kur do të jetë ajo në seancë. Ta sjellë në seancë, ta dimë datën kur do të vijë. Dhe, para asaj dite të mobilizohemi të gjithë, në radhë të parë Qeveria, ministria, presidenti, kryetari i Parlamentit, bashkësia ndërkombëtare që të bisedojmë me deputetët serbë, po them me deputetët serbë. Unë i përshëndes përpjekjet e ministrit me ato kërkesat e tyre dhe takimet që i ka pasur, deputetët janë ata që votojnë, deputetët janë zgjedhur, jo ministrat. Ministrat janë të emëruar, kështu që deputetët duhet të flasin me deputetë.

Pa keqkuptim, ministër, sepse kam qenë edhe vetë ministër. Nuk është ministri ai që jep garanci, sepse çfarëdo garancie që jep ministri, kryeministri mund t'ia ndryshojë. Ata kërkojnë që të bisedojnë me instanca më të larta të shtetit, dëshirojnë të bisedojnë me kryeministrin, me presidentin, me kryetarin e Parlamentit dhe, besa, dëshirojnë të bisedojnë edhe në prani të faktorit ndërkombëtar.

Sa herë ne kemi pasur telashe nga përvoja jonë, sa herë ka ndërhyrë faktori ndërkombëtar, na ka bërë bashkë, qoftë si parti politike, qoftë edhe me komunitetet e tjera. Pse ne kur të kemi datën e votimit të ndryshimeve kushtetuese të kërkojmë nga partnerët tanë ndërkombëtarë, që të na bëjnë bashkë, të bisedojmë bashkë, në prezencën e tyre, t'i dëgjojmë shqetësimet e tyre.

Dhe, unë propozoj që në atë takim t'ia bëjë ministri apo komandanti një prezantim në gjuhën e tyre: çka janë forcat e armatosura të Kosovës? Çfarë natyre, çfarë karakteri, çfarë roli, çfarë misioni, çfarë detyrash kanë? Dhe, ta shohin se janë në shërbim të të gjithë qytetarëve. Pra, të organizojmë një takim, t'ua sjellim 50 ushtarë serbë që janë sot në FSK. Në mesin e tyre, edhe 2 oficerë të shkolluar në Akademinë Ushtarake që e kanë kryer në Shkup e që janë oficerë të shkëlqyeshëm duke i kryer detyrat e tyre. Po edhe 5-6 janë duke e mbaruar Akademinë Ushtarake. T'i shohim, të shohim se asnjë pjesëtar i komunitetit serb kur ka ardhur në FSK s'e ka lëshuar FSK-në, sepse s'ka pasur arsye, e ka ndier veten mirë, e kanë ndier veten të respektuar. Pra, t'i ballafaqojmë me këto argumente. T'ua rikujtojmë... më fal, ministër, po i referohem kohës kur kam qenë ministër, kemi pasur gjatë këtij debati, ka qenë debat, shihej se si rezultat i kësaj do të jetë që Kosova duhet ta ketë ushtrinë e vet.

Presidenti i tyre, që edhe aktualisht është president, e pati dhënë një deklaratë që nuk mendoj se Kosovës i duhet ushtria, por në qoftë se e bëjnë, të kërkojmë që pjesëtarët e komunitetit serb të jenë të përfshirë ashtu siç janë të përfshirë në Policinë e Kosovës.

Kjo deklaratë e tij është marrë si qëndrim zyrtar. Është folur në NATO kur kemi qenë në takime, është folur këtu në bashkëpunim me... dhe është arkivuar në Ministrinë e FSK-së.

E dyta, fakt që duhet përmendur në këtë aktiv, gjatë tërë kohës ata kanë kërkuar informacione nga komandanti i KFOR-it, me të cilin kanë takime të rregullta, nga zyrtarët e NATO-s se çka po ndodh, dhe kanë kërkuar nga ta tri gjëra, të cilat të tria ne i kemi adresuar. E para është që të jetë forcë defensive, e fokusuar vetëm në mbrojtjen e vendit që, në fakt, është paraparë të jenë forcat e armatosura të Kosovës.

Tjetra çfarë kanë treguar, të jenë forcë multietnike, profesionale dhe me standarde të NATO-s. Që është parim edhe sot i FSK-së dhe ne jemi të përcaktuar për një gjë të tillë.

Dhe, e treta, kanë kërkuar garanci nga NATO që fillimisht për disa vjet në ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve të forcave të armatosura të jenë të kyçur dhe të përfshirë këshilltarët e NATO-s. Edhe kjo ndodh, po edhe ne e kërkojmë këtë punë.

Do të thotë, të tri këto shqetësime që i kanë pasur, i kemi adresuar. Dhe, mendoj që pas këtyre përpjekjeve, ne duhet të vijmë këtu në Kuvend dhe të shohim, a po votojnë apo jo? Të bindet edhe faktori ndërkombëtar që s'po e votojnë.

Ndoshta edhe një herë, edhe dy herë të provojmë, të bëjmë çmos. Të mos shkojmë drejt në variantin e dytë që është lehtë të bëhet.

E tani, çka është me rëndësi? Është me rëndësi të duam ta bëjmë. Më fal, s'qenka këtu kryeministri, por çdo gjë bëhet kur do ta bësh. Thonë, e kam thënë edhe një herë: ai që do ta bëjë, e gjen mënyrën. Pra, që do ta bëjë një punë, por ai që s'do ta bëjë një punë, e gjen arsyen. Ne e kemi gjetur arsyen: serbët s'po donë. Mirëpo kurrë s'kanë thënë: "S'po duam". S'i kemi provuar. Kemi biseduar me një, dy...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Rregulloren nuk e shkelim, por në emër të grupit mund të të japë grupi. Po, cili deputet do t'ia japë minutat? Fatmir Xhelili, flet nga koha e tij. Jemi në kohën e deputetit Fatmir Xhelili.

AGIM ÇEKU: Do të thotë, ai që do, e gjen mënyrën. Mënyra, si varianti i parë, plani A, e thashë.

Plani i dytë, prapë po them. Në qoftë se dështon, në qoftë se bindemi që nuk kanë gatishmëri ta votojnë ndryshimin e Kushtetutës, të bisedojmë a kanë gatishmëri ta votojnë ligjin, ndryshimin e Ligjit të FSK-së.

Ky ligj mund të ndryshohet, ka edhe bazë ligjore për t'u ndryshuar dhe plotësuar Ligji i FSK-së, por ka edhe improvizim. Nuk kisha pasur dëshirë, e as ju, besoj, që me këtë institucion serioz të bëjmë improvizime, por ta bëjmë në mënyrë të mirëfilltë.

Këtu s'po ndalem shumë, por Ligji për FSK-në, e sheh, është neni 6, pika 6. 2c, që thotë se "Kryeministri mund ta ndryshojë, mund ta modifikojë strukturën e FSK-së në bashkëpunim me presidentin dhe me miratimin e Parlamentit".

Neni i Kushtetutës në dispozitat e përgjithshme thotë gjithashtu kur flet për sovranitetin, neni 2, pika 2: "Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet, po e theksoj, mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj". Dhe, në qoftë se ne dëshirojmë ligjin, atëherë ky kapitull apo ky nen e përfshin në çfarëdo rreziku, se është institucion kushtetues FSK-ja edhe sot. Do të thotë, nuk përjashtohet mundësia që nëse cenohet sovraniteti, Kushtetuta e thotë se kemi të drejtë ta mbrojmë me të gjitha mjetet që i kemi, a një prej mjeteve është edhe sot FSK-ja.

Prapë po them, edhe këtu duhet bërë përpjekje që ata së paku ta votojnë ligjin, por të jenë pjesë, dhe prapë po e theksoj, duhet të jenë pjesë e këtij procesi.

Unë po them tash këtu, në qoftë se është propozim, po e afrojmë edhe një variant tjetër, më falni. Planin C, sikur po i thonë.

Plani A është forcat e armatosura të Kosovës.

Plani B, transformimi i FSK-së në forca të armatosura të Kosovës.

Plani C, edhe FSK, edhe forca të armatosura të Kosovës.

Qysh mendoj se mund të bëhet kjo punë? Në rekomandimet e sektorit të sigurisë parashihet që në fazën e dytë të zhvillimit kapacitetet e mbrojtjes civile që sot i ka FSK-ja, siç janë deminimi humanitar, kërkim-shpëtimi urban, kërkim-shpëtimi në ujëra, trajtimi i materialeve të rrezikshme, zjarrfikësit, të kalojnë e të bëhen bashkë me Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave.

Do të thotë, kjo është paraparë. Dhe, pasi sot e kemi kategori kushtetuese FSK-në, nuk po mund ta ndryshojmë Kushtetutën, t'i bëjmë bashkë këto dy institucione dhe këto kapacitete të bëhen njësi të specializuara për mbrojtjen civile. Këto janë diku 5% të FSK-së.

Dhe, pjesën tjetër të FSK-së ta shndërrojmë... nga pjesa tjetër t'i ndërtojmë forcat e armatosura të Kosovës.

Ku është baza ligjore? Unë s'jam ekspert ligjor, por jam i interesuar shumë për këtë çështje dhe i kam gjetur disa nene që mund të lidhen me to.

Kapitulli i parë: Dispozitat themelore, që e definojnë shtetin tonë, neni 4, pika 7, thotë: "Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës".

A i ka sot, Kushtetuta na obligon? Thotë: "Republika e Kosovës i ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe integritetin territorial".

Nuk ka sot Kosova institucion për mbrojtjen e integritetit territorial. Do të thotë, jemi të obliguar nga kjo Kushtetutë që ta bëjmë.

E dyta. Kapitulli 5. Presidenti i Republikës së Kosovës, neni 84, kompetencat e presidentit, thotë: "Presidenti i Republikës së Kosovës është komandant suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës". Do të thotë, flet në shumës. Kurse FSK-ja është njëjës. Është njëjës në Kushtetutën tonë, kurse Kushtetuta e njeh presidentin si komandant të të gjitha forcave të sigurisë, pra flet në shumës.

Prapë, pa keqkuptim, edhe një nen të Kushtetutës.

Qeverisja lokale dhe organizimi territorial. Neni 124 thotë: “Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është Komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes, e tjerë, të mos ua lexoj krejt nenin, por në këtë qeverisje lokale kurrkund nuk përmendet asociacioni i komunave.

E ne, kurrkund në Kushtetutë s’e kam lexuar se ekziston... Ne do ta bëjmë, por atëherë duhet ta bëjmë me ligj, me dekret. Pse atëherë, ta lëmë FSK-në qysh është, së bashku me AKM-në dhe të mos e lëmë Kushtetutën me një dekret, me ligj të veçantë, t’i bëjmë forcat e armatosura të Kosovës.

Por, prapë po them, në këto variante t’ua shtrojmë partnerëve tanë ndërkombëtarë, t’ua shtrojmë atyre që sot nuk janë të gatshëm ta ndryshojnë Kushtetutën, a bën edhe kështu.

Dhe, krejt në fund, në qoftë se kurrgjë s’bën, ne pa ushtri s’mund të mbesim, e as që guxojmë të mbetemi. Jemi përgjegjës dhe atëherë ne duhet ta nxjerrim ligjin për referendum dhe një ditë me referendum ta ndërrojmë Kushtetutën dhe ta bëjmë edhe ushtrinë, edhe të tjerat.

Dhe, për fund, kryetar. I përmenda rekomandimet e sektorit të sigurisë. 3 vjet janë bërë, asnjë rekomandim, janë me dhjetëra, e nuk janë kryer. Kanë mundur të kryhen shumë, sidomos disa bazë që i duhen ushtrisë së Kosovës.

Rekomandimi i parë është që Kosova, Qeveria, sa më parë ta nxjerrë dhe ta aprovojë në këtë Parlament strategjinë kombëtare të sigurisë. Nuk është bërë. Është punë shumë e thjeshtë, sepse ky raport, ky studim që është bërë e ka përcaktuar ambientin gjeostrategjik, kërcënimet, rreziqet, arkitekturën e sigurisë dhe, krejt janë aty, vetëm duhet të transmetohen në strategji kombëtare të sigurisë. Dhe, nga kjo strategji duhet të dalin shumë dokumente që i vyejnë kësaj ushtrie. Është strategjia e mbrojtjes, libri i bardhë, koncepti i mbrojtjes së shtetit, e të tjera.

Do të thotë, këto kemi mundur t’i bëjmë për këto tre vjet. S’i kemi bërë!

(Ndërrhyrje)

Tjetër. Edhe diçka. S’jam duke folur për demarkacionin, sepse veç për demarkacionin merresh vesh, në pyetje, edhe ajo është pyetje e madhe.

E dyta. Është rekomandim i fuqishëm që në kuadër të universitetit publik të formohet Fakulteti i Mbrojtjes së Sigurisë, ku prodhohen quadro të diplomuara. Sot, të gjitha shkollat që i kemi, edhe në polici, të krijojmë kuadër të certifikuar, kurse ne edhe në letrën e NATO-s që i është dërguar kryeministrit kërkohet bashkëpunim, e përmendi ministri, në fushën e shkencës e të sigurisë.

Ne, pse s' formojmë këtë fakultet? Është obligim i Ministrisë së Arsimit. Dhe, së fundi, rekomandim është që të formohet grupi për integritet në NATO, grupi ndërministror apo Këshilli konsultativ, ashtu siç e kemi për integritet në Evropë. As kjo s'është formuar, aq më tepër, tani prej 5 dhjetorit e kemi një ofertë konkrete të NATO-s për shumë fusha të bashkëpunimit, ku ne duhet të kemi iniciativë, e ato iniciativa duhet të koordinohen dhe, në kuadër të Qeverisë, po them, po edhe në kuadër të Parlamentit.

Pra, ka edhe punë të tjera, që duhet të paraprijnë, sepse ne mund ta bëjmë ushtrinë. Por çka bëjmë të nesërmen me ushtrinë. E dimë të gjithë, lehtë është të bëjmë diçka, por zor është ta mbajmë, dhe s'mund ta mbajmë në qoftë se e konteston dikush, nëse s'e pranon dikush, në qoftë se bëjmë ndonjë improvizim dhe në qoftë se e bëjmë pa mbështetje apo pa koordinim me faktorët tanë, të cilët gjithë proceset i kemi sjellë deri këtu ku jemi sot. Faleminderit për durimin!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përkatësisht kryetari i Grupit ka kërkuar që pjesa më e madhe e deputetëve janë larguar nga diskutimi për shkak të qëndrimit të qartë të Grupit Parlamentar të PDK-së. Kush do, mund ta marrë fjalën, sepse ka disa nga PDK-ja që janë prapë gjeneralë. Por, një pjesë e madhe është larguar dhe vendimmarrjen time e kam bazuar në nenin 40, pika 3. Po flas, vetëm të kemi parasysh, tërheqjen e deputetëve, por kush do, është i lirë, prapë është ky pak a shumë qëndrim i PDK-së që e tha Agim Çeku dhe Ganimete Musliu.

Dauti pati reagim, të bëhet gati Nuredin Ibishi.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Po i referohem fjalës së Agimit.

Edhe Agimi shumë mirë, krejt i shpjegoi saktë, por harroi se ka qenë vetë ministër dhe harroi që viti 2013 ishte deklaruar 'vit i ushtrisë'. Harroi që RSS-ja prej 2013-ës e sot është duke e pritur pikërisht këtë seancë, për shkak se Lista serbe nuk na e ka dhënë besimin, nuk mund të fshihemi ne, se tha deri në fund duhet pritur. A mund të dalë në mikrofon edhe një herë dhe ta na tregojë kur është fundi? Nëse e di ky në cilën ditë është fundi, e që unë nuk po e di, duhet pritur deri në fund Listën serbe, e para.

Fole me shumë kompetencë që nuk ka pasur tendencë të bisedohet me Listën serbe, a iu referove kryeministrit, presidentit edhe kryeparlamentarit në këtë, apo kujt i the, kush e ka përgjegjësinë?

E treta, the që është miratuar edhe në Komisionin Parlamentar dhe i janë proceduar Kryesisë amendamentet për ndryshimet kushtetuese. Mos u bë nervoz, Agim, me qetësi.

Zoti Agim Çeku, po të siguroj me kompetencë që në Kryesi kam marrë pjesë unë në emër të Grupit të Aleancës dhe kryetari i Kuvendit është këtu prezent, bashkë me shumë shefa të grupit parlamentar, të gjithë që kanë qenë aty dhe pyetja ka qenë shumë e qartë: A jeni marrë vesh me

Listën serbe? Përgjigjja ka qenë: “Jo”. Arsyeja e tërheqjes ka qenë pikërisht kjo. Do të thotë, ndoshta ti e ke një shkëputje prej FSK-së tash e një kohë dhe natyrisht mund të jesh edhe xheloz pse nuk je ministër, por nuk mund të shkojmë në pafundësi pa ushtri. Dhe, nuk është improvizim, po pikërisht ato mekanizma të NATO-s e të Forcave të Sigurisë e gjeneral shtabeve që i kemi aty, pikërisht i njëjti mekanizëm e ka bërë gati lëndën në versionin B, pikërisht edhe në kohën kur ju keni qenë ministër. Do të thotë, askush nuk po tenton të bëjë forca etnike, askush nuk po tenton të rrezikojë asnjë element serb, qëllimi final është të anëtarësohemi ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Agim Çeku, kundërreplikë, vazhdojmë.

AGIM ÇEKU: E para, rishikimi, si thonë, i sigurisë ka filluar në prill të 2012-ës. Kam qenë udhëheqës i Komitetit Drejtues, e kam udhëhequr këtë projekt, e di, domethënë jam i njoftuar shumë mirë, i di përpjekjet, të gjitha dhe ka përfunduar në shkurt të vitit 2014.

Në shkurt të vitit 2014 kemi filluar, është dorëzuar në Qeveri, është aprovuar në Qeveri, kanë ardhur në Parlament ndryshimet Kushtetuese dhe kanë filluar bisedat me komunitetin serb.

Në ato biseda kam marrë pjesë, kam qenë edhe me kryeministrin, ka qenë prezent edhe kryeministri i atëhershëm, zoti Hashim Thaçi dhe ka pasur gatishmëri. Të vetmin kusht e kanë pasur, po flas me kompetencë, sepse kam qenë prezent: “Do ta votojmë, a po na i jepni edhe për një mandat vendet e rezervuara”. Domethënë sot, jo për dy mandate e kanë pasur me Ahtisarin, e kërkonin edhe një mandat shtesë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Nuredin Ibish, përmbajuni Rregullores, ju lutem! Në diskutime shkojmë, Ismajl, t’i je më ekspeditiv.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Përfaqësues diplomatikë,
Media,
Qytetarë,

Së pari nuk e di kah ky shqetësim kaq i madh për diçka legale, për diçka që është bërë botërisht apo them ligjërisht, duke iu përmbajtur të gjithave, edhe marrëveshjes, edhe pakos së Ahtisarit, edhe Kushtetutës, edhe rishikimit strategjik apo raportit pas rishikimit strategjik të sektorit të

sigurisë. Mendoj që nuk është shqetësim, por është çështje për diskutim, edhe për zgjedhje të transformimit të FSK-së.

Unë së pari do të thërras edhe një herë në unitetin e Komisionit për Punës të Brendshme e Siguri lidhur me aspektin e mbikëqyrjes të FSK-së dhe zhvillimit të saj, bashkëpunimin e mirëfilltë.

Falënderoj gjithashtu edhe minoritetet, edhe thërras minoritetin serb që të përfshihet në votimin e amendamentimit të Kushtetutës për transformimin e FSK-së.

Në situatën e tashme të ndryshimeve të mëdha gjeopolitike dhe gjeostrategjike të sigurisë në rajon dhe në botë, që vijnë nga rreziqet dhe kërcënimet transnacionale me forma të reja të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, të cilat prekin ndjeshëm interesat dhe objektivat e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës, duke determinuar nevojën e transformimit të ndryshimit si në mision, ashtu edhe në detyra, të institucioneve tona të sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial.

Ky transformim ngërthen me vete edhe nevojën e ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Ky momentum përcakton edhe fillimin e transformimit të FSK-së sipas planit zhvillimor 10-vjeçar, pas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë së Kosovës.

Ngritja e kapacitetit të FSK-së në periudhën e caktuar duhet të shkojë në bashkëpunim dhe harmonizim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të pranisë ndërkombëtare ushtarake në Kosovë, KFOR-it dhe duke plotësuar standardet dhe kriteret e Aleancës Veri-atlantike të NATO-s, me synim që pas kalimit të fazës tranzitore, kjo forcë të bëhet pjesë e saj si mbrojtje kolektive.

Duke u mbështetur në dispozita dhe marrëveshje ndërkombëtare, të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, të cilat përcaktojnë misione në strukturën organizative dhe afatet kohore të transformimit që janë të parapara me rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë dhe, në rend të parë, është propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës nga marsi i vitit 2007, ku në nenin 5 përcaktohet se Forca e Sigurisë së Kosovës sanksionohet që nuk do të ketë armë të rënda, si tanke, artileri të rëndë dhe kapacitete ofensive ajrore që një formë e përcakton aspektin defensiv apo mbrojtës të saj.

Mandej Kushtetuta e vitit 2008, pra në nenin 1, si përkufizim të shtetit përcakton se Republika e Kosovës, në paragrafin 3, përcakton se Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjesë të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.

Neni 126, paragrafi 1, Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë e sigurisë së Kosovës dhe forcë kombëtare e Republikës së Kosovës.

Edhe në paragrafin 4, çka është me rëndësi po të këtij neni, te neni 126 përcakton se organizimi i brendshëm i FSK-së rregullohet me ligj, pra nuk është kategori kushtetuese.

E tash po shkojmë te Ligji i FSK-së rreth fushëveprimit, por edhe te neni 10, ku përcakton misionin dhe detyrat. Pra, edhe misioni dhe detyrat e FSK-së nuk janë kategori kushtetuese.

Edhe te i treti, që një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve që përcaktohet me pakon e Ahtisarit do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që nënkupton ka hyrë në vitin 2008 Ligji për FSK-në, ndërsa rishikimi i strategjisë të sektorit të sigurisë është bërë në vitin 2011.

Nga marrëveshja, Kushtetuta dhe Ligji për FSK-në po del me sa vijon:

FSK-ja është forcë kombëtare e sigurisë, është forcë defensive mbrojtëse për atë se Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale të ndonjë shteti.

Mandej, misioni, organizimi i brendshëm, struktura organizative e FSK-së është kategori ligjore, jokushtetuese, pra mund të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për FSK-në pa e bërë amendamentimin e Kushtetutës.

Ministria e FSK-së nuk është kategori kushtetuese, pra mund të ndryshohet Ligji për Ministrinë e FSK-së, të bëhet Ministri e Mbrojtjes.

Çështjet e ngritjes dhe të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, aktivë dhe rezervë, efektiva dhe plotësimit të standardeve do të zgjidhen me vendim politik mes autoriteteve të Kosovës, pranisë civile dhe pranisë ushtarake jo më herët se 5 vjet nga data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Në bazë të marrëveshjes të Ligjit të FSK-së, neni 10, misioni dhe detyrat, paragrafët 10.1, 10.2, ku çdo ndryshim në armatim do të përcaktohet nga prania ushtarake në bashkërendim me përfaqësuesit ndërkombëtarë, civilë dhe ushtarakë.

Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve do të bëhet jo më herët se 5 vjet, sikur që e ceka.

Në momentin e tanishëm, kur është bërë rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë, është ngritur buxheti i FSK-së në vitet buxhetore 2016-2017 për 9% dhe, me qëllim të realizimit të planit 10-vjeçar të zhvillimit të FSK-së, kur ende nuk kemi pëlqimin e Listës serbe për miratimin e amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas sistemit të 2/3 të minoriteteve,

propozoj që të bëjmë plotësim-ndryshimin e Ligjit për FSK-në, duke përfshirë, ky plani B, si po quhet, të mbetet miratimi i FSK-së, domethënë si emërtim.

Nën dy, të ndryshohet emërtimi i Ministrisë së FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes, plotësim-ndryshimi i Ligjit për FSK-në dhe ndryshime të ligjeve të tjera.

Nën 3, me Ligjin për FSK-në të bëhet plotësim-ndryshimi, të ndryshohet misioni, detyrat. Në vitin 2018 parashihet se Agjencia, atë çka e ceku zoti Çeku, Agjencia për Emergjencë Civile e Kosovës të marrë detyra primare të reagimit emergjent, ndërsa FSK-së i mbetet reagimi sekondar.

Nën 4, të përfshihet në Ligjin e FSK-së plani 10-vjeçar i zhvillimit të FSK-së sipas rishikimit të strategjisë të sektorit të sigurisë në forca, personal, efektiva defensiv, ngritje të kapacitete operacionale, logjistike, e të tjera.

Edhe pesë, në bashkëpunim dhe bashkërendim të autoriteteve të pranisë ndërkombëtare, civile dhe ushtarake të NATO-s dhe KFOR-it, të bëhet miratimi e planeve zhvillimore, mbikëqyrjes në përmbushjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe plotësimin e standardeve dhe kriterëve të parapara.

Kam qenë i mendimit para këtij debati që është dashur të kryhen një mori veprimesh, konsulta dhe aktivitete e subjekte që kanë ndërlidhshmëri me FSK-në, për këto që po flasim sot, duke filluar prej Kuvendit, grupeve parlamentare, partitë minoritare, Qeveria, Presidenca, Ministria e FSK-së, prania ndërkombëtare ushtarake, KFOR-i, NATO, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në Kosovë, SHBA, grupet e Kuintit, Akademia e Shkencave e Kosovës, shoqëria civile, institucionet e sigurisë, e të tjerë.

1. Nga institucionet që kanë këtë kompetencë kushtetuese, si Kuvendi, presidenti, Qeveria dhe Avokati i Popullit, sipas nenit 113 të Kushtetutës së Kosovës dhe, në veçanti, duke iu referuar praktikës së deritashme të presidentit për t’iu drejtuar me pyetje Gjykatës Kushtetuese ose me kërkesë për interpretimin kushtetues, në mundësi të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për FSK-në lidhur me misionet, detyrat, organogramin dhe çështje të tjera zhvillimore të FSK-së, që realisht deri tash nuk është bërë. Pra, është lëshuar një mundësi.

2. Konsultimet e autoriteteve të Qeverisë së Kosovës me autoritetet e misionit të pranisë ndërkombëtare ushtarake, po edhe diplomatike, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, grupit i Kuintit, e pranisë ndërkombëtare civile, sikurse që është përfaqësuesi i Bashkimit Evropian lidhur me plotësim-ndryshimin e Ligjit për FSK-në.

3. Bisedat dhe konsultat e brendshme Kuvend, Presidencë, Qeveri, me grupet parlamentare, minoritetet, në veçanti me Listën serbe për shqyrtimin e mundësisë së amendamentimit të Kushtetutës dhe 29 ligjeve që lidhen me FSK-në.

4. Debati dhe biseda me shoqërinë civile, qytetarët dhe institutet e specializuara dhe ekspertë të sigurisë, si të Akademisë së Shkencës së Kosovës, edhe institutet e sigurisë që realisht kanë bërë shumë debate dhe kanë dalë me shumë publikime, sikur që është Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, KIPRED-i, KATANA, e të tjerë.

5. Konsultat e vazhdueshme dhe raportet e mbikëqyrjes ndërkombëtare ushtarake ndaj FSK-së lidhur me përmbushjen e misionit, standardeve, kapaciteteve të FSK-së me gatishmëri për transformim të FSK-së që është dhënë, edhe çdo herë kanë qenë ato të nivelit të lartë.

6. Përgatitja e plotësim-ndryshimit të amendamentit të Ligjit për FSK-në dhe ligjeve të tjera nga autoritetet e FSK-së dhe Qeveria, sikur u raportua nga ministri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht do të doja ta pasqyroja edhe një herë një kronologji të të gjitha ngjarjeve që kanë të bëjnë me nismën e ndryshimeve kushtetuese, pra amendamenteve kushtetuese që kanë të bëjnë me krijimin e forcave të armatosura të Kosovës.

Më 6 mars 2014 Qeveria e Kosovës, e atëhershëmja, kishte miratuar amendamentet që kanë lidhje me shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Pastaj, më 11 mars 2014, kryetari i Kuvendit amendamentet i dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese.

Më 31 mars 2014, Gjykata Kushtetuese vendosi që kërkesa është e pranueshme.

Më 7 prill 2014 Kryesia e Kuvendit të Kosovës mori vendim që amendamentet t'i procedojë në komisionet përkatëse, në atë për Legjislacion, në atë për cilindo komision që do të duhej t'u nënshtroheshin këtyre ndryshimeve kushtetuese, nuk po i përmend me rend, për shkak se dihet cilat janë procedurat e një nisme të tillë nëpër komisione parlamentare.

Më 28 prill 2014 Kryesia e Kuvendit mori vendim që amendamentet e propozuara të procedohen për votim në seancën plenare.

Tash, nëse ju kujtohet juve që keni qenë atë kohë deputetë, dikush mund të jetë edhe tash në Qeveri, dikush të kundërtën.

Më 5 maj 2014, pika e katërt e rendit të ditës së seancës parlamentare ka qenë votimi i projekt-amendamenteve për ndryshime kushtetuese që ka të bëjë me shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur, duke filluar edhe nga misioni i saj kushtetues, edhe nga emri i saj dhe të tjerat që tashmë edhe u përmendën nga kolegët tanë, por edhe dihet se cilat janë ato ndryshime kushtetuese.

Kemi pritur atë ditë, nëse ju kujtohet, disa orë dhe gjatë kohës kur ne kemi pritur qoftë më 5 maj 2014, qoftë të nesërmen, më 6 maj 2014, deputetët serbë të asaj kohe kanë qenë fizikisht në Beograd për të marrë qëndrimin e Beogradit se a duhet të votohen apo s' duhet të votohen apo si të sillen ata në lidhje me këto ndryshime kushtetuese.

Prej asaj dite e deri sot Qeveria e Kosovës krijimin e kapaciteteve ushtarake e ka lënë në duar të vendimeve të Beogradit, se çka u thotë Beogradi deputetëve të tyre serbë në Parlamentin e Kosovës, se a t'i votojmë ndryshimet kushtetuese për shndërrimin e FSK-së në forcat e armatosura, apo jo?

Më 7 maj 2014, pra ditën pasuese, me 90 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime Kuvendi vendosi për shpërndarjen e legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, krejt kjo ndodhi në fund të mandatit të legjislaturës IV dhe krejt kjo ndodhi nën presionin e Qeverisë së Kosovës për të pranuar ne më shumë se sa krijimin e ushtrisë së Kosovës, vazhdimin e vendeve të rezervuara për serbët, ku ndërkohë ishte përgatitur tashmë Lista serbe që të futej në vota, në zgjedhje dhe ashtu si rezultat i saj, sot është pjesë e Parlamentit të Kosovës.

Edhe atë kohë kryetari i Grupit Parlamentar pati deklaruar se nuk u pajtuan, ne si grup parlamentar nuk u pajtuan, pra me vendimin e mazhorancës që të tërhiqen nga pika e rendit të ditës ndryshimet kushtetuese, për shkak se, pra, atë kohë u vendos që të tërhiqen nga rendi i ditës ndryshimet kushtetuese.

Kur po flasim këtu shpeshherë dhe, jo vetëm tash, por edhe në raste të kaluara është munduar disi që të fajësohet opozita pse ne sot s' kemi forca të armatosura të Kosovës. Çfarë paradoksi. Jo bash kështu e tha edhe vetë ish-ministri i atëhershëm i FSK-së, tash deputeti Çeku, që ka pasur subjekte politike që nuk kanë pranuar vazhdimin e vendeve të rezervuara për serbët dhe, si pasojë e kësaj, thotë, ne s' kemi ushtri. Kjo është e papranueshme. Përveç se është e papranueshme, është e pavërtetë, sepse ne edhe atëherë kemi qenë kundër siç iu referova transkriptit, kemi qenë kundër që të hiqen nga rendi i ditës këto pika, dhe atëherë e kemi dhënë mendimin tonë që Lëvizja "Vetëvendosje" do t'i përkrahë amendamentet kushtetuese, sikur edhe

të gjithë deputetët e tjerë, të cilat amendamente kërkonin atë kohë që të ndërrojë misioni i FSK-së në forca të armatosura të Kosovës.

Jo vetëm atëherë, po në vazhdimësi është munduar që Forca e Sigurisë së Kosovës, respektivisht ushtria e ardhshme e Kosovës të mbetet peng i disa koncesioneve në dëm të interesave të Republikës, në dëm të interesave të qytetarëve dhe shpeshherë në dëm të interesave edhe në dëm të vetë sovranitetit të Republikës së Kosovës. Atëherë, pra, është munduar dhe lënë peng FSK-ja për mandatet e rezervuara të serbëve.

Ndoshta ju kujtohet edhe gjatë votimit të Gjykatës Speciale ka pasur, por shqyr që nuk ka ardhur këtu një gjë e tillë.

Po ashtu, siç tha edhe zëvendësi i Qeverisë që FSK-ja tash qenka peng edhe i votimit për demarkacion, nuk u la fort anash, që mund të jetë kështu, edhe për krijimin e “Zajednicës”, prandaj prej fillimit e deri në fund, që nga marsi i vitit 2014 e deri sot Qeveria e Kosovës, edhe ajo e atëhershme, edhe sotmja, e ka lënë peng ushtrinë e Kosovës në varësi të vendimeve të dëmshme për Kosovën.

Se çfarë do të duhej të bëhej në këto raste, nuk është fort, ku ta dish se sa e zorshme të dihet, se çfarë do të duhej të bënim?

Lëvizja “Vetëvendosje” edhe një herë e përsërit që Qeveria e Kosovës ka mundur dhe sot mund ta bëjë atë çfarë parasheh ligji i tanishëm, infrastruktura e tanishme ligjore. Askush sot nuk ia ndalon FSK-së as me ligj, e kurrfarë pakoje tjetër që FSK-ja sot të jetë më e pajisur, që FSK-ja sot të jetë më e armatosur, që FSK-ja sot të jetë më e madhe në numër dhe askush deri më sot, asnjë ligj i Republikës së Kosovës nuk ia ndalon, pra Forcës së Sigurisë së Kosovës të jetë e shpërndarë dhe operacionale në gjithë territorin e Republikës. Edhe këtë nuk e ka përmbushur, pra, as ligjet e tanishme Qeveria e Kosovës nuk i ka përmbushur. Ajo çfarë mund të bëjë në ndërkohë është pra të zbatohet ligji i tanishëm, të amendamentohej ose të futej, siç edhe kryetari i Komisionit për Siguri e dha këtu propozimin dhe këtu parashihet edhe në projektrezolutën, pra të nisen nisma ligjore për plotësim- ndryshim të Ligjit për FSK-në, e cila i jep FSK-së mandat me mision ushtarak dhe të jemi të përgatitur që ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me ndryshimin edhe të emrit, edhe të misionit të saj kushtetues, të jenë thjesht ndryshime nominale në fund.

Pra, nuk e di se sa mund të presim nga Qeveria e tanishme ta bëjë diçka që duhet ta bëjë, kur e njëjta nuk po bën as atë çfarë sot mund ta bëjë. Dhe, ndërkohë nuk do të duhej që faktori ndërkombëtar të fajësohet për një gjë të tillë, për shkak se faktori ndërkombëtar nuk e ka penguar asnjëherë Kosovën në rritjen e saj, pra në rrugën e saj për rritjen e kapaciteteve ushtarake.

Në ndërkohë ne kemi mbetur, kemi ardhur në një situatë që jemi shumë të balancuar edhe në raportet me shtetet në rajon.

Më lejoni t'ju jap disa shifra, në varësi të kohës së limituar.

Nëse Kosova sot ka 2800 forca të FSK-së, 800 prej tyre i ka forca rezervë, në total 3600. Pra nëse sot Forca e Sigurisë së Kosovës ka 3600 forca, Mali i Zi i ka 13 mijë, nëse Kosova sot i ka 3600, Maqedonia i ka 12 mijë, Bosnjë e Hercegovina i ka 11 mijë, Shqipëria i ka 14 mijë, Kroacia i ka 42 mijë, kurse Serbia 90 mijë e 171 forca. Bëhet fjalë vetëm për forca ushtarake. A e shihni se sa të disbalancuar kemi mbetur në rajon dhe disbalanca e tillë është rreziku më i madh për konflikte, sepse e kundërta, balanca do të ishte garanci për paqen.

E në ndërkohë ne kemi kërkuar në çdo trajtim të buxhetit që edhe me buxhet Qeveria e Kosovës ta trajtojë forcën e sigurisë në mënyrë më dinjitoze dhe krahasimet janë këto.

Nëse Kosova sot ka 51 milionë euro, duke shtuar edhe atë 5-milionëshin, pra duke përfshirë edhe 5-milionëshin, i cili është i përfshirë për çdo vit si shtesë, Mali i Zi ka 80 milionë, Maqedonia i ka 108 milionë buxhetin e saj, Bosnjë e Hercegovina ka 138 milionë, Shqipëria ka 100 milionë, Kroacia ka 734 milionë, Serbia ka 452 milionë euro për ushtrinë, shto këtu edhe 300 milionë të tjera shtesë për armatim që ka vetëm sivjet. A e shihni se sa të disbalancuar jemi në rajon.

Prandaj, sot do të duhej që Qeveria e Kosovës ta merrte vendimin më të duhur në ruajtje të paqes, ta merrte vendimin dhe hapin e duhur për krijimin e kapaciteteve ushtarake të Kosovës.

Kështu që në varësi të kësaj, kërkoj edhe një herë që projektrezoluta e propozuar nga deputeti Haradinaj të mbështetet nga të gjithë dhe nga retorika dhe nga debati pra retorika e debatit të kalojmë në diçka konkrete, ku mendoj që të gjithë deputetët do të duhej ta përkrahni dhe mund ta përkrahin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Enver Hoti të bëhet gati.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Shteti i Kosovës hyri në një fazë të re në historinë e saj, e cila hap rrugë dhe plane për ndërtimin e institucioneve të veta, me programe konkrete zhvillimore në të gjitha sferat, duke i përfshirë edhe ato politike, ekonomike, fushën e respektimin të të drejtave njerëzore, të drejtën e qeverisjes, gjegjësisht aplikimin e shtetit ligjor, por edhe të sektorit të sigurisë.

Si pikënisje dhe si bazë institucionale zë vend të veçantë FSK-ja, si një kategori progresive e zhvillimit të forcës së armatosur të Kosovës, e cila do të ishte përshtatur me standarde perëndimore dhe të drejtën ndërkombëtare.

Kosova nuk e sheh veten si vend të izoluar në kuptimin e sigurisë, por më shumë e sheh vend që mund të kontribuojë edhe në sigurinë rajonale, e mund të absorbojë paqe dhe siguri, që prodhojnë të tjerët në rajon për Kosovën. Në kuptim të sigurisë e stabilitetit në rajon është se Kosova e arsyeton ngritjen e Forcave të Armatosura me një arkitekturë të re të sigurisë në koordinim me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, në bashkërenditje funksionale me koncepte e standarde të drejtuara nga Kushtetuta dhe ligjet, si dhe orientimet e mbështetjes së fuqishme të politikës ndërkombëtare, në këtë rast SHBA dhe NATO.

I gjithë programi për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur të Kosovës është dorëzuar në Qeveri dhe presim që të procedohet në Parlament me propozim për ndryshime kushtetuese. Siç dihet, Lista serbe është ajo e cila po e pengon këtë proces. Lista serbe në Kuvendin e Kosovës përfaqësohet me 11 deputetë, të cilët sa herë që bëhet fjalë për ndonjë të arritur të Kosovës e ngrijnë pjesëmarrjen e tyre edhe në Kuvendin e Kosovës, por edhe në Qeveri. Konsideroj që për këtë subjekt politik, i dirigjuar nga Beogradi, e që nuk paraqet përfaqësimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe nuk i mbron interesat vitale të popullit serb në shtetin e Kosovës, që me veprime të vazhdueshme obstruktive ndaj interesave të Republikës së Kosovës, duhet të shqyrtohet pozicionimi i tyre dhe të mos mbetemi pre e bojkotit që do të duhej të sanksionohej.

Ne e kemi obligim që të transformojmë Forcën e Sigurisë së Kosovës në ushtri dhe Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë zyrtarisht pjesë të caktuara të legjislacionit të domosdoshëm për zbatimin e kushteve për transformimin e FSK-së në FAK. Të gjitha kushtëzimet aktuale mund të eliminohen nëpërmjet ndryshimit të legjislacionit përkatës brenda dispozitave ekzistuese të Kushtetutës. Propozoj që krahas këtij procesi të hartohet edhe dokumenti shtetëror, strategjia shtetërore e sigurisë së Kosovës, e cila e ka burimin dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Strategjia e sigurisë së Republikës së Kosovës do të jetë dokumenti i sigurisë paqësore, e bazuar në vlera dhe praktika më të mira demokratike perëndimore.

Pra, një dokument modern i dizajnuar për t'u përballur me sfidat e sigurisë, sipas doktrinave dhe koncepteve perëndimore të sigurisë në shërbim të paqes. Kosova deri më tani kishte shumë zbrazëtira në aspektin e sigurisë nacionale për shkak të vetëpërmbajtjes së dokumentit të Rezolutës 1244, si kompetencë e rezervuar. Mirëpo, Kosova si shtet i ri me institucionet e veta është përgjegjëse për zbatimin e politikave për procesin e bërjes së një sistemi të sigurisë. Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta shprehimisht parashohin që FSK-ja duhet të themelohet dhe të operacionalizohet në mision të kufizuar, por duke lënë hapësirë që pas një periudhe pesëvjeçare

do të mund të rishikohej roli, misioni dhe nevojat për zgjerimin e kapaciteteve të kësaj force, e që i bie në vitin 2013.

Republika e Kosovës synon të jetë një faktor stabiliteti e paqeje në rajon dhe nuk shpreh armiqësi dhe pretendime territoriale për ndryshim kufijsh me përdorimin e forcës. Republika e Kosovës është kundër krijimit të krizave e konflikteve rajonale dhe të zgjedhjes së tyre me mjete të dhunës. Në këtë koncept, një ndër synimet strategjike të Republikës së Kosovës është ngritja e ushtrisë së saj dhe siguri i kapaciteteve për zhvillimin e operacioneve të mbështetjes së paqes në mbështetje të ligjit ndërkombëtar dhe parimeve humanitare nën drejtimin e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Me të drejtën ndërkombëtare dhe ligjeve aktuale, Republika e Kosovës mund ta ketë ushtrinë e vet dhe nëse nuk e emëron zyrtarisht me termin “ushtri”, por nëse i japim zgjerim të misionit, funksionet, kompetencat, armatimi dhe organizimin që është tipik për një forcë ushtarake. Zhvillimet gjeopolitike që po ndodhin, po hetohet sheshazi se shtetet individualisht janë duke investuar në fushën e mbrojtjes, atëherë kjo e shtrun nevojën që urgjentisht edhe Kosova ta ketë ushtrinë dhe garantimin e sigurisë për vete dhe stabilitetin në rajon.

Kërcënimi i sigurisë në Kosovë dhe në rajon nga Serbia e bën më shumë se të domosdoshme krijimin e Ushtrisë së Kosovës për mbrojtjen e vetvetes dhe integritetin territorial të saj. Kjo do të ishte një preventivë për çfarëdo kërcënimi apo rreziku të sigurisë së territorit tonë nga Serbia dhe kjo me automatizëm do ta shtynte Serbinë që ta ndryshonte qasjen aktuale ndaj nesh dhe ne, nga të qenët konsumues i sigurisë, Kosova do të bëhej kontribuuesi i drejtpërdrejtë në sigurinë rajonale dhe ju ftoj që të gjithë, pa dallim partie, ta përkrahim rezolutën dhe të kontribuojmë në formimin e Ushtrisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti e ka fjalën, bëhet gati shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht e shfrytëzoj rastin të falënderoj dhe përshëndes në emrin tim dhe të “Nismës” gjithë strukturën drejtuese, komanduese dhe gjithë personelin e FSK-së për punën, të cilën e kanë bërë, për përkushtimin dhe përgjegjësinë që kanë treguar në realizimin e detyrave dhe misionit që kanë pasur.

Me këtë dua të konstatoj se FSK-ja si trup dhe si organizatë e ka kryer misionin e vet dhe na ka dhënë mundësinë që ne të avancojmë më tutje, por u theksua se tre vjet na humbën, e unë mendoj që tre vjet janë tepër të mëdha për zhvillimin e kapaciteteve operacionale dhe për ndërtimin dhe avancimin e një trupe profesionale. Prandaj, kjo është e rëndë dhe është e papranueshme mendoj për të gjithë qytetarët, e veçmas duhet të jetë e papranueshme për ne dhe për Qeverinë aktuale.

E dëgjova ministrin me kujdes duke e paraqitur fjalën e tij dhe ngriti dy çështje që mendoj se duhet t'i trajtojmë. Ai i prezantoi një mori letrash dhe tentativa për të komunikuar me Listën serbe, por që nuk i kanë dhënë përgjigje, as ministrat e asaj liste dhe as Lista, mendoj se kjo është e papranueshme për ne si deputetë dhe sigurisht që nuk është pritur diçka tjetër nga kjo Listë serbe dhe nga këta ministra dhe mendojmë se nuk duhet të vazhdohet edhe më tutje me pritjen e ndonjë përgjigje pozitive të kësaj liste. Ndërsa, pjesa e dytë e fjalimit të ministrit që vendimmarrjen e adresoi te Kuvendi për këtë çështje, për themelimin e Ushtrisë së Kosovës, apo të Forcave të Armatosura të Kosovës, mendoj se ishte një tentativë aspak e mirë dhe goxha e sofistikuar, do të thosha e kamufluar për ta adresuar përgjegjësinë dhe për t'i ikur përgjegjësisë suaj si Qeveri, sepse edhe në të njëjtën kohë na paralajmërua se duhet të kemi kujdes se si do ta realizojmë dhe si do ta krijojmë atë forcë dhe ta koordinojmë më tutje me faktorin ndërkombëtar.

Unë mendoj dhe ndaj bindjen se të gjitha këto detyra i takojnë Qeverisë. Bashkëkoordinimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me faktorin ndërkombëtar është përgjegjësi juaja dhe vetëm juaja. Neve si Kuvend e keni mbështetjen tonë dhe nga ajo që e deklaruan edhe deputetët, nëse s'e kanë vetëm sa për retorikë elektorale deputetët e shumicës, e morët përkrahjen dhe ne do të ju mbështesim dhe i ftoj këto grupe parlamentare që unanimisht ta votojmë rezolutën e prezantuar nga zoti Haradinaj dhe që ju të ju ofrojnë një mundësi për të vepruar. Por, me sa po shihet nuk jeni të gatshëm që t'i merrni detyrat dhe përgjegjësitë tuaja. Nëse akoma vazhdohet kështu, ne ndajmë mendimin se ju duhet ta merrni një qëndrim krejtësisht tjetër edhe si ministër, pse jo ta rishqyrtoni edhe pozicionin tuaj në këtë detyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Kolegë deputetë,

Sigurisht që sot po debatojmë për një temë të ndjeshme, të ju them të drejtën nuk e kisha ndërmend të flas, por këtu u përmendën edhe disa çështje që më lejoni ta them edhe mendimin tim personal, por besoj edhe zoti Quni e ka thënë edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Është e vërtetë, por jo një parti politike, edhe Lidhja Demokratike, jo një që u përmend këtu, ka qenë kundërshtarë dhe refuzuese e vendeve të rezervuara dhe edhe sot konsiderojmë që kemi bërë mirë, sepse mund ta merrni me mend t'i kishim edhe ato vende të rezervuara, edhe ata deputetë, çfarë do të na ndodhte në situatat çfarë jemi tani. Prandaj, po e them, dihet publikisht që LDK-ja në atë kohë e ka kundërshtuar dhe është mirë që është bërë kjo, e para.

E dyta, nuk ka asnjë diskutim, asnjë dilemë që ne kemi nevojë për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, por po ashtu nuk kemi asnjë dilemë dhe asnjë dyshim se asnjë

Iloj ushtrie nuk i duhet Kosovës pa përkrahjen e partnerëve tanë strategjik, SHBA-ve e NATO-s, pa të cilat mund të kemi dëshirë të kemi ushtri, mund të kemi edhe shumë gjëra edhe në letër, por në realitet e dimë se çfarë do të ndodhte më vonë. Thjesht, ne duhet t'ua themi haptas qytetarëve, ne nuk kemi mbështetje aktualisht nga partnerët tanë strategjikë që FSK-ja të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. Nuk e kemi këtë mbështetje. Mos i thoni fjalitë deri në gjysmë, thoni deri në fund se si e thotë edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-së, edhe ministri i Mbrojtjes i SHBA-ve, edhe shumë e shumë të tjerë, e që na e thonë edhe në takimet që i kemi ndaras dhe a është interesi i Republikës së Kosovës që në një mënyrë, të mos them të dhunshme, por të njëanshme, të tentojmë të bëjë diçka pa përkrahjen e atyre që po na ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe të të bërit e asaj që aktualisht është FSK-ja? Dhe, a guxojmë këtë ta bëjmë në kuptimin e një qëndrimi të tillë që do ta bëjmë, “nuk ka rëndësi çfarë thonë tjerët”?

Jo, unë po e them si deputet, asnjëherë asnjë votë timen dhe besoj plotësisht të LDK-së, nuk do të marrë kurrfarë propozimi, i cili nuk e ka mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të NATO-s, ku synojmë të shkojmë. Nuk mund të shkojmë ne e të bëhemi anëtar i NATO-s duke i kundërshtuar edhe qëndrimet e tyre.

Kolegë të nderuar, qytetarëve duhet t'ua themi gjërat ashtu siç po na thuhet, në mënyrën shumë të qartë nga të gjithë ata që janë faktorë vendimmarrës dhe ne do ta përkrahim çdo vendim, çdo veprim, çdo punë që bëhet në koordinim me partnerët tanë strategjikë dhe nuk do ta përkrahim asnjë veprim tjetër, i cili bie ndesh me këtë partneritet tonin jetik.

Nuk mendoj që qëndron, ose që qëndrojnë disa krahasime. Është e vërtetë, po e marr Malin e Zi, po veç Mali i Zi është pjesë e NATO-s dhe nuk është bërë pjesë e NATO-s duke e kundërshtuar NATO-n, por duke bashkëvepruar me ta dhe duke i koordinuar punët dhe janë aty ku janë. Prandaj, kolegë të nderuar, ne si deputetë duhet parë me gjakftohtësi këtë punë, dhe unë mendoj që e vetmja gjë që në fund mund të dalë është ajo që e kemi thënë dhe e thashë në një mënyrë edhe në fjalën time deri këtu, që ne deputetët mund ta rikonfirmojmë edhe një herë vullnetin, dëshirën, nevojën, këmbëngulësinë tonë që të kemi transformim të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, por gjithnjë mbështetur dhe përkrahur nga partnerët tanë strategjikë.

Jashtë kësaj, çdo gjë, mund të citojmë nene, edhe unë kam mundur të marr të lexoj se çfarë thotë në ligjin këtë ose atë, cili nen çfarë thotë, por nuk e kemi përkrahjen, nuk kemi mbështetje ta bëjmë ushtrinë tonë pa koordinim dhe pa ata, të cilët janë mbështetësit tanë kryesorë në këtë rrugëtim tonin dhe ne besojmë thellë që përkrahja për FSK-në dhe në të ardhmen për Forcat e Armatosura të Kosovës do të jetë nga SHBA-ja dhe nga NATO-ja, por assesi jashtë përkrahjes së tyre dhe në asnjë mënyrë këtë nuk do të duhej të bënim veprime të tilla me votën tonë, sepse do t'i kushtonin Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë kemi një reagim nga Lëvizja “Vetëvendosje”, duke u lidhur me diskutimin po kërkojnë replikë. 2 minuta është replika, 1 minutë është kundër-replika. Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Po, nëse zoti Beqiri iu referua asaj çfarë thashë unë “mos i fajësoni miqtë ndërkombëtarë që ne sot s’kemi ushtri”, duhet ta përsëris edhe njëherë që nuk do të duhej thjesht tash herë ta fajësoni opozitën pse nuk dha vende të rezervuar, e herë ta fajësojmë ose të themi se nuk e kemi përkrahjen ndërkombëtare.

E kemi përkrahjen ndërkombëtare, por edhe nëse s’e kemi dua të rikujtoj diçka: në projekt-rezolutën e propozuar nga zoti Haradinaj dhe në emër të të gjithë deputetëve nënshkrues, ku edhe unë jam nënshkrues, atje thuhet shumë mirë që krejt kjo të ndodhë, pra në paragrafin 2, në koordinim të plotë të partnerëve strategjikë dhe të NATO-s. Pra, është e përfshirë kjo shumë mirë. Kërkojmë pikërisht koordinimin me bashkësinë ndërkombëtare dhe jo atë çfarë u mundua të thuhet që ne kërkojmë të bëjmë diçka në mënyrë të njëanshme dhe po ashtu edhe në paragrafin 3 është e thënë shumë mirë që pra institucionet t’i bashkërendojnë angazhimet për harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për zhvillim të kapaciteteve operationale konform misionit të ri të FSK-së.

Pra, nuk do të duhej të interpretohej kjo që ne po duam të bëjmë diçka në mënyrë të njëanshme. Përkundrazi, ne po duam që në bashkëpunim me ta dhe në koordinim të plotë me ta bëjmë një gjë të tillë, dhe edhe një herë dua ta them se nuk do të duhej thjesht të fajësoheshin ose të thuheshin që ne do ta bënim, por bashkësia dhe miqtë ndërkombëtarë nuk po na lejojnë. Ata na mbështesin neve në çdo iniciativë, e cila është e përshkruar edhe në dy paragrafë të kësaj projekt-rezolute.

KRYETARI: Kundër-replikë, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti Selimi, unë s’të përmenda, por sidoqoftë është e drejtë juaja ta thoni mendimin, ajo që po jua përsëris është për votat tuaja dhe qëndrimin e juaj në këtë rast vendet e rezervuara do t’i kishit pasur sot, kështu që unë këtu e pata dhe e thashë shumë qartë, sepse i kemi pas afro 30 vota, nuk më kujtohet saktësisht në mandatin e kaluar, dhe ti kot kishe folur sot, kishe menduar të thuash diçka të madhe, sepse ajo punë do të ishte kryer.

Por ne si LDK e kemi pasur atë qëndrim, ndërkaq për të tjerat unë e thashë një qëndrim shumë të qartë, pa koordinim, bashkëpunim dhe përkrahje të faktorit në këtë rast partnerëve strategjikë ne nuk përkrahim asgjë që ka të bëjë me këtë transformim të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Besim Beqaj..., Daut të mos i referohem si replikë a kundër-replikë, jua jap fjalën në fund, ti ashtu-kështu e ke sa të duash fjalën dhe e përmbledh, vetëm se projekt-rezoluta po diskutohet, ndërsa ne nuk e kemi propozimin, e është mirë të na sillni.

Na qartëso pra punën e projekt-rezolutës Daut. Dauti njëherë, pastaj Besim Beqaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Kryetar, unë në fillim e thashë, domethënë as që desha ta lexoj për shkak që t'u jepet kohë deputetëve që të diskutojnë dhe në fund ta sjellim një përfundim, por për të qenë më korrektë e lexova dhe asnjëherë asnjë pikë, asnjë presje, edhe një herë nëse do e përsëritim, nuk ka asnjë tendencë të njëanshme. Përkundrazi, është bukur e orkestruar, zoti Beqiri, domethënë e harmonizuar, e diskutuar, e trajtuar bukur gjatë.

Sido që të jetë, domethënë, ne këtu nuk jemi duke marrë vendim se nuk jemi duke e votuar ligjin. Ne jemi duke i dhënë obligim Qeverisë së Kosovës që t'i ndërmarrë masat. Kjo është duke u kërkuar sot, nuk e di pse debati po devijohet në drejtim ndoshta jo bash të qartë para opinionit, sepse ne sot nuk jemi duke votuar transformimin ose ndryshimin e ligjit. Ne jemi duke kërkuar prej Qeverisë, bile siç thashë edhe në fjalën hyrëse, edhe afatet kohore, unë e kam vënë si datë, por kjo nuk është as Bibël, as Kuran. Ne këtu do ta bëjmë bashkë, nëse është nevoja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë ka ardhur projekt-rezoluta, e qartësoi edhe zoti Haradinaj, Besim Beqaj e ka fjalën, dhe bëhen gati Teuta Haxhiu, e pastaj Gëzim Kelmendi.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk e pata në plan që të flas, sepse besoj që ka shumë njerëz të cilët në kuptimin profesional mund të flasin për transformimin e nevojshëm të FSK-së në Forca të Armatosura, por dua të kthehem pak në retrospektivë dhe kjo besoj ka të bëjë me punën e kryer apo të pakryer, e cila është dashur që të ndodhë gjatë viteve të kaluara.

Nëse mund të kthehemi pak në vitin 2013, vlerësimi i NATO-s ka qenë shumë i qartë se kapacitetet e FSK-së janë të gatshme për të marrë përgjegjësi, të cilat nuk janë specifikuar, por që realisht ka qenë një rrugë e hapur dhe unë besoj personalisht që ka qenë gabim mossjellja dhe marrja e vendimit të tillë dhe këtu të gjitha partitë politike, duke përfshirë edhe LDK-në, e cila nuk e ka votuar, atëherë një proces i tillë ka qenë gabim dhe duhet ta themi qartë para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës se një veprim i tillë nuk ka qenë në dobi të shtetit, por ka

qenë më shumë për çështje elektorale dhe më shumë për çështje të mosdhënies së një detyre të caktuar një partie.

Pra, ne duhet t'i kuptojmë edhe gabimet të cilat i kemi bërë, të mos mundohemi t'i pranojmë këto gabime si të tilla dhe të kalojmë nëpër to, por që ne prapë nuk duhet të fshihemi pas partnerëve ndërkombëtarë. Besoj që detyra e formimit të Forcave të Armatosura të Kosovës është detyrë e institucioneve, jo për të bërë gjëra, të cilat nuk janë të koordinuara dhe të planifikuara, por për t'i marrë hapat e nevojshëm institucionalë, ligjorë e profesionalë në ndërtimin e kapaciteteve.

Prandaj, në këtë drejtim besoj që është detyrë e Kuvendit të Kosovës, është detyrë e Qeverisë së Kosovës që sa më shpejt, në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare të ndërmarrë hapa, të cilët janë të nevojshëm për ta transformuar FSK-në në Forca të Armatosura të Kosovës.

Por, edhe një herë po e them, edhe kur bëhen gabimet politike, siç janë bërë në të kaluarën nga njerëzit, të cilët nuk e kanë votuar dhe nuk e kemi bërë, sepse nuk ishte ndonjë veprim shumë i madh në kuptimin e gabimeve, të cilat janë bërë. Unë besoj që ne duhet tani t'i marrim qëndrimet tona shumë të qarta drejt transformimit dhe të mos themi që kjo është apo ajo është pengesë. Besoj që rruga është e hapur, ne duhet t'i marrim përgjegjësitë tona në duart tona. Faleminderit!

KRYETARI: Gëzim Kelmendi, nuk qenka. Me parti po shkojmë. Teuta Haxhiu dhe bëhet gati Glauk Konjufca menjëherë. E kemi bërë një kapërcim, i kërkoj falje Lëvizjes "Vetëvendosje". Urdhëro, pastaj Glauk Konjufca, nga "Nisma" Shukrije Bytyqi e ka fjalën pastaj.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Me Pakon e Ahtisarit, Kosova do të duhej ta kishte ushtrinë e vet që në vitin 2013, por edhe sot e kësaj dite institucionet përkatëse ende nuk janë të gatshme t'i themelojnë Forcat e Armatosura.

Deklaratat e vazhdueshme të krerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës se kjo forcë është që moti e gatshme të transformohet në Ushtri të Kosovës, përkatësisht në Forca të Armatosura, në njërën anë, dhe kërkesat e vazhdueshme të deputetëve dhe opozitës, në përgjithësi, dhe të qytetarëve, ka vite që po hasin në vesh të shurdhër nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Situata e krijuar sidomos ditëve të fundit përballë provokimeve të vazhdueshme të Serbisë ka bërë që jo veç ekspertë të fushës e politikanë, por edhe njerëz të rëndomtë gjithandej të flasin për krijimin sa më të shpejtë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.

Edhe pse për krijimin e ushtrisë do të duhej të punohej çdo ditë, e jo veç kur shfaqen situata të pakëndshme, sikur këto të kohëve të fundit, e këtë do të duhej, para se gjithash, ta bëjë Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila tashmë veç po shihet që i ka humbur të gjitha rrugët. Krijimi i

Forcës së Sigurisë së Kosovës, pra në radhë të parë do të duhej të ndodhte si domosdoshmëri për ofrimin e sigurisë për të gjithë, e jo si reagim ndaj provokimeve që vijnë nga Serbia, e që nuk do të ndalen as viteve në vazhdim, sepse ne jemi të vetëdijshëm se me kë kemi të bëjmë. Në këtë rast ndoshta Qeveria e Republikës së Kosovës do të duhej të reflektonte ndryshe duke e ditur pra se kush është shteti serb.

Transformimin e Forcës së Sigurisë nuk po e kërkojmë për inat të askujt, as për inat të serbëve, përkundrazi ne mendojmë se edhe interesi i tyre është forcimi i shtetit të Kosovës, sepse ata këtu e kanë të ardhmen. Nuk është e ardhmja e tyre në Serbi. Ata do të duhej ta ndërtojnë jetën së bashku me ne. Prandaj, nuk do të duhej të jenë pengesë në këtë proces shumë të rëndësishëm për vendin tonë, për shtetin e Republikës së Kosovës. Forcat e Armatosura do të jenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, andaj është shumë e rëndësishme që për krijimin e këtyre forcave të pajtohen edhe serbët, të cilët pretendojnë të jetojnë në Kosovë, e jo për ata që vërtet nuk i përfaqësojnë denjësisht, edhe pse janë të ulur në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sepse serbët kosovarë do të jenë të përfaqësuar sikur në Forca të Sigurisë të Kosovës, ata do të jenë të përfaqësuar sidomos sipas përqindjes edhe në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Kjo do të ishte një garanci shtesë se kjo forcë do të jetë multietnike dhe do të ofrojë siguri për të gjithë. Ne si Aleancë, por edhe si deputetë, edhe të opozitës, në kontinuitet kemi kontribuar dhe jemi të interesuar të mos e kursejmë kontributin tonë në forcimin e Forcës së Sigurisë pra në Ushtri të Kosovës. Prandaj, ne mendojmë se Ligji për Forcat e Armatosura të Kosovës të procedohet dhe si i tillë të miratohet urgjentisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që Forcat e Armatosura të Kosovës të mos ngelin peng i zhvillimeve, apo peng i pazareve politike.

Kosova ka nevojë që krahas thellimit të raporteve me NATO-n të fokusohet sa më shpejt për gjetjen e zgjidhjeve dhe modaliteteve për ndërtimin e kapaciteteve operative të mbrojtjes. Në pamundësi të transformimit të FSK-së në ushtri nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, Qeveria e vendit do të duhej që maksimalisht t'i përkushtohet punës për ndryshimin e legjislacionit aktual për FSK-në, për ndryshimin e atyre dispozitave ligjore në lidhje me kufizimet sa u përket kompetencave, armatimit dhe numrit të personelit të Forcës.

Duke marrë parasysh që në Kushtetutën e Kosovës nuk ekzistojnë kufizime sa u përket këtyre elementeve të FSK-së, atëherë nuk ka kohë të pritet dhe nuk ka kohë që kjo të zvarritet më tutje.

Për më tepër, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ne kolegë deputetë, duhet të iniciojmë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin e FSK-së, në mënyrë që ta bëjmë kë të fundit forcë ushtarake për të marrë autorizimet përkatëse në fushën e mbrojtjes.

Për realizimin e këtij plani nuk ekzistojnë kurrfarë pengesash, gjegjësisht nuk kërkohen 2/3-at e votave të deputetëve në Kuvendin e Kosovës nga komuniteti pakicë. Për ndryshimin e këtij hapi nevojitet politik dhe guxim i udhëheqësve të institucioneve, gjë që po mungon e që nuk është dëshmuar deri më tani. Prandaj, mbetet në dorën tonë sot, të nderuar deputetë, që të marrim hapin e duhur, sepse para së gjithash betimi ynë është për të mbrojtur sovranitetin e vendit dhe për tu garantuar edhe të gjithë qytetarëve një stabilitet dhe një jetë më të mirë në vendin tonë.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën. Në ndërkohë bëhet gati zonja Shukrije Bytyqi.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Në diskursin tonë publik, sidomos në mesin e njerëzve që e krijojnë edhe opinionin publik, te ne quhen edhe analistë, ka dominuar justifikimi se Kosova bën edhe pa ushtri, duke thënë që jo çdo shtet në Botë ka ushtri dhe se po nuk patëm ushtri nuk bëhet nami.

Kurse, dihet fare mirë që në arenën ndërkombëtare shtetet me ushtri janë vetë rregulli, kurse shtetet pa ushtri janë më tepër përjashtim nga rregullat. Në Kosovë është investuar shumë që përjashtimi të konceptohet si rast normal e ushtria është një prej elementeve konstitutive të shtetësisë. Edhe ato shtete që nuk kanë ushtri, së paku kanë marrëveshje me shtete të tjera, që t'i mbrojnë ato në rast të sulmeve eventuale. Pra, ka një arsye të brendshme dhe parimore pse Kosova duhet të ketë ushtri.

Por edhe zhvillimet e jashtme po tregojnë, që ushtria për Kosovën është një domosdoshmëri, sidomos nëse e mendojmë brishtësinë e gjendjes së sigurisë pas hegjemonizmit rus, që gjatë dekadës së fundit i kishte tri momente të tij të agresionit global. Pra, së pari ndërhyrjen ushtarake në Gjeorgji, në vitin 2008, së dyti pushtimin e Krimesë, në vitin 2014 dhe së treti ndërhyrja në Siri, tash së fundi, para tre muajve, në fund të vitit 2016.

Ky hegjemonizëm i Rusisë e ka sfiduar seriozisht balancën ushtarake globale të ndërtuar pas rënies së Murit të Berlinit dhe ky sfidim po reflektohet edhe në Ballkan, siç po ndodh, për shembull, me destabilizimin e brendshëm të Malit të Zi nëpërmjet opozitës pro-ruse atje e në anën tjetër, me armatosjen e vazhdueshme të Serbisë përmes marrëveshjeve ushtarake, përmes shumë marrëveshjeve ushtarake, se Serbia i ka realizuar kohëve të fundit me Rusinë, siç ishte ajo e marrjes së nëntë aeroplanëve ushtarakë para një muaji nga Rusia, pak më herët blerja e dy helikopterëve ushtarakë nga Rusia, në nëntor të vitit të kaluar, nuk bën ta harrojmë edhe ushtrimin e përbashkët ushtarak të Ushtrisë, Bjellorusisë dhe Serbisë, të quajtur “Vëllazëria Sllave”. Pra, të gjitha këto tregojnë që Serbia, jo vetëm që nuk është larguar nga Rusia, kemi dëgjuar shumë për këtë diskursin ndërkombëtar që duhet t'i ofrohen kompromise Serbisë, për shkak që me e largua prej Rusisë. Jo vetëm, që kjo nuk ka ndodhur, por gjatë vitit 2016 ajo që kemi parë në arenën ndërkombëtare dhe në Ballkan është, se Serbia është duke u shndërruar

gjithnjë e më shumë në një bazë logjistike të Serbisë, me këto marrëveshje ushtarake, me armatimin e vazhdueshëm dhe tash edhe me mundësinë e aktivizimit të mburojës ajrore, pra të mbrojtjes ajrore, të rrjetit antiraketor, që quhet S300, që po ashtu vjen nga Rusia.

Pra të gjitha këto, edhe rrethanat globale, edhe rrethanat rajonale, na tregojnë që shndërrimi i FSK-së në ushtri është jo vetëm i fushës së sovranitetit shtëpiak edhe si parim i shtetësisë, po pas këtyre zhvillimeve globale dhe rajonale një ushtri për Kosovën është edhe një domosdoshmëri, që po e imponojnë gjithnjë e më shumë rrethanat e krijuara ndërkombëtare.

Po këtu ne mbajmë mend shumë mirë, që më 13 janar të vitit 2013, Qeveria e Kosovës ka dalë dhe ka thënë viti 2013 do të jetë viti i FSK-së ushtri. Pra, ky premtim ka qenë zyrtarisht, për herë të parë Qeveria Thaçi II e ka dhënë më 13 janar të vitit 2013. Pra, kanë kaluar më shumë se katër vjet prej kur është bërë ky premtim qeveritar e tash jemi në shkurt të vitit 2017 dhe asgjë nuk ka ndodhur deri tash, asgjë substanciale në fakt nuk ka ndodhur deri më tash, në drejtim të shndërrimit të FSK-së në ushtri.

Tash të dalim te ajo për të cilën diskutoi zoti Beqiri, se çka në të vërtetë mbrojnë miqtë tanë ndërkombëtarë dhe cili është qëndrimi, së paku i dy fuqive, që për ne janë relevante këtu në Kosovë dhe më të rëndësishme e që janë Aleanca Veriatlantike dhe Departamenti Amerikan i Shtetit. Unë mendoj që sa i përket Departamentit Amerikan të Shtetit, deklarata e fundit e ministrit të mbrojtjes është pa ekuivoke, është pa kurrfarë dykuptimësie ajo, është shumë e qartë dhe shumë e drejtpërdrejtë - FSK-ja duhet të bëhet ushtri. Por, sa i përket zotit Stoltenberg, i cili ishte në Prishtinë dhe i dha ato qëndrimet e tij, se cili është vizioni i NATO-s për FSK-në, atëherë këtu mund të kemi interpretime, por unë prapëseprapë e lexova edhe një herë me vëmendje edhe deklaratën zyrtare të NATO-s, pas konferencës për shtyp të zotit Stoltenberg dhe aty më bënë përshtypje nja dy-tri gjëra, të cilat dëshiroj t'i ndaj me juve këtu.

Kur pyetet lidhur me FSK-në dhe avancimin e mandatit të FSK-së në ushtri, zoti Stoltenberg thotë kështu: “Ne e përkrahim FSK-në brenda këtij mandati aktual.”, qysh e ka tash mandatin FSK-ja, “por...” thotë ai, “sa i përket avancimit të këtij mandati, nuk i përket NATO-s ta bëjë” thotë, “institucioneve të Kosovës i përket kjo kompetencë. Mirëpo, nëse ndodhë kjo...” . Pra, nëse do të ndodhte avancimi i mandatit dhe misionit të FSK-së në ushtri, atëherë Këshillit Veriatlantik që është njëri prej institucioneve më të rëndësishme të NATO-s, një Qeveri e NATO-s le të themi, “i përket që ta”, ka thënë ai, “i përket që ta shqyrtojë rikonfigurimin e statusit të KFOR-it, pra në Kosovë”, sepse ju e dini, KFOR-i është njëfarë ushtrie e vërtetë e Kosovës, FSK-ja është njëfarë formacioni joushtarak, i cili duhet të merret me të gjitha veprimtaritë, bile edhe në Ligjin e FSK-së shkruan, FSK-ja disi përcaktohet në mënyrë negative, thotë që FSK-ja merret me të gjitha ato punë që janë të papërshtatshme për Policinë, diçka me të cilat s'mund të merret Policia, diçka që është më shumë se Policia dhe më pak se ushtria.

Dhe, zoti Stoltenberg thotë që “atëherë shndërrimi i FSK-së në ushtri do t’ia zinte vendin KFOR-it”, se KFOR-i është ushtria e vërtetë e Kosovës tash dhe, nëse do t’ia zinte vendin KFOR-it atëherë, NATO-ja do të mbledhej dhe do ta shqyrtonte statusin e ri të KFOR-it.

Pra, zoti Stoltenberg nëse interpretojmë deklaratën e saktë të tij, nuk mendoj që ka thënë në mënyrë eksplicite, se nuk do të bëhet ushtria FSK-ja, ai ka thënë që nëse ju e bëni këtë atëherë ne na mbetet ta bëjmë edhe ne punën tonë, që është rishqyrtimi i mandatit të KFOR-it.

Dihet që NATO-ja përmes misionit të vet, që është KFOR-i, angazhohet në Kosovë sipas një mandati të OKB-së, sipas një mandati të dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Ky mandat si forcë ushtarake e njeh KFOR-in, kurse FSK-ja është forcë e sigurisë me armatim të lehtë, kompetencat e të cilës nuk janë klasike ushtarake, qysh i kanë ushtritë e zakonshme, si për shembull, mbrojtja e kufijve dhe mbrojtja e territorit dhe plus, që është precizuar se FSK-ja nuk ka të drejtë të ketë armatim artilerik, por për ta përfunduar, ky ligj për FSK-në është shumë i vjetër tashmë, ky që e kemi aktualisht. Përveç tjerash, përveç që kemi nevojë për ushtri, është i vjetër edhe nga një aspekt tjetër. A e dini ju, për shembull, që në nenin 10 thuhet që shndërrimi i FSK-së ose avancimi i misionit të saj duhet të bëhet në përputhje me përfaqësuesin civil ndërkombëtar. Po më falni, por përfaqësues civil ndërkombëtar nuk ka prej 2012-ës. Këtu kemi të bëjmë që 5 vjet me kategori antikushtetuese.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shukrije Bytyqi, fjala për ju. Kërkoj falje Zonja Bytyqi, qëndro të lutem, vetëm le ta përfundojë replikën Zoti Beqiri, sepse i është përmendur emri, dy minuta!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe më herët e thash dhe qëndroj pranë asaj, se fjalitë nuk lexohen deri në fund të zyrtarëve, në këtë rast, zyrtarëve të rëndësishëm, siç është ministri i Mbrojtjes i SHBA-ve, po edhe i zotit Stoltenberg. Problemi është këtu, lexojini deri në fund fjalitë. Lexojini krejt fjalitë dhe qëndrimet e jo atë që keni qejf. Ne të gjithë kemi dëshirë me e bë ushtrinë, nuk e kontestoj askush këtë, por është thënë shumë qartë, na është thënë shumë qartë, unë nuk di a kontakton kusht me ju, sinjerisht, nuk janë dy departamente të Shtetit Amerikan, veç një është, veç një ministër e kanë. Veç një sekretar i përgjithshëm i NATO-s është, ata takohen me zyrtarë edhe zyrtarët tanë, siç është kryeministri, kryetari i Kuvendit, presidenti... i thonë qëndrimet e qarta. Këto janë qëndrimet e qarta të tyre.

Aktualisht, “Nuk ka transformim...” , sipas tyre, unë po e them shumë zëshëm, “...pa ndryshime kushtetuese.” Dhe, ajo që u tha më herët edhe nga zoti Haradinaj, OK, kur të thuhet që në këtë rrugëtim do t’i bashkëveprojmë, ose do të bashkëveprojmë, për ne është OK, por jo në mënyrë të njëanshme. Dhe, ne nuk jemi, në asnjë rrethanë, aq më tepër tash, për t’ia zënë vendin KFOR-it, po do të ishte shumë gabim. Domethënë, në një mënyrë po e pranojmë ne, po e bëjmë ushtrinë,

sado që është e fortë aktualisht, ose do të mund të ishte për një periudhë të shkurtë, gjë që s'mund të ndodhë kjo, e le të shkojë KFOR-i, se kështu është thënë. "E bëni ju pa koordinim me ne, ne ecim..." dhe ne këtu nuk dëshirojmë ta bëjmë, kjo është më se e qartë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Konjufca, kundër-replikë 1 minutë!

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që diskutimi i zotit Beqiri ishte shumë joprofesional.

Tashmë, edhe institutet shumë të njohura edhe ndërkombëtare edhe vendore, në studimet e tyre e kanë vërtetuar se për tu bërë FSK-ja ushtri nuk ka nevojë për ndryshime kushtetuese. Pra, nëse e kemi për ndryshimin e mandatit dhe misionit të FSK-së, që është neni 10 i Ligjit aktual edhe nëse kemi të bëjmë me ndryshimin, pra me heqjen e kufizimeve për armatimin e FSK-së, siç thuhet, këto dy pikë nuk kërkojnë kurrfarë ndryshimi kushtetues, sepse këto nuk janë pika në Kushtetutë, me të cilën kufizohet armatimi i FSK-së apo misioni i vet. Misionin FSK-ja në Kushtetutë e ka pa kufizime, kështu që mund ta ndryshojmë vetëm ligjin, po qe se doni ta bëni ushtri. Pra, kjo nuk ka të bëjë fare me atë që tha ai, kurse sa i përket departamentit të shtetit, unë prapë mendoj që deklarata e tyre ishte shumë e qartë.

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë me diskutime apo shkojmë me projektrezolutën e harmonizuar. Po, zonja Bytyqi, gjithsesi fjala për ju, por më vonë...

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Forca e Sigurisë së Kosovës duhet të shndërrohet në ushtri, kjo nuk ka dilemë.

Një ndër shtyllat kryesore të shtetit në shërbim të sigurisë, ruajtjes së sovranitetit, por edhe të fuqizimit të shtetit në aspektin e balancimit të forcave, që do të kontribuonte në stabilitet, është edhe transformimi i FSK-së në ushtri të Republikës së Kosovës.

Kosova e pati fatin që nga paslufta të fillojë një transformim të ushtrisë me kompetenca të kufizuara, së pari prej UÇK-së në TMK e pastaj prej TMK-së në FSK. Por, asnjëherë kjo forcë që është më e besueshmja dhe më kontributdhënësja në Kosovë nuk u shndërrua në ushtri dhe për fat të keq, për gjithë këtë faji është i politikës apo më mirë të themi, i qeverisjeve të dobëta.

Të nderuar qytetarë, ndonëse kriza ka filluar anekënd Botës dhe lëvizjet politike ushtarake kanë marrë dhenë, Kosova ende mbetet peng i dhjetë individëve, të cilët nuk e dëshirojnë themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Gara e armatimit në Rajon është evidente, njëkohësisht rritja e numrit të ushtarëve po ashtu, ndërsa Kosova edhe pse ka kapacitete për themelimin e ushtrisë, mbetet peng

i politikës, i marrëveshjeve të dëmshme nga kjo Qeveri, që me paaftësinë e vet nuk është në gjendje të themelojë ushtrinë.

Ndonëse, kemi humbur shumë kohë, tanimë është momenti i fundit që kjo Qeveri të pranojë paaftësinë për themelimin e ushtrisë. Sot, ne duhet të jemi të vëmendshëm, se çfarë në të vërtetë po bën ky pushtet për të mjegulluar edhe më tej këtë gjendje.

FSK-ja ka kapacitete të mjaftueshme për të bërë ushtri dhe kjo është vlerësuar edhe nga institucionet më kredibile ndërkombëtare në fushën e sigurisë. Prandaj, çdo ditë e humbur është me vite larg arritjes së qëllimit tonë për shtetformues dhe shtet të fortë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definon FSK-në si forcë kombëtare të sigurisë, që mbrojnë qytetarët e Republikës së Kosovës në nenin 126 të saj, kurse misioni, detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me ligjet e Republikës së Kosovës. Kjo Qeveri është duke proklamuar se ndërkombëtarët po pengojnë Ushtrinë e Republikës së Kosovës. Atëherë, ne themi me shumë të drejtë, se a ka shtet ndërkombëtar që e ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe që ka deklaruar se nuk do të njohë ushtri të Kosovës, ose a ka shtet që e ka njohur Republikën e Kosovës dhe nuk ka ushtri të saj. Prandaj, kjo mjegull që po trazon mendjen e qytetarëve për sigurinë e tyre, po e humb durimin edhe te qytetarët, por edhe te një pjesë e politikës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, krijimi sa më i shpejtë i kësaj ushtrie do të forconte paqen dhe stabilitetin në rajon, do të balanconte forcat aleate në rajon dhe ndërkombëtar dhe do të ndikonte fuqishëm në ruajtjen e sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës.

Mua më vjen shumë keq, se edhe në pasqyrat financiare të kësaj Qeverie mungon buxheti i rritur për ushtrinë, që do të rriste kapacitetet operuese të saj dhe njëkohësisht modernizimin dhe profesionalizimin e saj. Qytetarët e Republikës së Kosovës dëshirojnë të dinë se përse Qeveria e Republikës së Kosovës deri më tani nuk ka marrë asnjë hap konkret në lidhje me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Ne e kemi dëgjuar kryeministrin e Republikës së Kosovës duke thënë, se kjo është për shkak të mospërkrahjes së Listës Serbe.

Unë pyes kryeministrin e Republikës së Kosovës, se a meritojnë qytetarët e Republikës së Kosovës, që djemtë dhe vajzat më të mira të kombit të jenë pre, që të mos e kenë statusin e ushtarit të Republikës së Kosovës, për tekun e Listës serbe.

Prandaj, të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që të jemi të vëmendshëm dhe së paku ndaj këtij institucioni dhe të gjithë të japim kontributin tonë në themelimin e një ushtrie stabile, të fuqishme, që do t'i shërbente dhe do tu përgjigjej nevojave të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhjetë kolegë deputetë kanë kërkuar fjalën. Ndërkohë, grupet parlamentare pothuajse e kanë harmonizuar projektrezolutën. Ne mund të vazhdojmë, unë fjalën s'ia ndal askujt, por në qoftë se është çështja për Forcën e Sigurisë së Kosovës, transformim në Forca të Armatosura, në qoftë se kemi konsensus të të gjitha grupeve parlamentare, ne shkojmë në votimin e projektrezolutës. Si të doni! Ju e vendosni! Kryetarët e grupeve parlamentare le të ma japin një qëndrim. Po e bëj një pauzë tre minuta brenda salle. Pastaj, ose e vazhdojmë... në rast se shkojmë drejt në votimin e projektrezolutës, deputetët kanë të drejtë që fjalimet e tyre t'i depozitojnë dhe u botohen sikurse t'i kenë mbajtur. Vetëm tre minuta, maksimum. Pastaj, unë prapë fjalën askujt s'ia ndal, në qoftë se s'tërhiqet. Jemi tre minuta në pauzë brenda sallës.

Ndërkohë, kolegët janë duke bashkëbiseduar në grupe parlamentare. Vazhdojmë diskutimet. Po shkojmë në bazë të partisë. Shukri Buja, Armend Zemaj.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Fillimisht, përsëri po e bëj një vërejtje.

I lutem kryetarit, që të mos seleksionojë fjalën e deputetëve. Në qoftë se, e kërkoj fjalën, e kam kërkuar me fillim, ende pa u hapur diskutimi, të më jepet fjala qysh e kërkoj. Zenuni s'qenka këtu, por qenka... jo, erdhi Zenuni. Më vjen mirë që erdhi!

Unë në qoftë se, nuk diskutoj për ushtrinë, unë nuk di të diskutoj për pesticidet. Ju lutem!

Po, u fol bukur, bukur shumë, këtu për politikën e shkuara, kush ishte fajtor... madje, diskutuan ata që janë protagonistë të dështimit të formimit të ushtrisë. Faji gjithmonë mbetet jetim e në politikë po mbetet dy herë jetim.

Këtu folën u fol nga dy, nga ministri dhe shefi i grupit parlamentar në të kundërtat e tyre, ministri e tha shumë qartë, që e kemi përkrahjen e sekretarit të mbrojtjes amerikane të NATO-s, për formimin e ushtrisë, ju thatë jo. Njëri e keni keq. Njëri e keni keq, s'e di cili e keni keq, por unë sikur të kisha thënë kështu, o do të jepte ministri ose shefi i grupit parlamentar. Mos bëni hajgare me këto deklarata. Qartësojeni qëndrimin, sepse sigurisht, i nderuar, nuk je i informuar sa unë në parti edhe ti në LDK, s'qenke i informuar.

Çështja e ushtrisë është një çështje e vogël për mbrojtjen, sidomos kur mbrojtja bëhet nga një ushtri profesionale. Mbrojtja është një fushë bukur e gjerë, në kuadër të saj përfshihet edhe instrumenti i mobilizimit, që ne s'e kemi fare, përfshihen edhe struktura të tjera, si arsimi dhe edukimi, të cilat duhet të përfshihen pjesët arsimore, u tha këtu edhe rreth fakultetit të mbrojtjes,

e tjerë... por, do të thotë është një fushë shumë e gjerë, ndërsa ne jemi përqendruar vetëm te ushtria.

Po, ju deputetë të nderuar, kur e kam shtruar që tri çështje kryesore i kam shtruar për buxhetin dhe e kam kundërshtuar buxhetin, ka qenë çështja... s'po i përmendi këto, por ka qenë njëra nga këto tri çështje ka qenë çështja e buxhetimit për FSK. Ne as sinjal nuk kemi dhënë se duam ta transformojmë FSK-në në ushtri, as sinjal buxhetor, lëre më të planifikohet me buxhet. Po, atëherë nuk na pat provokuar Serbia, kur na provokoi, atëherë "Oo kuku, s'e paskemi ushtrinë!". Edhe ju, deputetë të nderuar, në këtë nivel jeni.

Kushtetuta e ka në nenin 126 çështjen e FSK-së, 5 paragrafë i ka krejt. Në ato pesë paragrafë emri është FSK, as nuk përcakton organizimin, as misionin, as fushëveprimin, as detyrat, këto përcaktohen përmes Ligjit të FSK-së. Dhe, në ato pesë paragrafë rregullohet veç kush është komandanti i përgjithshëm, procedura kush e emëron komandantin e FSK-së, procedura tjetër është çështja që i mbron të gjithë qytetarët pa dallim etnie edhe që janë të gjitha një pjesë e forcës së sigurisë. Ndërsa me ligj, në nenin 10 u potencua këtu, përcaktohet, përcaktohen edhe fushat e përgjegjësi apo organizimi, misioni, fushëveprimi, e të tjera.

Te neni 9 kemi mundësi ta ndryshojmë. Në qoftë se e ndryshojmë ligjin, edhe në rast që e dini për 2/3 e pakicave dhe 2/3 e Kuvendit, është vështirë të ndryshohet Kushtetuta, por do të ishte mirë. Do të ishte e mirëseardhur ta ndryshonim Kushtetutën. Por, ne s'do të jemi peng, në qoftë se kemi mundësi të ndryshme ligjore, që këtë pamundësi ta ndryshojmë.

Në nenin 9.3 përcaktohet në këtë ligj, i cili thotë që "FSK-ja i përmbush funksionet e saj" dhe mund ta ndryshojmë këtë nen në "funksionet që i dëshirojmë", në pajtim normalisht me komunitetin ushtarak ndërkombëtar.

Po ashtu, në nenin 10, te misioni dhe detyrat, mund t'ia përcaktojmë misionin e qartë Forcës së Sigurisë për mbrojtjen e sovranitetit, ashtu sikur që mund t'ia përcaktojmë edhe në 10.2, ku përcaktohet që FSK-ja çfarë armësh ka, për ta përgjithësuar atë.

Në ligjin e FSK-së ajo që pengon në këtë moment është në aspektin e organizimit, sidomos të kapaciteteve të armatimit. Thuhet nuk kemi të drejtë të posedojmë tanke, nuk kemi të drejtë të artillerisë së rëndë dhe aviacionit sulmues.

Kurrkush s'na ka penguar se s'është tank autoblanda me artilleri të lehtë apo me mitraloz të rëndë. Kurrkush s'na ka penguar të kemi helikopter, sepse nuk llogariten aviacion sulmues ajror, do të thotë nuk llogariten në forcën ajrore sulmuese, por mbrojtëse. Kurrkush nuk na ka penguar të kemi armatime shtesë apo rezervë për ushtarët që i kemi në këtë kapacitet, madje në këtë nen parashihet që pas 5 vjetëve të rishikohet çështja e këtyre kufizimeve.

Janë bërë 9 vjet dhe ata që ishin përgjegjës sot na thonë: “Jo, duhet të shohim tash”. Po, 9 vjet janë bërë, e i kanë pasur pas 5 vjet të rishikohet edhe çështja e këtij neni dhe të armatimit. Kurrkush s’na pengon në këto kapacitete, por as këtu s’i kemi paraparë me buxhet, e le më tutje.

Mundësitë e ndryshimit të ligjit janë, nëse jo të Kushtetutës, me ligj të rregullohet çështja e organizimit ushtarak.

Dhe, gjithsesi, të nderuar deputetë, para se të bëhet vonë, e unë kam dëshirë të diskutoj para se të bëhet vonë. Ne, në qoftë se duamë të krijojmë ushtri, tash kapacitetet buxhetore mund t’i ndryshojmë në shtator, atje në rishikimin buxhetor me ligj, që të mund të funksionalizojmë pak këtë ushtri që po mendojmë me ligj ta rregullojmë, sepse s’kemi menduar në nëntor dhe dhjetor. Po më vjen keq që s’kemi menduar, por tash së paku të mendojmë ta rregullojmë çështjen edhe buxhetore në shtator, e pastaj edhe çështjet e tjera.

(Ndërhyrje)

Unë mund të jem ndoshta me qëndrime jo të njëjta me shumë deputetë, sidomos me të Partisë Demokratike, por unë jam deputet dhe qëndrimet e mia si deputet do t’i shtroj këtu. Në qoftë se janë në kundërshtim me partinë, partia i ka mekanizmat e vet dhe le të marrë masa disiplinore ndaj meje, por jo të ma kufizojë fjalën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka kërkuar fjalën dhe ju kisha lutur, të nderuar deputetë, çdonjëri që s’e tërheq fjalën, unë ia jap.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë vlerësoj se Kosova është shtet, i cili është pranuar nga 113 vende. I ka të gjitha institucionet shtetërore dhe i ka plotësuar po ashtu kushtet që të ketë forca të armatosura, siç i kanë edhe vendet e tjera.

Në ngritjen e institucioneve të sigurisë vendi ynë është treguar shumë i përgjegjshëm për zbatimin e standardeve më të larta të disiplinës dhe organizimit.

Policia e Kosovës vlerësohet ndër policitë më të organizuara në rajon. Agjencia Kosovare e Inteligjencës është treguar shumë e organizuar dhe efikase, sidomos në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Forca e Sigurisë së Kosovës, me përkrahjen e NATO-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe partnerëve të tjerë veçohet për organizim të lartë, për disiplinë, për kuadro të përgatitura në akademitë më prestigjioze ushtarake, për shkathësitë dhe për suksesin në pjesëmarrjen e misionëve paqësore.

Dhe, vlerësoj që Kosova jo vetëm se i plotëson kushtet të ketë forca të armatosura, por ajo meriton t'i ketë këto forca, sepse është sjellë me përgjegjësinë më të lartë të ndërtimit dhe menaxhimit të tyre.

Qeveria, gjatë këtij mandati ka punuar pareshtur në dy drejtime. Nën një, Ministria dhe Komanda e Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë bashkëpunuar vazhdimisht me ekipet këshilluese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me DIR-in e DIP-in për përgatitjen dhe planifikimin e transformimit të FSK-së dhe po ashtu ka bashkërenditur me ekipin këshillues të NATO-s...

Qeveria në vazhdimësi ka punuar me NATO-n dhe me partnerët ndërkombëtarë për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshme të transformimit të FSK-së.

Kemi punuar edhe me deputetët serbë në Parlament e në Qeveri. I kemi shtruar këto çështje në takimet me Sekretarin e NATO-s. Unë i kam pasur 3 takime, një takim e kam pasur në fillim të mandatit këtu në Kosovë, një takim e kam pasur në selinë e NATO-s në Bruksel me Sekretarin e NATO-s dhe tani takimin e fundit në Prishtinë.

I kemi trajtuar këto çështje me të gjithë përfaqësuesit më të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët kanë qenë këtu ose kur kemi qenë gjatë sesionit vjeshtor të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork.

Kemi shprehur përkushtimin tonë për paqe, për siguri dhe për stabilitet në rajon dhe kemi kërkuar përkrahje për transformimin e FSK-së në forcë të armatosur.

Është interes i Republikës së Kosovës dhe vullnet i të gjithë qytetarëve të saj që Kosova të bëhet anëtare e Aleancës Veri-atlantike. Kosova po ashtu është plotësisht e angazhuar për integrimin euro-atlantik, për marrëdhënie të mira me fqinjët, për partnerët konstruktiv në ndërtimin e paqes rajonale, sigurisë dhe stabilitetit.

Jemi të gatshëm po ashtu të marrim pjesë në misione paqeruajtëse dhe në misione humanitare nëpërmjet forcave të cilat ne i kemi.

Rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë ka treguar se FSK-ja është plotësisht e gatshme të transformohet në forcë të armatosur, por nga kontaktet e deritanishme kemi kuptuar se NATO dhe partnerët tanë strategjikë mbesin të përkushtuar që Forca e Sigurisë së Kosovës mund të transformohet në çdo kohë në forcë të armatosur të Kosovës nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, me përkrahje të nevojshme të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke i ruajtur të arriturat e deritanishme në konsolidimin e vendit dhe në integrimin e komuniteteve. Kjo na është thënë qartë në të gjitha takimet që i kemi pasur me faktorin ndërkombëtar.

Për këtë qëllim edhe janë përgatitur ndryshimet kushtetuese, është përgatitur edhe ligji mbi forcat e armatosura dhe ne si Qeveri kemi bërë të gjitha përgatitjet e mundshme.

I kemi mbajtur disa takime, edhe kur presidenti i tanishëm, zoti Thaçi, ka qenë zëvendëskryeministër, me deputetë të Listës serbe, me ministrin e FSK-së, me komandantin e FSK-së dhe së bashku me ta ua kemi dhënë të gjitha materialet atyre në mënyrë që ta qartësojmë këtë transformim dhe interesin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, por për fat të keq, nuk kemi arritur që ta kemi miratimin e tyre për transformimin e FSK-së nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese.

Të gjitha këto ia kemi prezantuar edhe faktorit ndërkombëtar. Unë mendoj se logjikisht në këtë situatë do të ishte iluzion që ne të presim që Serbia të përkrahë themelimin e forcave të armatosura të Kosovës, sepse ata po ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë te deputetët e Listës serbe që ata të mos e votojnë këtë.

Por, po ashtu është e domosdoshme që ne të punojmë edhe më shumë me ta, në mënyrë që ta kapërcejmë këtë transformim ashtu siç kërkon NATO-ja dhe ashtu siç kërkon bashkësia ndërkombëtare. Alternativa që ne këtë ta bëjmë vetëm nëpërmjet ndryshimit të ligjit, natyrisht se nuk është alternativë e cila do të hedhet poshtë, por është alternativë e cila mund të bëhet, por në marrëveshje me partnerët tanë strategjikë, me NATO-n, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e tjerë.

Deri më sot nuk e kemi pasur pajtueshmërinë e tyre, edhe pse e kemi shtruar edhe këtë çështje, sepse insistohet që ajo të bëhet me Kushtetutë dhe të bëhet në pajtim më të gjerë të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Na është bërë e qartë po ashtu nga partnerët ndërkombëtarë dhe nga ata jemi këshilluar se aftësia mbrojtëse e Kosovës dhe siguria e saj, sikurse edhe siguria në regjion, nuk varet nga vëllimi i armëve, të cilat ne do t'i kemi si rezultat ose pasojë e transformimit, por para se gjithash varet nga përkrahja dhe partneriteti që ne do ta kemi nga NATO-ja, përkatësisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e tjerë.

Unë si kryeministër besoj thellë se ne duhet ta thellojmë këtë partneritet dhe që zhvillimin e forcave të armatosura ta bëjmë në bashkërenditje të plotë me NATO-n dhe me partnerët e tjerë strategjikë.

Të nderuar deputetë,

Më 5 dhjetor të vitit të kaluar nga Sekretari i NATO-s, pas aprovimit të tekstit dhe programeve nga Këshilli Veri-Atlantik, e kam marrë përgjigjen në lerën që e kam dërguar në fillim të vitit të kaluar, me të cilën kisha kërkuar avancim të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe NATO-s.

Sipas kësaj letre, këto janë aktivitete nëpërmjet të cilave ne do të përfitojmë në këtë bashkëveprim, siç thuhet atje, bashkëveprim me NATO-n.

Është paraparë që të ketë rritje të vizitave të Këshillit të Atlantikut Verior në Kosovë dhe takimi me ekipin këshillues ndërlidhës të NATO-s, me autoritetet relevante të Kosovës, nëpërmjet të cilave do të zgjerohet dialogu politik dhe pastaj do të avancohet dialogu për aktivitetet e bashkëveprimit praktik me NATO-n.

Do të ketë aktivitete shtesë të përshtatura për nevoja specifike të Kosovës, të cilat mund të përfshijnë mbrojtjen e rrjeteve informative, edukim, trajnim dhe logjistikë.

Do të ketë zgjerim të aktiviteteve në kuadër të programit të ndërtimit të integritetit, me qëllim të rritjes së kapaciteteve institucionale.

Do të ketë pjesëmarrje në disa prej aktiviteteve të programit të NATO-s “Shkenca për paqe dhe siguri”, që ka të bëjë me mekanizmat që ofrojnë mundësi për shkencëtarët dhe ekspertët e NATO-s dhe të vendeve partnereve që të bashkëpunojnë në relacion me organet shkencore, me atë civile, në fushën e teknologjisë dhe të inovacionit.

Do të ketë konsideratë të mënyrave që Forca e Sigurisë së Kosovës, në suaza të mandatit të saj, të marrë pjesë si vëzhguese në ushtrimet e Qendrës koordinuese Euro-Atlantike për reagim në fatkeqësi.

Do të ketë eksplorim të mënyrave që FSK-ja në koordinim me ekipin këshillues ndërlidhës të marrë pjesë në ushtrimet e KFOR-it, në përputhje me mandatin e saj, ndërkaq Divizioni për Diplomaci Publike i NATO-s do të konsiderojë rrugët e bashkëveprimit dhe përkrahjes së institucioneve relevante të Kosovës, të OJQ-ve, universiteteve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile që merren me çështjet e paqes dhe të sigurisë me komunikim dhe diplomaci publike.

Si kryeministër kam kërkuar dhe shprehur nevojën e vazhdimit të qëndrimit të KFOR-it në Kosovë në interes të paqes, të stabilitetit dhe të besimit të krijuar nga qytetarët e Kosovës dhe veçmas të komuniteteve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në harmoni me kërkesat tuaja dhe me diskutimet që u zhvilluan këtu, po ju garantoj se Qeveria e Republikës së Kosovës do të intensifikojë më shumë aktivitetet për transformimin e FSK-së, përkatësisht për themelimin e forcave të armatosura, por në bashkëveprim dhe në partneritet me partnerët tanë strategjikë dhe me Aleancën Veri-atlantike.

Unë e shoh tepër të rëndësishme këtë diskutim dhe këtë debat, i cili u zhvillua këtu. E shoh se ai shpreh përkushtimin e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që Kosova të ketë forca të armatosura dhe këtë përkushtim duhet ta zhvillojmë bashkërisht, në mënyrë që këto forca t'i kemi sa më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend, fjala për ju dhe vazhdojmë, nga opozita e kemi vetëm Ismajl Kurteshin, s'po e lëmë të presë më shumë, e pastaj janë edhe kolegët e LDK-së dhe PDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ndoshta debati ndonjëherë duket i pakuptimtë në fillim dhe mundohemi ta përafrojmë qoftë në përcaktim qëndrimesh apo të qëndrimeve të shefave të grupeve parlamentare, por besoj se, në fund të fundit, e arrin efektin e dëshiruar, sidomos nga ajo që kohët e fundit ka pasur një gjuhë, ta quaj, më shumë populiste rreth krijimit të ushtrisë së Republikës së Kosovës, e selektuar në anën atë që është obligim i Qeverisë për të shtuar kapacitetet e veta apo angazhimin për transformimin e FSK-së në ushtri. Por, në anën tjetër, që për mendimin tim ka qenë negative futja e frikës se pushtimi i Kosovës do të ndodhë në çdo moment nëse ne nuk krijojmë ushtrinë e Republikës së Kosovës.

Dhe, besoj që sot debati pak a shumë këtu i dha rrjedhat e veta, por edhe të kristalizimit të qëndrimeve dhe besoj që do të mbizotërojë edhe me rekomandimet, por edhe hapat e mëtutjeshëm që obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës të vazhdojë me këmbëngulje të kërkojë që transformimi i FSK-së në partneritet me SHBA-në, NATO-n dhe të gjithë partnerët e tjerë të fuqishëm properëndimorë ta kalojmë këtë gjendje.

Dihet tash botërisht, në momentumin politik çfarë gjendemi duket i pamundur që të binden anëtarët e një komuniteti apo nga komuniteti serb. Kuptohet që janë deputetë për të dhënë votën për dhe të bëhet e mundshme që nëpërmjet ndryshimit kushtetues të kalojmë në fazën e transicionit ligjor për të marrë detyrat e një force ushtarake në partneritet me botën perëndimore, e këtu e kemi parasysh Paktin NATO.

Andaj, në këtë gjendje ne duhet të kërkojmë transformimin në një ushtri. Të rrisim kërkesat për formimin e ushtrisë, duke shtyrë përpara të gjitha agjendat pozitive, mbi të gjitha, krijimin e besimit, sepse formimi i ushtrisë do të jetë në shërbim të paqes dhe sigurisë së përgjithshme.

Në kuadër të kësaj askush neve nuk na kufizon qoftë si Kuvend, qoftë si institucione përgjegjëse që të kërkohet profesionalizëm, përkushtim dhe ushtri të papolitizuar, e cila do të vihet në shërbim të qytetarëve të vendit tonë.

Unë nuk do të përmendja pa shkas, sepse pa përgatitje profesionale, pa një rritje të shkollimit adekuat, edhe pranimi në strukturat evropiane dhe euro-atlantike të forcave të sigurisë do të jetë i pamundshëm.

Ne jo rrallëherë na ka rastisur që gradat, të cilat shumë njerëz i posedojnë, kanë qenë komplekse për vetë ushtritë e NATO-s. Me qindra gjeneralë të vetëmëruar dhe të cilët edhe sot janë pjesë komanduese dhe të cilët nga përgatitja profesionale dallojnë apo janë shumë mbrapa nga vetë kadetët e rinj që sot janë pjesë e Akademisë Ushtarake dhe Forcës së Sigurisë, por edhe akademike në të cilat po shkollohen çdo ditë e më tutje.

Pra, unë kërkoj edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mbi të gjitha, është punë edhe e Kuvendit të Kosovës, që të kërkohet zgjidhja brenda nenit 26 të Kushtetutës së Kosovës. Nuk do të thotë që ne të jemi të cunguar dhe të presim ardhjen e deputetëve të komunitetit serb që të na mundësojnë një gjë të tillë, kështu që nuk do të kthehesha edhe në histori të së kaluarës, të cilat kanë ndodhur rreth vazhdimit të mandateve apo mosvazhdimit, sepse tash po shihet qartë se jemi peng të katër deputetëve, të katër votave. Çka do të ndodhte po t'i kishim 30 vota këtu nga komuniteti serb dhe cila do të ishte gjendja apo formati edhe institucional në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dhe kjo nuk ka qenë e pamundur, sepse me keqardhje them, edhe atëherë kemi pasur polemika, kemi pasur qëndrime kundër edhe në aspektin kushtetues, edhe profesional, edhe politik. Shumë parti që edhe sot jashtë Kuvendit kërkojnë me ngulm krijimin e ushtrisë kanë kërkuar vazhdimin e këtyre mandateve të rezervuara apo edhe të garantuara.

Andaj, unë po besoj se i takon edhe Kuvendit të Kosovës, e ndoshta u takon edhe deputetëve që në kuadër të përgjegjësisë tona të kërkojmë edhe çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të kërkojmë një interpretim të ri kushtetues dhe jo vetëm të pjesës e cila tash ka marrë mendimin pozitiv nga Gjykata Kushtetuese, por të shohim edhe pjesën e ligjit dhe këtu të avancojmë në transformimin e FSK-së.

Kjo do të jetë e mundur, besoj se do të jetë e arritshme dhe, mbi të gjitha po shihet edhe vullneti politik që është në shtytje e tutje. Pa i shtyrë ne gjërat pozitivisht, as miqtë ndërkombëtarë nuk do të jenë koherent me kërkesat tona, pa marrë parasysh përkrahjes së madhe ndërkombëtare që ka edhe vetë krijimi i ushtrisë së re të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë fjalën e ka Ismajl Kurteshi, po u lajmërua edhe një koleg i opozitës, Faton Topalli, ai pret së bashku me nënkryetarin dhe me mua kur ta marrim fjalën nga fundi. Urdhëro, Ismajl!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përsëritje për të gjithë,

Në një rajon të trazuar si ky yni, ku shumë mjete po derdhen për blerjen e armatimit, ku librat shkollorë hapur po përhapin urrejtje, sidomos ndaj shqiptarëve, ku hegjemonizmi e karakterizon politikën e shtetit tonë fqinj, Serbisë, pavarësia dhe integriteti territorial i Kosovës është i paqëndrueshëm, madje është në rrezik permanent. Prandaj, institucionet e Kosovës duhet të punojnë seriozisht në gjetjen e rrugës më të shkurtër për bërjen e forcës së armatosur të aftë për të mbrojtur vendin, pavarësisht se si do të quhet ky mekanizëm mbrojtës.

Ata që eventualisht formimin e ushtrisë së Kosovës e shohin si kërcënim për paqe në rajon, e kanë gabim, sepse vetëm balancimi i aftësive mbrojtëse të dy shteteve shqiptare me Serbinë, që tradicionalisht ka synime territoriale, garantojnë paqen në rajon, në të kundërtën, konfliktet do të jenë të paevitueshme.

Miq të tanë ndërkombëtarë nuk kanë arsye të jenë kundër ushtrisë së Kosovës dhe nuk janë kundër saj, sepse ajo garanton stabilitet në regjion. Kurse sa i përket Serbisë do të presim kot e do të presim gjatë dhe asnjëherë nuk do të përfjethë një gjë të tillë që Serbia të pajtohet që Kosova të ketë ushtri. Prandaj ne duhet t'i lëmë arsyetimet në një anë, t'i përvishemi punës dhe ta bëjmë ushtrinë për të mirën tonë të përbashkët, por natyrisht, edhe për të mirën e këtij regjioni, i cili përherë ka pësuar nga mospërgatitja e mirë për mbrojtje.

Pra, sa herë që përgatitemi mirë për mbrojtje, luftën e largojmë dhe kjo është në interes tonin të përgjithshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Nën kryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, e ka kërkuar fjalën, e kisha ftuar posa të mbarojë fjalën, ta udhëheqë për kohësisht seancën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Zoti kryeministër i Republikës,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Nën një, po them, Liliputani që është i vocërr, krekoset dhe lavdërohet se në krah të divit mund të shohë shumë larg. Vetëm se, shikimi larg bëhet jo vetëm me sy, por bëhet me mendje dhe me zemër. Pra, duhet vullnet dhe mendim racional.

Dy, kurrkush s'i do nxënësit e dobët, as mësuesi, as protektori, sepse nxënësi i dobët, nëse i shkruhet notë kaluese, thotë: "E dhashë provimin". Po nëse nxënësit të dobët i shkruhet nota e dobët, thotë: "Më ngelën në provim".

Çështja është të merren përgjegjësitë dhe të punohet për atë që kërkohet. Ky është treshi.

Katër, kërkohet dhe është e domosdoshme që Kosova si shtet duhet të ketë forca të organizuara për mbrojtjen e popullit, të vendit, të shtetit.

Pra, le të formohet ushtria e Kosovës. Emri nuk ka shumë rëndësi. Unë mendoj se FSK është emër shumë i bukur, FAK po ashtu, FARK po ashtu.

Pesë, nga deklaratat e sotme këtu në Kuvend, kolegë shumë të respektuar, shihet që gjashtë grupe parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë rreth 110 deputetë, janë të mendimit që duhet të formohet ushtria e Kosovës, u tha këtu.

Pra, këta të gjithë, gjashtë grupe që bëjnë rreth 110 deputetë, unë i shihja 100 kur bisedova në mbledhjen e kaluar për konsensusin, tash po bëhen 110, le ta tregojnë me votë, fuqinë e votës së vet qytetare e parlamentare, nismën për transformimin e FSK-së në forcë, tash po i themi, mbrojtëse të vendit, të popullit, të shtetit.

Shtatë, kjo fuqi e votës që është fuqi e votës popullore, fuqi e votës qytetare, unë jam i bindur që do të ketë, vlerë edhe si e tillë do të ketë vlerë për partnerët ndërkombëtarë e aleatët strategjikë, si po e themi të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Shurdhaj, fjala për ju edhe vazhdojmë pastaj.

FATMIR SHURDHAI: I nderuar nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam qenë, nuk di i shtati apo i teti në rend të flas, por e shtyn kështu sikur të tjerëve. Nuk e di pse u krijua kjo atmosferë kështu, po me të vërtetë jemi në një situatë shumë të keqe.

Një popull, një shtet që nuk e ka arsimin, shëndetësinë dhe sigurinë, është në rrezik.

Më parë biseduam, debatuam për arsimin gjendjen ku e kishim, sot biseduam prapë, debatuam për shëndetësinë dhe u pa realiteti. Prapë jemi duke biseduar për sigurinë e vendit tonë. Në këtë realitet ku po bisedojmë për sigurinë e vendit tonë, unë po ju drejtohem si anëtar i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që ne morëm një vendim të bëjmë një debat. Ne i ulëm flamujt e partive politike, edhe pse pati tendenca në komision, me të vetmin qëllim ta ngremë flamurin e ushtrisë, por jo të vijmë këtu prapë e të tregojmë kush e ka penguar atëherë, kush po e pengon sot, edhe në fund ku jemi.

Krejt ky debat që po ndiqet edhe prej qytetarëve të Republikës së Kosovës, atyre që juve ju kanë votuar këtu, që edhe më parë kur janë kërkuar ndryshimet kushtetuese për ta shndërruar Forcën e

Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës, ka ndodhur e njëjta gjë, madje u prish edhe koalicioni qeveritar dhe kemi shkuar në zgjedhje. Mos po i pëlqen dikujt kjo kinema, të ndodhë kështu me këtë realitet tonin, çka është? Po kush na e mohon neve të drejtën për ta krijuar sigurinë e territorit, qytetarit, pronës, familjes e fëmijëve tanë? Askush. Asnjë referencë ndërkombëtare a mekanizma të sigurisë kolektive nuk na ka thënë që ju s'bëni të keni forca të armatosura, nuk mund të keni mbrojtje.

Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila që 9 vjet është përgatitur, është trajnuar, ka krijuar kuadro, ka marrë pjesë në misione humanitare, është graduar edhe është transformuar, të gjitha strategjitë e saj për ta transformuar këtë forcë në forca të armatosura gati kanë mbaruar. Këta oficerë, nënoficerë, ushtarë që u përgatitën që 9 vjet, po plaken dhe po shkojnë në pension pa e kryer misionin, për shkak tonin, për shkak të lojalitetit tonë, sepse ende na ka mbetur kryet kah Dragodani, qysh na thonë ata, duhet të bëjmë ne, po, kjo është e vërteta.

Më në fund erdhi kryeministri dhe e tha të vërtetën e komunikimeve diplomatike, politike që i kemi pasur me miqtë tanë ndërkombëtarë, me partnerët, të cilët e kanë përkrahur edhe e përkrahin edhe sot këtë forcë, edhe këtë shtet.

Qëllimi i komisionit ishte të bëjmë debat, t'i themi Qeverisë se e ke mandatin, nëse s'mund të bësh forcë të armatosura me ndryshime kushtetuese, për shkak të pengesës që e kemi, ta ndryshojmë misionin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, të mos ua hupim mundin atyre djemve dhe vajzave, të cilat janë graduar, kanë merita, janë ushtarët më të mirë në rajon.

FSK-ja gjatë vërshimeve në Shqipëri ka qenë më e mira, referencën më të mirë e ka pasur.

Vajzat edhe djemtë e FSK-së janë graduar, janë nëpër akademitë ushtarake në Amerikë, në Turqi, në Gjermani, në vende të tjera të Evropës, po na përkrahin neve dhe po përgatiten për një ushtri të ardhshme.

Ne sot, prapë këtu po vijmë dhe po biem viktimë e aparateve ideologjike e partive tona. Kush do të jetë në pushtet? Kush do ta udhëheqë? Kush do t'ia vejë emrin? Kush do ta nxjerrë bajrakun i pari ta vejë në kazermë të ushtrisë?

Ky nuk ka qenë as misioni i atyre djemve dhe vajzave që kanë rënë dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare, ky nuk ka qenë as misioni i TMK-së, të cilët pa rroga kanë qëndruar vite të tëra vetëm për ta krijuar ushtrinë e Kosovës. Ky nuk është misioni i këtyre djemve dhe vajzave që janë në FSK, të cilat janë të përgatitura me kapacitete më të mëdha ushtarake për ta përkrahur një ushtri.

Ne e dimë sa kemi buxhet, pse asnjë deputet këtu nuk doli e të thotë: “Jemi të gatshëm të japim 10% të rrogës për ushtrinë.” Apo të thotë ministri i Transportit: “Kryeministër, po e ndërpremë asfaltin, se s’kemi nevojë për më tepër asfalt, kemi nevojë për siguri.” Edhe ato janë lekë të qytetarëve që po ndërtojmë autostrada, ura, po na shemben atje këmbët e urave të “Bechtel”-it. Ku i keni marrë ato lekë, të qytetarëve janë ato. Mund ta ndërpremë atë e të krijojmë ushtrinë. Po kemi nevojë ta ndërpremë... po, po ndalen bizneset, po, po, ky është qëllimi.

Çka dua të them tjetër. Nëse një deputeti nuk i jepet mundësia ta thotë të vërtetën, realitetin për çka e ka votuar qytetari, nuk di pse rri këtu? Më mirë është të shkojë në zgjedhje, vjen dikush tjetër në vend tonin dhe e kryen punën më mirë se ne.

Kur janë në pyetje privilegjet, të gjithë po vrapojmë. Po, kemi nevojë për privilegje, t’i rritim pagat, të gjitha këto. Kur është në pyetje ta mbrojmë atë që na e ka dhënë qytetari, nuk po mundemi.

Keni pak durim, kolegë deputetë. Ne e dimë shumë mirë se jem peng i planit të Ahtisari për krijimin e ushtrisë së Kosovës. Ne jemi shumë të vetëdijshëm që Lista serbe nuk po do të vijë e t’i votojë ndryshimet kushtetuese e të krijojmë ushtrinë e Kosovës. Po do ta kryejmë detyrën tonë, edhe atë obligim që jua ka dhënë Komisioni Parlamentar, që ju e keni obliguar, të provojmë ta transformojmë këtë forcë, t’u hapim mundësi atyre djemve dhe vajzave të FSK-së, t’u japim detyra shtesë për ta mbrojtur sigurinë e vendit, integritetin dhe sovranitetin territorial. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse flasim në temë edhe më shkurt, bëhemi më ekspeditivë, por edhe na dëgjojnë më shumë. Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: I nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja për të cilën ne sot diskutojmë është një çështje që në princip të gjithëve na bashkon. Është një temë për të cilën ne duhet ta diskutojmë me kujdes, ta trajtojmë me maturi dhe të marrim vendime me bindje.

Kur ne ta trajtojmë me maturi, duhet të shohim se cila është gjendja e sigurisë në Kosovë, t’i analizojmë rreziqet, të cilat paraqiten sot.

Nëse marrim edhe shohim në aspektin e brendshëm të organizimi dhe sigurisë në Kosovë, mund të themi që nuk ka ndonjë rrezik të drejtpërdrejtë të brendshëm për Kosovën. Po, në të njëjtën

kohë, mund të themi që trendi i rreziqeve që kanë të bëjnë me ekstremizmin fetar dhe me terrorizmin mund t'i kanoset edhe Kosovës, sepse po i kanoset gjithë botës.

Në të njëjtën kohë, nëse dalim pak jashtë Kosovës dhe shohim trendët e zhvillimit në aspektin e sigurisë dhe politikave zhvillimore rajonale, mund të them që kemi disbalancë në aspektin e sigurisë dhe të forcës, të cilat prezantojnë shtetet në rajon. Kjo disbalancë shihet edhe me garën e fundit në armatim, e cila paraqitet mes Kroacisë dhe Serbisë dhe tendencat dhe veprimet e Republikës së Serbisë përballë Republikës së Kosovës.

Kemi parë veprimet, kërcënimet në vazhdimësi, veprimet me trenin dhe tendenca të tjera, të cilat paraqiten dhe tendenca të destabilizimit të brendshëm nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, tentimit të përdorimit të kapaciteteve të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës.

Prandaj, duke marrë parasysh elementet e rrezikut, ne shohim edhe elementet e sigurisë, dhe elementet e sigurisë në gjendjen të cilën gjendet Kosova sot mund të themi që nuk ka ndonjë rrezik, sepse sigurinë e brendshme edhe të jashtme të Kosovës dhe, sidomos sigurinë e jashtme, e garanton KFOR-i, si strukturë e autorizuar nga NATO. Dhe NATO-ja si struktura më e organizuar dhe më e madhe ushtarake në botë, garanton sigurinë e jashtme të Kosovës, po edhe sigurinë e brendshme nëse kërcënohet nga elemente terroriste apo elemente të tjera.

Dhe, në këto dy elemente, elementi i NATO-s dhe elementi i KFOR-it, të cilat paraqiten në Kosovë si elemente stabilitetit dhe elementet e rrezikut, të cilat paraqiten, si forca të ndërhyrjes së jashtme nëpërmjet terrorizmit apo elemente destruktive që mund të vijnë nga fqinjët tanë.

Ekziston bindja absolute e të gjithë deputetëve të Kuvendit, pa marrë parasysh grupin politik apo parlamentar dhe pa marrë parasysh grupin etnik, duke përjashtuar njërin nga grupet, të cilat nuk ka qenë shumë aktiv në këtë temë, që Kosova duhet të formojë kapacitetet e veta mbrojtëse dhe siguruese. Që Kosova duhet të jetë e angazhuar në ruajtjen e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, që Kosova duhet të ketë ushtrinë e vet.

Prandaj, në kuadër të kësaj ne mbërrimë edhe në një moment të ri politik, i cili shprehet nëpërmjet një rezolute në Kuvend, rezolutë e cila, po shpresoj dhe jam i bindur që do të harmonizohet me të gjitha grupet politike dhe të prezantohet në Kuvend për votim, rezolutë, e cila konfirmon bindjen e plotë të Kuvendit se Kosova do të ketë ushtrinë, rezolutë e cila i jep autorizime dhe e angazhon Qeverinë e Kosovës që të bashkëpunojë me partnerët tanë ndërkombëtarë që të formojmë ushtrinë tonë. Rezolutë, e cila fillon fazat e angazhimit të pajisjes, trajnimit, përgatitjes si në aspektin e infrastrukturës së butë që kemi të bëjmë me ligjet dhe me përgatitjen strukturore, dhe me përgatitjen profesionale, si në aspektin e infrastrukturës së fortë që ka të bëjë me armatimin dhe me mjete të tjera përcjellëse.

Pra, ne jemi të gatshëm të formojmë një ushtri, e cila garanton balancë të forcave në rajon, që të formojmë një ushtri, e cila garanton që do të jetë në partneritet me NATO-n dhe partnerët tanë evropianë dhe amerikanë.

Një ushtri, e cila do të jetë pjesëmarrëse në misione humanitare dhe ushtarake jashtë Kosovës. Një ushtri, për të cilën ne do të japim të gjitha kapacitetet ligjore, politike e financiare dhe për të cilën do të lutemi secilën ditë që kurrë të mos e përdorim në Kosovë apo në rajonin tonë.

Prandaj, ne po angazhohemi që të kemi një ushtri, për të cilën do të lutemi që të mos e përdorim kurrë në Kosovë dhe të mos kemi nevojë që ta përdorim në aktivitete luftarake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë, deputete!

Vendet normale e konsiderojnë sigurinë për qytetarët e tyre, respektivisht rrezikun nga jashtë varësisht nga situata në të cilën ndodhet një vend.

Vendet që kanë siguri më të lartë, stabilitet politik në rajon, përveç nëse kanë pretendime ekspansioniste ndaj shteteve të tjera, ndajnë më pak buxhet për sigurinë.

Të tjerat që e shohin të shtuar rrezikun nga sulmet potenciale nga jashtë, e rrisin buxhetin dhe angazhohen t'i shtojnë masat e sigurisë.

Nuk e di nëse Qeveria e Kosovës e konsideron situatën stabile në rajon.

Nuk e di gjithashtu nëse parasheh ndonjë rrezik nga Serbia, e cila vazhdon të mbajë qëndrim armiqësor ndaj Kosovës, pavarësisht nga fakti që në ekonomi kjo Qeveri e ka bërë Serbinë partnerin kryesor të saj.

Fakt është që Qeveria e Serbisë vazhdon të ketë ndikim qenësor në një pjesë të vendit tonë, madje një ndikim, i cili shtrihet deri në Graçanicë dhe nuk është më larg se tre kilometra larg Prishtinës.

Mendoj se është kulmi i ironisë kur kryeministri Mustafa deklaron se paska biseduar me palën serbe dhe pala serbe nuk paska pranuar që Kosova të ketë ushtrinë e saj.

Serbia vazhdon edhe më tutje ta konsiderojë Kosovën si pjesë të saj.

Deklaratat e drejtuesve më të lartë të shtetit se Kosova është pjesë e Serbisë janë bërë deri në Kombet e Bashkuara.

Takimet e fundit të krerëve serbë me zyrtarë të lartë të ushtrisë në afërsi të Kosovës flasin për sinjale jo të mira për vendin tonë. Besoj që këto janë fakte të mjaftueshme për të trajtuar seriozisht çështjen e sigurisë.

Uroj që ky debat t'i kontribuojë kësaj çështjeje.

Ajo që mua më brengos është që Qeveria e Kosovës, si kjo, si të tjerat para kësaj, nuk kanë shfaqur ndonjë interes, qoftë edhe minimal, për t'u marrë me çështjen e sigurisë.

Buxheti i ndarë për FSK-në në tre vjetët e fundit është dëshmia më e mirë se kjo temë nuk është trajtuar seriozisht, madje është neglizhuar deri në atë masë sa e bën të frikshme qasjen e Qeverisë ndaj sigurisë.

Në tre vjetët e fundit kemi një shtim të kuadrit, diku rreth 300 të punësuar që i kushtojnë buxhetit të Kosovës 5 milionë euro.

Problemi nuk qëndron te punësimi. Unë konsideroj edhe më tutje që rrogat e pjesëtarëve të FSK-së duhen të jenë më të larta, madje shumë më të larta se sa që janë tani.

Problemin e shoh, përkundër nevojës së shtimit të sigurisë, buxheti për investime kapitale është rritur për dallim prej vitit 2014 për afërsisht 2.5 milionë, që është një shumë jashtëzakonisht e vogël.

FSK-ja ka nevojë për dyfishim të buxhetit, ajo duhet t'i ndërtojë kapacitetet e saj, pavarësisht se cilin emër mban.

Policia e Kosovës është gjithashtu faktori i sigurisë. Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të mundësojë specializimin dhe armatimin e policisë me të gjitha mjetet e nevojshme, që në rast nevojë të ketë mundësi të marrë edhe detyra shtesë.

Dyfishimi i buxhetit të FSK-së nuk kushton më shumë se katër kilometra autostradë. Besoj që qytetarët e Kosovës janë në gjendje të ecin katër kilometra edhe në këmbë që ne të kemi ushtrinë tonë.

Nuk është me rëndësi emri, me rëndësi është ndërmarrja e masave të sigurisë, përgatitja. Zemra ma do që në Kosovë kurrë të mos ketë luftë, por kjo mundësi nuk përjashtohet.

Në fund, më lejoni t'ju përkujtoj se Zvicra, një vend në mes të Evropës, ka 8 milionë banorë dhe 4 milionë armë me leje në popullsi.

Nuk besoj që dikush mund të pretendojë se ky vend rrezikohet nga fqinjët e saj.

Megjithatë, kujdesi për sigurinë e qytetarëve është i madh, një kujdes që Qeveria e Kosovës nuk e ka fare.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedavajući!

I uvaženi premijeru,

Ministri i kolege poslanici,

Transformacija sigurnosti snaga u vojsku Republike Kosova je prioritet za sve nas poslanike, i svako politizovanje sa bilo čije strane ide u pogrešnom smeru i negativno utiče na sve nas građane, ali pre svega na opšti status naše zemlje u regionu.

Poštovani premijeru,

Meni je danas smešno kada slušam pojedine poslanike njihova izlaganja iz stavove po pitanju rezervisanih mesta, kada jako dobro znamo svih mi koji smo bili u prošlom sazivu parlamenta da nije postojala politička volja pojedinih lidera oko rezervisanih mesta samo za još jedan mandat, a ovaj mandat je već pred kraju, molimo gospodine tako da je žalosno i prosto neverovatno, jer već i tada bi smo imali formiranu našu vojsku,

Poštovani predsedavajući parlamenta,

Gospodo poslanici,

Svi mi zajedno kada smo po prvi puta ušli u ovu salu dali smo javnu zakletvu, koja nas obavezuje da štitimo suverenitet i teritorijalni integritet poštujući Ustav Republike Kosova, bez obzira na nacionalnost i političko opredelenje.

Poslanicima iz redova manjinskih zajednica ne treba niko danas ovde da se zahvaljuje za glas.

Mi gospodo glasamo za svoju vojsku, za vojsku Republike Kosova, koja će biti sastavljena od svih naroda koji žive na ovoj teritoriji, ni ti to činimo za Vladu ili neku političku grupaciju. Želimo stvoriti multietničku modernu armiju Kosova, koja će razbiti sve stereotipe i predrasu da jedni od drugima i biti primer vojske na Balkanu, a to možemo postići samo ako budemo jedinstveni i solidarni kada je u pitanju nacionalni interes naše države. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Doruntinë Maloku e ka fjalën.

DORUNTINË MALOKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kosova nuk bën përjashtim nga rreziqet e sigurisë me të cilat po përballlet rajoni dhe më gjerë, siç janë terrorizmi, radikalizmi fetar, krimi i organizuar, trafikimi dhe rreziqet e tjera globale.

Prandaj, edhe ne kemi nevojë që të rrisim dhe të forcojmë kapacitetet tona në fushën e sigurisë dhe atë të mbrojtjes.

Në këtë kuadër e shoh edhe transformimin e FSK-së në forcat e armatosura të Republikës së Kosovës.

Misioni i kësaj force, siç parashihet edhe në strategjinë e rishikimit të sektorit të sigurisë, është ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës dhe ofrimi i mbështetjes ushtarake për autoritet civile në raste fatkeqësie dhe kur rrezikohet rendi kushtetues.

Një arsye tjetër për krijimin e forcave të armatosura është edhe pjesëmarrja e saj në misione paqësore së bashku me ushtritë aleate të vendeve të NATO-s. Në këtë mënyrë ne dëshmojmë para partnerëve tanë euro-atlantikë se kemi kapacitete ushtarake për të prodhuar siguri për veten, por edhe për popujt e tjerë.

Krahas krijimit të kapaciteteve ushtarake, ne kemi nevojë që të rrisim edhe kapacitete tona shkencore dhe teknike në fushën e mbrojtjes. Bashkangjitur me procesin e transformimit për zhvillimin dhe udhëheqjen e ardhshme të sektorit të sigurisë dhe atë të mbrojtjes, rekomandohet që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të punojë për ta zhvilluar programin mësimor të mbrojtjes dhe sigurisë në Universitetin e Prishtinës.

Sa u përket modaliteteve për krijimin e ushtrisë së ardhshme, ne nuk duhet të eksperimentojmë, por të krijojmë kornizën kushtetuese dhe ligjore për krijimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të forcave të armatosura.

Ideja për ndryshimin e Ligjit për FSK-në dhe zgjerimin e kompetencave të saj nuk i plotëson nevojat e shtetit të Kosovës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Ne keni nevojë për kapacitete të mirëfillta ushtarake, për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri për sovranitetin dhe integritetin e vendit tonë, por njëkohësisht duke garantuar sovranitetin tonë, ne prodhojmë edhe paqe në rajon.

Të gjitha grupet parlamentare, besoj, kanë interes që Kosova të ketë kapacitete për garantimin e paqes dhe të sigurisë për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike.

Kolegët tanë deputetë nga komunitetet duhet të japin kontributin e tyre për ndryshimet e nevojshme kushtetuese për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes, pasi që ky sektor është i rëndësishëm edhe për komunitetet që ata përfaqësojnë.

E inkurajoj Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe grupet parlamentare që të bashkëpunojnë me të gjitha komunitetet në Kosovë për të qenë pjesë e ndryshimeve pozitive euro-atlantike për Kosovën.

Refuzimi dhe sabotimi i iniciativave euro-atlantike është kundër interesave politike të komuniteteve që ata i përfaqësojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Deputetë,

Forca e Sigurisë së Kosovës pa dyshim, së bashku me Policinë e Kosovës, janë prej institucioneve më kredibile dhe me performancën më të mirë, me të cilat mund të mburret shteti ynë, shteti i Kosovës.

Nuk do koment se ne, si institucione të Kosovës, qoftë si Kuvend, qoftë si Qeveri e Republikës së Kosovës, nuk kemi bërë atë çka duhet të bëjmë për këto dy institucionet që i përmenda me performancë të mirë, pozitive dhe kredibile dhe me të cilat krenohemi ne. Pa dyshim që përgjegjësia kryesore bie mbi ne si institucione më të larta Kuvendi dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës, së bashku me Policinë e Kosovës, janë gardianë të sigurisë së vendit tonë.

Puna e tyre profesionale e dëshmuar, njohja e tyre ndërkombëtare, çmimet e tyre ndërkombëtare të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, po në anën tjetër edhe të Policisë, ngase nuk mund t'i ndajmë sepse garantojnë siguri në vend, janë për çdo lëvdatë, nga se falë një pune të mirë të zhvilluar Policia e Kosovës së fundi ka arritur të parandalojë edhe organizime të ndryshme apo akte të ndryshme terroriste, siç është ai i vitit 2014, kur qytetari i nacionalitetit serb nga Beogradi, Slobodan Gavriq, arrestohet me 13 kilogramë eksploziv para Ambasadës Amerikane, sulm i cili ishte planifikuar të organizohej dy net para Krishtlindjeve në Kosovë, përmasat e të cilit do ishin shumë të mëdha dhe me pasoja afatgjate.

Në anën tjetër, gjithashtu si gardianë për debatin që jemi duke biseduar sot është pa dyshim edhe Forca e Sigurisë së Kosovës dhe është për keqardhje se si dëgjojmë se si duhet të jetë Forca e Sigurisë së Kosovës. Këto proza dhe poezi është koha që tash t'i shndërrojmë në vepra.

Fatkeqësisht është për keqardhje se si ende nuk kemi arritur ta themelojmë forcën e armatosur të Kosovës, ende nuk kemi arritur ta themelojmë ushtrinë e vendit, premtim ky i cili nuk është i këtij viti, i këtij mandati, por është premtim qe dy mandate.

Prandaj, është për keqardhje se si ende, si shtet i ri i Kosovës, nuk e kemi ushtrinë tonë, përderisa kërcënimet globale dhe rajonale dhe nga vendet fqinje na atakojnë në vazhdimësi, i kemi kërcënimet e ushtrimit në pjesën veriore nga vendi fqinj, nga Serbia.

Në anën tjetër, është kërcënimi global i terrorizmit, i cili nuk njeh fe, shtet, komb, ngjyrë, nuk njeh askënd. Prandaj, vendi ynë po qëndron latent, i fjetur dhe aspak i guximshëm të marrë një vendim konform Kushtetutës dhe ligjit të Kosovës, ta themelojë ushtrinë e Kosovës.

Është për keqardhje kur arsyetohem. Dëgjuam këtu më herët arsyetime se si Lista serbe qenka pengesë, se ajo po nxjerr kushte dhe po e shantazhon, në një formë, formimin e ushtrisë së Kosovës, po në anën tjetër, ku mbetëm ne si shtet, ku shumica absolute duhet të jetë e diskriminuar, e shtypur, të mos ketë ushtri për shkak të kërkesës së një grupi parlamentar, siç është rasti konkret, Lista serbe.

Unë e di që kërkesat e tyre kanë qenë edhe nga mandati i kaluar, kur kanë kërkuar kushtëzime me vende të rezervuara në Parlamentin e Kosovës dhe, të njëjtat kërkesa prapë i kanë. Por, a do të thotë kjo që ne të dorëzohemi para kërkesave të tyre? A do të thotë që ne të mos e themelojmë ushtrinë e vendit tonë?

Nëse Lista serbe është pengesë për themelimin e ushtrisë sonë, e kemi rrugën tjetër nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, rrugë kjo e cila është dashur të niset edhe në mandatin e kaluar, edhe në fillim të këtij mandati, ndërsa tash veçse jemi vonuar.

Prandaj, unë mendoj që nuk na ka hije si shtet të dorëzohemi para një grupi parlamentar, i cili në vazhdimësi po na kërcënon dhe po na shantazhon, se nuk do të pajtohet për themelimin e kësaj ushtrie.

Në anën tjetër, ne duhet të punojmë për vendin tonë. Është për keqardhje, ne jemi të gjithë të vetëdijshëm se Lista serbe prej të gjitha komuniteteve është më e privileguara në Kosovë, në raport me të gjitha komunitetet e tjera joshumicë, privilegjet që i ka Lista serbe, të gjitha komunitetet bashkë nuk mund t'i gëzojnë.

Po, në anën tjetër, ne jemi të dorëzuar para tyre dhe nuk marrim guximin një herë e përgjithmonë ta ndjekim rrugën kushtetuese dhe t'i bëjmë mirë vendit tonë. Edhe nëse janë bërë gabime nga hartuesit e Kushtetutës, unë e di që edhe ata duhet të japin përgjegjësi, disa nga hartuesit e Kushtetutës kanë edhe pozita ministrore, por gabimet e tyre sot ne po i vuajmë. Po hajde tash të mbyllim rrugën e këtyre gabimeve, t'i korrigjojmë këto gabime dhe t'i nisin këto ndryshime, të cilat është dashur shumë moti.

Situatën më të rëndë e bën edhe fakti se mosthemelimit të ushtrisë së Kosovës shpeshherë i jepet edhe konotacion apo karakter ndërkombëtar, se kinse, u dëgjua edhe në Parlamentin e Kosovës, se nga ndërkombëtarët njëherë për njëherë nuk e kemi përkrahjen ta themelojmë.

Unë mendoj që ndërkombëtarët kanë bërë shumë për Kosovën dhe po bëjnë shumë për Kosovën, po problemi qëndron te ne.

Të mos i implikojmë ndërkombëtarë në problemet tona, që ne nuk jemi të gatshëm dhe të fuqishëm t'i zgjedhim vetë.

Ne kemi pasur dhe kemi përkrahjen e ndërkombëtarëve, por ata nuk mund të na themelojnë ushtrinë, nëse ne nuk kërkojmë themelimin e ushtrisë.

E dimë shumë mirë që në kohën e zgjedhjeve, fushata parazgjedhor të dalin të gjithë si deputetë e si ministra të kërkojmë votë prej qytetarëve për pozita tona. Hajde të kërkojmë ne prej ndërkombëtarëve për shtetin tonë për themelimin e ushtrisë sonë. Do të thotë, qysh po kërkojmë vota, ta kërkojmë edhe themelimin e ushtrisë sonë. Por, e di që është një problem këtu, na mëngon guximi dhe vullneti si klasë politike, e si pasojë e mungesës së këtij guximi, si pasojë e mungesës së këtij vullneti, jemi të gatshëm t'i pranojmë dy mesazhe: njërin nga Lista serbe që nuk jemi të gatshëm ta kundërshtojmë Listën serbe dhe, e dyta, nuk jemi të gatshëm të kërkojmë, të jemi këmbëngulës në përkrahjen e ndërkombëtarëve në themelimin e ushtrisë së Kosovës.

Ne e dimë fort mirë që përkrahja e tyre ka qenë dhe do të jetë, e nuk do të mungojë, por problemi qëndron te ne dhe të mos i fajësojmë të tjerët. Është e padrejtë të themi se ndërkombëtarët nuk pajtohet, por është e drejtë të themi se vetë nuk jemi të gatshëm dhe nuk kemi vullnet dhe nuk kemi guxim.

Prandaj, unë mendoj që jemi shumë të vonuar dhe është momenti që një herë e përgjithmonë të reflektojmë pozitivisht dhe të mos bimë pre e kërcënimeve dhe shantazhimeve që na vijnë nga ndonjë grup i vogël parlamentar apo grupe të tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Veton Berisha, Berishë, si Berishë, shkurt ti, saktë!

VETON BERISHA: Patjetër, i nderuar nënkryetar!

Faleminderit për fjalën!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sigurisht do të jem i shkurtër dhe do të jap qëndrimin tim në raport me çështjen që po diskutojmë.

Unë si përfaqësues i komunitetit egjiptian të Kosovës jap mbështetjen pa rezervë të krijimit të ushtrisë, të forcave të armatosura të Republikës së Kosovës, qoftë nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese apo edhe nëpërmjet ligjit.

Më vjen keq shumë që komunitetet pakicë, me theks të veçantë, serbët, janë pengesë e procesit, të cilët vërtet do të duheshin që këto krijime në forca të armatosura secili nga ne t'i donte dhe t'i përkrahte.

Në anën tjetër, janë rrethana të ditura, të cilat nuk janë të sodit, janë të kahershme.

Në anën tjetër, ne e duam këtë ushtri, i duam Forcat e Sigurisë, jemi të gatshëm të mbështesim secilin mekanizëm të sigurisë në Kosovë, sepse prej kësaj edhe përfitojmë ndihemi edhe ne të lirë këtu dhe të sigurt.

Po, në anën tjetër, kërkojmë përfshirjen në këto institucione. Ne në diçka që e duam, e dëshirojmë dhe e mbështesim fuqishëm, normalisht që edhe dëshirojmë të jemi të përfshirë.

Zoti ministër Demolli, e dini mjaft mirë sa është numri i komunitetit egjiptian i përfshirë në Forcën e Sigurisë aktualisht dhe në Policinë e Kosovës, të njëjtën kohë dhe vërtet nuk ka asnjë kuptim që ky numër në gjithë mandatin tim të mbetet akoma i pandryshuar. Normalisht që diçka që dëshirojmë dhe mendojmë që duhet të jenë pjesë dhe duhet të krijohet qysh nesër, ndoshta dhe ne të mos jemi pjesë aktive dhe të mos jemi, ndoshta, edhe në pozicione ku jemi të gatshëm të marrim detyra, vërtet nuk na bënë të ndihemi mirë.

Edhe pa këtë fakt ne do ta mbështesim, por sigurisht presim nga institucionet që vërtet të reflektojnë dhe të kenë mundësi, të japin mundësi që edhe komunitetet e tjera të jenë të përfshirë dhe vetë fakti që komuniteti serb është mjaft mirë i akomoduar dhe në statistika del që komunitetet janë shumë të mirë të përfshirë, dhe kjo njëanshëm, vetëm me komunitetin serb, është mirë që kjo po na kushton tani.

I kuptojmë këto gjëra, por vërtet nuk është gjithmonë patjetër që të jetë komuniteti serb dhe e dimë shumë mirë që Forcat e Sigurisë janë forca multietnike dhe duhen të jenë forca multietnike dhe vetëm këtë formë ne ndihemi të sigurt.

Kështu që ta shikojmë mundësinë e përfshirjes së komunitetit tonë në Forcën të Sigurisë, në Policinë e Kosovës, në mënyrë që edhe ne të ndihemi rehat dhe komod dhe të japim kontributin tonë në këto segmente. Faleminderit, edhe një herë është përkrahje e plotë nga unë dhe komuniteti im në krijimin e këtyre forcave.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

ABDYL YMERI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po diskutojmë për një çështje, e cila mendoj se e ka vëmendjen e çdo qytetari të Kosovës, sepse ka ardhur momenti dhe koha që Kosova ta bëjë transformimin e FSK-së në Forcën të Armatosura të Kosovës, apo siç dëshirojnë në popull të quhet Ushtria e Kosovës, e cila në thelb është bashkësia e disa forcave (njësive të armatosura) nën një komandë, që është vlera më e çmuar dhe garanci mbrojtëse e sovranitetit dhe integritetit shtetëror, të paqes, lirisë dhe demokracisë.

Prandaj, nuk është në pyetje sot se kush është, e kush nuk është për transformimin e FSK-së në forca të armatosura, sepse të gjithë ne këtu jemi që kjo të ndodhë sa më shpejt, sepse krijimi i forcave të armatosura do ta forcojë shtetin e Kosovës dhe do të jetë faktor stabiliteti në rajon, e po ashtu do të përmbushë një ëndërr të kamotshme të gjeneratave që Kosova ta ketë ushtrinë e saj, e krijuar dhe e ndërtuar me standardet e NATO-s dhe me aspiratat që në një kohë sa më të afërt e të shpejtë të jetë pjesë dhe anëtare e NATO-s.

Ky debat duhet të na shërbejë se si të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme për të krijuar forcat e armatosura. Ajo që do të ishte më e mira do të ishte që të kemi një konsensus të plotë dhe gjithëpërfshirës, institucionet e Kosovës duhet ta kenë një plan të detajuar, të analizuar dhe të menduar mirë, plan i cili do duhet të jetë i konsultuar edhe me faktorin ndërkombëtar, me SHBA-të dhe NATO-n, në mënyrë që të kemi një pajtueshmëri gjithëpërfshirëse për formimin e ushtrisë.

Ne këtë këndvështrim ne kemi deklaratat shpresëdhënëse dhe të qarta të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, se “Kosova duhet të ketë ushtri, dhe që së shpejti do duhej të formohet ushtria e Republikës së Kosovës”, pastaj sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së, Matis, dhe e ambasadorit të SHBA-ve në Kosovë, Greg Delavi, i cili thotë:

“Sigurisht se SHBA-të e përkrahin transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një Forcë të Armatosur”. Por që kërkon që ky transformim të ndodhë në mënyrë kushtetuese. Prandaj, ne jemi në mes të planit A, i cili kërkon një diskutim të hapur dhe të gjerë, duke përfshirë edhe

minoritetet, në mënyrë që ta kemi një pajtueshmëri të plotë të të gjithë aktorëve, sepse duhet bërë ndryshime esenciale, që në fakt duhet të kemi ndryshime kushtetuese. Dhe plani B që ka të bëjë me ndryshimin e Ligjit për FSK-në, duke mos e ndryshuar emrin, por duke i shtuar kompetenca dhe duke e pajisur FSK-në me armatim dhe pajisje të përcaktuara në marrëveshje me NATO-n.

Mendoj që ne duhet zgjedhur zgjidhjen me adekuate dhe më të mirë, në mënyrë që pas krijimit të Ushtrisë së Kosovës të ketë mbështetje të fuqishme financiare dhe të pajiset me armatimin me modern që e kanë forcat e NATO-s. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Forcat e Armatosura të Kosovës, respektivisht Ushtria e Kosovës, duhet të formohet. Sa më parë, aq më mirë.

Ne kemi fat që aktualisht e kemi KFOR-in, si garantues të paqes dhe sigurisë sonë.

Por, KFOR-i nuk është e thënë që të jetë këtu edhe për shumë kohë. Ndryshimi i raportit të forcave në botë mund të reflektojë në zvogëlimin e interesimit të të tjerëve për Kosovën dhe, rrjedhimisht, të mos jenë të interesuar të vazhdojnë të qëndrojnë këtu forcat e KFOR-it në krye me Aleancën Ushtarake Veriatlantike (NATO).

Me qëllim që ta ruajmë dhe ta begatojmë lirinë tonë, sovranitetin tonë, ne kemi nevojë për Ushtrinë tonë.

Me qëllim që të krijojmë ambient të volitshëm për zhvillim ekonomik, aspekti i sigurisë është parakusht qenësor. Dhe stabilitet politik dhe ekonomik mund të ketë vetëm një vend sovran. Prandaj, ne kemi nevojë për Ushtrinë tonë.

Formimin e Ushtrisë së Kosovës, apo FAK, siç po parapëlqehet të quhet nga një pjesë e elitës politike kosovare, juridikisht mund ta bëjmë ose duke bërë ndryshime kushtetuese, ashtu që ta amendamentojmë nenin 126 të Kushtetutës së Kosovës, ose duke e ndryshuar Ligjin nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-108 për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës nr. 03/L-046.

Në bazë të Kushtetutës, për variantin e parë na nevojiten edhe 2/3 e votave të dyfishta të komuniteteve joshumicë. Sepse, për ndryshimin e çfarëdo dispozite kushtetuese: edhe për çështje që janë krejt elementare, edhe për çështje që janë jetike për shumicën dërrmuese të popullsisë, na nevojiten edhe 2/3 e votave të dyfishta.

Dhe, për miratim të çdo ndryshimi ku kërkohet vota e dyfishtë, si kundërshpërblim për dhënie të votës ka përpjekje për përfitime të padrejta të privilegjeve shtesë.

Ky fakt na tregon edhe një herë se sa e padrejtë është Kushtetuta jonë, ngase kur të duan një grup deputetësh që janë bërë deputetë me vende të garantuara, ua kufizojnë të drejtat e ligjshme shumicës dërmuese të qytetarëve të Kosovës, ua kufizojnë atyre vullnetin demokratik dhe mund ta bllokojnë jetën institucionale në Kosovë.

Duke e pasur parasysh se kemi hyrë në një fazë kur këto anomali kushtetuese po na pengojnë që të bëhemi një shtet normal, sa më parë duhet ta rishqyrtojmë ndryshimin e atyre dispozitave kushtetuese, të cilat po e bëjnë jofunksional shtetin e Kosovës.

Por, para kësaj, ne duhet të bëhemi garantues të fuqishëm të të drejtave të komuniteteve joshumicë.

Por, t'i kthehemi temës.

Përderisa për ta bërë ushtrinë kategori kushtetuese duke ia ndryshuar edhe emrin, edhe përmbajtjen, po shihet se tani për tani e kemi këtë pengesë, nuk na mbetet rrugë tjetër përveçse me Ligj ta bëjmë rritjen e kapaciteteve vepruese të FSK-së.

Në përputhje me nevojat e reja, duke i amendamentuar nenet 10 dhe 14 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës (Misionet dhe detyrat dhe Organizimi), t'i hapim rrugë shtimit të kapaciteteve vepruese të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në të gjitha drejtimet e mundshme.

Pra, si hap të parë, duhet ta plotësojmë e ndryshojmë Ligjin për FSK-në.

Dhe, para se ta plotësojmë e ndryshojmë Ligjin për FSK-në, duhet të japim garanci të fuqishme se rritja e kësaj force do të jetë në interes të sovranitetit të vendit, një forcë mbrojtëse dhe jo agresore dhe se nuk do të jetë rrezik për popujt e tjerë, e as për komunitetet joshumicë.

Këtë duhet ta themi fuqishëm. Dhe, të veprojmë në këtë drejtim.

Për forcimin e forcës mbrojtëse të Kosovës nuk kemi nevojë të bëjmë llogari politike se kush po përfiton, e kush po humb. Se cila parti politike po përfiton, e cila po humb. Se cili komunitet po përfiton, e cili po humb. Të gjithë qytetarët e Kosovës do të përfitojnë prej saj. E ardhmja jonë do të jetë më e sigurt, prandaj do të jetë edhe më e mirë. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

NAIM FETAHU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Tashmë, përkundër se jemi mbingarkuar me shumë tema tejet të rëndësishme për vendin, kjo që tani po diskutojmë është padyshim ndër më të rëndësishmet për të sotmen dhe të ardhmen e vendit tonë.

Kosova, tanimë e ka imediate të formojë Ushtrinë e Kosovës. Një nismë, e cila themelet i ka jo tani por në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pastaj Trupat Mbrojtëse të Kosovës e deri tani që është Forcë e Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, tani institucionet e vendit duhet t'i hapin rrugë formimit të Forcave të Armatosura të Kosovës, respektivisht Ushtrisë së Kosovës.

Bazuar në zhvillimet të cilat po kalojmë, bazuar edhe në iniciativën e Qeverisë në mandatin e kaluar me kryeministër Hashim Thaçi, ne duhet të procedojmë tutje me themelimin e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për vendin dhe sigurinë e së ardhmes sonë.

Formimi i FAK-ut është në interes të të gjithë qytetarëve të vendit dhe të së ardhmes së rajonit. Formimi i FAK-ut nuk paraqet rrezik për askënd në Kosovë e as në rajon. Përkundrazi, është një kontribut i madh për sigurinë dhe paqen në gjithë këtë pjesë të Evropës, e cila edhe ashtu ka nevojë për më shumë paqe.

Kosova është përcaktuar qartë për integritet Euroatlantike, kontribuuese e paqes dhe e qetësisë. Hapat që kemi ndërmarrë gjatë gjithë këtyre viteve për ndërtimin, fuqizimin dhe integrimin e vendit, kanë qenë hapa në këtë linjë përcaktuese dhe të qartë nga qytetarët e vendit tonë.

Formimi i Ushtrisë së Kosovës duhet të jetë prioritet i institucioneve tona. Çdo hap i ndërmarrë në këtë drejtim duhet të jetë i guximshëm dhe i menduar mirë, duke mos lejuar prolongim të pafundmë të kësaj çështjeje. Gjithsesi, ne nuk duhet të procedojmë me nguti e pa menduar mirë hapat, por që duhet të jemi më të shpejtë, padyshim se është më se e domosdoshme.

Kosova ka nevojë për ushtri të vetën, e cila duhet të jetë moderne dhe duhet të ecë rrugës së ushtrive moderne në Botë. Ky rrugëtim duhet të vazhdojë e të mos ndalet. Presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, në bashkërendim, duhet të lëvizin tutje me këtë proces.

Ndërsa, ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, në çdo kohë, besoj se do të jemi në gatishmëri për të nxjerrë vendime që janë në interes të Kosovës, të qytetarëve të saj dhe të gjithë rajonit.

Ushtria e Kosovës duhet të formohet, kjo nuk është vetëm dëshirë e jona, por është nevojë e domosdoshme e vendit.

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj. Nuk ka diskutues të tjerë, le të përgatiten përfundimet, nëse i keni bërë gati dhe thirrni deputetët. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Mendoj që ky debat është vërtet i nevojshëm dhe e kam përshëndetur iniciativën e organizimit të këtij debati.

Dua të them dy-tri gjëra edhe në rrafshin, kështu, individual, si njeri në politikë, por edhe në postin që e mbaj.

Mbi të gjitha debati ka të bëjë me sigurinë, ka të bëjë me mbrojtjen, ka të bëjë me kërcënimet e jashtme, të cilat i përmendën të gjithë deputetët.

Unë nuk dua t'i rikthehem vlerësimit se si e shohim gjendjen e sigurisë në Kosovë, në rajon dhe se sa shumë po ndryshon konteksti ndërkombëtar.

Por ky debat ka të bëjë edhe me diçka tjetër. Ka të bëjë me kompletimin e sovranitetit dhe sa kemi arritur në këto 10 vjet ta kompletojmë shtetësinë tonë, ta kompletojmë sovranitetin e Kosovës.

Disa njerëz që janë në këtë sallë, disa deputetë, disa kolegë ministra, por edhe unë kemi qenë diku para 10 vjetësh pjesë e negociatave në Vjenë dhe po e përmendi me qëllim këtë punë. Unë në atë kohë pakëz kam besuar që ne do ta kemi fillimin në 2017-tës dhe Kosova nuk do të ketë edhe më tutje ushtri, se në atë kohë kur e kanë vendosur një datë në Pakon e Ahtisarit që deri në mes të 2013-tës në qershor do të duhej të themelohej, të transformohet FSK-ja në një ushtri të Kosovës. Neve në 2007-tën na është dukur shumë vonë dhe tash jemi në janar të 2017-tës, dhe ende nuk e kemi një institucion të tillë.

Po e them këtë gjë për një arsye, që përveç debateve që i kemi për tema aktuale, duhet ta kemi edhe njëfarë konteksti më të gjerë dhe konteksti më i gjerë është që personalisht mendoj që shteti i Kosovës nuk është vetëm shtet në kuptimin territorial, gjeografik, institucional, por është edhe një entitet kohor. Nëse arritjet janë të vonuara, nganjëherë nuk janë arritje. Kështu që në këtë drejtim e përshëndes debatin dhe është mirë të ketë debat dhe është mirë të reflektojmë që duhet

ta kemi një ushtri të Kosovës me mandat, me mision, me doktrinë, me të gjitha elementet dhe kjo ushtri pastaj duhet ta mbështesë procesin e kompletimit të sovranitetit të shtetit të Kosovës.

Kjo është çështja e parë që desha ta ngre. Së dyti, për mua personalisht është e papranueshme sjellja e Listës serbe, e përfaqësuesve të tyre, në Kuvendin e Kosovës, sidomos në raport edhe me ushtrinë. Dhe, mënyra se si po keqpërdoret prej Beogradit dhe mendoj që si deputetë, që besojmë në Kosovën shumetnike, demokratike, duhet t'ia themi në mënyrën më të qartë të çdo kolegut tonë të çdo komuniteti se është pothuajse teprim.

Por, arsyeja pse e mora fjalën ka të bëjë edhe me diçka përtej kësaj pikës së parë dhe pikës së dytë. Ju e dini që ne e kemi filluar vitin e kaluar një partneritet me NATO-n, të cilit ne i themi bashkëpunim, por NATO-ja i thotë njëlloj ndërveprimi, ne i themi marrëdhënie kontraktuale, bashkëpunim, ata thonë njëlloj ndërveprimi. Dhe, kur e kemi iniciuar idenë që ta kemi një marrëdhënie kontraktuale me NATO-n, atëbotë kemi menduar që në letrën që e kemi marrë prej sekretarit të përgjithshëm të NATO-s do të ketë më shumë substancë, do të ketë më shumë formë. Ka disa elemente të mira, ka edhe dialog politik, ka edhe bashkëpunim praktik, ka disa fusha të bashkëpunimit, por kjo letër nuk është ajo çka kemi pritur, dhe a e dini pse po them? Po e them për një arsye, ju mund ta determinoni me data, mund ta determinoni me javë, me fillim të muajit, me fund të muajit, por unë jam i mendimit që nëse ky Kuvend duhet të marrë vendim për ta kompletuar misionin e FSK-së dhe ta shndërrojë këtë në ushtri të Kosovës duhet ta bëjmë edhe ndryshime kushtetuese, edhe me ligj, jo një gjysmë hapi, se një gjysmë hapi mund të jetë për ne problem që të lëvizim drejt NATO-s.

Mua më kanë thënë disa herë dhe duhet të ju them kështu në rrafshin më direkt të mundshëm, ne s'mund të bëjmë progres konkret drejt anëtarësimit të NATO-s pse nuk jemi ushtri. Do të thotë, me mandatin aktual të FSK-së nuk mund të lëvizim e të presim që mund të ndodhë diçka e madhe. Kështu që nuk e kisha matur me një rrafsh kohor, mund t'i rikthehem debatit edhe një herë në Kuvendin e Kosovës, na nevojitet partneritet, na nevojitet mbështetje ndërkombëtare, por hapin që duhet ta ndërmarrë Kuvendi duhet të jetë hap edhe i partnerëve tanë nëse dëshirojmë që pas 4-5 muajsh arrijtjet tona mos të jenë përsëri arritje të vonuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që kanë kërkuar të flasin. Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj, kërkues i këtij debati.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër,

Deputetë,

Pati diskutime të shumta dhe një pjesë e deputetëve, pothuajse nëse kisha mundur të them të të partive politike, e patën një gatishmëri për ta përafruar një rezolutë. Unë e kisha quajtur rezolutë

koti, meqenëse po e humb kuptimin, po e humb substancën, por edhe një herë po kthehemi prej fillimit.

Domethënë, e dëgjova tash ministrin e Jashtëm në fund kur tha që duhet kohë, domethënë prej vitit 2013, bukur një kohë, janë 4 vjet që kemi pritur, dhe kurrkush nuk po insiston që për shembull t'ia vendosim konopin në qafë Qeverisë ose një javë, ose një muaj. Do të thotë ne po kërkojmë dhe këtë le ta marrë edhe Qeveria, por edhe ata miqtë tanë, partnerët strategjikë, si presion i Parlamentit të Kosovës që sa më shpejt të bëhet ushtria. Tash po kërkohet të hiqet edhe diçka prej rezolutës.

Kisha pasur dëshirë t'i falënderoj deputetët e komunitetit joserb që janë në Parlament, të cilët tash e sa kohë, përpos që kanë qenë bashkëpunues, kanë qenë të gatshëm edhe ta japin kontributin e tyre për transformimin e FSK-së në ushtri. Se a ka vullnet te shumica e shqiptarëve në Kuvend, këtu nuk ka asnjë dilemë dhe nuk mendoj që ka deputetë normal këtu që është kundër. Dhe, çfarë kishim kërkuar ne sot? Ne kishim kërkuar sot që ta ndërrojmë Kushtetutën. Por, a është e mundur kjo të ndodhë? Fatkeqësisht, jo.

Ne e kemi sjellë një përfundim për të mos kaluar ky debat krejt pa një rezolutë, që unë mendoj që deputetët në fund, nëse mendojnë që është e drejtë t'i japin besim, nëse jo le ta votojmë kundër. Do të thotë u munduam që t'i përafrojmë, por jo gjithçka domethënë është në kuadër të kërkesave të grupeve parlamentare. Për qejf e kisha lexuar, e kompromisi më i madh që mundëm ta bëjmë si iniciues të debatit domethënë ishte kjo, më shumë nuk ka pati mundësi.

Projekt-rezoluta, Qeveria e Kosovës nuk e di a ka kuorum por, sido që të jetë po e lexoj, apo nuk jua kanë sjellë ende.

KRYESUESI: Nëse keni nevojë për konsultim të shkurtër, mirë!

DAUT HARADINAJ: Tash po më duket që vonesa është teknike, por nuk e di pse nuk kanë shkuar te deputetët, të paktën te shefat e grupeve parlamentare.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Zoti Haradinaj, a e ke përfunduar?

DAUT HARADINAJ: Po, kryetar!

KRYETARI: Atëherë, shkojmë veç pesë minuta pauzë, mos e lëshoni sallën, do të shkojmë në votim. Edhe një tjetër, a?

Vetëm pak, a është projekt-rezolutë për këtë, apo...? A ta përfundojmë këtë? Nuk do ta mbyllim seancën menjëherë, por kjo ka rëndësi në peshën e vet, pastaj flasim edhe për tjerët.

Atëherë pesë minuta pauzë, ju kisha lutur, dhe menjëherë i lus kolegët deputetë, kryetarët e grupeve parlamentare, që të kthehen në seancë. T'i thërrasin edhe kolegët deputetë, në mënyrë që t'i kemi të paktën 61 deputetë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës së shkurtër

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, e ftojme zotin Daut Haradinaj që ta sjellë projekt-rezolutën e ta lexojë para kolegëve deputetë, pastaj do ta votojmë.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Tash, e thashë edhe më herët, se kur e kemi parasysh një mekanizëm kaq të rëndësishëm, nganjëherë njeriu edhe kompromise duhet të bëjë, qofshin ato edhe jo në vullnet.

Projekt-rezoluta është e ndarë në dy pika, pikën numër 3 e kemi hequr krejt për shkak se nuk patëm mirëkuptim që të pastrohet ose të meremetohet, konstatoam që është më mirë të largohet krejt. Tash jemi në koordinim të plotë me të gjitha grupet parlamentare,

1. Qeveria e Kosovës autorizohet që sa më parë ta koordinojë dhe ta procedojë në Kuvendin e Kosovës për miratim Strategjinë për transformim të Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës,

2. Duke shprehur solemnisht përkushtimin e paalternativë për integrimin në organizatën e paktit Veriatlantik, NATO, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat tjerë institucionalë ta bashkërendojnë angazhimin për harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta me NATO-n dhe SHBA-në për zhvillimin e kapaciteteve operationale konform mandatit të ri të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Kjo është finalja. Kaq! Unë shpresoj që Qeveria e Kosovës edhe pa këtë rezolutë do të angazhohet, por shpresoj që minimum edhe kjo do ta japë një kontribut të vetin. Ju falënderoj shumë për diskutim dhe jam mirënjohës për angazhimin e përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haradinaj, a ka mundësi kopjen ta kemi? Atëherë Projekt-rezoluta është kjo, të cilën e lexoi kolegu im Daut Haradinaj. Jemi në fazën finale të votimit të saj.

Jemi 67 deputetë me prani fizike. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projekt-rezolutës të lexuar në fjalë. Votojmë tash!

Vetëm pak, 67 deputetë ishin në sallë, por i kemi 68 vota sipas kësaj. Atëherë, është me rëndësi për hir të korrektësisë në publik, 68 deputetë janë në sallë. 68 deputetë kanë votuar për, nga ta 65 në mënyrë elektronike, 3 nëpërmjet ngritjes me dorë. Kalon Projekt-rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, tanimë rezolutë. Urime! Faleminderit të gjithëve!

Të nderuar kolegë deputetë, ne kemi mundësi që të vazhdojmë edhe me një-dy pika të rendit të ditës, në qoftë se e kemi pajtueshmërinë. Po, do të vazhdojmë, ndërkohë nga kolegët e “Vetëvendosjes” kush e dëshiron fjalën. Po, urdhëro Besa Baftija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

BESA BAFTIJA: Të nderuar deputetë,

Ne e kemi harmonizuar Projekt-rezolutën së bashku me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Po ashtu, kjo Projekt-rezolutë është harmonizuar edhe nga debati që është nxjerrë nga interpelanca për sigurimet shëndetësore, iniciuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”. Po e lexoj Projekt-rezolutën:

1. Kërkojmë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të përgjithshëm të fondeve të ndara për sistemin informativ shëndetësor prej fillimit të implementimit të projektit deri në fund të muajit dhjetor 2016. Për këtë të përgatisë raport me shkrim për Kuvendin e Republikës së Kosovës,
2. Funkcionalizimi dhe shtrirja e plotë e sistemit informativ shëndetësor me plan e kalendar publik,
3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë në Kuvend në baza të rregullta tremujore për funksionalizimin e sistemit informativ shëndetësor,
4. Qeveria të shqyrtojë mundësinë e rritjes së buxhetit në mënyrë të vazhdueshme për shërbimet shëndetësore, barnat, materialin harxhues deri në funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore,
5. Plotësimi i parakushteve të parapara me Ligjin për sigurimet shëndetësore para fillimit të mbledhjes së premieeve,
6. Publikimi i dokumenteve me qëllim të informimit të publikut për çmimoren, kategoritë që përfshihen në pagesa dhe ato që përjashtohen.

Ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë Projekt-rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, pasi e marrim praninë, në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projekt-rezolutës të propozuar nga Besa Baftija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Votojmë tash!

Atëherë, janë 61 deputetë, të cilët kanë votuar në mënyrë elektronike.

Konstatoj se 59 për, 2 abstenime, 2 me dorë a jeni për? Me dorë janë 2. Janë 61 për dhe 2 abstenime.

Kalon edhe kjo Projekt-rezolutë në rezolutë.

A vazhdojmë edhe dy pika të rendit të ditës ta shfrytëzojmë këtë kohë?

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

E ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Paraqes para jush për miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ka filluar të zbatohet nga viti 2013 dhe gjatë zbatimit të tij janë hasur disa pengesa dhe vështirësi, të cilat nëpërmjet këtij projektligji Ministria e Drejtësisë i ka adresuar. Me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të legjislacionit të fushës së drejtësisë, si dhe duke synuar eliminimin e mangësive të ligjit ekzistues, e kemi hartuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Çështjet kryesore që parashihen në këtë projektligj janë si në vijim: dispozitat që i referohen çështjes së lirimit me kusht, duke përfshirë përbërjen e Panelit për Lirim me Kusht, si dhe mundësinë e atakimit të vendimit të panelit. Dispozitat që i referohen çështjes së përkujdesjes shëndetësore për të dënuarit, duke u siguruar që trajtimi shëndetësor i të dënuarve të bëhet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe në kushte të barabarta me personat në liri.

Dispozitat që i referohen pushimit në raste të jashtëzakonshme, me dispozitat që i referohen pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim për arsye shëndetësore, ku një kompetencë të cilën e kishte ministri i Drejtësisë, përmes këtij projektligji i është hequr dhe i është bartur Gjykatës. Po ashtu, është paraparë që për lirim të parakohshëm të të dënuarit, i cili ka pasur sjellje të mira, të mund të vendos Gjykata, si dhe harmonizimi i dispozitave të këtij projektligji me reformat që parasheh Ligji për kundërvajtje.

Me theks të veçantë do të theksoja ndryshimin e nenit 94 të Ligjit bazë, sipas të cilit ministri si i emëruar politik të ketë mundësi të pezullojë ekzekutimin e dënimit. Kjo çështje tashmë është ndryshuar dhe një mundësi e tillë i është bartur Gjykatës, si institucion kompetent për çështje të tilla dhe kjo konsiderojmë, se pos që është në harmoni me parimet kushtetuese, është edhe konform standardeve ndërkombëtare, si dhe është një hap i rëndësishëm në drejtim të ndarjes së pushteteve, ku gjykata vendos për dënimin por edhe për mundësinë e pezullimit, kurse Ministria e Drejtësisë vetëm e bën ekzekutimin e vendimeve të tilla.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria më 16 nëntor 2016. Është shpërndarë më 29 nëntor 2016 dhe nga ajo që shihet ka pasur disa vonesa, sa i përket procedimit të këtij projektligji. Nisur nga rëndësia e ndryshimeve, që parashihen përmes këtij projektligji, përmes të cilave dëshmojmë se vërtet jemi për reforma, vërtet jemi për sundim të ligjit dhe për sistem mbi bazën e vlerave dhe parimeve ndërkombëtare, me mirëkuptimin tuaj kërkoj që leximi i dytë të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar apo në një seancë të jashtëzakonshme.

Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë dhe nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, ju propozoj për miratim në procedurë, pra siç e ceka, të përshpejtuar të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas këtij prezantimi të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. E ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Selviqe Halimi, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17.1.2017, shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim:

- Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Të nderuar kolegë,

Meqenëse, ministrja për shkak të një periudhe të gjatë nga koha e aprovimit të ligjit në Qeveri dhe sjellja e projektligjit në Kuvend, kërkoj që të shqyrtohet projektligji me procedurë të përshpejtuar.

Ne si grup parlamentar e përkrahim propozimin e ministres, që të shkojmë me procedurë të përshpejtuar, por për këtë duhet të bëhet një shmangie nga Rregullorja e punës dhe për shmangie duhet të votojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kështu që, mbetet që kryetari i Kuvendit t'i drejtohet Kuvendit që të bëjmë shmangie nga rregullorja e punës, me qëllim që ligji të aprovohet me procedurë të përshpejtuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e ka kërkuar fjalën, Fatmir Xhelili apo Nait Hasani? Fatmir Xhelili. Si deputet apo në emër të grupit? Një herë vetëm t'ua japim radhën në emër të grupit. Selvija foli në emër të grupit apo do të flisni? Urdhëroni, zonja Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Vazhdojmë në emër të grupeve parlamentare, pastaj deputetët.

SELVIJE HALIMI: Po, faleminderit kryetar!

Unë lexova raportin e komisionit në mungesë të kryetares, tani paraqes edhe mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e sanksioneve penale dhe është që ky ligj të procedohet tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Është diskutuar shumë në të kaluarën nevoja për ndryshim-plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, po ashtu edhe deputetët, konkretisht komisioni ka bërë mbikëqyrjen e zbatueshmërinë së këtij projektligji.

Më vjen keq, që ky projektligj ka ardhur me vonesë, pasi që tash Kosova dhe sistemi i drejtësisë po i vuan pasojat e saj, fatkeqësisht, sidomos te përkujdesja shëndetësore e cila, ta quaj kushtimisht, edhe në raportet e progresit por edhe te raportet risi mbi sundimin e rendit të ligjit,

shihet si një dikaster që është keqpërdorur dhe sistemi i drejtësisë në vend është atakuar nga të gjithë ata, të cilët kanë qenë skeptikë për reformimin e saj.

Kështu që, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, sigurisht që e ka shqyrtuar. Të jem i sinqertë, nuk jam ithtar, personalisht mendoj, po edhe është obligim i Kuvendit që procedurat e shpejtuara nuk kanë dhënë ndonjë rezultat në dinamikën e plotësim-ndryshimit të ligjit apo në efikasitetin, sidomos në implementimin e ligjit në vazhdimësi. Por, sido që të jetë, për shkak të arsyeve që i dha ministria në fjalë, besoj që komisioni do të arrijë që ta plotësojë edhe këtë kriter.

E mira e saj është që sistemi i drejtësisë po kanalizohet drejt, po e merr rrugën e saj në reformimin e plotë. Mbi të gjitha, po shihet qartë një vullnet politik në bartjen e përgjegjësi të institucioneve, që janë kategori kushtetuese dhe politika t'i ketë duart larg nga sistemi i drejtësisë, në përgjithësi.

Unë kam shpresuar dhe kam menduar, nga ajo që është punuar edhe në të kaluarën, që krahas ndryshim-plotësimit të këtij ligji të shikohet edhe mënyra e përkrahjes së punëtorëve apo të stafit të Shërbimit Korrektues. Edhe kjo po shihet, që edhe me këto ndryshime pak a shumë është anashkaluar, duhet të jetë edhe prioritet, se të mos mendojmë vetëm në ankesat që kanë të burgosurit. Mua më vjen mirë kur të ketë ndryshime pozitive, por ata që punojnë aty, për mua, janë edhe ë rëndësisë së veçantë për zbatueshmërinë e ligjit, dhe sidomos, për mbarëvajtjen e burgjeve në Republikën e Kosovës, gjithnjë duke marrë edhe të kaluarën jo të mirë, siç kemi pasur shumë raste kur ligji është keqpërdorur për shkak të kushteve dhe kriterëve të dyfishta, që janë vendosur.

Por, sido që të jetë, kjo është një rrugë e mirë që po shihet se do të marrë edhe reformimi në tërësi i sistemit dhe i, ta quaj, burgjeve të Republikës së Kosovës dhe Grupi i Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta japë kontributin e vet gjatë kësaj periudhe, të cilën do ta kemi sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Më kujtohet kur ky Kuvend pati shqyrtuar projektligjin, tash Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili krijonte përshtypjen sikur Kosova i eliminoi të gjitha problemet që ishin nëpër qendrat korrektuese, përfshi këtu edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e të të burgosurve dhe stafin korrektues.

Nuk kaloi shumë kohë dhe u dëshmuar, që në Kosovë ligjet bëhen sa për një tik në Raportin e Progresit dhe jo për t'i adresuar problemet, me të cilat ne ballafaqohemi. Pra, edhe përkundër

hyrjes në fuqi të atij ligji, problemet nëpër burgje nuk janë adresuar, madje Kosova qëndron shumë keq në këtë drejtim. Kjo vërtetohet nga raportet vendore e ndërkombëtare, që janë të profilizuara për mbikëqyrjen e burgjeve.

Projektligji i proceduar nga Ministria e Drejtësisë përmban 24 nene plotësim ndryshime dhe këto janë kryesisht ndryshime kozmetike dhe mendojmë që përmes kësaj faze Ministria e Drejtësisë është dashur t'i evidentojë problemet reale e faktike, në mënyrë që t'i shndërrojë në amendamente.

Tek pika 1 e këtij projektligji, që synon ndryshimin e nenit 12, lidhur me vendosjen e personave të dënuar në institucionet korrektuese, thuhet që: “në institucione korrektuese personat e dënuar vendosen në qeli ose dhoma”, në të gjitha nenet e mëvonshme përdoret shprehja “qeli”. Ligji, së paku ky ligj, nuk përcakton se cili është dallimi në mes “dhomës” dhe “qelisë”.

Në nenin 3 të këtij projektligji flitet për hapësirën, në të cilën qëndron personi i dënuar. Sikur edhe në gjithë ligjin, Ministria e Drejtësisë është treguar ambicioze edhe në këtë dispozitë. Sipas këtij projektligji hapësira në të cilën do të qëndrojë i dënuari duhet të jetë, së paku, 8m² apo 4m² për secilin të dënuar, nëse jeton në hapësira të përbashkëta.

Do të doja të na tregojë ministrja e Drejtësisë, se sa janë të mëdha sot hapësirat ku jetojnë të burgosurit dhe a ka ndonjë plan konkret për rrënimin e të gjitha shtëpive korrektuese, renovimin e tyre apo ndërtimin e shtëpive të reja korrektuese, në mënyrë që ky ndryshim ligjor të mund të zbatohet.

Nga përvoja personale e di që në Burgun e Prishtinës, e kam parasysh ndryshimin në mes qendrës korrektuese dhe paraburgimit, që në një hapësirë e cila nuk ishte më e madhe se 8m² qëndronin 4 persona. Burgu i Prishtinës është mbyllur gjatë kohës që kam qëndruar në paraburgim. Në Burgun e Lipjanit gjendja ishte e njëjtë, në 8m² banonin 4 të burgosur.

Në dhjetor të vitit 2015, nëse nuk ka ndryshuar gjendja, të burgosurit detyroheshin të flinin me tri palë rroba për të përballuar të ftohtit, për shkak se ngrohja ishte e pamjaftueshme, nuk kishte dritë të mjaftueshme, nuk kishte ngrohje, nuk kishte ajrosje të duhur dhe nuk kishte hapësirë për një jetë me dinjitet. Pra, duhet të na thoni, pse ndryshimi i Ligjit nuk përmirëson kushtet e qytetarëve në paraburgim.

Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare. Zonja ministre, që ky nen të zbatohet, ose duhet të stopohet për pesë deri në dhjetë vjet botimi në “Gazetën Zyrtare”, në mënyrë që zbatimi i ligjit të pengohet, ose do të filloni shkeljen e tij si institucion, menjëherë pas publikimit të ndryshimit të ligjit. Nëse ky ndryshim ju duhet për t'i plotësuar standardet e Bashkimit Evropian në letër, duhet të na thoni, por një ndryshim real i paraparë sipas këtij neni nuk mund të

ndodhë, sepse me sa kam parë, në buxhetin e vitit 2017, por edhe në parashikimin për vitin 2018 dhe 2019 nuk është paraparë ndërtimi i shtëpive të reja korrektuese.

Është mirë, pra, ta ndërprisni këtë praktikë të keqe dhe mashtruese të krijimit të ligjeve, që në letër janë të mira, por që në praktikë nuk gjejnë zbatim. Kështu mashtrojmë, jo vetëm qytetarin, por edhe Bashkimin Evropian. E ardhmja evropiane nuk arrihet përmes mashtrimit.

Pra, Ministria e Drejtësisë do të bënte mirë të na sqaronte, se si e ka menduar realizimi në praktikë të ndryshimit të këtij neni.

Te neni 5 i këtij projektligji flitet për përkujdesjen shëndetësore. Ndryshimet e parapara shprehin tendencën për t'i barazuar shërbimet brenda dhe jashtë burgut, gjë që nuk përkon fare me realitetin. Ajo që më habit më së shumti, është se asnjë ndryshim nuk parasheh shtimin e sigurisë për ruajtjen e jetës së të burgosurit. Pas rastit të Astrit Deharit, vdekja e të cilit mbetet enigmë, kur shteti nuk arrin akoma të na thotë përse vdiq Astrit Dehari, pse nuk u mbrojt jeta e tij, çfarë nuk funksionoi në ofrimin e sigurisë, kam pritur që ndryshim-plotësimet e ligjit do të merreshin edhe me ngritjen e standardeve të sigurisë. Por, si duket, Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë nuk është e interesuar fare për të trajtuar çështjen e të burgosurve politikë.

Pra, zonja ministre, pse në këtë pikëpamje nuk ka asnjë ndryshim? Ndryshimi i ligjit nuk parasheh asgjë për të mundësuar një jetë me dinjitet të personave që mbahen në arrest shtëpiak. Sa për ilustrim, unë dua të veçoj rastin e Frashër Krasniqit, zyrtar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, i cili po mbahet në arrest shtëpiak për muaj të tërë. Unë e kam vizituar Frashër Krasniqin në banesën e tij dhe mund të ju them, se pozita e tij është më e rëndë se e secilit të paraburgosur, që ndodhet në paraburgim kudo në Kosovë. Derisa të paraburgosurit tjerë mund të dalin çdo ditë jashtë qelisë rreth 2 orë, Frashër Krasniqi, i cili jeton në banesën e tij në katin e pestë, për muaj me radhë nuk ka dalë asnjëherë. A mund ta paramendoni, se çfarë do të thotë për shëndetin e tij fizik, të mos dalë asnjëherë jashtë hapësirës së banesës? A e dini, që vetëm kjo sjellje, vetëm ky detyrim për të qëndruar brenda, pa dalë jashtë hapësirës së banimit në katin e pestë të ndërtesës shumë katërshe, është shkelje e të drejtave elementare të njeriut, është një shkelje e dinjitetit të njeriut, e shëndetit të tij dhe bie ndesh me të drejtat elementare të njeriut, që një të akuzuarit t'i lehet mundësi për të dalë për një kohë të caktuar jashtë hapësirës, ku mbahet i arrestuar.

A nuk është Frashër Krasniqi i diskriminuar në raport me të gjithë të paraburgosurit tjerë? Pse nuk mund të dalë Frashër Krasniqi jashtë banesës së tij? Po, a mund të paramendoni se çfarë do të thotë kjo për shëndetin e tij psikik, pavarësisht se Frashër Krasniqi nuk është ankuar asnjëherë?

Të gjithë këto tregojnë, se nuk jeni të interesuar për të krijuar kushte normale për ekzekutimin e dënimeve, por vetëm për ligjin në letër, ku flisni për një jetë me dinjitet për qytetarin e dënuar,

por që e trajtoni më keq se shtazët në disa vende perëndimore. Ju, jo vetëm që nuk jeni duke i përmirësuar kushtet e të burgosurve, por e keni kthyer gjithë Kosovën në një burg të madhe, pikërisht për faktin që bëni ligje evropiane në letër dhe praktika kineze në jetën e përditshme, duke na lënë, pikërisht për këto arsye, pa viza, pa të drejtën e qarkullimit të lirë.

Unë besoj, që standardet evropiane me letra i plotësojmë. Vallë, a është ky qëllimi i vetëm i Qeverisë, një jetë me dinjitet por vetëm në letër? Gjithçka tek ne është formë, ligji për ekzekutimin e dënimeve është formë, zhvillimi ekonomik është formë, mirëqenia qytetare është formë, Qeveria është formë, sovraniteti i vendit është formë. Por, në asnjërën prej këtyre fushave nuk ka përmbajtje, madje në disa prej tyre ka vetëm përmbajtje të keqe.

KRYETARI: Nait Hasani. Fatmir Xhelili kërkon... nuk kam të lajmëruar në monitor, prit pak atëherë. Në emër të Grupit Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj. U lajmërua edhe Shukrije Bytyqi në emër të Nismës.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket projektligjit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi, fjala për ju, në emër të Grupit Parlamentar të Nismës.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka shqyrtuar projektligjin dhe e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Xhelili, fjala për ju. E kam vetëm edhe një deputet, Nait Hasani. Ju lutem, kolegë deputetë, në qoftë se dëshironi të diskutoni, lajmërohuni.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, Kabinetin qeveritar!

Të nderuar deputetë,

E përgëzoj ministren e Drejtësisë dhe Qeverinë që e ka sjellë këtë ligj në Parlament. Edhe ashtu është ndoshta pak me vonesë, por është ligj që është adresuar edhe në Raportin e Progresit.

Lidhur me plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale. Në Kushtetutën tonë ndarja e pushteteve është themel bazë në të cilin është krijuar i tërë sistemi juridik i Kosovës. Në këtë drejtim, të gjitha vendimet gjyqësore duhet të merren nga gjyqësori dhe rrjedhimisht sistemi i ekzekutimit duhet të mbikëqyret nga Gjykata. Me këtë projektligj sillen një frymë e re e ndryshimeve, e cila është e orientuar drejt parimit se gjyqtari, gjegjësisht Gjykata, është kompetente që të vendos për të

gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit me burg, për shembull, lirimi me kusht, pezullimi, lirimi i parakohshëm. Konsideroj, se kjo është në përputhje me parimet e ndarjes së pushteteve, si dhe me të drejtat themelore dhe liritë e qytetarëve.

Disa nga ndryshimet më të rëndësishme të këtij ligji, konsideroj sa janë: pezullimi i përkohshëm i ekzekutimit të dënimit; monitorimi dhe heqja e pezullimit të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit; përbërja e panelit për lirim me kusht dhe njohja e drejtës së ankesës kundër vendimeve të panelit; si dhe lirimi i parakohshëm.

Kur flasim për pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të dënimit, monitorimit dhe heqjes së pezullimit, konsideroj se heqja e kompetencës së ministrit të Drejtësisë për të pezulluar ekzekutimin e burgimit, pa iu nënshtruar asnjë shqyrtimi gjyqësor, vetëm se e fuqizon parimin e ndarjes së pushteteve. Prandaj, është për tu miratuar zhvendosja e kësaj kompetence ekskluzivisht te gjyqësori, sepse ky ndryshim vetëm sa e forcon mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve nga Gjykata dhe rrjedhimisht, edhe sundimin e ligjit.

Për më tepër, fuqishëm besoj se duhet vendosur arsyet e qarta që arsyetojnë pezullimin. Roli dhe detyrat mbikëqyrëse të Gjykatës, rregullat për trajtimin mjekësor jashtë objektit të burgimit për të dënuarit, procedura e ankimit, kushtet për heqjen e pezullimit, të gjitha këto duhet të jenë të përcaktuara qartë.

Sipas ligjit në fuqi përbërja e panelit për lirim me kusht, nuk është me shumicë të gjyqtarëve, andaj edhe ndryshimi i propozuar dhe i prezantuar, në të cilën paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre anëtarësh, një gjyqtar i Gjykatës Supreme, një gjyqtar i Gjykatës së Apelit dhe një gjyqtari të Gjykatës Themelore është një ndryshim shumë pozitiv dhe i rëndësishëm, duke qenë se gjyqtarët janë gardianët juridikë më të lartë të të drejtave themelore dhe lirive të qytetarëve.

Gjithashtu, ligji në fuqi nuk lejon ankesë dhe as konflikt administrativ kundër aktvendimit të panelit për lirim me kusht. Kjo është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila thotë: secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij, ose të saj, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Prandaj, njohja e të drejtës së ankesës garanton realizimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe si e tillë është një avancim pozitiv i legjislacionit, i cili duhet mirëpritur.

Sipas ligjit në fuqi, drejtori i një institucioni korrektues është kompetent për lirim të personit të dënuar para përfundimit të vuajtjes së tij, ose saj, të dënimit me burg, nëse ai, ose ajo, ka shfaqur sjellje të mirë, sukses në punën e tij, ose saj, dhe aktivitete tjera. Njëjtë, sikurse tek lirimi me kusht edhe këtu, do të duhej që gjyqtari, gjegjësisht gjykata kompetente, ajo që vendos për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit me burg. Drejtori nuk duhet të ketë

autoritet për të marrë një vendim me peshë të tillë, veçanërisht pasi kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë kufizohen në administrimin e burgjeve, institucioneve korrektuese, e tjerë...

Pra, nuk duhet lënë mundësi të merren vendime lidhur me ekzekutimin e sanksioneve individuale. Mendoj se me aprovimin e ligjit të ri do të fuqizohet drejtësia në Kosovë dhe do të përmbushet edhe një kriter në drejtim të realizimit të ligjeve, të cilat janë adresuar në Raportin e Progresit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Xhelili! Zoti Hasani, fjala për ju. S'ka deputetë tjerë të paraqitur.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, kryeministër!

Kabinet qeveritar,

Përshëndetje edhe për ministren e Drejtësisë!

Unë kam bërë edhe një amendament, por pikërisht e mbështes fjalën e Fatmir Xhelilit, që e tha në mënyrë përmbajtjesore të gjitha ato. Unë mendoj që ky projektligj duhet të ketë edhe lirimet, ose ndihmesën e të burgosurve, sepse me këtë qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve nuk është vetëm për t'i shkatërruar apo ekzekutuar njerëzit, por është një çështje edhe riedukimi, humanizmi dhe një sjellje e mirë e shoqërisë, për t'i kthyer ata në shoqëri.

Mendoj se burgjet në krahasim me burgjet e shteteve të Bashkimit Evropian, kemi mjaft raste ku ata kanë edhe forma të ndryshme të sanksioneve, ku ata kanë edhe sanksionet një me një, një me tre, a një me pesë dhe një me shtatë, kjo do të thotë se një ditë e mbajtur me ju llogarit për 24 orë me 36 orë apo 40 orë apo edhe 30 orë. Do të thotë, ka mundësi që tu jepet një mundësi të burgosurve, ku shumë herë ata nuk e gëzojnë këtë të drejtë, por ata që i përmendi, për shkak të burokracisë, ose nuk i jepet mundësia të bëjë ankesë, tu shkojnë ankesat ose lutjet apo kërkesat, sepse kemi qenë vetë brenda dhe e dimë çfarë kanë hequr të burgosurit me ato kërkesat e tyre, që nuk u shkonin, meqë pjesa e administratës, pjesa e pazgjidhur e tyre dhe ata shpresonin në lutjet, në faljet e tyre, të cilat asnjëherë nuk i gëzonin ato të drejta.

Prandaj, për të arritur këtë mundësia është që Kuvendi i Kosovës ta miratojë në një amendament, që t'i shtohet këtij projektligji dhe ai të jetë pikërisht një mundësi e mirë, që t'i llogaritet një ditë 24 orësh në 36 orë, që do të thotë, që 1,5 kjo i bie që një shumë e madhe e të burgosurve do të përfitojnë nga ky amendament dhe ky projektligj, e ata do të lirohen. E nëse do të lirohen ata do të kemi, edhe përfitime familjare, edhe përfitime të shtetit të Kosovës, edhe humanizmin e shoqërisë sonë. Nëse i kemi, në bazë të statistikave që i kemi, kemi 1800 të burgosur në Kosovë, këta llogaritet që i kanë 28 deri në 30 euro e kanë një shujtë, nëse llogarisim matematikisht na dalin 54 000 shpenzime ditore që i vijnë, nëse llogarisim me 365 ditë, Qeveria e Kosovës do të lirohet diku rreth 18 milionë euro brenda një viti. Nëse do të lirohen 1 800 të burgosur për një vit

ata do të kenë një ulje për një vit, ndërsa shteti i Kosovës do të ketë mundësi që këto shpenzime t'i shpenzojë në përmirësimin e kushteve tjera të të burgosurve.

Por, në anën tjetër, nuk është vetëm kjo. Nëse i llogarisim prapë ashtu matematikisht, familjet tona që shkojnë, ose familja që shkon me i vizitua të burgosurit, mesatarisht 50 euro i kushton për një vizitë një anëtar i familjes, 1 800 na del neve 90 mijë euro mujorja për t'i vizituar familjet tona atje, ose familjarët tanë. Edhe këto, nëse i llogarisim me 12 muaj, na del 1 080 000 euro. Domethënë, rregullisht ose për çdo vit të falur, të amnistuar, të ndihmuar, familjet tona dhe të burgosurit do të ketë mundësi shteti i Kosovës të përfitojë diku 20 milionë euro, që do të ketë mundësi tu ndihmojë atyre.

Prandaj, unë kam përgatitur edhe amendament që do ta procedoj në Komisionin Legjislativ dhe kërkoj, që ligjit bazë të nenit 17 ekzekutimi i sanksioneve finale, pas paragrafit të dytë t'i shtohet paragrafi i ri, si në vijim: "Një ditë e kaluar, 24 orë, e kaluar në ekzekutimin e dënimit me burg, është e barasvlershme me një ditë e gjysmë ose 36 orë të kaluara në liri." Kjo do të thotë, që ne u ndihmojmë.

Unë dëgjoj fjalë, që "...jo i kanë thirr filani ose fisheku..." miqtë dhe të tjerët, ta kemi parasysh se pikërisht qëllimi i ligjit, qëllimi i dënimeve është kthimi i njerëzve për gabimet e tyre që i kanë bërë, të risocializimit, riedukimit dhe kthimit të tyre në familje, sepse nuk i kthejmë ata në familje, ne krijojmë njerëz armiq. Prandaj, shteti ynë nuk ka nevojë të krijojë armiq, por ka nevojë të krijojë njerëz që do t'i kthehen shoqërisë dhe familjes dhe t'i përmirësojmë ata dhe jetën tonë në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, nuk e ka kërkuar askush fjalën.

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Në rend të parë ne duhet të kemi kuorum. Po, zoti deputetë, vetëm ta 52 deputetë, siç po e shoh a e lëmë? Në qoftë se, vijnë deputetët a e vazhdojmë edhe një pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Desha edhe njëherë të kërkoj, që ministrja e Drejtësisë të përgjigjet, së paku në një pyetje. Ligji është i paimplementueshëm për shkak se ne nuk i kemi këto standarde në burgje. Ne po votojmë për një ligj, i cili posa të hyjë në fuqi duhet të shkelet, për shkak se nuk ekzistojnë kushtet. Le të thotë ministrja sa janë qelitë e mëdha në burgjet e Kosovës sot.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Topalli. Ministrja e pati të drejtën të përgjigjet, kur të kishte dashur. Në leximin e dytë, më duket se shpejt e paskëshit, e trajtoni.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Skender Hyseni, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin nr. 05/L-1243 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214 i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji është hartuar duke u bazuar në Programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon disa përkufizime, shprehje të përdorura, të drejtat themelore të njeriut me rastin e kalimit të kufirit, korsi të veçanta, informatat mbi shenjat dhe vendosjen e vulës katrore në dokumentet e udhëtimit gjatë kryerjes së kontrollit kufitar të hyrjes dhe daljes nga Republika e Kosovës, si dhe lehtësimin e kalimit të shërbimeve emergjente në pikëkalimet kufitare.

Ndryshim-plotësimi i këtij projektligji është paraparë me masat legislative afatshkurtra, në kuadër të planit për zbatim të Marrëveshjes së stabilizim-asociimit, përkatësisht në kuadër të objektivave në fushën e menaxhimit të kufirit, Kapitulli 24, Drejtësia, liria dhe siguria, i ‘acquis communautaire’ të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj ka transpozuar Rregulloren e BE-së 2016/399 dhe atë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 09 mars 2016 për krijimin e një kodi të Unionit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve, që ndryshe quhet ose njihet si kodi i kufijve Shengen.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat përkatëse, opinionin për vlerësim të ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave dhe opinionin ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integriteteve Evropiane.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë, unë ju ftoj që ta votojmë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas prezantimit të këtij projektligji, e hap debatin për diskutim, në parim. Nëse dëshiron, e ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Daut Haradinaj, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

Atëherë, Pal Lekaj, jo në emër të grupit, në emër të Komisionit, nëse dëshiron.

DAUT HARADINAJ: Kryetar, Komisioni FunkSIONAL konstaton se ky ligj i ka plotësuar kushtet që të miratohet në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kush e do fjalën? Është lajmëruar vetëm Faton Topalli. Anton Çuni dhe Fatmir Shurdhaj. Fillojmë me Anton Çunin, le të bëhen gati Fatmir Shurdhaj dhe Faton Topalli.

ANTON ÇUNI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim projektligjin në fjalë! Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Shurdhaj, fjala për ju.

FATMIR SHURDHAI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj, i cili plotëson dhe ndryshon Ligjin 04/072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-214.

Ky projektligj është i rëndësishëm së veçantë, për faktin se u mundëson qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të tjerë, të cilët futen në kufirin e Kosovës, e që duhet t'i paraqesin dokumentet në bazë të rregullave të reja, të cilat ne si qytetarë i kemi përjetuar edhe në kufijtë e tjerë ndërkombëtarë.

Projektligji është i përkrahur nga Ministria e Integritimit Evropian dhe Ministria e Drejtësisë. Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë janë dhënë disa rekomandime që me Konventën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u jepet mundësia qytetarëve për të kërkuar azil dhe migrim. Gjithashtu, edhe Ministria e Punëve të Brendshme i ka dhënë të gjitha rekomandimet e veta, duke e plotësuar këtë ligj dhe duke krijuar mundësitë e shenjëzimit të korsive në kalimet kufitare.

Partia Demokratike e përkrah këtë projektligj në parim dhe në Komisionin Funkcional do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Topalli, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”. Le të bëhet gati Daut Haradinaj në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Është normale që kur ligjet vijnë në shqyrtim të parë të diskutohet për to, të zhvillohet debat, ashtu siç është normale që ministrat të japin edhe përgjigje në pyetjet e deputetëve.

Unë po shoh se Qeveria nuk ka gatishmëri, as ministrja e Drejtësisë për t’u përballur me pyetjet e deputetëve. Kjo çështje në vendet demokratike është e patolerueshme. Dhe, në shenjë mospajtimi me këtë qëndrim ne po dalim nga salla, por ky nuk është qëndrimi ynë, nuk po deklarohe mi lidhur me pikën e rendit të ditës, e cila është duke u zhvilluar tani.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Shpresoj se edhe kolegët e mi deputetë nga radhët e Aleancës do t’i japin përkrahje në parim këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 04/L-072 për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-214 dhe mendojmë se është një projektligj i rëndësisë së veçantë, prandaj kontributin tonë do ta japim edhe në komisionin përkatës.

Pra, Grupi Parlamentar në parim e përkrah këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Votimin do ta lëmë më pas, atëherë kur të kemi kuorum.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e komisionit, zotin Muhamet Mustafa, që në cilësinë e propozuesit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të arsyetoj fare shkurt këtë ligj.

Iniciativa për këtë ligj ose për të nxjerrë këtë projektligji lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka ardhur nga Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kjo ka të bëjë me përfaqësimin, autorizimet për përfaqësimin e palëve në kontekstet pranë Dhomës Speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Sipas ligjit aktual, të gjitha palët që kanë konteste në Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme duhet të autorizojnë avokatë, anëtarë të odave të avokatëve, qofshin të vendeve apo të jashtëm dhe kjo e vënë në një pozitë të pavolitshme Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për arsye se AKP-ja ka një shërbim mjaft të kualifikuar juridik, me juristë të mirë, të cilët mund t'i mbrojnë interesat e AKP-së në kontestet me kreditorët dhe janë më mirë të informuar se sa avokatë që do të angazhoheshin eventualisht.

Mu për këtë, Bordi i AKP-së na ka propozuar që komisioni ynë të japë iniciativën për ndryshimin e një ligji, me të cilin sa i përket AKP-së, do të thotë të tjerat organizata mbesin njëjta zgjidhjet, por sa i përket AKP-së, ajo mund të përfaqësohet në kontestet në Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme edhe nga përfaqësuesit e autorizuar të AKP-së në shërbimin juridik të kësaj organizate.

Me këtë propozim kursehen mjete të konsiderueshme të buxhetit të AKP-së dhe të buxhetit publik të Kosovës, prandaj ju ftoj që ta aprovoni.

KRYETARI: Faleminderit! Pas prezantimit të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim. Nuk ka të paraqitur. E keni parasysh, debati mbaron, por shkojmë vetëm në votim dhe ne po sakrifikojmë që po qëndrojmë.

Atëherë, vetëm votimi ka mbetur dhe vazhdojmë me pikën e radhës.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zoti Avdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me qëllim të përmirësimit të kornizës qeverisëse dhe kontrolluese të Bankës Qendrore.

Projektligji adreson rekomandimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me masat mbrojtëse të BQK-së.

Janë dy ndryshime dhe plotësime që parashihen në këtë projektligj.

Ndryshimi i parë është në nenin 41 të ligjit bazik.

Ky nen rregullon diskualifikimin dhe shkarkimin nga Bordi i Bankës Qendrore të Guvernatorit dhe anëtarëve të Bordit.

Ligji bazik ka paraparë të drejtën e zëvendësguvernatorëve që të ankohen në Gjykatën Supreme kundër vendimit për shkarkimin e tyre, mirëpo nuk e ka paraparë të njëjtën të drejtë edhe për guvernatorin dhe anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore.

Mungesa e kësaj të drejte është konstatuar të jetë në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare që rregullojnë bankat qendrore, prandaj me plotësim-ndryshimin e këtij ligji sigurohet kjo e drejtë edhe për guvernatorin dhe anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore.

Ky plotësim-ndryshim i Ligjit të BQK-së është gjithashtu në pajtim edhe me nenin 14 të Statutit të sistemit evropian të bankave qendrore.

Ndryshimi i dytë është në neni 63 të ligjit bazik, i cili ka të bëjë me heqjen e dispozitës që kërkon aprovimin nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike për emërimin e auditorëve të jashtëm të Bankës Qendrore.

Është vlerësuar se kjo dispozitë nuk është në pajtim me nenin 27.1 të Statutit të sistemit evropian të bankave qendrore, prandaj plotësim-ndryshimi i këtij neni parasheh që Bordi i Bankës Qendrore të emërojë auditorin e jashtëm të BQK-së.

Kjo dispozitë e re do të ndikojë në sigurimin e autonomisë së plotë të Bankës Qendrore në përzgjedhjen dhe emërimin e auditorit të jashtëm dhe është në përputhje me praktikat më të mira për bankat qendrore.

Ne kemi zhvilluar diskutime publike dhe për këtë plotësim-ndryshim është plotësuar apo është dakorduar plotësisht Banka Qendrore, ashtu sikur kërkohet me ligj.

Ne kemi analizuar implikimet financiare të këtij projektligji dhe del se nuk ka ndonjë implikim financiar, prandaj duke pasur parasysh këto, ju ftoj që të aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Pas prezantimit të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim.

Sikur që po shoh, ka pajtueshmëri. Komisioni, a do të marrë fjalën? Atëherë, urdhëro zonja Safete Hadërgjonaj me kartelë të deputetit Bislim Zogaj. Fjala është për ju.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 05-L/150 për ndryshim-plotësimin e Ligjit 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe e ka përkrahur në parim këtë projektligj.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kanë qenë ministri i Financave, por edhe guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ne i kemi analizuar këto nene, për të cilat është kërkuar me plotësim-ndryshim të ndryshohen.

Komisioni për Buxhet dhe Financa është pajtuar, prandaj rekomandoj që deputetët e Kuvendit të Kosovës të përkrahin rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe ta përkrahin në parim këtë projektligj.

Nëse ka mundësi, zoti kryetar, e kisha thënë edhe mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin dhe e përkrah rekomandimin e komisionit që të votohet në lexim të parë ky projektligj, kurse kontributin tonë do ta japim në Komisionin për Buxhet e Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe njëkohësisht mbështet rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa dhe i fton të gjithë deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë mendoj se duhet ta përkrahim në parim këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve. Deri gjatë leximit të dytë mendoj se duhet të shohim edhe një herë lidhur me auditimin e Bankës Qendrore, a i kemi zgjedhjet më të mira apo jo, dhe eventualisht për ndonjë amendamentim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Debati edhe për këtë projektligj mbaroi dhe në mungesë të kuorumit, votimi do të bëhet në seancën e radhës.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Paraqes para jush për miratim Projektligjin për ndërmjetësimin. Miratimi i këtij projektligji paraqet njërin ndër angazhimet e drejtpërdrejta të Ministrisë së Drejtësisë për krijimin dhe avancimin e infrastrukturës ligjore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efektive për qytetarët tanë.

Projektligji për ndërmjetësimin është edhe një iniciativë tjetër që dëshmon angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për reformimin e legjislacionit në vendin tonë.

Jam e bindur se ndryshimet që i sjell ky projektligj do të ndikojnë pozitivisht në shfrytëzimin më të madh të kësaj metode jashtëgjyqësore të zgjidhjes së kontesteve, si dhe do të ndikojë që gjykatat të shkarkohen nga numri i madh i lëndëve.

Përveç tjerash, me ndryshimet e reja do të ketë një harmonizim më të plotë të procedurave të ndërmjetësimit si dhe një ndërlidhje më të mirë institucionale me gjyqësorin.

Prioritet i Ministrisë së Drejtësisë mbeten reformat në sistemin e drejtësisë në vend dhe Projektligji për ndërmjetësimin është hapi i radhës në këtë drejtim.

Ky projektligj i ka gjithsej 28 nene, me 6 kapituj, ku ndër të tjera rregullon parimet dhe procedurën e ndërmjetësimit, kushtet dhe regjistrimin e ndërmjetësuesit, të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe ndërmjetësuesit, si dhe njohjen e ndërmjetësuesit të huaj, si dhe dispozitat ndëshkimore.

Projektligji është në harmoni të plotë me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Hartimi dhe finalizimi i këtij projektligji ka rezultuar me një bashkëpunim të ngushtë me aktorët vendorë dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Andaj, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të legjislacionit të kësaj fushe dhe me qëllim të eliminimit të pengesave dhe vështirësive që janë hasur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, ju ftoj për ta miratuar Projektligjin për ndërmjetësim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim, në parim. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Selvije Halimi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 24. 1. 2017 ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndërmjetësim dhe i rekomandon Kuvendit që ta aprovojë në parim projektligjin dhe njëherësh i fton të gjithë deputetët, të cilët mund të kenë amendamente për ta rregulluar edhe më tej projektligjin, t'i paraqesin në Komisionin Funkcional, në mënyrë që ligji të bëhet sa më i lehtë për zbatim në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, Nezir Çoçaj, le të bëhet gati Armend Zemaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,
E nderuar ministre e Drejtësisë,
I nderuar ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin 05/L-135 për ndërmjetësim dhe si të tillë në parim do ta përkrahë. I ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj, fjala për ju, në emër të LDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar sigurisht se e përkrah Ligjin për ndërmjetësim. Kapitulli që ka të bëjë te ndërmjetësuesi dhe te kushtet e kërkuara të ndërmjetësuesit për certifikim thuhet se duhet të jenë konform kushteve të përgjithshme në përputhje me ligjin në fuqi, besoj se duhet të jenë me këtë ligj, e ndoshta është përvjedhur, sepse është parë nga ligji i kaluar dhe, sido që të jetë, janë edhe disa çështje, të cilat duhet të harmonizohen edhe me vetë Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Sido që të jetë, kjo vetëm se e avancon edhe atë që e tha vetë ministrja e Drejtësisë, shkarkimin e gjykatave dhe në ndihmesën e punëve apo konfliktet që i kanë palët në procedurë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe për këtë projektligj përfundon debati. Nuk ka të lajmëruar për diskutim, jemi vetëm në procesin e votimit.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Administratën Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!
E nderuar ministre,
Të nderuar deputetë,

Para jush paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në harmonizimin e parimeve të statistikave zyrtare me ato të Eurostatit, gjegjësisht me Kodin e Praktikës Evropiane, fuqizimin e pavarësisë institucionale dhe profesionale të statistikave tona zyrtare.

Qëllimi i projektligjit është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës që të arrijë të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm statistikor në Kosovë në aspektin institucional dhe atë profesional, që t'i respektojë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare dhe të punojë në ndërtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave në vend.

Është me rëndësi të potencohet që ky projektligj është në përputhshmëri të plotë me Rregulloren nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian, Këshillit mbi Statistikat Evropiane të 11 marsit 2009 dhe me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane.

Projektligji është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë realizuar një sërë konsultimesh dhe pjesëmarrje e gjerë e aktorëve kyçë dhe palëve të interesin që lidhen me këtë projektligj. Faleminderit për vëmendjen dhe ju ftoj ta aprovoni.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim, në parim. Në emër të Komisionit FunkSIONAL, kush e do fjalën? Nuk ka të paraqitur.

Atëherë, në emër të grupeve parlamentare, Zenun Pajaziti, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Unë po e shfrytëzoj rastin edhe në emër të komisionit, meqenëse zonja Izmaku është në udhëtim, e po ashtu edhe zëvendëskryetari i komisionit nuk është i pranishëm.

Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka vendosur që t'i rekomandojë seancës që ta miratojë në parim këtë projektligj.

Po ashtu, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi shqyrtuar dhe i japim përkrahje dhe në lexim të dytë do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mustafa, e keni fjalën. Atëherë, Agim Kikaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

AGIM KIKAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim këtë projektligj dhe i rekomandon Kuvendit që të miratohet në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Xhelili, fjala për ju, e pastaj le ta marrë fjalën profesor Mustafa! Të tjerë nuk ka të lajmëruar.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës, ashtu sikur në çdo vend të botës, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, qoftë për zhvillimin e politikave të ndryshme zhvillimore, hartimin e ligjeve, hartimin e strategjive afatgjata, hartimin e programeve dhe projekteve kapitale, proceset me rëndësi të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, e deri te pasqyrat apo të dhënat zyrtare që prezantojnë Republikën e Kosovës në botë.

Andaj, duke u bazuar në këtë rëndësi, mendoj se deri tash institucionet që janë pjesë e sistemit statistikor të Republikës së Kosovës nuk u është kushtuar vëmendje e duhur që ato e meritojnë.

Duke u bazuar në Ligjin ekzistues për statistikat zyrtare nr. 04/L-036, bartësja kryesore e statistikave zyrtare në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës si dhe Banka Qendrore e Kosovës, Ministria e Financave që prodhojnë disa statistika sipas përgjegjësisë së vet.

Bazuar në zhvillimet e pesë vjetëve të fundit, në sistemin statistikor të Kosovës ka ndodhur një progres i theksuar, vlerësim nga ana e Eurostatit, institucionit qendror për statistikat zyrtare në BE, por jo aq edhe e institucioneve vendore.

Ky vlerësim profesional pozitiv përfshin nxjerrjen e Ligjit për statistikat zyrtare në Kosovë nga Kuvendi i Kosovës nr. 04/L-036 pas ish-rregullores së UNMIK-ut, përfshin konsolidimin dhe riorganizimin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, krijimin dhe funksionalizimin e Këshillit Statistikor, realizimin e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, pas 30 vjet ndërprerjeje, realizimin e regjistrimit të bujqësisë 2014, pas më shumë se 50 vjetëve, realizimin për herë të parë të anketës për grupimin e indikatorëve të shumëfishtë, që tre nga këta indikatorë kontribuan për marrjen e MSC-së, projekt amerikan për Kosovën nga ana e Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu u rrit në mënyrë të theksuar numri i produkteve statistikore dhe indikatorëve statistikorë, u rrit dukshëm cilësia statistikore dhe tashmë prodhimet statistikore janë të bazuara tërësisht në metodologjinë dhe standardet e Eurostatit dhe atyre ndërkombëtar.

Periudha e kaluar sigurisht që pati edhe sfida, probleme dhe pengesa, të cilat gjenden në raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave.

Në këtë aspekt dominon problematika e mungesës së resurseve për shkaqe buxhetore.

Në bazë të informatave del se ASK-në shumë më shumë e kanë ndihmuar me buxhet donatorët ndërkombëtarë se sa institucionet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës.

Por, më lejoni të flas për mundësinë e kontributit tim si deputet për avancimin e sistemit statistikor të Kosovës.

Republika e Kosovës tash ka hyrë në një proces shumë dinamik të integritetit evropian. Kosova dhe BE-ja tash kanë një marrëveshje, MSA-në.

Neni 95 përcakton shumë qartë obligimet e institucioneve të Kosovës lidhur me statistikat zyrtare. Këto obligime janë vendosur edhe në planin kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Detyrimet e zhvillimit të statistikave zyrtare gjithashtu janë vendosur në agjendën për reforma evropiane dhe në të gjitha raportet vjetore të progresit nga Komisioni Evropian.

Suksesi në rrugën e integritetit evropian varet se sa Kosova përmbush obligimet nga zotimet e marra. Në këtë drejtim, edhe për fushën e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës është vendimtar zbatimi i rekomandimeve që dalin nga vlerësimet e Eurostatit për sistemin statistikor të Kosovës.

Pikërisht në bazë të këtyre rekomandimeve dhe nevojave të tjera për sistemin statistikor të Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, si sponsor i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të statistikave të Kosovës nr. 04/L-036, ka kërkuar që ky ligj të plotësohet me qëllim që sistemi statistikor i Kosovës të avancojë si një sistem bashkëkohor statistikor dhe sipas praktikave dhe standardeve të Eurostatit, në këtë rast të vendeve të BE-së.

Prandaj, sistemin statistikor të Kosovës dhe ASK-në Eurostatit e ka ndihmuar me rekomandimet dhe sugjerime të vazhdueshme. Kjo vërtetohet nëpërmjet shkresave zyrtare dhe vizitave të shpeshta të nivelit më të lartë të Eurostatit në Kosovë, ku janë vënë në dijeni përfaqësuesit e institucioneve më të larta të Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, lidhur me rëndësinë e vendosjes së rekomandimeve të tyre në projektligjin që po e aprovojmë sot në leximin e parë.

Eurostatit shkresat e tyre zyrtare nëpërmjet përfaqësuesve të Zyrës së BE-së në Kosovë i ka dërguar fillimisht të zëvendëskryeministrat e Kosovës më 24. 11. 2015, pastaj te kryeministri i Kosovës më 24. 4. 2016 dhe më 9. 12. 2016, si dhe te kryetari i Kuvendit të Kosovës më 9. 12. 2016.

Prandaj kërkoj që këto rekomandime të futen në ligj gjatë amendamentimit, sepse janë shumë të rëndësishme për sistemin statistikor të Kosovës, për Agjencinë e Statistikave të Kosovës, por edhe për procesin e integriteteve evropiane që po e synojmë.

Aty kërkohet edhe fuqizimi i pavarësisë profesionale dhe institucionale të Agjencisë si një nga parimet bazë të Kodit të praktikës evropiane për statistikat.

Në bazë të rekomandimeve të lartcekura konkretisht kërkoj që të futet një amendamentim që ASK-ja t'i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe si institucion të jetë në kuadër të Kuvendit të Kosovës, e jo të zhvendoset ky institucion nga Zyra e Kryeministrit në ndonjë nga ministritë e Qeverisë së Kosovës.

Në një nga amendamentet që përfshihet edhe rekomandimi i Eurostatit dhe kërkesa e Agjencisë së Statistikave të Kosovës që ka të bëjë me fuqizimin e Agjencisë në aspektin e pavarësisë profesionale dhe institucionale sipas parimit të Kodit të praktikës evropiane për statistika.

Gjithashtu kërkoj që të futet ky amendament dhe detyrimi i secilit institucion në Republikën e Kosovës që menaxhon me të dhëna administrative si burim i të dhënave statistikore, që në rastin e ndryshimeve në çfarëdo akte ligjore ose nënligjore për strukturën e të dhënave të kërkojë fillimisht edhe aprovimin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për ndryshimin e strukturës së këtyre të dhënave.

Kjo përgjegjësi në vendet e BE-së është e vendosur dhe zbatohet në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mustafa, fjala për ju.

MUHAMET MUSTAFA: Edhe unë dëshiroj t'i them disa gjëra, pasi mendoj se ky institucion është një nga më të rëndësishmit në Kosovë për të përmirësuar politikat, për të përmirësuar nivelin e informacionit dhe nivelin e analizave, mbi të cilin bazohen politikat ekonomike dhe politikat e tjera, jo vetëm ekonomike.

Në këtë drejtim, mendoj se është me vend që në ligj të lejohet mundësia që Agjencia e Statistikave të zhvendoset nga Zyra e Kryeministrit në ndonjë institucion tjetër apo Qeveria të vendosë për ndonjë solucion tjetër, sepse edhe unë mendoj që nuk është shumë e natyrshme që Agjencia e Statistikave të lidhet drejtpërdrejt me Zyrën e Kryeministrit, për arsye se kjo agjenci, unë nuk di si ka ardhur edhe deri te kjo. Ajo lidhje duhet të ketë një pavarësi më të madhe, duhet të ketë kushte më mëdha të punës, kështu që edhe unë e përkrah atë që tha ministri i Financave se duhet të shkojmë kah praktikatat e Eurostatit dhe praktikatat e tjera. Kjo ishte një çështje.

Çështja e dytë është se ne duhet të shohim që krahas ndryshimit të këtij ligji, të gjejmë solucione, të cilat sigurojnë pavarësinë e këtij institucioni dhe nivelin profesional, nivelin analitik, publikimet.

Pajtohem se kjo agjenci ka arritur rezultate në publikime, ka arritur rezultate në shumë fusha, por ende dështon që të publikojë raporte mbi disa çështje kyçe që kanë të bëjnë me politikat ekonomike.

Konkretisht, nuk kemi statistika mbi punësimin. Kemi statistika mbi papunësinë, por jo mbi punësimin.

Nuk kemi statistika mbi prodhimin, strukturën e prodhimit në Kosovë.

Nuk kemi statistika mbi investimet, të detajuara. Dhe, këto janë çështje që përbëjnë themelin e prioriteteve të politikave ekonomike që duhet t'i ketë Kosova.

Në këtë drejtim mendoj se krahas ndryshimit të statusit, krahas sigurimit të pavarësisë më të madhe, ne duhet të mendojmë si ta ristrukturojmë këtë agjenci që t'i prodhojë këto statistika të domosdoshme për të rritur cilësinë e informacionit, mbi të cilën bazohen politikat tona ekonomike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bulliqi, urdhëroni!

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti kryetar!

Të respektuar kolegë deputetë,

Unë desha një ndihmesë të vogël, normal nëse do të merret parasysh, sa i përket çështjes së transferit të Entit të Statistikave ose Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Me sa kam informacione, para disa vjetësh Agjencia e Statistikave të Kosovës ka qenë pjesë e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe, edhe unë plotësisht pajtohem që faktikisht kjo agjenci duhet larguar nga Zyra e Kryeministrit, sepse vërtet është një ngarkesë shumë e madhe që edhe me këtë çështje të merret kryeministri i vendit. Por, sigurisht që nuk pajtohem, dhe mendoj se shumë më e udhës është që prapë të rikthehet në suaza të Ministrisë së Shërbimeve Publike, aty ku ka qenë para disa vjetësh, të paktën në periudhën e përgatitjes së regjistrimit të popullsisë dhe në atë periudhë kohore ka qenë pjesë e kësaj ministrie, sepse mendoj që prapë nëse do të zhvendoset në Ministrinë e Financave, prapë do të jetë një ngarkesë për Ministrinë e Financave që edhe kjo agjenci të bëhet pjesë e saj.

Prandaj, propozimi im konkret është që Agjencia e Statistikave të Kosovës prapë të kthehet në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka më debat, pra përfundoi dhe s'ka tjerë të paraqitur për fjalë.

Të nderuar kolegë deputetë, me kaq po e përmbyllim seancën për sot, për të vazhduar nesër në orën 10:00, me votimet dhe pikat e tjera të mbetura. Faleminderit!

* * *

E mërkurë, 15 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 9-14 shkurt

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë!

Së pari, do të dëshiroja që ministres së re për Integritet t'ia urojmë detyrën, edhe në emrin tuaj dhe shpresoj që do ta ndjekë rrugën e ministrisë së kaluar që ka ardhur nëpër komisione për të na informuar.

Së dyti, para se të kalojmë në çështjet që duhet t'i votojmë, nënkryetarja e Kuvendit, zonja Aida Dërguti, ka kërkuar që ta bëjë një deklaratë lidhur me një çështje personale dhe unë i kam dhënë të drejtë. Parlament është ky, ka të drejtë të flasë, sa i përket çështjes që e kanë debatuar me zonjën ministre.

AIDA DËRGUTI: Zonja dhe zotërinj,

Javën e kaluar, gjatë seancës, hapësirën e pyetjeve parlamentare, ku unë nuk mund të përgjigjesha, Edita Tahiri e shfrytëzoi për shpifje lidhur me letrën time që para një viti ia kam dërguar ITU-s.

Kjo ministre u përpoq ta gënjejë opinionin publik, ashtu siç është mësuar të gënjejë shpesh rreth dialogut me Serbinë, e që madje ne kemi parë edhe demantin nga Brukseli për deklaratat e saj.

Paragrafi i dytë i letrës sime shtron kërkesën e qartë që kodi telefonik duhet t'i ndahet drejtpërdrejt Republikës së Kosovës, dhe jo nëpërmjet Serbisë, siç ka ndodhur.

Pronari i këtij kodi telefonik që na e solli Edita është Serbia, gjë që dëshmohet edhe në letrën e sekretarit të përgjithshëm të ITU-s, drejtuar zëvendëskryeministrit të Serbisë, Rasim Lajiq, pra kjo është letra.

Në këtë letër Republikës së Kosovës i referohet si regjion gjeografik i 'Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë'. Pra, me këtë emërtim i është dhënë kodi, e që për pronar e ka Serbinë. Prandaj, komunikimi zyrtar është me Serbinë dhe jo me Kosovën.

Le të na tregojë Edita, së paku një komunikim zyrtar mes ITU-s dhe Qeverisë së Kosovës, nuk ekziston, sepse nuk e njeh.

Ky ka që legalisht është në pronësi të Serbisë, në rend të parë cenon sigurinë kombëtare.

Përveç kësaj, letrën të cilën ia kam dërguar ITU-s nuk e kam dërguar në emër të Kuvendit, sepse e di që shumica parlamentare përfaqësohet nga kjo ministre, po në emër të opozitës dhe

peticionit të nënshkruar nga 200 mijë qytetarë të Kosovës, të cilët i kundërshtojnë këto marrëveshje.

Kjo letër është shkruar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë vendorë, të cilët kanë punuar në ITU që nga vitet '80-ta, e që fatkeqësisht Edita nuk i ka konsultuar asnjëherë për këtë çështje gjatë dialogut.

Edita Tahiri nuk përtoi të më akuzojë se paskam keqpërdorur logon e Kuvendit. Ajo harron se unë jam nënkryetare e Kuvendit dhe nga ky pozicion më lejohet përdorimi i logos në çdo korrespondencë zyrtare.

Logoja e Kuvendit mund edhe të mos i pëlqejë Editës, sepse në te shkruan “Republika e Kosovës” dhe nuk e ka fjollën e Editës që tashmë është shndërruar në ortek, e që rrezikon ta rrënojë shtetin e brishtë të Kosovës.

Kjo ministre madje shtirej si e përfolur, kinse vetëm gjatë seancës e kuptoi se unë e kisha dërguar atë letër. Letra ime ka qenë publike që nga 24 marsi 2016, të njëjtën e kam lexuar në seancën e 26 shtatorit, në Kuvendin e Kosovës.

Për hir të sqarimit të opinionit po e rilexoj edhe një herë letrën, por se nuk ekziston as në transkript.

“I nderuar z. Sekretar i Përgjithshëm,

Po ju shkruaj për të sjellë shqetësimet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e një procesi të gjatë të kodit telefonik ndërkombëtar për Republikën e Kosovës.

Është thënë se një proces është duke u zhvilluar për caktimin, nga ana e ITU-s, të kodeve ndërkombëtare për shërbime telefonike për vendin tonë. Ajo çfarë publikut në vendin tonë nuk i është thënë, është fakti që këto do të jenë “kode gjeografike” të caktuara për Republikën e Serbisë, e që do të ndahen më tej nga Serbia, për një shtet të cilin Serbia e konsideron të jetë krahinë e saj. Nismëtarët e këtij procesi kanë kaluar nëpër vështirësi të mëdha për t'i fshehur këto fakte nga publiku, ndër të tjera, duke e përfshirë BE-në dhe administratën austriake. Nga ajo që është bërë publike, është e qartë se qëllimi i tyre është edhe ta përdorin ITU-n duke parashkruar njoftime dhe lajmërime të ITU-s lidhur me këtë proces. Shpresoj dhe pres që ITU-ja do të refuzojë të jetë pjesë e këtij komploti për ta mashtruar popullin e Republikës së Kosovës dhe të reflektojë të vërtetën në të gjitha dokumentet dhe njoftimet lidhur me këtë proces.

Republika e Kosovës është shtet i pavarur, i njohur nga 111 vende të botës, ase më shumë se gjysma e anëtarësisë së ITU-s. Serbia, jo vetëm që nuk e njeh, por Kushtetuta e saj e konsideron Republikën e Kosovës të jetë territor i saj. Ky fakt i vetëm e përjashton Serbinë për të pasur ndonjë rol në caktimin e numrave ndërkombëtarë për shërbime telefonike për Republikën e

Kosovës. Duke pranuar rolin e Serbisë në këtë proces, në mënyrë të pashmangshme do të interpretohet si ITU-ja pranon qëndrimin e Serbisë lidhur me Republikën e Kosovës. Ne besojmë se ky nuk është, në asnjë mënyrë, qëllimi i ITU-s, prandaj ITU-ja duhet të caktojë kodet ndërkombëtare drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Pasojat e përfshirjes së Serbisë në këtë proces mund të shihen më së miri në “Planin e zbatimit” për këto kode. Ky dokument tregon qartë çmimin e rëndë që Republika e Kosovës do të paguajë për shkak të autoritetit dhënë Serbisë për të caktuar kodet e lëshuara nga ITU-ja. Serbia përdor një autoritet të tillë për të diktuar politikën e telekomunikacionit, funksionet rregullative dhe operacionale në sektorin e telekomunikacionit të Republikës së Kosovës, siç janë licencimi, kodet, interkoneksioni, tarifat, etj. Kjo është një tjetër arsye pse kodet ndërkombëtare duhet të caktohen nga ITU-ja drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, dhe jo të Serbisë. Nëse ka qëllim të vërtetë për të zgjidhur çështjen e kodeve të vendit, atëherë kjo nuk duhet të paraqesë problem. Por, nëse Serbia ka një agjendë tjetër, siç është minimi i sovranitetit të vendit fqinj, atëherë ne shpresojmë dhe presim që ITU-ja do të refuzojë të jetë pjesë e saj.

Në dokumentet e bëra publike deri tani është propozuar përdorimi i një emërtimi jokushtetues për vendin tonë në të gjitha dokumentet e ITU-s dhe njoftimet lidhur me këtë proces. Ne shpresojmë dhe presim që ITU-ja nuk do të pranojë një propozim të tillë, sepse kjo do të thotë pranim nga ITU-ja i qëndrimit të Serbisë lidhur me Republikën e Kosovës.

Për shkak të të gjitha të lartpërmendurave, ekziston një kundërshtim i fortë publik për qasjen karshi caktimit të kodit telefonik ndërkombëtar për vendin tonë, i shprehur, ndër të tjera, në një petition të nënshkruar nga më shumë se 200 mijë qytetarë. Në emër të tyre dhe në emër të 30 anëtarëve të Parlamentit, unë jam duke i ndritur këto shqetësime para jush, me shpresën se ITU-ja do t'i marrë ato në konsideratë.

Ju falënderoj për kohën dhe kuptimin, i nderuar zoti Sekretar i Përgjithshëm!

Aida Dërguti, nënkryetare e Kuvendit të Kosovës”.

Tani po ia dorëzoj edhe administratës, në mënyrë që ta fusin në transkript. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë po fillojmë me seancën e rregullt.

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra të Qeverisë së Kosovës,

Reagim, po nuk po hapim debat tash, ajo deklaratë. Ani, mirë, fol. Zenun Pajaziti e ka fjalën, në rregull.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Mendoj që sot seanca duhej të niste aty ku mbetëm dje dhe nuk ishte mirë sot të hapej një temë dhe aq më tepër ta apostrofojë një ministre që sot nuk është këtu.

Është fjala për një temë, e cila mendoj që ka pasur debate në parlament dhe i kemi kryer këto debate. Nuk ka pse të apostrofohet as ITU-ja, e cila ka qenë një partnere në një proces të gjatë pas dialogimit, ku ne kemi përfituar një kod telefonik, të cilin sot Kosova e ka të vetin.

Nëse dikush ka gabuar në këtë proces, nuk mendoj që është mënyra më e mirë e tillë që sot, aq më tepër, që duhej të debatohej mes ministres për Dialog dhe deputetes, pra të bëhej në mungesë të ministres. Askush nuk ka të drejtë as të përdorë logot e institucioneve, të flasë me emër të institucioneve dhe as të keqpërdorë nënshkrimet e qytetarëve për qëllime politike ditore, dhe kjo u pa edhe sot në leximin e kësaj letre.

Mendoj që sot nuk ishte mirë që t'i jepej fjala askujt, të devijojë agjenda e kësaj seance dhe aq më tepër, një farë mënyre të devalvohet ajo që është arritur në vendin tonë. Kodi telefonik është marrë, ITU është institucion që nuk pyet fatmirësisht asnjë deputet, por është mirë që kjo të mos keqpërdoret, dhe ne, si të thuash, të ballafaqohemi në debate kur është ajo temë dhe kur janë personat që duhej të ishin këtu, sidomos ministrja e Dialogut. Faleminderit!

KRYESUESI: Deklarata në Kuvend nuk e prish marrëveshjes, ka pasur qejf të bëjë deklarata, të sqarohet opinioni. Zoti Beqiri e ka fjalën. Është e drejtë e saj, është nënkryetare e Kuvendit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Edhe unë konsideroj që është keqpërdorim, e para, e logos së Kuvendit. E dyta, kjo temë ka përfunduar dhe është dashur edhe ne ta kishim këtë letër. Është e drejtë e deputetes të shkruajë letra dhe të thotë mendimin e saj. Por, ajo që më shtyu ta them që absolutisht nuk qëndron ajo që ju mund të flisni në emër të 200 mijë nënshkrimeve. Absolutisht nuk është e vërtetë, sepse ato 200 mijë nënshkrime kur i keni mbledhur ju për kod telefonik, ju lutem...

Unë po ju dëgjoj, unë po e them mendimin e grupit dhe timin, ju e thoni tuajin dhe nuk keni nevojë të reagoni, sepse jeni mësuar që me dhunë të tentoni t'ua impononi mendimet të tjerëve, mendimet tuaja të tjerëve.

Prandaj, edhe një herë konsiderojmë që është keqpërdorur dhe është një mendim politik, i cili është artikuluar këtu dhe pasi nuk është ministrja, edhe ne është mirë ta kemi atë shkresë. Ne nuk pajtohemi, normalisht, rreth qasjes ose qëndrimit që ka të bëjë me kodin. Ne konsiderojmë që ka

përfitime vendi ynë dhe janë thënë, janë shpjeguar qartë shumë herë këtu. Përfitimet janë shumë të qarta dhe vetëm ai që nuk do t'i shohë thotë ndryshe. Edhe një herë, mendimi ynë është shumë i qartë që po abuzohet shpeshherë edhe këtu. Ta kishim marrë ne fjalën për një çështje të tillë, sigurisht reagimet do të ishin, sepse nuk është në rend të ditës. Kjo punë ka mundur të jetë në deklarime në ndonjë seancë tjetër, sidoqoftë qëndrimi ynë është shumë i qartë që po abuzohet me të qenët deputet dhe adresimin në emër dhe me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Unë mendoj që mjaftueshëm është kjo, nuk ka më debat. Ka qenë një deklaratë, ju lutem, nuk e kam hapur debatin. Vazhdojmë me seancën. Jo, jo, nuk ka debat. E ka bërë deklaratën Aida, ju nuk keni çka të flisni, tash. Jo, jo, e ka bërë Aida deklaratën, ju s'mundni...u krye ajo punë. Këta reagues, mirë boll, këta mendimin e vet, ju tuajin dhe u mbyll me kaq. Nuk po e politizojmë, o burrë, se nuk është gjë ajo punë.

Atëherë po hyjmë në seancë të rregullt. Sa deputetë i kemi?

10. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Ju njoftoj që diskutimet për këtë pikë dhe pikat në vazhdim 11, 12, 13, 14 dhe 15 kanë përfunduar në seancën e djeshme, më 14 shkurt 2017, andaj procedojmë vetëm me votimin e tyre.

Në sallë janë 64 deputetë.

Ju ftoj të përgatiteni për votim, regjia, votojmë tash:

Po e nxjerr edhe një herë në votim, ju lus, para votimit të paraqitni kush nuk ka kartelë, nuk po funksionon. Tre veta janë pa kartelë.

Në sallë janë 67 deputetë. Edhe një herë e përsërisë votimin, votojmë tani:

Ju pa kartelë jeni për, nuk ka kundër? Në rregull.

Kanë votuar 64 deputetë me kartelë. Tre vetë janë pa kartelë, edhe këta kanë votuar për. Domethënë, për kanë votuar 62, plus 3 pa kartelë, bëjnë 65 vota për, 2 abstenime dhe asnjë votë kundër.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Tani kemi një propozim të Grupit Parlamentar të PDK-së. Besoj që më mirë ta lexojë vetë kryetari i grupit parlamentar, se sa t'ju sqaroj unë dhe pastaj vazhdojmë me votime. Zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse ne dje debatuar për këtë projektligj dhe meqenëse ministrja e prezantoi edhe nevojën që ky projektligj, ngase është një prej kritereve për MSA-në të bëhet më shpejt. Ne propozojmë që me këtë projektligj të shmangemi nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren, me nenin 57. Kërkojmë që Komisioni Funkcional, edhe ato të përhershme, ta shqyrtojnë dhe t'i paraqesin raportet sot në një seancë të re, të cilën për orën vendosim ose ju, kryesues, ose me deputetë bashkë. Edhe shqyrtimi i dytë i projektligjit të bëhet pra sot, të njëjtën ditë, në një seancë të re.

Kërkoj nga grupet parlamentare dhe deputetët që ta mbështesin këtë propozim për shmangie nga Rregullorja e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë ky është mocion i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Unë propozimin e nxjerr në diskutim dhe pastaj votojmë mocionin.

Fjalën e ka zoti Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Për hir të urgjencës, edhe asaj që u tha edhe nga ministrja dje, edhe nga propozimi që doli prej kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, ne e përkrahim edhe shmangien, edhe që sot të mbahet kjo seancë për shqyrtimin e dytë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Edhe ne në parim u pajtuam me ligjin, ashtu siç e theksova edhe dje që ligj ka çështje të cilat duhet të rregullohen dhe, mje

risht, ky ligj nuk i rregullon. E kam fjalën edhe për pjesën që ka të bëjë me paraburgimet. Ne i kemi aktualisht në burg Adeja Batushën, Frashër Krasniqin, Atdhe Arifin dhe Egzon Halilin, të cilët janë të trajtuar më keq se sa në paraburgim.

Nuk jemi për shmangie, sepse mendojmë që ta trajtojmë seriozisht ligjin dhe nuk do të thotë që kjo çështje të kryhet pasdite, mund të presim edhe disa ditë, derisa t'i bëjmë amendamentet, në mënyrë që ligji të jetë më i mirë dhe t'i dedikohet vërtet qëllimit për të cilin po bëhet.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse është një projektligji i rëndësishë së veçantë dhe meqenëse qenka një urgjencë, ne po e përkrahim shmangien, me kusht që anëtari që është në Komisionin përkatës, edhe pse është një

periudhë shumë e shkurtër, të mund të propozojnë ndonjë amendamentim ose ndryshim që vërtet ia vlen.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, zonja Valdete Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu edhe “Nisma” e përkrah në parim këtë projektligj, mirëpo neve na duhet kohë, kryetar, për ta shqyrtuar këtë ligj. Nuk mundemi për një ditë ligjet me rëndësi t’i trajtojmë për 2-3 orë dhe definitivisht këto procedura ose ikja nga procedurat e rregullta është mosseriozitet i këtij Kuvendi.

Prandaj, edhe “Nisma për Kosovën” e kundërshton dhe shpresoj që edhe mazhoranca t’i marrë me seriozitet dhe t’i trajtojë ashtu siç duhet ligjet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+” e ka fjalën.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Önemli yasa olduđu için PDK grubunun önerisini 6+ Parolmenter Grubu da kabul etmekteyiz.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne i dëgjuam propozimet. Unë jam ta zbatojmë Rregulloren. Rregullorja thotë që me 2/3 e votave të deputetëve prezentë mund të shmangemi nga Rregullorja, kështu që e nxjerr në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, s’kemi kuorum. Jo, po punon teknika, po mesazhi është i tillë, se teknika është duke punuar mirë.

Në sallë janë 69 deputetë dhe kanë votuar 42, u bënë 70.

Edhe një herë e hedh në votim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Kur të arrini konsensus, e votomë prapë. Faleminderit!

11. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Të nderuar deputetë,

Diskutimet kanë përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 64 deputetë me kartelë, 2 deputetë janë pa kartelë, bëjnë 66 deputetë, për janë 54 deputetë, plus dy, 56. Kundër janë 10 dhe asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Diskutimet kanë përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe juve, të nderuar deputetë, që të përgatitemi për votim, votojmë tash:

Në sallë janë 70 deputetë. Me kartelë kanë votuar 61 deputetë, plus dy janë pa kartelë, bëjnë 63.

Për, me kartelë janë 56, plus 2 pa kartelë, bëjnë 58 për. 3 kundër dhe 2 abstenime. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Votimi i Projektligjit për ndërmjetësim

Diskutimet kanë përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatitemi për votim, votojmë tani:

Faleminderit! Kanë votuar 68 deputetë me kartelë, 2 janë pa kartelë. Në qoftë se i keni rregulluar, tregoni. Për kanë votuar 68, asnjë votë nuk është kundër, asnjë abstenim, plus 2 janë pa kartelë, bëjnë 70 vota për.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmjetësim.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Diskutimet kanë përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Kanë votuar 73 deputetë me kartelë, plus 2 pa kartelë, bëjnë 75. Për janë 64 me kartelë dhe 2 pa kartelë, bëjnë 66 deputetë, asnjë kundër dhe 9 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Diskutimet edhe për këtë kanë përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Në sallë janë 74 deputetë. Kanë votuar 61 deputetë, plus 2 pa kartelë, bëjnë 63, 63 deputetë janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane

Komisioni Funkcional për Integritet Evropiane ka shqyrtuar Agjendën për Reforma Evropiane dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Tani diskutues, sipas radhës, nëse përfaqësuesi e Qeverisë e dëshiron fjalën, mund ta marrë. Zonja Mimoza Ahmeti, ministre për Integritet, e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA MIMOZA AHMETI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush Agjendën për Reforma Evropiane, apo shkurt e njohur si ERA.

ERA është rezultat i përpjekjeve tona të përbashkëta në nivelin më të lartë politik për të intensifikuar zbatimin e reformave kyçe, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.

Më konkretisht, kjo kornizë formale është ideuar së bashku me BE-në dhe në nëntor të vitit 2016 është lansuar zyrtarisht nga kryeministri Mustafa dhe Komisari për Fqinjësi dhe Zgjerim, Johanesh Han.

Më konkretisht, qëllimi i ERA-s është që të shërbejë si dokument formal për zhvillimin e dialogut të nivelit të lartë politik mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, që do të shtyjë përpara zbatimin e MSA-së dhe reforma të tjera fundamentale që do ta shtyjë procesin e aderimit të vendit tonë në BE në një fazë më të avancuar të marrëdhënieve politike, ekonomike dhe institucionale.

Kjo synohet të arrihet duke i dhënë vëmendje më të lartë politike realizimit të reformave kyçe ekonomike, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë.

Gjatë përgatitjes së ERA-s kemi zhvilluar konsultime të vazhdueshme në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli më i lartë politik, duke përfshirë edhe presidentin e Republikës së Kosovës dhe kryetarin e Kuvendit, e deri në nivel të të gjitha departamenteve të institucioneve relevante të vendit.

Këto konsultime punuese kanë çuar në një listë prej 22 prioritetesh që do të zbatohen deri në fund të vitit 2017.

Prioritetet janë të ndara në tri shtylla: qeverisja e mirë dhe sundimi i ligji, konkurrueshmëria dhe klima e investimeve dhe punësimi e arsimit.

Shtylla e parë, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, përmban 9 prioritete, të cilat prekin reformën e administratës publike, politikat kundër korrupsionit, reformën në sistemin e drejtësisë dhe prokurimit publik.

Më konkretisht, në kuadër të kësaj shtylle do të konsolidojmë më tej legjislacionin për parandalimin dhe luftimin e konfliktit të interesit dhe formave të tjera të korrupsionit në të gjitha institucionet publike.

Do të miratojmë dhe fillojmë së zbatuari legjislacionin e ri për shërbimin civil, pagat e shërbyesve civilë dhe organizimin e administratës publike, do të vendosim një sistem të llogaridhënies dhe transparencës së funksionimit të partive politike, do të përmirësojmë pavarësinë dhe llogaridhënien e institucioneve të pavarura, do të fillojmë me zbatimin e prokurimit elektronik në të gjitha institucionet dhe nivelet, do të ngrihen kapacitetet institucionale të gjykatave në çështjet fiskale dhe ekonomike si dhe do ngrihen kapacitetet e Prokurorisë Speciale me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e prioriteteve të shtyllës së parë janë: Kuvendi, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Administratës Publike, e Financave, organet e prokurimit publik si dhe Këshilli Gjyqësor, Institucioni Gjyqësor, gjykatat, Prokuroria Speciale dhe institucione të tjera të pavarura, të mandatuara për fushat e sipërpërmendura, ku bien këto prioritete.

Në kuadër të shtyllës së dytë, konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, kemi paraparë shtatë prioritete, të cilat prekin klimën afariste dhe të investimeve, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, infrastrukturën dhe energjinë.

Sa i përket klimës afariste dhe të investimeve, ERA parasheh ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e shërbimeve për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, përmirësimin e ambientit afarist, me fokus në avancimin dhe zbatimin e legjislacionit për falimentim, për kontabilitet, auditim e raportim financiar dhe atij për licenca në treg.

Pastaj, luftimin e ekonomisë joformale, përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të statistikave në vend, zbatimin e prioriteteve të procesit të Berlinit për përmirësimin e ndërlidhshmërisë infrastrukture me vendet e tjera të

rajonit në shërbim të zhvillimit ekonomik e shkëmbimeve tregtare si dhe modernizimin e sektorit të energjisë, me fokus në infrastrukturën e gjenerimit të energjisë, eficiencën e energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme.

Institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e prioriteteve të shtyllës së parë janë: Zyra e kryeministrit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Zhvillimit Ekonomik, e Financave dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

Shtylla e fundit, ajo e punësimit dhe e arsimit, përmban gjashtë prioritete që do të sjellin avancimin e cilësisë dhe zbatimit të politikave për punësim, adresimin e papunësisë së të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, funksionalizimin e Agjencisë së punësimit, si institucion përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimit aktiv, avancimin e legjislacionit për reforma në sektorin e arsimit, përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me fokus, në përmirësimin e kurrikulave dhe trajnimin e mësimdhënësve, si dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit e aftësisë profesionale dhe të kalimit nga shkollimi në tregun e punës.

Përgjegjësia për zbatimin e prioriteteve të shtyllës së tretë bie mbi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Integritet Evropian, zonjën Njomza Emini, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NJOMZA EMINI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Fillimisht më lejoni t'i uroj për postin e ri zonjës Ahmetaj, urime dhe shpresoj në bashkëpunimin bashkë me Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian.

Ju njoftoj se Komisioni për Integritet Evropian më 21 dhjetor 2016 ka shqyrtuar Agjendën për Reforma Evropiane dhe ka rekomanduar për miratim në seancë plenare.

Agjenda për Reforma Evropiane paraqet një rëndësi të veçantë jo vetëm në kuptim të caktimit të prioriteteve dhe planifikimit, por edhe në kuptim të realizimit të këtyre prioriteteve që mundësojnë njëkohësisht edhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Avancimi i rrugëtimit apo agjendës së vendit tonë në integrimin evropian ndërlidhet me zbatimin e MSA-s, ndërsa caktimi i prioriteteve nëpërmjet Agjendës për Reforma Evropiane janë sundimi i ligjit dhe reforma e administratës publike, rritja e konkurrueshmërisë ekonomike, arsimit dhe punësimi sigurojnë një zbatim efektiv të MSA-së.

Duke e pasur parasysh që planifikimi dhe caktimi i prioriteteve gjithmonë paraqet një sfidë për ne, identifikimi i prioriteteve nëpërmjet këtij dokumenti, siç është Agjenda për Reforma Evropiane, në një mënyrë paraqet një tejkalim të suksesshëm të kësaj sfide, duke kaluar në sfidën tjetër, atë të zbatimit efektiv të kësaj agjende. Pra, në përmbushjen e obligimeve të secilit institucion në kuadër të planit të veprimit për zbatimin e prioriteteve kyçe.

Kjo agjendë është e ndarë në tri shtylla. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe klima e investimeve dhe punësimi e arsimit.

Plani i veprimit për vitin 2017 i Agjendës së Reformave Evropiane përmban rreth 130 veprime.

1. Shtylla e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit ka për qëllim: proces më transparent të emërimi dhe të bazuara në merita, përforcim të integritetit dhe mekanizma në shërbimin publik.

Publikimin e raporteve të audituara të financimit të partive politike, përdorim më transparent dhe efikas të financave publike nëpërmjet prokurimit, gjykata më efikase dhe më të forcuara, për zhvillim ekonomik, fuqizim të Zyrës së Prokurorisë Speciale për luftimin të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

2. Shtylla e konkurrueshmërisë dhe klimës së investimeve ka për qëllim: lehtësim të regjistrimit të bizneseve nëpërmjet përmirësimit të regjistrimit online dhe paraqitjes së numrit unik të bizneseve, përmirësim të konkurrueshmërisë dhe ekspertëve, përforcim të sigurisë së produkteve dhe cilësisë më të mirë të mallrave, përmirësim të infrastrukturës dhe mbikëqyrjes së tregut, përmirësim të lidhjes brenda Kosovës dhe në rajon, furnizim i zgjeruar me energji, i mbështetur në furnizimet ekologjikisht miqësore të energjisë elektrike.

3. Shtylla e punësimit dhe e arsimit ka për qëllim: rritjen e mundësive të punësimit për gratë dhe të rinjtë, përmirësim të cilësisë së nevojave të tregut të punës që përputhen me arsimin e lartë, më shumë kopshte të mira për fëmijët, mësues më të kualifikuar për të gjitha nivelet, bashkëpunim më të mirë mes bizneseve dhe shkollave të arsimit profesional, për mundësi më të mira punësimi.

Andaj zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane rrit më shumë përgjegjësinë për institucionet e Republikës së Kosovës, ku duke ushtruar apo zbatuar suksesshëm këtë agjendë jo vetëm që vendi ynë përgatitet për hapa të tjerë në procesin e integritetit, por edhe në ngritjen e standardit për qytetarin e vendit tonë.

Kolegë të nderuar,

Duke pasur parasysh rolin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe Komisionit për Integritet Evropiane në procesin e integritetit evropian, në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integritet Evropiane ju siguroj, bashkë me kolegët e mi nga opozita dhe pozita, që do të luajmë një rol

afirmativ dhe mbështetës për të siguruar përmbushjen e Agjendës për Reforma Evropiane, si dhe do të mbikëqyrim zbatimin e këtij dokumenti.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që ta miratojmë Agjendën për Reforma Evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Xhelili më duket është paraqitur.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje,

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së me kujdes e ka analizuar Agjendën e Reformave Evropiane.

Forcimi i qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, nxitja e arritjes ekonomike dhe punësimit, zhvillimi gradual i një zone të tregtisë së lirë me BE-në, tërheqja e investimeve të huaja dhe të brendshme, përmirësimi i ambientit afarist janë objektiva të Agjendës së Reformave Evropiane.

Ky dokument ka për qëllim përcaktimin e prioritetëve për përmbushjen e obligimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2017.

Përcaktimi i prioritetëve të fushave të caktuara në kuadër të MSA-s dhe zbatimi i aktiviteteve konkrete për përmbushjen e tyre do të jetë objektiv primar.

Agjenda për Reformën Evropiane bazohet në prioritetin kyç të Qeverisë së Republikës tonë: Kosova dhe integrimi në BE.

Agjenda është në përputhje me programin e Qeverisë, programin kombëtar për zbatimin e MSA-s dhe programin e reformave ekonomike.

Dokumenti kryesor nacional i politikave për përmbushjen e obligimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është programi kombëtar për zbatimin e MSA-s dhe në maj të vitit 2016 kryeministri dhe Komisari i Bashkimit Evropian për Politika të Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit janë dakorduar të dalin me një listë të prioritetëve afatshkurtra për përshpejtimin e zbatimit të marrëveshjes.

Si rezultat është hartuar edhe Agjenda e Reformave Evropiane, e cila përmban edhe planin e veprimit, të hartuar së bashku me Komisionin Evropian dhe institucionet relevante të linjës.

ERA përmban tri shtylla, të cilat edhe u përmendën, ka 22 prioritete dhe rreth 130 veprime për zbatimin e këtyre prioriteteve.

Përmban tri pjesë: pjesën hyrëse, listën e prioriteteve dhe planin e veprimeve.

Të gjitha institucionet përgjegjëse janë konsultuar në kuadër të përgatitjes së agjendës dhe organizatat e tjera si edhe organizatat e shoqërisë civile.

Zbatimi i agjendës parashihet të realizohet në kuadër të limiteve buxhetore të institucioneve përgjegjëse, të përcaktuara me qarkore buxhetore nga Ministria e Financave.

Andaj, deputetë të nderuar, ju ftoj që me votën tuaj për Agjendën e Reformave Evropiane të mundësoni që Qeveria dhe institucionet e tjera të bëhen obliguese në zbatimin e këtyre prioriteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Emini.

NJOMZA EMINI: Edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e miratojmë Agjendën e Reformave Evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Nëse e shihni dokumentin, është aprovuar në Qeveri më 9. 11. 2016.

Përmbajtja e dokumentit parasheh tri pika kyçe, do të thotë: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, konkurrueshmërinë dhe klima e investimeve dhe punësimi dhe arsimi.

Janë të shtjelluara në këtë dokument të prezantuar sfidat dhe nevojat për reforma, përshkruhet një takim ndërmjet kryeministrit Mustafa dhe Komisarit Han më 17 maj 2016 dhe rrjedhimisht një pajtim për zhvillimin e Agjendës Evropiane për Reforma.

Ndërkohë, çka ndodh pas këtij takimi, pas këtij dakordimi dhe pas këtij aprovimi për reforma dhe pas nxjerrjes së këtij dokumenti, është si në vijim:

Kryeministri Mustafa vazhdon t’u japë tender djemve për herë të dytë dhe kjo është në kundërshtim me ligjet e vendit, siç e dimë, por është, në fakt, edhe në kundërshtim me praktikën e Bashkimit Evropian. Si mund të flasë një kryeministër për reforma dhe të zotohet për reforma, ndërkohë që vazhdon në mënyrë të jashtëligjshme t’u japë tenderë djemve të vet?

Kryeministri, që është kryetar i LDK-së, tani e katër vjet nuk e ka bërë publik raportin financiar të LDK-së. Kjo është pikërisht një nga pikat kyçe, në të cilën flitet në këtë dokument dhe është një nga kriteret kryesore, të cilat kërkojnë një trajtim në të gjitha raportet e progresit, të cilat përsëriten vit pas viti.

Qeveria ndërkohë e tërhoqi Ligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Vazhdoi loja e arbitrazheve dhe miliona euro humbën nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe në fund të vitit 2016, pra Kosova përsëri te ‘Transparency International’ u shpall në mesin e vendeve më të korruptuara në rajon dhe në Evropë. Pra, cilat ishin rezultatet e këtij zotimi dhe cilat ishin rezultatet e kësaj agjente, u pa përgjatë vitit 2016.

Po ashtu, përgjatë vitit 2016, te pika Sundimi i ligjit, janë emëruar gjyqtarë, prokurorë dhe janë ngritur në detyrë kryesisht njerëz me dosje, të përkushtuar në përndjekjen e opozitës. Kanë vdekur në burg të rinjtë e pafajshëm, aktivist politikë, Astrit Dehari, është cenua siguria dhe sovraniteti në veri dhe perëndim, ka vazhduar politizimi i bordeve dhe i ndërmarrjeve. Së fundi, një eksponent politik të cilit iu hodh aktakuza pak ditë para emërimit, erdhi në krye të Shërbimit Inteligjent të Kosovës. A është kjo reformë? Po i pyes deputetët, a është kjo reformë dhe a mund të flasim këtu për zbatim të një agjende të dakorduar në maj të vitit 2016? A përbëjnë këto veprime përkushtim për reforma?

Te klima e investimeve. Përveç korrupsionit dhe asaj që cilësohet si risku në vend për shkak të veriut të vendit, një problem ky që është edhe energjia.

Ky është problem i lidhur drejtpërdrejt me vetë qeverinë.

Së pari, duke e minuar vetë linjën e interkoneksionit Shqipëri-Kosovë me marrëveshjen e 25 gushtit 2016 për energjinë, ku si pasojë Serbia ende sot e mban të bllokuar sistemin e transmisionit. Së dyti, duke mos projektuar dhe filluar nga zbatimi i rindërtimit të Termocentralit “Kosova A” dhe projektimi i buxhetimit nga fondet publike të kapaciteteve të reja, pra “Kosova e Re”, në vend të kësaj Qeveria po vazhdon të mbahet peng nga një projekt jo i besueshëm dhe me probleme shumë serioze, siç është kompania private, “Contur Global”.

Po ashtu, politizimi i skajshëm dhe konflikti i interesit të Zyrës së Rregullatorit me ekzekutimin dhe me kompanitë private të shpërndarjes, në këtë rast me KEDS-in, e kanë rritur dy herë çmimin e energjisë elektrike brenda vitit, duke rënduar jo vetëm amvisëritë, por mbi të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Heqja e TVSH-së për energjinë në vitin 2015 nuk e ka kompensuar rritjen e madhe të çmimit të energjisë së bërë arbitrarisht gjatë vitit 2014-2015.

Pra, ne nuk mund të presim që të kemi investime, ose nuk mund të flasim për klimë më të mirë ose përmirësim të ambientit biznesor, përderisa nuk sigurojmë energji elektrike. Ju e dini që plot kompani, edhe vendore, në fakt po ikin dhe ndërmarrjet e tyre po i bartin në vendet e rajonit, edhe në Maqedoni, në mënyrë që t'i evitojnë problemet tepër të mëdha të shkaktuara nga mungesa e energjisë elektrike.

Tek punësimi dhe arsimit, ndërhyrja brutale në punësime pa kriter në gjithë rrjetin e shkollave të mesme, me theks të atyre profesionale, si dhe në Universitetin e Prishtinës, as nuk po ndalen, e as nuk po adresohen, për aq kohë sa edhe njëra edhe tjetra përjetohen nga partitë në pushtet si çështje elektorale. Ju e dini se mësuesit dhe në përgjithësi sektori i arsimit, në të gjitha periudhat kohore është shfrytëzuar kryesisht si trupë elektorale nga këta njerëz.

Arsimi dhe universiteti e kërkimi shkencor nuk e kanë as buxhetin e nevojshëm, as zbatimin e rregullave strikte sa i përket funksionimit. Te përmirësimi i shërbimeve të punësimit nëpërmjet krijimit të Agjencisë për Punësim dhe masave aktive të tregut të punës, tash imagjinojeni - kjo masë është aq e vonuar, këta njerëz janë në vitin e tretë të qeverisjes, ndërkohë që kanë premtuar 200 mijë vende pune, e ndërkohë që në vitin e tretë të qeverisjes flasin për themelimin e një agjencie për punësim.

Te çështja e rishikimit të legjislacionit duhet theksuar se Kosova nuk vuan nga mangësia e ligjeve. Ne në vazhdimësi, edhe në këtë Kuvend kemi plotësim-ndryshim të projektligjeve, të cilat nuk zbatohen asnjëherë. Vijnë në emër të reformave, bëhet plotësim-ndryshimi i tyre, mirëpo asnjëherë nuk janë zbatuar dhe nuk zbatohen në vazhdimësi. Do të thotë, zbatimi i ligjit lidhet me problemin kyç të funksionimit dhe të sundimit të ligjit, e jo nga mungesa e ligjeve.

Ndërsa përgjegjësit për këtë gjendje nuk e kanë as përkushtimin, as vullnetin politik, e as resurset e duhura për ta drejtuar vendin në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Me këtë strukturë qeverisëse dhe me këto politika qeverisëse ne nuk mund të presim që agjendat, edhe nëse janë shkruar nga të huajt, sikur kjo, në fakt do të sjellin ndonjë ndryshim substancial, sepse veprimet dhe ajo çfarë shkruhet në këto agjenda janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Përderisa e kemi këtë strukturë, këta njerëz dhe këtë mendësi politike, Kosova do të vazhdojë të mbetet e mbyllur, e izoluar, e papërpërpëruar dhe larg Bashkimit Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën për replikë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Meqenëse u përmend LDK-ja, unë jam sekretar i përgjithshëm i LDK-së dhe dua t'i them zonjës Kadaj, mund të hyjë në ueb-faqe dhe t'i shohë raportet financiare e para, e dyta raportet rregullisht janë të dorëzuara në KQZ, prandaj kjo është e pavërtetë çfarë thoni, por asnjëherë nuk

mund ta nisni ndonjë fjalim, pavarësisht pikave, pa tentuar që të shpifni dhe të njollosni. Nuk është në rregull kësisoj, dhe unë kisha obligim në emër të LDK-së të them se kjo nuk qëndron.

Ndërkaq sa i përket çështjes së zotit Mustafa, kryeministrit, të gjithë e dimë që ai nuk jep tender dhe nëse ka dhe në këtë rast unë nuk jam ai që e mbroj zotin Mustafa, sepse e mbron puna e tij, por nëse ka lëshime, ka abuzime në këto punë, janë organet kompetente që duhet të merren, e jo ne në kuptimin vetëm të tentimit të njollosjes së njerëzve, ose bartësve të institucioneve. Dhe, ne çdo shpenzim që e kemi, edhe një herë po kthehem te shpenzimet, janë të raportuara në Komisionin Qendror Zgjedhor, atje ku e kemi obligim si subjekte politike dhe janë në ueb-faqen e LDK-së.

Prandaj, nuk është mirë për çdo gjë të tentoni vetëm të njollosni dhe të etiketoni. Ndoshta kjo nuk e di se si i kanë shpenzuar më herët paratë të gjitha në “Vetëvendosje”, për çdo gjë që kanë shpenzuar, sepse ka shkuar më vonë, edhe për mjetet që janë përdorur në protesta e të gjitha këto duhet që t’i raportojnë dhe mund të mos e dinë. Por, nuk janë marrë dhe as nuk duan të merren me atë punë, sepse janë organet që duhet të merren me këto çështje, por ju lus mos shpifni sa herë e keni këtë mundësi, sepse mos mendoni që kjo ju sjell benefite politike vetëm duke atakuar të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zonja Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Realisht unë konstatova fakte, dhashë argumente. Krejt çka i thashë janë të shënuara edhe në raportet ndërkombëtare dhe vijnë si kritika ndaj institucioneve. Te Zyra e Kryeministrit, e di që personalisht ai nuk e jep tenderin, po e japim drejtorët e buxhetit, të cilët janë në burg dhe të cilët u kanë dhënë dy herë tenderë djemve të Isa Mustafës.

Nëse s’është e vërtetë, dokumentoje nëpërmjet të dhënave zyrtare. Zyrtarisht, ata dy herë kanë marrë tenderë, në fakt herën e dytë për punën e njëjtë kanë marrë pesë herë më shumë para se herën e parë, dhe kjo në njëfarë forme është konfirmuar dhe është pranuar edhe prej vetë kryeministrit tënd, i cili ka thënë “unë kam para boll, s’lodhem për 3-4 mijë euro”. Po herën e dytë ua ka dhënë një tender tjetër rreth 13 mijë euro. Këto janë fakte Ismet, janë argumente, janë zyrtare, publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zonja Time Kadrijaj e ka fjalën. Ke të drejtë të diskutosh Ismet, 10 minuta i ke, kur të duash! Vazhdoni, zonja deputete!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Agjendën për Reforma Evropiane dhe në fakt ne kemi dëshmuar se gjithëherë kur ka qenë çka ka pasur lidhje për integrim dhe anëtarësim në organizatat të ndryshme ndërkombëtare, e kemi vlerësuar dhe e kemi përkrahur në

vazhdimësi, edhe pse në ndërkohë Qeveria për çdo dështim që e ka pasur në këtë vit dhe gjatë kësaj qeverisjeje, çdo dështim në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, por edhe për liberalizim të vizave dhe për çështje të tjera e ka pasur një adresë dhe kjo adresë ka qenë opozita. Dhe, ky është një opinion i gabuar, sepse mospuna e Qeverisë nuk duhet t'i adresohet opozitës, por vetë Qeverisë.

Kemi të bëjmë me tri shtylla: qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe lehtësimi në investime të huaja, e kemi edhe punësimin dhe arsimin që janë tri shtyllat në të cilat vërtet po kemi ngecje dhe ka ankesa në çdo raport të progresit që po vjen në Kosovë. Ne kemi marrë pjesë, edhe kur është prezantuar plani Agjenda për Reforma Evropiane kemi kontribuar edhe në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropiane dhe mendoj që edhe kësaj here do ta përkrahim, në mënyrë që Qeveria vërtet të mos jetë e mirë vetëm në shkrimin e këtyre agjendave dhe përcaktimin e prioriteteve, të cilat janë caktuar deri në fund të vitit 2017, por vërtet t'i zbatojë ashtu siç po parashihet me këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të partisë “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mendoj se ne Grupi Parlamentar, edhe “Nisma”, e kanë analizuar mirë Agjendën për Reformën Evropiane dhe shtyllat mbi të cilat mbështetet kjo reformë, si dhe prioritetet që i ka përcaktuar Qeveria, që janë 22 prioritete dhe përafërsisht mbi 100 veprime që duhet të ndërmerren për t'i realizuar këto synime tona të përbashkëta mendoj të të gjithëve, ne i kemi analizuar dhe i mbështetim. Por, ajo çka desha të theksoj tani është se ndajmë dyshimin se kush do ta zbatojë këtë reformë?

A ka kapacitete dhe a ka fuqi një qeveri e tillë, e cila tash tre vjet nuk ka dhënë asnjë element që mund të realizojë veprime të tilla? Po ndalem vetëm pak te shtylla e parë, siç është sundimi i ligjit.

Mendoj se kjo është ajo që ne na bën ta përkrahim, sepse deri më tani ne kemi e parë një sundim të ligjit selektiv dhe për pasojë këtë fushë më së tepërmi po e vuan “Nisma” si parti. Prandaj, ne e mbështetëm dhe kërkojmë që të zbatohet, por dyshojmë shumë sidomos në këto shtylla, të cilat i ka përcaktuar dhe i parashih kjo reformë, kjo Qeveri me këto kapacitete dhe cila është e pushtuar do të thosha në këtë formë kështu nga grupet joformale dhe nga palët që udhëhiqet tani për tani si Qeveri, nuk mund dhe nuk do të ketë fuqi ta shtyjë përpara, por presim që faktori ndërkombëtar të ndërhyjë, ta bëjë dhe ta jetësojë këtë ta bëjë realitet për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zonja Duda Balje. Më fal për renditjen nëse të kalova gabimisht.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” je razmotrila agendu o Evropskoj reformi. S obzirom na to da ona ima za cilj definisanje prioriteta za naše institucije do kraja 2017. godine i vrlo važna tri stuba sa 22. prioriteta, smatramo da je vrlo važna i država mu je na čelu, dalji doprinos daćemo kroz radu Komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministrja Hykmete Bajrami.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sa i përket përmirësimit të mjedisit afarist, tanimë ndryshimet po njihen nga institucione shumë kredibile, po njihen nga Banka Botërore, nga organizatat si Heritage, e cila në publikimin e sotëm për lirinë ekonomike e rendit Kosovën në nivel botëror në pozitën e 46-të, në Evropë në pozitën e 22-të dhe në Ballkan në pozitën e 2-të.

Gjithashtu, ju e dini që në emër të Qeverisë unë para dy ditëve e kam marrë një çmim në “Forum Botëror të Investitorëve Engjëj” në Stamboll, si Qeveria më e mirë në mbështetje të ndërmarrësisë, edhe këtë falë asaj që kemi kaluar sipas raportit të Bankës Botërore nga pozita e 47-të në pozitën e 13-të për regjistrim të ‘start up’-ve dhe bizneseve. E kemi sistemin me burokracinë më të vogël për pagesën e taksave dhe e kemi sistemin me taksat më të ulëta në Evropë, duke e matur këtu tatimin në fitim 10% dhe tatimin në dividendë 0%.

Është shumë keq, në fakt, që këto të arritura nuk njihen nga të gjithë, por është tepër me rëndësi që këto të arritura njihen nga Asociacionet e Biznesit dhe të gjitha bizneset në Kosovë. Nominimin në “Forum Botëror të Investitorëve Engjëj” nuk e kishim bërë ne si Qeveri, e kishte bërë rrjeti kosovar i bizneseve “Engjëj”, që do të thotë nominimi për Qeverinë më të mirë për këtë çmim ka ardhur nga sektori privat, dhe kjo është tepër e rëndësishme. Unë nuk e kam ditur që kam marrë çmim, kam shkuar aty për ta udhëhequr njërin nga panelet, i cili ka pasur të bëjë me politikat inovative për financimin e ‘start up’-ve.

Në ditën e shtunë të javës së kaluar, kryeministri me katër ministra që udhëheqin dikastere ekonomike për rrafsh katër orë ka biseduar me komunitetin e biznesit, besoni që në situatën në të cilën po bisedonim dhe duke marrë parasysh ato që po fliten, shumë të pavërteta, është guxim i madh të bashkëbisedosh me biznese për rreth katër orë.

Kemi bashkëbiseduar për shkak se asnjë nga këto nuk janë të vërteta, sepse përndryshe ne nuk do të mund të qëndronim katër orë me 400 biznese në sallë për t’i pasur të gjitha këto diskutime.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë dua t'i listoj ndryshimet që i kemi bërë në përmirësimin e mjedisit afarist dhe që ju duhet t'i dini dhe duhet t'i pranoni, sepse kanë ndodhur, e nëse nuk kanë ndodhur duhet t'i dokumentoni se nuk kanë ndodhur. Ne e kemi racionalizuar buxhetin duke krijuar kështu hapësirë më të madhe për investimet kapitale. Falë disiplinës financiare që e ka vënë Ministria e Financave, ne e kemi harmonizuar në masë të madhe legjislacionin, kemi bërë eliminim të shumë taksave për shërbimet që ofrojmë në nivelin qendror dhe në nivele lokale.

Gjithashtu, ju thashë edhe më herët në konkurrencë me 190 shtete tjera kemi kaluar nga pozita e 47-të në pozitën e 13-të për regjistrim të bizneseve, kemi bërë unifikimin e numrit të bizneseve me doganat, shumë shpejt do ta bëjmë unifikimin e numrit me ATK-në dhe bizneset do ta kenë vetëm një numër që ndikon edhe në luftën e informalitetit dhe të evazionit fiskal. Është çështje ditësh kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të fillojë lansimin e projektit për regjistrimin e bizneseve, regjistrimin online. Kemi investuar në zonat ekonomike që dy vjet dhe kemi në plan që të investojmë edhe në këtë vit. I kemi përfunduar investimet në Shtime, e kemi përfunduar parkun e Drenasit, kemi filluar të investojmë në Suharekë, kemi investuar në Mitrovicë dhe jemi duke bashkëpunuar edhe me komunat tjera, ndërkohë që jemi në një masë shumë të avancuar të dialogut me BERZH-in që të bëjmë zgjerimin e Parkut të Drenasit në Drenas.

Të nderuar deputetë,

Vendosja në zonë ekonomike për një biznes nënkupton që Qeveria mbulon diku rreth 30% të kostos për hapjen e një biznesi, apo zgjerimin e kapaciteteve të tij. Jemi duke u ndihmuar ndërmarrjeve në certifikim të produkteve për standardet e cilësisë. I kemi ndihmuar ato që të marrin pjesë në dhjetëra panairë ndërkombëtare dhe si rezultat i pjesëmarrjes në këto panairë janë nënshkruar mbi 40 kontrata dhe mbi 80 prej tyre janë duke u negociuar.

Ju e dini që vitin e kaluar në afate rekorde pas nënshkrimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit dhe hyrjes së saj në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur ta nënshkruajë marrëveshjen në kornizë për qasjen e programit të BE-së dhe ne gjatë këtij viti do të anëtarësohemi në gjashtë programe shumë të rëndësishme. E kemi funksional Fondin për Garanci Kreditorë, janë 108 kredi, të cilat janë lëshuar nën ombrellën e këtij fondi, kredi që përndryshe, në mungesë të fondit, nuk do të jepeshin nga banka. Siç e dini, ne mbulojmë aty 50% të rrezikut. Pakoja fiskale 1 - i keni parë rezultatet, prej 7 masave kemi kaluar në 19 masa në pakon fiskale 2, dhe bizneset për herë të parë, ato prodhuese, janë në pozitë më të avancuar se bizneset tregtare. Po e implementojmë me sukses Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Të nderuar deputetë,

Në vitin 2014 i kemi pasur 151 milionë investime të huaja, në vitin 2015 kemi arritur që t'i ngremë ato në 340 milionë. Në vitin 2014 rritja ekonomike ka qenë 1%, kurse në vitin 2015 rritja

ekonomike ka qenë 4,1%. Deri në tetor të vitit 2016 kemi arritur që të kemi 208 milionë dhe rritja ekonomike pritet që të jetë 4% për vitin 2016. Papunësia sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka rënë prej 36% deri në 24%.

Ju lutem shumë, sot e keni Agjendën Evropiane të Reformave, prandaj është mirë që t'i shihni masat dhe pas një ose tre muajve të na thirrni këtu dhe të na thoni "ju jeni zotuar që do t'i bëni këto reforma, pse nuk i keni bërë?". Ky do të ishte debati i vërtetë që duhet të ndodhte dhe sa i përket Transparency International, zonja Kadaj-Bujupi, kur njerëzit, qytetarët dhe të tjerët u dëgjojnë që i flisni këto në Kuvendin e Republikës së Kosovës, atëherë normalisht që edhe percepticioni krijohet i gabuar.

Ju keni shumë më shumë hapësirë dhe e merrni fjalën këtu tërë ditën, nuk ka kurrfarë kufizimesh, kurse unë mezi e mora fjalën nga zoti Haliti për të dalë dhe për të ju treguar juve këtu se çfarë po bëhet. Mirëpo, jam e sigurt që në afat të gjatë qytetarët e Republikës së Kosovës do ta dinë se kush e ka më drejt dhe më lejoni të ju them edhe një herë që situata politike e krijuar pikërisht në Kuvendin e Kosovës ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e investimeve të huaja. Ne si shembull kemi Maqedoninë, me të gjithë insentivat financiare e fiskale që i kanë, ata kanë shumë më pak investime të huaja se sa në Kosovë, pikërisht për shkak të ngërçit politik.

Të bëhemi racionalë dhe ta merrni Qeverinë në interpelanca dhe në pyetje për gjërat, të cilat ne nuk po i bëjmë dhe kemi premtuar që do t'i bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Shqipe Pantina. Jo replikë s'ke ti, jo! A ta ka përmendur emrin? Në rregull, s'e kam dëgjuar, nëse ta ka përmendur emrin ke të drejtë. Zonja Donika Kadaj-Bujupi, replikë!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, pikërisht unë për këtë pyeta: keni premtuar 200 mijë vende pune, ndërkohë që punë ju u keni dhënë veç djemve të kryeministrit nëpërmjet tenderëve. Kallëzona çka po ndodh? Kjo ishte pyetja. 200 mijë vende pune, punë u keni dhënë veç djemve të kryeministrit. Po flet për reforma, sot keni urdhëruar që në UP të hyjë policia, t'i rrahë studentët, t'i zvarrisë ata të cilët po kërkojnë reforma të UP-së, reforma të cilat janë ose të domosdoshme, reforma të cilat nënkuptojnë një ndryshim të përgjithshëm në këtë vend, të cilin ju komplet e keni zaptuar dhe kur ke qenë deputete e ke pasur goxha një zë kundër këtyre veprimeve. Tash që je kthyer në ministre, je kthyer në fakt në anën e kundërt. S'po di çka po ndodh?!

Njëherë pate thënë se jam sakrifikuar, por me të vërtetë po më vjen keq. Tregona, 200 mijë vende pune, punë djemve të kryeministrit! Ku po mbeten ato vende tjera të punës? Sa vende pune i keni hapur? Je ministre, e përfaqëson një dikaster të rëndësishëm. Thuana në cilat komuna, në cilët sektorë, kush është punësuar? Pak më eksplicit, a jeni takuar a s'jeni takuar me

biznesmenë, kjo nuk është e arritur. Të dëgjova me vëmendje. Po thua është arritje shumë e madhe të kesh guxim t'i takosh njerëzit e biznesit tënd. Por kur ta këqyrësh edhe është e arritur, se çka i bëni ju atij biznesi duhet të frikoheni të takoheni me ta pastaj, se ua përplasni fytyrës një ditë të gjitha veprimet tuaja.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Zonja Kadaj, po më duket që debat në kontest ekonomik nuk mund të bëjmë, se kalove te studentët dhe sinqerisht nuk po e di se çka po ndodh me studentët, por nuk e di se kush jep urdhra, domethënë jam në punë, në takime prej mëngjesit. Nuk kam ndryshuar në fakt asnjë fije. Ndoshta jeni ju ajo që keni ndryshuar duke i ndryshuar edhe partitë, por ato kritikën që i kam bërë kur kam qenë deputete tash po i vë komplet në punë.

Unë tregova për investimet e huaja, për rritjen ekonomike, rritja prej 1,1% në 4,1% edhe investimet prej 151 milionë në 320 milionë, dhe zbutja e papunësisë prej 34% në 26%, besoj që këto mjaftojnë, por ndoshta edhe e keni pak problem që t'i deshifroni.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti ka kërkuar replikë, e keni fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Me të vërtetë ishte kënaqësi ta dëgjosh ministren duke e paraqitur një sukses të Qeverisë, por e vërteta është krejtësisht ndryshe. Unë edhe një herë dua ta them që edhe për këtë reformë, Agjenda e Reformës Evropiane, jam i bindur që komisionari Han e ka shtyrë me vështirësi Qeverinë që të vijë deri te ky përcaktim i këtyre prioritetëve dhe dua të besoj që ai do ta shtyjë akoma më tutje fuqishëm, sepse nuk është vullnet i kësaj Qeverie, ndërsa gjendja e investimeve të huaja është si kurrë njëherë më keq.

Unë dua ta pyes ministren sikur i ka harruar ato skenat e fundvitit 2014-2015, ikjen masive të qytetarëve të Kosovës. Ikja e të rinjve i konvenon vetëm kësaj Qeverie. Nuk ka familje dhe nuk ka individ i cili dëshiron të qëndrojë me sukseset e kësaj qeverie në Kosovë. Të gjithë janë të gatshëm ta lënë vendin dhe të ikin për shkak të atyre kushteve "të mira" që i ka ofruar kjo Qeveri. Prandaj, po them se është marre të dalë këtu dhe të tentojë për t'i mashtruar qytetarët e Kosovës se Qeveria ka bërë punë të mira tash tre vjet. Këtë e dinë më së miri ata, të cilët janë të gatshëm për çdo moment të ikin pikërisht nga keqqeverisja e kësaj Qeverie të drejtuar nga zoti Mustafa. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Ju thashë edhe një herë se këto retorika më besoni që është problem që të ju shiten te qytetarët, "kjo qeverisje, ajo qeverisje; ky tender, ai tender".

Bëhuni konkret, o zotëri! Unë tregova me shifra, me numra, me fakte, me raporte, me institucione kredibile duheni të jeni konkret nga këto që i thashë, zonat ekonomike, politikat fiskale, faza e parë, faza e dytë, unifikimi i numrit, eliminimi i burokracisë, çmimet, Banka Botërore në raportin e saj, që po e parashihet progresin. Cila nuk është e vërtetë për ty? Cila nuk është e vërtetë?

Më thuaj cila nuk është e vërtetë dhe tani debatojmë. Dil, merre dokumentin, thuaj “ministrja po gënjen, kjo nuk është kështu, por është ashtu”. Hynë në ueb është publikimi i Heritage dhe do ta shohësh që sipas lirisë ekonomike Kosova renditet e 2-ta në Ballkan, e 22-ta në Evropë dhe e 46-ta në botë. Prej krejt shteteve të botës. Hynë në raportin e Bankës Botërore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë desha të ndalem në dokumentin që e kemi përpara, e për të cilin fillimisht unë dua ta pyes ministren, e cila është e re dhe nuk e di a ka pasur kohë që ta lexojë.

E para, të na shpjegojë, a është një agjendë për të cilën ministrja kërkon besimin, përkatësisht aprovimin e deputetëve, në mënyrë që të fillojë të zbatohet tani e tutje, apo është një raport i aktiviteteve që tashmë kanë përfunduar dhe ajo po na njofton për to, sepse 1/3 e veprimeve të parapara në këtë plan afat kohor të zbatimit të tyre e kanë pasur tremujorin e fundit, po besoj se është K4 të vitit 2016. Tash ministre, çfarë po ndodh, çfarë dokumenti keni përpara? Çfarë po kërkon nga ne?

A po kërkon ta miratojmë si raport dhe ju po raportoni këtu se këto veprime tashmë kanë përfunduar, pasi e paskan pasur afatin shumica e tyre në vitin 2016, apo po e prezanton një plan i cili do të zbatohet dhe atëherë na trego se cili është afati kohor për zbatimin e tyre, sepse të paktën unë jam shumë konfuze se çka po prezantoni.

Merreni planin e veprimit e shihni dhe ja po ua jap një shembull të vetëm. Pika 1.6 thotë “sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo politik, në harmoni me Ligjin për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe kompanitë publike”. Zbatimi i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit si afat kohor të zbatimit ka pasur edhe në vitin 2016. Këtu flitet për mënyrën e emërimeve që duhet të bëhen dhe për një memorandum mirëkuptimi, që është nënshkruar me Qeverinë dhe Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar për emërimin e bordeve të institucioneve dhe agjencive të pavarura.

Aty po ashtu përmendet se njëra nga mënyrat si do bëhet ajo, është edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe shoqërisë civile në procesin e përzgjedhjes, ku thuhet se CV-të e atyre që do të hyjnë në listën e ngushtë do të bëhen publike, e kështu me radhë. Deri më tani këto asnjë nuk kanë ndodhur. Ne sot në rend të ditës e kemi votimin e anëtarëve të bordeve për dy institucione dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre ka qenë nga një bord politik, një komision ad hoc i përzgjedhur nga Kuvendi.

Dhe, çështja e dytë është që kur flasim për qeverisjen e mirë, jo vetëm për Qeverinë, por për qeverisjen në përgjithësi, a futet këtu edhe një punë e mirë transparente dhe llogaridhënese e Kuvendit të Kosovës. Sot është dita e tretë e një seance të muajit shkurt, Kuvendi mbledhet një herë në muaj në seanca maratoni dhe kjo po bëhet për dy arsye. E para, për t'u ikur deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, për të cilën koalicioni po mendon se e ka gjetur një zgjidhje kreative, se deri më tani ministrat nuk vinin për të raportuar, tani po tentojnë që ta heqin fare si mundësi për deputetët.

Dhe, e dyta, po ashtu kur flitet për procedurat e miratimit të ligjeve, ne vetëm dje pas orës 20:00 në mbrëmje, kur deputetët tashmë kishin kaluar 10 orë në seancë dhe qytetarët e kishin humbur interesimin për t'i përcjellë seancat, janë shqyrtuar gjoja "shqyrtuar" pesë projektligje të rëndësishme, të cilat sot veç u votuan. Në shumicën e rasteve, komisionet shkojnë në Shqipëri për t'i amandamentuar dhe për t'i ndryshuar. Pothuajse për asnjë për këto ligje nuk është organizuar asnjë debat publik, ku qytetarët e grupet tjera të interesit, përfshirë këtu edhe bizneset për projektligjet që e prekin fushën e tyre, do të mund t'i jepnin rekomandimet, vërejtjet dhe komentet e tyre. Kjo po u merret plotësisht si mundësi të gjithë të tjerëve të interesuar dhe në shumicën e herëve ligjet me rëndësi, siç ndodhi edhe sot, tejkalohen me procedura të përshpejtuara dhe pastaj natyrisht se ka ngecje të mëdha në zbatimin e tyre.

Prandaj, na thoni për çfarë qeverisje të mirë po flitet këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Sot në Qeverinë e Republikës së Kosovës e kemi një ministre të re, zonjën Ahmeti, ish ambasadore. Sot është dita e parë e punës së ministres, fillimisht si një femër, meqë nuk kemi pasur numër dhe nuk kemi numër aq sa duhet të jenë femra të përfaqësuara në Qeveri, urime! Por, ministre, më vjen keq sot dita e parë e punës suaj dhe menjëherë e keni marrë një strategji domethënëse që quhet "era". Në fakt, ju keni marrë një barrë shumë të rëndë duke deklaruar dje nëpërmjet mediave se demarkacioni duhet të kalojë sa më parë.

Barra e rëndë është se kundër demarkacionit nuk jemi as ne, nuk janë as 205 mijë qytetarë, por janë kundër demarkacionit aktualisht në mënyrën dhe formën se si është sjellë nga Qeveria, pra i

nënshkruar nga zoti Thaçi dhe kryetari i Komisionit, Murat Meha, dhe tani edhe nga kryetari i Qeverisë, zoti Mustafa. Prandaj, mos e merrni barrën për t'u thirrur, sepse është një përgjegjësi shumë e madhe. Nuk është kriter bazë demarkacioni, kriter bazë është korrupsioni që e ka ngulfatur shtetin e Kosovës, është krimi i organizuar. Këto luftojini, në këto thirruri, këtu punoni, sepse nuk e kemi të drejtën, ju jeni ministre e emëruar, nuk jeni e zgjedhur nga populli, prandaj në pozitën tuaj është mirë që të punoni në drejtimin e luftimit të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, sepse investitorët ikin pikërisht nga këtu, dhe investitorët nuk ikin kur ngrihet zëri arsyeshëm për të kundërshtuar, për të mos falur territore, për ta mbrojtur sovranitetin e vendit.

Investitorët ikin vetëm për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar, i cili po lulëzon fatkeqësisht çdo ditë. Prandaj, edhe një herë, është mirë të punohet fuqishëm, të integrohemi edhe në Bashkimin Evropian, por jo në mënyrën dhe deklaratat sikur kanë ndodhur me flluskat e sapunit të ministres Tahiri, të cilat tanimë janë shndërruar në akullnajë.

Prandaj, edhe një herë ministre, uroj që vërtet ta kryeni detyrën e ministres në interes të vendit, e jo të thirrreni në deklarata sa për të thënë, e aq më tepër në deklarata, të cilat janë një përgjegjësi, sepse janë 205 mijë qytetarë që u është ofruar të nënshkruajnë kundër demarkacionit në mënyrën se si ka ardhur dhe shumë e shumë të tjerë, të cilët do ta nënshkruanin, po t'u ofrohej. Prandaj nuk është që sot jemi ministre dhe vërtet e merr një përgjegjësi për të folur ashtu siç thotë fjala e popullit "kah të fryn era".

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dëshiroj të theksoj se me të vërtetë nganjëherë debati po huq, po devalvohet dhe po shndërrohet thjesht në një retorikë politike, propagandistike.

Është mirë që më shumë të fokusohemi në përmbajtje. Esenciale për ekonominë e Kosovës dhe për agjendën e reformave është që ne ta përmirësojmë nivelin e aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës. Reformat që i ka bërë Qeveria kanë qenë të mira për investime dhe pikërisht është ajo që na duhet të bëjmë, duhet t'i rritim investimet për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të nxitur punësimin. Megjithatë, ne ende duhet të punojmë që t'i forcojmë këto rezultate, në mënyrë që ta rritim eksportin dhe ta ulim deficitin tregtar.

Këto janë çështje shumë të rëndësishme. Rezultate ka, ato rezultate janë fillestare dhe ne duhet t'i mbështetim, duhet t'i pranojmë dhe t'i mbështetim, e jo të mundohemi gjithçka të mohojmë. Kjo është një çështje shumë aktuale për arsye se ne tash jemi në një fazë kur duhet ta mbështetim riindustrializimin dhe disa masa që janë marrë në favor të sektorit prodhues dhe pakoja fiskale 2, besoj që janë një hap në drejtimin e duhur. Ajo që neve na duhet është që të insistojmë më shumë

në zbatim të ligjeve, në zbatim të masave dhe në një transparencë më të madhe, si dhe në fuqizimin e rezultateve në luftë kundër korrupsionit, në mënyrë që të kemi më shumë investime. Kemi domethënë nxitje të investimeve dhe kjo do të fuqizohet pa mëdyshje me masat që janë ndërmarrë deri tani dhe në vitet që vijnë.

Sa u përket ligjeve, unë pajtohem se duhet të bëhet një debat, duhet të ketë më shumë dëgjime publike, por unë nuk e di unë, mund të ju them sesa i përket komisionit të ne, Komisionit për Zhvillim Ekonomik, 90% e ligjeve dhe e ndryshimeve të ligjeve shkojnë në dëgjim publik. Unë e dëgjova këtu që nuk bëhen dëgjime publike, por duhet të jemi realë, nuk duhet të mohojmë gjithçka. Ne kemi shumë dobësi, kemi shumë probleme, duhet t'i atakojmë ato dobësi në mënyrë konkrete dhe t'i përmirësojmë gjërat, por jo në një diskutim, i cili zhvlerëson gjithçka dhe humb poentën ku duhet të jetë.

Prandaj, na mbetet shumë punë rreth reformës, por puna e parë është që të shkojmë drejt integriteteve evropiane dhe fuqizimit të ekonomisë, sjelljes më shumë të investimeve, është që ta evitojmë luftën primitive politike për pushtet dhe të frikësohemi mos kjo Qeveri po ka ndonjë sukses, sepse në qoftë se Qeveria s'ka ndonjë sukses e marrin dështim personal, apo dështim partiak. Mendoj kjo nuk është produktive, Qeveria edhe situata ka boll telashe ku mund të kritikojmë, sepse e dimë se në çfarë niveli të zhvillimit jemi, dhe problemet e rindërtimit që i kemi, mirëpo një luftë primitive politike partiake për pushtet mendoj se e dëmton imazhin e Kosovës dhe i dëmton proceset e zhvillimit ekonomik dhe të integriteteve evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Sot po flasim për Agjendën për Reforma Evropiane. E dëgjova mirë çfarë tha zonja Hykmete Bajrami dhe e kam përpara edhe materialin për të cilin po e diskutojnë. Në fakt, këto probleme për të cilat u diskutua, që i tha edhe zonja Kadaj, janë reale dhe janë pjesë e këtij plani për zbatim.

Unë po e lexoj vetëm pikën 1.1, që tregon se cilat janë temat kryesore. Pra, te pika 1.1, e cila është dashur të përfundojë qysh në vitin 2016, thotë “rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bën të detyrueshëm pezullimin ose largimin e zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion”. Pra, sikur të mos kishim korrupsion, sikur të mos kishim keqpërdorim të pushtetit, atëherë kjo nuk do të ishte pika numër 1 në Agjendën e Reformave Evropiane.

Pastaj, vazhdon ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlidhura duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët

publikë mund të kenë punësim apo emërim shtesë. Pra, domethënë kemi konflikt interesi, përndryshe kjo nuk do të ishte prioritet dhe nuk do të ishte pika numër 2 në planin që është bërë.

Pika numër 3 është: “sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies të financimit të partive politike”. Zoti Beqiri tha që janë publikuar të dhënat e partisë së tij, në të cilën është sekretar, po më vjen mirë që e paskan rregulluar çështjen e ueb-faqes, sepse një parti e cila është në krye të pushtetit, që pretendon të arrijë zhvillimin ekonomik, të krijojë vende të reja të punës, e kështu me radhë, e nuk është në gjendje ta rregullojë një ueb-faqe. Natyrisht, që në KQZ i kanë dorëzuar raportet financiare, por nuk janë audituar për arsye se dy partitë më të mëdha e kanë penguar auditimin duke mos i krijuar kushtet e nevojshme, por në njëfarë mënyre e kanë bllokuar auditivin, kështu që pika numër 3 në Agjendën Evropiane është pikërisht ajo e cila ka të bëjë me partitë politike. E kështu me radhë.

Pra, këto janë probleme, domethënë çështjet të cilat janë shtruar në agjendë tregojnë që ka probleme pikërisht në ato që ne po i themi si grup parlamentar. Në qoftë se kjo është politikë primitive do të duhej të na tregoni se cila është politika moderne.

Për çfarë reformash evropiane po flasim ne kur para pak minutash, me rastin e 47-vjetorit të themelimit të Universitetit burgosen studentë, përdoret dhuna kundër tyre për shkak që ata dëshirojnë pikërisht të ketë reforma të vërteta në arsim. Këta studentë, të cilët janë arrestuar janë: Flamur Pireva, Egzon Azemi, Bardh Ahmeti, Trim Gashi, Miran Rudhani, Dardan Kadaj, Nijazi Behluli, Endrit Shatri dhe Premton Zogiani, ndërsa janë lënduar edhe 8 të tjerë. Nuk ndërtohet e ardhmja evropiane me dhunë, me pengim të fjalës së lirë dhe me pengim të instrumenteve demokratike, të cilat përdoren në të gjitha vendet e zhvilluara evropiane.

Ju po thoni që ka zhvillim ekonomik, po thoni që keni bërë politika fiskale, të cilat pastaj tregojnë që ne jemi duke ecur në drejtimin e duhur!

Në fakt, pyetni qytetarët cili është ndikimi i politikave, të cilat ju po i bëni? Donika Kadaj tha që keni premtuar 200 mijë vende të reja të punës, unë dua ta kundërshtoj pak, sepse nuk është bash e saktë, sepse 100 mijë vende të punës i keni siguruar në dhjetor të vitit 2015, kur janë larguar qytetarët nga Kosova. Prej 1 janarit deri më 1 gusht të vitit 2016 i keni siguruar edhe nja diku rreth 7 mijë vende të reja të punës në Gjermani. Pra, këto janë sukseset e politikave fiskale dhe zonave industriale, të cilat ju i proklamoni me kaq shumë bujë, por të cilat nuk kanë efekt.

Pyetni qytetarët çka ka ndryshuar në jetën e tyre, çka ka ndryshuar në familjet e tyre, a kanë rrogat më të mëdha apo më të vogla? A kanë punësuar dikë nga familjet e tyre gjatë këtij viti apo vitit të kaluar? A kanë borxhe më shumë, a më pak?

Politikat e mira, zhvillimin ekonomik duhet ta ndiejnë qytetarët, jo vetëm ta thonë politikanët. Natyrisht besoj që ju nuk keni pritur që ne të ju japim lule, sepse në fund të fundit detyrë e opozitës është të kritikojë pikërisht aty ku ka probleme në mënyrë që pastaj qeverisja të ketë mundësi t'i korrigjojë politikat e saj.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Nënkryetar, unë e kuptoj misionin e dashakëqijve, ngucakeqëve, por po ashtu e kuptoj dhe kam thënë herën e kaluar shumë qartë që nuk kam dëshirë fortë që të merrem me ata që tri ditë janë në Prishtinë e një muaj janë në kurbet me pasaportë, e duke i kontribuar në mënyrë “të zjarrtë” Kosovës dhe e harxhojnë buxhetin, se edhe ky merr pagë prej Buxhetit të Kosovës. Unë veç këtë buxhet të Kosovës e shfrytëzoj si pagë që e marr dhe mirë është të qenën në Kosovë, të përcillen zhvillimet dhe e thashë edhe në një prononcim timin ‘s’kam kundër atyre që e kanë vetëm një pasaportë, mendojnë vetëm për një shtet, punojnë vetëm për një shtet’, për dallim prej të tjerëve që shfrytëzojnë benefite të mëdha në vende të tjera dhe normalisht Kosovën e kanë kalimthi sa për ta shpërndarë këtu ndonjë patriotizëm kalimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Topalli!

FATON TOPALLI: Po, unë në fakt i kam dy pasaporta, por nuk i kam dy fytyra si zoti Beqiri. Unë nuk kam përfituar asnjë banesë, domethënë s’kam beneficion ndonjë banesë, siç e ka marrë zoti Beqiri. Unë jam njëri prej deputetëve shumë aktiv në Kuvendin e Kosovës dhe me pak përjashtime marr pjesë në shumicën e seancave të cilat i zhvillon Kuvendi i Kosovës, edhe pse po zhvillohen shumë pak seanca, sepse po grumbullohen brenda 3-4 ditëve.

Unë nuk përfitoj nga Buxheti i Kosovës më shumë sesa zoti Beqiri, unë nuk jap tenderë, domethënë nuk kam ndonjë afërsi me kryeministrin, nuk kam mundësi t'i jap tenderë askujt. Prandaj, mendoj që po e kryej detyrën time si deputet, po habitem me këtë farë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë Ismet, s’ke të drejtë tash. Ke të drejtë që ta marrësh fjalën për diskutim, dhjetë minuta. Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Unë e thashë më herët, ne e mbështetim gjithë këtë punë që po bëhet në të mirën e vendit, gjithmonë me mundësitë që ka lëshime dhe ato mund të përmirësohen, por jo në mënyrën se si diskutohet këtu dhe e kam thënë, sepse e vetmja gjë që këtu keqpërdoret është fjala kur i jepet deputetit. Unë shyqyr i gëzohem që ju s’keni pasur nevojë që të përfitoni siç po thoni në këtë Kosovën tonë, që ju nuk e pranoni, urdhëroni janë organet, për çdo gjë që ju e kontestoni, për

çdo gjë, ama bash për çdo gjë, edhe në këtë rast, sepse që nga tre vjet merreni vetëm me këtë çështje siç e përmendi parafolësi. Nuk ka kurrfarë problemi.

Meqenëse u personalizuar, unë ia di për nder shtetit që më ka bërë zgjidhje absolutisht, sepse kam pasur nevojë, meqenëse është personale, dhe unë i ftoj publikisht këta që me këtë çështje janë marrë që nga tre vjet, por nuk kanë gjetur argumente ligjore. Mirëpo, ajo që më shqetëson është fakti që gjithmonë me goditje të ulëta ndaj njerëzve tentojnë t'i plasojnë para opinionit. Ndërkaq, për afërsitë, sigurisht ne e kemi kryeministrin e vendit, që i takon partisë sime, dhe jo që këtë s'dua ta fsheh, por duhet dhe ndihemi krenar që ne e kemi një kryeministër të përgatitur dhe e bën punën ashtu siç do të duhej ta bëjë. Ndërkaq, për të tjerët i kanë udhëheqësit e tyre dhe është çështje e tyre se si i trajtojnë udhëheqësit shtetërorë në këtë rast.

Unë, pa dashur, sepse më nuk do ta marr fjalën për këtë çështje, por edhe një herë po e them - ne i pranojmë organet tona të pavarura, ne i pranojmë vendimet e tyre, ne i pranojmë institucionet tona për çdo gjë, për dallim prej atyre që i pranojnë vetëm në momentet kur vlerësojnë se e kanë bërë ndonjë vendim në favor të tyre. Prandaj, në emër të kësaj le të vazhdojnë të shpifin, le të vazhdojnë të spekulojnë, por do të vijë besoj dita shumë e qartë që nga qytetarët, secili prej nesh, duke i përfshirë edhe ata, të cilët vetëm shpifin, ose një numër prej tyre, të mos keqkuptohemi, do ta marrim sigurisht edhe "shpërblimin" e merituar me vota, apo edhe dënimin me votë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti. Më fal, se më herët ke folur në emër të Grupit...

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Jemi të bindur që reforma si e tillë dhe përmbajtja e saj është synim yni i të gjithëve, e veçmas i "Nismës" dhe sigurisht këtu prezantohen pikëpamjet dhe synimet tona për shoqërinë, për shtetin, dhe për të ardhmen e vendit, pa asnjë dilemë.

Por, nëse ne si deputetë të opozitës i prezantojmë edhe e pasqyrojmë gjendjen reale të deritanishme të funksionimit të institucioneve tona, mendoj se nuk është primitivizëm, por është detyrë dhe obligim i yni dhe do të doja dhe do të dëshiroja që ky obligim të ishte edhe i deputetëve që janë këtu, pavarësisht cilit tabor politik i takojnë, shumicë e pakicë. Nëse ne i referohemi gjendjes aktuale nëpër të cilën kanë funksionuar institucionet tona, që kanë pasur detyrime për t'i realizuar përgjegjësitë e tyre karshi zbatimit të ligjit, unë do të ndalem shkurtimisht vetëm të paraqes raportet e Auditorit të Përgjithshëm, besoj se të gjithë i kemi parë dhe i kemi trajtuar, por reagimi i institucioneve përkatëse karshi atyre raporteve që janë tepër të dëmshme dhe kanë pasqyruar në menaxhim të dobët dhe funksionim të dobët të organizatave buxhetore janë një e vërtetë e madhe, që askush nuk mund ta kundërshtojë.

Nëse dalim te mënyra e funksionimit të ndërmarrjeve publike, apo të ndërmarrjeve të pavarura, agjencitë e pavarura, e shohim dhe të gjithë kemi një pajtim se ato ndërmarrje e kanë një performansë si mos më keq. Kemi institucione, të cilave nuk u është miratuar as raporti në Kuvendin e Kosovës dhe masat reaguese ndaj tyre janë zero ose janë minimale, dhe janë sa për sy e faqe, vetëm deklarim. Këto ndërmarrje publike, ndërmarrjet e pavarura janë shndërruar në çerdhe dhe në grupe të shërbyesve të partive në pushtet. Këtu nuk kemi asnjë dilemë. Nëse shkojmë më tutje, te gjendja në Administratën e vendit, Administrata është tërësisht në funksion të politikave dhe grupeve politike të caktuara, prandaj vetëm nëse i marrim këto pika ne mund të konstatojmë se përmbajtja, detyrat dhe prioritetet që janë përcaktuar në këtë reformë evropiane janë të detyrueshme për Qeverinë dhe ne ndajmë bindjen, mendojmë dhe jemi të bindur se prioritetet dhe masat që i ka kërkuar të merren kjo reformë janë detyrim dhe janë goxha të zorshme për Qeverinë.

Qeveria as nuk ka pasur vullnet t'i fusë për t'i bërë pjesë të kësaj reforme, as nuk e ka vullnetin që t'i zbatojë, por janë të zorshme dhe janë të detyrueshme dhe ne kërkojmë që këto të zbatohen sa më shpejt dhe të bëhen, meqë do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve dhe funksionimin e shtetit dhe të institucioneve përkatëse, përndryshe, të nderuar deputetë të pozitës, nuk keni nevojë që ta merrni kaq ngushtë reagimin tonë, sepse është një reagim real, i cili e pasqyron gjendjen reale. Qeveria nuk i ka kryer detyrat e veta, institucionet ose dikasteret e caktuara kanë dështuar tërësisht, pavarësisht se sa një ministër ose një ministre mund ta përdorë foltoren për ta ngritur zërin, por ajo ose ai duhet që t'i kryejë detyrat e saj përkatëse brenda kuadrit ligjor edhe fushës së veprimit, ndërsa me ngritje të zërit nuk zgjidhen problemet e këtij vendit, por kryhen dhe zgjidhen duke e zbatuar ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse një pjesë të mirë të temës që e pata ndërmend për ta diskutuar e mori Teuta Haxhiu, së pari e përgëzoj ministren e re, se e ka marrë shumë për ngut demarkacionin. Besoj që edhe kjo do të zhgënjehet, nëse s'i kanë ndihmuar në Bruksel për ta vënë kusht se ka qenë bukur lobuese.

Tash, e dëgjova edhe ministren Bajrami. E para, domethënë këto janë tri tema shumë me rëndësi, për të cilat ju po thoni duhet me qenë Qeveria, ku është ministri i Arsimit? Ku është ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, që nuk është këtu, se ato janë tema bukur serioze. Edhe ai është dashur për shembull të na i arsyetojë ato pika, të cilat ne do t'i votojmë më vonë besoj. Për shembull, po thotë "21 universitete të larta për 1 milion banorë". Edhe këtë për shembull është dashur sot të na shpjegohet, ndërsa kemi dalë atje të renditur pothuajse se më së keqi në botë.

E ke klimën e mirë për investime, më gëzon fakti nëse janë të vërteta ato që i the, por megjithatë është e pamohueshme se mbi 100 mijë banorë vitin e kaluar e kanë lëshuar Kosovën. Domethënë

është pak shqetësuese dhe do të ishte mirë të vinin edhe ministrat këtu, meqenëse po thoni që duhet të diskutojmë.

E pashë që ka një varg çështjesh që duhet t'i plotësojmë në këtë ligj, ose në këtë agjendë siç po e quajmë, por edhe një pyetje për ministren e re tash të Integritetit: Në rast se këto i plotësoni, siç është paraparë, a do të ketë liberalizim të vizave, sepse këtu asnjëherë, asnjë pikë nuk po futet në ato tema, për të cilat për shembull ju dje me shumë zell ishit kujdesur, siç ishte demarkacionit. Do të thotë, në rast se ju i përmbushni këto, se e keni sundimin, rendin e ligjit, klimën e mirë për investime, arsimin, e kishit aty për shembull që ishte shumë me rëndësi për ta parë te barazia gjinore në punësim, cilat janë ato veprime? Për shembull, kishit thënë vetëm për të krijuar kushte të mira, klimë të mirë për punësimin dhe barazinë gjinore.

Domethënë, keni shumë tema për të cilat ishte dashur dikush sot të përgjigjet, por po e shoh që vetëm me dy ministra këtu është e pamundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kërkoja fjalën, sepse kam nevojë për një sqarim nga ministrja Bajrami. Ajo në fjalën e saj, përveç tjerash, tha se punësimi në Kosovë ka rënë nga 36% në 24%, më falni, papunësia, e që vërtet është një lajm shumë inkurajues, po që se del se numri i të punësuarve është rritur aq shumë. Por, ajo që më intereson mua është, që ministrja të na thotë se 12%-shi i atyre që janë punësuar, sa është në shifra, në cilat fusha janë punësuar këta njerëz? A janë punësuar në Kosovë apo jashtë Kosove dhe nga cila bazë është marrë edhe 36%-shi i të papunësuarve edhe ky 12%-sh, sepse sipas statistikave, për aq sa e dimë, rreth 1 500 000 qytetarë të Kosovës i takojnë moshës së punës aktive, që janë mbi 18 vjet dhe nën 65 vjeç e që 12%-shi i bie diku rreth njëqind e shtatë a tetëdhjetë mijë njerëz, që do të duhej të ishin punësuar, po megjithatë unë kërkoj që ministrja ta sqarojë këtë çështje mirë dhe mundësisht, të na japë shifrat se sa janë punësuar, me shifra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Unë vetëm desha të jap një koment lidhur me këtë draft që na e kanë dërguar këtu. Është përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë, si njëra prej pikave, por këtu janë vetëm dy gjëra: krijimi i funksionalizimit të këshillave industrialë dhe shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit.

A mendoni me të vërtetë, që vetëm me këto dy pikë mund të përmirësohet gjendja e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë? Dhe, nëse shikojmë buxhetin e viteve të kaluara, kur s'ka pasur

kurrfarë ndryshimi në aspektin e investimeve në arsimin e lartë e sidomos, ndarja për hulumtime, e cila sipas ligjit duhet të jetë 0,7%, kurrë nuk është ndarë. Si mund të zhvillojmë arsimin e lartë në Kosovë pa fonde të ndara për hulumtime? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami ka shprehur dëshirën t'u përgjigjet të dy pyetjeve, që i bënë deputetët.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kurteshi!

Sipas të dhënave që i kemi në fondin pensional, në vitin 2015 kemi pasur 18 mijë kontributdhënës, domethënë tatimpagues, ose kontributpagues në Trustin Pensional dhe 22 mijë në vitin 2016. Këto janë kryesisht në sektorin privat. Siç e dini, në fillim të mandatit qeveritar kemi marrë vendim, që edhe të mos i rrisim pagat, por edhe të mos e shtojmë numrin e vendeve të punës në Administratën Publike, për shkak se kemi llogaritur që zhvillimi dhe punësimi duhet të vijë nga sektori privat.

Ndërkohë, që ju e dini se në këtë mandat, domethënë që tri vite radhazi kemi rreth 50 milionë grande dhe subvencione në sektorin e bujqësisë. Diku rreth 250 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës janë të aktivizuar, janë aktivë në sektorin e bujqësisë dhe këto bëjnë diku rreth 80 mijë vende të plota të punës. Nuk po themi, se janë krijuar të gjitha gjatë këtij mandati, mirëpo dhënia, domethënë shumëfishimi i buxhetit në sektorin e bujqësisë, grandet dhe subvencionet kanë ndikuar shumë, që aty të krijohen vende pune e të cilat në fakt nuk janë zyrtarisht të përfshira.

Ndërkohë, që statistikat 34% papunësia në vitin 2014 dhe rënia në 26% në fund të vitit 2016, vijnë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë të njëjtat metoda që ata kanë përdorur tash e sa kohë, nuk ka ndryshuar asgjë në metodologjinë e kalkulimit të statistikave gjatë këtij mandati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Meqenëse, këtu në këtë strategji që po na prezantohet, si pikë e parë është qeverisja e mirë, qeverisja në mënyrë demokratike, qeverisja përmes sundimit të ligjit, qeverisja për të mirën e vendit, atëherë unë përmes një rasti dua që ta shpjegoj, le të themi, mënyrën e qeverisjes së keqe në Kosovë dhe pse me këtë qeverisje, as që do të mund të shpresojmë se do të ecim me hapa të shpejtë në drejtim të integriteteve evropiane.

Pra, nuk ka të bëjë fare qeverisja në Kosovë me vlerat evropiane në përgjithësi. Dhe, rastin që po dua ta shfrytëzoj e ta ndaj bashkë me ju është çfarë ka ndodhur në Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës. Kjo tregon, se çfarë po ndodhë në Kosovë me të vërtetë. Para pak ditësh e kemi pasur atë, që në opinionin publik u quajt "Dorëheqja e drejtorit të AKI-së, zotit Agron Selimajt." Por,

kjo ngjarje e ka mbuluar një ngjarje tjetër, shumë më të rëndësishme, qëllimi i vërtet i së cilës ka qenë shkarkimi i zotit Selimaj.

Çfarë ka ndodhur në të vërtetë në Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës? Ka ndodhur diçka që nuk është bërë shumë publike, nuk ka qenë temë e lajmeve, po unë dua ta ngre edhe një herë si problem, në mënyrë që ta kuptojmë më mirë defektin e mënyrës, se si qeveriset Kosova dhe ky është një defekt kardinal.

Ekziston atje një proces i auditimit të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës. Këtë proces të auditimit e ka udhëhequr një zotëri i quajtur Naim Ibrahimaj. Ky zotëri, një qytetar shumë i mirë i Kosovës, një auditor shumë profesional i vendit tonë, që nuk i kemi shumë, një patriot që e do vendin e vet dhe që dëshiron ta kryejë detyrën e tij pa ndikime politike, që dëshiron t'ia thotë të vërtetën popullit të vet dhe që dëshiron t'i ndihmojë vendit të vet, është suspenduar para pak ditësh prej kësaj Qeverie.

Pse është suspenduar Naim Ibrahimaj, shtrohet pyetja. Ai është një zyrtar i rëndësishëm i Republikës së Kosovës. Naim Ibrahimaj, zonja dhe zotërinj, është suspenduar sepse në AKI i ka zbuluar tri gjëra shumë të rrezikshme për këtë pushtet, për këtë qeverisje të keqe.

Shtrohet pyetja, çka paska zbuluar ky Naim Ibrahimaj? Së pari, ka zbuluar që në AKI janë keqpërdorur 246 mijë euro. E ka shkruar një raport konfidencial, që ju nuk e keni, po që e kanë pasur vetëm dy persona në Kosovë, kryeministri Isa Mustafa dhe presidenti Hashim Thaçi. Ua ka dërguar të dyve, është një raport 13 faqe me keqpërdorime të hollësishme brenda Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës. E para 246 mijë euro keqpërdorime.

E dyta, keqpërdorimi i dytë brenda AKI-së, pranimi i 8 personave pa kurrfarë testi dhe pa kurrfarë konkursi. Shikoni, brenda institucioneve tona njerëzit po u punësuakan pa konkurse dhe pa testim, pa intervistë. Shkon drejtpërdrejt, je militant partiak, të shtinë në institucionin më të rëndësishëm të vendit, të fusin në Inteligjencë aty edhe duhet për t'i kryer pastaj detyrat dhe shërbimet partiake, jo shtetërore, ti kishte qenë shtetërore bile... po shërbime partiake! Ky është keqpërdorimi i dytë, e keni në raport.

Unë do të kërkoja prej zotit Ibrahimaj që ta publikojë këtë raport, është shumë me rëndësi që mos ta ketë vetëm kryeministri dhe presidenti këtë raport, le t'u shpërndahet të gjithë deputetëve ky raport. Kur e shohin kryeministri dhe presidenti çka paska ndodhur në AKI, çfarë keqpërdorime të tmerrshme dhe që këto të nesërmen do të dalin në publik, shkojnë dhe para se të dalin keqpërdorimet e shkarkojnë drejtorin e AKI-së, zotin Agron Selimi. Edhe ky që u shkarkua nuk është ndonjë mëkat i madh i Qeverisë, këtu mirë ia ka bërë që e ka shkarkuar, se ky qe besa ka qenë njëfarë poltroni, po e keqja në Kosovë është, se po shkon një poltron e po vjen tjetri, po vjen ky Driton Gashi. Dhe, më bëri shumë përshtypje, për nder! Ditën që u zgjedh ky Driton

Gashi, më bëri përshtypje se si e prezantoi atë biografinë e tij Radiotelevizionit të Kosovës, i përmendi krejt ato shkollimet e tij profesionale e të gjitha ato, por tri më të rëndësishmet nuk i përmendi televizioni ynë publik, për të cilin paguajmë ne para, nuk e përmendi që ka qenë anëtar i degës së PDK-së në Prishtinë, nuk e përmendi që ka qenë këtu në Grupin Parlamentar të PDK-së, ka punuar. Këto janë gjërat më të rëndësishme pse ai vjen në krye të AKI-së, se këtu në Kosovë, këto dy partitë që e qeverisin Kosovën i kanë ndarë postet në mënyrë partiake. Me qenë se ai i pari i AKI-së paska qenë i PDK-së, më i afërti i PDK-së, cilindo që ta heqin prapë i PDK-së duhet të jetë ky tjetri, se kur e keni bërë marrëveshjen e koalicionit atëherë në fillim, e keni bërë që postet edhe nëpër agjenci të pavarura, edhe nëpër institucione publike, për t'u ndarë në mënyrë partiake. Qe, këto janë vlerat tuaja evropiane.

Dhe, çfarë bëhet në AKI? Dua t'i kthehem prapë AKI-së, se ky është institucion i rëndësishëm, këtu është çfarë po ndodhë me agjencitë e pavarura, kjo tregon në atë se çfarë niveli evropian të qeverisjes kemi. Ky zoti Ibrahimaj, kur e ka kuptuar kryeministri dhe presidenti që tash i del korrupsioni Agron Selimajt, e heqin atë por çfarë është më e rëndësishme, e heqin edhe këtë që e ka treguar të vërtetën, këtë zotin Naim Ibrahimaj. Njeriu është i suspenduar bashkë me dy bashkëpunëtorët e tij, të cilët e kanë shkruar këtë raport, ku tregojnë për keqpërdorime. Dhe, qe çfarë ndodhë në Kosovë!

Një njeri i ndershëm, një njeri që dëshiron të punojë për shtetin, një njeri që është profesional, nuk ka mbrojtje, përkundrazi, jo që nuk e mbron kurrkush, po e suspendojnë për t'u dhënë mesazh të tjerëve, që punojnë në mënyrë të ndershme në këtë vend e që janë boll pak, po s'po duan ta lënë asnjë, hiç asnjë!

Të gjithë naimave të tjerë, që nesër do ta thonë të vërtetën, që do t'i auditojnë institucionet tona edhe ku dalin tenderët, që kryeministri ua ka dhënë djemve të vet, qe ky e ka qit tenderin, ky Naim Ibrahimaj. Kur, unë ia kam publikuar kryeministrit, atë tenderin e parë, që ua pat dhënë djemve të vet për BMW, pati dalë kryeministri në qershor edhe tha: nuk ka më, më falni, nuk ka më tenderë për djemtë e mi, kjo do të jetë hera e fundit. Prej sot, nuk ka më! Në tetor ua ka dhënë tjetrin, në tetor... a ne qershor e ka bërë premtimin, se nuk do të ketë më kësi lloj tenderësh.

Çfarë t'i themi tash kësaj? A çohet ndokush në këtë vend, e ta mbrojë Naim Ibrahimin që e thotë të vërtetën, që tregon se në AKI njerëzit kanë blerë I-phona privatë. Në AKI njerëzit blejnë I-phona privatë edhe i marrin të vetët te shpija, pronën publike të shtetit, atë që i përket popullit, atë që ta jep populli e merr te shtëpia!

Kësi lloj qeverisjeje ka nëpër institucionet tona. E kjo shtyhet përpara, kurse ai që tregon dërgohet në shtëpi, ai shantazhohet e kërcënohet. Këto janë vlerat evropiane të Kosovës.

KRYESUESI: Tani, ky debati po ndryshon kahen, akuzat janë jo për temën që e kemi, por sidoqoftë rreth ndërmarrjeve publike. Është një problem që duhet të diskutohet. Kisha thënë, që s'është mirë të futemi në një temë, të cilën mund ta shqyrtojmë edhe në një seancë të veçantë po të jetë, s'na prish edhe shumë punë, sepse për atë punë jemi mbledhur dhe për atë punë është Parlamenti, për të diskutuar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të vërtetën, ose jo. E vërteta e njëanshme gjithmonë është problematike.

Sidoqoftë, fjalën e ka zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të nderuar,

Me theks të veçantë, më lejoni ta përgëzoj dhe ta uroj për punën, ministren e re të Integritetit dhe t'i uroj sukses!

Është e vërtetë, që ne sot po e shqyrtojmë, ose po e diskutojmë e debatojmë një temë të rëndësishme, që ka të bëjë me agjendën për reforma evropiane. Por, t'u them sinjerisht nuk e pata ndërmend ta marr fjalën, por pasi që këtu shumë deputetë po e marrin fjalën më shumë që t'u drejtohen elektoratit të vet edhe kjo është, deri diku, legjitime, por ne automatikisht pastaj kemi obligim për të sqaruar disa gjëra, sepse edhe ne kemi elektorat. Dhe, tek e fundit, ne kemi përgjegjësi para këtyre qytetarëve si dhe ndaj elektoratit të opozitës. Prandaj, disa gjëra të cilat thuhën këtu edhe pa bazë, duhet të sqarohen.

Kolegë të nderuar,

Unë pajtohem që në qeverisjen tonë ka shumë probleme dhe duhet përmirësuar çdo ditë. Por, askush nuk mund ta mohojë, që vërtet kjo qeverisje ka sukseset, rezultatet e sidomos në raport me luftën e korrupsionit, krimin, balancën e kësaj deri sot se si kanë shkuar punësimet, e krejt, nuk mund të themi se është gjithçka perfekt, por ka përmirësim dhe na tregojnë edhe raportet që i kemi çdo ditë.

Në qoftë se, kolegu im flet, e mori shembull AKI-në, po bëhem e sinqertë që s'e kam parë atë raport. Një gjë po ju them, se dorëheqja e shefit të AKI-së edhe për mua është dashur të jetë më e qartë, a ka dhënë dorëheqje a është shkarkuar. Nëse ka dhënë dorëheqje, duhet të ketë, pak a shumë, më shumë të dhëna pse dhe nëse është shkarkuar, njerëzit kur të shkarkohen duhet të marrin edhe përgjegjësi më tutje.

Por, ne e dimë se ligji thotë, se njerëzit që punojnë në AKI, më së paku 5 vjet, nuk guxojnë të japin asnjë deklaratë, këtë e kanë në kontratë. Dhe pastaj, ne deputetët, që doemos jemi politikanë dhe po punojmë për këtë shtet, na duhet pasur kujdes që ligjet tona t'i respektojmë dhe mos t'i rëndojmë njerëzit duke u munduar ta qesim këtu që vërtet ata paskan bërë punë të madhe, që nëse e ka bërë punën e mirë e ka pasur obligim dhe duhet bërë.

Ju, kolegë të nderuar, po flisni për punësimin që unë nuk e di, ndoshta edhe ka ndodhur ashtu, nuk është e jashtëzakonshme, këtu kanë ndodhur përpara gjëra të tilla, por unë po ju pyes juve, 200 kontrata mbi vepër punësime në Prishtinë, si janë bërë ato, dhe janë krejt partiake. Këtë duhet ta dijë elektorati dhe këtë duhet ta dinë qytetarët e Kosovës. Nuk mund të dilni e të gjykoni këtu asnjë parti, kur ju jeni në nivel të tillë, 200 kontrata mbi vepër i keni në Komunën e Prishtinës. Pastaj, iu drejtuat e folët për tenderët e djemve të kryeministrit, se s'po dua këtu të shndërrohem në avokat të kurrkujt, por ne shumica këtu kemi fëmijë dhe po e bëjmë një punë, konsideroj unë, ata që e bëjnë me përkushtim, që jeni këtu, fëmijët tanë athua vallë s'kanë të drejtë, as me u shkollua, as me u punësua, lëre më në administratën shtetërore, por as në biznes privat!?

Ata kanë një biznes privat para se të bëhet babai i tyre kryeministër e politikan e ku ta di unë... dhe ata duhet të punojnë dhe janë të pavarur. Nuk e di pse ju duhet të merreni me ta çdo ditë, ose fëmijët e mi, ose unë me fëmijët e juaj!? Këtë, së paku, ne duhet ta kemi parasysh.

E dyta, edhe unë juve po ju pyes, tenderët ju në Komunën e Prishtinës a t'i analizojmë kujt po ia jepni. Hajde t'i qesim një herë emrat e ta shohim se kush janë ata njerëz, që po i marrin tenderët prej Komunës së Prishtinës. Edhe unë po them, që në qoftë se ka vërejtje për qeverisjen, hajde bash t'i bëjmë vërejtjet parimore, por mos na shitni këtu mend e patriotizëm, se s'është ashtu. Ju e keni një model shumë konkret, se çfarë do të bënit ju po të ishit në Qeveri, me Komunën e Prishtinës.

KRYESUESI: Po, ke të drejtë për replikë, se t'u drejtua ty. Regjia, Glaukut fjalën, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: E para, po të kishte pasur ndonjë keqpërdorim në Komunën e Prishtinës, apo ndonjë korrupsion, siç ka pasur në kohën e LDK-së, unë mendoj që këta do ta kishin qitur tashmë. Edhe gjykatat do të ishin marrë me neve në mënyrë speciale, sepse janë të kapura dhe mezi presin që "Vetëvendosja" të bëjë ndonjë gabim.

Në Komunën e Prishtinës deri tash në qeverisjen e Shpend Ahmetit nuk ka asnjë lëndë të korrupsionit, për të cilën ai gjykohet, si dhe të gjitha që ai i ka nën kontroll. Pra, të gjithë vartësit e tij, si punëtorë të Komunës së Prishtinës, nuk kanë pasur ndonjë akuzë për korrupsion, gjë që nuk ndodh me LDK-në e viteve të kaluara, ku deri tash, me sa di unë, diku 90 raste të keqpërdorimeve të mëdha në Komunë të P janë prej vitit 2001, kur ka qeverisur LDK-ja.

E dyta, sa i përket Besa Gaxherrit, tash po e kuptoj më mirë, kjo sikur me qenë motra e Adem Grabovcit diqysh, në kuptimin që Adem Grabovci pati dalë, ky është mentaliteti qeverisës i këtyre, "ne nëse nuk u ndihmojmë familjeve tona, nëse nuk i punësojmë djemtë e tezet e dajët tanë, kënd kemi me e punësua në këtë shtet". Unë nuk kam vërejtje që djemtë e kryeministrit

punojnë në mënyrë private, atë hall nuk e kam fare, asnjë problem nuk e kam me këtë punë. Ka privatë në Kosovë, punojnë me djersën e tyre, fitojnë... kjo është mirë për shtetin e Kosovës.

Problemi fillon aty ku një kryeministër e shfrytëzon pozicionin dhe pushtetin që e ka, për t'ia modifikuar, natyrisht ai vet jo, po një drejtor i tij, njerëzit e tij, t'ia modifikojnë specifikacionet konkrete një tenderi, që ai "çuditërisht" të përfundojë te djemtë e vet. Ky duhet të jetë shqetësim për publikun dhe për shtetin. E nuk është kjo "tash, s'kanë të drejtë edhe ata të punojnë..."

KRYESUESI: Faleminderit! Besa ka kundër-replikë.

BESA GAXHERRI: Paj, tash Glauk, për njëmend me juve të shtyhesh është shumë problem, se ju kështu sy për sy, ta kthen fjalën dhe qëllimin për vete, e s'të vjen marre me thënë ti si... unë nuk di çfarë krahasimi të bësh ti "unë si Adem Grabovci", hiç s'po mund të të kuptoj. Ti veç mund ta thuash atë dhe e thua, megjithëse tash ju jeni bë këtu garniturë "kasetofoni i prishur" edhe nuk ju zihet për të madhe. Por, unë po të them edhe një herë, familjet tona duhet të jetojnë edhe ju nuk keni të drejtë të merreni me fëmijët e njëri-tjetrit, merruni këtu me mua, nëse ke diçka konkretisht, edhe me atë e me atë tjetrin, se është shumë e ulët, një. E dyta, edhe një herë po ta përsëris, nëse, zotëri, ju i paskësh 90 vepra që i keni në prokurori, kur të vijmë tash ne, që ua marrim juve Prishtinën, 120 keni me i pas një. E dyta, pse këto vërejtje që i dhe ti këtu, s'i ke çuar në Prokurori, por po i sjell këtu?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Besa, u bë "bozë" kjo puna e fëmijëve të kryeministrit, po ata i kanë dy rrugë, ose me e dorëzua përfaqësinë e BMW-së, mos me qua kurrkush BMW për servisim, ose me i dorëzua krejt kerret kush ka BMW, po ne kemi probleme më të thella, të cilat duhet me i analizua, mendoj unë. Nuk kemi nevojë të godasim aq ulët, nën brez.

Unë po dua të them, që agjenda evropiane në Kosovë është një referencë të cilën ne duhet ta përcjellim dhe t'i standardizojmë këto obligime, të cilat i përmbushin aspiratat tona për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian. Por, çudia më e madhe është që asnjë ministër nuk paraqet asnjë problem më të vogël të funksionalizimit të ministrive të veta. Çdoherë, paraqesin në atë prezantimin e tyre, tash edhe sot ministrja e paraqiti sikur është çdo gjë shembullore. Nuk është çdo gjë shembullore. Ju duhet të jeni edhe kritikë. Të gjeturat t'i numëroni vetë, sepse ua numëron edhe opozita edhe ne dhe më mirë është t'i gjeni të gjeturat dhe t'i numëroni, sesa t'i mbuloni.

Ju thatë, keni ndenjur 4 orë me biznesmenët, mund të rrini edhe 4 ditë me biznesmenë të përzgjedhur dhe ata ju dëgjojnë, se ata janë marrë vesh që të ju dëgjojnë, po jo që ata e kanë përfaqësuar biznesin e Republikës së Kosovës. Ju e dini fort mirë, se ku po dua të dal!

Juve, Oda Ekonomike e Kosovës u imponon biznesmenë që janë të përgatitur për të dëgjuar, por jo për të vlerësuar dhe jo për të parë problemet të cilat janë të shumta, si në cilësi edhe në prodhim e monitorim të cilësisë, që ne duhet t'i shohim. Çfarë mund të bëjmë? Si mund t'i adaptojmë këto çështje, por jo t'i kamuflujmë dhe jo t'i shtyjmë vetëm sa për të votuar tash ne edhe... e votuam këtë strategji.

Formën e standardeve, nuk është “kuran” puna e ligjeve të Bashkimit Evropian, që ta miratojmë secilën. Sepse, standardi i Kosovës është në një rrethanë tjetër ekonomike dhe politike, por ne mund t'ua adaptojmë. Por, edhe Bashkimi Evropian nuk mund të përdorë dy “kute” për Republikën e Kosovës dhe për republika të tjera. Ne kemi edhe standardet politike hipotetike, të cilat përdoren edhe në planin e strategjisë për çështjen e sigurisë, që edhe dje folëm për çështjen e FSK-së edhe për çështjen e demarkacionit, për të cilin Bashkimi Evropian nuk mund t'i ikë fajit për këto çështje, sepse është bashkëfajtor me monitorimin dhe ndjekjen e cilësisë së të bërit shtet në Republikën e Kosovës.

Prandaj, ne nuk mund të nënshtrohemi para Bashkimit Evropian verbërisht, duke na e mbajtur shkopin te veshët për secilën gjë, por ne duhet të ngrihemi dhe t'i tregojmë, mundësitë tona janë këto, hapësira jonë për të lëshuar është kaq, autoriteti ynë politik, njerëzor dhe shtetëror është kaq. Prandaj, ne po dalim, ka të drejtë zoti Haliti, kur thotë se po dalim prej temës, mirëpo edhe sot për ta vërtetuar këtë votim që do ta kërkon nga ne edhe si strategji, do të mbesë në letër, por në ligje nuk është ashtu. Ka shumë ligje, zoti Haliti, që janë miratuar këtu e të cilat kanë edhe miratimin e Zyrës së Integritimit Evropian, por nuk funksionojnë ato ligje.

Ne duhet, ose t'i kthejmë, ose t'i vlerësojmë, se përse s'po bëjnë. Kush janë problemet? Brenda ministrive nuk ka koordinim. Kurrkush nuk e flet këtë. Një ministër çohet, mendon që ka filluar puna me atë ministër dhe nëse unë eci si ministër, shkon dhe përfundon çdo gjë. As memorien shtetërore nuk e ruajmë! Nuk jemi duke e ruajtur memorien shtetërore të trashëgimisë, të vlerësimit dhe të implementimit të shumë projekteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Zoti Muja!

Vetëm edhe një sqarim sa i përket takimit dhe bashkëbisedimit katërorësh me biznese të kryeministrit dhe katër ministrave tjerë, që merren me zhvillimin ekonomik.

Katërqind biznese që kanë qenë prezentë nuk i ka dërguar Oda, i kemi ftuar përmes ftesave publike në rrjetet sociale. A e di veç cila kategori s'ka qenë e përfaqësuar, biznes si puna jote, domethënë që janë edhe deputetë edhe biznese. Ata nuk i kemi ftuar, më vjen keq, por kemi harruar. Ndërkohë, që nuk është kurrfarë arritje. Unë e thash tashmë, po të ishte situata si e paraqiti “Vetëvendosja” ne nuk do të kishim pasur as guxim të ballafaqohemi me biznese, përndryshe ajo nuk është arritje. Unë i tregova arritjet tjera që i listova, ishin mbi 30 prej tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Muja.

SHAIPI MUJA: Faleminderit! Kur po them se kjo qeveri duhet të shkojë në shtëpi sa më shpejt, zoti nënkryetar, kjo tregon. Unë nuk e fsheh që punoj biznes që 35 vjet dhe asnjëherë s'kam qenë në Republikën e Kosovës në ekzekutiv. Edhe po ta merrja unë me tenderë që merreni ju, do të më grinit, por nuk ka tenderë dhe ju mund të jeni të përlyer dhe gjeni të përlyer diku tjetër.

Si s'të vjen turp të thuash “në rrjete sociale kemi ftuar biznese”? Unë po t'i numëroj shumë fakte, meqë po do tash ta bësh. Ju nuk keni krijuar kushte të favorshme për bizneset. Bizneset janë duke ju ikur në Maqedoni, janë duke u demotivuar, duke filluar nga mbrojtja e biznesit, energjia elektrike, të cilën ne nuk e monitorojmë për bizneset me i stimulua, nga lënda e parë, këtë shishe që ti e merr, e zhdoganon ti, shkon e blen prodhuesi ynë në ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Unë, edhe pse kam me çka t'i replikoj edhe Shaipit, por për një minutë nuk mundesha, por po të falënderoj që ma dhe mundësinë ta plotësoj replikën. Edhe po ju them edhe juve të “Vetëvendosjes” edhe këtë, konkursin e fundit, se pasi që po doni, konkursin e fundit në arsim pse është refuzua? Dhe, po ju pyes, lejet në Prishtinë cila studio i lëshon? Komuna e Prishtinës asnjë leje nuk e lëshon, vetëm përmes studiove, dy-tri studiove të “Vetëvendosjes”. Pa shkua atje, asnjë leje nuk mund ta marrësh në Prishtinë.

Kështu që, këto janë një ndër ato... realiteti i “mirëqeverisjes” suaj, modeli juaj. Ty Shaip, një herë tjetër, më duhen nja 5 min a 10, për të ta dhënë replikën.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Nga Komuna e Prishtinës në konferencën e tyre të fundit, Dren Kukaj dhe Arben Vitija kanë publikuar një gjë shumë interesante për qeverisjen e LDK-së në Prishtinë.

Çka është kjo gjë? Kjo është që këta, banesat që kanë qenë të dedikuara për raste sociale, ia kanë ndarë vetvetes. Domethënë, figura zyrtare shumë të larta të Komunës së Prishtinës banesat e dedikuara për raste sociale, këta i keqpërdorin. Tash, unë nuk kam... a e din, argument tjetër më të plotë për të treguar të vërtetën e qeverisjes së tyre në Prishtinë.

Tash, çka është e vërteta e qeverisjes së “Vetëvendosjes”? Këto banesa do t’ua marrë dhe uroj që, kjo marrje e pasurisë së paligjshme dhe në mënyrë mafioze, të shkojë deri në strukturat më të larta të Qeverisë, kur “Vetëvendosja” të vijë edhe në qeverisjen qendrore. Ky do të jetë shembulli ynë, përmes të cilit do të qeverisim.

Njerëzve që e kanë dëmtuar popullin, njerëzve që e kanë vjedhur popullin, duhet me ua marrë pasurinë. Kjo ka filluar në Prishtinë, kjo do të vazhdojë deri lartë.

KRYESUESI: Shqip, me kë ke kundërreplikë, me Besën. Në rregull, kundër-replikë ka Shqip.

SHAIPI MUJA: Unë e falënderoj Besën, që më dha mundësi dy minuta t’i përgjigjem tash ministres për çështjen e bizneseve.

Këta e kanë marrë zëvendëskryeministër Ramiz Kelmendin edhe thotë “ti me biznese”. Ky mentalitet primitiv, i kaluar, që fukarenjtë duan t’i shtyjnë të mendojnë siç duan vetë. Ramiz Kelmendi ka shumë komente për bizneset e tij në relacion me Serbinë si për evazionin fiskal që e bën, edhe që ia mbush kasën e parave Serbisë dhe destimulon prodhimet vendore e thotë “unë po i stimuloj”, sepse futë konkurrencë nga Serbia në mënyrë fantastike dhe thotë “unë po bëj biznes”.

Prandaj mos i shitni këto farë “fore”, po hajde të ulemi e të shohim ku po “na rrjedh uji” e ta mbyllim më përpara, se nuk lidhet fati me mua, me ca të tjerë e me ty...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zenun Pajaziti, i fundit e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja ministre,

Kolegë deputetë,

Është për keqardhje qysh një pikë e tillë e rendit të ditës, siç është agjenda për reformat evropiane të devijojë deri në këtë pikë.

Mendoj që sot ne lëshuam një rast për të pasur një debat më përmbajtjesor, edhe pse disa nga deputetët patën në fokus çështje që kanë të bëjnë me reformën evropiane dhe me agjendën

evropiane. Po mendoj, se në tërësi e lëshuam rastin për ta bërë një debat që na duhet, një debat përmbajtjesor dhe mendoj që kemi pasur edhe njëfarë zbrastësi në këtë kohë. Me ardhjen e ministres së re, të cilës i uroj suksese, padyshim se është njëra me përvojën më të mirë, sepse ka shërbyer në Bruksel për një kohë të gjatë, po do të ishte mirë që sot të fokusohemi në çështje që janë më të ngutshme, për sa i përket kësaj agjende.

Sot nuk na duhet ne, në mënyrë të përsëritur ndoshta, me cilësime të ulëta prej “kriminelë e vjedhës” e deri në cilësime tjera, se dikush na qenka “qytetar i mirë e patriot i mirë e profesionist i mirë”. Janë të gjithë ata shërbyes civilë që i shërbejnë këtij vendi, në përputhje me ligjin e bëjnë punën e tyre, mund të jenë qytetarë të mirë e patriotë të mirë, po ne nuk u shërbejmë atyre dhe as sundimit të ligjit, nëse ne foltoren e Parlamentit, sallën e Parlamentit, e bëjmë një arenë e cila nuk duket që mund të kontribuojë e as mund të çojë ndonjë sinjal të mirë.

Zonja ministre,

E kisha vetëm për të thënë diçka që është përtej kësaj që ju i keni të adresuara në projektin tuaj, në agjendën për reforma.

Ajo që na mungon tash, përtej saj është ndoshta një aktivitet më i shtuar në Parlamentin Evropian. Ne të gjithë deputetët që jemi këtu kemi nevojë, pavarësisht se kemi komisionet kompetente dhe njerëz, që me vite kanë lobuar dhe kanë bërë kontaktet e tyre, mendoj se bashkë me ty mund të bëjmë diçka më shumë, për sa i përket një lobimi më të madh në Parlamentin Evropian, sidomos të shtetet që nuk na kanë njohur, që të mund të bënim, ndoshta, edhe njëfarë grupimi joformal në mes nesh, pozitë dhe opozitë, në mënyrë që të mund ta shtynim pak më tutje agjendën e integriteteve, sidomos çështjen e liberalizimit të vizave.

Në këtë drejtim, zonja ministre, ju ftoj të bashkëpunojmë me Parlamentin dhe në këtë drejtim, ndoshta, mund të kyçemi veç e veç secili, ose bashkërisht, që të bëjmë pak më shumë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Unë mendoj, se ishte një debat i koncentruar pikërisht rreth Agjendës Evropiane, edhe pse u ngritën çështje që kanë të bëjnë pikërisht me Raportin e Progresit, që është për Kosovën.

Nga diskutuesit që ia dinë njëri-tjetrit gjërat, u dëgjuan shumë probleme. Besoj se ka edhe më shumë, sepse sikur të mos kishte kaq shumë, nuk do të na kritikonin në Raportin e Progresit. Unë ua kisha dëshiruar të gjithë atyre që kanë informacion dhe që mund të kontribuojnë në luftimin e korrupsionit në Kosovë, që t’i emërtojnë rastet, sepse ajo puna e djalit të kryeministrit u bë bozë, realisht, veç sa për të folur këtu në Parlament. E ka marrë një kerr, e ka ndreq, e s’e ka ndreq, e ka servis, në rregull është. Nëse është keqpërdorur, jep llogari ai që e ka keqpërdorur.

Po dua të them, se nuk është në pyetje në është rregulluar një kerr, një veturë, e dikujt ose një institucionit, te djali i kryeministrit, që rastësisht mund ta ketë një servis, problemi është që ne e dimë se shumë gjëra bëhen në emër të fëmijëve, në emër të vëllezërve, në emër të kushërinjve, e të atyre... Në qoftë se, ka korrupsion të niveleve të larta, siç po thuhet, hajde t'i diskutojmë në parlament, hajde të krijojmë komisione të parlamentit dhe urdhëroni shkoni në Prokurori, se i bëni shërbim vendit, s'i bëni shërbim drejt, kushdo qoftë. Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja, e fundit është e që fjala është e Qeverisë, në këtë rast Mimoza e ka fjalën dhe po e përfundojmë pastaj me votim.

MINISTRJA MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët për debatin dhe kontributin që dhanë, në lidhje me Agjendën për reformën Evropiane.

Është fatmirësi dhe është për t'u vlerësuar, që Agjenda Evropiane e Kosovës nuk ka filluar sot me ditën e emërimit tim si ministre, por të gjithë qytetarët e Kosovës, të gjitha partitë politike ende pa qenë Kosova vetë shtet, kanë pasur dhe vazhdojnë ta kenë ambicie integrimin dhe anëtarësimin e plotë të Kosovës, si shtet me të drejta të barabarta si të gjitha shtetet tjera në Bashkimin Evropian.

Do të dëshiroja, prandaj, të ju ftoj të gjithëve që ta përkrahni këtë agjendë dhe t'i jap edhe një herë disa shpjegime lidhur me atë, me pyetjet që disa deputetë i patën. Edhe një herë po e them, dokumenti si i tillë është një kornizë formale, e cila është diskutuar vitin e kaluar në mes të kryeministrit dhe komisionarit për fqinjësi dhe zgjerim, komisionarit Han. Pas analizave të shumta, pasi që janë përfshirë të gjitha strukturat shtetërore të vendit tonë, nga presidenti, kryetari i Parlamentit dhe të gjitha segmentet, departamentet relevante të institucioneve tona dhe pas analizave të shumta, kanë ardhur në përfundimin që në një listë, që përbëhet nga 22 prioritete dhe të cilat do të duhej të implementoheshin. Periudha kohore, për të cilën ne po flasim, është një periudhë 18-muajshe dhe që i përfshin të gjitha ministrinë, siç edhe e thash parëz në fillim.

Secila nga ministrinë ka marrë obligimet e veta dhe përgjegjësitë dhe ka bërë planin e punës. Se si do ta implementojnë dhe do ta realizojnë këtë agjendë, mbetet të shihet. Ne të gjithë ministrat do t'i kemi dhe me të gjithë do ta kemi mundësinë që të bisedojmë.

Unë, që nga sot, do të vazhdoj të jem bashkë me juve, ashtu siç edhe e tha kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, krahë jush, bashkë me ju, në të gjitha aktivitetet e përbashkëta, që Parlamenti do t'i ketë, jo vetëm në Parlamentin Evropian, po edhe në të gjitha institucionet tjera relevante që janë në Bruksel, qoftë edhe bashkëpunimin apo punën e drejtpërdrejtë me shtetet anëtare që atje i kanë selitë dhe do të bëj çmos, që ta tejkalojmë këtë punën e mosnjohjes nga pesë shtetet anëtare dhe ta afrojmë Kosovën sa më shpejt që është e mundur drejt BE-së.

Prandaj, edhe një herë kërkoj nga ju që t'ia jepni dritën e gjelbër, ta përkrahni këtë reformë që ta lentojmë dhe ty shtyjme më përpara agjendën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E kemi edhe një raport, mund ta shqyrtojmë, mund të marrim pauzë. Si ta keni... pastaj, kemi votimet që zgjasin dy orë. Po, ty kryejmë. Tash është një raport që e ka Vetoni për... Janë 65 deputetë në sallë, kuorum ka për t'u votuar. Atëherë, e votojmë Agjendën për Reforma Evropiane. Votojmë tash!

Konstatohet që me 63 vota për, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Agjendën për Reforma Evropiane.

Atëherë, zoti Muharremi e keni fjalën. 65 vota janë. Atëherë, në ora 14:30 kthehemi në sallë dhe fillojmë me seancën...

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, po e fillojmë pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Për këtë çështje ftoj deputetin Veton Berisha, që në emër të Komisionit FunkSIONAL ta arsyetojë raportin me rekomandime.

VETON BERISHA: I nderuar nënkryetar Haliti,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mungesë të ministrave duhet të jap një raport, i cili për nga koha ka dy vjet që jemi marrë me këtë raport dhe vërtet, do të ishte e dëshirueshme që të jenë prezentë, sidomos ato dikastere ku kjo fushë është e rëndësishme për ta, në veçanti Ministria e Administratës Publike do të duhej të ishte këtu prezent.

Sido që të jetë, unë duke kërkuar mirëkuptimin dhe vëmendjen tuaj dhe duke treguar që nga këtu, që për të qenë komunitet pakicë në Kosovë nuk është privilegj, e dëshmon më së miri ky raport, që do të prezantohet para jush.

I autorizuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe si kryesues i Grupit për monitorimin e nenit 11 të Ligjit për shërbimin civil, më lejoni që para jush të prezantoj raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit me nr. 03/L-149 për Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, i cili nen thotë se në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror, minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit.

Ndërsa, në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.

Të nderuar deputetë,

Ky nen bazën e referencës e ka në nenin 61, pika 1 dhe nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, domethënë e ka një bazë kushtetuese. Duke u bazuar në rregullën 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, në kuadër të përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit, planit të punës për vitin 2016, ka bërë mbikëqyrjen e këtij neni me qëllim të përcaktimit të shkallës së zbatimit të këtij neni në praktikë, përkitazi me çështjen e pranimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Kosovës.

Me këtë rast falënderoj për kontributin anëtarët e Komisionit për Interesa të Komuniteteve, të cilët dhanë një kontribut të çmuar në nxjerrjen e këtij raporti. Gjithashtu, falënderoj edhe organizatën KDI, OSBE dhe të gjitha organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, që na ndihmuan në daljen e këtij raporti.

Pra, qëllimi është vlerësimi i gjendjes momentale mbi përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në shërbimet e administratës publike dhe që institucioneve relevante t'u paraqesë argumente për çështjen e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve në sektorin publik, në nivelin qendror dhe lokal.

Ky raport analizon të dhëna statistikore në krahasim me kushtet ligjore, në mënyrë që të përcaktohet se a është duke u zbatuar parimi ligjor nga ana e institucioneve të pushtetit të paraqesë konstatime dhe përfundime të rëndësishme, të paraqesë disa rekomandime institucioneve kompetente, me qëllim të marrjes së masave pozitive për ngritjen e shkallës së punësimit të komuniteteve jo shumicë në shërbimet e administratës publike.

Në hulumtim të këtij raporti janë përdorur të gjitha veprimet e nevojshme, duke siguruar të dhëna zyrtare nga Ministria e Administratës Publike, për 51 institucione publike, për të punësuarit e komuniteteve jo shumicë, në nxjerrjen e interpretimeve juridike, mbajtjen e dëgjimeve publike dhe prezencë të ministrave në komision për veprime të tjera.

Përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë në nivelin qendror

Në bazë të të dhënave preliminare të statistikave zyrtare, që ka grumbulluar MAP për vitin 2015, numri i nëpunësve civilë të punësuar në 51 institucione qendrore të Shërbimit Civil arrin 6,24%, çka do të thotë se përqindja e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë është nën nivelin e shkallës prej 3,76% nga pragu i përcaktuar ligjor prej 10%.

Nga numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë të punësuar në nivelin qendror në shërbimin civil shqiptarë janë 11,595, apo 93,76%, serbë 455, apo 3,67%, boshnjakë 129, apo 1,04%, turq 134, apo 1,08%, goranë 18, apo 0,14%, ashkali 9, apo 0,07%, romë 17, apo 0,13%, egjiptianë 4, apo 0,03%, të tjerë 6, apo 0,04%.

Nga statistikat e prezantuara dhe analizat e kryera del se numri i përgjithshëm prej 51 institucioneve sa kanë raportuar numrin e të punësuarve, 15 institucione të nivelit qendror nuk kanë të punësuar asnjë pjesëtar të komuniteteve joshumicë, ndërsa një numër prej 6 institucioneve kanë të punësuar nga 1 apo 2 pjesëtarë të komuniteteve joshumicë.

Pothuajse të gjitha ministritë dhe agjencitë ekzekutive janë me përfaqësim nën 10% të komuniteteve joshumicë.

Nga të gjitha institucionet, një numër krejtësisht i vogël i institucioneve qendrore ka arritur prapun e kërkuar ligjor të përfaqësimit drejt dhe proporcional prej 10%, dhe atë kryesisht me komunitetin serb.

Si përfundim. Nëse nisemi nga sqarimet dhe rëndësia e nenit 11, Ligji për shërbyesit civilë dhe kuotës së përcaktuar prej 10%, në raport me përbërjen e popullsisë, komunitetet joshumicë, egjiptianët, romët, ashkalitë dhe goranët, edhe më tutje nuk janë të përfaqësuar në masën e duhur, apo nuk janë të përfaqësuar fare.

Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në nivelin lokal, siç është theksuar edhe më parë, me qëllim të zbatimit të nenit 11 të Ligjit për shërbyesit civilë dhe Rregullorja 04/2010 për veprimet e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, komunat janë të detyruara të sigurojnë një shërbim civil, i cili përfaqëson përbërjen etnike të banorëve të tyre.

Duke u nisur nga numri i raportit të të punësuarve në nivel të pushtetit lokal, pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë në qeverinë lokale arrin përqindjen 16.83%, por kjo përqindje është e llogaritur në numrin e të punësuarve të komunitetit serb në komunat me shumicë serbe.

Në nivel të pushtetit lokal, komunal, përfshirë këtu 38 komuna, janë të punësuar gjithsej 6 679 nëpunës civilë. Nga ky numër shqiptarë janë 5 556, apo 83,17%, serbë 855, apo 12,8%, boshnjakë 130, apo 1,94%, turq 80, apo 1,2%, goranë 7, apo 0,10%, ashkali 21, apo 0,30%, egjiptianë 8, apo 0,12%, romë 16 apo 0,24% dhe të tjerë 6, apo 0,09%.

Është konstatuar shkallë e ulët e zbatimit të nenit 5 të Rregullores 04/2010 mbi përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin shtetëror, në pozitat funksionale.

Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në nivelin qendror MAP për zbatimin e nenit 11 të ligjit ka nxjerrë Rregulloren 04/2010 për përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin shtetëror.

Për zbatimin e nenit 5 të Rregullores parashihet që institucionet, si në nivelin qendror, ashtu edhe atë lokal, të ndërmarrin veprime dhe masa aktive për punësimin me qëllim të përmirësimit të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë.

Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në nivelin lokal, veprime të cilat duhet të zbatohen në nivelin lokal, përveç numrit të përgjithshëm të vendeve të rezervuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me përfaqësimin proporcional të komuniteteve, komunat përkatëse, njëkohësisht kërkohet që në përputhje me përqindjen e vendeve të punës brenda kornizave funksionale të kategorive të jenë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve.

Është konstatuar po ashtu se një numër shumë i vogël i institucioneve kanë mbajtur evidencë lidhur me atë se cilit komunitet i takojnë kandidatët, prandaj ekziston një problem i identitetit në përfaqësim të rrejshëm.

Të gjitha institucionet janë të detyruara të grumbullojnë të dhëna lidhur me aplikacionet për punë sa i përket përkatësisë nacionale të komuniteteve dhe të punësuarve, me qëllim të përcjelljes së raportimit apo grumbullimit të të dhënave të tilla, e gjerë më tani nuk ka qenë e mundur.

Përfundim. Duke i pasur parasysh gjetjet e grumbulluara, Komisioni ka arritur te ky përfundim pas këtij hulumtimi.

Duke pasur parasysh gjetjet e grumbulluara, drejtimet me shkrim në institucione, hulumtimet e realizuara parlamentare, numrin e dëgjimeve publike si dhe raportimet e ministrave dhe të

autoriteteve të tjera, grupi punues ka arritur të bëjë identifikimin e çështjeve të theksuara si probleme për zbatimin e ligjit, i cili rregullon fushën dhe problematikën e punësimit të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në bazë të problemeve të identifikuara, grupi ka arritur në përfundim se neni 11 i Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës është i zbatueshëm me disa pengesa të caktuara, për të cilat duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes aktuale.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji dhe rritjes së përgjegjësisë institucionale, propozohen këto:

R e k o m a n d i m e

1. Të implementohet në tërësi neni 11 i Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës nga të gjithë mekanizmat e implementimit të ligjit, në të gjitha nivelet, duke siguruar përfaqësim të drejtë dhe proporcional të të gjitha komuniteteve joshumicë në Kosovë, në nivel qendror dhe lokal, ku secili institucion duhet të ndërmarrë masa aktive dhe të veprojë në përputhje me frymën e ligjit për gjithëpërfshirje dhe të ndërmerren masa proaktive të bazuara me Rregulloren 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

2. Që Qeveria, përkatësisht Ministria e Shërbimeve Publike sa më parë të krijojë bazën e të dhënave me numrin e të punësuarve në mesin e tyre të dhënave të veçanta për strukturën etnike të të punësuarve në shërbimin civil. Njëkohësisht rekomandohet krijimi i sistemit elektronik për menaxhimin e resurseve njerëzore, meqë dosjet elektronike sigurojnë të dhëna reale të të punësuarve, me rastin e deklarimit të përkatësisë etnike si dhe përfaqësimit të rekrutimit të shërbyesve civilë në Administratën Publike.

3. Të gjithë të punësuarit aktualë në shërbimin civil janë të angazhuar mbi bazën e kuotës për komunitetet joshumicë në Kosovë dhe kandidatët, të cilët aplikojnë në pozitat e nëpunësve civilë në kuadër të kuotave për komunitetet joshumicë nga institucioni përkatës, të verifikohen dokumentet personale nga Enti i Statistikave të Kosovës dhe në bazë të të dhënave të siguruara nga regjistrimi i fundit i popullsisë për vitin 2011, ku secilit i figuron deklarimi i përkatësisë etnike.

4. Të verifikohen të gjitha vendet e lira në Administratën Publike dhe të merret qëndrim që ato të rezervohen për plotësimin e vendeve nga komunitetet joshumicë, në radhë të parë të plotësohen me komunitetet e nënpërfaqësuar dhe të krijohen masa rekrutimi, në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë. Bazuar në hulumtimin parlamentar, të

dhënat zyrtare dhe statistikat e prezantuara në raport, rezulton se komunitetet joshumicë egjiptian, ashkali, rom dhe goran janë të nënpërfaqësuara në proporcion me numrin e popullsisë.

5. Të angazhohet Këshilli i Pavarur i Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të vlerësojë gjendjen e implementimit të Kushtetutës, ligjit dhe udhëzimeve administrative, përfaqësimin proporcional të komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës dhe të rekomandojë dhe të obligojë masa shtesë për gjithëpërfshirje dhe përfaqësim proporcional në Administratën Publike për komunitetet joshumicë.

6. Të krijohet një mekanizëm qendror unik, i cili do të monitorojë, propozojë dhe vendosë ndërmarrjen e hapave konkretë për krijimin e mekanizmave, të cilët do të implementojnë me përpikëri detyrimet ligjore të Qeverisë së Kosovës për përfaqësim të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Kosovës.

7. Të raportohet nga secili institucion qendror dhe lokal mbi bazat e rregullta kohore të parapara me ligj dhe rregullore mbi ndërmarrjen e masave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani, le ta përfundojë!

VETON BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Është raport dyvjetor, kështu që është pak më i gjatë.

8. Të raportohet nga secili institucion qendror dhe lokal mbi baza të rregullta kohore të parapara me ligj dhe Rregulloren mbi ndërmarrjen e masave aktive dhe përmbushjen e obligimeve ligjore për përfaqësim të komuniteteve joshumicë dhe këto të dhëna të kenë qasje publike.

9. Që Qeveria e Republikës së Kosovës, në harmoni me kompetencat e veta, të nxjerrë masa të veçanta dhe të parashohë mjetet shtesë buxhetore për realizmin e kuotës minimale të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Kosovës.

Në komision e kemi pasur përkrahjen e të gjitha grupeve parlamentare, andaj kolegë deputetë, ju ftoj dhe bëj thirrje që ta përkrahni këtë raport dhe t'i votoni rekomandimet e propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Radha është e kryetarëve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsedniče Parlamenta!

Poslanici Parlamentarne grupe PDK-a u potpunosti podržavaju izveštaj Komisije za prava i interes zajednice, odnosno izveštaj sa preporukama o nadgledanju i sprovođenja člana 11 Zakona o civilnoj službi Republike Kosova.

Bazirajući se na Ustav Republike Kosova, zakon broj 03/L-0149 o civilnoj službi Republike Kosova, Zakon broj 03/L-047 o zaštiti i promovisanja prava zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosovo, Zakon protiv diskriminacije 2004/3 koji je stupio na snazi Uredba 12. 2. 2004 godine, kao i Uredba broj 04/2010 o postupcima pravične i srazmerne zastupljenosti nevećinskih zajednica u Javnoj službi Republike Kosova, u potpunosti podržavamo Izveštaj o nadgledanju sprovođenja člana 11 Zakona broj 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, čiji je cilj sprovođenje u praksi ovog zakona, kako bi smo dobili dovoljan broj podataka o pravilnom programu Vlade i njenih obaveza prema nevećinskih zajednica.

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Predstavnici međunarodnih organizacija,

17 godina posle rata i dalje je jako zabrinjavajući fenomen niske primene člana 5 Uredbe broj 04/2010 o pravičnoj i proporcionalnoj zastupljenosti nevećinskih zajednica u državnoj službi na funkcionalnim pozicijama, postupci koji bi trebalo da se primene na centralnom ali i lokalnom nivou, sem ukupnog srazmernog broja za rezervisana mesta gde svaka institucija treba da ispuni uslov od 10% i sprovede najmanje 1 od 5 navedenih kategorija za zapošljavanja nevećinskih zajednica na centralnom nivou mislim na državne službenike visokog rukovodećeg nivoa na državne službenike rukovodećeg nivoa, državne službenike stručnog nivoa, kao i državne službenike tehničko-administrativnog nivoa.

Kada govorimo o zastupljenosti nevećinskih zajednica, zahtevamo precizne podatke o etničkoj pripadnosti zajednicama koji pripadaju kandidati, odnosno njihovo lažno predstavljanje nacionalnog identiteta dugih niz godina.

Zahtevamo bazu podataka svih zaposlenih u civilnoj službi koji su angažovani na osnovu kvote za nevećinske zajednice, da se provere lični dokumenti iz Zavoda za statistiku Kosova na osnovu ličnih podataka koji su dobijeni tokom poslednjeg popisa stanovništva 2011 godine, gde svakome figuriše izjašnjavanje o njegovoj etničkoj pripadnosti, ali i da naša Vlada Republike Kosova u skladu sa vojim nadležnostima donese posebne mere i predvidi dodatne budžetska sredstva za ispunjenje minimalne kvote zaposlenosti pripadnika nevećinskih zajednica u civilnoj službi na centralnom i lokalnom nivou.

Što se tiče zastupljenosti nevećinskih zajednica na lokalnom nivou, osim ukupnog procenta za rezervisana mesta, koji treba da odgovara proporcionalnoj zastupljenosti zajednica po opštinama,

tražimo i srazmeran procenat novih radnih mesta, odnosno samo zahtevamo da se poštuje Ustav odnosno Zakon o zaposlenosti nevećinskih zajednica u javnim institucijama.

Parlamentarna grupa PDK, odnosno poslanici ispred redova PDK-a podržavaju ovaj izveštaj i predlažu Parlamentu za njegovo usvajanje. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga LDK s'ka të paraqitur, për faktin që besoj Berisha e ka bërë, ose Kymete Bytyqi u paraqit, nëse doni. Zonja Bytyqi e ka fjalën.

KYMETE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, për Kthim, çka ka të bëjë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, pra të nenit 11 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje” janë dy të paraqitur. Fjalën e ka zonja Puhije Demaku.

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje” i ndan shqetësimet që janë paraqitur në këtë raport bashkë edhe me përfaqësuesin, i cili e prezantoi me zotin Veton Berisha, natyrisht duke shpresuar se këto rekomandime që janë dhënë nga ky raport të mos mbesin rekomandime në letër, por të zbatohen, dhe do t'i mbështesim rekomandimet si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar me kujdes raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe vërtet të gjitha ato të gjetura që janë në raport dhe ato rekomandime, ne do t'i përkrahim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”!

MUFERA ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Sivil Hizmetler Yasası hakkında Topluluklar Hak ve Çıkarları çalışma grubu başkanının sunmuş olduğu rapor verilerini tekrarlamamak şartiyle, Sivil Hizmetler Yasasının 11. Maddesine göre çoğunlukta olmayan topluluklara ayrılmış yüzde 10 istihdam oranının çığnendiğini görmekteyiz.

Topluluk Hak ve Çıkarlar Komisyonunda yaptığımız çalışmalar doğrultusunda ve günlük yaşamımızdan bu konuda toplulukların bu yüzdelikten tamamıyla yararlanamamakta olduklarını görmekteyiz.

Resmi Raporlara bakıldığında yüzde 10'nun üzerinde bir oran sunulmaktadır. Milli mensubiyetini yalan yanlış evraklarla belgeleyenlerin inandırıcı olmayan bu raporun yüzdelikteki sayıların üzerine isim listesini komisyondan talep etmişsinizdir. Bu listeye göre her çalışanın milli mensubiyetini belirttikten sonra gerçek bir tablonun ortaya çıkacağına inanmaktayız.

Kağıtta kalmayarak yürürlüğe geçeceğini inandığımız bu Raporu 6+ Parlamanto Grubu olarak desteklemekteyiz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, zoti kryesues!

“Nisma” e ka trajtuar raportin dhe njëkohësisht e mbështesim raportin dhe rekomandimet e paraqitura nga zoti Veton Berisha dhe kërkojmë që këto çështje të realizohen sipas parashikimit të ligjit, e veçmas që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë ashkali, rom, egjiptian, goran dhe turk dhe kërkojmë që këto të zbatohen në përpikëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qerim Bajrami e ka fjalën.

QERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Republike Kosova,

Ja kao član Radne grupe, odnosno kao član Komisije za zajednice, mogu samo da izrazim svoju zahvalnost i onome koji je prezentirao ovaj izveštaj u kome smo učestvovali gotovo u svako slovo tokom nejdovog donošenja, a također se zahvaljujem svim članovima Komisije ispred većinskog Albanskog naroda koji su dali konstruktivan doprinos da se ovaj izveštaj privede kraju, bez obzira na momentalno nepristvo poslanika ispred Srpske zajednice u Komisiji i u Radnoj grupi.

Zahvaljujem se također svim predstavnicima parlamentarnih grupa koje su izrazile podršku ovom izveštaju i za koga će verovatno doći do glasanja.

Ono što želim ovom prilikom da posebno naglasim jeste da bez obzira na odredbe Zakona koji predviđa da 10% minimalno zapošljene u administraciji na centralnom i lokalnim nivoima bude od strane pripadnika nevećinskih zajednica. Dakle, imamo ovaj po meni katastrofalan podatak da imamo 6,20 i nekoliko procenata samo zapošljenih na centralnom nivou.

Od toga, odmah da naglasim, jedan fenomen koji je takođe u izveštaju podvučen, a to je da nažalost mi predstavnici Bošnjaka, a verovatno i Roma, Aškalije a Egipćana pogotovo imamo dodatni fenomen, a to je lažno zaposlenih ljudi u administraciji koji su se predstavljali tokom zapošljavanja kao Bošnjaci, Romi, Aškalije, Egipćani i tako dalje.

Ovaj fenomen u perspektivi mi očekujemo i ja njih pozivam javno odavde i upućujem im apel kako god hoće, da se sada prevedu, dakle kao pripadnici većinske zajednice i da oslobode ta mesta za pripadnike nevećinske zajednice, tim prije što niko od njih zbog toga biti otpušteni sa posla. Možda su ti ljudi u među vreme i avancovali, postali nešto važni u administraciji i tako dalje, i oni neće izgubiti svoje pozicije, ali ćemo mi mnogo dobiti ako oni oslobode ta mjesta.

U svakom slučaju, da ne bi čekali na njihovu milost ili ne milost, mi pozivamo odmah ministra administracije da preduzme obećano, a to je da formira što prije bazu podataka sa brojem zapošljenih i njihovim imenima i pozicijama.

Ovde također, gospodine predsedavajući Skpštine, želim da naglasim jednu važnu stvar. Veoma često u ministarstvima kada pitate ljude – koliko imate zapošljenih? Oni kažu, evo imamo 5-6 i ispunjavamo kvotu za nevećinske zajednice.

Međutim ti zapošljeni su u glavnom na veoma niskim pozicijama ili, da ne vređam nikoga, kao čistači. Dakle ispada da su nevećinske zajednice ovde, i mi njihovi predstavnici sa time se ponižavamo, jer ispada da među našim zajednicama nema dovoljno kvalificiranih ljudi za vodeća ili rukovodeća mjesta.

Dakle, struktura zapošljenih je takođe katastrofalna. I ono što želim ovde da naglasim a da smo u međuvreme raščistili i sa ministarstvom i sa nezavisnom komisijom za administraciju a to je da nikako ne može da se povezuje administracija na lokalnim nivoima i administracija na centralnim nivoima, iz prostog razloga što u nekim opštinama ima možda i više zaposlenih nekih pripadnika nevećinskih zajednica zato što su oni prisutni u toj opštini, i oni ne mogu se brojiti, dakle ne mogu sabirati babe i žabe ni u kom slučaju, jer u mnogim opštinama sada idamo administraciju uglavnom od pripadnika Srpskog zajednice. Imamo 10 opština gde je administracija na lokalnu uglavnom od pripadnika Srpske zajednice. Dakle 10 opština sa Srpskom zajednicom.

Prema tome, nemožemo dakle te dve stavke sabirati i da ovde također napomenem ako ima preko 10% procenata na lokalnu, tu zakon nije prekršen jer iz prostog razloga zakon predviđa minimum 10%, a ne kažem maksimum koliki.

Također u ovom pravcu želim da naglasim nekoliko stvari koje smo u izveštaju također naglasili a to je da tražimo dodatna sredstva u budžetu Republike Kosova, dakle za sva ministarstva za dodatno zapošljavanje pripadnika nevećinske zajednice.

Ova Vlada Kosova mora da uzme veoma ozbiljno i već na predstojećem rebalancu budžeta da predvidi ta sredstva.

Također zahtevamo da Vlada aktivira svoju međuministarsku komisiju koja treba veoma ozbiljno da uzme ovaj naš izveštaj i da poradi na njemu, odnosno da predlaže konkretne mehanizme i poteze Vladi da bi mogla da realizuje ove naše preporuke.

U ovom pravcu također ja pozivam ovde da svakog ministarstva u ministarstvima koje rukovodi, ako trenutno nema dovoljan broj zapošljenih pripadnika nevećinskih zajednica da neće kao ove korake nego da odmah preduzme konkretne stvari i da zaposli po nekog pripadnika ispred nevećinske zajednice.

Također pozivam ministre, s obzirom da smo mi pozicija, dakle vladajuća pozicija, da one službenike koji imaju sve kvalifikacije unutar ministarstva, unutrašnjim konkursima, odnosno unutrašnjim preusmeravanjem kadrova postave na neka rukovodeća i odgovorna mjesta.

U ovom pravcu mi ćemo, dakle sva ministarstva i dalje kao komisija obilaziti i tražiti da ovo sprovedu.

Također, s obzirom da nemamo ovde predsednika Skupštine, ali imamo vas uvaženog potpredsednika koji ste dugo godina ovde, u ovom Parlamentu, i potpredsednik ste Parlamenta, ne vidim ovde gospodina Sabri Hamitija jer i on je u više mandata i on drugi potpredsednik i tako dalje, tražimo od vas da i vi sprovedete ovo ida u Skupštini pogledate kakav je sastav administracije i konačno počnete sa zapošljavanjem nekih od pripadnika nevećinskih zajednica.

U ovom pravcu, ja sve poslanike još jednom pozivam da glasaju za ovaj izveštaj i da preuzmu jedan dio odgovornosti za sprovođenje ovog izveštaja, jer nama će najbolje biti ako poslanici većinske zajednice i ministri većinske zajednice preuzmu adekvatnu brigu za nas, a ne prebacivaju na našu stranu. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zakonisht kur është fjala për pikat e ndjeshme të rendit të ditës ka shumë diskutues dhe po habitem që në këtë çështje, të kësaj pike të rendit të ditës, numri është kaq i vogël.

Unë desha të shpreh pajtueshmërinë time sa i përket pikës që është shtruar për diskutim dhe, në të njëjtën kohë, të shpreh mbi të gjitha shqetësimin tim për diskriminimin që i bëhet komuniteteve rom, egjiptian e ashkali, pa përjashtuar komunitetet e tjera, por mbi të gjitha këtyre komuniteteve u bëhet një diskriminim jashtëzakonisht i madh në politikën e punësimit, të shkollimit, e kështu me radhë.

Desha të ndaj me ju edhe një përvojë që e kam bërë në Zvicër, pikërisht për faktin se çka do të thotë të jesh pjesë e një minoriteti. Unë kam jetuar në një lagje në të cilën kam pasur fqinj të parë pjesëtarë të minoritetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe zakonisht mbaj mend kohën kur kam jetuar gjatë moshës 18-vjeçare dhe është thënë se ata nuk duan të integrohen, ata nuk duan të mësojnë, është pjesë e kulturës së tyre, ata vjedhin, e kështu me radhë.

Të njëjtat akuza i kanë përjetuar në Zvicër karshi komunitetit shqiptar. Është thënë që shqiptarët nuk duan të integrohen, nuk duan të punojnë, nuk duan të shkollohen, është pjesë e kulturës së tyre dhe kjo më çon te bindja që popullsia shumicë është ajo e cila ka për detyrë integrimin e minoriteteve dhe popullsi shumicë është ajo që përcakton se cila do të jetë politika ndaj minoriteteve.

Unë i thërras të gjithë deputetët që t'i votojnë propozimet dhe i ftoj, sidomos përfaqësuesit e minoriteteve të jenë më të zëshëm sa i përket mbrojtjes së drejtave të tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë mendoj se shqetësimet e ngritura lidhur me angazhimin e punonjësve civilë të minoriteteve nganjëherë me dashje apo mos dashje po u japim një hapësirë, e cila nuk na obligon nga aspekti kushtetues në nivelet e ministrave. Ne këtu i kemi disa ministra të minoriteteve, largo këta të Listës serbe, të cilët i kemi sjellë vetë apo na janë imponuar, por kemi edhe ministra të tjerë, për shembull, Rasim Demiri që është pa portofol, ne nuk e dimë çka punon. Më mirë është dhe ka të drejtë deputeti kur thotë se në administratën civile është më mirë që ministri të mos jetë me portofol e pa portofol, por në proporcionalitet të mundshëm të angazhohen minoritetet dhe t'u plotësohen vendet e punës edhe me angazhime. Ose zoti Yagcilar që është në Administratën Publike, që disa vjet ministër dhe ka vërejtje mu në cilësinë dhe performansën e administratës publike në shumë divizione.

Prandaj, ne nganjëherë po u japim më shumë të drejtë minoriteteve në pozicione të cilat nuk duhet t'u japim, por duhet t'i ofrojmë në pozicione ku gjejnë afirmim, por jo afirmim fiktiv. Dhe këto që i kemi sistemuar, për atë kjo Qeveri edhe në kërkesën e riformatizimit, zoti nënkryetar, e cila është imperativ edhe vendor, edhe ndërkombëtar nuk është në gjendje të bëjë as riformatizim cilësor e as sasior, edhe në administratë ka ngecje.

Ka vërejtje serioze, prandaj ne si Parlament duhet të marrim qëndrim për ta miratuar këtë material, por ne duhet seriozisht të ulemi e të studiojmë dhe bëjmë rekomandimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Muja! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë vetëm 40 deputetë dhe nuk mund të procedojmë për ta votuar, e lëmë për momentin kur ka kuorum.

Tani i kemi edhe 4 pika të rendit të ditës, që janë: 18. *Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera*; 19. *Zgjedhja e një anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave*; 20. *Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për liritë fetare* (Kjo duhet të hiqet prej rendit të ditës, për shkak se nuk funksionon votimi deri sa të rikthehen deputetët serbë në Kuvend); 21. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor* (këtu duhen 2/3 e votave); 22. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e zyrës rajonale për bashkëpunim rinor në mes të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë* (edhe këtu na duhen 2/3 e votave); 23. *Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serb*.

Të gjitha janë votime, një pjesë kërkojnë 2/3 dhe një pjesë që kërkojnë kuorum për të votuar.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar kolegë, ju kisha lutur për pak vëmendje, sepse mungesa e kuorumit po na detyron të zgjidhim probleme me konsensus, në njëfarë forme dhe, meqenëse për pikat 18 dhe 19 ende nuk është bërë kuorumi, siç nuk patëm mundësi as ta votonim raportin e mëparshëm, kemi dy kërkesa, të dy ministrive. Njëra e Ministrisë së Kulturës, ministri është këtu, sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes dhe themelimin e zyrës rajonale për bashkëpunim rinor në mes të Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë dhe pika 21 është Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Të dy këto pika të rendit të ditës kërkojnë votimin nga 2/3 të deputetëve.

Tani kërkesa e ministrive, po e marr rolin e kërkuesit ose të sqaruesit, sepse duhet dalë në foltore dhe vetë ta sqarojmë ose të kërkojë dikush mocion, është që të debatojmë sa u përket këtyre dy pikave dhe t'i votojmë në momentin kur të krijohen kushtet.

Deri tani i kemi 60 deputetë në sallë, sikur të vinte edhe 1, do të kishim mundësi që të futemi në proces të votimit. Përndryshe, mendoj se nesër në orën 10:00 duhet të vazhdojmë seancën vetëm me votime.

Prandaj, meqenëse i kemi vetëm votimet dhe këto dy pika janë edhe për debat dhe për vota, mendoj se do të ishte mirë të fillojmë me pikën e 22-të të rendit të ditës, e pastaj të vazhdojmë me pikën 21 kur të vijë ministri Hoxhaj.

Besoj se s'jeni kundër këtij propozimi? Ka kundër, zonja Demaku e ka fjalën.

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Meqë unë jam përgatitur të flas edhe për pikën 21, e cila është një marrëveshje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe në të njëjtën kohë jashtëzakonisht e dëmshme për Kosovën, konsideroj se debati nuk duhet të ndahet nga votimi, sepse kur po kalon një debat shumë i ashpër, mbase edhe shumë i rëndësishëm e po harrohet çfarë është thënë në debat, deputetët disi po i ikin përgjegjësisë dhe po marrin lirinë që votimin ta bëjnë krejtësisht ndryshe karshi deklarimeve pra që po i bëjmë në debat.

Prandaj, posaçërisht për ratifikimin e një marrëveshjeje, siç është kjo për Fondin e Ballkanit Perëndimor, jemi absolutisht kundër si grup parlamentar që të bëhet ndaras debati dhe ndaras votimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën, për procedurë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe unë jam kundër që të bëhet ndaras debati dhe ndaras votimi, sepse le të dihet që secili deputet çfarë flet dhe çfarë voton, sepse edhe ne nuk jemi ‘badihavxhinj’ që rrimë gjithë ditën në seancë.

Është mirë që të ketë një respekt së pari ndaj vetvetes, si deputetë që jemi në sallë gjatë gjithë kohës dhe, thjesht kërkoj që debati të bëhet bashkë me votimin në të njëjtën ditë. Pra, nëse vendoset sot, ftoni deputetët të vijnë dhe nëse vendoset për ditën tjetër le të shtyhet edhe votimi, edhe debati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Gjithashtu edhe ne mendojmë se secila marrëveshje është e rëndësishme së vet, por të ndahet votimi dhe debati nuk bën. Duke pasur parasysh edhe numrin e votave që kërkohen për aprovimin e marrëveshjeve, prandaj le të mbeten bashkërisht, pra edhe votimi, edhe diskutimi, sepse duhet të diskutohen shumë çështje dhe të mos kalojnë shkel e shko dhe pastaj të akuzohet dikush se vërtet nuk po voton në interes të vendit. Pra, duhet të tregohen nganjëherë edhe të mirat, edhe dëmet që vijnë dhe marrëveshjet që na i sjellin këtu.

Prandaj, edhe ne mendojmë që bashkërisht edhe votimi, edhe debati të shkojnë paralel.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë po ashtu pajtohem me këto që u thanë, duke mos dashur t'i përsëris. Unë kisha pasur një kërkesë specifike, pra nëse sot nuk bëhet kuorumi, ne nesër edhe ashtu e kemi seancën solemne, mund ta caktojmë më herët, të vijmë në seancë dhe vazhdojmë këtë pikë edhe me debat, edhe me votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, e ke fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Gjithmonë është parimore që deputetët të jenë të pranishëm kur debatohen, qoftë projektligje e ligje dhe akte të tjera që i miraton Kuvendi. Por unë nuk e shoh të arsyeshme që tash të bllokohet puna pese prania e deputetëve nuk është në votën e kërkuar që duhet të jenë 2/3 të Kuvendit.

Besoj se temat trajtohen sipas interesit, por edhe dëgjohen sipas interesit që e kanë deputetët, ndërsa nuk mund të kushtëzohen me praninë e tyre në kohën e votës: nuk ke qenë pjesë e debatit dhe tash ti do të vendosësh apo nuk do të vendosësh për votën.

Prandaj, debati mund të zhvillohet, deputetët që kanë interes mund të kyçen në diskutime, por edhe ata tjerët të dëgjojnë. Për votë, dihet, është votë kushtetuese dhe kërkohet vota e kualifikuar. Prandaj unë mendoj që debati për këto dy pika të zhvillohet sipas agjendës, sepse ne vetëm jemi duke e shtyrë dhe kështu duke u shtyrë është bërë edhe ngarkesa e pikave të rendit të ditës dhe i kemi diku 30 pika të rendit të ditës për këtë seancë plenare, e cila që tri ditë apo tri herë është duke vazhduar.

Pra, ju kisha lutur që të jemi më racionalë, ata që kanë interes dhe gatishmëri të debatojnë, të kontribuojnë, të japin vërejtjet apo edhe përkrahjen e tyre, kurse vota është e domosdoshme dhe është me 2/3 e votave në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hoxhaj e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Shumë të respektuar kolegë deputetë,

Unë nuk e kam ndërmend të flas për atë se si vendos Kuvendi, a hyn sot në debat apo jo? E kam ndërmend që edhe zoti Shala dhe unë t'i prezantojmë të dy marrëveshjet ndërkombëtare, qoftë në këtë seancë, qoftë në një seancë tjetër dhe t'ju lus të gjithëve, edhe partive që janë në koalicion në Qeveri dhe partive që janë në opozitë, edhe "Vetëvendosjen", edhe AAK-në dhe "Nismën" që këto dy marrëveshje për herë të parë i themelojnë dy organizata ndërkombëtare rajonale, të cilat vendosen në Tiranë. Dhe, ne kemi apel prej Tiranës që deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i votojnë dy organizata, të cilat selinë do ta kenë në Tiranë.

Edhe unë personalisht kam pasur hezitime për Fondin e Ballkanit Perëndimor, para 4-5 vjetësh. Kemi pasur debate të gjera dhe të gjata me zotin Shtefan Fylle, kemi pasur debate në atë kohë edhe me zonjën Eshton dhe unë nuk jam në favor të asaj që të ketë ndonjë rishpikje apo shpikje të ndonjë neosfere jugosllave apo të ndonjë neojugosllavizmi. Por në të njëjtën kohë dua ta ftoj çdo deputet të Kuvendit të Kosovës dhe të gjitha partive politike, të gjitha grupeve etnike, është absurde që Kuvendi i Kosovës të jetë i fundit, i fundit, i fundit në rajon, kur krejt parlamentet e të gjitha vendeve të rajonit kanë votuar për vendosjen e këtyre dy organizatave në Tiranë.

Po ju them, shumë miqësisht, edhe presidenti Nishani, edhe kryeministri Rama, edhe ministri Bushati, edhe kolegët e tjerë të Qeverisë së Shqipërisë kanë apeluar disa herë dhe ju kisha lutur, para se të hyjmë në debat, që thjesht ta sigurojmë një mbështetje paraprake dhe i kisha lutur edhe partitë e opozitës që të votojnë me votën tyre, meqë janë organizatat e para ndërkombëtare, të cilat në historinë e shtetit shqiptar do ta kenë selinë në Tiranë. Sikurse ne mund ta kemi një situatë, çka po bëjmë përpjekje aktualisht të marrim një lloj traktati të transportit dhe ta vendosim me seli në Prishtinë dhe nëse ne sillemi në këtë mënyrë, mund të them se shtetet e tjera të rajonit në të ardhmen mund të na bllokojnë për aspekte përmbajtjesore edhe të Fondit të Ballkanit Perëndimor, edhe të Organizatës RAIKO, që nënkupton rrjetet rinore.

Unë jam i gatshëm të debatojmë, jam i gatshëm që të vij në komisione që t'ju informoj. Jam i gatshëm të vij në çdo grup parlamentar, por nuk e ndiej veten mirë si anëtar i Qeverisë nëse ky Kuvend në pafundësi, dy organizatave, të cilat do të duhej të vendosen në Tiranë, nuk ua mundësojmë që ta kenë selinë atje. Prandaj, ju apeloj të gjithëve që kësaj here, nëse e keni një dashuri për Shqipërinë, prej tërë anëve, të djathtës e të majtës, ta dëshmoni me votë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe zoti Shala.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Tani unë do ta kisha, për lehtësi të funksionimit, sepse edhe unë pajtohem që të plotësohen kushtet kushtetuese dhe sot për këtë projektligj të debatohet duhet të jenë të pranishëm 2/3 e deputetëve në sallë. Unë pajtohem që të presim radhën e të debatohet e të votohet kur të plotësohen kushtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demaku e ka fjalën.

PUHIJE DEMAKU: Unë desha të pyes ministrin, me këtë rast ministrin Hoxhaj, a po e tërhiqni, pra, fjalën që i keni thënë zotit Rama që të mos përzihet në punët e Kosovës kur ka qenë në Beograd? Dhe, në këtë rast, unë konsideroj se u keqpërdor foltorja e Kuvendit për të startuar debati në një kohë kur ne po flasim se a duhet debati të mbahet apo jo bashkë me votimin dhe njëkohësisht atyre që konsiderojnë se bën të ndahen këto të dyja, unë ju kisha kujtuar që klauzola që kërkon 2/3 e votave nuk është enkas vetëm për votat. Është, sepse këto marrëveshje janë të

një rëndësie të veçantë, ku kërkohen edhe 2/3 e njerëzve që debatojnë për një rëndësi të veçantë të një çështjeje. Prandaj, edhe duhet të jenë të bashkuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, sipas procedurës, ne duhet ta fusim në votim kalimin e pikave të rendit të ditës dhe me sa po shoh, është vështirë të pajtohemi. Unë i kisha lutur deputetët që nesër në orën 10:00 të vazhdojmë seancën dhe të vijmë të gjithë kolegët, të kemi kuorum dhe t'i votojmë të gjitha çështjet. Në orën 15:00 kemi seancë solemne, kështu që na merr shumë kohë debati, sepse janë tema për të cilat njerëzit do të diskutojnë.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, nuk ka seancë nesër në orën 10:00. Për mbledhjen tjetër ju lajmërojmë pas mbledhjes së Kryesisë, për vazhdimin e seancës, sepse nesër fillojnë vizitat dhe dyshoj se mund të bëjmë kuorum për të votuar.

* * *

E hënë, 27 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 9-14-15 shkurt

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Thërras kolegët deputetë, kryetarët e grupeve parlamentare, që t'i ftojnë kolegët deputetë të vijnë në sallë.

Ndërkohë po e shfrytëzoj rastin, ngase janë 51 deputetë, Enver Hoti dhe Shaip Muja e kanë kërkuar fjalën, vetëm shpejt. Enver Hoti, fillojmë me opozitën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi pse e kërkoja fjalën është protesta e Postës së Kosovës lidhur me një vendim që e ka nxjerrë Autoriteti i Pavarur i Konkurrencës, i cili marrëveshjet që i ka arritur Posta me disa institucione të Kosovës, siç është Ministra e Punëve të Brendshme dhe tri komunat, i ka shpallur marrëveshje që e dëmtojnë konkurrencën dhe ka kërkuar nga këto institucione që menjëherë zyrat e postës të largohen nga ambientet e tyre.

Ne mendojmë se Autoriteti i Konkurrencës nuk e ka bërë një vlerësim të duhur dhe të saktë, edhe pse kemi respekt të jashtëzakonshëm për punën, autoritetin dhe autonominë e tyre.

Duke marrë parasysh se kemi shumë çështje, të cilat është dashur të trajtohen, është dashur të trajtohen nga Autoriteti i Konkurrencës dhe ende nuk janë trajtuar, mendojmë se shumë vështirë e ka ky autoritet, në këto rrethana, të japë një vendim të saktë, e si pasojë jemi të bindur se vendimi i tij e dëmton interesin e kësaj ndërmarrjeje publike, e dëmton interesin e aseteve të shtetit, e dëmton interesin e mbi 1 000 punëtorëve, të cilët janë aty.

Prandaj, i kam dy kërkesa publike nëpërmjet Kuvendit për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për komunat përkatëse që të mos e zbatojnë këtë propozim të Autoritetit të Konkurrencës, derisa të merret një vendim nga gjykata, sepse ka informacione se Posta ka ushtrua padi dhe ankimim në gjykatë. Mendoj se duhet të pritët ai vendim dhe i bëjmë thirrje njëkohësisht Autoritetit të Konkurrencës ta rishqyrtojë edhe një herë vendimin e tij. Shihet qartë se një vendim kaq i shpejtë dhe një intervenim kaq i shpejtë i këtij autoriteti ka një nxitje nga interesa të individëve të caktuar apo interesa private, të cilat në masë të madhe do ta dëmtojnë këtë ndërmarrje publike, punëtorët e saj dhe asetet e shtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Muja, a është e njëjta çështje? Ndërkohë deputetët janë duke hyrë brenda, tani jemi në rend të ditës.

Urdhëro, zoti Muja, vetëm shpejt!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, faleminderit!

Është mirë që gjenoriziteti juaj që po i jepni opozitës, duke i dhënë përparësi, është një praktikë e re, e mirë, dhe shpresoj që edhe kërkesat do të trajtohen pak më qetësisht.

Kjo seancë është vazhdim i të mëparshmes. Mirëpo, unë propozoj që të mbahet një seancë shumë urgjente, ka shumë probleme Kosova, mu për këtë problemin e punonjësve publikë që janë para derës së Parlamentit, Presidencës dhe Qeverisë.

Ligji i konkurrencës, i cili po aplikohet sot, nuk është i barabartë, i drejtë dhe i bazuar, sepse po flasim për një institucion publik, i cili po konkurren me institucionet mikrofinanciare. Atyre institucioneve mikrofinanciare duhet t'ua shohim bazën ligjore të shtrirjes dhe aktivitetit. Është e turpshme që institucioni publik, administrata, e në krejt botën është praktikë që administrata i fut institucionet e veta publike për shërbimin e qytetarëve.

Prandaj, është shumë joserioze nëse ata i lëmë të kalojnë aq lehtësisht vetëm me një demonstrim, kjo është një përgjegjësie e Qeverisë dhe e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që i lejojnë punonjësit publikë të kritikojnë institucionin publik.

Ne duhet ta shohim shumë shpejt ligjshmërinë dhe vendimin e institucionit të konkurrencës.

Nëse pesë anëtarë atje kanë votuar, tre kundër dhe dy për, e merret vendimi, ai është vendim joligjor.

Prandaj, zoti kryetar, të kisha sugjeruar, nuk ka nevojë shumë deputetë të merren, mund të ulemi, ta bëjmë një komision shumë të shpejtë dhe t'i thërrasim në përgjegjësi dhe të bisedojmë për atë problem.

Aty flitet për 1 000 familje, të cilat financohen nga ai institucion dhe ata nuk po kërkojnë asgjë, po thonë: “Na lini të punojmë!”.

Prandaj, të ngrihem në nivel të përgjegjësisë dhe të mos krijojmë probleme sociale të vazhdueshme, e aq më shumë në kuadër të institucioneve publike. Faleminderit!

Kryetari: Faleminderit! Me sa po shoh, tanimë e kemi gjendjen reale për të vazhduar seancën.

Jemi mbi 61 deputetë, aktualisht janë 66 deputetë.

Kolegë deputetë, po, po e shoh, Bislim Zogaj, Besim Beqaj, Muhamet Mustafa.

Duke pasur parasysh, se më duket se është e njëjta temë, edhe ashtu-kështu Rregulloren nuk do ta shkelim më, se tanimë i kemi 61 deputetë.

Unë kisha kërkuar, pasi janë punëtorë, janë rreth 1 000, për kurtuazi, kjo temë nuk mund të futet, dihet si mbahet seanca e jashtëzakonshme, duhen 40 nënshkrime të deputetëve.

Por le të dalë përfaqësuesi i çdo grupi parlamentar me punëtorë, janë 1 000 vetë, nuk janë, e kanë krye protestën.

Atëherë, është çështje e tyre, në qoftë se nuk janë aty, po në qoftë se janë, të mos e bartim në seancë, seancë të jashtëzakonshme nuk mund të mbajmë, nuk është korrekte, e kemi një seancë, edhe një seancë tjetër.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 9, 14 dhe 15 shkurt 2017.

1. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e datës 15 shkurt. Andaj, në seancën e sotme procedojmë me votimin e raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Jemi 71 deputetë në sallë, do të thotë po lëviz 69-71. Sido që të jetë, jemi mbi 61, mund të procedojmë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Me 67 vota, 66 për, një abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

(Ndërprerje e incizimit)

Kërkoj falje, para se të futem në votim të fshehtë, po mundohem ta shfrytëzoj rastin t'i votojmë këto, të cilat janë pa votim të fshehtë, ta shfrytëzojmë kohën.

Atëherë, të nderuar kolegë, duhet të futemi në votimin e fshehtë.

Pikat e rendit të ditës, të cilat janë me votim të fshehtë, për arsye se të tjerat projektligje, të cilat janë në pritje, duhet votimi i 2/3 të komunitetit.

2. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve të tjera

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar si në vijim.

1. Shadije Gërguri,
2. Qerim Fazliji.

Ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Selvije Halimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Nuk është këtu. Urdhëro, Armend Zemaj e merr fjalën në emër të komisionit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Po e lexoj rekomandimin e komisionit, në emër të komisionit, pasi që as kryetarja e as zëvendëskryetarja nuk janë këtu.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 5 a, të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, zhvilloi procedurat për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2016 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit, sikurse vijon:

1. Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e komuniteteve të tjera, siç përcaktohet me nenin 108, janë dy kandidatë, zonja Shadije Gërguri, e cila është renditur me 70 pikë dhe zoti Qerim Fazliu, me 63 pikë.

2. Kuvendi prej dy kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor do të zgjedhë njërin nga kandidatët.

3. Votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor bëhet me votim të fshehtë.

4. Mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është pesë vjet.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Më pas mund të kërkohet deklarimi i kryetarëve, përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nuk u lajmërua asnjë përfaqësues.

Para se të futet si pikë e rendit të ditës, a ka mundësi edhe një herë, kërkoj falje edhe vëmendjen tuaj. Në qoftë se pajtohem, qenkan tri pika, të cilat mund t'i fusim shpejt në votim, nuk janë votuar për shkak të mungesës së kuorumit, tri qenkan, Armend, pasi po reagon, janë:

- *Votimi i propozim-rezolutës lidhur me arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,*
- *Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe*
- *Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë.*

A dëshironi t'i fus këto. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, unë pata diçka tjetër që lidhet me votimin për një anëtar të Këshillit Gjyqësor nga komuniteti serb, domethënë nga komuniteti pakicë.

Nëse dëshironi t'i kemi dy fletëvotime, mund të shkojmë përnjëherë, domethënë dy fletëvotime të ndara, për shkak të procedurës. Është e njëjta çështje, vetëm që ky është i komuniteteve të tjera, e ai është nga komuniteti serb.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zemaj! Për vëmendjen e kolegëve deputetë, propozimi i zotit Zemaj ndërlidhet me zgjedhjen e një anëtarit të Bordit për Ankesa të Mediave edhe shumë lehtë mund të procedohet.

Para se të futemi në vazhdimin e votimit të fshehtë, a dëshironi t'i fus këto tri pika të rendit të ditës në votim? Po e shoh, ekziston vullnet i përbashkët.

Zoti Bajrami, po thotë jo. LDK-ja, a jeni që t'i fusim në votim. Po. PDK-ja, po, “Vetëvendosja”, po. AAK-ja, po. “Nisma”, po. Zoti Bajrami, po futemi në votim.

9. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në seancën e kaluar për këtë pikë nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Andaj në seancën e sotme e procedojmë përsëri për votim Propozim-rezolutën lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Më falni, kolegë deputetë, a ka nevojë edhe një herë që Lëvizja “Vetëvendosje” ta lexojë? Nuk ka nevojë!

Urdhëro zoti Konjufca, para votimit ka të drejtë, le ta marrë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Vetëm desha ta bëj një sqarim më shumë për opinionin ndoshta, për arsye se këtu herën e kaluar nuk është që s'ka pasur kuorum, pra sa i përket pranisë fizike të deputetëve të koalicionit qeverisës. Çështja është që këta nuk kanë dashur të votojnë, nuk kanë dashur ta ushtrojnë të drejtën e votimit në seancë.

Unë e kuptoj që ndonjëherë opozita e shfrytëzon këtë për arsye se është më e paktë në numër dhe është strategji normale e opozitës për të shfrytëzuar mekanizma për të mos ia bërë kuorumin për shembull pozitës, veçse kur pozita nuk voton, kjo është sikur në vitin 2014, që ndodhte me PDK-në, atëherë shkohet në zgjedhje kur pozita nuk voton. Kështu e di unë që ndodh zakonisht.

KRYETARI: Faleminderit! Sido që të jetë, procedurat janë të qarta dhe kjo të cilën qëndron me arsyetimin e zotit Konjufca. Shkojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, edhe një herë! Për hir të korrektësisë, 34 deputetë kanë votuar: 25 për, 3 kundër dhe 6 abstenime.

Do të thotë, për mungesë të kuoromit të mjaftueshëm për vendimmarrje, edhe këtë herë mbetet e njëjta situatë dhe nuk e di a do ta sjellim më në seancë. Është rregull i Rregullores, unë s'mund ta ndërroj.

10. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Të nderuar kolegë,

Ju njoftoj se në seancën plenare, më 15 shkurt 2017, grupet parlamentare i kanë propozuar deputetëve për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit nga radha e komunitetit serb. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, s'po i lexoj edhe një herë, por kemi situatën këtë:

Grupi Parlamentar Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk e ka propozuar anëtarin e komisionit. Po ashtu, edhe Lista serbe.

Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” është këtu, a dëshiron të propozojë apo jo? Ende është e njëjta situatë, edhe Lista serbe nuk e ka propozuar një deputet për zëvendës kryesues të parë të komisionit.

Atëherë, shkojmë në votim! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, me këtë përbërje: a ka nevojë që t'i lexoj emrat edhe një herë? I dimë të gjithë. Votojmë tash!

Është e njëjta situatë. 58 deputetë: 53 për, 5 abstenime. Nuk kemi vendimmarrje për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, kështu që vazhdojmë. Situatë shumë e qartë, ballkanike, hakmarrje.

11. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën e krijuar në Mitrovicë

Të nderuar kolegë,

Ju njoftoj se në seancën e kaluar diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar, andaj në seancën e sotme procedojmë me votimin për Propozim-rezolutën lidhur me situatën e krijuar në Mitrovicë. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim rezolutës. A keni nevojë edhe një herë ta lexoj? Jo, veç shkojmë drejt në votim.

Atëherë, lus kolegët deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash! E patën fatin tri pikat e rendit të ditës të njëjtë.

Kanë votuar 36 deputetë: 29 për, 1 kundër, 6 abstenime. Mungesë e kuorumit të mjaftueshëm, njësoj nuk kemi vendimmarrje.

2. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera

A e fusim bashkërisht me këtë edhe Zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve? Duhet deklaram, seanca e voton. Unë po e kërkoj deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare, pastaj e hedh në votim me vendimmarrje të shumicës.

Nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, kush e merr fjalën? Zonja Brovina, fjala për ju. Cili është qëndrimi i PDK-së?

FLORA BROVINA: Ne do të votojmë për.

KRYETARI: Lidhja Demokratike e Kosovës, ju lutem!

ISMET BEQIRI: Po, ne e mbështetim që me një proces ose me një votim të bëhet për të dy kandidatët, për të cilët kërkoi zoti Zemaj, që të futen në një proces të vetëm. Faleminderit!

KRYETARI: Lëvizja “Vetëvendosje”, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: Pajtohem që të shkojmë me një votim të përbashkët.

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ju lutem!

PAL LEKAJ: Pajtohem që të shkojmë me një votim të përbashkët.

KRYETARI: “Nisma”, ju lutem! Zonja Valdete, fjala për ju!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu, “Nisma” e përkrah një iniciativë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: “6+”, ju lutem! Nuk dëgjuam zonja Mufera, ju lutem edhe një herë!

MÛFERA SERBICA-ŞINIK: Azni şekilde aynı süreç içerisinde gidebilir... Teşekkür ederim!

KRYETARI: Po, qëndrimi ishte po, ishte edhe mirësjellja. Faleminderit! Atëherë, vetëm votim formal.

Kush është kundër? S’ka kundër. Abstenim nuk ka. I bëjmë të dy pikat bashkë, vetëm t’i lexoj. Armend, urdhëro! A ka mundësi dhe na e rregullon më mirë, e lexon edhe për deputetët, t’i futim të dyja bashkë, pastaj unë vetëm i pyes kryetarët e grupeve parlamentare.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Unë nuk desha të ndërhyj, sepse ishit duke i lexuar. Këtu i kemi tri votime sot. I kemi dy votime për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe një votim është për një anëtar të Bordit për Ankesa të Medieve.

Unë propozova që anëtarët që vijnë nga komunitetet tjera dhe anëtari që vjen nga komuniteti serb të jenë në dy fletëvotime, ashtu siç edhe janë të përcaktuar, por ju e propozuat që të jetë në votim edhe anëtari i Bordit për Ankesa të Medieve, që për mua është në rregull. Kështu që duhet të jenë tri votime, domethënë tri fletëvotime, nëse ka nevojë mund ta ndajmë në dy pjesë, por mund të jetë edhe njëjtë. Por, për t'i bërë të tria duhet t'i lexoni tash edhe këto dy rekomandime, qoftë për anëtarin për Bordin për Ankesa të Medieve, por edhe për anëtarin e Këshillit Gjyqësor nga komuniteti serb.

KRYETARI: Faleminderit, Armend! Por, duke pasur parasysh se Kushtetutën e kemi shumë moderne, e cila krijon situata që mund të na kthehen prapë në seancë, nuk do ta futim për shkak të komunitetit serb që mund ta çojë në Gjykatën Kushtetuese. Më mirë nuk po rrezikojmë.

ARMEND ZEMAJ: Ok! Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, kalojmë me këto dy pika të rendit të ditës, vetëm i bëjmë bashkë, votim i përbashkët. Nuk po rrezikojmë. Unë po e lexoj formalisht këtë pjesën, e cila më duhet, por pastaj procedojmë për dy pikat e rendit të ditës bashkërisht.

3. Zgjedhja e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve

Jemi edhe te zgjedhja e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve. Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, i ka shqyrtuar biografitë dhe ka zhvilluar intervistimin e kandidatëve të nominuar dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve nga dy kandidatët e propozuar.

Prapë, zonja Halimi nuk është. Zoti Zemaj, në qoftë se ka nevojë të na paraqitësh dhe arsyetosh rekomandimin. Urdhëro, zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit për Ankesa të Medieve e ka bërë këtë rekomandim, me të cilin propozohen dy anëtarë, zgjedhja është për një anëtar, Dua Kadriu dhe Mentor Hoxha. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, zoti Mustafa e ka kërkuar fjalën në ndërkohë.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Nuk e di, po më duket tash jemi një numër më i madh këtu, po më duket që jemi mbi 80. Ndoshta ka qenë mirë, në qoftë se e kemi numrin, që t'i ratifikojmë 2-3 marrëveshje që i kemi këtu derisa ta bëjnë gati fletëvotimin.

Për shembull, i kemi 2-3 projekt-marrëveshje për të cilat nuk duhen 2/3 e minoriteteve, duhen vetëm 2/3 e deputetëve. Në qoftë se kemi numrin e deputetëve këtu, është mirë që t'i votojmë.

KRYETARI: Për korrektësi, faleminderit zoti Mustafa, në momentin që e arrijmë 80 deputetë, unë kërkoj mirëkuptim prej juve t'i futim menjëherë në votim. Aktualisht jemi vetëm 76 deputetë. Çdo moment kisha kërkuar, kolegë deputetë, se kur fillon votimi i fshehur pastaj deputetët e lëshojnë sallën, disa prej tyre, në qoftë se janë edhe 4 deputetë afër, i kisha lutur që të vijnë në sallë, ndërkohë derisa ta krijojmë komisionin formal për votues.

I ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues për dy pika të rendit të ditës. Partia Demokratike e Kosovës, zonja Brovina!

FLORA BROVINA: Në emër të Partisë Demokratike, Blerta Deliu, kryetare e komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Ne për anëtar të komisionit e propozojmë zotin Armend Zemaj.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Ne propozojmë Besa Baftiun.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Berisha, urdhëro!

ALI BERISHA: Ne propozojmë zotin Lahi Brahimaj.

KRYETARI: Në rregull! Grupi Parlamentar "Nisma", zonja Bajrami urdhëro!

VALDETE BAJRAMI: Nga "Nisma" do të jetë deputetja Shukrije Bytyqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga "6+", zonja Mufera urdhëro!

MÜFERA ŞINIK: Kryetar!

Unë besoj që kur kam folur edhe në gjuhën turke ju keni marrë vesh. Tash “6+” e propozon Qerim Bajramin.

KRYETARI: Faleminderit! Tanimë i kemi marrë emrat për anëtarë të komisionit, nevojiten vetëm deputetët me ngritje formale të dorës.

A ka kush kundër në rend të parë? Jo! Abstenim? Nuk ka!

Atëherë, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e një anëtari në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe, në të njëjtën kohë, për zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve.

Kërkoj nga komisioni që të fillojë menjëherë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët do të ftohen që të votojnë sipas listës. Sa deputetë i kemi në sallë? Vetëm ta verifikojmë pa filluar, pa lëvizur deputetët në komision. 77 deputetë janë. Atëherë, komisioni le ta zëre vendin, ju lutem! Të përgatitet për votim!

Lus edhe një herë kryetarët e grupeve parlamentare, jemi shumë afër votimit me 80 deputetë që duhen, t’i thërrasin kolegët deputetë të vijnë në sallën e seancës plenare.

* * *

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,

Ka ardhur një njoftim zyrtar. Sot, para dy orësh, Bangladeshi ka njohur Pavarësinë e Kosovës. Kështu që desha t’u falënderohem!

Është njoftim zyrtar i Ministrisë së Jashtme dhe zotit Hoxhaj, prandaj uroj që edhe më tutje të kemi njohje të reja!

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë vazhdojmë: Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Donikë Maloku-Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Shurdhaj, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim

Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Dedaj, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kymete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veseli-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Termkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliqeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nehat Baftiu, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj;

Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhie Demaku, Rafet Rama, Raif Çela, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Sali Salihu, Salije Mustafa, Sasha Milosavljeviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

* * *

KRYESUESI: Atëherë po fillojmë numërimin e votave, Komisioni e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Po fillojmë leximin e votave për anëtar të Këshillit Gjyqësor:

Qerim Fazliji,
Qerim Faziliji,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Shadije Gërguri,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,

Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Shadije Gurguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,

Qerim Fazliji,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Shadije Gërguri,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji,
E pavlefshme,
Qerim Fazliji,
Qerim Fazliji.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Po vazhdojmë me numërimin e votave, kryetarja e komisionit, Blerta Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Komisioni votues pas procedurës së votimit dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera, në seancën plenare të mbajtur më 27 shkurt 2017,

K o n s t a t o n:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 91 deputetë.

Të pavlefshme janë 10 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

Shadije Gërguri i ka fituar 11 vota,

Qerim Fazliji i ka fituar 70 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 5 a të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

K o n s t a t o n:

Se zoti Qerim Fazliji zgjidhet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera me mandat 5-vjeçar.

KRYESUESI: Urime!

Vazhdojmë me rezultatin e votimeve të mëparshme, zonja Blerta Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU KODRA:

Mentor Hoxha,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Mentor Hoxha,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,

Mentor Hoxha,

Dua Kadriu,

Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
E pavlefshme,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
E pavlefshme,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,

Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
E pavlefshme,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Mentor Hoxha,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu,
Dua Kadriu dhe
Mentor Hoxha.

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehur dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve, në seancën plenare, të mbajtur më 27 shkurt 2017,

K o n s t a t o n:

Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 91 deputetë. Të pavlefshme janë tri fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

Dua Kadriu i ka fituar 58 vota,
Mentor Hoxha i ka fituar 30 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 65, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës te neni 38, 39 dhe 40 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe të nenit 51, të Rregullores së Kuvendit konstatohet se zonja Dua Kadriu zgjidhet anëtare e Bordit për Ankesa të Medieve në mandat trevjeçar.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, regjia bini ziles le ta shtojmë kuorumin. Atëherë, marrëveshjet që kërkojnë 2/3 e votave nuk po i futim sot në votim, po e lëmë për ditën e enjte kur e kemi thirrur seancën, meqenëse nuk kemi kuorum. Po vazhdojmë me pyetjet parlamentare që i kemi paralajmëruar që t'i kryejmë.

Kanë të drejtë që të tërhiqen, të kërkojnë që ta shtyjnë sipas Rregullores. Ne e kemi për detyrë që t'i përfundojmë, sepse edhe ashtu ka pyetje që janë bërë që nga janari e deri më sot, edhe e kanë humbur edhe kuptimin që t'u përgjigjet dikush. Megjithatë, unë ju ftoj që të fillojmë me punë.

12. Koha për pyetje parlamentare

E para është Albulena Haxhiu, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. Albulena nuk është këtu, po më duket.

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zonja Haxhiu, dëshironi ta bëni pyetjen apo ta shtyni, meqenëse s'është kryeministri këtu.

TEUTA HAXHIU: Ka kohë që unë e kam bërë këtë pyetje, por në fakt është hera e dytë që e përsëris, edhe pse ka ndoshta dy muaj që është parashtruar prapë. Fjala është për kryeministrin, se në këto bisedimet maratonike në Bruksel ai vitin e kaluar këtu në Kuvendin e Kosovës na tha që çështja e të pagjeturve është diskutuar. Në fakt, edhe një herë i them që të tregojë se kur, në çfarë niveli e diskutoi edhe a u mor ndonjëherë me çështjen e të pagjeturve.

Edhe pse edhe në kohën kur u miratua buxheti, kryeministri pra lloboi kundër ndarjes buxhetore për Kompleksin Memorial “27 Prilli”, andaj asnjëherë nuk e tregoi pra nivelin dhe përgjegjësinë si kryeministër sa i përket çështjes së të pagjeturve. Pyetja është pra: A është biseduar ndonjëherë dhe a keni paraparë ju ndonjëherë që çështjen e të pagjeturve ta trajtoni vërtet ashtu siç e meriton?

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja tjetër është e zonjës Haxhiu prapë për ministrin Lutfi Zharku.

TEUTA HAXHIU: Ministri nuk është këtu, për këtë pyetje në të vërtetë është fjala për rrethin te Kompleksi “Adem Jashari”, në fakt te stacioni aty para hyrjes te autobusët, por në fakt te Stacioni i Autobusëve, ai rreth i cili është ndërtuar po ua vështirëson qasjen qytetarëve, pra qasjen edhe fëmijëve, sidomos nxënësve të katër shkollave që janë aty, mirëpo për këtë pyetje është mirë ministri të jetë këtu dhe unë e përcjell për një seancë, kur të jetë ministri këtu, ose ministri të më përgjigjet me shkrim. Pra, në pyetjen që kam drejtuar, ngase qytetarët po kërkojnë sqarime se u është vështirësuar qasja nxënësve të katër shkollave, po edhe të qytetarëve për të kryer shumë shërbime, që janë afër te ajo rrugë, e që u është vështirësuar jeta dhe qarkullimi vërtet, prej ndërtimit të rrugës Pejë - Prishtinë.

Pikërisht aty do të duhej të ndërtohej një nënkalim apo mbikalim dhe është mirë që ministri të na tregojë nëse ka paraparë dhe a është ky një lëshim i ministrit apo ministrisë së vet, që ka ndikuar që qytetarëve t’u bëhet jeta shumë më e vështirë dhe të kemi aksidente, sikurse fatkeqësisht patëm edhe në ditët e fundit, pra edhe në Fushë-Kosovë.

Prandaj, për t’i parandaluar këto ata duhet të kenë një qasje të drejtë, të planifikojnë drejt, e jo të planifikojnë në dëm të qytetarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Abrashi. Zoti Shala..., është kryer, a? Në rregull!

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Ministri s’qenka këtu, e keni fjalën zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Para se ta lexoj pyetjen për ministrin, së pari e kam një pyetje për këtë Kuvend, i cili e ka zgjedhur dhe po e mban në pushtet një qeveri kaq të papërgjegjshme, e cila asnjëherë nuk është në gjendje t’u përgjigjet pyetjeve parlamentare që janë një formë e kontrollit të Qeverisë.

Pyetja ime për Parlamentin është: Deri kur do ta tolerojë këtë Qeveri të papërgjegjshme që të luajë me deputetët, e kjo i bie lojë edhe me qytetarët e Kosovës? Besoj që do ta marrim këtë

përgjigje prej atyre, që e kanë shumicën e votave, kurse sa i përket pyetjes që ia kam drejtuar ministrit të Arsimit, është kjo:

Bazuar në përgjigjen me shkrim të inspektorëve të Arsimit, të datës 16 nëntor 2016, Inspektorati i Arsimit gjatë inspektimit në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Doktor Asllan Elezi”, në Gjiilan, ka konstatuar se drejtorja e shkollës nuk i ka respektuar kriteret e konkursit të rregullt për pranimin e nxënësve, duke e shtuar numrin e nxënësve në paralele dhe duke i shtuar dy paralele bazuar në vendimin e 5 tetorit 2016. Ka lejuar hapjen e dy paraleleve të reja jashtë konkursit të rregullt pa miratimin e MASHT-it dhe kjo ka ndodhur me përafërsisht dy muaj vonesë. Pra, pyetja është çka po ndërmerret ministria ndaj shkeljeve të këtilla tepër të vrazhda dhe jo vetëm në këtë rast, por në shumë raste tjera dhe jo vetëm në shkolla të mesme, por edhe në kolegje dhe në fakultete, ku absolutisht nuk respektohen kriteret, ligjet..., por veprohet sipas dëshirës së njerëzve që e udhëheqin institucionin në fjalë, siç është rasti konkret në një shkollë të mesme.

Dhe po ashtu, kërkojmë nga mini...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, sërish pyetje për ministrin Abrashi.

ISMAJL KURTESHI: Po, do ta lexoj edhe këtë pyetje, meqë këto pyetje janë shkruar para tre muajsh dhe absolutisht s’po na vjen rendi për t’i lexuar.

Këtu bëhet fjalë për diskriminimin e një kategorie të pensionistëve. Vazhdimisht po rritet numri i atyre qytetarëve që e kanë moshën e pensionimit e që nuk i kanë tamam 15 vjet përvojë pune para lufte dhe ata që për një ditë nuk e përmbushin këtë kusht, po përjashtohen nga e drejta e pensionimit.

Shumë nga këta qytetarë, ose kanë pak ose nuk kanë fare mjete në Trustin PENSIONAL. Askund në Evropë, besoj as në botë, nuk ndodh që dikujt t’i mohohet e drejta e shfrytëzimit të kontributit vetjak, sepse edhe ata që i kanë 14 vjet përvojë edhe ata që i kanë dy vjet përvojë para lufte, e kanë njëloj kontributi dhe atyre do të duhej patjetër që t’u njihet ajo e drejtë dhe t’u kthehen kontributet e tyre.

Pra, pyetja është: Pse ata që i kanë 14 vjet pune kontribut nuk e marrin atë që u takon? Askush nuk ka të drejtë t’i përjashtojë nga kjo e drejtë, nëse dikush e ka edhe vetëm një vit përvojë pune.

Pyetja dhe kërkesa është që të ndërrohet ky ligj, ose vendim që është marrë dhe njerëzve t’u kthehen kontributet e tyre, për aq sa kanë kontribuar dhe jo t’u bëhet një diskriminim i këtij lloji, siç po ndodh që dikush për një ditë të mos i shfrytëzojë 15 vjet të kontributit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ali Berisha, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Zoti Berisha, e keni fjalën.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë dëshiroj ta pyes ministrin lidhur me barnat. Në shumë barnatore të ndryshme të qyteteve të Kosovës çmimet e barnave janë të ndryshme dhe qytetarët e Kosovës po kanë probleme të mëdha në blerjen e barnave, pasi çmimet janë kontradiktore nga një barnatore te barnatorja tjetër.

Pyetja ime është konkrete: Çka ka bërë Ministria e Shëndetësisë në aspektin e nivelimit të çmimit të barërave në nivel të Republikës?

Unë e di që kjo pyetje duhet të adresohet kur ministri të jetë këtu, por meqenëse është mungesa e tij, kisha dëshiruar të paktën ta marr me shkrim këtë pyetje që e adresova sot në këtë Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kymete Bytyqi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

KYMETE BYTYQI: Kryesues!

Meqenëse ministri s'është këtu, unë do ta parashtroj pyetjen dhe besoj që në seancën e ardhshme do të vijë dhe të na japë përgjigjen.

Atëherë, pyetja është: Pacientët e diagnostifikuar me sëmundjen kancerogjene, siç është kanceri i mushkërive, i gjirit, e tjerë, nga regjioni i Prizrenit, Rahovecit, Mamushës dhe Dragashit detyrohen që për trajtim mjekësor, kimioterapi dhe për rrezatim të vijnë në QKUK në Prishtinë.

Atëherë, e pyes ministrin se përse nuk ekziston Reparti i Onkologjisë në Spitalin Rajonal të Prizrenit, për t'u ofruar më afër pacientëve shërbime shëndetësore për trajtim me kimioterapi dhe rrezatim, kur dihet se kemi mjaft specialistë për këtë lëmi dhe udhëtojnë çdo ditë nga Prizreni dhe komuna përreth për Prishtinë dhe anasjelltas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Blerta, dëshironi ta bëni pyetjen?

BLERTA DELIU-KODRA: Jo, nënkryetar! Meqë kryeministri nuk është këtu, do ta përsëris në seancën e ardhshme, në ditën e enjte.

KRYESUESI: Ju e dini që si të bëhet dy herë pyetja e nuk përgjigjet ministri, ose kryeministri, pyetja publikohet dhe shlyhet nga procesverbali, duhet ta përsëritni prapë.

Sërish Blerta Deliu, pyetje për ministren Edita Tahiri.

BLERTA DELIU-KODRA: Edhe pyetjen për ministren Tahiri do ta bëj në ditën e enjte, në seancën plenare që do ta kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lirije Kajtazi, pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, po do ta pres praninë e ministres.

KRYESUESI: Zonja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Shqipja s'është këtu, po më duket. Sërish Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. S'është.

Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Zonja Bytyqi, urdhëro!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit kryesues, por unë nuk do ta bëj pyetjen, sepse është shumë e rëndësishme dhe qytetarët e presin përgjigjen nga ministri.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bislim Zogaj, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

BISLIM ZOGAJ: Do ta pres ministrin.

KRYESUESI: Deputeti Hajdar Beqa, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Po e lë pyetjen për seancën e ardhshme, kur të jetë edhe ministri këtu. Konsideroj që është e rëndësishme që ministri të përgjigjet për qytetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

VISAR YMERI: Kjo pyetje është shtruar, ose dorëzuar, në fakt, më 7 shkurt të këtij viti dhe ende nuk ka përgjigje, madje s'i ka ardhur asnjëherë radha as të lexohet në seancë. Edhe sot, siç duket, nuk do të ketë përgjigje, sepse mungon e gjithë Qeveria, me përjashtim të një ministri, që po e shoh aty.

Por, sidoqoftë, unë po e lexoj pyetjen dhe pres që në seancën e radhës të marr përgjigje nga kryeministri për të.

Pyetja ime lidhet me shkëmbimet tregtare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat janë shumë të ulëta, si edhe në vitet e mëparshme. Po, përveç kësaj, në vitin e fundit kanë rënë edhe më tej. Për vitin 2016, ulja më e madhe e eksporteve në Republikën e Shqipërisë është ajo me Kosovën, që shënon -20,6% krahasuar me një vit më parë.

Kjo situatë flet për barriera tregtare, midis tjerash probleme me терминаlet dhe ato të certifikatave që janë ravijëzuar, si disa prej problemeve kryesore në këtë marrëdhënie tregtare. Pra, pyetja është se duke pasur parasysh që Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar tashmë dhjetëra marrëveshje, a ka mundësi të na tregoni pse nuk jetësohet pjesa kryesore e tyre për sa i takon tregtisë së lëvizjes së lirë të mallrave?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin. Donika s'është këtu.

Zonja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Abrashi.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse ministri nuk është këtu, pyetjen do ta parashtroj në seancën e ardhshme, sepse dua të marr përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Fatoni s'është. Edhe një pyetje e ka Fatoni, nuk janë as kryeministri, as Fatoni. Çka t'i bëj Fatonit që s'është!?

Deputeti Enver Hoti, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe meqë nuk është ministri këtu, unë do ta bëj pyetjen për hir të opinionit. Pyetja ka qenë e drejtuar kryeministrit të Republikës, sa zëvendësministra i ka Qeveria e Republikës së Kosovës?

Nga një hulumtim që kemi bërë ne deri më 15 shkurt kanë qenë diku afërsisht 40 zëvendësministra dhe kjo po na jep të kuptojmë se sigurisht mund të shtohet ndonjë, sepse palët në Qeveri, nëse ka ndonjë militant diku, goxha në dert kanë rënë qysh t'ua bëjnë zyrat, t'ua improvizojnë zyrat, e ndërsa numri i qytetarëve të Kosovës vazhdimisht po shkon në rënie duke ikur, Kabineti qeveritar po i rrit angazhimet dhe ministrat e zëvendësministrat po i shton si trupa.

Ne deshëm të dimë, sigurisht në seancën e ardhshme, kryeministri do të na japë një përgjigje se sa i kushton Qeverisë së Kosovës një zëvendësministër së bashku me kabinetin e tij. Vlerësojmë se ndoshta edhe Kina nuk i ka afro 40 zëvendësministra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani zoti Ymeri, kryeministri e ka autorizuar ministren Bajrami për t'iu përgjigjur pyetjes suaj dhe një pyetjeje tjetër që ishte këtu. Edhe zonjës Lirije Kajtazi. E lexove ti, apo deshe... a dëshiron ta lexosh tani? Atëherë, përgjigju në pyetjen e Visarit. Ky e lexoi, e pastaj e lexon Liria.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Ne, meqenëse e përcjellim fushën e tregtisë si ministri kompetente, e kemi marrë këtë pyetje nga Zyra e Kryeministrit.

Është e vërtetë, në dhjetor të vitit 2013 është arritur marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe gjithashtu Qeverisë së Republikës së Kosovës për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë ndërmjet dy vendeve.

Më lejoni të ju informoj, zoti Ymeri, që gjatë këtyre viteve ne kemi arritur që t'i adresojmë pothuajse të gjitha barrierat tregtare që kemi pasur me Shqipërinë. Kemi pasur barrierën e eksportit të barnave. Për herë të parë, Kosova, pas një pengese, që ka qëndruar pothuajse 5 vjet, tash Shqipëria e ka ndërruar edhe ligjin dhe ne mund t'i eksportojmë produktet farmaceutike në Shqipëri.

Kemi arritur t'i adresojmë çmimet referente të çokollatës, kuotën e qumështit, të patateve, të rrushit, të verës dhe nuk ka, për momentin, barrierë, të cilat janë të dokumentuara nga operatorët ekonomikë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Normalisht se operatorët mund të kenë probleme, por në qoftë se ata nuk vijnë dhe nuk raportojnë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, atëherë ne kemi problem që ato t'i adresojmë.

Një çështje, e cila po adresohet, është çështja e miellit dhe e përmbajtjes së proteinave.

Siç mund të jeni informuar, Republika e Shqipërisë e ka të rregulluar përmbajtjen e proteinave në miell me një rregullore të veçantë. Ne kemi ngritur këtë brenda komuniteteve që janë të themeluara për zbatimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë dhe autoritetet shqiptare na kanë dhënë premtime që kjo çështje do të adresohet.

Normalisht se autoritetet e një vendi vendosin për kualitetin e produkteve që ata vendosin t'i konsumojmë dhe, në qoftë se ne vijmë në përfundim se ajo është një masë e paarsyeshme, atëherë mund të merren masa reciprociteti, siç është rasti në vitin 2016, kur kemi qenë pak para marrjes së masave për reciprocitet nëse nuk do të zgjidhej çështja e adresimit të eksportit të barnave në Shqipëri, meqenëse të njëjtin kriter nuk e kishim ne për produktet farmaceutike që eksportohehin nga Shqipëria.

Është e vërtetë se kemi rënie të eksportit të Shqipërisë, mirëpo kjo nuk varet, apo kjo nuk është çështje e autoriteteve, por thjesht varet prej operatorëve ekonomikë, me cilët partnerë ata dëshirojnë të bëjnë tregti.

Ne i kemi edhe grupet e bashkëpunimit, kemi një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha autoritetet atje, po edhe grupet teknike që janë të themeluara për zbatim të marrëveshjeve po i adresojnë të gjitha çështjet e ngritura. Ka edhe iniciativa të tjera konkrete për ngritjen e bashkëpunimit.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ju lutem! Atëherë, është pyetja e zonjës Kajtazi. Zonja Kajtazi, e keni fjalën.

Është edhe pyetja shtesë e zotit Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit që më në fund u dha një përgjigje për këtë pyetje, por më shumë ishte konstatim i gjendjes dhe, në njëfarë mënyre, atë që Qeveria pretendon se e ka kryer, por për mua ka shpërputhje të mëdha në mes të shifrave, pra statistikave që importi nga Shqipëria është duke rënë dhe, në anën tjetër, këtyre punëve të suksesshme që i paska bërë Qeveria në arritjen dhe realizimin e marrëveshjeve.

Pra, prapë po e përsëris. Nëse krahasohet, ta zëmë, eksporti dhe importi i Kosovës, po flas për vitin 2016 dhe jo për të gjithë muajt, sepse s'i kam shënimet për të gjithë muajt, shihet se kur vjen te eksporti ne eksportojmë shumë më shumë në Shqipëri, se sa që eksportojmë në Serbi. Ndërkohë që kur vjen te importi, ne importojmë dyfish më shumë nga Serbia se sa që importojmë nga Shqipëria.

Dhe, këtu ka një disbalancë jashtëzakonisht të dëmshme tregtare dhe ekonomike që e kemi, po i marr si shembull këto dy vende, ku natyrisht se Kosova do të përfitonte shumë më shumë po të kishte marrëdhënie shumë më të mira tregtare me Shqipërinë se sa që përfitojmë nga Serbia.

KRYESUESI: Zonja Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Tani, deputet Ymeri, ju e dini që ne edhe me rregullim kushtetues jemi ekonomi e tregut të lirë, do të thotë që ajo çka është e arsyeshme është se nuk ka barriera, të cilat janë të raportuara dhe të cilat janë të vendosura nga institucionet.

E thashë edhe më herët, është komplet në vullnetin e operatorëve ekonomikë se me kë donë ata të zhvillojnë tregtinë.

Ne sa herë që bisedojmë, faktikisht të gjithë importin që e kemi me vendet e tjera fqinje e shohim dhe ua tregojmë si potencial, do të thotë autoriteteve shqiptare, në mënyrë që ata të nxisin bizneset e veta dhe të orientojnë e ta shfrytëzojnë këtë potencial që e ka tregu kosovar.

Ne kemi pasur në vitin 2015 rënie të eksportit, ndërkohë që ata kanë pasur një ngritje prej diku 55%, që do të thotë janë thjesht fluktuime që ndoshta kanë ndodhur edhe si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që do të thotë tregtia e lirë që është bërë me 28 vende të BE-së, por nuk ka barriera nga ana institucionale. Është vullnet, prapë po e them, i operatorëve ekonomikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi, e keni fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për ministren Bajrami kam bërë pyetjen lidhur me Fondin e garantuar kreditor.

Pra, siç dihet, problem preokupues për qytetarët dhe numër një është papunësia, përtej mendimit ndoshta edhe të kësaj sale se janë çështje të tjera, prandaj është ky fond, i cili është përpjekur të zbusë këtë problem, që është më i shprehur te disa kategori, e në këtë rast, te gratë dhe të rinjtë.

E nderuar ministre,

Sa ka ndikuar Fondi që të zbutet papunësia te gratë?

KRYESUESI: Zonja Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar deputete Kajtazi!

Të nderuar deputetë,

Fondi kosovar për garanci kreditorë, siç e dini, është funksional që nga viti i kaluar, dhe deri më 31 dhjetor të vitit 2016 nga Fondi, ose nën ombrellën e Fondit, bankat komerciale në Kosovë kanë arritur të lëshojnë 108 kredi.

Pra, është rritur edhe kredidhënia. Fondi, që sipas ligjit që është themeluar nuk ka programe të veçanta për gjininë femërore. Ne e dimë që një nga barrierat e të gjitha bizneseve është pikërisht qasja e limituar në financa.

Fondi kosovar për garanci kreditorë mbulon 50% të rrezikut dhe është komplet në diskrecion të bankave komerciale, të cilat tashmë i kanë nënshkruar të gjitha marrëveshjet me Fondin kosovar për garanci kreditorë që ato t'i vlerësojnë në bazë të kriterëve të tyre dhe në qoftë se kërkesa për kredi dhe biznes-plani është i arsyeshëm, por mungon kolaterali, atëherë vjen në shprehje Fondi.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka kontribuar deri më tani me 2 milionë euro në Fondin për garanci kreditorë. Republika e Republikës së Kosovës ka për qëllim që edhe në rishikim të buxhetit, po edhe në vitet e ardhshme të kontribuojë më shumë, sepse është paraparë që është një instrument tepër i suksesshëm.

Tani është rritur kredidhënia dhe po presim të shohim rezultatet dhe të pritet vlerësimi i parë.

Ndërkohë, ligji nuk kufizon që ne dalim edhe me instrumente të tjera, kështu që kërkesa juaj të bëjmë program të veçantë sa i përket bizneseve të grave, besoj se edhe mund të arsyetohet dhe të shqyrtohet me shumë kujdes nga ana e institucioneve qeveritare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Kajtazif? Jo! Atëherë, është edhe një pyetje tjetër e Visar Ymerit për kryeministrin Mustafa.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Edhe kjo pyetje është e të njëjtës kohë, pra e 7 shkurtit dhe ka një çështje urgjente, që e mbulon.

Prej disa kohësh, natyrisht se jemi duke u përballur me krizën energjetike, si Kosovë, por tash e kemi edhe një problem shtesë që ndërlidhet me sektorin e energjisë në përgjithësi, për shkak të problemit ose për shkak të ndaljes së punës në mihjen e Sibovcit dhe mosprodhimit të thëngjillit për termolektranat nga kjo mihje.

Pra, aktualisht sipas informatave që i kemi nga punëtorët e KEK-ut aty, nuk ka fare punë në shpluarjen e minierave të tjera, që i bie praktikisht se për një kohë shumë të shkurtër Kosova rrezikon të mbetet pa prodhim të thëngjillit fare, që do të nënkuptonte ose import të thëngjillit për të prodhuar energji elektrike, ose import i energjisë elektrike për ta mirëmbajtur sistemin.

Në këtë drejtim problemi kryesor është se në territorin e destinuar për mihje tash janë mbi 260 ndërtime pa leje, përkundër faktit se me dy vendime të institucioneve qendrore ajo është shpallur zonë e interesit të veçantë, me të cilin automatikisht do të duhej të ndaloheshin çfarëdo veprimtari mbi të dhe veçanërisht ato që e vështirësojnë përdorimin e thëngjillit për energjinë elektrike.

Pra, pyetja për kryeministrin është që sa kohë ju duhet si Qeveri ta zgjidhni çështjen e minierës së Sibovcit dhe hapjes së terrenit për shfrytëzimin e thëngjillit?

Prapë po e përsëris, kjo është një situatë jashtëzakonisht urgjente, sepse do të vijmë në një moment shumë shpejt kur nuk do të kemi mundësi të prodhojmë energji elektrike dhe do të duhej ta furnizojmë Kosovën me energji të importuar që natyrisht na kushton edhe shumë më shtrenjtë dhe paraqet probleme të tjera të jashtëzakonshme ekonomike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, a keni përgjigjen? Jo! Atëherë deputeti Haskuka, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

MYTAHER HASKUKA: Kjo problematika e grumbullimit të pyetjeve parlamentare që po kalon një kohë e gjatë pa u diskutuar, nganjëherë po del mirë.

Me rastin e pyetjes time, do të thotë kur ka qenë pyetja në fillim të shkurtit, unë pata bërë pyetje lidhur me çështjen e vendit të xhamisë së Ibrit, ku sipas Komisionit qeveritar për Persona të Zhdukur në vitin 2010 Gjykata e EULEX-it ka nxjerrë një urdhëresë gjyqësore për gjurmimin te ky vend, aty ku ka qenë xhamia e Ibrit në Mitrovicë, e cila është djegur gjatë luftës, sepse sipas vendimit ekzistojnë dyshime të argumentuara se aty mund të ketë varreza masive.

Pra, që nga viti 2010 asgjë nuk është bërë në zbatimin e urdhëresës gjyqësore nëse kemi parasysh që edhe 17 vjet pas luftës në Kosovë ende janë 1.660 persona të pagjetur dhe nëse kemi parasysh që para disa kohësh në varrezat myslimane, në pjesën veriore janë gjetur mbetje mortore, atëherë nuk ka pasur arsyetim pse nuk janë bërë gjurmimet në këtë lokacion. Por pas shtrimit të pyetjes, besoj se para 10 ditësh kanë filluar gjurmimet, prandaj po më vjen mirë që Qeveria ka filluar të punojë sipas pyetjeve ose çështjeve që po ngrihen si pyetje parlamentare. Por prapë kryeministri nuk është këtu për të na treguar se çka po ndodh aty, a është gjetur diçka, apo si po shkojnë gjurmimet në vendin ku ka qenë xhamia e Ibrit. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi pyetjen e Donika Kada-Bujupi për kryeministrin Isa Mustafa, dhe pasi erdhi, deputete, a doni ta bëni pyetjen?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Meqenëse s'është këtu kryeministri dhe s'po është asnjëherë, është e pakuptimtë të vazhdoj të bëj pyetje.

KRYESUESI: Në rregull, ministrja Bajrami është e autorizuar t'i përgjigjet pyetjes tuaj. Megjithatë, është e drejtë juaja.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Rrahmani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Kohët e fundit ka dalë një raport nga Zyra Kombëtare e Auditimit që është bërë në Ministrinë e Shëndetësisë, ku është deklaruar se janë shpenzuar diku 8 milionë euro për shërbime jashtë institucioneve shëndetësore.

Mirëpo, për fat të keq, në këtë auditim janë hasur shumë parregullsi, sepse kemi pasur kërkesa që janë bërë nga pacientët për raste urgjente, të cilat në fakt nuk janë shqyrtuar me kohë, gjë që ka mund t'u kushtojë me jetë pacientëve.

Ndërsa, kërkesat që kanë qenë pak më specifike, po që s'e kanë pasur urgjencë, ka pasur trajtim dhe shqyrtim të tyre diku me katër muaj vonësë.

Kam dashur ta pyes ministrin pse të gjitha këto parregullsi në një proces kaq të ndjeshëm dhe të domosdoshëm për pacientët e Kosovës?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri s'është këtu! Prapë zonja Kadrijaj, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

TIME KADRIJAJ: Këto ditë është publikuar një indeks i harmonizimit të çmimeve të konsumit, në të cilin hetohet se shporta e konsumatorit të qytetarët është shtrenjtuar dukshëm.

Raporti i fundit, në janar të këtij viti, tregon se jeta e qytetarëve të Kosovës po shtrenjtohet çdo ditë e më shumë. Çmimet e produkteve jetike, pa të cilat nuk mund të ushqehet dhe të jetojë, rrjedhimisht jetesa bëhet më e vështirë, siç janë mielli, vaji, sheqeri, qumështi dhe produktet e tjera kanë pasur rritje enorme të çmimeve krahasuar me vitin e kaluar, e të mos flasim për gjëra të tjera, siç janë çmimi i energjisë elektrike, që rritja e faturave të energjisë elektrike janë të papërbalueshme për xhepin e cekët të qytetarëve, duke e ditur se në Kosovë kemi një numër të madh të papunësuar, kemi raste të shumta sociale, kemi pensionistë, të cilët vështirë se mund ta përballojnë këto rritje të çmimeve.

A ka dijeni ministri dhe Qeveria për këtë rritje enorme të çmimeve të konsumit?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lahi Brahimaj, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Zoti Lahi s'qenka këtu.

Deputeti Ali Berisha, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Zoti Berisha, a dëshironi të bëni pyetjen?

ALI BERISHA: Do ta rezervoj të drejtën kur të jetë ministri këtu ta bëj pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftija, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë këtë pyetje e kam parashtruar qysh para Vitit të Ri, gjegjësisht më 17 dhjetor të vitit 2016 dhe meqenëse nga dy seanca nuk kam marrë përgjigje dhe meqenëse është një pyetje me interes të institucioneve të shëndetësisë publike, unë prapë e kam riproceduar këtë pyetje dhe desha të marr përgjigje nga ministri. Mirëpo, siç shihet, edhe në këtë seancë ministri mungon, prandaj këtë pyetje prapë po e lë që ta lexoj në seancën e ardhshme, ditën e enjte.

KRYESUESI: Nuk di a është gabim, apo çfarë është, por me siguri se e ke përsëritur pyetjen, sepse i ke dy data për të njëjtën pyetje, apo ndoshta keni një pyetje tjetër për Imet Rrahmanin?

BESA BAFTIJA: Siç e thashë, unë e kam bërë këtë pyetje në dhjetor të vitit të kaluar, meqenëse nuk kam marrë përgjigje në dy seanca dhe meqenëse është në interes të shëndetësisë publike, e kam riproceduar, ripërsëritur. Prandaj dua ta bëj kur ministri që po besoj se tani jo vetëm të ma jep përgjigjen, por edhe ka bërë zgjidhje në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Unë i kam dy pyetje tua këtu, me të njëjtën datë, pra me protokoll me numër tjetër. Për atë edhe të pyeta a e ke një apo dy pyetje?

Nuk ka pyetje të tjera, apo nëse ka ndokush që mendon se e kam kaluar, s'e besoj, mund ta marrë fjalën.

Pyetjet, siç e dimë që nuk kanë marrë përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Mirupafshim të enjten, në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*